Ekzsitojnë zona ekonomike të suksesshme në vende të ndryshme, disa prej të cilave janë prezantuar në vijim.169
Një model nga SHBA-të është Parku për Hulumtim "Cummings", i cili është model udhëheqës për transformimin e hulumtimeve që biznesi të jetë i suksesshëm. Me një përzierje të 500 kompanive lokale dhe ndërkombëtare të teknologjisë së lartë, ky park ka për qëllim rritjen e bizneseve, promovimin e përparësive ekonomike, zgjerimin e aktiviteteteve te anëtarëve, etj.

Zona e parë ekonomike dhe njëkohësisht dhe ndër më të njohurat në botë është Shenzhen, e themeluar nga Republika Popullore e Kinës në fillimin e viteve '80, e cila është një qendër e madhe e prodhimit dhe qendër e kompanive më të suksesshme high-tech të Kinës. Si rezultat i krijimit të zonës ekonomike, Shenzhen është tani një ndër qytetet më të pasura në Kinë.

Edhe Turqia ka një model shumë të suksesshëm të zonave ekonomike e cila është e njohur sidomos me ndarjen e zonave në bazë të veprimtarive siç është zona për përpunimin e arit, ajo për bujqësi si dhe ajo për tekstil. Turqia ka arritur t"i mbledh nëpër zonat ekonomike prodhuesit duke iu ofruar edhe stimulime shtesë siç janë lirimet nga taksat, përfitime qeveritare sipas kuantitetit të eksportit, etj.170.
TECH-GATE Vienna, Austria është poashtu një zonë ekonomike e njohur, e cila si fushëveprimtari të veten ka zhvillimin dhe hulumtimin, shkencën dhe biznesin, kompanitë e reja dhe ato me përmasa globale, telekomunikimin, teknologjinë informative dhe zhvillimin e softuerëve, bioteknologjinë dhe shkencat natyrore, nanoteknologjinë dhe teknologjinë e senzorëve, dhe teknologjinë e materialeve. Krijimi i kësaj zone ka mundësuar dhe mundëson punësim të sigurtë dhe kualitativ sidomos për banoret e zonës, inkurajim të një ambienti të ri për kompanitë e reja në fushën e teknologjisë, promovim të bizneseve dhe konkurrencës ndërkombëtare, si dhe përmirësim të dinamikës së inovacioneve dhe zhvillimeve.

Në Poloni ka 14 zona të veçanta ekonomike. Zona Ekonomike Speciale (ZES) është një kombinim i suksesshëm i nevojave të investitorëve dhe të nevojave të rajoneve të veçanta në të cilat ato janë krijuar. Çdo rajon është një njësi administrative e veçantë e territorit, të destinuara për përforcimin e punëve ekonomike në kushte të caktuara. Ndërmarrësit (kompanitë) në ZES kanë të siguruar lehtësim të taksave dhe një përfitim shtesë është fakti se kompania mund të fillojë të veprojë (varësisht nga lloji i biznesit) në një terren të përgatitur posaçërisht për veprimtarinë e kompanisë. Lejet për të kryer aktivitete ekonomike në ZES lëshohen nga autoritetet e çdo zone.

Në Bullgari një nga shembujt më të mirë të suksesshëm të partneritetit publik-privat është Zona Industriale në Rakovski e cila është e vendosur afër qytetit të Plovdivit. Sipas ekspertëve, për Zonën Industriale në Rakovski, zhvillimi i së cilës ka filluar në vitin 2004, ka mjaft të interesuar deri më tani dhe i ka të gjitha dispozitat për tu bërë Zona numër një në Bullgari.

Në Kroaci zonat ekonomike kanë karakteristikën e zonave të lira ekonomike dhe janë të vendosura pranë porteve të mëdha të Kroacisë, si Porti i Pulas, Porti i Riekës, Porti i Splitit, Porti i Dalmacias, etj. Zhvillimi i tyre është i ndryshëm në lokacione të ndryshme. Në përgjithësi, zonat e tilla kanë për qëllim tërheqjen e investimeve, veçanërisht të HDI-ve, si qendra tregtie ndërkombëtare për ata operatorë që i përdorin këto zona vetëm për pak kohë.

[169] MTI, Koncept Plani Kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë (2014-2018). http://www.zonatekonomike.org/repository/docs/Koncept_Plani_per_ZE_-_Final_857070.pdf
[170] GAP- Instituti për Studime të Avancuara, Ligji për Zonat Ekonomike: ndikimi i tij në zhvillimin e parqeve të biznesit, 2012, fq. 13.

Mali i Zi, ka miratuar ligjin për krijimin apo themelimin e zonave ekonomike të lira tregtare në vitin 2004. Ligji lejon lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit dhe punës në zona të tregtisë së lirë dhe ofron disa përfitime për investitorët së bashku me përjashtimin nga taksat, doganat dhe detyrave tjera. Mallrat dhe shërbimet që hyjnë në zonat e lira të tregtisë janë të përjashtuar nga TVSH-ja. Aktualisht, ka vetëm një zonë të tregtisë së lirë, e themeluar nga shteti brenda në Portin e Tivarit, e cila është pjesë e doganave në territorin e vendit.

Në Shqipëri historiku i zonave ekonomike fillon me përpjekjet për hartimin e kuadrit përkatës ligjor. Iniciativa për zhvillimin e Zonave Ekonomike gjenë shprehjen e saj procedurale në Ligjin për Zonat Ekonomike dhe konceptin e saj juridik në Ligjin e Koncesioneve. Kuadri ligjor bazë, Ligji i Koncesioneve si dhe Ligji për Zonat Ekonomike inkorporon praktikën më të mirë procedurale në zhvillimin e kësaj iniciative, duke qenë plotësisht konform legjislacionit evropian të ndihmës shtetërore për sa i përket trajtimit të Zonave të Lira Ekonomike.

Maqedonia është treguar tejet e suksesshme sidomos me zonat ekonomike përreth Shkupit, Tetovës dhe Stipit. Qeveria maqedonase përpos dhënies së tokave në shfrytëzim me çmim shumë atraktiv, ka ofruar edhe lirime nga taksat për 3-10 vitet e para të operimit të biznesit (e kjo varësisht nga lloji i biznesit prodhues) si dhe lirime nga tatimi në fitim për 50% në 5 vitet e para për punonjësit maqedonas të cilët i punëson firma171.

Zonat ekonomike në Kosovë

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Mbështetje të NVM-ve është mekanizëm institucional ekzekutiv për zbatimin e Ligjit për Zonat Ekonomike në Kosovë.
Zonat Ekonomike (ZE) janë një realitet i ri në Kosovë në kontestin e ekonomisë së tregut dhe si të tilla në një periudhë jo të largët do të bëhen bartës kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe industrializimit të vendit.
Ky koncept plan mbështetet në: Ligjin për Zonat Ekonomike, Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve, Kodin Doganor dhe të Akcizave, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, Planin dhe Vizionin për Zhvillimin Ekonomik, Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme dhe në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017172. Qeveria e Republikës së Kosovës duke pasur zhvillimin ekonomik në prioritet, si dhe rëndësinë që zhvillimi i zonave ka në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, ka vendosur për krijimin e zonave të lira ekonomike.
Sipas Ligjit të Zonave Ekonomike 04/L-159, përkufizimi "Zonë Ekonomike" definon territorin që ka një status të veçantë ekonomik. Nismat e para për krijimin e zonave ekonomike kanë filluar në vitin 2004/2005. Ndërsa ligji i parë i zonave ekonomike, Ligji Nr. 03/L- 129, u miratua në vitin 2009 si legjislacioni i parë mbi zonat ekonomike në Kosovë. Më pas, ky ligj u rregullua edhe me akte nën ligjore. Për të avancuar legjislacionin me praktikat më të mira në rajon, ky ligj u zëvendësua me ligjin e ri Nr.-04/L-159, në vitin 2013, ku përkufizimi i "Zonë ekonomike" nënkupton një zonë gjeografike në kuadër të territorit shtetëror, që ka një status të veçantë ekonomik, e krijuar për qëllime të promovimit, zhvillimit të bizneseve173.
Krijimi i zonave ekonomike në Republikën e Kosovës ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Kosovë duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e tyre, hapjen e vendeve te reja te punës dhe krijimin e të ardhurave, tërheqjen e teknologjive të përparuara; përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar; zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve; krijimin e kushteve për biznese për qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji dhe shërbime të tjera në mbështetje të biznesit si dhe rritjen e konkurrencës në biznesin vendor.

[171] GAP- Instituti për Studime të Avancuara, Ligji për Zonat Ekonomike: ndikimi i tij në zhvillimin e parqeve të biznesit, 2012, fq. 11.
[172] MTI, Koncept Plani Kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë (2014-2018). http://www.zonatekonomike.org/repository/docs/Koncept_Plani_per_ZE_-_Final_857070.pdf
[173] MTI/Agjencia për mbështetje të NVM-ve, Ligji për Zonat Ekonomike ka nr. 04/L-159 , Prishtinë, 2013 http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20zonat%20ekonomike.pdf

Zonat ekonomike dhe iniciativat në Kosovë janë:174

Parku i Biznesit në Drenas (PBD) që vleresohet si një projekt kapital, si përfshirje për të siguruar që ky park biznesi t'i shërbej zhvillimit ekonomik të Kosovës përmes gjenerimit të vendeve të punës, rritjes të të ardhurave, e në anën tjetër duke shërbyer si testim dhe model i një filozofie të re të zhvillimit të ardhshëm të ndërmarrjeve në Kosovë dhe për tërheqjen e IHD-ve. Ky park biznesi paraqet fazën e parë për krijimin e një zone të gjerë që është arritur në pjesën qendrore të Kosovës. Kompanitë e orientuara nga prodhimi i produkteve me vlerë të shtuar duke përfshirë edhe shërbimet, do të jenë synim për mbi 80% të hapësirës së parkut.
Parku i Biznesit krijon perspektivë për punësimin e deri në 1000 punëtorë, 40% e të cilëve do të jenë nga rrethina e Drenasit, pasi si zonë e tillë ekonomike ka për qëllim të ulë papunësinë në rrethinën në të cilën është ndërtuar ky park. Në Parkun e Biznesit në Drenas, kanë kontratë 41 biznese, ku tri prej tyre janë investime të huaja dhe 5 janë bashkëinvestim.
Parku i Biznesit – Mitrovicë, ku janë të vendosura 22 biznese të selektuara. Parku është i kompletuar me infrastrukturë fizike e cila ofron kushte optimale për zhvillim të bizneseve175.
Zona Ekonomike – Parku Industrial në Mitrovicë, e cila ka marre pëlqimin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe ka filluar punimet në nivelizimin e terenit.
Zona Ekonomike-Parku Teknologjik në Shtime,e cila është pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal - Shtime. Në të parashihen vendosja e 15 Bizneseve të vogla dhe të mesme të karakterit kryesisht prodhues dhe në të cilën parashihen të punësohen rreth 600 punëtorë, i cila ka marre pëlqimin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe ka filluar punimet në nivelizimin e terenit.
Iniciativat e krijimit të zonave ekonomike në Kosovë të cilat ndodhen në fazën e legalizimit janë: Parku i Biznesit – Vushtrri, Parku Industriale Holandez "Zinkunie" Prizren, Zona Industriale në Suharekë , Zona Ekonomike - Gjilan/Novobërdë.
Me qëllim të tërheqjes së investimeve vendore dhe të huaja janë themeluar zonat e lira ekonomike në bazë të propozimit të Ministrisë dhe konsultimit me Doganat e Kosovës dhe komunën në territorin e së cilës parashikohet të themelohet zona e lirë. Këtu bëjnë pjesë: zona e Lirë Ekonomike në Mitrovicë, zona e Lirë Ekonomike në Gjakovë dhe zona e Lirë Ekonomike në Prizren176.

Vlerësimi i përgjithshëm për zonat ekonomike

Vlerësimi për zonat ekonomike në vende të ndryshme është bërë në bazë të analizave të ZE, parqeve industriale, parqeve shkencore, parqeve teknologjike, në aspektin e organizimit dhe mënyrës së funksionimit të tyre: për zonat ekonomike publike dhe ato private177.

Zonat ekonomike publike kanë një zhvillim më të hershëm në krahasim me zonat ekonomike private, sepse zhvillimi i këtyre zonave ka filluar shumë më herët, duke pasur parasysh se shtetet kanë pasur programe zhvillimore në të cilat kanë investuar nëpër pjesë të ndryshme të vendit duke implementuar programet e tyre zhvillimore. Në këto zhvillime ka pasur ndikim edhe mënyra e organizimit shtetëror në të kaluarën dhe tani.
Te disa shtete (psh. shtetet e rajonit) ndikim në zhvillimin e zonave industriale ekonomike ka pasur organizimi politik i shtetit dhe qasja e shtetit ndaj kapitalit si dhe politikat zhvillimore për kapitalin privat. Në disa shtete, zonat ekonomike publike vazhdojnë të jenë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Orientimi i këtyre zonave është drejt investimeve të huaja dhe promovimit të ekonomisë, bizneseve vendore, etj.

Zonat ekonomike private janë më pak të shtrenjta për t'u zhvilluar dhe kanë kosto të ulët operacionale në krahasim me zonat ekonomike publike të një vendi si dhe japin rezultate më të mira ekonomike.

[174]MTI, Koncept Plani Kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë (2014-2018). MTI-KIESA, web faqe per zonat ekonomike ne Kosove: http://www.invest-ks.org/sq/zonat-ekonomike
[175]MTI/Agjencia për mbështetje të NVM-ve, Zonat ekonomike, Prishtinë 2013
[176]KIESA-Agjencia per investime dhe perkrahjen e ndermarrjeve ne Kosove, MTI, http://www.zonatekonomike.org/sq/zonat-e-lira-ekonomike
[177]MTI, Programi per menaxhimin e zonave ekonomike ne Kosove, hulumtim nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji, 2011. http://www.zonatekonomike.org/repository/docs/Programi_per_menaxhimin_e_Zonave_Ekonomike_602829.pdf

Në tërësi, zonat private kanë tendencë që të ofrojnë infrastrukturë dhe shërbime më të mira, marrin çmime më të larta nga qiramarrësit. Si rezultat, zonat private në përgjithësi kanë qenë më fitimprurëse dhe kanë pasur performanca më të mira sociale dhe mjedisore se sa zonat publike në të gjithë botën178.
Krijimi i zonave ekonomike duhet bërë pas një studimi të fizibilitetit - arsyeshmërisë financiare, gjithnjë duke pasur parasysh kosto-përfitimin dhe periudhën e kthimit të investimit.
Përvojat e vendeve të ndryshme tregojnë se deshtimi apo suksesi i zonave ekonomike është i lidhur me kornizën dhe politikat nxitëse, ku janë të vendosura dhe si ato janë te zhvilluara dhe të menaxhuara. Problem i cili paraqitet lidhur me arritjen e një performance optimale të zonave ekonomike është mungesa e koordinimit efektiv të të gjithe akterëve të përfshirë në aspektet procedurale dhe fizike të vet zonës ekonomike179.

Përfundim

Krijimi i zonave ekonomike në Republikën e Kosovës ka për qëllim të inkurajojë investimet në Kosovë, duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e tyre, të mundësojë hapjen e vendeve te reja të punës dhe krijimin e të ardhurave, tërheqjen e teknologjive të përparuara, të zgjerojë bashkëpunimit mes bizneseve, të krijojë kushte për biznese për qasje më të lehtë në lidhje, transport, furnizimi me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit, të rrisë konkurrencën në biznesin vendor, etj.
Nevojiten lehtesira tatimore, doganore, lirim nga taksat komunale dhe mbështetetje me politika fiskale, sidomos në fillim të veprimtarisë së bizneseve dhe se kjo përkrahje duhet të jetë e vazhdueshme me qëllim të krijimit të një ambienti më të favorshëm për bizneset që do te investojnë në kuadër të zonave ekonomike.
Është i nevojshëm një vlerësim i tyre pas një periudhe të caktuar kohore të funksionimit të tyre lidhur me përfitimet e arritura nga krijimi dhe funksionimi i zonave ekonomike dhe rezutatet e arritura të krahasohen me objektivat e parashtruara, për të nxjerrur mësimet për zonat ekonomike të tjera të cilat do të mund të krijoheshin në vazhdimësi.

Literatura

Callea, L.Publication of the economy zone of the Trieste, Geographic position, Trieste, 2012.
FIAS, Special economic Zones performance, leS onS learned, and implicationS for Zone development 2008
GAP- Instituti për Studime të Avancuara, Ligji për Zonat Ekonomike: ndikimi i tij në zhvillimin e parqeve të biznesit, 2012.
ILO, Export processing zones groëing steadily, Geneva, 2003
Kristo, I., Informacioni dhe kërkimi në marketingun ndërkombetar , Tiranë 2010.
MTI - Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve "Raporti Vjetor" Prishtinë, 2012.
MTI, "Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve 2012 – 2016 me Vizion deri 2020" Prishtinë, 2011.
MTI, Koncept Plani Kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë (2014-2018). http://www.zonatekonomike.org/repository/docs/Koncept_Plani_per_ZE_-_Final_857070.pdf
MTI, Programi për menaxhimin e zonave ekonomike në Kosovë, hulumtim nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji, 2011, http://www.zonatekonomike.org/repository/docs/Programi_per_menaxhimin_e_Zonave_Ekonomike_602829.pdf
MTI/Agjencia për mbështetje të NVM-ve, Ligji për Zonat Ekonomike ka nr. 04/L-159, 2013. http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20zonat%20ekonomike.pdf
MTI/Agjencia për mbështetje të NVM-ve, Zonat ekonomike, Prishtinë 2013.

[178]MTI, Programi per menaxhimin e zonave ekonomike ne Kosove, 2011.
http://www.zonatekonomike.org/repository/docs/Programi_per_menaxhimin_e_Zonave_Ekonomike_602829.pdf
[179] Burimi i njëjtë.

MTI-Agjencia per Mbeshtetjen e NVM-ve, Dokument i specifikimit të kushtet dhe kriteret për tu vendosur në PBD, Prishtinë, 2010.
Buzhala, N. Punim masteri, Fakulteti Ekonomik UP, 2014.
The World Bank, Export Competitiveness and Export Processing Zones, Washington, 2012
Xhelili –Krasniqi, F."Vetë-punësimi për rimëkëmbjen ekonomike lokale", Konferenca "Biznesi dhe punësimi", 2004.
Prenaj, V. "Influence of Economic Zones to attract investors" Society Internationalization – Effectivity and Problems. University of Zenica, Public University of Peja "Haxhi Zeka" and European University College Dukagjini, 01,02 June 2012
Web faqe per zonat ekonomike:
MTI-KIESA, web faqe per zonat ekonomike ne Kosove: http://www.invest-ks.org/sq/zonat-ekonomike
The Port Trieste wants a modern free trade zone, Trieste, 2012. http://www.portstrategy.com/news101/world/europe/trieste-wants-modernisation-to-increase-traffic
Zona e Lirë Shannon, Irland www.shannonireland.com
Meaning and definition of Special Economic Zone (SEZ), 2011 http://www.indiastudychannel.com/experts/23961-Meaning-definition-Special-Economic-Zone-SEZ.aspx

PROF. DR. FAHRUSH REXHEPI – INTEGRIMI I SHQIPTARËVE MUSLIMAN NË EVROPË DHE ROLI I FESË NË SHOQËRI

PROF. DR. FAHRUSH REXHEPI
Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame, Prishtinë

Abstrakt

Integrimet multikulturore, multifetare dhe multinacionale ndërmjet popujve dhe shoqërive me diversitete të ndryshme kombëtare, kulturore dhe fetare është në të vërtet një synim dhe një sfidë për të gjitha kombet dhe shoqëritë e rajonit të Ballkanit, por edhe më gjerë. Trajtimi i temave me përmbajtje të tilla në këtë konferencë orienton dhe kontribon kah avansimi i promovimit dhe kultivimit të vlerave kulturore, paqësore, tolerante dhe të dialogut në shoqëritë shumë etnike dhe multikonfesionale në Kosovë, në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.
Angazhimi i bashkësive fetare dhe i personaliteteve fetare në proceset kulturore, politike, integruese dhe në paqëndërtim, mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërive në Ballkan, dhe një përgjegjësi sa kombëtare po aq edhe fetare e këtyre njerëzve për të cilët ka nevoj çdo shoqëri.
Besimet fetare kërkojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe predikojnë barazi midis qenieve njerëzore. Ato hedhin poshtë çdo formë të diskriminimit racial, fetar dhe kulturor duke bërë thirrje për lirin e të gjithëve, pa inponim në fe dhe ndërhyrje në lirin individuale të njerzve. Edhe islami bënë thirrje për njohje, dialog dhe bashkpunim reciprok ndërmjet popujve dhe kombeve për të rritur stabilitetin dhe garantuar paqën në rajonin e ballkanit, por edhe më gjërë.
Edhe librat e shenjta qiellore ftojnë për dialog, marrveshje dhe bashkpunim mes pjestarëve me besime të ndryshme. Kur'ani, libri hyjnor i muslimanve duke folur për dialog dhe bashkpunim fton duke thenë: " O ithtarë të librit, ejani të bashkohemi (të dialogojmë) rreth gjërave të përbashkta edhe për ju, edhe për ne: të adhurojmë vetëm një Zot e mos t'i bëjmë asnjë shok Atij dhe mos ta marrim njëri-tjetrin për Zot, në vend të Perëndisë".

Fjalët kyqe: dialog, paqe, islam, tolerancë

Roli i fesë në shoqëritë moderne

Kontributi dhe roli i bashkësive fetare dhe i fesë si dhe bashkpunimi i tyre me institucionet publike shtetrore në ndërtimin e paqës dhe në zhvillimin e proceseve multinacionale, multikonfesionale si dhe në ato politike dhe integruese, është shumë i rëndësishëm dhe mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërive dhe një përgjegjësi sa fetare e humane po aq edhe politike e shtetrore për të cilat ka nevojë çdo vend.
Besimet fetare kërkojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe predikojnë barazi midis qenieve njerëzore. Ato hedhin poshtë çdo formë të diskriminimit racial, fetarë dhe kulturor duke bërë thirrje për lirinë e të gjithëve , pa inponim në fe dhe ndërhyrje në lirinë individuale të njerëzve.
Islami si fe hyjnore në vazhdimsi bënë thirrje për njohje, dialog dhe bashkpunim reciprok ndërmjet popujve dhe kombeve për të rritur stabilitetin dhe garantuar paqën në Kosovë, në rajon dhe në botë. Njerëzit janë krijuar të ndryshëm për t'u njohur në mes vete, e jo për të treguar, e shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit. Këtë e theksoi Kurani që në fillim të shpalljes së tij:"O njerëz! Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli e një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri – tjetrin. Më fisniku tek All-llahu është ai, i cili më shumë e ka frik Atë. All-llahu, me të vërtetë është shumë i ditur dhe i informuar mirë".180

[180] Kur`an: *(Huxhurat, 13)*

Për të luajtur rol feja dhe institucionet fetare në shoqërinë kosovare dhe gjithkund në botë, atyre duhet dhënë më shumë hapsirë në jetën publike, në jetën mediatike dhe në institucionet tjera qofshin ato të arsimit, të shkencës dhe kulturës. Thjeshtë feja dhe roli i saj nuk duhet të vështrohet si diçka që nuk e ka vendin në institucione dhe në jetën publike të shoqërisë sonë, dhe si diçka që duhet të mbetet private dhe e izoluar.
Ne mendojmë se bota sot por edhe të gjithë shoqëritë tona kanë nevojë për energji fetare, të cilën shumë vende po e shfrytëzojnë ngase laicizmi është treguar i pasukseshëm në zgjidhjen e problemeve shoqërore e veçmas atyre morale e shpirtërore.
Këtë e vërteton fakti i pa kontestuar se sot bota posedon pasuri dhe të mira materiale më shumë se kurrnjëher më parë, por aq sa të shtohen begatitë dhe të mirat materiale aq më shumë shtohen pasiguria dhe rrezikimi i paqes. Pra gjykohet kështu ngase besimi i pastërt dhe i sinqertë në Krijuesin e gjithsisë është i vetmi burim , i cili te individi dhe shoqëria prodhon pandërprerë paqë, qetësi dhe stabilitet. Lidhur me këtë një citat Kur'anor thotë: "Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatrruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurtë dhe ata janë në rrugë të drejtë"181 .
Bota njerzore sot duke rënë nën ndikimin e plotë të materies dhe duke harruar komponentin tjetër të përbërjes së tij , shpirtëroren, ka rënë nën ndikimin e ligjit të vetëvlersimit, që nënkupton zbatimin e ligjit më të fuqishmit, i cili është sistem i botës shtazore, e jo i botës njerëzore.
Edhe në ligjerimin politik e akademik perëndimor hasim disa pikëpamje mbi natyrën, vendin dhe rolin e fesë në botë në përgjithsi dhe të islamit në veçanti përsa i përket aspektit politik dhe zgjidhjes së konflikteve. Për në fillim më janë dukur më të përshtatshmit dhe më interesante dy vlerësime. Njëri është i rabninit të Anglis Dr. Xhonatan Saksit, i cili ka thënë: "Feja është bërë forcë madhore në formësimin e ngjarjeve në botë dhe nëse nuk është pjesë e zgjidhjes është me siguri pjesë e problemit"182
Ndërsa vlerësimi tjetër, është i ish presidentit të SHBA-ve , Xhimi Karter, i cili është shprehur se : "Vitet e fundit besimi fetar ka hyrë në një shkallë të pabesueshme në mbretërinë e politikës … dhe se… ka një prirje drejtë fondamentalizimit në të gjitha fetë".183 Madje, për ndikim e teolgjisë në politikën e SHBA-ve kuptojmë edhe më shumë nga drita e mendimeve të Xhimi Karterit i cili thekson se: "Besime teologjike ngushtësisht të përcaktuar janë pranuar si rend i rreptë dite nga një parti politike…Disa nga udhëheqësist fetarë kanë qenë në vijën e parë të frontit për të na çuar në luftën e Irakut" (Vlerat tona në rrezik, 2005 f. 7, 114). Ideja se teologjia ndikon shumë në politikën shtetrore amerikane është objekt shtjellimi në 400 faqet e librit të Kevin Filips "Teokracia amerikane" (American theocracy 2006).184
Nëse i referohem një shkrimi të Kardinalit Ratzinger (Papa Benedikti XVI) të botuar në revistën gjermane "Cicero" do të shohim se sa e nevojshme është për perendimin besimi në fe dhe në Zot. Ai ndër të tjera në këtë revistë shkruan: "Perendimi vuan nga një vetëurrejtje e quditshme, e cila s`mund të quhet ndryshe përpos patologjike… Për të mbijetuar Evropa duhet t`a pranoj veten në një mënyrë të re… një botë pa Zot nuk ka ardhëmri … Evropa është e sëmurë".185
Sa i përket islamit, ai është program që jep shpjegimin realist të jetës dhe si fe përkon me natyrën njerëzore. Më saktë ai është: "një vetëdije e thellë politike, përshkak të një konceptimi të përgjithshëm dhe të kompletuar mbi jetën, universin, shoqërinë, politikën, ekonominë dhe etikën".186 Mbështetur në këtë premisë islami ofron vizionin e një jete civilizuese ku duhet të mbretëroj ligji, rendi, paqa dhe drejtësia në jetën shoqërore. Islami rregullon marrëdhëniet njeri - njeri, njeri -shoqëri, njeri - natyrë dhe njeri – Krijues.

Shqiptarët musliman dhe integrimi në BE

Kur jemi te integrimi dhe roli i fesë dhe muslimanëve në këtë integrim, për shkak se shumica e shqiptarëve në trojet shqiptare i përkasin besimit islam, ka pasur shpeshëher opinione, polemika dhe

[181] Kur`an: (El-Enam. 82)
[182] Kliford Longli "Populli i zgjedhur" (Clifford Longley, "Chosen people…", Angli, 2002, f.148).
[183]Jimmy Carter "Our endangered values. America's moral crisis", 2005, fq.16,30.
[184] Abdi Baleta, *"Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që islami përcjellë në këtë integrim",* Simpozium Kombëtar, 2008, fq. 71.
[185]Kardinali Ratzinger, Revista " Cicero", qershor, 2004.
[186]Muhamed Bakir ess- Sadër, Filozofia jonë, Prishtinë, Zëri ynë, 2006, fq.67.

debate në të cilat ky fakt është konsideruar si një penges për integrimin e shqiptarëve në mekanizmat ndërkombëtar.
Ne mendojmë se këto opinione janë të gabuara dhe janë përpjekje të paargumentuara sepse pa shqiptarët musliman nuk mund të ketë as shtet as komb, nuk mund të ketë as tolerancë ndërfetare as tolerancë multietnike e kësi soji nuk mund të ketë as unitet, e as integrim të brendshëm ndër shqiptar, dhe në fund as integrim ndërkombëtar.
Është mrekulli e mrekullive se si nën kthetrat e disa perandorive arritën të mbijetojnë shqiptarët nëpër shekuj, pa u nda dhe pa u tretur asnjëher. Me pranimin e fesë islame nga shumica e shqiptarëve, shqiptarët jo vetëm që mbijetuan, por edhe shpëtuan nga asimilimi dhe shkombëtarizimi. Të vërteta të qëndrueshme janë fjalët e Faik Bej Konicës i cili thotë: "Të mos ishte feja islame, populli shqiptar do të ishte shumë më tepër por jo shqiptar...187. Të vërteta të qëndrueshme janë edhe fjalët e Stavro Skëndit i cili në librin "Historia e Rilindjes Kombëtare" të botuar në universitetin "Princeton" të Nju Xhersit, në SH.B.A. , shkruan: "Shqiptarët musliman përbënin shumicën dhe pa ata nuk mund të kishte Shqipëri".188

Shqiptarëve musliman nuk u ka munguar asnjëher edhe klasa e formuar intelektuale shumë profesioniste e prijësve të tyre islam. Ata kanë treguar gjat gjithë historisë së tyre, se islami si pjesë e rëndësishme e identitetit të tyre, ka qenë dhe do të jetë përherë një shtytës dhe një mobilizues i rëndësishëm i angazhimeve dhe aspiratave të tyre kombëtare dhe kulturore. Ata kanë besuar vazhdimisht, se atdheu i tyre është pjesë e pandarë e një nocioni gjeografik që quhet Evropë, sikurse kanë qenë të bindur gjithmonë se mirëqenia e tyre në trojet e veta është e lidhur pashmangshëm në nxitjen, përkrahjen si dhe promovimin e vazhdueshëm të vlerave të bashkëjetesës, bashkëekzistencës dhe mirëkuptimit me fqinjët e tyre, së pari, si dhe me të gjithë pjestarët e tjerë të familjes gjeografike, së cilës natyrshëm ata i përkasin.
Lidhur me integrimin e shqiptarëve sot në mekanizmat ndërkombëtare evropian mendojmë se shumica apsolute e popullatës së Kosovës janë pro integrimeve evropiane, pavarësisht nacionalitetit apo fesë që i përkasin. Mirëpo, shqiptarët do të pranonin të integrohen në Evropë me vlerat kulturore dhe me identitetin e tyre kombëtar, gjuhësorë, kulturor dhe tradicional e jo të qveshur nga këto ndjenja. Shqiptarët sot jo rrallëherë po përballen me sfida të tjetërsimit kulturor, sepse ndryshku moral, gjuhësor.shpirtëror, fetar e kombëtar po përhapet me shpejtësi ndërshqiptarët në Kosovë dhe jashtë saj.

Shqiptarët në Kosovë janë pro integrimeve evropiane dhe duhet të jenë pro këtyre integrimeve në BE, por jo drejt asimilimit të identitetit kulturor. Për të kuptura më mirë se në çfarë raporti gjenden integrimi dhe asimilimi kur bëhet fjalë për Bashkimin Evropian, ne duhet ta ndajmë të kuptuarit tonë në dy çështjë thelbësore.
Së pari: A është në të vërtet Bashkimi Evropian i integruar në vetvete dhe cili është të kuptuarit e këtij integrimi nga antarët e BE-së në raport me shtetas të kulturave dhe etnive të ndryshme? Së dyti : Cili është qendrimi i BE-së në procesin e integrimit, kur bëhet fjalë për shqiptarët si përfaqësues të një identiteti kulturor të ndryshëm me BE-në dhe pozicionimi i lidershipit politik shqiptar? Në spektrin shqiptar integrimi në strukturat e BE-së ka marrë forma dhe trajta të ndryshme. Ashtu si në pjesën më të madhe të vendeve të Ballakanit, integrimi për pushtetarët shqiptar është kthyer në një prioritet të shkallës së parë. Por në ndryshim nga vendet e tjera aspirante për t`u bërë anëtare të BE-së, shqiptarët si bartës të një identiteti kulturor të ndryshëm, përballen me një realitet integrues, sa të veçantë, aq edhe qesharak. Të veçantë në trajtimin që BE duhet t`i bëjë Kosovës dhe shqiptarëve të shpërndarë në të gjitha vendet ballkanike, që aspirojnë integrimin dhe qesharak në politikat, strategjitë që ndjekin shpesh qeveritë dhe elita kulturore shqiptare. Nga ana tjetër qeveritë dhe elita kulturore shqiptare e kanë shpallur integrimin në BE si shpëtim përfundimtar dhe si parajsa e zgjidhjes së të gjitha problemeve. Për këtë arsye gjatë kësaj dekade të fundit po përthithin pa filtër fare gjithçka që është oksidentale duke tentuar hapur të dëmtojnë apo të transformojnë strukturën e AND-së tonë identitare. Ndërkohë që Bashkimi Evropian akoma nuk e ka kaluar sprovën e pranimi të anëtarëve me identitet religjioz të ndryshëm nga i saji, shqiptarëve u mbetet të tregojnë vlerat e veta si një popull, i cili ka

[187] Faik Ali Hoxha- Kasollja , Në pragun e misticizmit, Tiranë, 2002, fq.15.
[188] Integrimi i shqiptarëve në evropë dhe vlerat që islami përcjell në këtë integrim, Kavaj, Shkurt, 2008, fq.8.

ditur për gjatë historisë të bëjë zgjedhjet e duhura. Ndoshta ne shqiptarët duke ruajtur identitetin tonë mund ta ndihmojmë BE-në të kapërcejë muret ndarëse, frikën dhe fobirat që vijnë si kujtim nga e kaluara.

Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut sipas modelit islam

Sistemi islam nuk është i kufizuar vetëm në të drejtat e ithtarëve të tij, gjë që në fakt e dallon Islamin nga të tjera sisteme jo vetëm të asaj kohe, por edhe të mëvonshme. Aty jomuslimanët dhe muslimanët marrin pjesë në shumë të drejta të përgjithshme, të cilat askush nuk arriti t`i siguroj më parë.
Allahu i madhëruar thotë: "Ne i nderuam të gjithë pasardhësit e Ademit". Këtu duket qartë thirrja që bënë Kurani për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare.
Islami nuk i ka detyruar njerëzit të hyjnë në këtë fe me dhunë, kështu që edhe jomuslimanëve u ka lënë liri të plotë të qëndrojnë në fenë e tyre, duke mos i detyruar të përqafojnë islamin. Në Kuran citohet: "Sikur të kishte dashur Zoti yt (o Muhamed), do t`i besonin Atij të gjithë banorët e tokës. A ti do t`i detyrosh njerëzit të bëhen muslimanë?"189
Një tjetër precedent shumë i rëndësishëm historik, në këtë kontekst është edhe Muri i Vajtimit në Jeruzalem, të cilin sot hebrenjët e konsiderojnë të shenjtë në lutjet e tyre. Dikur ky mur ishte i fshehur mes mbeturinave. Kur dëgjoi për këtë, Halifi i shtetit islam, sultan Sulejman Kanuni, dërgoi prijësin islam të Jeruzalemit me urdhër që ta pastroj vendin dhe t`i lejoj çifutët që ta vizitojnë atë vend. Orientalisti anglez Tomas Arnold thotë: "Ne asnjëherë nuk kemi dëgjuar për ndonjë përpjekje për të detyruar jomuslimanët për të pranuar Islamin apo për ndonjë persekutim të organizuar që ka pasur për qëllim zhdukjen e Krishterimit. Në qoftë se Halifët muslimanë do të kishin zgjedhur një nga këto plane, ata do ta kishin fshirë Krishterimin nga faqja e dheut po aq lehtë siç u bë me Islamin gjatë kohës së Ferdinandit dhe Isabelës në Spanjë."190

Islami dhe paqja nga këndvështrimi perendimor

Dihet mirëfilli se feja islame nuk është fe e luftës dhe as nuk nxitë dhunë edhe pse një pjesë e njerëzve nga shumë shoqëri të botës e akuzojnë islamin si fe të luftës. E vërteta është se islami është fe e paqës, tolerances, dialogut, marrveshjes dhe nuk e lejon luftën, përveç në raste kur është më se e nevojshme ajo, kur s'ka ndonjë rrugë tjetër përpos saj, si dhe nuk e justifikon muslimanin që të shpresojë në luftë, apo të thërras në të qoftë edhe ndaj agresorve, ndaj abuzuesve, nga se duhet provuar mjetet tjera paqësore, nëse kanë efekt, në mënyrë që të mos derdhet gjaku përmes armëve, por të përdoren metodat tjera për eleminimin dhe shmangien e luftës.
Në këtë kontekst Pejngamberi a.s thoshte: " O ju njerëz mos shpresoni në takim me armikun, luteni Allahun për shëndet të mire, e nëse i takoni armiqët (në betejë) dijeni se Parajsa është nën hijen e shpatave", e pastaj ai thoshte: " O Zot zbritës i librave, shtytës i reve, mposhti ata dhe mundësona të ngadhnjejmë ndaj tyre".191
Islami, jovetëm që nuk nxitë luftën e dhunën, por edhe është kategori kundër këtij fenomeni, madje mbytjen e një njeriu të pafajshëm e konsideron si mbytje të tërë njerzimit: "…kush mbytë një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatrrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si ta kishte mbytur gjith njerëzimin. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si ta kishte ngjallur (shpëtuar) gjithë njerzimin".192
Kur flasim për islamin dhe paqen ose të kundërtën, islamin dhe luftën, apo ekstremizmin nga këndvështrimi perëndimor patjetër duhet ti rikthehemi edhe një herë ligjërimit politik perëndimor, por pa e harruar edhe konstatimin e ish presidentit të SHBA-ve, Xhimi Karter , për "praninë e fundamentalizimit dhe ekstremizmit në të gjitha fetë". Ky konstatim dhe shumë konstatime të personaliteteve dhe të studijuesve të tjerë na bënë ta kuptojmë se ekstremizmi nuk ka ngjyrë dhe nuk njeh kufij.

[189] Kur`an: (Junus, 99).
[190] Kreshnik Osmani, "Standardet e integrimit evropian, janë kërkesa islame përpara se të jenë kushte për integrim", në : "Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që islami përcjell në këtë integrim". Kavajë, shkurt, 2008, fq.26-27.
[191] Transmeton Buhariu, Libri i xhihadit, nr. i hadithit 2821. Muslimi, nr. i hadithit 3276.
[192] Kur`an: (El-Maide, 32).

Nga fetë më të përhapura monoteiste në botë, islami është bërë tema madhore dhe më e mprehtë e ditës në ligjërimin perendimor politik. Në kuadër të këtij ligjërimi "hapësira islamike u bë qendra nervore e universit tonë të vënë në rrugën e mondializimit".193 Këtu lindën edhe kundërthëniet rrethë hipotezave nëse perendimi po i vënte në shënjestër islamin e muslimanët për të plotësuar nevojën për një armik të ri, që të ruaj kompaktësin e tij si sistem dhe si politikë, apo me të vërtetë perendimi ndihej dhe ishte i kërcënuar nga rreziku i quajtur fundamentalizëm dhe terrorizëm islamik.
Kur e shtrojmë këtë dilemë dhe kur e ngrejme këtë pyetje, ndoshta përgjigjen mund ta gjejmë në veprën "Islami dhe miti i konfrontimit…" i autorit Fred Hollidei. Ai përmes kësaj vepre paralajmëronte se: "Pas mbarimit të luftës së ftohtë duket se rivalitete të reja do ta zëvendësojnë atë, një prej të cilëve është ai midis islamit dhe perendimit".194 Ndërsa Xhon Espozito ka shkruar se: "Shekulli XXI to të mbizotrohet nga ndeshja globale e dy feve me rritjen më të shpejtë, krishterimit dhe islamit". Këtë mendim e ka shprehur në veprën e tij "Lufta pashenjtëri".
Megjithatë pasë tragjedisë së 11 shtatorit 2001, sulmi ndaj islamit dhe muslimanëve u bë pothuajse modë për televizionet, radiot dhe mediat tjera të shkruara perendimore. Shkrimtarë, studiues, analistë, politikaj, dhe autorët anti-islam përpiqen të jenë kopje e njëjtë e Steve Emersion, në kohën kur islami portretizohet si fe që promovon dhunën dhe luftën.195 Hirësia e tij Jerry Fallvell pas 11 shtatorit pati deklaruar se : "Muhamedi është terrorist, kurse islami është fatkeqësi". Ndërkohë që Pat Robertson e ka quajtur islamin armik, kurse për muslimanët ka thënë: "Muslimanët janë më të këqij se nazistët".196
Islamofobia ishte përhapur edhe në vende të tjera të perendimit, sidomos në Francë. Kështu Patrik De Klark, shkrimtar dhe analist francez, i cili në gazetën e njohur franceze "Le Monde" boton një artikull me titull : "Unë e urrej islamin", në të cilin, ai e sulmon islamin me shprehjet dhe atributet më të këqija duke thënë: "Ai sjell marrëzinë, sepse ai bënë segregacion mes dy gjinive…. sistemi i të menduarit të tij mbështetet në luftën e shenjtë".197
Shembuj të këtillë ka përplot. Por, në këtë rast vlen të përmendet edhe ana tjetër e medaljes. Pas ngjarjeve tragjike të 11 shtatorit, një numër i konsiderueshëm i intelektualëve perendimor u solidarizuan me popullaten muslimane si në SHBA ashtu edhe në Evropë, duke bërë dallimin ndaj një përjashtimi të një grupi ekstremistësh dhe islamit si fe universale dhe muslimanëve si popull, të cilët jetojnë në të gjitha kontinentet e Botës.

Përkrahësit e ideve më të ashpra në ligjërimin perendimor për islamin shpeshëherë shprehin pakënaqësi dhe zemërim, kur politikanët e rëndësishëm perendimor i thonë disa të vërteta publikisht, ose mbajnë qëndrime neutrale ndaj islamit për nevoja të realpolitikës. Atyre nuk u konvenon kur ish-presidenti amerikan Bill Klinton, ish-sekretarja e shtetit Medlin Ollbrajt, apo sekretarja e mëvonshme e shtetit Hilari Klinton deklarojnë e lavdërojnë, se virtytet e vlerat e islamit janë të mirëpritura në Amerikë, sepse pasurojnë vendin me mësimet për vetëdisiplinën , mëshirën, përkushtimin ndaj familjes, solidaritetin e respektin për të gjithë, paqën…198.
Studiuesja e njohur e islamit Karen Amstrong, e cila ka shkruar disa libra dhe artikuj për islamin, para opinionit amerikan dhe atij perendimor ka shtruar disa pyetje: "Nëse islami është aq i keq, ashtu siç paraqitet nga mediat perendimore, si është e mundur që ai të përhapet me një shpejtësi marramendëse në perendim?!".199 Ajo pastaj shtron edhe këtë pyetje: "Ku është shpata e islamit tash? "Islami është fe e paqës, por muslimanët nuk janë lënë të qetë për një kohë të gjatë nga kryqtarët e së kalauarës dhe të tashëm…islami nuk është i dhënë pas lufte, lufta nuk është njëra prej 5 shtyllave të islamit…".

Ne mendojmë se islami si i tillë nuk përbënë kërcënim për askënd, por, islami ekstrem, radikal ashtu si çdo ekstremizëm tjetër fetar kërcënon shoqëritë në shumë drejtime, madje edhe në mesin e

[193] Aleksandër Adler "Në takim me islamin" f. 75.
[194] Fred Hollidei, "Islami dhe miti i konfrontimit…", 1996, f.2.
[195] Indianapolis Star, December 4, 2002, Column by Cal Thomas.
[196] Mr. Qemajl Morina, Edukata Islame (Revistë shkencore kulturore islame, nr. 84, Prishtinë, 2007, f.5).
[197] Po aty, f.6.
[198] Abdi Baleta, *Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që islami përcjellë në këtë integrim* (simpozium kombëtar) , 2008, f. 63.
[199] Rime Magazine, 17.09.2001, the true peaceful face of islam.

muslimanëve. E gjithë kjo vije si pasojë e keqinterpretimit të islamit nga grupe e rryma të ndryshme intolerante, të cilat luftën për pushtet dhe për motive tjera e mbështjellin me dogma fetare. Ndarja në sekte, në fraksione , në lëvizje me karakter lokal e nacional, e ka sfiduar nëpër kohë përmbajtjen plotësisht universale dhe paqësore të islamit hyjnor, edhe në mesin e besimtarëve musliman, e më shumë në sytë e të tjerëve.

Paqja sipas burimeve themelore të islamit

Për ta vlerësuar një fe, apo një sistem a shoqëri se sa është paqësore dhe tolerante mendojmë se kriter është që të analizohen dhe të shiqohen dispozitat dhe ligjet e asaj feje apo të atij sistemi si dhe historia e zhvillimit të asaj shoqërie. Sa më fisnike dhe bujare të jenë dispozitat e një feje, aqë më paqësore dhe tolerante do të jetë ajo fe dhe aq më të mëdha do të jenë predispozitat e saj për t`u bërë fe universale.
Nëse i analizojmë dhe i zbërthejmë mirë burimet kryesore të fesë islame, kur`anin dhe traditën profetike do të shohim se që të dyja këto burime me normat dhe rregullat e tyre në mënyrë reale trajtojnë çështjen e tolerancës, barazisë dhe të bashkëjetesës ndërmjet besimtarëve me përkatësi të ndryshme fetare dhe kombëtare.
Në vazhdim do të citojmë disa ajete kur`anore në të cilat theksohet qartë liria e besimit: citojmë; "Në fe nuk ka shtyerje me dhunë"200. Ndërsa në ajetin tjetër theksohet se zgjidhja përfundimtare e besimit është çështje personale: "Thuaj: e vërteta është nga Zoti juaj, prandaj kushdo le të besoj, kushdo le të mos besoj"201.
Koncepti paqësor ndaj besimeve të tjera vërehet edhe në ajetin tjetër në të cilin thuhet: "Ti këshillo, ti je vetëm këshillues. Ti ndaj tyre nuk je detyrues"202.
Kur`ani nga besimtarët e vetë jo vetëm që kërkon dialog, bashkëpunim, mirëkuptim me pjesëtarët e feve tjera, por ai shkon edhe më larg dhe nga bashkëpunimi reciprok kalon në shkallën e njohjes, që është shkalla më e lartë e tolerancës dhe garanci për të drejta të barabarta mbarë njerëzore si vlera univerzale për bashkëjetesë. Kurani si libër hyjnor i shpallur nga Krijuesi që të tri fetë, i quan fe qiellore dhe i fton për bashkëpunim me këto fjalë: "O ithtar të librit, ejani të bashkohemi (të dialogojmë) rreth gjërave të përbashkëta edhe për ju, edhe për ne: të adhurojmë vetëm një Zot e mos t`i bëjmë asnjë shok Atij dhe mos ta marrim njëri-tjetrin për Zot, në vend të Perendisë"203.
Nëse fetë qjellore dhe besimin e vërtetë në krijuesin e gjithsisë e trajtojmë në këtë dritë dhe e shiqojmë në këtë prizmë, atëherë edhe pikat e përbashkëta ndërmjet hebreizmit, krishterimit dhe islamit do të ishin më të mëdha. Në këtë rast do të nxirrej përfundimi se keqkuptimet dhe konfliktet kanë ardhur nga interpretimet e shtrembëruara, nga devijimet që u janë bërë shpalljeve e jo nga shpalljet burimore dhe nga pejgamberët e pasuesit e tyre.
Në lidhje me lirin e besmit dhe respektin e ndërrsjellë dhe të drejtat e njeriut në traditën profetike, profeti Muhamed a.s., si interpretues ligjitim i kuranit, më së miri i sqaroi parimet dhe idealet e larta kuranore, që kanë të bëjnë me këtë fenomen. Ai me shembullin e vet i bëri traditë praktike këto parime, dhe u bë model edhe për brezat e ardhshëm. Ai kishte theksuar: "Drejtësia mbanë qiellin dhe tokën".
Muhamedi a.s. me ligje u kishte garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e pjestarëve të feve qiellore në shtetin islam. Kështu në hadithin e Pejgamberit a.s. thuhet: "Ai që mundon një hebre ose një të krishter, në Ditën e Gjykimit mua do të më gjejë si paditës i tij".
Kjo frymë e paqës dhe e tolerancës do të vazhdoj gjatë gjithë historisë së zhvillimit të kulturës dhe civilizimit islam. Islami gjatë historisë së tij asnjëherë nuk ka pasur në gjirin e vet grupe inkuizicioni dhe asnjëherë nuk ka pasur për qëllim ndërrimin me forcë të fesë së ndonjë populli.
Edhe shoqëria jonë, nacionalitetet tona pavarsisht bindjeve fetare dhe nacionale duhet të kuptojnë njëherë e përgjithmonë se realiteti dhe fati, jo vetëm i yni, por i gjithë botës, është larmi bindjesh e besimesh. Ky është vullneti i krijuesit të gjithësisë dhe kush mund të merrte guximin të ngritej kundër vullnetit të Tij.

[200] Kur`an: (El Bekare, 256).
[201] Kur`an: (El-Kehf, 29).
[202] Kur`an: (El-Gashje, 22-23).
[203] Kur`an: (Ali Imran, 64).

Sa i përket luftës në islam, Kur'ani ka përmendur se lufta është një veprim i urrejtur për besimtarët, ata nuk e duan atë dhe nuk pajtohen me të, mirëpo në raste të caktuara ata e pranojnë atë ngase është caktim i Zotit në rast se nuk ka rrugdalje tjetër, kur shterren gjitha mundësitë tjera, atëher lufta mbetet opsioni i pashmangshëm, gjithsesi mjet i fundit.

Legjislacioni islam e ka lejuar luftën si nevojë njerzore, e cila mund të adresohet kundër renegatëve, zullumqarëve, plaqkitësve, apo edhe ndonjë grupi tjetër, e cila në disa raste njihet me emrin luftë në rrugën e Allahut, e në disa tjera si luftë për qëllime të mira e për dobi të përgjithshme.
Kur themi se islami e ka miratuar apo lejuar luftën, qëllimi është se ajo është lejuar si një domosdoshmëri që është në interes të përgjithshëm, për ta larguar armikun e jashtëm, për t'i dhënë të drejtën atij që është gjunjëzuar nga e drejta e tij, e nuk është lejuar për motive agresive, apo për lakmi ekspansioni, mirëpo është legjitimuar për qëllime bujare e fisnike. Lufta është bërë legjitime për ndihmë ndaj atij që i është bërë padrejtsi, është bërë legjitime për largimin e okupatorit, për mbrojtje të atdheut, për frymim të lirisë fetare dhe për të sjell drejtësi.

Toleranca ndërfetare në Kosovë model për të tjerët

Sociologët e fesë theksojnë se bota sot është në shumicën e rajoneve të saj më religjioze se në të kaluarën. Thënë këtë, duhet të njohim të gjitha trajtat e këtij rigjallërimi shpirtëror që në disa raste manifestohet në forma të ngurta. Dekadën e fundit, në disa vende muslimane konfliktet e ndryshme me karakter politik kanë marrë gjithashtu edhe ngjyra sektare, ku ithtarë të bashkësive të ndryshme janë futur në spirale dhune të pandalshme. Këtu jemi dëshmitarë të dështimit të autoriteteve fetare, të cilëve situata u ka dalë nhga kontrolli në favor të grupeve margjinale që interpretojnë fenë ngushtësisht për të maksimalizuar përfitimet politike. Pasojat ë këtyre konflikteve ndërkohë kanë një impakt të gjerë në opinionin public ndërkombatar, saqë shpesh përtej një solidaritetit me karakter humanitar që zbutin pasojat e konflikteve, implikojnë dhe përfshirjen emocionale të simpatizantëve në rreshtime militante.[204]
Në rastin e shqiptarëve, mund të theksojmë se nuk ka premisa për përplasje sektare apo ndërfetare, dhe se mes besimtarëve të feve të ndryshme, grupe potenciale që mund të minojnë bashkëjetesën mes feve janë të papërfillshme në shumicën e rasteve tek shqiptarët në Kosovë apo edhe më gjerë.[205]

Këtu vlen të përmendim se, edhe pse populli shqiptar numerikisht është i vogël dhe i ndarë në tri konfesione e disa rite, historia nuk mban në mend të kenë ndodhur ndonjëherë konflikte fetare. Aq më tepër ai gjatë historisë tregoi një tolerancë dhe respekt të paparë edhe ndaj religjioneve dhe objekteve sakrale të fqinjëve të tij, duke i ruajtur ato brez pas brezi. Shqiptarët për shekuj me radhë i kanë ruajtur kishat ortodokse në Kosovë dhe familjet serbe, kur ato kishin nevojë. Mjerisht, objektet fetare islame në Serbi, si dhe popullata muslimane nuk patën të njëjtin fat. Beogradi në kohën e Perandorisë Osmane kishte afër 85 xhami, mesxhide, mejtepe e medrese, e sot ka vetëm një xhami.

Të njëjtën fatkeqësi objektet fetare islame e pësuan gjatë agresionit të fundit serb në Kosovë. Vlen të përmendim se gjatë periudhës 28 shkurt 1998 – 20 qershor 1999 nga soldateska serbe u dogjën, u granatuan dhe u shkatërruan 218 Xhami nga 560 sa i kishte Kosova, disa prej të cilave me vlera të mëdha arkitektonike.[206]

Përfundim

Edhe pse ne jemi të mendimit se konflikti serbo-shqiptar në Kosovë nuk kishte karakter fetar, pala serbe është përpjekur që simbolet fetare t'i përdorte për mobilizimin e forcave serbe, për pastrimin e territoreve ku jetojnë shqiptarët, dhe për zhdukjen e monumenteve kulturore të tyre, siç janë xhamitë, minaret, mejtepet si dhe vizatimi i katër S-ve si simbol i ortodoksizmit, bile këtë në shumë raste e

[204] Mr. Qemajl Morina, *Lufta në Siri dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në të, "Edukata Islame"* nr. 105, Prishtinë, 2014, f.9.
[205] Po aty, f. 9 – 10.
[206] Bashkësia Islame e Kosovës, Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt 98-qershor 99 Prishtinë, 2000, f.8).

bënte policia serbe në kraharorët dhe fytyrat e të rinjve shqiptarë. Kisha Ortodokse Serbe, me ardhjen e Sllobodan Millosheviqit në pushtet, u shëndrrua në skenën publike, për të ndihmuar operacionalizimin e programit nacional serb. Në këtë, kisha ka luajtur rol të madh, duke i kontribuar zgjimit të etnonacionalizimit dhe disponimit shtetmadh të shtresave të gjera, duke manipuluar me ndjenjat religjioze dhe nacionale të qytetarëve për qëllime politike. Njëkohësisht, i ka dhënë përkrahje të plotë regjimit millosheviqian, që ka pasur rol të rëndësishëm në mobilizimin e segmenteve të caktuara antikomuniste të shoqërisë.207

Me gjithë tërë ato që kanë ndodhur në Kosovë, qoftë në të kaluarën e largët apo të afërt, shqiptarët si popull shumicë në Kosovë, i janë kthyer ardhmërisë dhe ata jetësisht janë të interesuar për stabilizimin e gjendjes në të.

Duke e pasur parasysh rëndësinë që ka paqja dhe toleranca në Kosovë, si dhe rolin që mund ta kenë institucionet fetare në ndërtimin e paqes, Bashkësia Islame e Kosovës, institucionet e saja dhe imamët anë e kënd vendit në vazhdimësi janë angazhuar dhe duhet të angazhohen edhe në të ardhmen që me mësimet dhe predikimet e tyre të përçojnë mesazhet hyjnore, që thërrasin për paqe, dashuri, mirëkuptim, respektim të tjetrit e para së gjithash në falje e mirëkuptim.

Literatura

Kur'an
Clifford Longley, "Chosen people…", Angli, 2002.
Jimmy Carter, "Our endangered values. America's moral crisis", 2005.
Integrimi i shiptarëve në Evropë dhe vlerat që islami përcjellë në këtë integrim, Simpozium kombëtar, firumi musliman i Shqipërisë, Kavajë, shkurt 2008.
Kardinali Ratzinger, Revista " Cicero", qershor, 2004.
Muhamed Bakir ess- Sadër, filozofia jonë, Prishtinë, Zëri ynë, 2006.
Aleksandër Adler "Në takim me islamin".
Fred Hollidei, 1996, "Islami dhe miti i konfrontimit…".
Indianapolis Star, December 4, 2002, Column by Cal Thomas).
Mr. Qemajl Morina, Edukata Islame, Revistë shkencore kulturore islame, nr. 84, Prishtinë, 2007.
Rime Magazine, 17.09.2001, The true peaceful face of islam.
Bashkësia Islame e Kosovës,Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt-98-qershor 99 Prishtinë, 2000.
Dr.Samet Dalipi, Ndërtimi i paqes në Kosovë (nga perspektiva e politikologjisë perëndimore), Prishtinë, 2014.
Transmeton Buhariu, Libri i xhihadit, nr. i hadithit 2821. Muslimi, nr. i hadithit 3276.
Mr. Qemajl Morina, Lufta në Siri dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në të, "Edukata Islame" nr. 105, Prishtinë, 2014, f.9.
Faik Ali Hoxha – Kasollja, Në pragun e misticizmit, Tiranë, 2002.
Abdi Baleta, Islami në ligjërimin politik pernedimor, në: "Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që islami përcjellë në këtë integrim", Kavajë, shkurt 2008.
Kreshnik Osmani, "Standardet e integrimit evropian, janë kërkesa islame përpara se të jenë kushte për integrim", në : "Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që islami përcjell në këtë integrim". Kavajë, shkurt, 2008.

[207] Dr.Samet Dalipi, Ndërtimi i paqes në Kosovë (nga perspektiva e politikologjisë perëndimore), Prishtinë, 2014, f.40.

PHD. (C) REXHEP SUMA – TOLERANCA FETARE VLERË INTEGRUESE NË SHOQËRINË SHQIPTARE

PHD. (C) REXHEP SUMA
Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës,
Kryeredaktor i revistës Dituria Islame", Prishtinë

Abstrakti

Shndërrimi i botës në një fshat global ku shoqëritë postmoderne janë të lidhura shumë ngushtë më dhënie dhe marrje të informacionit dhe teknologjisë, reflekton zhvillime dhe ndikime në aspektin e studimeve kulturore. Ashtu siç shprehet edhe Samuel Huntington Luftërat ndërmjet klaneve, grupeve etnike, komuniteteve fetare dhe nacioneve kanë për të qenë të dukshme në çdo periudhë dhe në çdo civilizim, sepse ato janë të rrënjosura në identitetin e popujve. E veçanta e tyre është që ato nuk përfshijnë çështje të gjera, ideologjike apo politike, me interes të drejtpërdrejtë për ata që nuk marrin pjesë, apo më mirë të themi për grupet e jashtme. Ato gjithashtu kanë të ngjarë të jenë vicioze dhe të përgjakshme, meqë këtu rrezikohen çështjet themelore të identitetit. Për më tepër, ato kanë tendencë të jenë të gjata; ato mund të ndërpriten nga pakte dhe marrëveshje, të cilat kanë tendencë të thyhen përsëri, kështu që konflikti rifillon. Por në krahun tjetër, fitorja decizive ushtarake e njërës palë në një luftë civile për identitet, rrit mundësinë e një gjenocidi.
Por në shoqërinë shqiptare jo vetëm që nuk ka pasur luftë mes dy pjesëtarëve të feve (islame dhe krishtere) por ato për mrekulli kanë bashkëjetuar përgjatë shekujve në harmoni, dashuri, respekt, ndihmë e bujari. Ky element unikat në shoqëritë njerëzore ku deri më tani nuk është shënuar asnjë konflikt e lerë më luftë mes shqiptarëve çmohet dhe vlerësohet lartë si dhe kultivohet me gjelozinë më të madhe ndër shqiptarë.

Për më tepër, feja sot është një subjekt i pashmangshëm në të gjitha sferat dhe rrjedhat shoqërore, politike e gjeostrategjike. Një numër i madh problemesh akute të botës së sotme zanafillën e tyre e kanë edhe në mosmarrëveshjet fetare ose edhe në keqinterpretimin e fesë për qëllime politike, ekonomike e të ngjashme. Andaj, studimi i këtyre problemeve, edhe në aspektin fetar, mund të na ndihmojë për eliminimin e disa keqkuptimeve, të cilat kohë pas kohe shfaqen jo vetëm në rajonin ballkanik e në opinionin shqiptar, por edhe më gjerë, për shkak të mosnjohjes së rolit dhe misionit që duhet të luajnë fetë në shoqërinë njerëzore.

Fjalët Kyçe: shoqëri, tolerancë, fe, unikat, harmoni, postomoderne

Shembull i gjallë i tolerancës

Shoqëria shqiptare karakterizohet me elementin e tolerancës që e ka ruajtur përgjatë shekujve dhe vazhdon ta kultivoj si një vlerë që e dallon nga të gjithë popujt tjerë ballkanik dhe më gjerë. Kjo është arritur në saje të bashkëpunimit, respektit dhe dashurisë që ka komuniteti mysliman shumicë ndaj pakicës së krishtere (ortodokse dhe katolike).
Nuk ka dyshim se sundimi gjysmëshekullor komunist te shqiptarët dëmtoi në një masë të madhe çështjen fetare, sidomos në Shqipëri. Për këtë shkak, me fillimin e procesit të demokratizimit të saj, aty nxituan misionarë nga të gjitha anët e botës, sepse mendonin se Shqipëria ishte terren i përshtatshëm për përhapjen e propagandës fetare, sepse aty shqiptarët e në mënyrë të veçantë rinia, kishin humbur identitetin fetar gjatë periudhës së diktaturës së regjimit komunist, i cili bënte shpërnguljen e trurit nga besimet fetare, duke edukuar popullin në frymën ateiste. (Morina, 2003:22-23).
Toleranca u bë pjesë e shoqërisë shqiptare dhe si prodhim kemi zhvillim funksionim të shtetit si dhe përparimit si komb. Toleranca fetare nënkupton mënjanonim e shtypjes dhe diskriminimit ndaj personave, besimi fetar i të cilëve është i ndryshëm nga i juaji, do të thotë të respektosh të drejtën e të

tjerëve për të pasur një besim fetar ndryshe. Në aspektin politik, toleranca fetare përfaqëson politikën publike që përfaqëson dhe garanton lirinë dhe barazimin e besimit në raport me shtetin. (Shala, 2006).

Popullsia shqiptare e Kosovës, e cila është pothuajse e tëra myslimane ka dëshmuar një vlerë të identitetit kombëtarë, duke mos e zhdukur apo asimiluar nga represioni serb. Me kulturën e tyre prej muslimanësh të devotshëm i dhanë kombit tonë një dimension të ri evropian për mënyrën se si do të marrin pavarësinë.(Marku, 2008:89).
Populli shqiptar i ofron popujve evropian shumë vlera dhe urtësi e një ndër to është edhe toleranca, mirëkuptimi, harmonia e respekti i ndërsjellë ndërfetar, i cili është krucial dhe prodhon një stabilitet, humanizëm dhe dashuri për njëri-tjetrin. Këtë tolerancë e treguan edhe me të tjerët sic është rasti me strehimin e hebrenjve në Shqipëri në familjet myslimane gjatë Luftës së Dytë Botërore.
Islamizimi i shqiptarëve ka qenë një pritë kundër presionit sllav, ashtu sikurs më parë pranimi i katolicizmit kishte qenë mbështetje kundër greqizmit të favorizuar nga ortodoksia bizantine.(Roca,1994:23).

Hulumtues e udhëpërshkrues të shumtë evropianë si (E. Durham, G.L. Jarray etj.) kanë hetuar bashkekzistimin, relativisht paqësorë, nëpër kohëra, midis dy feve te shqiptarët (krishterizmi dhe Islamit. Mungesa e luftërave fetare është shënuar sa nga historianët evropianë aq edhe nga ideologët e nacionalizmit shqiptar. Derisa këta të fundit e paraqesin një imazh idilik të raportit të këtyre feve, të parët kanë konstatuar, megjithatë, në disa momente të së kaluarës, tensione brenda-fetare dhe trajta të diskriminimit fetar.

Teoria e qarqeve kulturore shqiptare

Në veri të Shqipërisë dhe në Kosovë, një bashkësi katolike jeton bashkë me bashkësinë myslimane. Gjuhëtari i madh shqiptar, Eqrem Çabej kishte zhvilluar teorinë e qarqeve kulturore shqiptare, në bazë të kritereve fetare: veriu katolik, qendra myslimane dhe jugu ortodoks. Veç kësaj, personaliteti i cili e shpalli pavarësinë kombëtare të shtetit shqiptar, më 1912 në Vlorë, Ismail Qemajli, propozon kantonizimin e Shqipërisë sipas të njëjtit model. Në vitet ’30 Gjergj Fishta propozon të njëjtin model. Sociologu kosovar, Gani Bobi, në veprën e tij Paradoksi kulturor (1987), vë në pah se ky klasifikim është i ngurtë, sepse shqiptarët myslimanë e katolik të veriut kanë shumë tipare të përbashkëta kulturore, që dallojnë nga tiparet e shqiptarëve myslimanë e ortodoks të jugut. Skema e dytë e analizës së identitetit kulturor të shqiptarëve është adekuate ngase merr parasysh faktorë të ndryshëm e jo vetëm atë fetar.(Kullashi, 2003:121).

Toleranca ndërfetare ndër shqiptarët çmohet edhe nga personalitetet me ndikim planetar siç është rasti i Papa Françesku kur vizitoi Shqipërinë në 21 shtator 2014 për të lëvduar bashkekzistencën midis komuniteteve fetare të vendit. "Mbani me kujdes dhe vëmendje bashkëjetesën paqësore midis anëtarëve të feve të ndryshme. Kjo është një pasuri e paçmueshme për vendin, që merr mjaft rëndësi në kohën e tashme," tha Papa Françesku në Tiranë, ku mijëra njerëz u mblodhën ta përshëndesin atë.

Por është vlerësuar dhe çmuar edhe nga poetët e shkrimtarët tanë. Në mjedisin tonë ende gjënë frymë thënia dhe porosia e Çajupit:
Ngrihuni trima të tërë
muslimanë e të krishterë
të luftoni për lirinë
të shpëtoni Shqipërinë (Çajupi,1983:1).

Shembujt e tolerancës

Fetë në mjedisin shqiptarë kanë bashkëjetuar në harmoni të plotë andaj nuk është tolerante atëherë nuk mund të flitet për raporte normale mes besimeve dhe bashkëjetesë mes tyre.

Kohët e fundit, komuniteti mysliman i komunës së Malbardhës ofroi asistencë financiare për rindërtimin e kishës katolike 600 vjeçare të Shën Mëhillit. Ceremonia e hapjes së kishës solli së bashku për të festuar banorët nga të gjitha fetë.

"Prej gjithë akuzave, paragjykimeve dhe gabimeve, me të cilat kërkojnë të rëndojnë supet tona, kjo është më e pa drejta dhe më e pa baza. Megjithëqë elementi mysliman ka shumicën në Shqipëri, nuk besoj të ketë një shtet të qytetëruar, ku të mbretërojë aq, gjer në indiferentizëm, tolerancë feje, sa në Shqipëri. Prova e faktit, për të cilën me të drejtë krenohen të gjithë shqiptarët, është, që në krye të Qeverisë së sotme jam unë, një peshkop ortodoks, dukuri e panjohur edhe për shtete ortodokse. Personalisht jam e lirë në ushtrimin e fesë. Jam rritur në një familje me të krishterë e myslimanë me mbiemrin që u bëri ballë shekujve, Gjoni. Xhaxhai im jeton me ortodoksen e mirë Aspasi për 60 vjet rresht, në një harmoni të shkëlqyer, kurrë s'i kemi pasur këto ndasi me njeri –tjetrin. Janë dhjetëra e dhjetëra figura të shquara që janë martuar me besime të ndryshme. A nuk ishte Ali Pashë Tepelena që u martua me ortodoksen Vasiliqi dhe që e respektoi aq shumë duke i ndërtuar dhe kishën në respekt të saj? Po Mbreti Ahmet Zogu që u martua me katoliken e butë dhe të bukur Geraldina dhe që populli shqiptar i deshi dhe i çmoi aq shume virtytet e saj? thoshte Noli

Ky element i forcës së qenies sonë kombëtare lartësohet edhe nga udhëheqësit tanë shpirtërorë". Kështu myftiu i Republikës së Kosovës Naim ef. Tërnava në një fjalim të mbajtur më 2008 në Shba tha se Për të ekzistuar paqja, harmonia e toleranca ndërmjet popujve dhe për dialog të suksesshëm, nevojitet respekt i ndërsjellë ndërmjet besimeve, duhet mirëkuptim dhe bashkëpunim i vazhdueshëm, sinqeritet e jo dyfytyrësi gjatë dialogut, duhen ndërmarrë aktivitete të përbashkëta, si në fushën e hulumtimeve të përbashkëta shkencore, duke mbrojtur të drejtat e çdonjërit, në bashkëpunim të përhershëm edhe në luftimin e krimit të organizuar, i çfarëdo natyre qoftë, me aksione të përbashkëta në luftë kundër terrorizmit, drogës e shumë sëmundjeve të tjera, që janë rrezik për shoqërinë njerëzore.

Dialogu me të tjerët ndihmon edhe në pakësimin e varfërisë, arsimimin e atyre që nuk kanë mundësi të arsimohen e në shumë probleme të tjera.

Ne, krerët fetarë, duhet të jemi më të zëshëm, të ngremë zërin tonë te qendra të shumta ndërkombëtare të vendosjes, nëpërmjet deklaratave të përbashkëta, tek qeveritë tona, në raport me të këqijat që po përjeton krijesa më e çmuar e Zotit - njeriu.

Është e dhimbshme kur shohim se si shumë fëmijë brenda ditës vdesin nga uria, sa kohë që sa e sa mjete harxhohen në armatim vetëm brenda një dite.

E, pra, më pakë armatim, më pak luftëra, më pakë urrejtje e më shumë dashuri, më shumë tolerancë, dhe më pakë gjakderdhje e krime, më shumë respekt e aspak hakmarrje. Vëllazëri e fqinjësi - dhe jo gjakderdhje e armiqësi.

Planeti ynë është lodhur nga luftëra të shumta, prandaj duhet t'i kthehemi arsyes e të jetojmë në paqe. Një frymë e thellë bashkëpunimi ekziston midis institucioneve fetare në Shqipëri, gjë që kontribuon në ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve vëllazërore," sqaron Genti Kruja, drejtor i kulturës në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Shumica myslimane respekton pakicën krishtere

Dr. Zyhdi Dervishi, përgjegjës i Departamentit të Sociologjisë në Universitetin e Tiranës. Sipas tij, evidentohet shpesh fakti që në raste festash fetare ka shkëmbime urimi nga besime të ndryshme.
Historia e ka të qartë procesin: Kështu ndodh aktualisht me besimin mysliman, që është në shumicë dhe respekton besimet në pakicë. Pra, në thelb jam duke thënë se ky raport mes shumicës dhe minorancës është kyçi në tolerancën ndërfetare në Shqipëri, tolerancë që është me rrënjë të thella."
Çështja është dhe më e thellë në përmbajtjen e këtij fenomeni, thotë prof. dr Dervishi. "Është një traditë e konsoliduar ndër shekuj që besimtarët myslimanë shkojnë tek vendet e shenjta të krishtera,

ose e kundërta, me shpresën për të gjetur shërim për veten e tyre, mbarësi për fëmijët a të afërmit. Natyrshëm lind pyetja, se a mund ta urresh një institucion fetar të një feje tjetër kur mendon se tek ky institucion, tek ky vend i shenjtë do të gjesh mbarësi? Kjo do të thotë se ke respekt, ke adhurim të veçantë për një vend të shenjtë të një feje tjetër. Gjithashtu është një traditë ndoshta unike tipike shqiptare fakti që vite më parë, por dhe aktualisht, kur një çifti nuk i jetojnë fëmijët, atëherë fëmijët që ju lindin më pas ju vënë një emër të besimit tjetër nga janë vetë. Për shembull të krishterët i venë emër mysliman, apo myslimanët i venë fëmijës një emër të besimit të krishterë". (Muka, 2012).
Edhe paraqitja e liderëve fetar së bashku në publik e ka jehonën e vet dhe ndikon pozitivisht në mendjen e secilit komunitet. Rasti më i mirë është në "Marshimin e Unitetit" në Paris të Francës, në nder të viktimave që humbën jetën nga sulmi terrorist ndaj redaksisë të revistës satirike "Charlie Hebdo" e dy sulmeve të tjera terroriste që e pasuan. Pjesë e këtij marshimi ishte dhe delegacioni shqiptar i kryesuar nga kryeministri Edi Rama, si edhe 4 përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Shqipëri. Harmonia jonë fetare e përcjellë nëpërmjet krerëve të komunitetit mysliman, katolik, ortodoks dhe bektashi është duartrokitur nga të pranishmit në "Marshimin e Unitetit" meqërast kryeministri Rama kryesoi delegacionin shqiptar që mori pjesë në Marshimin e Unitetit në Paris të Francës në nder të viktimave pas sulmeve terroriste. Gjatë qëndrimit në Paris ai ka dhënë një intervistë për "France 24" ku pohoi se islami është pjesë e Evropës demokratike dhe se tërheqja pas kësaj, nga projekti i madh evropian do ishte vetëvrasje për unionin. "Këtu, Islami është pjesë e jetës, dhe kur them këtu them në Evropën demokratike, në Evropën e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë. Pra me kë do ta bëjmë luftën? Kundër kujt, kundër vetes? Nëse shkojmë në këtë drejtim, do të bëjmë ekzaktësisht atë që terroristët duam që në të bëjmë. Në këto kushte natyrisht që duhet shumë më shumë koordinim në terma të sigurisë, në terma këshillimi dhe informacioni edhe gjithë komponentëve të tjerë. Por duhet një Evropë më e fortë, duhet më shumë Evropë, jo më pak Evropë".

Sami Frashri, shkruan : " Ndarjet në besim nuk sollën çarje në mes të shqiptarëve. Gjendjet e besimit, jo vetëm në vendet e lindjes, por edhe në Evropë, e në vendet e ndriçuara me qytetërim, shumë herë kanë nxjerr vrasje të mëdha e të tmerruara; Në Shqipëri, këto grindje nuk ndihen dhe kurrë në këtë vend s`kanë ngjarë.
Ndërkaq Tomas W. Arnold vë theksin se "Myslimanët shqiptar, sikur edhe të krishterët flasin me një gjuhë, kanë traditat dhe moralin e njëjtë, nuk kanë far urrejtje, sepse me gjenerata nuk kanë pasur armiqësi. Faktori fetar nuk ka qenë shkak për përçarje ".
Faik Konica në letrat e tij për tolerancën fetare ndërshqiptare thoshte se "Unë besojë se shqiptarët gjithkund janë tolerantë për besimet e tjera dhe ndoshta ky është i vetmi vend në Evropë ku nuk ka pasur luftëra fetare".
Biçoku shprehet se Islami dhe katolicizmi u bënë dy barriera shumë të fuqishme për të ruajtur individualitetin dhe vetëdijën kombëtare të shqiptarëve, që kombi ynë të mos pësonte fatin e vllehve, të cilët janë asimiluar prej fundamentalizmit ortodoks ballkanik.(Biçoku, 1999:71).

Shteti laik populli besimtar

Shteti i Kosovës përkufizohet nga Kushtetuta e saj si shtet laik, i cili promovon kulturën e laicizmit në nivele të ndryshme. Shumica e shqiptarëve të Kosovës janë mysliman, por ka edhe pakica katolike e ortodokse lindore. Në regjistrimin e fundit të popullsisë më 2011, përgjigjja në pyetjen për fenë nuk ka qenë e obligueshme. Megjithatë, shumica në Kosovë u deklaruan si myslimanë (96%), pasuar nga katolikë 2.21%, ortodoks 1.49%; të tjerë 0.07%, pa fe 0.07% dhe 0.06% të cilët kanë parapëlqyer të mos përgjigjen.
Sipas porosisë profetike dhe mësimeve të Kur'anit, muslimanët duhet të besojnë në misionin e profetëve që i kanë prirë Muhamedit a.s. dhe në librat e shenjtë që u janë shpallur të dërguarve para Muhamedit a.s., siç argumenton edhe ky ajet

Ju (besimtarë) thuani: "Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbedhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur. (El Bekare,136).

I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, si dhe besimtarët. Secili i besoi All-llahut dhe melekëve të Tij dhe të dërguarve të Tij. "Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij", dhe thanë: "Dëgjuam dhe respektuam. Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë, te Ti është ardhmëria (jonë)." (El Bekare,285).

Për Isain (Jezusin) në Kur'an është thënë: Ne vazhduam gjurmët e tyre (të pejgamberëve) me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit që kishin më parë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit. (E zbritëm) Që ithtarët e Inxhilit të gjykojnë sipas asaj që All-llahu e zbriti në të. E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit. (El Maide,46-47).

Shqiptarët mysliman nuk luftojnë kundër asnjërës prej ketyre dy feve (krishtere dhe hebreje) sepse ata janë tolerantë.

Sikurse ata poashtu nisen nga mësimet fetare, I Cili nga ana e tij urdhëroi muslimanët për tolerancë dhe ka urdhëruar që t'i mbrojnë idhujtarët në qoftëse se vijn tek Ai. Kjo mbrojtje athua nuk ngritet në shkallën më të lartë të tolerancës? Ta dëgjojmë këtë ajet: "E nëse ndokush prejidhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjojë fjalët e Allahut (Kur'anin (e mandej shoqëroje deri në vend të sigurt të ti j(Et-Tevbe,6).

Por edhe Profeti a.s., porosit myslimanët për tolerancë me këto fjalë:
"Ai që shtyp një person, me të cilin është lidhur me një zotim, ose i cenon të drejtat e tij, ose ia imponon një detyre mbi mundsinë e tij, ose ia merr me detyrim një gjë, mua do të më ketë kundërshtuar në Ditën e Gjykimit"(Muhamed El Hufi,17).

Përkundrejt grupeve të tjera fqinje që i ngjeshnin në mënyrë kërcënuese, procesi i konvertimit u dha shqiptarëve mundësinë të mbështeteshin mbi njëjtësinë e tyre të re fetare, krejtësisht refraktare ndaj kulturave sllave dhe greke. Megjithatë, duhet të pranohet gjithashtu se tashmë ai që ndihmoi në ruajtjen e njëjtësisë etnike shqiptare kundër asimilimeve të huaja ishte islamizmi. (Doja, 2001:14).
Shqiptarët me vetëdije të lartë nuk lejuan që në trupin e tyre të zgjatet dora përçarëse e fqinjëve që ushqyen ndjenja armiqësore dhe shpeshëher edhe "dizajnuan" tokat tona. Nuk lejuan që të humbet as gjënë më të vogël të karakterit nacional dhe sot ofron shembullin e gjallë të tolerancës, mirëkuptimit dhe të harmonisë fetare. Shqiptarët e dy anëve të kufirit, i cili duhet të pasojë fatin e Berlinit, edhe nëpërmjet të elementit fetar dëshirojnë t'u thonë popujve të Evropës, se "ne nuk jemi të huaj, se ne kemi lidhje me njëri tjetrin, se ne jemi shumë tët afërt me njëri-tjetrin, se ne jemi miq dhe qytetarë të Evropës" (Krasniqi, K.1996:8).

Se toleranca dhe harmonia e plotë mes dy feve tek shqiptarët ka qenë për çdo lëvdatë është fakti se ka familje në Kosovë ku nën një çati jetojnë dy vëllezër, njëri i besimit mysliman kurse tjetri i besimit krishterë dhe ndajnë të mirën dhe të keqen bashkërisht. Ku familjet p.sh vetëm për muaj të ramazanit rrinë së bashku për t'i përgatitur syfyrin deri në orët e hershme të agimit.
Poashtu edhe në sferën e besimit pjesëtarët mysliman me fanatizëm kanë mbrojtur kishat katolike e ortodokse duke i konsideruar si vlerë dhe pasuri kombëtare e popullit shqiptarë që e ka kultivuar këtë tolerancë shekuj me radhë.
Myslimanët shumicë aspak nuk kanë paragjykime ndaj krishterëve dhe me këtë tregojnë dhe domestrojnë një civilizim të përkryer dhe të lashtë qoftë ballkanike apo evropiane.

Media dhe vlerat shoqërore

Në kushtet dhe rrethanat e demokracisë së tanishme liberale, që Ballkani Perëndimor asnjëherë në historinë e vetë nuk i ka shijuar, identitetet kolektive në numër më të madh, duhet patjetër ta zvogëlojnë karakterin e vetë autoritarë (ngaqë, ai nuk konsiderohet si burim i lirive dhe i drejtave) dhe se përmes koncepteve neoliberale ai duhet të na sigurojë të drejtat e barabarta. Raportet e reja

shoqërore, sipas këtij principi janë të mundshme vetëm përmes sistemit politik – pra decentralizimit, rajonizimit dhe subrajonizimit.
Sot, në botë janë duke ndodhur procese të atilla,, që sugjerojnë se në të ardhmen procesi i stabilitetit do të jetë shumë i diskutueshëm poqëse nuk ushtrohet procesi i decentralizimit.
Është sugjeruar shpesh se mediat kanë efekte potencialisht të thellë në formimin e identitetit social të të rinjve.

Rrjetet sociale në përgjithësi konsiderohen si një "zgjatje e jetës së përditshme dhe një mjet i ndryshimit kulturor. Kështu, formimi identitetit, si një koncept shoqëror, është duke u transformuar në mënyra të reja dhe madje edhe me përmasa globale.
Mediat në kohën e globalizmit pak hapësirë japin apo tregojnë respekt për traditën. E gjithë ideja e traditave fjala për të duket mjaft e çuditshme. Nga ata shpeshëher lind pyetja se pse do të duam të bëjmë të njëjtën gjë si gjeneratat e mëparshme? Çfarë është kaq e madhe në lidhje me të kaluarën? Mediet e popullarizuara nxisin dëshirën për të krijuar mënyra të reja të jetës - brenda kontekstit të sistemit kapitalist.
Edhe pse çështja e identiteteve dhe trajtimi i tyre në mënyrë të duhur në media në shkallë globale mbetet një dëshirë që ekziston ndër popuj që do të duhej të kishin ndikim dhe peshë të respektimin dhe njohjen e identiteteve periferike.

Toleranca dhe zhvillimet shoqërore

Nocioni globalizëm tashmë ka përfshirë çdo fushë të jetës, dijës dhe zhvillimeve të ndryshme. Epoka në të cilën jetojmë njihet si epoka e globalizmit. Ky nocion fillimisht u përdor si një përshkrim neutral i një procesi të qenësishëm në ndikimet botërore të revolucionit teknologjik. Një përkufizim ndihmës u dha në vitin 2000 nga profesori Çarls Doran, i cili e shpjegoi fenomenin si "ndërveprim i teknologjisë informative dhe i ekonomisë globale. Ai dallohet në sensin e intensitetit, fushës, volumit dhe vlerës së transaksioneve ndërkombëtare në sferat informative, financiare, tregtare dhe administrative anekënd botës. Një rritje e theksuar në përqindjen e këtyre transaksioneve në dekadën e fundit, rrjedhimisht edhe në nivelin e tyre, është manifestimi më i matshëm i procesit të globalizimit". (Doran, 2000:6).

Meqë çlirimi i Kosovës koinçidoi me kohën kur ndodhi eksplodimi i ndikimit të internetit dhe hedonizmit e konsumerizmit të pafre, një pjesë e rinisë u dorëzua para kësaj lodre të re dhe para pasioneve doniste. Shpejt u hoq dorë nga vlerat e traditës shqiptare, nga kujtimet historike, nga artet dhe nga kultura kombëtare, në emër të kozmopolitizmit e të kulturës së huaj dhe sot kemi të bëjmë me breza të tërë të tjetërsuar kultuarlisht dhe të zvetënuar moralisht. Përhapja e tmerrshme e përdorimit të drogave, në radhët e rinisë së kësaj kategorie, është treguesi më autentik i këtij ndryshimi moral e kulturor. (Krasniqi, 2015:8).

KONKLUZIONE

1.Multifetarizmi dhe tolerance është një proces i përfunduar historik, dhe si rezultat shqiptarët evropianë nuk kanë frikë se mund të ndodh ndonjë fërkim apo thyerje të reja.

2.Identiteti fetar tek shqiptarët është vlerë tradicionale, qytetruese, civilizuese, kulturore por edhe kombëtare ndër shqiptarët që duhet kultivuar e avancuaar në mesin e popullatës.

3.Toleranca ndër shqiptarë mbetet element për studim dhe modelim edhe për kombet tjera evropiane dhe më gjerë.

Literatura

Biçoku, K.(1999) "Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar", Tiranë, p.71.
Çajupi, Vepra 1, Prishtinë, 1983.
Doja, A. (2001) Përdorimi politik i fesë në rindërtimin e identiteteve: rasti shqiptar, Instituti shqiptar për studime ndërkombëtare,Tiranë, p.14.
Doran F. Charles. (2000) Globalization and statecraft".p. 6.
Krasniqi, K. (1996) Roli i fesë në ruajtjen e identitetit dhe të harmonisë kombëtare te shqiptarët, Vjenë, p. 8.
Krasniqi, M.(2015) Kriza morale e kulturore, mjet për ta imponuar disiplinimin e shqiptarëve, Shenja, 47, Shkup, p.8.
Kullashi, M. (2003), Përplasja e identiteteve, Pejë.p.121.
Marku, At N.(2008), Mirëkuptimi fetar në Shqipëri një vlerë e integrimit të shqiptarëve në evropë, simpozium ndërkombëtar, Kavajë, 2008. p.89.
Morina, Q.(2003) Identiteti fetar i shqiptarëve. Shtresimet e Identitetit kulturor shqiptar, Zëri ynë. Prishtinë. p.22-23.
Muhamed El Hufi, A. Toleranca Islame, Dituria Islame, Prishtinë.p.17.
Muka, A. (2012) Harmonia dhe toleranca fetare në Shqipëri (Accesse 15 march 2015). Avaliable from World Wide Web: http://www.dw.de/harmonia-dhe-toleranca-fetare-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/a-16384835.
Roca, R. (1994) Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944, Tiranë, p.23.
Shala, Xh.(2006) Toleranca fetare, media dhe siguria kombëtare (Accesse 1march 2015). Avaliable from World Wide Web: http://www.acnss.com/html/studime/toleranca.htm.

ARDITA BYLO, MF - FAKTORËT KRYESORË, QË NDIKOJNË NË KËRKESËN PËR KREDI HIPOTEKORE

ARDITA BYLO, MF
Pedagoge, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkoder

Abstrakti

Për shumë prej nesh, blerja e një shtëpie është një nga vendimet më të rëndësishme si dhe ndonjëherë transaksioni më i madh financiar që mund të bëhet në jetë. Të qartësosh pyetjet përpara se të zgjedhësh një kredi do të thotë të bësh krahasimin mes marrjes së një kredie që mund ta përballosh dhe humbjen e të drejtës mbi pronën. Zhvillimi dhe zgjerimi i tregut bankar gjatë viteve të fundit, me krijimin e produkteve dhe programeve të reja, e ka bërë të rëndësishëm kuptimin e kushteve të ofruara për të bërë një zgjedhje racionale. Nëse mendojmë të marrim një kredi hipotekore, duhet të konsiderojmë të gjitha mundësitë . Eshtë e rëndësishme që të edukohemi pasi "dija" është "aftësi". Duke siguruar informacionin e nevojshëm mbi kredinë hipotekore, jemi të aftë për të zgjedhur kushtet më optimale dhe shmangur shpenzimet e tepërta, na jep një bazë teorike dhe praktike njëkohësisht, që do t'na ndihmojë të mësojmë qëllimet e kredive hipotekore avantazhet dhe disavantazhet e marrjes së një kredie të tillë .
Në këtë punim gjithashtu është trajtuar edhe ecuria e kredive hipotekore në shqipëri dhe krahasimi me vendet e tjera të europës . Poashtu edhe ndikimi që kanë këto kredi në çmimin e banesave në treg dhe tregtimi i tyre nga bankat në trajtën e obligacioneve që mbështetën në huatë hipotekore.

Fjalët Kyçe: Kredi Hipotekore, Kërkesa, Kredi, Pasuri të Paluajtshme, Sistemi Bankar, Letra me Vlerë, Obligacione, Treg Dytësor

Avantazhet dhe disavantazhet e kredive hipotekore

Avantazhet kryesore të kredisë hipotekore janë si më poshtë:

Me marrjen e një kredie hipotekore, huamarrësi vë në zbatim një nga parimet bazë të blerjes së pasurive të paluajtshme. Kjo eleminon nevojën e përdorimit të parave (cash) ose rezervave (depozitave), të cilat janë aq të vlefshme në raste urgjence, apo për mundësi të tjera investimi. Po aq i rëndësishëm mbetet fakti, që ju mund të mos i zotëroni këto para për ekzekutimin e këtij transaksioni.
Me blerjen e pasurisë tuaj ju nuk do të shpërdoroni më paratë në shpenzime qeraje. Gjithashtu, ju mund ta përdorni pasurinë e paluajtshme si kolateral për një kredi të dytë në të ardhmen.
Kredia hipotekore mund të shërbejë për realizimin e qëllimeve të ndryshme si: ndërtimin e një shtëpie verore, rinovimin e shtëpisë suaj etj.
Pasuria e paluajtshme mund të përdoret si një residencë e dytë ose mund ta jepni me qera, të ardhura këto me të cilat mund të shlyeni këstet mujore të kredisë.

Megjithatë, marrja e një kredie hipotekore ka edhe disavantazhe:

Ekziston risku i mospagimit në kohë, si pasojë e papunësisë, sëmundjeve, apo ndonjë ngjarjeje të paparashikueshme e cila nuk mbulohet nga policat e sigurimeve.
Mund të përballeni me uljen e vlerës së shtëpisë tuaj; si pasojë, çmimi i shtëpisë tuaj mund të rezultojë më i vogël sesa borxhi ndaj huadhënësit.
Norma e interesit mund të luhatet përderisa kreditë jepen edhe me norma të ndryshueshme interesi. Nëse interesi rritet, kësti mujor i kredisë do të rritet.

Per stimulimin e veprimeve te huave hipotekore ne mjaft shtete ekzistojne nje seri organizmash shteterore qe ndihmojne te dy palet huamarresit dhe huadhenesit. Ne SHBA veprojne organizmat e meposhtme:

- ❑ Banka Federale e Huave te Banesave
- ❑ Administrata Federale e Strehimit
- ❑ Bankat Federale te Tokes
- ❑ Shoqata Federale Nacionale e Huave Hipotekore
- ❑ Administrata e Veteranve

Në shumë studime janë vlerësuar faktorët kryesorë, të cilët ndikojnë në kërkesën për shtëpinë dhe në çmimet e tyre. Këto studime vlerësojnë se nga ana e kërkesës, dinamika e çmimeve të shtëpive përcaktohet në periudhën afatgjatë kryesisht; nga rritja e të ardhurave të disponueshme të individëve; zhvendosja graduale demografike; karakteristikat e sistemit të taksave në ekonomi; kredia bankare; si edhe niveli mesatar i normave të interesit. Nga ana e ofertës, si tregues që përcaktojnë në periudhën afatgjatë dinamikën e çmimeve të banesave, përmenden: disponueshmëria dhe kosto e truallit; kostoja e ndërtimit; investimet në përmirësimin e cilësisë së stokut ekzistues të shtëpive; etj.

Kredia hipotekore dhe ndikimi i saj në çmimin e banesave

Një nga faktorët e kërkesës, të cilit i është kushtuar një vëmendje e veçantë në literaturë, është ndikimi i kredisë, sidomos asaj hipotekore, në çmimin e banesave. Analiza e kësaj lidhje, ka marrë rëndësi të veçantë për vetë implikimet që ka në dy sektorët e rëndësishëm të ekonomisë (në sektorin e ndërtimit dhe atë bankar), si dhe pasojat direkte apo indirekte që këta sektorë përcjellin për gjithë ekonominë dhe stabilitetin financiar në vend.

Kindlerberger (1978) dhe Minsky (1982) në studimet e tyre, kanë theksuar rolin që luan kredia në ecurinë e çmimeve të banesave. Lehtësimi i procedurave për marrjen e një kredie, krahas faktorëve të tjerë, do të rrisë kërkesën për banesa. Duke marrë parasysh që për periudhën afatshkurtër oferta për shtëpi është e pandryshueshme, rritja e kërkesës do të rezultonte në një rritje të çmimeve.
Kredia hipotekore ndikon në çmimet e banesave nëpërmjet të ashtuquajturit mekanizmi i nxitësit financiar. Kështu, nëpërmjet kredisë së dhënë nga bankat nxitet kërkesa për blerjen e banesave. Në përgjigje të kërkesës së shtuar çmimet e banesave do të rriten, dhe ndërkohë kolaterali i lënë peng për marrjen e kredisë do të shtohet, duke mundësuar marrjen e një kredie shtesë për banesa dhe duke nxitur kështu më tej kërkesën për kredi dhe përshpejtuar procesin.

Ecuria e kredisë për banesa ndër vite në Shqipëri dhe krahasimi me vendet e Euroznës

Tregu i banesave dhe ai i kredisë në Shqipëri kanë përjetuar ndryshime të ndjeshme. Zhvillimet në këto dy tregje mund të ndahen në dy periudha të dallueshme nga njëra tjetra. Gjatë periudhës së parë 2000-2007 vihet re një zhvillim i shpejtë, si në tregun e banesave ashtu edhe në atë të kredisë hipotekore.
Ndërkohë, gjatë periudhës 2008-2010 vihet re një ngadalësim i dukshëm i ritmit të rritjes së këtyre tregjeve e ndikuar nga ecuria e ngadaltë e aktivitetit ekonomik në vend, e cila ka reflektuar edhe efektet që përcolli kriza financiare globale në ekonominë shqiptare.

☞ Gjatë periudhës 2004-2007, kredia për pasuri të paluajtshme ka njohur rritje në nivele të larta, duke u rritur mesatarisht me një normë vjetore prej 65%.
☞ Ecuria pozitive në vitet 2004-2007 është mbështetur nga vet zhvillimet e sistemit bankar dhe zhvillimi ekonomik në vend.

Për shumë banka, kredia për banesa ndihmon në diversifikimin e portofolit të kredive, në ruajtjen e cilësisë së huadhënies e cila shoqërohet me një kosto me të vogël për kapitalin e tyre

Grafiku 1. Krahasimi i kredise per pasuri te paluajtshme ndaj totalit te kredise 2007-2012



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave, Buletine mujore Dhjetor 2007- 2012

Ndërsa po të shohim grafikun e kredisë hipotekore në disa nga vendet e evropës shihet se që ka të njëjtën tendencë si në shqipëri deri në vitin 2006- 2007 është vërejtur një rritje e ndjeshme në të gjitha vendet por rritja më e madhe është verejtur në greqi.

Grafiku 2. Rritja e Kredive Hipotekore, 2003-2006, (%)



Burimi: ECB

Faktoret që çuan në rritjen dhe rënien e kredive hipotekore në Shqiperi ndër vite.

Gatishmëria e bankave për të zhvilluar këtë segment të tregut u shoqërua edhe nga dëshira e klientëve të tyre për të marrë kredi. Gjatë kësaj periudhe, u vu re një rritje e interesimit të individëve për të marrë kredi, e nxitur nga vet rritja e shpejtë e çmimeve për banesa gjatë viteve 2004-2007, e cila vështirësoi blerjen e një banese nga individët me fondet e veta. Çmimet e banesave gjatë kësaj periudhe ishin rreth 50% më të larta se në fund të vitit 2004. Në të njëjtën kohë, bankat prezantuan oferta tërheqëse të kredisë hipotekore, duke lehtësuar dukshëm kushtet e kredi-dhënies, të cilat nxitën kërkesën për kredi hipotekore. Rritja vjetore e kredisë hipotekore shënoi 65%, dhe në fund të periudhës portofoli i kredisë hipotekore ishte pothuajse dy herë më i lartë se në fundin e vitit 2004. Po kështu, kjo periudhë është karakterizuar nga rritja e aktivitetit ekonomik në vend, e cila gjykohet se ka ndihmuar në krijimin e pritshmërive pozitive për të ardhmen dhe për rritjen e mëtejshme të çmimeve të banesave, duke nxitur individët për të blerë banesa me kredi.

Ndërkohë, mbas vitit 2007, norma e rritjes së portofolit të kredisë është zvogëluar dukshëm duke shënuar dhe vlera negative përgjatë vitit 2010. Në fund të vitit 2008, nga ana e ofertës, ngadalësimi i dukshëm i rritjes së portofolit të kredisë është ndikuar nga vështirësitë në likuiditet të sistemit bankar. Këto vështirësi i detyruan bankat të shtrëngonin ndjeshëm kushtet e kreditimit, në veçanti për kreditimin në valutë të individëve.

Në fund të vitit 2010, niveli i kredisë hipotekore në Shqipëri, përbën më pak se 10% të prodhimit të brendshëm bruto të vendit, ose ndryshe rreth 226 euro kredi për banorë. Kredia hipotekore për individë përbën rreth 20% të portofolit të kredisë së sistemit bankar.

Grafiku 3. Kredia Hipotekore dhe Çmimet e Banesave



Burimi: Banka e Shqiperise

Letrat me vlerë të emetuara mbi bazën e huave hipotekore

Si per te gjitha letrat me vlere edhe per huate hipotekore zhvillohen nje sere veprimesh qe perfaqesojne veprime te tregut sekondar. Domosdoshmeria e e veprimeve ne tregun sekondar per huate hipotekore lind nga nevoja e garantimit te bankave akorduese nga rreziku i mosshlyerjes se huase , ndryshimeve te pafavorshme ne normat e interesit, dhe zhvillimin e metejshem te financimeve per zgjidhjen e problemeve te strehimit dhe investimit te fondeve te lira.
Për shtimin e burimeve të kreditimit bankat huadhënëse përdorën kthimin e huave hipotekore në tituj obligacionale (letra me vlerë borxhi), të cilat shiteshin në tregun e kapitaleve dhe nga paratë e arkëtuara jepeshin kredi të reja hipotekore. U krijua kështu një radhë e tërë e derivateve financiare - tituj borxhi që garantoheshin me po të njëjtat hua të dhëna hipotekore. Përveç kësaj në përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e burimeve të reja kreditimi bankat dhe institucionet e specializuara filluan të blejnë huatë hipotekore, t'i klasifikojnë ato sipas kritereve të posaçme dhe pastaj t'i shndërrojë në kategori të ndryshme tituj detyrimesh duke arkëtuar likuiditete me të cilat mund të jepeshin hua të tjera. Kjo praktikë në literaturë përshkruhet me emërtimin "pool creation" (krijim i grumbuj-depozitave të huave dhe emetim për to i obligacioneve të reja).
Në këtë mënyrë krijohet një rrjet i tërë derivatesh financiare nëpërmjet të cilave jo vetëm siguroheshin burime të reja kreditimi, por shpërndahej dhe rreziku i mosshlyerjes së detyrimeve në shumë hallka. Po të shikohen të gjitha llojet e derivateve financiare arrihet në konkluzionin se sot shuma botërore e derivateve financiare kap madhësinë e 60 trilion dollarëve, që është 100 herë më e madhe se 10 vjet më parë. Me këto mënyra u zgjerua jashtë masës dhe u deformua gjithë struktura e mjeteve likuide në ekonominë botërore.

Në tregun dytësor të huave hipotekore kryhen këto veprime :

☑ Shitjen nga ana e akorduesve të detyrimeve të huave hipotekore me zbritje te caktuar siç veprohet për skontim të çdo lloj tjetër borxhi.
☑ Klasifikimi dhe kthimi i huave hipotekore në letra me vlere të veçanta detyrimi dhe shitja e tyre investitorëve të tjerë.
☑ Emetimi mbi bazën e huave hipotekore të obligacioneve të veçanta të garantuara nga pasuritë e paluajtshme.

Dallimet mes tregut tradicional të obligacioneve dhe atij të obligacioneve të mbështetur në huatë hipotekore.

a) Së pari, huatë hipotekore, ashtu edhe letrat me vlerë të emetuara në bazë të tyre kanë si garanci objekte të një pasurie reale, në formen e ndërtesave , trojeve, etj dhe huadhënësi në rast dëmtimesh mund të veprojë si pronar i këtyre objekteve për plotësimin e shlyerjes së fondeve të akorduara gjë që në rastine obligacioneve tradicionale nuk ekziston.

b) Së dyti, instrumentat e tregut të huave hipotekore dhe të obligacioneve të bazuara në to, nuk kanë një shprehje standarte nga ana e vlerës së një njesie siç janë obligacionet e tjera , të cilat emetohen zakonisht në njesi standarte me një vlerë të paracaktuar p.sh 1 000 dollarë njëra , ka gjithashtu afatin individual të maturimit , normën individuale të interesit etj që nuk i kanë llojet e tjera të obligacioneve standarde.

c) Së treti, huatë hipotekore dhe obligacionet e bazuara në to karakterizohen nga lidhje të tjera ndërmjet investitorëve, huadhënësve dhe emetueseve të tyre. Për obligacionet tradicionale të kompanive që tregtohen në formën e ankandëve publike ekziston informacion i plotë mbi emetuesit mbi kushtet e emetimit informacion ky që nuk është aq i detajuar në rastin e obligacioneve që emetohen mbi huatë hipotekore se investiori i blen ato nga bankat dhe nuk ka informacion për huamarrësit dhe aftësinë shlyerse të tyre.

Referencat

BSH, Buletini i Bankës së Shqipërisë, me dt. 05.05.2015, www.bankofalbania.org
ECB, Statistical Data Warehouse, http://sdw.ecb.europa.eu
EMF, http://www.hypo.org
EMF, "Hypostat", me dt. 05.05.2015, http://www.hypo.org/Content/Default.asp?PageID=524
Hess, A., Holzhausen, A., "The structure of European mortgage markets", 2008, fq. 13-15
Pano, A., "Kriza e tanishme financiare - kreditore dhe ndikimi i saj ne ekonomine tone", Tirane, 2009, fq. 18-21
Pano, A., Gjoni, E., "Tregjet Financiare", Tirane, 2009, fq. 181-205
Shqiperia.com, "Kredi me te lira per shtepi, ku mund t'i gjeni dhe si t'i merrni", 2010, gjendur me dt. 05.05.2015, https://www.shqiperia.com/Kredi-me-te-lira-per-shtepi-ku-mund-t%EF%BF%BDEuro%EF%BF%BDi-gjeni-dhe-si-t%EF%BF%BDEuro%EF%BF%BDi-merrni.8443
Yan, A., "Introduction To Asset-Backed And Mortgage-Backed Securities", me dt. 05.05.2015, http://www.investopedia.com/articles/bonds/12/introduction-asset-backed-securities.asp
http://investinginbonds.com
http://www.freddiemac.com

PROF. ASS. DR. MUJO DACIĆ, MSC. FARUK Z. DACI – NDËRGJEGJËSIMI I POPULLSISË REZIDENTE PËR PARAQITJEN E OFERTËS TURISTIKE NË ROZHAJË

PROF. ASS. DR. MUJO DACIĆ
Fakultet za Menadžment i Poslovnu Ekonomiju, Univerzitet u Travniku, Sarajevo, BiH

MSC. FARUK Z. DACI
Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim "Horizonti i Diturisë", Rozhajë, Mali i Zi

Abstrakti

Mali i Zi shquhet për potenciale të turizmit malor, parqeve nacionale, të gjuetisë dhe turizmit kulturor, krahas turizmit detar. Sidomos në pjesën veriore të pozitës gjeografike të saj, konkretisht në Malësinë e Rozhajës, si një zonë me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit.
Qëllimii këtij punimi është paraqitja e disa aspekteve të cilat identifikojnë mundësitë dhe rëndësinë që ofron Malësia e Rozhajës në zhvillimi i turizmit, posaqersht masivi malor i bjeshkës së Hajlës (me lsrtësi mbi detare 2403m). Në këtë punim posaqerisht paraqitet ndërgjegjsimi i popullatës rezidente në shërbim të ofertës turistike, pasi që deri vonë resurset janë shfrytezuar vetëm për nevoja industriale.

Fjalë kyçe: Potenciale turistke, Oferta turistike, Kërkesa, Mundësi zhvillimi, Malësia e Rozhajës.

Hyrje

Duke parë se Malësia e Rozhajës ka mjaft pasuri natyrore për zhvillimin e turizmit, sidomos atij malor, ka qenë arsyeja e hartimit të këtij punimi. Mirëpo me gjithë pasuritë e saja të rralla si ato natyrore, kulturore, etj, si duket nuk janë ruajtur, ose shfrytëzimi i këtyre bukurive nuk ka ende nivelin e duhur.
Rutina e përditshmërisë bënë që njerëzit të levizin shumë, kështu që bënë të zhvillohet turizmi si veprimtari ekonomike e cila sjell, levërdi fitimprurëse për ekonominë e secilit vend, e po ashtu edhe të Republikës se Malit të Zi, si vend në tranzicion. Potencialet e shumta dhe shfrytëzimi i tyre, në shërbim të ofertës se mirëfilltë turistike, kanë peshën, rolin dhe rendësin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe në përgjithësi të brutoproduktit shoqëror.

Mundësitë e zhvillimit të turizmit

Turizmi si degë më prioritare e zhvillimit ekonomik përkrah degeve tjera është paraqitur e para në listë.Sa i përket parimeve të qëndrueshmërisë autorët i referohen aspekteve mjedisore, ekonomike, dhe socio-kulturore të zhvillimit të turizmit e sidomos turizmit malor.208
Sipas Organizatës e Kombeve të Bashkuara Botërore e Turizmit209 përkufizimi turistnënkupton një person që udhëton jashtë vendit të tij ose të saj të zakonshëm për një periudhë të caktuar kohore, me një qëllim të udhëtimit që është i ndryshëm, ka një varg aktiviteteve të ndryshme që paguhen nga personi në vendin e vizituar.210 d.m.th. me turizëm nënkuptojmë lëvizjen e njerëzëve me qëllim rekreacioni, argëtimi, shërimi dhe zgjerimi të njohurive kulturore.
Kuptimi i turizmit varet shumë nga aspekti i qasjes së studiuesve. Turizmi përcaktohet si lëmi biznesore transproduktive e cila buron pikërisht nga struktura biznesore dhe organizative e tyre, fjala është për fenomenet më hetorogjene të botës bashkohore që i përfshin sistemet natyrore,

[208] Kruk, E., Hummel, J., and Banskota, K., (2007). "*Facilitating Sustainable Mountain Tourism"*. Resource Book - Volume I, Nepal. pp.124-140
[209] UNWTO (United NationsWorld Tourism Organization)
[210] UNWTO 2014: http://www2.unwto.org/

antropogjene, ekonomike, sociale, politike, kulturore, etiologjike, shëndetësore, sportive, rekreative, religjioze, informatikës, komunikuese dhe ekologjike.211 Me turizëm kuptojmë një sektor të rëndësishëm, një industri me kapacitetete të shumta, e cila ka bërë arritje dhe sukses të jashtëzakonshëm. Sektori turistik nërthuret dhe bashkvepron me shumë sektorë tjerë.
Turizmi konsiderohet një rrugë për zhvillimin e rajonit, një ndër specifikat kryesore me ndikim në viset malore me përfitime të konsiderueshme, që ndikon në mënyrën e jetesës e jetesës që mund të shndërrohet në mundësi ekonomike pasi që jetesa tradicionale janë nën kërcënim.
Malet paraqesin potencialin më të rëndesishëm për zhvillimin e turizmit në komunën e Rozhajës, dhe për atë të Veriut të vendit dhe Malit të Zi në përgjithësi. Malët e Bjeshkeve të Nemura (afër Rozhajës) bëjnë pjesë në me një siperfaqe rreth 28,457 ha (hektar)212, një zonë me një potencial të madh turistik.

Deri vonë, pavarësisht paraqitjes së potencailit turistik me të mira natyrore, që një shansë për plasimin në tregun turistik vendor dhe ndërkombëtar si dhe një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal, Bjeshkët Hajlë që njihet si vend malor, bjeshkë me bukuri të rralla, nuk kanë qenë të shfrytëzuara sa duhet për shtigje malore për turistët, por si burime natyrore për lëndë të parë në përpunim industrial të drurit dhe si lëndë djegëse. Kështu që Ndërmarrja Shoqerore "Gornji Ibar", ka pasur një rritje në vitet e shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta të shekullit 20-të të shfrytezimit të pyjeve. Autorët Haxhiq F. dhe Lluboder, H., (2013)213 në librin e tyre, duke u bazuar në të dhëna zyrtare të "Gornji Ibar" në vitin 1979 është thyer rekordi në përpunimin e drurit 72.000 m3 në vit. Mirëpo ne do të përqendrohemi më tepër në zhvillimin ekonomik të tanishëm si dhe promovimi e bjeshkës së Hajlës. Mundësitë e krijimit të projekteve nga organziata të ndryshme relevante, që në një farë mënyre ndikojnë në zhvillim ekonomik, qoftë afatshkurtër apo afatmesëm. Me ndihmën e shtetit do të krijoheshin kushte më të favorshme për banorët, bizneset dhe turistët, ku këta të fundit do të kënë hapsirë më të madhe për kërkim të një pushimi sa më relaksues.
Falë angazhimi të lartë banorëve, të ndërmarrësve, Bizneseve të Vogëla dhe të Mesme, organizatave të ndryshme dhe institucioneve përkatëse shtetrore, ka bërë që në Mal të Zi të zhvilohet turizmi mjaf shumë, kështu që sipas raportit të Këshillit të Udhëtimeve dhe Turizmit Botëror214 për vitin 2013, Mali i Zi renditet i dyti në botë në aspektin e kontributit të drejtpërdrejtë të turizmit në BBV-i dhe parashikimet për periudhen 2013-2023 janë se Mali i Zi do të vazhdojë të qëndrojë pranë në krye të listës në këtë drejtim.
Sa i përket zhvillimit të rajoneve shume me tepër është përqendruar në zhvillimin e turizmit detar. Posaqërisht do të duhej të jepet rëndesi zhvillimit të turizmit rural, siq është rajoni i Rozhajës, e veçanarisht në vendet ku janë të përqendruara komuniteti pakicë.
Në zhvillimin ekonomik të Rozhajës rolin kryesor e luajnë aktualisht degë si: turizmi, tregtia, transporti, ekonomia bujqësore, etj.215 Veçanarisht në qytetin e Rozhajës dhe bjeshkën e Hajlës me qendrën turisitke në Bukel të Epërm ka marrë rëndësi të veçantë zhvillimi i ekonomisë turistike. Për zhvillimin e turizmit malor ka potencale të shumta:
Sezoni i dimrit i mbuluar me dëbor,
Pasuria natyrore,
Sezoni i verës me diell, por edhe me diell,
Flora dhe fauna e pasur,
Shkëmbinjë të thepisur, etj.

Tregu i synuar për këto produkte turistike malore janë turistët vendor, fqinjësor dhe ndërkombëtar. Karakteristikat e individeve apo grupeve janë fëmijët, moshat të reja, mosha të mesme dhe moshat të shtyera. Pushues të orientuar në mjedis të pastër, në të cilin ende mund të zbulohen sekrete të çmuara dhe të rralla të natyrës piktoreske.

[211] Koja, V. &Gorica,K. (2007). *" Marketingu i turizmt"*, Tiranë. Fq. 242
[212] Statistical Office of Montengro-MONSTAT. (2014). *"Statistical yearbook 2014*". Podgorica.
[213] Hadžića, F. & Lubodera, H. (2013). "*Staro Rožaje – fotomonografije*". Rožaje/Rozhajë.
[214] Faqja zyrtare e World Travel and Tourism Council : http://www.wttc.org/
[215] Faqja zyrtare e Komunës së Rozhajës: www.rozaje.me

Ndërgjegjësimi i popullsisë rezidente për paraqitjen e ofertës turistike në Rozhajë

Malet janë ekosisteme të cilat mbulojnë 23% të siperfaqës së tokës në botë.Ato shënojnë çdo kontinent dhe të gjitha llojet kryesore të ekosistemeve, nga shkretëtira tropikale deri të pjesa tjetër ndaj akullnajave polare (UNEP-WCMC, 2014).216 Sipas shumë agjencive të statistikave, rreth 12 deri 14 për qind e popullatës në botë jetojnë në male, ose shumë pranë në zonat malore dhe e varur në burimet e tyre. Shumica e komuniteteve malore janë rurale, dhe më të jetojnë në varfëri. Për të sinjalizuar zbutjen e varferisë duhen implementuar projekte në interes për banoret lokal dhe shtetit në përgjithësi, me synim promovimin e turizmit.
Zhvillimi dhe rritja së turizmit varet nga projektet që implementohen, e ku projektet e zhvillimit të turizmit që kanë qenë më efektive të kontribuojë në zbutjen e varfërisë përfshijnë:217

- Nxitja e punësimit në vende rurale për hapjen e bizneseve turistike (duke përfshirë trajnimin, veçanërisht për gra jo të arsimuara);
- Promovimi e krijimit të bizneseve të reja turistike nga të varfërit (të tilla si mikro dhe bizneset të vogla);
- Nxitja e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për bizneset turistike nga bizneset që kanë në pronësi më të madhe produkte (zinxhirin e furnizimit);
- Nxitja në shitjen e drejtpërdrejtë të mallrave dhe shërbimeve për turistët nga të varfërit;
- Përfshirja në partneritet me qeveritë lokale për të mbështetur strategjitë fiskale, të tilla si taksa apo tatime se fondi për ndërtimin e rrugëve, rrjetet e komunikimit, shkollat rurale, kanalizime apo shëndetin përmirësime.
- Lehtësimi në dhurimet vullnetare dhe mbështetje nga bizneset turistike dhe turistët; dhe
- Investimi në infrastrukturë dhe ngritjen e kapaciteteve vendore.

Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të banorëve së vitit 2011, komuna e Rozhajës ka 23,312 banorë me 5684 ekonomi familjare. Përberja kombëtare e banorëve sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011 është si vijon: Boshnjak 83,91%, Shqiptar 5,04%, Mysliman 4,55%, Serb 3.58, Malazezë 1.75%, Të pa përcaktuar 0.31 %, të tjerë 0.86%.218
Rozhajës është vendosur në pozita gjeografike në mes 42°e45' dhe 42°e59' gjerësi veriore dhe 17°e41'dhe 18°e0' gjatësi lindore.219 E vendosur në pjesën veriore të Malit të Zi, në kufirin e Serbisë, Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës. Rozhaja është Komuna e vetëme në Mal të Zi, e cila dallohet për karakteristikat demografike, veçanarisht për rininë, ku mosha mesatare e banorëve është 29,9 vjet.220 Andaj është me lehtë të pranohen dhe implementohen projektet.
Banorët rezident nuk do të përjetojnë çdo ndikim. Disa janë të varur nga tiparet e veçanta e burimeve natyrore (malet) ose zhvillimi i modeleve hapësinore ("zona turistike" të veçanta), disa të tjerë kanë të bëjnë me gjendjen sociale të komunitetit, veçanërisht aftësinë për të vlerësuar ndikimin qëtë lidhet me turistë.Ende të tjerët kanë të bëjnë me llojet dhe intensitetit të zhvillimeve turistike, dmth, miratimit ose refuzimit ndaj aktiviteteve turistike.221
Për një ekonomi të turizmit të bazuar për të mbajtur veten në komunitetet lokale, banorët duhet të jenë partnerë të gatshëm në këtë proces. Qëndrimet e tyre ndaj turizmit dhe përceptimet e ndikimin e saj në jetën e komunitetit duhet të vlerësohen vazhdimisht.222
Destinacionet malore janë të përhapura gjithandej territorit të Malit të Zi. “Komuna e Rozhajës është zona me përqindjen më të lartë të pyjeve në gadishullin e Ballkanit, ku mbi 48% e territorit të saj të

[216] UNEP - United Nations Environment Programme, Copyright © United Nations Environment Programme, 2007, Tourism and Mountains A Practical Guide to Managing the Environmental and Social Impacts of Mountain Tours: http://www.unep.org/
[217] Richardson, R. (2010). *“The Contribution of Tourism to Economic Growth and Food Security”.*Accelerated Economic Growth Team.*USAID Mali. pp. 1-6*
[218] Statistical Office of Montengro-MONSTAT. (2011).
[219] Po aty.
[220] Faqja zyrtare e Komunës së Rozhajës: www.rozaje.me
[221]Kreag G., (2001), *“The Impacts of Tourism”*, Minnesota Sea Grant, University of Minesota, USA: 2-19.
[222]Allen, et al.,(1988). *“The impact of tourism development on resident’s perception of community life”*. Journal of Travel Research 27(1): 16-21.

përgjithshëm prej 432 km2 është e mbuluar me pyje ose toka pyjore".223 Ndër pikat më të më atraktive për zhvilliin e turizmit malor është masivi malor i Hajlës 2403m lartësi mbidetare mbi nivelin e detit. Ku pranë kësaj maje më të lartë, në pjesën veriore gjendet fshati piktoresk ekoturistik Bukeli i Epërm, që ndryshe nga banoret lokal të të dy anët e kufirit njihet si fshati ndër Hajlë. Falë masivit malor të Hajlës, ky fshat gëzon epitetin e fshatit turistik në Komunën e Rozhajës. Fshati Bukeli i Epërm së bashku me Hajlën, janë një antibiotik për banorët e Rozhajës, për turistët vendor dhe turistët nga shtetet tjera. Lokalitetet atraktive ofrojnë mundësi të shumta për të praktikuar aktivitetet të shumta në natyre si: ski, alpinizëm biçiklizëm malor, pushim të qetë, etj.
Lumi i Bukelit të Epërm që burimet i ka në Hajlë, e dy më të njohurat janë burimi i quajtur Gurra e Studentit (buron në lartësinë afër 2000m) dhe Gurra e Malsorëve (buron në lartësinë 1800m). Gjithashtu gjatë rrjedhes deri në fshat mbledh edhe shumë kroje tjera si Gurrat e Ftohta, Kroni i Kralanit, Kroni i Livadheve të Smajlit, Kroni i rrëmbave, Gurra e Zenelit, etj. Gjithashtu edhe në fshat mbledh 6 kroje: Kroni i Dulajve, Gurra e Rexhës, Kroni i Elezajve, Kroni i Bregut dhisë, Gurra e Deshajve dhe Kroni i pasmajës, të gjitha këto burime të sistemuara në një largësi 1 km, afersia mes njera tjetrës nuk kalon 200 m. Të gjitha këto burime të lartcëkura edhe të tjera janë të pijshme, të pasura me kristale, të ftohta dhe shumë të shëndetshme për organizmin e njeriut dhe organizmin e kafshëve. Në lumin e Bukelit të Epërm rritet shumëllojshmëri e peshkut, siç është Trofta.
Bukeli i Epërm ndodhet në një faqe mali dhe njihet se deri tek vendi arrihet nëpërmes rrugeve karakteristike të shtruara me gurë. Rruga e parë nga Rozhaja arrihet me veturë te vogël nëpërmes magjistrales Rozhajë – Pejë, e që në kilometrin e 6-të, lihet magjistralja dhe vazhdohet rruga e shtruar me gurë buzë rrjedhës së lumit Bukeli i Epërm, e që për 2 km dërgon në këtë fshat. Rruga tjetër është e quajtur Hajlit (rruga e Karvanit), sjellë nga qëndra duke vazhduar rrugës përbuz Kombinatit të drurit "GORNJI IBAR", për të filluar për tu ngjitur për lagjen e Demaj, përbuzë paralagjes Banxhovobërdo dhe fshatit Peshkaj e Bukel i Poshtëm, drejt ne krye të fshatit në lartesine 1450m lmd të quajtur Qafë e Bukelit.

Roli dhe rëndesia e turizmit për zhvillimin e turizmit malor në fshatin turistik Bukeli I Epërm është i madh. Në bazë të potencialeve në disponim, zhvillimi i turizmit mund te jete njera prej veprimtarive ekonomike që do te ndikoj në zhvillimin ekonomik të Bukelit të Epërm. Kur kemi parasysh vështirsite nëpër të cilatka kaluar kjo veprimtari ekonomike se bashku me deget e tjera ekonomike, sot jane krijuar kushte për zhvillimin e sajë. Vështirësit janë paraqitur pasi të ardhurat gjithnje janë gjenuar më se shumti nga prerja e pyllit dhe shitja e tyre në tregun e drurit për shfrytezim të me tutjeshem, pastaj për shfrytëzim për djegje, etj.

Foto1. *Pamje e Hajlës nga Bukeli i Epërm, Rozhajë, Mali i Zi*

Burimi: *Faruk DACI, 2014*

Në këtë rajon në aspektin e produktit turistik, mund të përpilohen paketa disaditore duke u përqendruar në veprimtaritë e turizmit malor të interesit të veçantë. Kështu, këtu mund të zhvilohet turizmi rural bazuar në mënyren e jetesës, prodhimet tradicionale, ushqimet, pijet, etj.

[223] Faqja zyrtare e Komunës së Rozhajës: www.rozaje.me

Oferta turistike në fshatin turistik Bukel të Epërm:

Ekoturizmi i orientuar në natyrë,
Hedhje me parashutë sportive (paragliding),
Vozitje motoristike nëpër bjeshkë (si me vetura – chipa ashtu edhe me motor (me dy rrota),
Biçikleta malore,
Shetitje në këmbë dhe çlodhje,
Ekskurzionet nga grupe të ndryshme (të rinjët, familjet, nxënësit, studentet, pensionistët),
Ecje me kalë,224
Udhëtime studimore (me theksim për studimet e pasurisë bimore),
Udhëtime artistike (me theksim të pikturimit të bukurive dhe
Turizmi kulturor (me shtëpi muze, veshje tradicionale),
Peshkimi, 225
Gjuetia,226
Udhëtime në zonat kufitare në bashkëpunim me Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë në bjeshkët e Hajlës 2403, dhe pikave tjera të larta Shtedimi, Dromodoli, Gjeravica, Maja e Karënfilit, etj.

Për të zhvilluar turizmin malor duhet punë e madhe dhe mjaft serizoe si nga banorët resident, nga shteti dhe nga operatoret turistik, duke krijuaar mundësi të drejtëprdrejta për zhvillim dhe një sërë shërbishesh atrkative për turistet.
Zhvillimi ekonomik lokal dhe reduktimi i varfërisë arrihet nga veprimtaritë e bizneseve turistike me investime konkrete, përmes menaxhimit të mirë dhe duke maksimizuar numrin e punonjësve që kryejnë punët e nevojshme. Gjithashtu bartin një mesazh të qartë që sigurojnë banorët për të shitur produktet tradicionale autoktone tek bizneset, që ndikimi rritet gjithnjë e më i lartë komunitet.
Meqenëse zhvillimi ekonomik sipas hulumtimeve teorike dhe praktike të paraqitura në këtë hulumtim, ka të bëjë me shumë llojllojshmëri aspektesh, zhvillimi i turizmit si aktivitet ekonomik duhet te trajtohet jo vetem në aspekt te rritjes ekonomike të vendit, por edhe në aspekt të ndërlidhjes me kualitetin e jetës së banorëve resident.
Për arsye se të ardhurat e gjeneruara nga pyjet janë zvogluar, sepse vedijesimi shterreor ka filluar, gjithashtu edhe vedijesimi i gjenerateave të reja nga këto anë për mbrojtjen e pasurisë malore. Gjithashtu ndikon edhe ulja e intersimit të të rinjëve për tu marr me këto punë, pasi janë të veshtira dhe kërkojnë aktivitet shumë të lartë fizik dhe ne numër më të madh të organziuar, si dhe migrimi i disa të rinjëve, gjë që e zvogëlon zingjirin e puntorëve të familjes përkatëse.
Për të shpëtuar fshatin Bukeli i Epërm e posaqerisht bjeshkët e Hajlës nga demtimet duhet që të jenë banorët e punsuar, do të zhvillohej industria e turizmit ku ka nevojë për të vepruar në mjedise të cilat do të jenë atractive për turistët mbeten, si shtiqet për shetitje, argetim, pushim, shërim, komunikim dhe infrastrukturën energjetike. Këto shërbime dhe objektet janë gjithashtu të vlefshme për komunitetet lokale. Shumë prej të pranishmëve mendonin se turizmi nuk ka të bëjë shumë që të ketë një ndikim të rëndësishëm në familje të ardhurat dhe mjetet e jetesës në një zonë lokale. Kjo mund të përbëjë një ndikim të rëndësishëm kombëtar nëse industrinë e turizmit si një adoptuar gjithë praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Përfundimi

Duke u nisur nga trendet aktuale dhe trendet e parashikuara të kërkesës ndërkombëtare turistike, ekzistojnë mundësi reale në plasimin e ofertës turistike të Bjeshkëve të Nemura në tregjet ndërkombëtare. Oferta kulminante turistike e Rozhajës është ajo në bjeshkët e Hajlës për rajonin verior të Malit të Zi, që përfshinë rrethin më të gjerë të kërkesës lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare bazohet në: peizazhet masive malore, që kanë potencial të madh pranimi, natyra e

[224] Ndjekje e kursit paraprak për kalërim të organziaura nga banorët rezident, që e kanë po thuajse profesion, sidomos të vjetërit, mirëpo synohet të trashegohet tek gjeneratat e reja.
[225] Gjatë muajve të verës egziston periudhë ku mund të peshkohet, në bazë të Ligjeve, Rregulloreve në fuqi të Republikës së Malit të Zi, dhe në bazë të antarësimit paraprak në Shoqatën e Peshkatarisë.
[226] Sipas Ligjeve përkatëse në Mal të Zi nuk mund të zhvillohet në të gjitha kafshet gjuetia, sepse janë te mborjtuara disa dhe janë në rrezik të zhdukjes. Mirëpo disa të tjera mund të gjuhën në të gjitha stinët e vitit, me leje paraprake shtetrore.

ruajtur, sidomos flora dhe fauna, lartësitë malore që arrijnë mbi 2400m lartësi mbidetare, me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror e sidomos të atij dimëror.
Turizmi konsiderohet një rrugë për zhvillimin e rajonit, një ndër specifikat kryesore me ndikim në viset malore me përfitime të konsiderueshme, që ndikon në mënyrën e jetesës që mund të shndërrohet në mundësi ekonomike pasi që jetes tradicionale eshtë nën kërcënim.
Turizmi është një sektor i rëndësishëm ekonomik në rritjen dhe zhvillimin e një vendi, kjo do të arrihet duke bërë permërsimin të shërbimeve që ofrohen në zonën malore të Hajlës të Malësisë së Rozhajës, me informimin e mirëfilltë të konsumatorëve/turistëve me marketing, në mënyrë që të bëhet rritja e vlerës së turistëve dhe banorëve rezident në lokacionin përkatës. Gjithashtu thuhet se një pjesë të barrës apo përgjëgjësisë duhet bartur edhe agjensionet turistike duke promovuar sa më shumë dhe sa më mirë ofertën turistike vendore.
Banorët e Malësisë së Rozhajës janë duke bërë përpjekje që të paraqesin para turistëve ofertën e tyre, e mirëpresin çdo projekt që ndërmerret nga institucionet shtetrore që ka për synim zhvillimin e me tutjeshëm të të turizmit të Malësisë së Rozhajës, si një zone me potenciale të shumta.

Literatura

Allen, et al.,(1988). "The impact of tourism development on resident's perception of community life". Journal of Travel Research 27(1). Pp. 16-21.
Hadžića, F. & Lubodera, H. (2013). "Staro Rožaje – fotomonografije". Rožaje/Rozhajë. Ueb faqja "AVLIJA.ME". Zbartur me 15 janar 2015. Për më shumë: http://www.avlija.me/promocije/foto-prica-gornji-ibar-rozaje-gir;
Koja, V. & Gorica, K. (2007). " Marketingu i turizmt", Tiranë. fq. 242-245
Kreag G., (2001), "The Impacts of Tourism", Minnesota Sea Grant, University of Minesota, USA. Pp. 2-19.
Kruk, E., Hummel, J., and Banskota, K., (2007). "Facilitating Sustainable Mountain Tourism". Resource Book - Volume I, Nepal. pp.124-140
Richardson, R. (2010). "The Contribution of Tourism to Economic Growth and Food Security". Accelerated Economic Growth Team. USAID Mali. Pp. 1-6
Statistical Office of Montengro-MONSTAT. (2014). "Statistical yearbook 2014". Podgorica.
Statistical Office of Montengro-MONSTAT. (2011). "Population of Montenegro by sex, type of settlement, etnicity, religion and mother tongue, per municipalities". Podgorica.
UNEP - United Nations Environment Programme, Copyright © United Nations Environment Programme. (2007). "Tourism and Mountains A Practical Guide to Managing the Environmental and Social Impacts of Mountain Tours": http://www.unep.org/
World Travel and Tourism Council. Ueb faqja "WTTC.ORG". Zbartur me 15 janar 2015. Për më shumë: http://www.wttc.org/
Komuna e Rozhajës. Ueb faqja "ROZAJE.ME". Zbartur me 16 janar 2015. Për më shumë : www.rozaje.me

DIANA SHEHU – GLOBALIZIMI DHE NDIKIMI I TIJ NE INSTITUCIONET FINANCIARE

DIANA SHEHU
Universiteti Bujqesor, Tiranë

Abstrakti

Globalizimi është një process, i cili përfshin të gjitha aspektet jetësore: politike, sociale, ekonomike, demografike, ambientale, kulturore, megjithëse kushtet paraprake të zhvillimit të këtij procesi duket se kanë patur më tepër karakter ekonomik dhe social. Si rrjedhim, analiza e tij në mënyrë të pjesshme nuk do ta plotësonte kuadrin plotësisht, por për qëllime studimore bëhet i pashmangshëm studimi i tij sektorial. Në të njëjtën kohë duket e qartë se globalizimi është një fenomen i pandalshëm, i cili duhet pranuar si i tillë dhe të administrohet në atë mënyrë që të jetë i vlefshëm për të gjithë njerëzimin, duke marrë parasysh edhe karakterin e tij mbarënjerëzor. Edhe mbi origjinën e globalizimit ka mendime nga më të ndryshmet. Diferenciali kohor midis këtyre mendimeve nuk është i parëndësishëm: përfshin shekuj, por edhe mijëvjeçarë duke filluar që me tregtinë në Egjiptin e vjetër, duke kaluar në zbulimin e Amerikës, duke vazhduar më pas me revolucionin industrial të shek. XIX e deri në zhvillimin teknologjik të disa dekadave më parë.

Me gjithë rëndësinë e zbulimeve dhe marrëdhënieve tregtare të disa shekujve apo disa mijëvjeçarëve më parë, duhet thënë se zhvillimet e dy shekujve të fundit, duke filluar nga revolucioni industrial i shek. XIX, kanë qenë vendimtare në procesin e globalizimit për një sërë arsyesh të cilat e dallojnë globalizimin e tanishëm nga integrimet e mëparshme në disa pika:

- volumi tregtar ka pësuar një rritje të jashtëzakonshme në dy shekujt e fundit në nivel botëror;
- varieteti i mallrave dhe shërbimeve të përfshira në marrëdhëniet tregtare kanë pësuar një rritje të konsiderueshme;
- diferenca midis çmimeve për të njëjtin produkt apo shërbim ka pësuar një rënie të vazhdueshme ne tregjet e vendeve te ndryshme;
- shmangia e efekteve inflacioniste nëpërmjet rritjes së disponibilitetit të faktorëve prodhues si rezultat i rritjes së marrëdhënieve tregtare ka bërë të mundur që të ndajë presionin e çmimit mbi faktorët e pamjaftueshëm prodhues.

Globalizimi i tregjeve financiare

Në vazhdën e botëkuptimit neo-liberal të kapitalizmit, duke filluar nga vitet ’80 të shekullit të kaluar edhe tregjet financiare kanë pësuar një liberalizim të theksuar duke vënë theksin në këtë mënyrë tek “dora e padukshme” e tregut, i cili mund të përmirësojë situatën e vendeve në zhvillim (dhe natyrisht edhe të vendeve të zhvilluara) pa qenë e nevojshme ndërhyrja dhe kontrolli i shtetit në daljet dhe hyrjet e kapitalit. Përsa i përket aktorëve financiarë duhet thënë se tashmë vihet re një shumëllojshmëri aktorësh që veprojnë në tregjet financiare. Sot bizneset mund të kërkojnë kredi me procedura më të thjeshta pranë tregjeve financiare. Bankat e nivelit të dytë mund t’i drejtohen tregut dhe të financohen nga banka të tjera apo edhe nga biznese të tjera, kur më përpara duhej të drejtoheshin kryesisht tek bankat qendrore në rast problemesh likuiditeti. Vetë shteti, mund të veprojë në të njëjtën mënyrë si bizneset e tregut financiar. Si rrjedhim shteti, bankat dhe operatorë të tjerë veprojnë në të njëjtin treg duke i përzier rolet, role të cilat para liberalizimit ishin më të qarta dhe më të ndara. Në të njëjtën kohë ka marrë një zhvillim mjaft të madh tregu i derivatëve financiarë, të cilët shërbejnë për të siguruar instrumentet primarë financiarë (si p.sh aksionet) nga rreziku i luhatjes së interesave apo këmbimit monetar: këto derivatë financiarë kur përdoren për qëllime spekullimi, pra për një fitim afatshkurtër, bëhen mjete mjaft të rrezikshme për të prodhuar kriza, duke qenë se ndikojnë në mënyrë indirekte në kostot e ekonomisë reale.

Në fakt derivatët financiarë janë “tituj mbi tituj”, të cilët e shpejtojnë qarkullimin financiar dhe e “virtualizojnë” ekonominë reale duke rritur së tepërmi rrezikun e falimentimit, që si një valë tsunami

mund të përfshijë të gjithë tregun financiar tashmë të globalizuar. Për të kuptuar rolin dhe përhapjen e madhe të këtyre mjeteve financiare mund ta konkretizojmë këtë duke thënë se transaksionet financiare ndërkombëtare janë në vlerën e 1000 miliardëve dollarë në ditë kur vlera e shkëmbimeve të mallrave dhe shërbimeve është shumë herë më e vogël se kaq. Një gjë e tillë tregon që veprimet në tregjet financiare nuk kanë një raport të drejtpërdrejtë me shkëmbimet ndërkombëtare të mallrave dhe shërbimeve.

Një situatë e tillë përshpejtohet edhe nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit, i cili afron tregjet me njëri - tjetrin pothuajse në kohë reale duke bërë të mundur që, përveç anëve pozitive të rritet edhe aftësia kontraktuese e spekulatorëve. Po kështu liberalizimi i tregjeve ka mundësuar edhe shtimin e parajsave fiskale, ku mund të investojnë bankat, bizneset shumëkombëshe deri edhe mafiat e ndryshme, të cilat mund ta riciklojnë mjaft lirshëm pasurinë e krijuar nga aktivitetet e tyre të paligjshme Përsa i përket pasojave të liberalizimit të tregjeve financiare do t'i referohemi kontributeve të teorisë ekonomike dhe paralelisht me të do të bazohemi tek të dhënat empirike për të vërtetuar koerencën e përfundimeve teorike me realitetin ekonomik. Kështu sipas teorisë ekonomike, tregjet financiare janë të dobishme për disa arsye.
Së pari, liberalizimi i tregjeve financiare mundëson lëvizjen e kapitalit nga ato vende ku gjendet me shumicë, në vendet ku ka një defiçit të bilancit të pagesave, pra ku ka një mungesë kapitalesh. Alokimi efektiv i kapitalit rrit mirëqënien e përgjithshme të popujve. Si rrjedhim, një gjë e tillë do të mundësonte që p.sh. kapitali me shumicë nga vendet e zhvilluara të lëvizte drejt tregjeve financiare të vendeve në zhvillim.
Së dyti, liberalizimi i tregjeve mundëson kërkimin dhe gjetjen e atyre tregjeve që ofrojnë investime me fitime më të mëdha.
Së treti, rritja e konkurrencës mes ndërmjetësve financiarë do të duhet të zvogëlojë kostot e financimit, e cila përkthehet në një ulje të kostos së investimit për ndërmarrjet e vendeve të financuara.
Së katërti, zhvillime të tilla ku kemi një përmirësim të funksionimit të tregjeve dhe një shtim të operatorëve në konkurrencë me njëri - tjetrin do të shërbenin për një zhvillim të tregjeve financiare ku drejtohen financimet.

Globalizimi dhe institucionet financiare

Globalizimi në sistemin financiar ka sjellë bashkimet dhe blerjet midis institucioneve të mëdha financiare që po bëhen gjithnjë më të shpeshta në tregjet mbarëbotërore, të cilat kanë kanë tërhequr vëmendjen e politikbërësve, studiuesve dhe mbarë shtypit financiar, që vazhdimisht rendisin firmat më të mëdha financiare në mbarë botën. Shumica e këtyre megabashkimeve kanë kombinuar bankat tregtare të një vendi nën një të vetme. Në Shtetet e Bashkuara, bashkimet e fundit mes bankave tregtare kanë ndodhur midis bankave të mëdha siç është Bank of America me Nations Bank, Bank One me First Chicago dhe Norwest me Wells Fargo, të cilat janë rënditur si bashkimet më të mëdha midis këtyre institucioneve në aspektin e vlerës së tregut që kanë ndodhur në historinë e industrisë amerikane. Gjithashtu dhe në Europë janë krijuar megabashkimet midis bankave tregtare si UBS me Banken Zviceriane duke krijuar një treg bankar gjigant, të cilat janë shumë më të mëdha se ç'mund të kenë qënë bankat në të kaluarën. Në Japoni bashkimi midis tre bankave, Fuji Bank, Dai-Ichi Kangyo Bank dhe Banka Industriale e Japonisë po krijojnë bankën e parë Trillion-Dollarëshe në botë. Ajo që vemë re është një prirje e këtyre institucioneve ndërkufitare drejt bashkimeve midis institucioneve të mëdha financiare midis vendeve të ndryshme. Këto bashkime ndërkufitare shpesh herë përfshijnë institucione të ndryshme finaciare, të cilat ofrojnë lloje të ndryshme të shërbimeve financiare në vende të ndryshme. Një shembull i spikatur i këtyre lloj mega shkrirjeve është ajo e Deutche Bank me Bankers Trust, ku ky bashkim solli një bankë lider universale europiane, me një akses të madh në shitjen me shumicë të burimeve dhe investimeve bankare në Shtetet e Bashkuara. Në Europë, gjithashtu ka qëne i konsiderueshëm konsolidimi ndërkufitar i të gjithë llojeve të institucioneve financiare pas heqjeve të rregullave të konsiderueshme ndërkufitare të aktiviteteve ekonomike në tregjet financiare dhe jofinanciare. Për industritë e letrave me vlerë dhe shoqëritë e sigurimit, vitet e fundit vlera e tregut ndërkufitar e institucioneve financiare europiane të bashkuara e kanë tejkalur vleren e tregut të tyre që kanë pasur para bashkimit në vendet përkatëse. Bashkimet dhe shkrirjet e

vazhdueshme të institucioneve financiare kanë ngritur çështje të rëndësishme dhe pyetje rreth politikave, shkaqeve dhe pasojave të këtyre konsolidimeve në strukturë e ardhshme të institucioneve financiare. Ekziston një literaturë e gjerë kërkimore mbi motivet dhe pasojat e këtyre konsolidimeve, duke mbuluar efikasitetin, fuqinë e tregut dhe çështjet manaxheriale.

Duket se, shumica e rritjes së konsolidimeve përfaqeson përgjigjet e tregut për çrregullimet që e bëri atë më të mundshëm dhe më pak të kushtueshëm për t'u konsoliduar, të tillë si aktin e Riegle-Neal në Shtetet e Bashkuara dhe Programin e Vetëm të Tregut në Bashkimin Europian (BE).

Konsolidimet e ardhshme mund të motivohen nga ndryshimet e politikave të fundit, të tilla si pasazhi i aktit Gramm-Leach- Bliley në Shtetet e Bashkuara dhe krijimi i bashkimit monetar (Euro) në Bashkimin Europian. Këto ndryshime të politikave mund të përshpejtojnë konsolidime të mëtejshme të institucioneve të mëdha financiare, me pasoja të rëndësishme sociale për riskun sistematik dhe politikën monetare të vendeve të ndryshme, si dhe për efikasitetin dhe fuqinë e tregut në industrinë e shërbimeve financiare.

Trendet e institucioneve financiare

Një ndër faktorët më motivues në konsolidimet ndërkufitare të institucioneve financiare është rritja e nivelit të përgjithshëm të integrimit ekonomik përtej kufijve kombëtarë. Reduktimet në barrierat tregtare, rënia në kostot e transporteve, si dhe avancimet në teknologjinë e komunikimit kanë çuar në një përshpejtim të integrimit ekonomik ndërkombëtar në vitet e fundit. Transaksionet ndërkombëtare në mallra dhe në shërbime shpjegojnë një pjesë gjithnjë e ne rritje të ekonomisë botërore. Përshembull: produkti i brendshëm bruto botëror i tregtisë në mallra është rritur nga 21 % që ka qënë në 1937 në 30 % në vitin 1998. Rritjet e fundit të ekonomisë ndërkombëtare kanë krijuar një kerkesë për shërbime financiare ndërkombëtare. Një institucion financiar mund të përdorë një shumëllojshmëri të kanaleve për t'i ofruar shërbime financiare një klienti biznesmen të një vendi të huaj. Institucioni mund t'i ofrojë shërbimet drejtpërsëdrejti biznesit të huaj nga selia e tij qendrore në vendin e origjinës. Institucioni mund të marrë pjesë në një sindikatë që financon një hua të madhe apo tituj të letrave me vlerë që është iniciuar nga një institucion tjetër financiar që është vendosur në një vend të huaj. Dhe së fundmi, institucioni financiar mund të ketë një prani fizike në vendin e huaj (duke blerë një institucion financiar atje apo duke hapur një filial të ri) dhe të ofrojë shërbimin në vendin e huaj. Krijimi i një prezence fizike në një vend të huaj përfshin një numër të madh shpenzimesh për institucionet financiare të tilla si: vështirësitë ekonomike dhe organizative apo monotorimi i një institucioni në distancë. Megjithatë, krijimi i një pranie fizike në një vend të huaj ofron disa avantazhe potencialisht kompensuese që përfshijnë:
Shërbimi dhe monotorimi më me efektivitet i konsumatorëve me pakicë;
Mundësinë për të konkuruar për klientët më pakicë apo me shumicë në një vend të huaj.

Liberalizimi i kohëve të fundit i ka reduktuar shpenzimet e ofrimit të kësaj mënyre operimi të institucioneve financiare. Tregjet e letrave me vlerë gjithashtu reflektojnë një prirje drejt globalizimit. Çështjet ndërkombëtare të letrave me vlerë të borxhit, të letrave me vlerë të kapitalit dhe flukset e fondeve bankare ndërkufitare janë rritur të gjitha vitet e fundit. Nga viti 1933 deri 1998 obligacionet ndërkombëtare (obligacione të lëshuara nga nënshtetas të huaj plus eurobondet) u rriten nga 1.3 trilion $ në 2.6 trilion $, të cilat dyfishuan nga 8% në 16% përqindjen e bonove ndërkombëtare ndaj totalit të bonove në tregjet botërore. Kapitali neto ndërkombëtar gjithashtu është rritur ndjeshëm në terma realë; nga 50 bilion $ në vitin 1996 në më shumë se 70 bilion $ në vitin 1998. Pavarësisht këtyre rritjeve, rrjedha e fondeve ndërkombëtare e bankave mbetet po aq e madhe sa çështjet e bonove ndërkombëtare dhe në thelb janë më të mëdha se kapitali neto ndërkombëtar.

Motivet e Tregjeve Financiare

Shumica e hulumtimeve të fuqisë së tregut fokusohet mbi efektet e konsolidimit të shkrirjeve dhe blerjeve brenda një vendi dhe mbi efektet e tyre te konsumatorët me pakicë. Më konkretisht, fokusimi

është veçanarisht mbi depozituesit e vegjël dhe bizneset e vogla të bashkimeve dhe blerjeve midis institucioneve në të njëjtin treg lokal.
Tregu i bashkimeve apo blerjeve të institucioneve financiare mund të rrisin përqendrimin në tregun vendas dhe të lejojë institucione të konsoliduara të rrisin vlerën e aksionarëve, duke vendosur çmime më pak të favorshme për klientët me pakicë (norma më të ulëta të depozitave, apo norma më të larta të kredisë për bizneset e vogla). Në përputhje me këtë fokus, është vërtetuar se familjet amerikane apo bizneset e vogla pothuajse gjithmonë zgjedhin një institucion financiar lokal. Konsolidimet ndërkufitare nuk rrisin direkt përqendrimin në tregun lokal për produktet e blera në mënyrë tipike nga konsumatorët me pakicë. Megjithatë, ai mund të ndikojë në ushtrimin e fuqisë se tregut mbi këta konsumatorë duke:

Ndikuar në konsolidimin brenda kombeve;
Duke ndryshuar dinamikën konkuruese nëpërmjet konsolidimit ndërkufitar të institucioneve;
Duke nxitur rivalitet dhe rritur nivelin konkurues të tregjeve bankare vendase.

Konsolidimet ndërkufitare apo kërcënimet e tyre mund të çojnë në konsolidimin e institucioneve financiare brenda për brenda kombeve, duke rritur përqëndrimin në tregun vendas. Për të mbrojtur, së pari, fuqinë e tregut ekzistues apo manaxhimin e rrënjosur, institucionet financiare brenda kombeve të tyre mund të angazhohen në bashkimet apo blerjet midis tyre për të ndihmuar njëri-tjetrin, për të shmangur konkurentet potencialë të huaj.
Hulumtimet e tregut në përgjithësi sugjerojnë se përqendrimi i konsolidimeve në tregun lokal brenda një shteti ka gjasa që të rrisë fuqinë e tregut në vendosjen e çmimeve për shërbimet financiare të shitjes me pakicë. Studimet e bashkimeve dhe blerjeve midis bankave në çmimet kanë zbuluar se bashkimet dhe blerjet përfshijnë rritje të konsiderueshme në përqëndrimin e tregut lokal, të cilat kanë tendencen për të rritur fuqinë e tregut në vendosjen e çmimeve dhe që aspektet e tjera të këtyre bashkimeve janë të paqarta. Studime të tjera tregojnë se bankat në tregjet më të koncentruara zbatojnë norma më të larta interesi për kreditë e bizneseve të vogla dhe paguajnë norma më të ulëta interesi për depozitat me pakicë dhe se normat e depozitave të tyre janë të ngadalshme për t'iu përgjigjur ndryshimeve të tregut të normave të interesit. Është sugjeruar që fuqia e tregut mbi klientët e vegjël mund të ketë rënë në vitet e fundit, për shkak të rritjes së shkallës së konkurrimit midis shërbimeve të tregjeve financiare dhe teknologjive të reja për ofrimin e shërbimeve financiare, por evidencat empirike për këtë çështje janë të përziera. Konsolidimi ndërkufitar mund të ndikojë dhe në ushtrimin e fuqisë së tregut brenda tregjeve të veçantae dhe nëse nuk ka ndonjë ndryshim në përqendrimin e tregut vendas.
Institucionet kanë tendencen për të vendosur çmime uniformë për të gjithë organizatën edhe kur strukturat e tregut vendas ndryshojnë ndjeshëm me të gjithë tregjet me të cilët ata konkurojnë. Përshembull: një studim konstaton se bankat e mëdha amerikane shpesh kanë vendosur norma interesi uniforme për depozitat apo për kreditë përgjatë gjithë tregut gjeografik brenda një shteti apo një rajoni, edhe pse arsyet për këtë s'janë të qarta. Çmimi uniform mund të ndodhë për arsyen sepse ai është më i lehtë për tu' administruar, për arsye të marrëdhënieve publike për barazi apo faktorëvë të tjerë.
Evidencat e bankave mbi tarifat e depozitave me pakicë dhe shërbimeve të pagesave tregon marrëdhënie të pakta në përqëndrimin e tregut lokal në vitet 1990 dhe një tendencë të bankave ndërkombëtare të mbajtjes së tarifave më të larta për konsumatorët me pakicë se sa bankat e tjera. Këto rezultate të ngjashme sugjerojnë se faktorët e tjerë të përqendrimit në tregun lokal janë të rëndësishëm në ushtrimin e fuqisë së tregut. Përshembull: kjo strategji e vendosjes së çmimit mund të jetë dizenjuar nga menaxherët përgjegjës për një zhvendosje prej klientëve të vegjël të shërbyer në drejtim të klientëve të mëdhenj.

Për më tepër, konsolidimet ndërkufitare mund të rezultojnë se institucione të njejta konkurrojnë kundër njëri-tjetrit në vende të shumta. Teoria e multimarketit të kontakteve sugjeron se në qoftë se firmat përballen me njëra-tjetrën në tregjet e shumta, ato nuk mund të ushtrojnë më shumë ose më pak fuqi se sa tregu. Ato mund të kenë më shumë fuqi në treg sepse në mënyrë reciproke ndikojnë tek njëra-tjetra. Kjo është një ndër arsyet pse ato vendosin çmime të larta në vend që të konkurojnë në tregje të tjera. Gjithashtu ato mund të kenë më pak forcë në ushtrimin e fuqisë së tregut së paku në

afat të shkurtër, nëse bankat vendosin çmime strategjike për të sinjalizuar kostot e tyre apo për të përzënë konkurentët nga tregu. Të dhënat janë të përziera për efekt të kontakteve të shumta të tregut mbi çmimvënien e produkteve bankare me pakicë. Së fundmi, konsolidimet ndërkufitare apo kërcënimet e hyrjeve të reja ndërkufitare mund të reduktojnë fuqinë e ushtrimit të tregut për shkak të rritjes së konkurrencës. Një mënyrë që kjo të ndodhë është nëse institucionet ekzistuese financiare në një treg, ndryshojnë sjelljen e tyre çmim-kufi, në vendosjen e çmimeve më të favorshme për konsumatorët si një përpjekje për të penguar hyrjet e jashtme. Gjithashtu, kjo mund të ndodhë dhe nëse prodhuesit efikas të huaj hyjnë në treg dhe ofrojnë shërbime me çmime më të favorshme për të marrë pjesë nga tregu vendas nga prodhuesit vendorë që janë jo efikasë. Në Bashkimin Europian, një pikë kryesore në studimin e Cecchini mbi impaktin e tregut të vetëm unik ishte se konkurrenca ndërkufitare do të krijonte potencial të konsiderueshëm në ndryshimin e çmimeve dhe të binte në nivelin e prodhuesve me kosto të ulët.

Në të vërtetë krijimi i një tregu të vetëm për shërbimet financiare në Bashkimin Europian është një test i rëndësishëm i këtij fenomeni. Që nga miratimi i Traktaktit të Romës në vitin 1957, BE ka miratuar legjislacione të projektuara për të nxitur konkurrencën midis institucioneve financiare nëpërmjet krijimit të liçensave të vetme bankare dhe harmonizimin e rregullimeve. Miratimi i një monedhe të vetme pritet të rrisë më shumë konkurrencën midis institucioneve financiare, duke ulur barrierat e hyrjes në treg dhe duke ulur rrezikun e monedhës, e cila mund të rrisë gatishmërinë e disa konsumatorëve për të blerë shërbime financiare nga vende të tjera. Thellimi i tregjeve të kapitalit në BE ka gjasa të sigurojë konkurrencë shtesë midis bankave dhe më së shumti të atyre bankave që janë të orientuara prej shteteve të Europës Qendrore. Ky cenim i tregjeve të letrave me vlerë mund të rrisë presionin konkurrues mbi bankat, duke i dhënë klientëve të bizneseve mundësi të tjera për të rritur kapitalin e tyre duke lëshuar letra tregtare, obligacione apo barazi në kapitalin publik në vendin e kredive bankare dhe duke i dhënë mundësi të tjera kursimtarëve për të investuar me fondet e tyre në tregun e parasë, tregjet e kapitalit apo në pasuri të tjera që tregtohen në vend të depozitave bankare.

Perfundimi

Në sajë të globalizimit ekonomia globale është duke përjetuar krizën më të rëndë financiare në tetëdhjetë vitet e fundit. Kriza së pari përfshiu një pjesë të madhe të sistemit financiar amerikan, kreditë hipotekore, kurse gradualisht është përhapur në sistemin bankar të sigurimeve, fondeve dhe në bursa. Kriza financiare amerikane shumë shpejt është përhapur në sektorin financiar europian, bankar dhe në bursa. Rritja ekonomike globale e BPSH (GDP) seriozisht është ngadalësuar, janë në rënie çmimet e patundshmërive (të të gjitha llojeve), disa prej sektorëve të industrive kanë filluar të pësojnë humbje të mëdha. Treguesit e shumtë po tregojnë për rrezikun që për momentin po përjeton ekonomia globale, e cila gjithnjë e më shumë po i ofrohet recesionit e ndoshta edhe depresionit të paparë gjerë më tani. Në përpjekje që të evitohet përhapja e krizës, qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve më të zhvilluara me masa energjike po e vënë në veprim kapitalin e freskët në sektorin bankar.

Përveç kësaj, disa banka gjer më tani me emër të madh në SHBA-të dhe në Britaninë e Madhe nuk ekzistojnë më, kanë falimentuar. Disa prej këtyre bankave qeveria amerikane i ka marrë në mbikqyrje, kurse në Europë gjithashtu po ndodh i njejti skenar. Në opinion publik është përhapur qëndrimi, që krizën financiare e kanë shkaktuar kreditë hipotekare në SHBA. Është e njohur tashmë se kreditë hipotekare të pakthyera dhe rënia e çmimit të tyre në tregun e patundshmërive ka shkaktuar humbje të pa kompensueshme, për një mori fondesh dhe banka. Kurse tërë kjo ka shkaktuar fillimin e krizës financiare të tanishme.

Mirëpo sipas shumë analizave të ekspertëve, rrjedh se kjo nuk është shkaktari kryesor i krizës. Pse nuk funksionoi sistemi financiar i rregullatorit mbikqyrës? Që në fillim duhet thënë se kriza financiare globale është krizë e sistemit financiar botëror. Ajo tani është e vështirë dhe ndryshe nga të gjitha krizat gjer më tani. Është e ditur se themelet e sistemit financiar aktual janë krijuar në Bretton Woods në gjysmën e shekullit të kaluar. Si bazë e këtij sistemi ka shërbyer dollari amerikan, në të cilin janë fiksuar të gjitha valutat e tjera, kurse dollari ka qenë i bazuar në arin. Një konstruksion i tillë ka funksionuar gjerë te shkëputja e konvertibilitetit të dollarit në fillim të viteve të shtatëdhjeta.

Shkëputja e konvertibilitetit e ka ndërprerë në një mënyrë simbolike ekonominë reale nga ajo financiare. Këtu ka ndodhur transformimi i sistemit tradicional konservativ bankar, që ka pasuar me lindjen e institucione të reja, krijimin e produkteve të reja financiare, të ashtuquajtura inovacione, opsione, derivime. Duke u bazuar në tërë këtë, sektori financiar është zhvilluar i pavarur dhe në mënyrë të pa krahasueshme më shpejt se sa ekonomia reale. Nxitja e kësaj fryrjeje financiare e ka predikuar doktrinën dominuese të tregut me bindjen që tregu financiar është mekanizëm vetërregullues, i cili nuk ka mundësi të përojë thyerje. Rritja e sektorit financiar dhe globalizimi i tij ka mundësuar rirregullimin dinamik.

Këte e ka mundësuar zhvillimi i teknologjive të larta - informatikës dhe telekomunikacionit, si dhe zhvillimi i teknologjive adaptive të një numri të madh të inovacioneve financiare. Tregu financiar është bërë global, janë zhvilluar subjekte financiare gjigante, banka dhe fonde tjera financiare, të cilat janë bërë aq të mëdha sa që mundësia e falimentimit eventual ishte minimale. Krahasimisht me rritjen e tregut financiar janë zhvilluar edhe sistemet e mbikëqyrjes dhe rregullimit, mirëpo ato si të tilla në një masë të madhe kanë mbetur me karakter nacional. Për këtë, shumë produkte inovative financiare, posaçërisht në sektorin investiv bankar, kanë funksionuar jashtë mbikëqyrjes së sistemit rregulativ. Kjo njëherit ishte dobësia kryesore që shkaktoi stuhinë në sistemin financiar, i cili veproi në mënyrë të pakontrolluar nga ana e rregullatorit mbikqyrës.

Literatura

Banka e Shqipërisë, 101 terma nga bankingu qendror- broshurë e botuar nga Banka e Shqipërisë me rastin e Konferencës V të Bankës së Shqipërisë, 2004.
Cook Thimoty Q. Instruments of the money market 1986
Fadil Govori; Tregjet financiare 1992.
Campbell R. Harvey; Hypertextual Finance Glossary
Raportet vjetore të bankave tregtare të ndryshme
Saunders Anthony, "Financial Institutions Management", botimi i tretë, viti 2000.
Bonin John, "Financial Intermediation in Southeast Europe: Banking in Balkan", tetor 2000.
Jeff Madura; Personal Finance and Financial Planning Workbook, 2/e
Frederick S. Mishkin and Stanley G. Eakins; Financial Markets and Institutions, 4/e,
Englewood Cliffs 1996; International financial markets
Herbert B.Mayo, Financa Tiranë 1995
David N. King 1999; Financial claims and derivatives, 1st edition
Mf.Erjola Sakti .Punim shkencor Rregullimi banker,akordet e Bazelit 2013
MF.Kledi Tufi.punim shkencor Tregu i derivateve

PHD. (C) ARTAN OSMANI, VAIT NIKAJ - INDEKSET NDËRKOMBTARE NË TREGUN E KAPITALIT

PHD. (C) ARTAN OSMANI
Fakulteti per Menaxhim dhe Finance, Tivar

VAIT NIKAJ
Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim, Ulqin

Abstrakti

Në vitet e fundit tregjet ndërkombëtare janë zhvilluar shumë dhe interesi për investime ndërkombëtare në kapital është gjithnjë e më shumë në rritje duke çuar në lindjen e nevojës së krijimit të indekseve për të ndihmuar investitorët në kryerjen e investimeve të duhura. Ata kryejnë një sërë funksionesh dhe secili nga indekset shërben për të matur një element të veçantë të tregut. Tregues të ndryshëm ndërtohen mbi lista të ndryshme të aksioneve ku një tregues mund të përfshijë disa aksione të tregtuara në publikë një pjesë të tyre. Kjo detyrë kursi do të na njohë me llojet e indekseve, mënyrën e funksionimit të tyre dhe disa nga indekset ndërkombëtare më të njohura në botë.

Qëllimi i kësaj detyre është njohja e konceptit indeks në përgjithësi dhe atij të indeksit të tregut të kapitalit, funksionimin e tyre, llojet e indekseve bazuar në klasifikimin ndërkombëtar dhe me disa nga indekset më të njohura ndërkombëtare që përdoren më së shumti nga investitorët.

Metodologjia
Për punimin e kësaj detyre kam shfrytëzuar burimet sekondare si literatura në lidhje me indekset ndërkombëtare dhe informacionet e siguruara nga faqet e ndryshme të web-it.

Çfarë kuptojmë me indeks
Para se të flasim për indekset duhet të njihemi fillimisht me termin indeks në përgjithësi dhe po ashtu me termin indeks në tregun e kapitalit në veçanti. Me termin indeks[227] kuptojmë matjen statistikore të ndryshimit në një ekonomi apo në një treg të letrave me vlerë. Në rastin e tregjeve financiare, një indeks është një portofol imagjinar i letrave me vlerë që përfaqësojnë një treg të veçantë ose një pjesë të tij. Secili indeks ka metodologjinë e vet të llogaritjes dhe është e shprehur në termat e ndryshimit nga një vlerë bazë.
Indekset[228] masin gjithashtu edhe ulje-ngritjet e çmimeve të aksioneve, bonove dhe tregjeve të mallrave dhe numrin e aksioneve në qarkullim për kompanitë që bëjnë pjesë në indeks. Disa indekse të njohura janë Dow Jones Averages, New York Stock Exchange Composite Index, American Stock Exchange Composite Index, Standard & Poor's 500 Index, NASDAQ Composite Index, Russell 2000 Index dhe Value Line Composite Index.
Indekset mund të jenë në forma të ndryshme. Indekset e tregut të aksioneve masin vlerën përkatëse të një grupi aksionesh. Indekset e çmimeve përfaqësojnë mesataret e ponderuara të çmimeve për kategori të caktuara të mallrave dhe shërbimeve, ilustrojnë luhatje të çmimeve në një fushë të caktuar dhe gjatë një periudhe të caktuar.

Llojet e indekseve

Indekset e tregut të aksioneve mund të jenë kombëtare dhe ndërkombëtare. Një indeks ndërkombëtar apo global përfshin kompani të medha pa patur parasysh se ku aksionet e tyre tregtohen apo dominojnë siç janë MSCI World dhe S&P 100 Global, ndërsa indekset kombëtare paraqesin performancën e tregut të aksioneve të një vendi të caktuar dhe reflekton besimin e investitorëve mbi

[227] http://www.investopedia.com/terms/i/index.asp
[228] http://www.allbusiness.com/glossaries/index/4944919-1.html

gjendjen e ekonomisë së saj siç janë S&P 500, Nikkei 225 japonez dhe FTSE 100 britanik. Indekset e tjera mund të jenë rajonale të tillë si FTSE Europe Index apo FTSE Asia Pacific Index.

Si funksionojnë indekset[229]

Indekset mbledhin aksione në atë që quhet "shportë" dhe në qoftë se një investitor kërkon të investojë në një indeks atëherë ai do të investojë në të gjitha aksionet që përmban shporta. Indekset janë të dizenjuara për një treg të veçantë apo për një aktiv të tillë. Investitorët që kërkojnë të kryejnë investime ndërkombëtare mund të zgjedhin njërin nga indekset ndërkombëtare pa patur nevojë të kryejë investime në të gjitha kompanitë më të mëdha të botës që një indeks mund të përfshijë. Ponderimi në një indeks varet se si aksionet janë të shpërndara në shportë dhe se si indeksi është i projektuar. Për shembull në indekset me sasi të ndryshme të pjesëve të aksionit për çdo çmim të aksionit, një aksion që kushton 20$ do të kishte një pjesë aksioni e ndërsa një aksion që kushton 5$ do të kishte 4 pjesë të aksionit për t'a bërë të barabartë me aksionin 20$. Po ashtu pesha varet edhe nga kapitalizimi i tregut, pjesët e çdo aksioni ponderohen në bazë të vlerës së tregut të aksioneve.
Indekset janë një mënyrë e mirë për të fituar ndaj ekspozimit në tregje apo sektorë të caktuar apo ndaj performancës së përgjithshme të një tregu duke blerë shportën e indeksit të duhur. Por nëse një indeks është i projektuar për një treg të caktuar kjo nuk do të thotë se është 100 % i saktë. Nëse një investitor blen një indeks tregu të huaj të një rajoni të caktuar nuk do të thotë se shporta e aksioneve do të lëvizë ekzaktësisht me ekonominë e atij rajoni. Ka shumë faktorë që mund të ndryshojnë rrjedhën e një tregu që nganjëherë nuk mund të reflektohen menjëherë në indeks.

Indekset më të njohura ndërkombëtare
Më poshtë listohen disa ndër indekset më të njohura ndërkombëtare si :
- MSCI EAFE Index
- MSCI All Country World Index (ACWI)
- S&P Global Equity Index
- FTSE Global Equity Index (VEU)
- Salomon Brothers World Equity Index (SBWEI)

Indeksi MSCI EAFE[230] njihet si një pikë referimi mjaft e njohur në Shtetet e Bashkuara për të matur performancën e kapitalit ndërkombëtar. Ajo përbëhet nga indekse MSCI të vendeve që përfaqësojnë tregje të zhvilluara jashtë Amerikës së Veriut si Europa, Australia, Asia dhe Lindja e Largët. Janë të shumta këmbimet e fondeve që kryhen në indeksin e EAFE MSCI dhe që listohen në shumicën e bursave kryesore dhe mat performancën e më shumë së 1,000 aksioneve në 21 vende si : Australia, Austria, Belgjika, Finlanda, Danimarka, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Norvegjia, Portugalia, Singapori, Spanja, Zvicra, Suedia, Zelanda e Re, Franca, Britania e Madhe, etj. Indeksi u zhvillua fillimisht në vitin 1969 nga Morgan Stanley Capital International e cila është në pronësi të bankës së njohur të investimeve Morgan Stanley dhe është i njohur aktualisht si MSCI Barra. Si një nga indekset ndërkombëtare më të vjetra, EAFE është gjerësisht e përdorur në menaxhimin e investimeve për të gjykuar performancën e fondeve të huaja të përbashkëta dhe fondeve të pensioneve.
Avantazhi i MSCI EAFE është se duke qenë një shportë aksionesh ofron ekspozimin e gjerë në tregjet e huaja me një kosto të ulët. Por edhe pse është një pikënisje e mirë investimesh ai nuk përfshin vende në zhvillim dhe me rritje të shpejtë të tregut si Brazili, Rusia, India dhe Kina. Gjithashtu vendet me tregje më të mëdha dhe më të avancuara si Japonia dhe Britania e Madhe gjithmonë do të priren të kenë peshën më të madhe në indeks, pa marrë parasysh perspektivat e tyre të investimeve dhe vendet me tregje më të vogla të aksioneve do të kenë më pak ndikim edhe në qoftë se ofrojnë kthime spektakolare.

Investitorët që janë në kërkim të krijimit të një portofoli të larmishëm aksionesh mund t'a realizojnë lehtësisht duke përdorur MSCI All Country World Index (ACWI). Ai përfshin në portofol kapital aksioner të vogla dhe të mëdha të vendeve të zhvilluara dhe kapitale të vogla dhe të mëdha të vendeve

[229] http://etf.about.com/od/etfbasics/a/What_is_a_Stock_Index.htm
[230] http://internationalinvest.about.com/od/internationalstockindices/a/EAFE.htm

në zhvillim. Ky indeks është i zhvilluar po nga Morgan Stanley Capital International (MSCI), ofruesi kryesor i mjeteve për marrjen e vendimeve të investimit. Investitorët e përdorin këtë indeks sepse ofron një mënyrë të lehtë dhe të matshme për diversifikimin e investimeve globalisht si dhe gjithashtu si nje pikë referimi për portofolet e tyre.

Indeksi S&P Global Equity231 është indeks i tregut të aksioneve për aksionet globale nga Standard&Poor's. Ai është i dizenjuar të përfshijë aksionet më likuide të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Të gjitha tregjet e mëdha rajonale, kombëtare janë të përfshira duke matur performancën e 100 kompanive shumëkombëshe me kapital të madh dhe që një pjesë të madhe të të ardhurave i sigurojnë nga vendet e ndryshme ku operojnë. Një kompani shumëkombëshe është ajo koorporatë e cila ka objekte të prodhimit dhe / ose asete fikse në vende të shumta të tjera dhe që i merr vendimet në kontekst global. Ky indeks plotëson nevojat e investitorëve që dëshirojnë të ndjekin performancën e kompanive globale. Me 100 kompanitë më likuide në përbërje, indeksi mbështet investitorët me një kosto të ulët duke përfshirë fondet e huaja dhe disa derivative si kontratat e së ardhmes dhe opsionet. Kompanitë janë të përzgjedhura nga 29 vende dhe pesha e tyre në indeks varet sipas madhësisë së tregut.

FTSE Global Equity Index (VEU) mbulon mbi 7,400 letra me vlerë në 47 vende të ndryshme. FTSE Group llogarit dhjetëra mijëra tregues të performancës të tregut dhe u formua si një kompani e pavarur nga çfarë ishte fillimisht si një ndërmarrje e përbashkët e Financial Times dhe Bursës së Londrës.

Salomon Brothers World Equity Index (SBWEI)232 është një tregues që mat ecurinë e të ardhurave fikse dhe të letrave me vlerë dhe të letrave me vlerë të kapitalit nga tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare që konsiston në kompani me një rrjedhë parash së paku 100 milionë dollarësh. Ky indeks përdor një analizë top-down për të vlerësuar kompanitë dhe pesha e tyre varet nga pesha e rrjedhave të tyre të parave. Ky indeks përfshin aksione të mbi 6,000 kompanive të vendosura në 22 vende të ndryshme.

Përfundime

Nevoja për kryerjen e investimeve të duhura ndërkombëtare ka çuar në lindjen e indekseve, duke i grumbulluar në një "shportë" aksionet më të vlerësuara dhe të konsoliduara në treg dhe ato aksione të reja të cilat paraqesin një perspektivë zhvillimi dhe ofrimin e tyre investitorëve.
Pesha e aksioneve varet nga vlera e tyre dhe "pesha" e tyre reale në treg që çon në mbizotërimin e aksioneve kryesore ndërkombëtare ato më të njohurat dhe duke lënë disi në hije ato aksione të cilët nuk janë shumë të njohura por që mund të paraqesin një zhvillim të lartë në të ardhmen.
Indekset mund të jenë në forma të ndryshme dhe bazuar në klasifikimin me bazë kufinjtë ato mund t'i ndajmë në indekse kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.
Ato i ndihmojnë shumë investitorët duke ulur kostot dhe ndihmuar në diversifikimin e portofolit pa patur nevojë në kryerjen e investimeve individuale në secilin aksion.

Referenca

Prof. Ass. Dr. Elez Osmani, Ristani R., Tregjet dhe Institucionet Financiare Shtypshkronja Rozafat, Botimi i dyte, 2013
www.about.com
www.allbusiness.com
www.investinganswers.com
www.investopedia.com

[231] http://www.investinganswers.com/financial-dictionary/stock-market/sp-global-equity-index-series-2984
[232] http://www.investopedia.com/terms/s/sbwei.asp

DR. YLLKA RUPA, DR. SANDER BOCI – ASPEKTE TË RREGULLIMIT TË SKEMËS SË PËRFITIMEVE SIPAS LIGJIT TË RI TË SIGURIMEVE SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Dr. Yllka RUPA
Dr. Sander BOCI

Fakulteti Juridik, Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi"

Abstrakti

Reformat në kuadrin ligjor të mbrojtjes dhe të shërbimeve sociale kanë synuar gjithnjë të rrisin mirëqenien e qytetarëve. Një aspekt krejtësisht i veçantë dhe me ndikim të drejtpërdrejtë te qytetari është sigurimi shoqëror dhe përfitimet që kontribuuesi merr nga pagesat që shoqërojnë të gjithë periudhën e punësimit të tij. Ndër vite skema e sigurimit shoqëror ka pësuar ndryshime, të cilat jo gjithmonë kanë pasur në vëmendje përfituesit, por janë përqendruar kryesisht në rritjen e performancës dhe qëndrueshmërisë së skemës së përfitimeve. Së fundmi reformimi i skemës së sigurimeve shoqërore është projektuar duke pasur në vëmendje kryesisht rritjen e pensionit për subjektet përfituese dhe mbulimin me të ardhura të të gjithë të moshuarve pavarësisht periudhave të sigurimit. Ky shkrim vë në dukje të gjitha risitë e sjella në skemën e re të pensioneve dhe modalitetet e llogaritjes dhe vlerësimit të tyre në raport me backgraundin kontributiv të subjektit të siguruar.

.....

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore është një nga institucionet bazë të politikës sociale që synon mbështetjen me të ardhura apo shërbime sociale. Për këtë, nevoja e zhvillimit të sistemit të mbrojtjes shoqërore dhe rimodelimi i skemave të sigurimit shoqëror me qëllim përshtatjen e tij me kërkesat në rritje të shoqërisë u pa i domosdoshëm. I ndërtuar mbi bazën e një filozofie të kontribuimit solidar të brezave, i tërë sistemi i sigurimeve shoqërore bazohet mbi marrëdhënien e ndërtuar mes shtetit dhe individit, ku shteti synon të konsolidojë politikat e mbrojtjes sociale në shërbimet e individit dhe ky i fundit të rrisë në këtë mënyrë besueshmërinë në skemat e mbrojtjes sociale. Reformat në fushën e sigurimeve shoqërore pas viteve 90 kanë rezultuar disi tranzitore, në kuptimin që ato nuk sollën një stabilizim të plotë të sistemit dhe modelim të tij sipas parametrave evropianë. Numri i vogël i personave të punësuar, kjo si rezultat i nivelit të lartë të papunësisë, si dhe mungesa e konsiderueshme e fondeve sociale çuan në dobësimin e skemës, kryesisht asaj të pensioneve dhe rritjen në nivele mjaft të ulëta të pensioneve të të gjitha kategorive. Konceptimi i një reforme të gjerë në fushën e sigurimeve shoqërore u pa si shumë dimensional dhe i fokusuar jo vetëm në ndërhyrjen e sistemit të përllogaritjes së përfitimeve me koeficientë të tjerë, por edhe në një shtrirje gjithëpërfshirëse të përfitimeve për kategoritë e subjekteve përfituese. Rimodelimi i skemës së sigurimeve shoqërore bëhet në një stad kur angazhimet e politikave sociale janë të drejtuara në nivele bashkëpunimi me shtete të fuqishme, nga pikëpamja e ndërtimit të skemave të mbrojtjes shoqërore me të cilët vendi ynë ka negociuar për njohjen e periudhave kontribuitive të shtetasve shqiptarë që punojnë atje. Qëllimi kryesor ishte krijimi i një skeme, e cila mund të mbajë veten me financime pa pasur nevojë për ndërhyrjen domosdoshmërisht të fondeve sociale dhe duke ulur sa të jetë e mundur barrën mbi Buxhetin e Shtetit, i cili vitet e fundit ka financuar në mënyrë të konsiderueshme fondin e pensioneve. Synimi drejt një skeme të pavarur dhe autonome nga pikëpamja e të ardhurave u shoqërua me ndërhyrjen në ligjin për sigurimet shoqërore, në ato dispozita që përcaktojnë mënyrën e kalimit të përfitimeve, përllogaritjen e tyre dhe shtrirjen te subjektet përfituese. Kështu pjesë e sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore krahas sigurimit shoqëror të detyrueshëm, vullnetar, suplementar, për pensionet shtetërore të posaçme, bëhet edhe sigurimi për pensionet sociale, një përcaktim krejtësisht i ri, që shikohet si një mbrojtje që vetë skema merr përsipër t'u japë personave që kanë moshën për përfitimin e një pensioni, por nuk kanë periudhat e sigurimit. Shkohet kështu drejt një rikonceptimi të mbështetjes me të ardhura që nuk bëhet vetëm për subjektet që kanë paguar kontributet, por drejt një solidarizimi që del

përtej parimit të universialitetit që mbulon vetëm personat kontribuues. Kështu ka të drejtën e përfitimit të pensionit social çdo shtetas shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, ka një qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për 5 vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura që përfiton nga ndonjë burim tjetër, ose të ardhurat që përfiton janë më të ulëta se të ardhurat që përfitohen nga pensioni social233. Me këtë përcaktim që bën ligji shihet qartë përqasja e sistemit drejt tre kolonave. Së pari "kolona 0" që i referohet mungesës tërësisht të periudhave të sigurimit dhe në të bëhet përfshirja e të gjithë të moshuarve pavarësisht nëse ata kontribuojnë ose jo Kjo është praktikë e shteteve të zhvilluara, të cilët kanë hartuar politika të mira sociale dhe gjithëpërfshirëse. Në disa prej këtyre vendeve si Belgjika, Suedia e Danimarka kjo skemë aplikohet për të gjithë të moshuarit mbi një moshë të caktuar (këtë përcaktim bën edhe ligji shqiptar), ndërsa disa të tjerë e aplikojnë pensionin social vetëm për të moshuarit e varfër që nuk kanë asnjë mjet për mbajtjen e vetes. Synimi i kësaj kolone është të ofrojë një nivel bazë të ardhurash për të gjithë ata të moshuar që nuk kanë vjetërsinë në punë, si kushtin e nevojshëm për përfitimin e një pensioni. Atyre u sigurohet kështu një nivel të ardhurash që u siguron minimumin jetik. Siç vihet re, standardi i parashikuar shkon drejt një konceptimi tepër vizionar duke pasur parasysh kushtet aktuale të vjeljes apo financimit të skemës kontributeve, e cila ka mjaft deficite për faktin e numrit të ulët të personave të siguruar që mbajnë fondin e pensioneve apo shpenzimeve të tjera të përfitimeve. Statistikat që e rendisin Shqipërinë ndër vendet më të prapambetura për sa i përket numrit të kontribuuesve flasin qartë për mosfunksionimin e skemës së vjetër të pensioneve, e cila në fakt mbulonte me të ardhura vetëm kontribuuesit. Mirëpo amendimet në ligjin për sigurimet shoqërore padyshim që duhen parë të lidhura ngushtë me ndërhyrje të tjera në ligje që rregullojnë periudhat e sigurimit të detyrueshëm dhe vendosin rregulla strikte për subjektet punëdhënëse si dhe të ligjit fiskal dhe atij tatimor për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit me eficiensë të administratës tatimore. Politikat e punësimit nga ana tjetër kanë një rëndësi të posaçme, parë në këndvështrimin e rritjes së numrit të të punësuarve, ato kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin dhe konsolidimin e skemës kontributive si burimi bazë i financimit të pensioneve të mira dhe jo vetëm atyre që u akordohen kontribuuesve që mbushin moshën për përfitim por edhe personave që përfshihen në skemën e pensioneve sociale. Ndër të tjera hapja e vendeve të punës dhe rritja e nivelit të pagave ndihmon në uljen e borxhit publik. Sistemi reformues i sigurimeve shoqërore u propozua nga sistemet ndërkombëtare të financimit e në mënyrë të posaçme nga Banka Botërore e cila bëri edhe orientimet përkatëse. Ndërkohë skema e kontributit të detyrueshëm do të administrohet nga skema publike dhe do mbështetet si zakonisht në parimin e solidaritetit mes brezave. Kjo do të garantojë një pension bazë për përfituesit, ndërsa një pjesë tjetër kontributive do të administrohet nga operatorë të licencuar nga organet e shtetit në forma financimi me qëllim rritjet e të ardhurave në fondin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore. Si rezultat i këtyre parashikimeve do të bëhet i mundur ndërtimi i një skeme funksionale që prodhon pensione të mira dhe me standarde bashkëkohore. Pay as you go parashikon administrimin e vazhdueshëm të sigurimeve shoqërore nga skema publike e kjo e bën gjithnjë të besueshëm sistemin, megjithëkëtë kjo nuk është një risi e ndryshimeve të bëra në sistem, pasi kjo mënyrë e administrimit është parashikuar gjithmonë. Risia konsiston në aplikimin e saj paralel me përcaktimet apo kolonat që u përfolën me lart, përfshirë këtu edhe operatorët privat që parashikon ligji për të bërë të mundur investime prej tyre në ato zëra sigurimi që u mundësojnë përfituesve shtesa mbi pensionin në raport me kontributet që kanë likuiduar në institucionet private të pensioneve.

Ndryshimet në ligj konsistojnë në disa përcaktime të reja lidhur me ndryshimin e koeficienteve të përllogaritjes së pensioneve si dhe heqjen e kategorive të veçanta të përfitimit, të parashikuara këto me ligjin e mëparshëm. Kështu personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie kur arrijnë moshën e përcaktuar sipas ligjit, pensioni do të llogaritet sipas periudhave kontributive. Ndryshimet e reja në ligj nuk parashikojnë më pensionin e pjesshëm të pleqërisë, por ndryshojnë disa përcaktime për pensionin e reduktuar lidhur me koeficientin e reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë në 0.6 % në muaj. Pension të reduktuar kanë të drejtë të marrin të gjithë ata persona që plotësojnë periudhën e plotë të sigurimit të nevojshëm për pensionin e plotë të pleqërisë, por nuk kanë mbushur moshën e kërkuar nga ligji, kështu ligji iu

[233] Ligji nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Nenet 1, 5/1

mundëson atyre të drejtën e përfitimit 3 vjet përpara mbushjes së moshës. Ky aplikim bëhet vetëm për subjektet që nuk ushtrojnë aktivitete private si të punësuar apo të vetëpunësuar, pra nuk sigurojnë të ardhura nga ndonjë veprimtari ekonomike. Në vazhdimësi, pensioni i pleqërisë do të llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar nga ligji, duke aplikuar edhe shtesat që do të jenë 1% për çdo vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat kanë arritur nëpërmjet kontributeve.234 Reformimi i pensioneve ka hequr pensionin tavan dhe bën të mundur një lidhje më organike mes kontributeve dhe përfitimeve. Kështu në sistemin kontributiv duhet ndërhyrë me mjete efikase për të bërë të mundur rritjen e kontributeve duke i nxitur subjektet e marrëdhënies së punësimit të bëjnë deklarime të sakta të pagave reale dhe të jenë pjesë e skemës kontributive me besimin se kontributet e derdhura do t'ju kthehen në masë të plotë në momentin kur iu lind e drejta e përfitimit. Krijimi i një besimi në transparencë të skemës së sigurimeve shoqërore padyshim që rrit numrin e kontribuuesve duke rritur në këtë mënyrë edhe të ardhurat në buxhet. Ndryshimet e reja në ligj prekin edhe moshën e daljes në pension duke e rritur atë si për burrat ashtu edhe për gratë. Rritja e moshës së daljes në pension është parashikuar në mënyrë progresive duke u kujdesur që të mos prekë ata persona që janë në prag të daljes në pension. Rritja e moshës së daljes në pension është ndryshuar duke u mbështetur edhe në faktorë të tjerë social, siç është për shembull rritja e jetëgjatësisë, por në të njëjtën kohë edhe mosha jo e re e nënshkrimit për herë të parë të një kontrate të ligjshme pune. Ndër të tjera deri tani për gruan përfituese është zbatuar diskriminimi pozitiv sa i takon moshës së daljes në pension, njohjes si periudhë e kontributeve të studimeve të larta, por edhe trajtimi në disa aspekte të rëndësishme të marrëdhënies së punës dhe vendit të punës. Rritja e moshës për pension prek gjithashtu gratë përfituese te të cilat do të zbatohet rritja progresive e moshës së daljes në pension deri në një barazim të plotë me burrin dhe njëkohësisht me këtë rritje do ketë barazim edhe të periudhave të sigurimit për të dyja këto kategori. Për herë të parë në Shqipëri aplikohet një trajtim i barabartë për sa i përket kushteve të përfitimit për efekt të pensionit të pleqërisë si për burrin ashtu edhe për gruan. Disa janë faktorët që çuan në një trajtim të barabartë për të dyja kategoritë, ndër të cilët sidomos rritja e jetëgjatësisë për përfitueset femra.

2. Ndryshimet në ligj prekin edhe sigurimet afatshkurtra. Pagesa për përfitimet afatshkurtra do të bëhet nga skema e sigurimit të detyrueshëm. Në rastet e paaftësisë së përkohshme në punë për shkak të sëmundjeve dhe barrëlindjes pagesat do të realizohen përmes fondit të kontributeve mbi bazën e përllogaritjeve të reja. E ardhura për sëmundje përfitohet nga personi i siguruar kur vërtetohet me raport mjekësor se ai është përkohësisht i aftë për punë. Paaftësia e përkohshme në punë nënkupton një pezullim të përkohshëm për punë të shtetasit, si rezultat i humbjes së aftësisë për shkaqe të ndryshme që zakonisht lidhen me sëmundje të ndryshme apo me aksidente në punë dhe që është i përkohshëm. Gjendja e paaftësisë nuk cenon kontratën e punës për të siguruarin, i cili ka një garanci të dyfishtë për sa i përket dispozitave mbrojtëse. Kodi i punës mbron punëmarrësin gjatë periudhës së paaftësisë së përkohshme duke i garantuar atij ruajtjen e pozicionit të punës dhe në të njëjtën kohë mbulimin me të ardhura për shkak të gjendjes së paaftësisë. Mbrojtja që ligji për sigurimet shoqërore i bën shtetasit ka të bëjë me dispozita që përcaktojnë, kushtet e lindjes së të drejtës, humbjen e të ardhurave, kushtet e përfitimit, koeficientet e llogaritjes së bazës së vlerësuar dhe shtrirja e të drejtës së pretendimit për përfitim.235 Të ardhurat që përfitohen si rezultat i gjendjes së paaftësisë, ligji i klasifikon si të ardhura për sëmundje, e ardhura për barrëlindje, e ardhura për kompensim të vendit të punës për gruan shtatzënë kur ndryshon vendin e punës, si dhe e ardhura për kompensim kur ndryshon vendin e punës për shtetasin që është në gjendje të përkohshme paaftësie.

a. Të ardhurat për sëmundje janë 70% e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës. Ligji nuk përcakton se cili quhet momenti i lindjes së të drejtës, por përmes akteve të tjera nënligjore është [pranuar së do të konsiderohet moment i lindjes së të drejtës pikërisht ai i fillimit të raportës së paaftësisë i vlerësuar nga mjeku kompetent ose nga komisioni mjeko-ligjor që vlerëson paaftësinë në punë si dhe periudhën e ekzistencës së paaftësisë. Lidhur me përqindjet e përllogaritjes së të ardhurave, në ndryshim me përcaktimet e ligjit të mëparshëm, bëhet ndarja në dy kategori të personave përfitues përkatësisht duke u mbështetur në periudhat e sigurimit ose në vjetërsinë në punë të tyre. Për shtetasit që kanë deri në 10 vite punë, e

[234] Ligji nr. 104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Nenet 31,32.

[235] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë

ardhura për sëmundje është 70 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto për gjashtë muajt e fundit nga data e lindjes së të drejtës, ndërsa për shtetasit që kanë mbi 10 vjet punë, e ardhura për sëmundje është 80% e mesatares ditore për këtë periudhë.236 Ligji bën një rregullim të ri edhe për periudhën kur përfituesi është i shtruar në spital. Kur përfituesi është i shtruar në spital dhe nuk ka njeri në ngarkim, të ardhurat për sëmundje janë 50% e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës. Të ardhurat që do të përfitohen për kompensim të vendit të punës kanë ndryshuar për sa i përket përqindjeve të përllogaritjes së tyre. E ardhura është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshëm dhe pagës së vendit të ri të punës. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50% e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës. Siç vihet re, në përcaktimin e koeficienteve llogaritës të përfitimit ka një ulje të ndjeshme krahasuar me ligjin e vjetër, kjo në varësi të kategorive përfituese, bëhet kujdes në shpërndarjen e përfitimit edhe për shtetasit që kanë nevojë për përkujdesje në ambientet spitalore. Ligji nuk bën përcaktime si çfarë do të konsiderohet paaftësi e përkohshme në punë duke e lënë këtë në kompetencën e organeve përkatëse. Shenjat dalluese të paaftësisë së përkohshme në punë janë: Qenia i sëmurë apo i dëmtuar, kufizimi i përkohshëm i aftësisë për punë, që e pengon shtetasin të kryejë aktivitetin e tij të zakonshëm të prodhimit, varësia ndërmjet shkakut, sëmundjes apo dëmtimit dhe pasojës së kufizimit të aftësisë për të punuar.237 Njohja e dy kushteve të lartpërmendura dhe shkakut të tyre në varësi me organet përkatëse.238 Pjesëmarrja në sistemin e sigurimit shëndetësor përkatës është një kusht tjetër i rëndësishëm për sigurimin e shtetasit për sëmundje. Humbja e të ardhurave për shkak të paaftësisë është një gjendje e cila kërkon një mbrojtje të posaçme nga ligji sepse me këtë garantohet me kompensim për të ardhurat e humbura shtetasi i cili është bërë pjesë e një sistemi të detyrueshëm sigurimi. Për këtë edhe sistemet e sigurimit të shëndetit dhe të paaftësisë për shkak të sëmundjeve apo faktorëve të tjerë janë të detyrueshme dhe nuk lënë gjë në përcaktim të vullnetit të përfituesve. Duke qenë të tilla, shteti përcakton edhe modalitetet e kushteve të përfitimit, kur ndodh fakti ose gjendja për shkak të së cilës përfiton nga skema. Duke qenë kështu reformat në sistemin e sigurimeve shoqërore gjithnjë shoqërohen me kundërshti të grupeve të interesit, të cilët janë të ndjeshëm sidomos kur këto ndryshime prekin kushtet e përfitimit.239 Kusht bazë për përfitimin nga paaftësia e përkohshme është qenia në marrëdhënie pune, kështu mbi pagën e llogaritur mbi të ardhurat neto, gjithnjë duke pasur në konsideratë gjashtëmujorëshin për të cilin është likuiduar kontributi. Periudha e paaftësisë së përkohshme krahas mbrojtjes së vendit të punës konsiderohet edhe periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të të ardhurave të tjera që rrjedhin nga ligji për sigurimet shoqërore. Kriteret e kohëzgjatjes së paaftësisë së përkohshme nuk janë përcaktuar në ligj por trajtohen në referencë të akteve të tjera. E ardhura ditore mesatare bazë e përdorur në përcaktimin e përfitimit për shkak të sigurimit për sëmundje, përdoret edhe për të gjitha rastet e tjera të sigurimit dhe të përfitimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. E ardhura mesatare e përdorur për llogaritjen e përfitimit përdoret ajo e cila është e pranishme apo e vlerësuar në momentin e lindjes së të drejtës, ajo vazhdon deri në përfundimin e gjendjes së paaftësisë edhe nëse kemi një kalim nga një lloj përfitimi në tjetrin. Përjashtimisht në rastet e kalimit në përfitimin e pensionit të invaliditetit llogaritjet bëhen sipas bazës së vlerësueshme të atyre periudhave sigurimi për të cilat bën fjalë skema e përgjithshme e caktimit dhe e llogaritjes së pensioneve të pleqërisë. Kjo në rastet kur kemi të bëjmë me invaliditet të përhershëm.

E ardhura për barrëlindje.

Sigurimi i grave gjatë shtatzënisë dhe nënave pas lindjes së fëmijës rregullohet me ligj. Dispozitat e reja flasin për kushtet e përfitimit të lejes së lindjes, kriteret e dhënies së saj si dhe subjektet përfituese. Shqipëria hyn në ato shtete të cilat e lidhin ngushtë periudhën e përfitimit për efekt të shtatzënisë me sigurimin e detyrueshëm. Mënyra e trajtimit me të ardhura për gratë shtatzëna për periudhën para dhe pas lindjes ndryshon nga një vend në tjetrin. Ka disa shtete me politika sociale të

[237]Prof. Igor Tomas "E drejta e sigurimit social" Tiranë 1997

[238]Kushtet këtu janë dy: a) të qenit i sëmurë, dhe b) i paaftë për punë, ndërkohë që lidhja mes gjendjes dhe shkakut dhe pasojës vërtetohet nga organi përkatës (mjeku). Igor Tomas

[239]Grupe interesi konsiderohen kryesisht grupimet sindikale të punëmarrësve që mbrojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga marrëdhënia juridike e punësimit.

zhvilluara që nuk vënë si kriter periudhën e sigurimit por e lidhin përfitimin me vendbanimin e gruas për një periudhë të caktuar që në shumë raste është minimale. Disa të tjerë nuk kanë kritere dalluese mes burrit dhe gruas dhe e akordojnë përfitimin të njërit prej bashkëshortëve. Disa shtete kanë një rregullim të posaçëm për situatat kur gruaja humb jetën gjatë lindjes së fëmijës dhe bëjnë në këtë rast kalimin e përfitimit te prindi babë. Vendet që bëjnë një rregullim shumë të mirë të periudhës së përfitimit për nënat para dhe pas lindjes së fëmijës janë ato Skandinave. Këto vende nuk e lidhin domosdoshmërisht periudhën e përfitimit me ekzistencën e një kontrate pune përmes të cilës gruaja të ketë likuiduar kontributet, ashtu sikurse nuk e kufizojnë përfitimin vetëm tek nëna. Ndryshimet e fundit në ligjin Shqiptar nuk mund të quhen reformuese në kuptimin e vendosjes së vlerave të përfitimit dhe as në trajtimin njësoj të subjekteve përfituese (bashkëshortëve). Kështu Shqipëria hyn në kategorinë e shteteve që e lidhin përfitimin domosdoshmërisht me periudhat kontributive. Kusht i domosdoshëm është që gruaja të jetë e siguruar për çdo rast përfitimi. Për çdo rast përfitimi ajo duhet të ketë 12 muaj sigurim shoqëror. I vetmi përjashtim nga rregulli për periudhat e sigurimit është rasti kur e drejta e pagesës për barrëlindjen e radhës ndodh Brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm. Ky është një rregullim i ri në ndryshim nga ligji i vjetër të cilit i mjaftonte vetëm sigurimi prej 12 muajsh pavarësisht se gruaja mund të kishte përfituar njëherë raportin e barrëlindjes mbi bazën e këtij sigurimi. Ky përcaktim lë të zbuluar shumë kategori përfituese të cilat nuk kanë mundësi sigurimi për shkak të mungesës së vendeve të punës, ose ato përfituese që mund të kenë vite pune por në kohë më të largët se periudha e lindjes së të drejtës për përfitim e në këto kushte mbeten të pazbuluara. Ajo që bie në sy është zgjatja e periudhës së detyrueshme duke përfshirë një minimum të detyrueshëm 35 ditë përpara dhe 63 ditë pas lindjes së të drejtës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditë para dhe 63 ditë pas lindjes së fëmijëve.240 Lidhur me përllogaritjen e vlerës së përfitimit mund të themi se ligji Shqiptar është modeluar sipas legjislacionit të vendeve ku përfitimi për barrëlindje jepet si përqindje e caktuar e të ardhurave të realizuara nga nëna deri në momentin e marrjes së lejes së lindjes. Ndërhyrjet në dispozitat që mbrojnë gruan shtatzënë para dhe pas lindjes së fëmijës nuk sjellin ndonjë risi sidomos me rregullimin e disa situatave në të cilat mund të gjendet gruaja gjatë procesit të lindjes së fëmijës si dhe rritjes së tij. Në Evropë ka filluar të përdoret termi "leje prindërore" ose leje për rritjen dhe edukimin e fëmijës, pasi në varësi të rregullimeve ligjore në këtë fushë, në shumë vende kjo leje mund t'i akordohet si nënës, ashtu edhe babait të fëmijës.241 Lejen prindërore e rregullojnë me ligj vende si Italia, Belgjika, Franca, Gjermania etj., është një e drejtë që i njihet gruas në lidhje me kujdesin për fëmijën e lindur, ajo ka të drejtë të marrë me marrëveshje leje të jashtëzakonshme pa i lindur e drejta e zëvendësimit të pagës gjatë saj, pra ka të drejtë për një leje lindje shtesë. Gjithashtu legjislacionet perëndimore i kushtojnë një vëmendje të posaçme ndihmës financiare dhe materiale që u akordohen fëmijëve të sapolindur por edhe prindërve. Po ashtu shtetet e zhvilluara aplikojnë forma të konsoliduara të sigurimit material të nënës dhe fëmijës, madje edhe të krejt familjes me rastin e ardhjes në jetë të një krijese të re. Kuptohet që Ligji Shqiptar është shumë larg këtyre përcaktimeve, kjo për shkak të faktorëve specifik shqiptar të terrenit mbi të cilin ndërtohet sistemi i sigurimeve. Me gjithë pretendimet për një skemë më sociale, për shkak të faktorëve që përmendëm më lart, mund të themi se ndryshimet e bëra me amendime të dispozitave thelbësore mbi të cilat ndërtohet sistemi, sigurojnë ndërtimin e një strukture më solide sigurimi që garanton shtetasit në kthimin e kontributeve të likuiduara gjatë viteve në forma përfitimi të nevojshme në periudhat e plakjes apo pamundësisë për punë si rezultat i ndonjë sëmundje. Kjo garanci vjen si rezultat i ndërhyrjeve në rritjen e moshës së daljes në pension, njehsimin e pagës minimale kontributive me pagën minimale zyrtare dhe indeksimi i pagës maksimale kontributive me rritjen e pagës mesatare, si dhe vendosja e pensionit social për subjektet krejtësisht të pambuluara nga ndonjë skemë sigurimi.

[240] Ligji nr. 104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Neni 27

[241] Prof. Igor Tomas "E drejta e sigurimit social" Tiranë 1997

DR. SENADA REÇI - ASPEKTE TË DISPOZITAVE KOMUNITARE QË RREGULLOJNË USHTRIMIN E PROFESIONIT TË AVOKATIT NË BE DHE EFEKTET E JURISPRUDENCËS SË GJED.

Dr. Senada Reçi
Fakulteti Juridik, Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi"

Abstract

In the European Single Market there are many EU nationals seeking to become active in other Member States as professional architects, doctors, lawyers, etc., but that free movement of the services they provide, does not applies in the spirit of the Treaty or directives in the heterogeneous reality of the national markets of the Union, which present different obstacles in the exercise of various professions, appropriate training, recognition of the qualification or not, depending on its assessment of compliance with the required qualifications for the same occupations to equivalent. A separate discussion on the doctrine and jurisprudence of the ECJ represents the status and recognition of qualifications of professionals lawyers in member states of the EU other than the country of origin of their qualifications. Analysis of sectoral provisions for lawyers in this paper, aims to assess the real situation of implementation evidenced by the jurisprudence of the ECJ, the issues that still demonstrate movement of professionals with national restrictions and obstacles since we are talking about a system of mutual recognition of qualifications.This paper aims to analyze some aspects of the regulation of the profession of lawyer and his practice in the EU Single Market specifically reflecting the impact and evolution of the free movement of lawyers under the influence of the jurisprudence of the European Court of Justice.

Dispozitat për profesionin e avokatit si profesion i rregulluar në mënyrë specifike në BE.

Në Tregun Unik Evropian ka shumë shtetas të BE-së që kërkojnë të aktivizohen në shtete të tjera anëtare si profesionistë arkitektë, mjekë, avokatë etj, por që qarkullimi i lirë, i shërbimeve që ato ofrojnë, nuk zbatohet sipas frymës së Traktatit apo direktivave, në realitetin e tregjeve kombëtare heterogjene të Bashkimit, që paraqesin pengesa të ndryshme në lidhje me ushtrimin e profesioneve të ndryshme, kualifikimit të duhur, njohjes së atij kualifikimi apo jo, në varësi të vlerësimit të përputhjes së tij me kualifikimin e kërkuar vendas për të njëjtat profesione për t'i ekuivalentuar. Një diskutim me vete në doktrinën dhe jurisprudencën e GJED-së përbën statusi dhe njohja e kualifikimeve të profesionistëve avokatë në shtetet anëtare të BE-së të ndryshme nga shteti i origjinës së kualifikimit të tyre. Analiza e dispozitave sektoriale per avokatet në këtë punim ka si qëllim vlerësimin e situatës reale të zbatimit që evidentohet nëpërmjet jurisprudencës së GJED-së, në çështjet që ende demostrojnë lëvizje të profesionistëve me kufizime e pengesa kombëtare duke qënë se flasim për një sistem reciprok njohjeje të kualifikimeve.

Direktiva 77/249 për lirinë e ofrimit të shërbimeve nga avokatët, efektet e zbatimit të saj në BE dhe njohja e profesionit të avokatit
Traktati përcakton vetëm kuadrin e përgjithshëm për lëvizjen e lirë të shërbimeve në shtetet e tjera anëtare dhe nuk rregullon rendin e dispozitës për lloje të ndryshme të shërbimeve". Një mungesë e tillë shihet edhe te lëvizja e lirë e avokatëve në ofrimin e shërbimeve juridike profesionale. Para zbatimit të një direktive të veçantë që të krijonte mundësinë për një avokat për të ofruar shërbime përkohësisht në një shtet tjetër anëtar, vendimet e GJED mbështeteshin në nenin 56 të TFBE që sanksionon lirinë për të ofruar shërbime, veçanërisht në çështjen Van Binsbergen (33/74) Çështja ka të bëjë me një shtetas hollandez që vepronte si këshilltar juridik për Van Binsbergen ne lidhje me procedimet përpara një gjykate hollandeze të sigurimeve shoqërore, dhe zhvendosi vendqëndrimin e tij nga Hollanda në Belgjikë, gjatë zhvillimit të procedurave. Atij iu tha se nuk mund të përfaqësonte

më klientin e tij duke qënë se sipas ligjit hollandez, vetëm personat e vendosur në Hollande mund të vepronin si këshilltarë juridike. Në këtë rast u bë një kërkesë paragjykimore në GJED, për të përcaktuar nëse neni 56 kishte efekt të drejtpërdrejtë dhe rregulli hollandez ishte në përputhje me të242. Sipas pikës 27 të këtij vendimi, paragrafi i parë i nenit 56 të TFBE dhe paragrafit të tretë të nenit 57 të TFBE, kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe për këtë arsye mund të jenë të mbështetur para gjykatave kombëtare, të paktën për aq sa ata kërkojnë për të hequr çdo lloj diskriminimi ndaj një personi që ofron një shërbim për shkak të kombësisë së tij apo për faktin se ai banon në një shtet anëtar tjetër nga ai në të cilën shërbimi ofrohet243.

Profesioni i avokatit përbën një pozicion unik në mesin e profesioneve në Evropë, pasi: së pari, avokatët kanë një funksion të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë dhe në ruajtjen e sundimit të ligjit; së dyti, avokatët luajnë një rol jetik në ekonomitë e Shteteve Anëtare dhe funksionimin e tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian; së treti, profesioni i avokatit është vënë në shënjestër në mënyrë specifike pasi ai është i bazuar në sistemet ligjore kombëtare në të cilën avokatët e ardhshëm kualifikohen dhe ushtrojnë praktikat profesionale. Në përgjithësi, kjo do të thotë se avokatët janë të trajnuar dhe, prandaj, janë ekspertë në sistemet e tyre respektive ligjore, por kjo nuk dmth që domosdoshmërisht të kenë edhe njohuri të sistemeve të tjera ligjore. Kriteret e kualifikimit dhe shtrirjes (ose madje edhe ekzistencës) së aktiviteteve që mund të kryhen vetëm nga juristët ndryshojnë në masë të madhe në mes të Shteteve Anëtare, e kjo përbën një ndërlikim në realizimin e lëvizjes së lirë të avokatëve në Bashkimin Evropian244.
Pikërisht për arsye të këtyre specifikave profesioni ligjor i avokatit në BE rregullohet nga kuadri ligjor i mëposhtëm:
Direktiva 77/249 mbi lehtësimin e ushtrimit nga avokatët të lëvizjes së lirë të shërbimeve
Direktiva 98/5 mbi vendosjen e avokatëve
Direktiva 2005/36 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale

Direktiva e Shërbimeve 77/249

Ajo rregullon ofrimin e shërbimeve nga një avokat i BE/ZEE245 dhe Zvicrës në një shtet tjetër anëtar, përveç atij në të cilin ai fitoi titullin e tij/saj - i njohur si shteti pritës, pa u regjistruar në Dhomën e avokatisë të atij shteti. Direktiva në 9 nenet e saj ka si qëllim të lehtësojë lëvizjen e lirë të avokatëve, por ajo nuk merret me vendosjen e tyre apo me njohjen e kualifikimeve. Ajo parashikon që një avokat duke ofruar shërbime në një shtet tjetër anëtar - si avokat "migrant" - duhet të bëje këtë nën titullin e shtetit të tij/saj të origjinës. Avokatët migrues mund të ndërmarrin aktivitete të përfaqësimit nën të njëjtat kushte si avokatët vendas, përveç kur kërkohet qëndrimi/rezidenca ose kërkesa për të qënë anëtar i Dhomës së Avokatëve të shtetit pritës. Megjithatë, në rastin e avokatëve migrantë që ofrojnë konsulencat ligjore apo mbrojtje të përkohshme para gjykatës mund t'u kërkohet të punojnë në bashkëpunim me një avokat që praktikon përpara autoritetit gjyqësor në fjalë. Për aktivitete të tjera, rregullat e sjelljes profesionale të shtetit të origjinës zbatohen pa paragjykim, për respektimin e rregullave të shtetit pritës, sidomos konfidencialiteti, konfliktet e interesit, marrëdhëniet me avokatët e tjerë dhe veprimtaritë e papajtueshme me profesionin ligjor.
Njohja e profesionit ligjor të avokatit në BE ka hasur në vështirësi që kanë marrë zgjidhje specifike. Për njohjen e titullit të avokatit janë parashikuar dy rrugë: njëra ka të bëjë me ndjekjen e regjimit të përgjithshëm të direktivës 2005/36 qe konsiderohet perqasja horizontale, e dyta ka të bëjë me

[242] Për më tepër shih : Johannes Henricus Maria van Binsbergen v Bestuur van de Bedrijfsverenigingvoor de Metaalnijverheid 33/74, ECR, [1975] kërkesë paragjykimore, në http://eurlex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!CELEXnumdoc&numdoc=61974J0033&lg=en .
[243] BARRERE., Anne-Sophie, Free Movement of Lawyers within the European Union: the Position of Third Country Nationals, në http://www.consulegis.com/wp-content/uploads/2014/10/Free-Movement-of-Lawyers-within-the-European-Union-the-Position-of-Third-Country-Nationals.pdf
[244] Shih: Evaluation of the legal framework for the free movement of lawyers, Executive summary, Mastricht University, Zoetermeer, December 18, 2012, fq.3-5.
[245] ZEE Zona ekonomike evropiane përbëhet nga shtetet anëtare të BE (aktualisht 28) duke përfshirë edhe Islanden, Lihtenshtejnin dhe Norvegjinë, por edhe në Zvicër në bazë të Marrëveshjes Bilaterale me BE mbi lëvizjen e lirë të personave e nënshkruar më 21 qershor 1999. Në lidhje me Zvicrën, me referendum të datës 9 shkurt 2014 shtetasit zviceranë votuan për futjen e kufizimeve sasiore për imigracionin që vijnë nga tregu i vetëm.

zbatimin e direktivës 98/5 për vendosjen e avokatëve në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai në të cilin i është dhënë kualifikimi.
Në lidhje me rrugën e parë duhet t'i referohemi nenit 14 (3) të direktivës që parashikon: "Për profesionet ushtrimi i të cilave kërkon një njohje të saktë të së drejtës kombëtare dhe në të cilat shërbimet dhe konsulenca dhe/ose asistenca në fjalë e së drejtës kombëtare përbën një element thelbësor e të vazhdueshëm të aktivitetit profesional", (duke marrë parasysh formimin për t'u pranuar në profesionin e avokatit), që zgjedhja mes një praktike përshtatjeje ose kalimi i një prove aftësie i lihet në dorë shtetit anëtar pritës, dhe jo të interesuarit246. Si shembull kemi rastin 118/09 Koeller të një shtetasi austriak të diplomuar në Austri, që ka marrë titullin avokat në Spanjë dhe që dëshiron ta njohë titullin në Austri në mënyrë që të ushtrojë profesionin e avokatit atje. Rasti Gebhard (55/94) ku Gebhard ishte një shtetas gjerman ndaj të cilit kishte procedime disiplinore nga Dhoma e Avokatisë së Milanos për ndjekjen e aktivitetit professional si avokat në Itali në baza të përhershme.dhe kishte krijuar/hapur dhomat e tij të avokatisë nën titullin avvocato, megjithëse nuk ishte pranuar si tillë nga Dhoma e Avokatisë së Milanos dhe megjithëse trajnimi, kualifikimet dhe eksperienca e tij nuk ishin njohur formalisht në Itali, përcaktoi dallimin në mes ofrimit të shërbimeve dhe vendosjes së avokatit sipas titullit të tij të origjinës/: "natyra e përkohshme e aktiviteteve në fjalë duhet të përcaktohet në dritëm, jo vetëm të kohëzgjatjes së ofrimit të shërbimit, por edhe rregullsisë së saj, periodicitetit apo vazhdimësisë247".

Ndërsa rruga e dytë e njohjes është sipas direktivës mbi vendosjen e avokatëve që do analizohet në vijim.

Në fakt po te flasim për praktikën në përgjithësi, nevojat për shërbimet ndërkufitare ligjore janë rritur që nga futja e Direktivave të avokatëve, për shkak të globalizimit, integrimit të tregjeve, migrimit të familjes, martesave ndërkufitare, tregtisë ndërkufitare dhe lëvizshmërisë dhe lehtësisë së ofrimit ndërkufitar të shërbimeve në një distancë nga përdorimi i teknologjisë, etj, dhe shumica e qytetarëve individualë dhe bizneset e vogla preferojnë një avokat që flet gjuhën e tyre, duke ndikuar kështu në rritjen e gamës së shërbimeve të ofruara nga juristët, por në disa vende të reja anëtare aftësia e avokatëve kompetente në çeshtjet ndërkufitare duket të jetë e pamjaftueshme, pjesërisht për shkak të faktit se arsimimi i tyre nuk fokusohet tradicionalisht në të drejtën krahasuese dhe evropiane. Studimet e një sondazhi të fundit të Universitetit të Mastrihtit përsa i përket tregut të shërbimeve ndërkufitare të përkohshme të avokateve, tregojnë se gjysma e avokatëve të cilat kanë ofruar shërbime të përkohshme nuk kanë hasur në ndonjë vështirësi që lidhen me praktikën e profesionit, por vështirësitë që hasen më së shpeshti nga të tjerët janë mungesa e ekspertizës profesionale në ligjin e një shteti tjetër anëtar dhe vështirësitë që lidhen me gjuhën. Rreth një në çdo dhjetë avokatë ka hasur vështirësi që lidhen me deontologjinë248 dhe mungesën e të kuptuarit dhe pranimit nga ana e profesionistëve të tjerë, të tilla si gjykatësit dhe avokatët vendorë, e për shkak të zhvillimeve në rregulloret e zbatueshme kombëtare të avokatëve në shtete të ndryshme anëtare, dallimet midis rregulloreve dhe vështirësitë që lidhen me deontologjinë, janë rritur dyfish. Ekzistojnë tri lloje të problemeve që lidhen me deontologjinë e dyfishtë:

- nuk është gjithmonë e qartë se cilat rregullore zbatohen, duke rezultuar në paqartësi ligjore, rreziqe dhe kostot shtesë për avokatët në përcaktimin se çfarë rregullore zbatohen;
- ka dallime në deontologjinë ndërmjet shteteve anëtare që rezultojnë në disavantazhe konkurruese për avokatët që punojnë në një nivel ndërkufitar;

[246] Free movement of lawyers në http://international.lawsociety.org.uk/eu/practise ; Daniele.L., Diritto del Mercato Unico Europeo, seconda edizione, Giuffre Editore 2012, fq.212-213; Council Directive 77/249/EEC of 22 March 1977 to facilitate the effective exercise by lawyers of freedom to provide services ne http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31977L0249:EN:HTML .

[247] Për më tepër shih: BARRERE., Anne-Sophie, Free Movement of Lawyers within the European Union: the Position of Third Country Nationals, fq.11, në http://www.consulegis.com/wp-content/uploads/2014/10/Free-Movement-of-Lawyers-within-the-European-Union-the-Position-of-Third-Country-Nationals.pdf dhe Craig.P.,De Burca.G.,EU law text cases and materials, fifth edition, Oxford University Press 2011, fq.774-775.

[248] Kjo do të thotë se dy rregulla sjelljeje janë të zbatueshme për avokatet që ofrojne shërbime në një shtet tjetër anëtar: ato të përcaktuara nga shteti pritës dhe ato të përcaktuara nga Shtet Anëtar I origjinës .

- në disa raste është e pamundur që të pajtohesh me deontologjinë e dyfishtë, sepse rregullat janë kontradiktore249.

Kjo tregon se vështirësitë me këtë përballje janë për klientët nga njëra anë dhe për avokatët nga ana tjetër, të cilët për arsye të probleme të sapo analizuara mund të hezitojnë në ofrimin e shërbimeve ndërkufitare të avokatisë, duke mos realizuar kështu integrimin e tyre nderkufitar ne ushtrimin e profesionit te lirë. Prandaj mund të thuhet me saktësi se parashikimi në direktiva i lëvizjes së lirë të shërbimeve të avokatëve nuk është absolut, por në varësi të mundësive të ushtrimit të profesionit në sisteme të ndryshme që pasqyrojnë realitete të ndryshme të pershtatjes për ushtrimin e një profesioni delikat siç është ai i avokatisë.

Direktiva 98/5 për vendosjen e avokatëve dhe efektet në zbatimin komunitar.

Në vitin 1998 u miratua Direktiva 98/5 e Këshillit Evropian mbi të drejtën e vendosjes për avokatët të cilët kanë marrë kualifikime profesionale në shtetin anëtar të origjinës dhe dëshirojnë të praktikojnë profesionin e tyre mbi një bazë të përhershme në një shtet tjetër anëtar.
Direktiva vlen edhe për avokatët e punësuar dhe të vetëpunësuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe tiparet kryesore të kësaj Direktive janë:
- Avokatët e vendosur në një shtet tjetër anëtar duhet të përdorin titullin profesional qe kanë marrë në shtetin anëtar të origjinës. Ky kufizim u gjykua i nevojshëm në mënyrë që të shmangte konfuzionin midis vendeve anëtare për kualifikimin sipas shtetit anëtar të avokatëve dhe kualifikimin e kërkuar në shtetin anëtar pritës.Titulli profesional duhet të shprehet në gjuhën zyrtare të shtetit anëtar të origjinës.
- Avokatët të cilët dëshirojnë të vendosen në një shtet tjetër anëtar duhet të regjistrohen tek autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës.
- Ata mund të japin këshilla ligjore në të dy ligjet e shtetit anëtar të origjinës dhe shtetit anëtar pritës, si dhe së drejtës së BE-së dhe të drejtës ndërkombëtare. Nëse një shtet anëtar pritës rezervon aktivitete, të tilla si, administrimi i pronave apo krijimi dhe transferimi i interesave të tokës për kategori të caktuara të avokatëve, dhe në shtete të tjera anëtare këto aktivitete nuk kryhen nga avokatët, një shtet anëtar pritës është i lejuar për të përjashtuar ushtrimin e profesionit të avokatit sipas një titulli profesional të marrë në shtetin e origjinës për kryerjen e këtyre aktiviteteve. Ky kufizim shpjegohet dhe nga fakti se Direktiva nuk ndikon noterët të cilët, në shumë vende të BE-së, kanë të drejta ekskluzive në këto dy fusha. Më tej, Direktiva u kërkon avokatëve për t'u shoqëruar në gjykatë nga një avokat lokal në situata ku vetëm një avokat mund të paraqitet para gjykatës në fjalë.
- Për avokatët që praktikojnë profesionin në një shtet anëtar pritës zbatohen rregullat e sjelljes personale dhe rregullat e mirësjelljes të shtetit anëtar të origjinës dhe të atij shteti anëtar pritës.
- Autoritetet kompetente të një shteti anëtar pritës kanë të drejtë të sjellin procedimet disiplinore ndaj avokatëve nga një shtet tjetër anëtar i regjistruar në shtetin anëtar pritës të cilët nuk kanë përmbushur standardet profesionale që kërkohen nga ky shtet anëtar nën të njëjtat kushte që zbatohen për avokatët e kualifikuar në shtetin anëtar pritës.
- Direktiva ka rishikuar gjithashtu në thelb, kushtet sipas të cilave avokatët nga një shtet anëtar mund të kualifikohen si avokatë në një shtet tjetër anëtar pritës. Ka dy mënyra të ndryshme:
1- Së pari, në qoftë se ata në mënyrë efektive dhe rregullisht ndjekin praktikën e tyre në ligjin e shtetit anëtar pritës për tre vjet;
2- Edhe në qoftë se ata praktikojnë të drejtën e shtetit anëtar të origjinës apo të drejtën e BE-së apo të drejtën ndërkombëtare, ato mund të marrin kualifikimin në shtetin anëtar pritës me kusht që të kryejnë aktivitetet e tyre profesionale në atë shtet për tre vjet dhe të kënaqin autoritetet e shtetit anëtar pritës të kompetencës së tyre në lidhje me të drejtën e atij shteti anëtar.
- Një avokat i regjistruar në një shtet anëtar pritës sipas titullit profesional të shtetit të origjinës, mund të praktikojë profesionin si avokat me pagesë tek një avokat tjetër, ose firmë, shoqëri, ndërmarrje publike ose private me qëllim që shteti anëtar pritës të lejojë avokatët të regjistrohen sipas titullit profesional të fituar në atë shtet

[249] Shih: Evaluation of the legal framework for the free movement of lawyers, Executive summary, Mastricht University, Zoetermeer, December 18, 2012, fq.6-7.

Direktiva përbën një harmonizim të plotë të kushteve për ushtrimin e të drejtës së vendosjes për avokatët. Rrjedhimisht, një shteti anëtar nuk i lejohet të vendosë kushte të mëtejshme në zonën e mbuluar nga Direktiva, dhe kjo është deklaruar qartë në rastin 506/04 Graham J. Wilson v ordre des Avocats du BARREAU de Luxembourg, ku avokatët nga shtete të tjera anëtare përveç Luksemburgut duhet të kalonin një test gjuhësor si një parakusht i regjistrimit. GJED-ja ka qenë shumë e qartë në këtë pikë dhe ka deklaruar se kushti i vetëm për regjistrimin është prezantimi nga aplikuesi ndaj autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës e një çertifikatë që vërteton për regjistrimin të autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës. Po këtu Gjykata, sqaroi më tej se organi i apelit kundër vendimeve që refuzojnë regjistrimin duhet të konsiderohet si një gjykatë, brenda kuptimit të nenit 267 TFBE (ish-neni 234 TKE). Natyrisht, Luksemburgu ishte shumë i pakënaqur me Direktivën dhe e sfidoi ligjshmërinë e saj në rastin 193/05 Luxembourg v Commission, ku u konstatua nga GJED shkelja e së drejtës së BE-së duke imponuar, në kundërshtim me dispozitat e direktivës mbi vendosjen e avokatëve, kërkesat e mëposhtme për avokatët nga shtetet e tjera anëtare që dëshirojnë të praktikojnë në Luksemburg:
- kërkesat në lidhje me njohuritë e gjuhës;
- ndalimin për të qenë një person i autorizuar që të pranojë shërbimin në emër të shoqërive;
- dhe detyrimin për të prodhuar çdo vit një çertifikatë që vërteton regjistrimin tek autoritetet kompetente në shtetin anëtar të origjinës250.

Pra direktiva mbi vendosjen e avokatëve shohim se ka si qëllim lehtësimin e ushtrimit të profesionit të avokatit në një shtet tjetër anëtar nga shteti në të cilin ai ka marrë kualifikimin profesional duke i lejuar atij:
- ushtrimin e profesionit me titull të përkohshëm për një afat maksimal prej 5 vitesh;
- përdorimin e titullit të shprehur në gjuhën apo njërën nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar të origjinës;

Direktiva 2005/36 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale

Pas 3 vitesh të provës së ushtrimit të një aktiviteti profesional efektiv e të vazhdueshëm në lidhje me të drejtën e shtetit anëtar pritës profesionisti i lirë fiton të drejtën të ushtrojë në shtetin anëtar pritës përfundimisht dhe me titullin e atij shteti pritës. Aspekti i rëndësishëm i kësaj rruge është se në këtë rast nuk është e nevojshme të kalohet një provë përshtatjeje siç është parashikuar tek direktiva 2005/36. Në këtë kontekst mund të përmendim çështjen 313/01 Morgenbesser (vendim i vitit 2003) që ka të bëjë me një zonjë titullare e një LLM në drejtësi të lëshuar nga një universitet francez që kërkonte në Këshillin e Urdhrit të avokatëve të Gjenovas (Itali) të regjistrohej në regjistrin e praktikantëve avokatë me qëllim që të pranohej në praktikën e detyrueshme për të dhënë provimin e avokatit. Refuzimi nga ky këshill i ishte bërë me arsyetimin se diploma e saj franceze nuk ishte njohur asnjëherë si ekuivalente me diplomën italiane në drejtësi. GJED-ja, duke konstatuar se aktiviteti i avokatit praktikant nuk përbën një profesion të rregulluar dhe nuk hyn në fushën e zbatimit te asnjë direktive në fushën e njohjes së diplomave, deklaroi se : i takon autoriteti kompetent të verifikojë në përputhje me parimet e sanksionuara nga Gjykata në çështjet Vlassopulou dhe De Bobadilla që si, dhe në çfarë mase, njohuritë e vërtetuara nga diploma e lëshuar nga një shtet anëtar ose kualifikimet dhe eksperienca profesionale e bërë aty, si dhe eksperienca e marrë në shtetin anëtar ku kandidati kërkon të regjistrohet, përmbushin, qoftë edhe pjesërisht, kushtet e kërkuara për pranimin në aktivitetin në fjalë251.

Pra sipas GJED-së është në kundërshtim me të drejtën komunitare, refuzimi i bërë nga autoriteti kombëtar në fjalë, pasi kufizon të drejtën e ushtrimit të profesionit të avokatit bazuar në një argument të papranueshëm të mosnjohjes së një diplome të një shteti anëtar si ekuivalente me një diplome të një shteti tjetër anëtar, kur diçka e tillë nuk parashikohet në asnjë normë komunitare, përkundrazi ndalohet.

[250] Kaczorowska.A.,European Union Law, Second edition published, 2011, by Routledge, fq.735-737.
[251] Daniele.L., Diritto del Mercato Unico Europeo, seconda edizione, Giuffre Editore, 2012, fq.212-213.

Në këtë analizë të direktivës për vendosjen na intereson të dimë edhe ca fakte konkrete për zbatimin e saj në praktikë, pasi ajo qëllim ka harmonizimin e rregullave të saj në të gjithë komunitetin në lidhje me vendosjen e avokatëve dhe studimi i Universitetit te Mastrihtit na tregon se pothuajse një e treta e avokatëve që janë vendosur në një shtet tjetër anëtar, nuk përjetojnë vështirësi që lidhen me ushtrimin e profesionit të avokatit, por vështirësi që lidhen me sigurimin e dëmshpërblimit profesional, vështirësi për shkak të kërkesave të vazhdueshme për të qëndruar të regjistruar në dhomën e avokatisë se vendit të tyre, vështirësi që lidhen me deontologjinë e dyfishtë (dmth.te shtetit anetar te origjines dhe shtetit anetar pritës). Një problem i veçantë është se është e paqartë nëse Direktiva zbatohet për situatat kur një jurist nga një shtet anëtar që ndalohet të bëjë mbrojtje ligjore në vendin e tij të origjinës mund të vendoset si një avokat i brendshëm në një tjetër Shtet Anëtar në të cilin mbrojtja është e lejuar.

Harmonizimi potencialisht mund të ndihmojë në mënyrë të konsiderueshme lëvizjen e lirë të avokatëve duke zvogëluar dallimet në sistemet ligjore të te gjithë shteteve anëtare nga perspektiva e përmbajtjes. Në nivel evropian, ka pasur masa harmonizuese të konkretizuara në një numër zhvillimesh që ndoshta mund të ndikojnë në sistemin e lëvizjes së lirë të avokatëve, përmendim përpjekjet e bëra nga Bashkimi Evropian për të krijuar një urdhër evropian për procedurën e pagesës, direktiven për ndihmë juridike në kontestet ndërkufitare, ndërsa në nivel kombëtar ka qenë një numër i reformave, nga të cilat zhvillimet në lidhje me strukturat e biznesit që janë veçanërisht të rëndësishme për lëvizjen ndërkufitare të avokatëve dhe firmave të ligjit. Direktiva 98/5 përmban një nen mbi praktikën e përbashkët (neni 11) i cili lejon shtetet anëtare të ndalojnë avokatët të praktikojnë profesionin kur janë anëtarë të një grupimi që përfshin anëtarë që nuk janë avokatë. Në fakt në shumicën e shteteve anëtare, menaxhimi dhe pronësia e firmave të ligjit nuk janë të lejuara për jo-avokatët, megjithatë, kohët e fundit një numër i shteteve anëtare kanë lejuar disa forma të jo-avokatëve të përfshihen në firma të ligjit. Në Angli dhe Uells, për shembull, ekziston mundësia, sipas kushteve të caktuara, për një jo-avokat e drejtimit të praktikave multidisiplinare, praktikat që lejohen në një farë mase në Skoci, Itali, Spanjë dhe Danimarkë. Meqë këto lloje të praktikave mbeten ilegale në shumicën e shteteve anëtare dhe shumica e dhomave të avokatisë janë kundër futjes së tyre, studiuesit mendojnë se masat mbrojtëse në Nenin 11 të Direktivës në fjalë janë, në përgjithësi, të përshtatshme, por duhet të sqarohet nëse e drejta e shtetit pritës për të parandaluar një avokat të veprojë në emër të një grupimi, siç thuhet në nenin 11 (5), është në vetvete një e drejtë ose nëse ushtrimi i të drejtës së tillë duhet të përmbushë testin-Gebhard. Opsioni i fundit duhet të jetë në përputhje me nenin 15 të Direktivës së Shërbimeve. Disa shtete anëtare kanë futur rregullore të firmave të ligjit përveç atyre ekzistuese të avokatëve bazuar në rregullat individuale. Në Angli dhe Gjermani disa firma kanë dhënë tituj avokat. Është e paqartë nëse këto firma janë në gjendje të bëjnë përdorimin e Direktivave të avokatëve. Hulumtuesit sugjerojnë për të zgjeruar fushën e Direktivave në mënyrë që firmat e ligjit të mund të përdorin liritë e parashikuara 252. Ne te ardhmen vlen per tu pare se si institucionet komunitare do te kontribuojne ne lehtesimin e levizjes se lire te avokateve si profesioniste te lire qe japin sherbimet e tyre juridike te mbrojtjes pa kufizime te fshehta apo diskriminim por trajtim te barabarte me vendasit ne shtetin anetar te BE ku ata ndodhen apo jane vendosur.

[252] Shih: Evaluation of the legal framework for the free movement of lawyers, Executive summary, Mastricht University, Zoetermeer, December 18, 2012, fq.8.

Bibliografia

Craig, P., De Burca.G., EU law text cases and materials, 5th edition, Oxford University Press 2011.
Evaluation of the legal framework for the free movement of lawyers, Executive summary, Mastricht University, Zoetermeer, December 18, 2012.
Sjoerd Joseph Franciscus, Johannes Claessens, Free Movement of Lawyers in the European Union, 2008, https://atmire.com/dspace-labs3/bitstream/handle/123456789/6737/file14501.pdf?sequence=1
Daniele Luigi., Diritto del Mercato Unico Europeo, seconda edizione, Giuffre Editore 2012, fq.212-213;
Free movement of lawyers, në http://international.lawsociety.org.uk/eu/practise
Johannes Henricus Maria van Binsbergen v Bestuur van de Bedrijfsvereniging voor de Metaalnijverheid 33/74, ECR, [1975] kërkesë paragjykimore, http://eurlex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!CELEXnumdoc&numdoc=61974J0033&lg=en
Council Directive 77/249/EEC of 22 March 1977 to facilitate the effective exercise by lawyers of freedom to provide services ne http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31977L0249:EN:HTML
Directive 98/5/EC of the European Parliament and of the Council of 16 February 1998 to facilitate practice of the profession of lawyer on a permanent basis in a Member State other than that in which the qualification was obtained, http://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/ALL/?uri=CELEX:31998L0005
Kaczorowska.A.,European Union Law, Second edition published, 2011, by Routledge.
Country Nationals http://www.consulegis.com/wp- content/uploads/2014/10/Free-Movement-of-Lawyers-within-the-European-Union-the-Position-of-Third-Country-Nationals.pdf
Directive 2005/36/EC on the recognition of professional qualifications http://ec.europa.eu/growth/single-market/services/qualifications/policy-developments/legislation/index_en.htm

DR. EMIRJETA BEJLERI, MIRELA GERDOCI, MBA – MODELI I BIZNESIT "SHQIPERIA TRIKOT SH.P.K"

DR. EMIRJETA BEJLERI MEMA
MIRELA GERDOCI, MBA

Abstrakt

Për të pasqyruar ndryshimet që janë bërë në industrine e fasoneve zgjodhem per rast studimi një kompani të industrisë fason, siç është "Shqipëria Trikot sh.p.k", në Shkodër, e cila prodhon për "Cotonella Spa" në Itali. Objektivi i këtij studimi është të pasqyrojë sesi ndryshimi i modelit të të bërit biznes për këtë kompani fason, ka ndryshuar zinxhirin e furnizimit, duke e bërë atë gjithnjë e më të integruar dhe duke shtuar vlerë. Gjithashtu zinxhiri i integruar i furnizimit ka shkaktuar ndryshime në një sërë elementesh si: prodhimi, të ardhurat, kapaciteti, furnitorët dhe produktet, por më e rëndësishmja ka ndikuar tek konkurrueshmëria e "Shqiperia Trikot sh.p.k", duke e bërë atë gjithnjë e më vitale për suksesin e "Cotonella S.p.A",duke i dhënë asaj avantazh konkurrues dhe qëndrueshmeri.

Abstract

In order to reflect the changes made in the fasson industry we have chosen as a case study a company in the fasson industry as "Albania Trikot sh.pk" in Shkodra, which produces for the "Cotonella Spa" in Italy. The objective of this study is to reflect that change and progress of the new way of doing business for this company has changed the supply chain drastically, making it more integrated and adding value. Also integrated supply chain has caused changes in a variety of elements, such as production, income, capacity, suppliers and products, but more importantly has influenced competitiveness "of Trikot sh.pk Albania", making it increasingly vital to the success of "Cotonella SpA", giving it a competitive advantage and sustainability.

Hyrje

Ekonomia botërore në ditët e sotme karakterizohet nga një konkurrencë e egër globale. Për të patur sukses në tregjet konkurruese që përbëjnë ekonominë e sotme, kompanitë duhet të mësojnë për të lidhur zinxhirët e tyre të furnizimit me kërkesat e tregjeve të cilave u shërbejnë. Performanca e zinxhirit të furnizimit është tani një avantazh konkurrues për kompanitë që të shkëlqejnë në këtë fushë në qendër të analizës konkurruese të jenë SC dhe rrjetet e përbëra nga sipërmarrje të shumëfishta (Chen dhe Paulraj, 2004: Miles dhe Snow, 2007).Ka shumë përkufizime të ndryshme të SCI nga studiues të shumtë. Lawrence dhe Lorsch (1986) e përkufizojnë SCI si "cilësia e gjendjes së bashkëveprimit që ekziston midis departamenteve e cila është e nevojshme për të arritur unitetin e përpjekjeve nga kërkesat e mjedisit". Përkufizimi i referohet vetëm integrimit të brendshëm të një kompanie apo sipërmarrjeje. Autorë të ndryshëm, si për shembull: Bowersox e Morash (1989) argumentojnë se SCI do të thotë të integrosh marrëdhëniet, veprimatarinë, funksionet, proceset dhe lokacionet përgjatë të gjithë anëtarëve të kanalit në zinxhirin e furnizimit. Bowersox et al (1999) e kanë konceptuar SC në kontekstin e gjashtë llojeve përberës: integrimi i furnizuesve integrimi i teknologjisë integrimi i konsumatorit, integrimi i brendshëm, integrimi planifikimit, integrimi i sistemeve të matjeve dhe integrimi i marrëdhënieve furnizues konsumator Stevens (1989) propozoi se SCI ka të bëjë veçanërisht me planifikimin, bashkërendimin, bashkëveprimin dhe kontrollin e mallrave, duke përfshirë të gjithë nivelet, strategjike, taktike dhe operacionale të pjesëve dhe materialeve të përfunduar nga furnizuesit deri tek konsumatorët përfundimtar. Ndërkohë, Vickery et al. (2003) thotë se SCI duhet dhe mund të menaxhohet strategjikisht, taktikisht dhe operacionalisht nga një sistem i vetëm, e jo nga nënsisteme të cilat ofrojnë optimizimin e cdo kompanie individuale të cilat janë pjesë integruese të zinxhirit të furnizimit. SCI mund të përkufizohet si një përqasje menaxheriale e cila lufton për një bashkërendim dhe bashkëpunim më të madh midis partnerëve të SC, në përpjekje për të ruajtur konkurrueshmërinë e firmës.

Fazat e zhvillimit të “Shqipëria Trikot sh.p.k

Faza e parë, është viti 1995 deri në vitin 1998, ku kanë punuar në një ndërmarrje të vogël në hapësirë dhe në numër punonjësish nga 100-120 veta, ku SHTR funksinonte si një fason i mirëfilltë. Në Cotonela bëhej prerja e materialit, pregatitja e PL me të gjithë aksesorët, ndërsa qepja realizohej nga “Shqiperia Trikot në bazë të skedave të punës të cilat realizohen nga modelistet e stafit të disagni-t. Në këtë mënyrë themi se prodhonte me material porositësi 100 % për eksport.

Faza e dytë, nga viti 1998 deri më 2006 është marrë vendimi për blerjen e një ndërrmarrjeje më të madhe në të njëjtën zonë industriale dhe me të njejtat kushte prodhimi, por me një kapacitet prodhimi shumë më të madh, duke parë performancë të lartë dhe eficente të “Shqipëria Trikot”. Gjatë kesaj faze numri të punësuarve është rritur në mbi 450 punetorë, si rrjedhoje rritet dukshëm numri i produkteve të gatshme të prodhuara. Kjo fazë shënon rritje të performancës në trajnim të përsonelit vendas nga menaxherë të huaj, rritje te sasive të prodhuara si rezulatat i rritjes së numrit të të punësuarve.

Faza e tretë, nga viti 2006-2009 është konsideruar edhe faza më e rëndësishme dhe me ndryshimet më rrënjësore për SHTR. Pas një periudhe disavjeçare bashkëpunimi mes “Cotonella” dhe SHTR merret vendimi që të ndryshohet model i të bërit biznes, duke kaluar nga një fason tradicional, ku SHTR bënte qepjen e produkteve me material porositësi 100% për eksport, të kalohet në një paketë me të plotë të zinxhirit te vlerës, ku tani logjistika, importimi i marrë nga porositësi dhe eksportimi i produktit të gatshëm të realizohet nga SHTR ndërsa qepja nga nënkontraktorë, të cilët klasifikohen furnitorë vetëm për vlerën e re të krijuar.

Faza e katërt, nga 2009-ta e në vazhdim. Nëvitin 2009përfundoi investimi më i rëndesishëm për “Cotonella” dhe SHTR, në zonën industriale të qytetit tëtë Shkodres. Investimi kap shifren mbi pesë milion euro, kjondërtesëdo të shërbejë për magazinimin e produkteve (lëndeve të para) të importuara dhe të produkteve të gatshme të prodhuara në Shqipëri. Në ndërtesën e re përballë fermentimit do të funksionojnë magazinat dhe zyrat e shoqërisë, ku importi i material porositësit bëhet në metrazhe dhe proçesi i prerjes realizohet tek SHTR, magazinimi i lëndës së parë dhe kontrolli nga laboratori, i posaçëm, magazinimi i produktit të gatshëm, kontrolli përfundimtar i produktit si dhe logjistika.Ekzistojnë tre reparte të mëdha, lendë të parareparti i prerjes si dhe reparti logjistikës.

Faza e pestë, përfshin hapat e parë kur kompania fillon të tregtojë produktet e gatshme në tregun shqiptar,të drejtën e tregtimit të produkteve në tregun shqiptar e ka nënkontraktori SHTR, MADISH sh.p.k. Që nga viti 2010-të ka vazhduar me hapa gradual ofrimi i këtyre produkteve mjaft cilësore dhe me çmime të arsyeshmenën etiketën “Made in Albania” dhe markën e “Cotonella” edhe për konsumatorët shqiptarë. Në bazë të informacioneve themi se rezulton me sukses tregtimi i këtyre produkteve dhe se konsumatorët shqiptarë po përgjigjen mjaft pozitivë ndaj tyre. Këto produkte përveçse shiten publikut të gjerë, mund të blihen pranë hipermarketeve të mëdha e në njësi të tjera tregtare, falë zgjerimit të rrjetit të shitjes së këtyre produkteve në Shkodër, Vlorë, Tiranë, Korçë e qytete të tjera brenda vendit si dhe jashtë vendit psh: Kosovë, Mal i Zi.

Modeli i biznesit “Shqipëria Trikot sh.p.k” nga 1995-2006



Në vitin 1996 “Cotonella S.p.a.” merr vendimin që të decentralizojë prodhimin e produkteve. Për këtë decentralizim zgjidhen 3 shtete të ndryshme, Shqipëria, Rumania dhe Serbia, të cilat do të funksiononin si fasone të mirëfillta. “Cotonella” vendos transferimin e prodhimit në Shqipëri dhe pikërisht në Shkoder për këto arsye:

1- Kushtet e favorshme ekonomiko-politike
2-Distanca e afërt me Italinë
3-Decentralizimi i prodhimit sjell lehtësi në logjistikë duke përshpejtuar dorëzimin e produkteve tek klientët përfundimtar, në sasinë e kërkuar dhe në kohën e duhur, duke shmagur sa më shumë që të jetë e mundur vonesat e dorëzimit të mallit.
4-Njohja e mirë e kulturës dhe e gjuhës së vendit fqinj, sepse në zonat urbane rreth 90% e popullsisë flet gjuhën italiane.
5-Italia dhe Shqipëria kanë qenëndër vite bashkëpunëtore të suksesshme të marrëdhënieve tregtare.
6-Kosto e ulët prodhimi, pagat e fuqisë punëtore shumë më të ulta se në Itali dhe në shumë vende te tjera të Ballkanit, cilësi e lartë prodhimi dhe afat i lëvrimit të mallit.

Grafik 1. Paga minimale në disa shtete të Ballkanit.



Burimi: Gazeta Panorama viti 2013

Duke qenë se ishte në fillimet e saj nga "Cotonella S.p.A." merret vendimi që numri i operacioneve që do të realizohej në "Shqipëria Trikot" të ishte i vogël. Si një fason tradicional, këtu do të realizohej qepja e produkteve dhe konfeksioni.
Kompania "Cotonella" realizonte të gjitha aktivitetet primare të zinxhirit të furnizimit. Planifikimin e sasive që do të prodhoje të cilën e realizonnë një analizë tregu për sasinë e produkteve që do të prodhohen për periudhat në vazhdim, duke u bazuar në parashikimete viteve të kaluara. Një peshë të konsiderueshme të produkteve që do të prodhohen e zënëporositë paraprake të bëra nga markat private përproduktet e tyre. Kontrolli i të gjithë aksesorëve të lëndës së parë bëhet në laborator, në kompanikonform standarteve të larta italiane dhe të direktivave të ISO 9001:2008.
Departamenti i dizanjit realizonte modelet dhe më pas prerjen e produktit në departamentin e prerjes, pas përfundimit të këtij proçesi bëhet dërgimi i materialit të prerë në Shqipëri, Serbi dhe Rumani. Puna e ndarë sipas pl të vendeve pritëse dërgohet bashkëngjitur me një skemë të detajuar e cila tregon mënyrën sesi duhet të qepen, rradhën e kryerjes së punës, sasinë etj dhe të gjithë aksesorët e nevojshëm për qepje e konfeksionim.

I gjithë proçesi punës monitorohej nga teknikë italianë të dërguar nga Kompania mëmë për të kontrolluar dhe verifikuar që proçesi realizohej sipas skemës së dhënë dhe standarteve të cilesisë së kërkuar në periudha të caktuara. Proçeset e punës tëSH. T. R në fillimet e saj, kur kishte fillimisht 100-120 punonjës deri në 1998 që arriti në 450 punëtorë, konsistonin në procesin e qepjes dhe konfeksionimit të mallit. Në vitin 2001 "Cotonella" në bashkëpunim me SHTR, pas bërjes së një sërë analizash të performancës së "Shqipëria Trikot", duke u nisur që nga numri i produkteve të prodhuara, cilësia e produkteve, koha që duhej për marrjen dhe përfundimin e një porosie të veçantë, arritja e standarteve të kërkuara nga "Cotonella S.p.A", marrëdhëniet shumë bashkëpunuese dhe produktive ndërmjet "Cotonella" dhe SHTR filluan që të mendojnë për ndryshinim e modelit të të bërit biznes deri në atë vit duke e shndërruar SHTR nga nje fasonist trandicional, në një kompani me "paketë më të plotë", ku shumë nga aktivitetet primare të zinxhirit të furnizimit do të kalonin nga Italia në Shqipëri, përkatësisht nga "Cotonella S.p.A" tek "Shqipëria Trikot sh.p.k".

Arsyet për marrjen e një vendimi të tillë ishin:

1-Performancë shumë e mirë në cilësine e produkteve të prodhuara.
2-Numri i të punësuareve pranë "Shqipëria Trikot" kishte arritur në 450, gjë e cila po krijonte vështirësi në kontrollin dhe administrimin e tyre, dhe nevoja për fuqi punëtore më të madhe për të plotësuar të gjitha porositë që "Cotonella" mendonte të prodhonte në Shqipëri
3-Shkëputja e marrëdhënieve me Serbinë dhe Rumaninë, për shkak se sasia e produkteve të prodhuara në Serbi mund të prodhohej në Shqipëri, me një cilësi më të lartë, kosto më të ulët dhe në një kohë më të shkurtër. Ndërsa Rumania shumë shpejt do të ishte vend anëtar e Bashkimit Europian, dhe plotësimi i kritereve për të qenë vend anëtar nënkuptonte kosto më të lartë prodhuese.
4- Transferimi i laboratorëvetë kontrollit të cilësisë së lëndës së parë dhe të produkteve të gatshme dhe gjithashtu prerja dhe paketimi i produkteve që të realizohej pranë "Shqipëria Trikot", sepse në këtë mënyrë kishte nje ndikim të dukshëm në kohë duke shkurtuar kohën që i duhej produkteve dhe

lëndeve të para të dërgoheshin nga vendet furnitore në Itali. Në këtë mënyrë meqenëse mbas analizave të bëra kryesisht në kosto, rezultoi se nënkontraktimi nënkuptonte kosto të njejta prodhimi por kishte efekte pozitive në kohë, kontroll më efiçent manaxherial, ishte më e thjeshtë për tu administruar, specializimi ishte më i madh, kapaciteti i prodhimit do të rritej, numri i artikujve të prodhuar ishte gjithnjë e në rritje, u vendos që në mënyrë graduale të ndodhnin ndryshime të zinxhirit të krijimit të vlerës.

Të gjitha këto ndryshime morën një kohë prej pesë vitesh, nga viti 2001-2006, për të marrë formën e biznesit që është tani.

Modeli i biznesit "Shqipëria Trikot sh.p.k" nga viti 2006 deri 2014

Siç duket edhe nga skema,që nga viti 2006 "Shqipëria Trikot" realizon një numër shumë më të madh të zinxhirit të furnizimit,ndërkohë që prodhimi i produkteve ka kaluar totalisht në duar të nënkontraktorëve.Tani "Cotonella S.p.A" kryen vetëm një pjesë të logjistikës së jashtme që janë furnitorët, gjetjen e tyre dhe bërjes së porosisë, realizon marketingun dhe shërbimin mbas shitjes,ndërsa marrja e lëndëve të para bëhet direkt tek "Shqiperia Trikot",pa kaluar nga "Cotonella" siç ndodhte më përpara.

Nënkontraktorët



Proçese tëprodhimit, qepjes dhe paketimitt të produkteve"Shqipëria Trikot sh.p.k"e realizon mepesë nënkontraktorët e saj.
Nënkontraktori Madish sh.p.k është krijuar që në vitin 1995 duke qenë fillimisht pjesë përbërëse e kompanisë "Shqipëria Trikot sh.p.k".Në vitin 2001 me ndryshimin e formës së prodhimit kjo njësi u shkëput nga kompania duke u kthyer në nënkontraktor të "Shqipëria Trikot sh.p.k".
Nënkontraktorët e tjerë janë Laurus sh.p.k (2006), Melkans sh.p.k (2003), Silvana sh.p.k (2008) dhe Andrea sh.p.k (2013).Ata kontrollohen nga punonjës të "Shqipëria Trikot sh.p.k" të cilët janë teknikë te lartë. Artikujt që gjenerohen nga nënkontraktorët përfshijnë slip, fanella, komplete, sytjena,

pizhame. “Shqipëria Trikot sh.p.k” siguron kontratate punës, në këtë menyrë siguronpunën dhe marxhin e fitimit për secilin nënkontraktor.Numri i të punësuarve arrin në total në 414 persona.

Tabela 8. Nënkontraktorët e Shqipëria Trikot sh.p.k

Nënkontraktori	Numri i të punësuarve	% në prodhimin total të Cotonella S.p.A
Madish sh.p.k	103	22.85%
Laurus sh.p.k	126	22.85%
Melkans sh.p.k	88	19%
Silvana sh.p.k	97	19%
Andrea sh.p.k.	15	4%
Totali	414	87.7%

Burimi: Cotonella viti 2013

Grafik 7. Numri i të punësuarve i nënkontraktorëve të Shqipëria Trikot sh.p.k



Burimi: Cotonella viti 2013

“Shqipëria Trikot sh.p.k” i ofron mbështetje të vazhdueshme nënkontraktorëve të saj. Asistenca teknike konsiston në:
përzgjedhjen dhe trajnimin e stafit
trajnimin e stafit të secilit nënkontraktor sa herë ndryshojnë kërkesat e tregut dhe ndryshime në organizimin e kompanisë
trajnimin periodik të personelit i cili merret me kontrollin e cilësisë së produktit
trajnimin e stafit që kryen kontrollin gjatë prodhimit
asistencë teknike në mirëmbajtjen e makinerive

Në të njëjtën kohë “Shqipëria Trikot sh.p.k” është e angazhuar maksimalisht për të kryer monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit prodhues të secilit nënkontraktor. Monitorimi kryhet në tre drejtime kryesore. Së pari, gjatë procesit të prodhimit në secilin nënkontraktor është një teknik i “Shqipëria Trikot sh.p.k” i cili është prezent gjatë gjithë periudhës që ushtrohet aktiviteti. Teknikët përgatisin relacione periodike për të eliminuar vështirësitë dhe problemet e hasura gjatë aktivitetit prodhues. Së dyti, monitorohet cilësia e produktit përfundimtar nga reparti i kontrollit të ”Shqipëria Trikot sh.p.k” të cilët përgatisin githashtu relacione statistikore mbi nivelin e cilësisë për secilin nënkontraktor. Së treti, kryhen auditime të vazhdueshme të cilat monitorojnë zbatimin e kërkesave, kontratave dhe standarteve të kërkuara nga kompania mëmë. Në sajë të mbështetjes së ofruar nga “Shqipëria Trikot sh.p.k” dhe kërkesës së kompanisë mëmë aktiviteti i secilit nënkontraktor është rritur si dhe numri i të punësuarve prej tyre.

Grafik 8. Prodhimi i nënkontraktorëve të Shqipëria Trikot sh.p.k



Burimi: Cotonella viti 2013

Efektet e ndryshimit të modelit të biznesit

Prodhimi

Strategjia e prodhimit të "Cotonella S.p.A" është e orientuar drejt një rënie graduale të prodhimit në vendet si Kina dhe India në favor të Shqipërisë. Kjo tregon se konkurrenca e tregut shqiptar të punës, e kombinuar me profesionalizmin dhe sensibilizimin drejt cilësisë, është tani në gjendje për të konkuruar me këdo nga gjigandët e prodhimit botëror të cilëve gradualisht "Cotonella S.p.A" së bashku me "Shqipëria Trikot sh.p.k" është duke i përvetësuar një pjesë gjithnjë e më të rëndësishme të kapacitetit prodhues.

Aktiviteti prodhues i "Shqipëria Trikot sh.p.k" është rritur gjatëkalimit të viteve. Në fillimet e saj në vitin 1998 kompania prodhonte vetëm 60% të totalit të "Cotonella S.p.A." ndërsa në vitin 2013 prodhon rreth 95% të prodhimit total duke pasur një rritje prej 35% krahasuar me vitin 1998. Krahasuar me vitin 2010 prodhimi është rritur në total me 23%. sh.p.k".Rritja e prodhimit në masën 95% është indikatori kyç i kapaciteteve prodhuese të kompanisë dhe prezencës së stafit të specializuar, i cili është në gjendje të prodhojë artikuj më të sofistikuar, në përputhje të plotë me objektivat e kompanisë për transferimin e prodhimit nga Kina dhe India në "Shqipëria Trikot sh.p.k".Në Kinë aktualisht prodhohen 99% e recipetave të cilat përfshihen në linjën ekonomike të "Cotonella S.p.A".Arsyeja e prodhimit në Kinë është prezenca e lëndës së parë dhe kostoja më e ulët e prodhimit për sasi të konsiderueshme deri në 500,000 palë për të cilat kompania mëmë ka kërkesën më të lartë.Ndërsa për realizimin e recipetave të linjës më të shtrenjë është Shqipëria ku prodhimi arrin deri në 5,000 palë në vit.Në Indi prodhohen pigjamet dhe veshjet e brendshme si rrjedhojë e specializimit që ka në prodhimin e pëlhurave të nevojshme për këto produkte. Për më tepër, "Shqipëria Trikot sh.p.k" gjatë fundit të vitit 2014 dhe në vazhdim do të realizojë produkte të reja të kostumeve të banjos falë blerjes së kompanisë të njohur Linea Sprint. Prodhimi i kostumeve të banjës është një vlerë e shtuar për këtë kompani.

Tabela 9, Aktiviteti prodhues Shqipëria Trikot sh.p.k 2010, 2013

Artikull	Prodhimi 2010	Prodhimi 2013	% e rritjes së prodhimit
Mbathje	10,000,000	11,500,000	15%
Fanella	450,000	1,300,000	189%

Recipeta	15,000	50,000	233%
Pizhame	2,000	5,000	150%
Total	10,467,000	12,855,000	23%

Burimi: Cotonella viti 2013

Të ardhurat e "Shqipëria Trikot sh.p.k

Të ardhurat e Shqipëria Trikot kanë pasur një rritje të konsiderueshme me rritjen e sasisë së artikujve të prodhuar.Viti 2013 shënoi një rritje të të ardhurave me 116% krahasuar me vitin 2000.Luhatjet në nivelin e të ardhurave gjatë tre viteve të fundit janë edhe si rezultat i lëvizjeve të konsiderueshme që monedha vendase ka patur ndaj monedhës evropiane.

Furnizuesit e lëndës së parë

Në fillimet e aktivitetit të saj "Shqipëria Trikot sh.p.k" importontevetëm nga kompania mëmë, copa të prera dhe aksesorë (llastik, fije, etiketa), materiale për paketim ndërsa pas viteve 2000 ajo importon pëlhura dhe aksesorë të nevojshëm për qepje dhe paketim. Lëndën e parë "Shqipëria Trikot sh.p.k" e importon në pjesën më të madhe nga Turqia dhe më pak nga Italia, Rumania, Bullgaria dhe Kina. Për prodhimin e 12-15 millionë copëve nevojiten të importohen rreth 5000-7000 ton copë. Niveli i importit nga Turqia është rritur shumë dhe ai nga Kina është ulur për shkak të marrëveshjes doganore për të cilën importi i lëndës së parë është free of charge. Pavarësisht këtyre lehtësirave për të eksportuar produktin përfundimtar të realizuar mbi lëndën e parë të importuar nga vendet jashtë Bashkimit Evropian, duhet të paguhet një taksë prej 12.5%.

Importi i lëndës së parë kryhet në varësi të raportit çmim-cilësi dhe sipas kërkesave të klientëve të kompanisë mëmë. Bashkëpunimi me furnizuesit sigurohet nga sektori i blerjeve të kompanisë mëmë dhe bazohet në raportet shumëvjeçare të krijuara me secilin furnizues. Bashkëpunimi konsiston në: (a) përmirësimin e parametrave, (b) eliminimin ose shtimin e karakteristikave apo modifkimin e tyre, (c) kërkesa specifike për materiale të ndryshme të cilat nuk janë të pranishme në tregje.Në të njëjtën kohë, "Shqipëria Trikot sh.p.k" garanton cilësinë e furnizuesit nëpërmjet kontrollit të vazhdueshën të lëndës së parë në laboratorët përkatës që në momentin kur lënda mbërrin në destinacion. Në raste të identifikimit të jo konformiteteve të ndeshura gjatë kontrollit, furnizuesit njoftohen për parregullsitë dhe proçedohet sipas rregullave të vendosura. Për furnizuesit që janë skeptik për rezultatet e testeve të kontrolllit "Shqipëria Trikot sh.p.k" mundëson vëzhgimin e metodave të kontrollit nga furnizuesit përkatës, dhe deri tani shkalla e refuzimit të lëndës së parë është e vogël dhe sporadike. Për të intesifikuar bashkëpunimin me furnizuesit "Shqipëria Trikot sh.p.k" organizon takime me furnizuesit çdo tre muaj gjatë të cilave drejtuesit dhe teknikët e kompanisë njihen me të rejat e fundit të teknologjisë dhe materialeve inovative që mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së produkteve të kompanisë.
Furnizuesit vendas nuk janë pjesë e aktivitetit prodhues të "Shqipëria Trikot sh.p.k" pasi nuk gjenden furnizues në vende që prodhon materialet të cilat plotësojnë parametrat e lartë që janë të nevojshëm për aktivitetin prodhues të kompanisë.

Departamenti i kërkimit dhë zhvillimit (R&D) ndodhet në "Cotonella S.p.a" në Itali. Ky departament ka një staf prej gjashtë personash të cilët kryejnë kërkime mbi materialet e reja të nevojshme për: (a) prodhimin e veshtjeve intime, (b) krijimin e produkteve që lejojnë përshtatjen maksimale në atonominë e trupit, dhe (c) krijimin e produkteve të reja në përputhje me kërkesat e ndryshueshme të klientëve të "Cotonella S.p.A".

Grafik 9. Të ardhurat e SHTR nga 2004-2012



Burimi: Cotonella 2012

Niveli skarcitetit

Ndërsa në bazë të informacioneve të marra për vitet 1995-2006, niveli skarcitetit të produkteve ishte rreth 3%, kjo nuk ishte një shifër alarmuese, por duke marrë parasysh një sërë faktorësh si teknologji të reja që ishin në përdorim për prodhimin e produkteve, specializimin dhe trajnimin e punonjësve, skica prodhimi gjithnjë e më të sistemuara dhe të detajuara nga departamenti i operacioneve mendohej se kjo shifer duhej të ishte më e ulët.
Tani, mbas ndryshime të bëra dhe decentralizimin e prodhimit, niveli skarcitetit është ulur duke arritur në 1.5%. Ajo që është gjithashtu e rëndesishme është fakti se më parë çdo skarco produkti rëndonte shpenzimet e "Shqipëria Trikot", pasi ajo ishte përgjegjëse për dëmet e bera, ndërsa aktualisht në shumicën e rasteve shpenzimet e skarco përballohen nga nënkontraktorët, me përjashtim të rastit kur dëmi ka ardhur si pasojë e një difekti në lënden e parë, ku mban përgjegjësi SHTR.

Specializimi i produktit

Deri në vitin 2001, kur "Shqipëria Trikot" prodhonte vetë, llojshmëria e produkteve të prodhuara ishte e vogël për shkak se kompania nuk arrinte të prodhonte një shumëllojshmëri artikujsh, fuqia punëtore nuk ishte shumë e specializuar dhe kërkonte shpenzime shtesë dhe trajnime për të arritur në prodhimin me suksese të një modeli të ri produkti apo linjë të re prodhimi. Ndërsa tani secili nënkontraktor është më shumë i specializuar në një llojshmëri të përcaktuar artikujsh, duke bërë që cilësia e produkteve të jetë më e lartë, koha për prodhim e produkteve të jetë më e ulët. Pra jane artikujt bazikë qe i prodhon secili nënkontarktor, kemi edhe artikujt të veçantë ku secili prej tyre është i specializuar në një numër të caktuar dhe në modele te ndryshme.
Rritje ka pësuar dhe portofoli i produkteve, i cili është zgjeruar në kalimin e viteve. Në vitet e para të aktivitetit janë prodhuar vetëm mbathje për meshkuj dhe femra. Merritjen e përformancës së kompanisë, cilësisë së prodhimit, dhe shtimin e personelit të specializuar,në vitet në vazhdim është shtuar gama e artikujve si fanella, reçipeta dhe produkte për fëmijë. Në 5 vitet e fundit prodhohen dhe pigjame për femra, meshkuj, fëmijë si dhe këmisha nate. Vlen për tu theksuar se produktet si recipetat kanë pësuar një rritje prej 233% për të njëjtën periudhë kohore ndërsa fanellat janë rritur me 189% dhe pizhamet me 150%.

Stafi "Shqipëria Trikot sh.p.k"

Në qendër të suksesit të "Shqipëria Trikot sh.p.k" është stafi shumë i përkushtuar dhe i kualifikuar i kompanisë.Në vitin e parë të krijimit kompania ka patur 82 punonjës. Në vitin 2000 numri i tyre arriti në 440 punonjës. Me ndryshimin e formës së prodhimit ku shërbimin e qepjes e kryejnë nënkontraktorët numri i punonjësve të kompanisë ka arritur në 78 të punësuar. Ajo që është për tu theksuar është se suksesin "Shqipëria Trikot sh.p.k" e ka arritur falë stafit të vendit pritës. Që nga data

e krijimit të saj e deri më sot kjo kompani nuk ka patur asnjë të huaj të punësuar në aktivitetin prodhues as dhe në atë drejtues. Punëtorët e kompanisë mëmë vijnë kryesisht për periudha të shkurtra për të ofruar asistencë teknike dhe për të marrë pjesë në takime të cilat shërbejnë për të monitoruar aktivitetin e shoqërisë, saktësuar objektivat për të ardhmen dhe vendosur strategjitë përkatëse në periudhat në vazhdim.

Vertikalizimi i prodhimit

Një nga objektivat më të rëndësishëm në të ardhmen e "Shqipëria Trikot sh.p.k" duke konsideruar zhvillimet e tregut dhe startegjitë e brendshme del e nevojshme vertikalizimi i gjithë rrjetit prodhues i cili do të mundësonte: (a) transferimin e prodhimit nga vendet aziatike, (b) do të reduktonte importet e lëndës së parë, (c) do të rriste konkurrueshmërinë e Shqipërisë në shkurtimin e kohës së shpërndarjes dhe (d) do të forconte aftësitë teknike të stafit duke arritur standartet më të larta evropiane. Vertikalizimi do të mundësojë që kompania të realizojë thurjen, stampimin dhe ngjyrosjen e pëlhurës në qytetin e Shkodrës. Për më tepër, kompania synon realizimin e një qendre rajonale e cila do të mund të ofrojë këto shërbime për rajonin dhe për prodhuesit e tjerë fason. I gjithë projekti do të jetë një investim prej 12 milionë eurosh. Kjo qendër do të sigurojë minimalisht 800 vende të reja pune, drejtues, nenpunës, dhe punëtorë të specializuar. Makineritë që do të punojnë respektojnë në mënyrë rigoroze normativat europiane në lidhje me ndotjen e mbjentit dhe garantojnë një nivle sigurie që tejkalojnë standartet e vëndosura nga ligji.

Realizimi i kësaj qëndre do të mundësojë:
reduktimin e kohës së prodhimit
përmirësimin e logjistikës
ulje e ndjeshme e humbjeve nga luhatjet e kursit të këmbimit valutor
eliminimin e transportit të dyfishtë
rritje eksporteve për produktet "Made in Albania"

Aktualisht kompania është duke vlerësuar kohën më optimale për kryerjen e investimit pasi, aktualisht mjedisi i të bërit biznes është jo shumë i favorshëm në vend dhe kapaciteti prodhues që duhet të ketë kjo qendër pasi nevojitet një prodhim minimalisht prej 5,000 ton për të siguruar rentabilitetin e saj, prandaj shikohet nevoja e një studimi të hollësishëm.

Konkluzione

Përqëndrimi i Cotonella Spa vetëm në proceset e logjistikës(marredhëniet me furnitorët) shitjen dhe shërbimet mbas shitjes kanë rezultuarme suksese për kompaninë duke ju referuar treguesve që më lart janë marrë në studim. Gjithashtu nënkontraktimi nga ana e Shqiperia Trikot shpk e 5 nënkontraktoreve dhe kryerja në Shqipëri e një numër procesesh shumë më të mëdha se sa perpara viteve 2006, ka çuar në rritjen e vleres së shtuar të produkteve "Made in Albania", e cila nga ana tjeter është një element shumë i rëndësishëm për njohjen e produkteve të prodhuara këtu në gjithë Europen edhe më tej dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj.

Realizimi i një cikli të plotë prodhimi tek Shqipëria Trikot sh.p.k, ka siguruar një sërë avantazhesh për të dhe Cotonella Spa, duke rritur konkurrueshmërine dhe duke siguruar qëndrueshmëri dhe marrëdhënie bashkëpunimi edhe më të forta ndërmjet Cotonella S.p.a dhe Shqipëria Trikot sh.p.k. Një ndër ndryshimet më të rëndësishme është integrimi zinxhirit të furnizimit, ku gjithnjë e më shumë vërehet një bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni ndërmjet hallkave të zinxhirit të vlerës.
"Shqipëria Trikot shpk" realizon të gjithë ciklin e proçeseve deri në lëvrimin e mallit tek klientët, në përjashtim të design-it, blerjes së lëndës së parë dhe marketing-ut, por me synimin e afërt të plotësimit të të gjithë proçeseve duke mundësuar produkte 100 % "Made in Albania"

Një nga objektivat më të rëndësishëm në të ardhmen e "Shqipëria Trikot sh.p.k" është vertikalizimi i prodhimit duke mundësuar krijimin e bazës së furnizuesve së lëndës së parë në Shqipëri për mbulimin

e nevojave të tregut brenda dhe jashte duke realizuar thurjen, stampimin dhe ngjyrosjen e pëlhurës në qytetin e Shkodrës

Suksesi i "Shqipëria Trikot sh.p.k" është arritur falë stafit të vendit pritës. Që nga data e krijimit të saj e deri më sot kjo kompani nuk ka patur asnjë të punësuar nga kompania mëmë në aktivitetin prodhues, dhe as në atë drejtues.

Referencat

www.instat.gov.al
www.cotonella.com
Bowersox & Morash (1989):"The intergration of marketing flows in channels of distribution"
Chen & Paulraj, (2004): "Towards a theory of supply chain management: The constructs and measurements"
Lawrence &Lorsch (1986):"Organization and Environment: Managing Differentiation and Integration"
Miles & Snow (2007): "Organization theory and supply chain management:An evolving research perspective"
Stevens (1989):"Integrating the supply chain"
Stevens (1989):"Integrating the of marketing flows in channels of distribution"
Vickery (2003):"The effects of an integrative supply chain strategy on costumer service and financial performance supply chain strategy on costumer service and financial performance"

MSC. XHEMILE BERISHA HOTI, PHD. (C) ARTA HOTI, MSC. SAMI ARIFAJ, PHD. (C) SEVDIE ALSHIQI BEKTESHI – ROLI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË PËRMIRËSIMIN E OPERACIONEVE BANKARE

MSC. XHEMILE BERISHA HOTI
Internal Auditor, Bank for Business, Prishtina, Kosovo

PHD. (C) ARTA HOTI
Teaching Assistant, University of Prishtina "Hasan Prishtina"
Manager, Interline Company, Prishtina, Kosovo

PHD. (C) SEVDIE ALSHIQI BEKTESHI
Teaching Assistant, University of Prishtina "Hasan Prishtina", Kosovo

Abstrakt

Ky punim vlerëson rolin e auditimit të brendshëm në bankat komerciale të Sistemit Bankar në Republikën e Kosovës, por gjetjet kryesore janë bërë nga analiza e funksionimit të auditimit të brendshëm të një banke në Kosovë si rast studimi si dhe krahasimi me bankat tjera.

Me këtë punim është synuar të bëhet vlerësimi i sistemit ligjor dhe rregullativ i krijuar në sistemin Bankar të Kosovës për funksionimin e mirëfilltë të Auditimit të Brendshëm, kornizat ligjore të cilat duhet ti respektoj një auditor i brendshëm gjatë kryerjes së punës, objektivat që duhet ti parapërcaktoj dhe synoj ti arrij, auditimin e bazuar në vlerësimin e rrezikut, auditimin e bazuar në vlerësimin e funksionimi të kontrollit të brendshëm, hapat e kryerjes së auditimit të brendshëm, cilat janë auditimet kyqe në bankë si dhe roli i auditimit të brendshëm në përmirësimin e operacioneve bankare.

Qëllimi i punimit është të analizoj se sa ka arritur që auditimi i brendshëm pas më shumë se një dekade të funksionimit të sistemit bankar në Kosovë, të ketë ndikime në një institucion bankarë të përmirësoj operacionet bankar, kjo përmes rolit të tij në përmirësimin e menaxhimit të rrezikut, sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe proceseve qeverisëse.

Punimi është i organizuar sipas pjesëve në vijim:
Pjesa e I një historik të shkurtër të zhvillimit të sistemit bankar në Kosovë si dhe gjendja aktuale e sistemit bankar. Pjesa e II përshkruan kornizën ligjore brenda kufijve të të cilës duhet të veproj auditori i brendshëm. Pjesa e III ka të bëjë me përcaktimin e objektivave të çdo auditimi. Pjesa e IV përshkruan fushëveprimin e auditimit të brendshëm në bankë duke u fokusuar në katër shtyllat kryesore: rreziqet bankare, rolin e kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm si dhe hapat e procesit të auditimit. Pjesa e V përfshinë auditimin e funksioneve kyçe në bankë që është i shpërndarë në gjashtë njësitë kryesore të bankës. Pjesa kryesore apo e VI me radhë që përfshinë rolin që ka auditimi i brendshëm në përmirësimin e operacioneve bankare si dhe pjesa e fundit e cila paraqet një përmbledhje të punimit si dhe konkluzionet kryesore të arritura.

Hyrje

Duke marrë për bazë rëndësinë e bankave në sistemin bankar si dhe sistemin bankar në mbarëvajtjen e sistemit financiar dhe ekonomik të vendit lind nevoja e krijimit të mekanizmave të brendshëm në banka që sa më lehtë dhe më shpejtë të identifikojnë rreziqet në aktivitetet kryesore të bankës dhe kontrolleve të brendshme të pritura që mendohet se i lehtësojnë / zbusin këto rreziqe.

Në këtë punim do të shtjellohet kuptimi i rrezikut të bazuar në kornizën e auditimit, aftësia e planifikimit të auditimit duke përdorur qasjen e bazuar në rrezik, do të shtjellohen apo mësohen

teknikat për kontrollimin dhe auditimin e funksioneve kyçe, transaksionet e aplikimit të biznesit, aktivitetit, kontrollit dhe procedurat.

Do të elaborohet mënyra se si të aplikohet një qasje pro aktive për të ofruar një shërbim të vlerës së shtuar në organizatën tuaj.

Të sigurohet, gjatë kryerjes së auditimit tuaj të brendshëm, se auditorët janë duke zbatuar standardet e auditimit ndërkombëtarë si dhe praktikat më të mira.

Zhvillimi i sistemit bankar në Kosovë

Kosova pas luftës doli me një sektor bankar të shkatërruar totalisht pa asnjë bankë funksionale. Sipas dispozitave të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("UNMIK") Rregullorja nr. 1999/20 e nxjerrë më 15 nëntor 1999 (e ndryshuar më 1 tetor 2001) u themelua Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës. Me 24 gusht 2006 PSSP ka nënshkruar rregulloren e re mbi Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe ka transformuar Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (AQBK) në Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Sipas kësaj rregulloreje, objektivat themelore të BQK-së janë:

☑ Të ruhet fuqia, aftësia paguese dhe funksionimi efikas i një sistemi stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar krijimin e instrumenteve të sigurta financiare; dhe
☑ Pa ndonjë paragjykim, të përkrah politikat e përgjithshme në Kosovë për te kontribuar në një alokim efikas të burimeve në pajtim me principet e një ekonomie me treg të hapur.

Në Republikën e Kosovës sot operojnë 9 (nëntë) banka komerciale dhe përbëjnë 76.3 përqind të aseteve totale të sektorit financiar. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking. Qasja në shërbimet e këtyre bankave mundësohet përmes aktualisht 310 degëve dhe nëndegëve, 415 ATM-ve dhe 8361 POS dhe 55292 llogarive e-banking (bankimi elektronik).

Në bazë të rregullave të aprovuara nga organet kompetente të këtij institucioni është obliguar krijimi i një sistemi të mirëfilltë të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm, më saktësisht sipas rregullës mbi kontrollat e brendshme dhe auditimin e brendshëm, përcaktohen saktë përgjegjësit e çdo banke për funksionalizimin e këtij sistemi.

Korniza ligjore e Auditimit të Brendshëm në Sistemin Bankar në Kosovë

Me qëllim të arritjes së rezultateve të dëshiruara në përmirësimin e operacioneve bankara Auditorët e Brendshëm në Sistemin Bankar në Kosovë, punën e tyre duhet ta mbështesin çdo herë në kornizat e mëposhtme:

☑ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
☑ Standardet e Atributit, Përformancës dhe Implementimit
☑ Kodi i etikës
☑ Ndihmat dhe praktikat zhvillimore
☑ Rregullat e BQK-së
☑ Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare
☑ Politika, Procedura dhe Manualet e Brendshme

Objektivat e Auditimit të Brendshëm

Objektivat e auditimit duhet të jenë të vendosura për çdo angazhim dhe duhet gjithmonë të bazohen në rezultatet e vlerësimit të rrezikut.

Objektivat kryesore të auditimit të cilat duhet ti kenë parasysh auditorët gjatë auditimit janë:

☑ Nëse aktivitetet bankare janë duke u kryer në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret, politikat dhe procedurat në fuqi, sepse vetëm në këtë mënyrë kompanitë mund të arrijnë drejt caqeve të dëshiruara dhe vetëm në këtë mënyrë mund të arrihen rezultatet e dëshiruara të politikave financiare dhe ekonomike,
☑ Nëse aktivitetet bankare në proces kanë për qëllim dhe funksionojnë për ngritjen e profitit të kompanisë,
☑ Nëse aktivitetet bankare kanë për qëllim që të rrisin çdo herë e më shumë reputacionin e kompanisë,

Fushëveprimi i Auditimit të Brendshëm

Fushëveprimi i auditorit të brendshëm në çdo institucion po edhe në bankë përkufizohet përmes nëntë hapave të auditimit të brendshëm të cilët janë rezultat i vlerësimit të rreziqeve bankare, funksionimit të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në bankë.

Rreziqet Bankare

Gjithmonë ekzistojnë mundësia që një ngjarje specifike të ndodhë brenda një periudhe specifike apo në rrethana specifike, varësisht prej rrethanave dhe kjo mund të jetë frekuencë apo probabilitet.

Gjithmonë ekziston mundësia e një ngjarjeje të pafavorshme, situate fizike me potencial të lëndimeve njerëzore, dëmtimit të pronës, dëmtimit të mjedisit apo ndonjë kombinim i tyre.
Duke u bazuar në përvojën nga e kaluara rreziqet kryesore me të cilat ballafaqohen bankat janë:

Rreziku Strategjik është ndikimi aktual dhe i ardhshëm në fitimin apo kapitalin që vjen si rrjedhojë e vendimeve të pafavorshme të biznesit, implementimi i gabuar i vendimeve apo pamundësia e përgjigjes ndaj ndryshimeve industriale.
Rreziku Reputacional është ndikimi aktual dhe i ardhshëm në fitimin apo kapitalin që vjen nga opinioni negativ i publikut.
Rreziku Ligjor është rreziku aktual dhe i ardhshëm në fitimin apo kapitalin që vjen nga shkelja apo mosnënshtrimi i ligjit, rregullave, rregulloreve, praktikave të përshkruara, politikave të brendshme apo standardeve etike.
Rreziku i Kredisë – Rreziku i mospagimit të huamarrësit apo dështimit të performimit.
Kredia e mirë përfshin një seri të faktorëve: politika të qarta, zbatim të politikave, kontrolle të vlefshmërisë së kredisë, analiza të rreziqeve përfshirë koncentrimin, monitorimin dhe rishikimin, përcaktimin e kufijve, pjesëmarrjen e menaxhmentit.
Rreziku i Tregjeve – Ndryshimin në vlerën e tregut të portofolios së bankës dhe shkaqet e kanosjes së bankës nga ky rrezik janë: normat e kamatës, normat e këmbimit të huaj, paanësia, marrëveshja dhe çmimet e mallrave, paqëndrueshmëria dhe shpërndarjet kreditore, përcaktimi i sasisë së rrezikut bazuar në pritjet duke siguruar se tregtia mbetet brenda partnerëve të dakorduar, menaxhimi i pavarur (nga tregtarët), shënjimi i tregut në baza ditore etj.
Rreziku i Likuiditetit – Banka pranon depozita dhe i huazon ato dhe si pasoj bilanci i rrjedhave të të hyrave dhe të dalurave mund të jetë delikat, banka mund të ketë probleme tradicionale të rrjedhës së parave, kthimi i të ardhurave të parave të gatshme nëse huazohen, norma e kamatës më e lartë për më pak fonde të likuiditetit pastaj cikli i rrjedhës së parasë etj.
Rreziku Operacional – Gjatë punës operative të cilën bankat e kryejnë çdo ditë mund të kanosen nga rreziqe operacionale të cilat mund të jenë të natyrave të ndryshme, p.sh. lejimet e kredive, hapjet e llogarive, sistemimet e dokumentacionit etj.
Rreziku i Mashtrimit – Pavarësisht tendencës për vendosjen e një sistemi të mirëfilltë të kontrollit të brendshëm gjithmonë ekziston mundësia e mashtrimit të një kompanie qoftë nga personat e brendshëm apo të jashtë dhe mashtrimet e tilla mund ti shkaktojnë kompanisë humbje të mëdha qoftë financiare po në disa raste edhe deri në falimentim, apo edhe përgjigje dhe dënime të mëdha para organeve kompetente të gjyqësisë.

Kontrolli i Brendshëm

Për të kuptuar rolin e sistemit të kontrollit të brendshëm në banka duhet të bazohemi ne 13 parimet e përgjithshme të kontrollit të brendshëm:

❑ Bordi i drejtorëve duhet të ketë përgjegjësi për aprovimin dhe rishikimin periodik të strategjive të përgjithshme të biznesit dhe politikave të rëndësishme të bankës dhe të kuptojë rreziqet kryesore të udhëhequra nga banka. Bordi është së fundi përgjegjës për të siguruar se një SKB (Sistem i Kontrollit të Brendshëm) adekuate dhe efektive është vendosur dhe mirëmbajtur.
❑ Udhëheqësia e lartë duhet të ketë përgjegjësi për implementimin e strategjive dhe politikave të aprovuara nga bordi, të vendosë politika të duhura të kontrollit të brendshëm dhe monitorim të përshtatshmërisë dhe efektshmërisë të sistemit të kontrollit të brendshëm.
❑ Bordi dhe udhëheqësit e lartë janë përgjegjës për promovimin e standardeve të etikës dhe integritetit të lartë, dhe për themelimin e një kulture brenda organizatës e cila thekson dhe demonstron të gjithë niveleve të personelit, rëndësinë e kontrolleve të brendshme.
❑ Një SKB efektive kërkon që rreziqet materiale që mund të ndikojnë negativisht në arritjet e qëllimeve të bankës të njihen dhe vazhdimisht të vlerësohen. Ky vlerësim duhet të zbulojë të gjitha rreziqet që i kanosen bankës (kredia, shteti, transferi, tregu, kamata, likuiditeti, rreziqet operative, ligjore dhe reputacionale).
❑ Aktivitetet e kontrollit duhet të jenë pjesë e integruar e aktiviteteve ditore bankare. Një SKB efektive kërkon vendosjen e strukturës së kontrollit të duhur, me aktivitete të kontrollit të definuara në çdo nivel të punës.
❑ Një SKB efektive kërkon ekzistimin e ndarjes së duhur të detyrave dhe se personelit nuk i caktohen detyra konfliktuese.
❑ Një SKB efektive kërkon ekzistimin e të dhënave të brendshme adekuate dhe gjithëpërfshirëse financiare, operative dhe të pajtueshme, si dhe informata të tregut të jashtëm mbi ngjarjet dhe kushtet që janë relevante për vendim marrje.
❑ Një SKB efektive kërkon ekzistimin e sistemeve të besueshme informative që mbulojnë të gjitha aktivitetet e rëndësishme të bankës.
❑ Një SKB efektive kërkon kanale efektive të komunikimit për të siguruar se i tërë stafi plotësisht i kupton dhe pajtohet me politikat dhe procedurat që ndikojnë në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
❑ Efektshmëria e përgjithshme e kontrollit të brendshëm të bankës duhet të monitorohet në baza të vazhdueshme.
❑ Duhet të ekzistojë një kontroll i brendshëm efektiv dhe gjithëpërfshirës i sistemit të kontrollit të brendshëm i udhëhequr nga një staf operativisht i pavarur, i trajnuar si duhet dhe kompetent.
❑ Mungesat e kontrollit të brendshëm, të identifikuara nga linja e biznesit, auditori i brendshëm apo personeli tjetër i kontrollit, duhet të raportohet me kohë tek niveli adekuat i udhëheqësisë dhe të qaset me shpejtësi.
❑ Mbikëqyrësit duhet të kërkojnë që të gjitha bankat, pavarësisht nga madhësia, të kenë një sistem efektiv të kontrolleve të brendshme që është në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rrezikun e pandarë në aktivitetet e brenda dhe jashtë fletës së bilancit dhe që i përgjigjet ndryshimeve të mjedisit dhe kushteve të bankës.

Auditimi i Brendshëm

Gjithashtu një Auditor i Brendshëm për të arritur rezultatet e synuara drejt përmirësimit të operacioneve bankara duhet tu përmbahet 20 parimeve në bazë të të cilave duhet të punoj një auditori i brendshëm në bankë:

❑ Bordi i drejtorëve të bankës mban përgjegjësinë për të siguruar se udhëheqësia e lartë themelon dhe mirëmban një sistem adekuat dhe efektiv të kontrolleve të brendshme (SKB). Së paku një herë në vit, bordi duhet të rishikojë SKB-në.
❑ Udhëheqësia e lartë e bankës është përgjegjëse për zhvillimin e proceseve që identifikojnë, mesin, monitorojnë dhe kontrollojnë rreziqet e shkaktuara nga banka. Udhëheqësia e lartë duhet së paku një herë në vit të raportojë tek bordi mbi fushëveprimin dhe përformancën e SKB-së.

❑ Auditimi i brendshëm është pjesë e monitorimit të vazhdueshëm të sistemit të kontrolleve të brendshme të bankës, sepse ai ofron vlerësim të pavarur të përshtatshmërisë, dhe pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e themeluara të bankës. Si i tillë, ai ndihmon udhëheqësin e lartë dhe bordin në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre.
❑ Çdo bankë duhet të ketë funksion të përhershëm të auditimit të brendshëm.
❑ Udhëheqësia e lartë duhet t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme ashtu që banka në mënyrë të vazhdueshme të mund të mbështetet në funksionin adekuat të auditimit të brendshëm, i përshtatshëm me madhësinë dhe natyrën e veprimet e bankës. Këto masa përfshijnë ofrimin e resurseve dhe plotësimin e duhur me personel.
❑ Auditimi i brendshëm bankar duhet të jetë i pavarur prej aktiviteteve të audituara dhe nga veprimet e proceseve të përditshme të kontrollit të brendshëm.
❑ Çdo bankë duhet të ketë statut të auditimit të brendshëm e cila do të rrisë pozitën dhe autoritetin e auditimit të brendshëm brenda bankës.
❑ Auditimi i brendshëm duhet të jetë objektiv dhe i paanshëm, që do të thotë të jetë në pozitë të përmbush detyrat e tij pa ndërhyrje.
❑ Kompetenca profesionale e çdo auditori të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm si tërësi është e domosdoshme për funksionim të mirëfilltë të auditimit të brendshëm.
❑ Çdo aktivitet dhe çdo entitet i bankës duhet të jetë brenda fushëveprimit të auditimit të brendshëm.
❑ Auditimi i brendshëm kryen rishikim të rregullt dhe të pavarur të sistemit të menaxhimit të rrezikut të zhvilluar nga banka për të ndërlidhur rrezikun me nivelin e kapitalit të bankës dhe metodën e themeluar për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat e brendshme kapitale.
❑ Auditimi i brendshëm përfshin hartimin e planit të brendshëm, ekzaminimin dhe vlerësimin e informatave të disponueshme, publikimin e rezultateve dhe rekomandimet vazhduese.
❑ Kreu i auditimit të brendshëm duhet të jetë përgjegjës për të siguruar se auditimi i brendshëm është në pajtueshmëri me parimet e shëndosha të auditimit të brendshëm.
❑ Mbikëqyrësit duhet të vlerësojnë punën e auditimit të brendshëm dhe, nëse janë të kënaqur, mund të mbështeten në të për të identifikuar fushat e rrezikut potencial.
❑ Mbikëqyrësit duhet të kenë konsultime të herëpashershme me auditorë të brendshëm për të diskutuar fushat e identifikuara të rrezikut dhe masat e ndërmarra.
❑ Mbikëqyrësit inkurajohen për të aranzhuar diskutime të rregullta të çështjeve të politikave me krerët e auditimit të brendshëm të bankave nën mbikëqyrjen e tyre.
❑ Mbikëqyrësit duhet të inkurajojnë konsultime në mes të auditorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm në mënyrë që bashkëpunimi i tyre të bëhet sa më efikas dhe efektiv që është e mundur.
❑ Puna e kryer nga ana e auditorit të jashtëm për mbikëqyrësin duhet të jetë në baza ligjore apo kontraktuese. Çdo detyrë e caktuar auditorit të jashtëm nga mbikëqyrësi duhet të jetë plotësim i punës së tij të rregullt dhe duhet të jetë brenda kompetencave të tij.
❑ Bashkëpunimi në mes të mbikëqyrësit, auditorit të jashtëm dhe auditorit të brendshëm ka për qëllim ngritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë së të gjitha palëve të përfshira. Bashkëpunimi mund të jetë i bazuar në takime periodike.
❑ Krijimi i Komisionit të përhershëm të Auditimit është zgjidhje për Bordin për të siguruar ekzistencën dhe mirëmbajtjen e një sistemi adekuat të kontrolleve të brendshme. Një komision i tillë përforcon sistemin e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm dhe të jashtëm.
❑ Pavarësisht nëse aktivitetet e auditimit të brendshëm mbeten pa burime, Bordi dhe udhëheqësia e lartë mbesin përfundimisht përgjegjëse për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm dhe auditimi i brendshëm janë adekuat dhe funksionojnë në mënyrë të efektshme.

Hapat e procesit të auditimit

Për ta përfunduar një proces të auditimit, një auditor duhet të kaloj nëpër disa hapa të auditimit të cilat janë të listuara më poshtë:
1 → Zgjedhja e objektit të auditimit
2 → Planifikimi i angazhimit të auditimit
3 → Studimi preliminar
4 → Analiza (vlerësimi) i përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm

5 → Vlerësimi i efektshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm
6 → Zhvillimi i zbulimeve dhe rekomandimeve
7 → Raportimi i auditimit dhe shpërndarja
8 → Monitorimi i rezultateve (përcjellja)
9 → Vlerësimi i auditimit të kryer

Auditimi i funksioneve kyçe në bankë

Auditimi i funksionit të depozitave - Në mënyrë që të kuptojmë më qartë rëndësinë e auditimit të funksioneve të depozitave duhet të fillojmë qysh në hapin e parë, e që është hapja e llogarisë që ka të bëjë me kontaktin e parë dhe marrëveshjen e parë që klienti bënë me bankën. Hapja e llogarisë përfshinë lloje ndryshme të llogarive të cilat ofrojnë kushte të ndryshme për mbajtjen e depozitave të klientëve të bankës, si dhe pjesa më e rëndësishme e funksionit depozitues të bankës pengimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Auditimi i funksionit të kredive - Auditimi i funksioneve të kredive mund të bëhet vetëm atëherë kur kemi plotësisht të qartë përkufizimin se çka është kredia, çfarë lloje të kredive kemi si dhe hapat e ciklit të kredisë. Duke mos anashkaluar rendësin e asnjë auditimi të funksioneve të bankës mund të themi se funksioni i kredisë paraqet një njësi shumë të rëndësishme të funksionimit të bankës.

Kontrollimi dhe auditimi i Teknologjisë Informatike - Auditimi i SI-ve: procesi i grumbullimit dhe vlerësimit të dëshmive për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, mirëmban integritetin e të dhënave, mundëson arritjen e synimeve organizative në mënyrë efektive, dhe përdor resurset në mënyrë të efektshme.

Auditimi i funksioneve të tregjeve të thesarit / kapitalit - Me qëllim të identifikimit të hapave dhe pikave kyçe për auditimin e funksioneve të tregjeve të thesarit\kapitalit do të shtjellojmë limitet, sistemin e komunikimit me qëllim të tregtimit në tregjet e kapitalit, rreziqet me të cilat kanoset ky aktivitet dhe mbi të cilin duhet të bazohet auditimi, pastaj objektivat, llojet dhe përgatitja e auditimit.

Auditimi i funksionit të kontabilitetit - Auditimi i funksioneve të kontabilitetit duhet fillimisht të kuptoj se si funksionon departamenti i kontabilitetit, cilat janë karakteristikat e kontabilitetit të bankës, si funksionojnë aplikacionet e kontabilitetit, cilat janë proceset e kontabilitetit, parametrat e aplikacionit, si bëhet procedimi i protokollit dhe çka duhet të përfshijë programi i auditimit.

Auditimi i deklaratave financiare të bankës - Me qëllim të arritjes së një opinioni të arsyeshëm auditori i brendshëm gjatë auditimit të deklaratave financiar të bankës duhet të ketë parasysh karakteristikat e deklaratave financiare të bankës, transparenca e deklaratave financiare, cilat janë kriteret për standardet e kontabilitetit, pasqyrimi sipas IFRS-së, përputhshmëria sipas parimeve të kontabilitetit si dhe raportimi sipas rregullatives së BQK-së.

Roli i Auditimit të Brendshëm në përmirësimin e operacioneve bankare

Aktivitet të pavarur dhe objektiv të ofrimit të sigurisë dhe këshillëdhënës, të dizajnuar që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë aktivitetet operative të një organizate. Ndihmon organizatën që të përmbushë objektivat e saj duke sjellë qasje sistematike për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të rrezikut, kontrolli dhe procesit të qeverisjes.

Gjatë punës operative të cilën bankat e kryejnë çdo ditë mund të kanosen nga rrezik operacionale të cilat mund të jenë të natyrave të ndryshme p.sh. Lejimet e kredive, hapjet e llogarive, sistemimet e dokumentacioneve etj.

Me qëllim të përgjithësimit të auditimit të brendshëm do ta përmbledhim në tri hipoteza bazike të cilat ngërthejnë në vete aktivitetet dhe synimet bazë të punës së auditorit të brendshëm në një institucion, apo në veçanti rolin e auditimit në përmirësimin e operacioneve bankare:

→ Roli i auditimit të brendshëm në përmirësimin e menaxhimit të rrezikut,
→ Roli i auditimit të brendshëm në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm,
→ Roli i auditimit në përmirësimin e proceseve qeverisëse,

Qëllimi kryesor i auditorit të brendshëm në një kompani e që në rastin tonë të studimit është institucion bankar është të hetoj dhe vlerësoj efektivitetin me të cilin njësitë e ndryshme të kompanisë janë duke i kryer detyrat e tyre të caktuara. Por mbi të gjitha aktivitet kyç i auditorit është studimi dhe vlerësimi i kontrolleve të brendshme duke pas parasysh se funksionimi efektiv i kontrollës së brendshme nënkupton në mënyrë të drejtpërdrejtë menaxhim më të mirë të rrezikut dhe arritje më të sigurt dhe më të shpejtë në objektivat e përcaktuara.

Përmbledhje dhe Përfundime

Auditimi i brendshëm ka një rol kyç në menaxhimin e një institucioni bankar, sepse ofron një siguri objektive mbi kontrollet dhe menaxhimet e rrezikut. Auditimi i brendshëm është një aktiviteti i pavarur, i sigurisë objektive dhe konsultuese i dizajnuar për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet bankare.

Auditimet operacionale janë auditime të proceseve operacionale të bankës të cilat mund të kontrollojnë vetëm faktin nëse është duke u vepruar në përputhje me kontrollet e brendshme, por që në të njëjtën kohë kontrollojnë edhe efektivitetin e kontrolleve si pjesë e procesit të menaxhimit të rrezikut. Auditorët e brendshëm duhet të posedojnë njohuri, zotësi dhe aftësi tjera të nevojshme për ti realizuar përgjegjësitë e tyre individuale.

Auditori i brendshëm duhet të ketë njohuri të mjaftueshme për të identifikuar indikatorët e mashtrimeve por nga ai nuk pritet të ketë ekspertizë të një personi, përgjegjësia kryesore e të cilit është identifikimi dhe investigimi i mashtrimeve.

Parimet kryesore të cilat duhet ti respektojnë auditorët për të qenë etik gjatë punës janë:

-Integriteti
-Objektiviteti
-Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur
-Konfidencialiteti
-Sjellja në mënyrë profesionale

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut, aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të cilat kanë të bëjnë me qeverisjen e organizatës, operacionet dhe sistemet informative. Kjo duhet të përfshijë:

-Besueshmërinë dhe integritetin e informatave financiare dhe operative.
-Efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve.
-Ruajtjen e aseteve.
-Pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe kontratat.

Për të kuptuar më saktësisht se si auditimi i brendshëm ka rol të rëndësishëm në përmirësimin e operacioneve bankare duhet ta kuptojmë rolin e auditimit të fokusuar në tri degë të cilat në mënyrë të tërthortë janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe ato janë, roli i auditimit të brendshëm në:

→ Përmirësimin e menaxhimit të rrezikut,
→ Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe
→ Përmirësimin e proceseve qeverisëse.

Menaxhimi i mirëfilltë i rrezikut me qëllim të minimizimit të tij, krijimi i një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm dhe një proces qeverisës adekuat janë çelës i suksesit të një institucioni financiar (banke) dhe dëshmi e kontributit të madh të auditimit të brendshëm në suksesin e bankës.
Katër sfidat kryesore që ballafaqojnë auditimin e brendshëm:

→ Roli i ardhshëm i auditimit në pritjet e qeverisjes së bankës dhe të bartësve,
→ Adresimi i propozimit të vlerës së shtuar përmes përqendrimit të në proceset e kontrollit, menaxhimit të rrezikut dhe të qeverisjes,
→ Sigurimi dhe mirëmbajtja e kompetencave të kërkuara për të ofruar shërbim të vlerës së shtuar,
→ Vlerësimi periodik i këtyre kompetencave nga palët e jashtme.

Elementet e kompetencës:

→ Zhvillo një mirëkuptim të rreziqeve të bankës
→ Zhvillo mirëkuptim të përshtatshmërisë dhe efikasitetit të strategjive të kontrollit, strukturës dhe sistemeve të bankës
→ Kontribuo në përmirësimin e rreziqeve të kontrolluara nga bankat, menaxhimin e rrezikut dhe procesin e qeverisjes
→ Ofro siguri të vazhduar se organizimi është në kontrollin përkatës ndaj rreziqeve
→ Menaxho auditimin e brendshëm brenda kontekstit të organizatës dhe në pajtueshmëri me Standardet e IIA

Në mënyrë që puna e auditorëve të brendshëm të ketë rol të rëndësishëm në përmirësimin e operacioneve bankare auditorët e brendshëm duhet gjithmonë të përqendrohen në 4 fusha kyçe dhe ato janë:

"Zbatimi i auditimit bazuar në rreziqe",
"Përqendrimi në pritjet e bartësve",
"Ofrimi i shërbimeve të sigurisë pro aktive" dhe
"Koncentrimin në aktivitetet e vlerës së shtuar".

Referenca dhe literatura e shfrytëzuar

A. Jakupi, Ligjërata të autorizuara, Metodologjia e punës shkencore kërkimore, 2005
ACCA dhe SCAAK, Auditimi i Avancuar, 2009
ACCA dhe SCAAK, Praktika Profesionale, 2009
ACCA dhe SCAAK, Raportimi financiar i avancuar, 2009
B. Scott Parsowith, Fundamentals of Quality Auditing, 1995
E. Boce, Si të shkruajmë një punim kërkimor, 2004
E. M. Shont, Internal Bank Auditing, 1982
G. Luboteni, Banka dhe Afarizmi Bankar, 2002
G. Luboteni, Menaxhmenti Bankar, 2003
I. Gray and S. Manson, The Audit Process: Principles, Practice and Cases, 2007
J. P. Russell, The Process Auditing Techniques Guide, 2003
K. F. Reding; Ph.D.; CIA; CPA; CMA; Paul J. Sobel; CIA; CPA; Urton L. Anderson; Ph.D.; CIA; CCSA; CGAP; Michael J. Head; CIA; CPA; CISA; Sridhar Ramamoorti; Ph.D.; CIA; CPA; CFE; CFSA; CGAP; Mark Salamasick; CIA; CISA; CSP; Contributing Writer;Cris Ridd, Richard Tuschman, Internal Auditing: Assurance and Consulting Services, 2007
K. H. Spencer Pickett , Audit Planning: A Risk-Based Approach – Hardcover, 2006
O.Ray Whittington, CIA, CMA, CPA, De Paul University, Kurt Pany, CFE, CPA Universiteti Shtetëror I Airzonës, " Parimet e Auditimit & Shërbimet e tera të sigurisë, 2010, Arizona, faqe 864
R. Hightower, Internal Controls Policies and Procedures, 2009
R.P. Gupta, D.P. Gupta, Risk Based Internal Audit In Banks, 2004

S. Komoni, Financa, 1976
W. F. Messier, JR, Revizija Prirucnik za revizore i studenta, Zabreg 2000
Xh. Shatku, Paraja dhe Aktiviteti Ekonomik, 2004

Burime tjera:

D. Casier - Head of Division, Internal Audit unit at National Bank of Belgium, Trajnim në Shoqatën e Bankave të Kosovës, Auditimi i funksioneve kyçe në banka, 2006
J. Grosjean - ATTF Research Director, Trajnim në Shoqatën e Bankave të Kosovës, Auditimi i Brendshëm dhe i Jashtëm, 2007
Y. Mathieu - Board and Executive Committee Member at Ethias Bank, Trajnim në Shoqatën e Bankave të Kosovës, Menaxhimi i riskut global, 2009
Rregulla mbi Sistemin e Kontrollit të Brendshëm Autorizuar sipas Nenit 46 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21 dhe Nenit 42 të Ligjit mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Burime nga interneti:

http://bank.bankrate.com/
http://riskrewardlimited.com/?gclid=CKPDnIGGzaICFQZgZwodFjHQxQ
http://siteresources.worldbank.org/WBI/Resources/Internalaudit.pdf
http://www.accaglobal.com/
http://www.bkt.com.al/
http://www.bls.gov/oco/ocos001.htm
http://www.bpbbank.com/
http://www.bqk-kos.org/
http://www.cimaglobal.com/
http://www.ecb.int/home/html/index.en.html http://www.bankofalbania.org/
http://www.ehow.com/
http://www.fatf-gafi.org/
http://www.ifac.org/
http://www.internal-auditor.com/
http://www.isaca.org/
http://www.mifc.com/
http://www.minfin.gov.al/http://www.pdfound.com/pdf/auditimi-i-brendshem-ne-banken-raiffeisen.html
http://www.scaak-ks.org/
http://www.theiia.org/training/index.cfm?act=seminar.detail&semID=160
http://www.treasury.gov.my/

MSC. MUHAMET HALILI – NDIKIMI I FAKTORËVE TË RRETHINËS NË VENDIM-MARRJEN AFARISTE

MSC. MUHAMET HALILI

Abstrakt

Ky punim ka synim trajtimin e faktorëve që ndikojnë për marrjen e një vendimi, sa më të drejtë në momentin dhe kohën e duhur në mënyrë që ndërmarrjet të ken një siguri më të lartë në afarizimin e tyre.
Objektiv themelor i punimit është që përmes tij të indentifikojë ndikimet më të rëndësishme të faktorëve të mjedisit apo rrethinës në vendimmarrje. Por njëkohësisht marrësit e vendimeve ose menaxherët të informohen dhe të dinë se si të merren vendimet më të drejta dhe kualitative.
Faktoret e mjedisit janë një llojë predispozuesi për marrjen e vendimeve nga menaxherët e ndërmarrjeve, por gjithnjë duke pasur parasysh edhe rreziqet të cilat mundë të paraqiten gjatë procesit të vendimmarrjes.

Hyrje

Sa herë të flasim për vendosjen dhe faktorët që ndikojnë në të, duhet kujdesur edhe për një dimension të rendësishëm, e ky deminsion mund të përmblidhet si dallimet kulturore të vendeve të caktuar. Për këtë arsye ndodh që vendosja për probleme të njejta, ndryshon nga vendi në vend varsisht nga specifikat kulturore të vendeve të caktuar.

Faktorët e rrethinës që ndikojnë në vendimmarrje janë: Faktorët shoqëror-social, Faktorët kulturor, Faktorët politik, Faktorët juridik, Faktorët ekonomik, Faktorët teknologjik, Faktorët ekologjik, Konkurrenca dhe tregu si faktor.

Faktorët shoqëror-social

Faktorët shoqëror kanë të bëjnë me atë se secila shoqëri i ka normat e veta morale dhe normat e shkruara të cilat janë norma që bazohen në vlerat universale të njeriut, por që përmbajnë edhe specifikat e secilës shoqëri konkrete.

Në faktorët shoqëror e veqanarisht në faktorët social përfshihen vlerat, besimet, qëndrimet, opinionet dhe mënyra e jetesës së individeve që bëjnë pjesë në rrethinën e organizatës.

Faktorët social ndryshojnë me një shpejtësi të madhe pra janë dinamik si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të individeve për rritjen e mirëqenjës së tyre, duke synuar që ti realizojnë ambiciet individuale në përputhje me nivelin e ambientit që i rrethon, pra një ndikim interaktiv kanë këto përpjekje për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të tyre.

Faktorët shoqëror ndikimin më të madh në ndërmarrje e bëjnë përmes kërkesave që ka shoqëria lidhur me përmirsimin e kualitetit të jetës. Parashikimi i faktorëve social në veprimtarin e ndërmarrjes nuk është një punë e lehtë. Mbledhja e informatave për ndikimin e faktorëve social është një punë shumë e vështirë.

Por marrja në konsideratë e variantave të mundëshme që paraqiten, ndërmarrjen e ndihmon në formulimin sa më afër realitetit të objektivave të ndërmarrjes.

Faktorët kulturor

Kultura është një koleksion besimesh, shpresash me vlera të mishëruara me antarët e shoqërisë dhe që transmetohet brez pas brezi. Secila organizatë në rrethinën ku vepronë duhet ta njoh mirë kulturën dhe specifikat e rrethinës.

Ndër faktorët më të rendësishëm kulturor janë: vlerat, besimet, supozimet (shpresat), organizimi familjarë (madhësia e familjes), solidariteti, besa, lidhjet farefisnore etj.

Gjatë vlersimit të zhvillimit të organizatës gjithmonë menaxherët duhet të kenë parasysh përpilimin e strategjisë zhvillimore me kulturën e rrethinës. Mirëpo menaxhmenti gjatë procesit të vendimmarrjes nuk guxon të ndikohet vetëm nga faktorët kulturor. Pra vendimmarrësit nuk do të injorojnë faktorët kulturor, por nuk do ti marrin vendime në kundërshtim me strategjinë dhe objektivat e ndërmarrjes. Pra do të merren vedime që tregojnë përpjekje të përshtatjes së këtyre faktorëve me trendët bashkohor të zhvillimit të shoqërisë.

Një vendimmarrës i kujdesshëm duhet të krahasoj përqindjen e rrezikut me përqindjen e fitimit, kur injorohen ose faktorizohen faktorët kulturor në procesin e vendosjes.

Faktorët politik

Shumë menaxherë u kushtojnë rëndësi të njëjtë si faktorët ekonomik edhe faktorëve politik. Ata mendojnë se suksesi i ndërmarrjes varet në një shkall të lartë nga faktorët politik si madhësia e buxhetit të qeverisë, tatimet, shpenzimet për administratë, për arsim për shëndetësi, siguria për investime etj.

Pastaj faktorë shumë i rëndësishëm politik është edhe reputacioni i vendit në arenën ndërkobëtare dhe marrveshjet tregtare, pastaj kufizimet doganore subvencionet si dhe masat mbrojtëse për prodhuesit vendorë.

Faktorët politik e përcaktojnë parametrat ligjor dhe rregullues mbrenda të cilave ndërmarrja duhet të veprojë. Faktorët politik vërtetë janë të shumtë që vendimmarrësit duhet të i kenë parasysh.

Shumë vendime kur merren duhet ti kenë parasysh ligjet anti trust programe të taksave, politikat dhe programet e mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, mbrojtjen e konsumatorëve etj. Në përgjithsi faktorët politik ndikojnë në uljen e mundësive ponteciale të ndërmarrjeve për fitim por krahës këtyre ka edhe veprime politike që janë në favor edhe mbrojtje të intersesave të ndërmarrjeve.

Pra vendimmarrësit duhet të dijnë të i shfrytzojnë favorët që sjellin faktorët politik dhe ti minimizojnë pengesat eventuale.

Faktorët juridik

Faktorët juridik në procesin e vendimmarrjës me zhvillimet e fundshekullit të kaluar mund të themi se janë bërë më të lehtë që të parashikohen. Kur e them këtë mendoj në ndryshimet e mëdha politike në Evropën Lindore.

Me ndërrimet në sistemet shoqërore dhe me ardhjen në fuqi të kapitalizmit ku është legjitimuar me ligje ekonomia e trgut, rregullat e sjelljes dhe ekonomizmit të ndërmarrjeve janë mjaftë të qarta, dhe njëkohsisht janë mjaftë të favorshme në shumicën e situatave.

Faktorët juridik më së shumti ndërlidhen me rrjetin e ligjeve të cilat shpesh nuk mund të përcjellin zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimet dinamike që sjell progresi shkencorë- teknologjik.

Nga vendimmarrësit kërkohet që t'i njohin kufizimet juridike dhe kërkesat në raport me veprimet e ligjeve. Natyrisht shumë vendimmarrës gjatë marrjes së shumë vendimeve kërkojnë medimin e juristëve. Në shumë fusha ligjet përparojnë në përputhje me zhvillimin ekonomik shoqërorë por ka fusha ku zhvillimi i këtyre ligjeve nuk mund ta përcjellë këtë zhvillim dinamik.

Pra procesi i vendimmarrjes ndikon në faktorët juridik por nga menaxherët vendimmarrës kërkohet që të ndërtojnë një strategji të përcjelljes së zhvillimeve në këtë fushë dhe njëkohësisht të minimizojnë kufizimet dhe ndikimet që vështirësojnë arritjen e qëllimit të organizatës.

Faktorët ekonomik

Vendimmarrja ndikohet nga faktorët ekonomik jashtëzakonisht shumë. Ata ndikojnë përmes natyrës dhe drejtimit ekonomik ku ndërmarrja zhvillon aktivitetin e saj.

Vendimmarrja duhet të merr konsiderat prirjet ekonomike të segmenteve të tregut në industrin e saj. Faktorët ekonomik janë shumë të rëndësishëm për suksesin e një ndërmarrje apo industrie.. Shumica e ndërmarrjeve ndër objektivat më të rendësishëm e ka maksimizimin e fitimit.

Ky objektiv varet në mas të madhe nga kualiteti i vendimeve, por edhe nga mjedisi industrial në të cilin vepron ndërmarrja. Pra në këtë rast shihet se faktorët ekonomik janë faktorë të rrethinës, të cilat janë jashtë kontrollit të ndërmarrjes. Niveli i zhvillimit ekonomik ndikon direkt përmes këtyre faktorëve në disa mënyra. Stadi i ciklit ekonomik ndikon drejtpërdrejt në nivelin e invesitmeve dhe shitjeve. Shumë më lehtë është të rritesh shitjet në një koh të lulzimit ekonomik se sa gjatë kohës së rënjes ekonomike.

Andaj ndikimi i faktorëve ekonomik është i favorshëm për ndërmarrjen, por ndikimi i këtyre faktorëve është negative gjatë periudhës së rënies ekonomike.

Produktiviteti relative i ekonomisë, partneriteti i konkurrenteve, efektet e këmbimit import-export janë disa faktorët ekonomik që ndikojnë drejtpërdrejt në vendimmarrje. Nuk duhet përjashtuar edhe ndikimin faktorëve ekonomik ndërkombëtar.

Andaj parashikimi edhe vlersimi i ndikimit të faktorëve ekonomik është pjesa ma kritike e procesit të vendosjes. Parashikimi i ndikimit të faktorëve ekonomik ka të bëj me konditat mjedisorë ekonomike, të ardhurat për frymë, indeksi i çmimit të konsumatorit, raportet e pagave dhe produktivitetit që të gjitha të dhënat për këta faktorë mund të merren nga burimet biznesore dhe qeveritare.

Mirëpo mund të mbështetemi edhe të tendencat historiko ekonomike, por gjithmonë duke pasur parsysh kushtet edhe rrëthina ekonomike nuk mbetet e pa ndyshuar. Përveç faktorëve të lartpërmendur të vendimmarrësit duhet vlersojnë edhe opinionet e konsumatorëve në lidhje me produktet dhe shërbimet.

Kjo arrihet përmes pyetësorëve që shërbejnë për mbledhjen e të dhënave, por ata pyetësor janë të vështirë për tu hartuar dhe nga vendimmarrësit kërkohet shkathtësi dhe kohë për tu dizajnuar.

Nga e tëra që u tha shihet se ndikimi i faktorëve ekonomik në vendimmarrje është jashtëzakonisht komplekse. Faktorët ekonomik me ndikim janë: kapitali, çmimi i punës, politika fiskale dhe tatimore dhe fuqia blerëse.

Faktorët teknologjik

Një ndryshim tekologjik në rrethinën e ndërmarrjes shkakton efekte të papritura. Për vendimmarrësin, parashikimet për progresin teknologjik dhe vlerësimi i efektit të tij, mbi veprimtarin janë shumë domethënëse. Vendimet afariste gjithmonë duhet të parashikojnë ndryshimet teknologjike që influencojnë në aktivitetet e ndërmarrrjes.

Duhet të merren vendime që mund të shmangin vjetërsimit para kohe të makinerive dhe paisjeve që e nxisin novacione ose përshtatjet teknologjike, që krijonë mundësi për prodhimin e produkteve të reja, për përmirësimin e produkteve ekzistuese dhe me këtë sjell krijimin e tregjeve për produktet e reja e cilësore. Vendimmarrësit duhet të parashikojnë edhe zhvillimet teknologjike që kanë të bëjnë me pajisjet që i kanë në përdorim. Pra mençuria e sjellë dijën, ndërsa teknologjia e shfrytzon në praktikë

sjellë dobishmëri për njeriun. Me teknologji kuptojmë dijen e gjithmbarshme që e kemi për mënyrën se si gjërat bëhen. Ndikimet e faktorëve teknologjik shihen në produktet e reja, në pajisjet e reja, materialet e reja dhe në shërbimet e reja. Faktorët teknologjik duhet orientuar në krijimin e favoreve për organizatën. Me pak kreativitet organizata mund të bëjë ndryshime të mëdha në imixhin e organizatës. Mund të kostatojmë se faktorët teknologjik ndikojnë favorshëm në ndërmarrje, nëse vendimmarrja i akordon këta faktorë me objektivat e sajë.

Dobia më e madhe ka të bëjë me rritjen e prodhimit, rritjen e standardit të jetesës, për punonjësit më shumë kohë e lirë, dhe laramani më e madhe e produkteve. Me fjalë tjera faktorët teknologjik kanë aq shumë ndikim në veprimtarinë e organizatës dhe shoqërisë, sa kanë edhe revolucionet në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë, dhe tani quhen edhe revolucione teknologjike.

Faktorët ekologjik

Ekologjia nënkupton marrëdhëniet që ekzistojnë midis njeriut e qenieve të gjalla, nga njëra anë, dhe ujit, tokës dhe ajrit, nga ana tjetër. Zhvillimi i gjithëmbarshëm i njerëzimit ka sjellë me vete edhe ndikime të dëmshme për mjedisin. Si rezultat i këtij zhvillimi sot njerëzimi ka probleme me ngrohjen globale dhe shumë sisteme ekologjike janë para shkatërrimit. Si rezultat i këtyre aktiviteteve njerëzore përherë e më shumë po kërcënohen edhe jeta e njerëzve dhe qenive të gjalla. Ndërmarrjet duke qenë kontribuesit më të mëdhenj të shkaktimit të këtyre problemeve duhet të mbajnë përgjegjësi për ruajten dhe kultivimin e ambientit.

Gjatë procesit të vendimmarrjes menaxherët ndikohen nga kufizimet e faktorëve ekologjik. Këto kufizime kanë të bëjnë me ndërhyrjet e shtetit që obligon ndërmarrjet për ruajtjen e ambienti qoftë përmes deponimit të sigurt të mbeturinave, riciklimit të tyre ose me ndalimin e prodhimit në rast se tejkalohen parametrat e paracaktuar të cilat nuk lejojnë ndotjen e ambientit ose shëndetin e njeriut apo gjallesave të tjera në përgjithësi. Shumë ndërmarrje kanë marrë vendime që zvogëlojnë fitimet nën ndikimin e faktorëve ekologjik.

Konkurrenca dhe tregu si faktor

Secila ndërmarrje duhet të ketë parasysh konkurrencën si njërin ndër faktorët e rrethinës i cili ndikon në afarizmin e sajë. Ndërmarrja e prodhimit të materialit ndërtimor, paraqitet me produktet e sajë në treg dhe ju ofron konsumatorëve të vetë kualitetin e caktuar, mirëpo duhet ditur se ka edhe prodhues të tjerë që ofrojnë produkte të ngjashme. Me këtë rast ajo përballet drejt për drejt edhe me konkurrent tjerë që mund të ofrojnë produkte të ngjashme me çmim më të lirë dhe me cilësi më të mirë. Kur dihet se konsumatorët Kosovar kanë fuqi të kufizuar blerëse, ata mund të humbin produkte të shtrenjta dhe orientohen në produkte më të lira.

Ka mundësi që në treg të paraqitet një produkt i ri i cili me sukses zëvendëson pdroduktin e vjetër dhe kështu konkurrenca e “nxjer” prej loje organizatën. Pastaj mund të ketë konkurrencë të tërthortë ku tregu ofron ndonjë produkt krejt të ri që i zëvendëson produktet aktuale.

Prandaj, vendimmarrësit është me rëndësi të përcjell informatat për gjendjen e konkurrencës së drejtpërdrejt dhe të tërthortë. Pra të përcillet struktura e kostos, formimi i çmimeve, mënyrat e promovimit, drejtimin e lëvizjes së trendëve të ndërtimit dhe aspekte tjera të konkurrencës që ndikojnë në afarizmin e ndërmarrjes. Dihet se në botën bashkëkohore konkurrenca është në rritje e sipër. Në ekonominë e tregut mbretëron një rrethin e pamëshirshme e cila (nuk ka medalje për vend të dytë).
Mirëpo, në shtete moderne janë rregulluar aq mirë mardhëniet shoqërore sa është paraparë edhe marrja e sanksioneve shumë të ashpra po që se shkelen këto rregulla.

Parashihet që konkurenca duhet të jetë e ndershme. Pra konkurenca e mirëfillt e nxit shtimin e vlerave dhe njëkohsisht mundëson produkte më cilësore dhe më të lira.

Pikërishtë për këtë shteti nuk lejon konkurrencën jo lojale, monopolin dhe format tjera të dominimit të pa ligjshëm. Prandaj edhe në procesin e vendimmarrjes këto rregulla të sjelljes kanë ndikim, sepse vendimmarrësit duhet të marrin vendime konform tyre. Rregullatori kryesor i sjelljes së ndërmarrjeve lidhur me çmimin e produkteve është tregu.

Çmimi caktohet në mënyra dhe me metoda të ndryshme, sepse në të ndikojnë faktorë të llojllojshëm. Çmimi është faktorë mjaftë i ndjeshëm për ndërmarrje dhe për konsumatorin.
Një vendim i mirë mund të ndikoj në çmim dhe të sjell fitim për ndërmarrje duke tërhequr blersit. Pra, çmimi është element që i zgjidh kontradiktat e sjelljes së prodhuesve dhe konsumatorve.
Politika e çmimeve ka për synim realizimin e synimeve të ndërmarrjes, maksimizimi e profitit dhe krijimin e shanseve të konsumatorëve që të i kenë produktet apo shërbimet e nevojshme. Ndikimi i këtyre faktorëve në vendimmarrje është i madh dhe dinamik.

Vendimmarrësit duhet të jenë të vëmendshëm që konkurrenca dhe çmimi të mos jetë penges në realizimin objektivave dhe të gjejnë zgjidhje të atilla që të kenë blerës lojal për periudha afatgjata.
Menaxherët mund të merrin vendime të mira që reduktojnë çmimet por njëkohësisht ruajn cilësin e produktit apo shërbimit. Vendimmarrësit gjithmon duhet të parashikojnë rrezikun që një ndërmarrje tjetër të hedhë në trgë një produkt me një çmim të ngjajshëm të organizates së tyre me qëllim që të pushtoj tregun, por vendimet e marra duhet t'i sigurojm organizatës avantazhe të përhershme kostoje në raport me konkurrentet.

Përfundimet

Qëllimi i këtij punimi është indentifikimi i faktorëve të rrethinës dhe shkalla e ndikimit të tyre në vendimmarrje.

Secila ndërmarrje është një sistem, secili sistem për të funksionuar, ndër të tjera duhet të jetë i hapur. Edhe vendosja në sistemet e hapura ndikohet nga faktorët e mjedisit.

Objektiv i punimit eshte që përmes këtij studimi të indentifikojë ndikimet më të rëndësishme të faktorëve të rrethinës në vendimmarrje.
Por njëkohësisht marrësit e vendimeve të informohen dhe të dinë se si të merren vendimet më kualitative, dritën e asaj se ciliët faktorë janë më me ndikim nga mjedisi.

Po ashtu vendimmarrësit përveç se duhet t'i njohin ndikimet më të rëndësishme nga rrethina, ata duhen t'i njohin edhe metodat, mënyrat dhe teknikat e vendosjes, me qëllime të minimizimit të ndikimeve negative, si dhe kthimin e kërcënimeve në përparsi për organizatën.

Po ashtu në këtë punim është trajtuar edhe ndikimi i vendimmarrjes në suksesin afarist të ndërmarrjes.

Përfundimisht para secilit akt të vendosjes duhet ditur se organizatat janë sisteme dinamike dhe të hapura, e që janë në interaksion permanent me rrethinën.

Referenca e literatures

Prof.dr. Vaselika Kume: Manaxhimi Strategjik, Tiranë, 2003
Richard.L. Daft, Dorothy Matrcic: Understanding Managment, SH.B.A. 2004
Prof.dr. Shyqeri Llaçi: Manaxhimi, Tiranë, 2002
Prof.dr. M.Kasimati, M.Manxhari: Sjellje Organizative, 2002
Samuel.C.Certo: Modern Managment
Ëarren R.Plunkett, Kaymond F.Attner: Managment, SH.B.A, 1992
Prof.dr. Ibrahim Kuka: Vendosja Afariste, Riinvest, Prishtinë, 2003
Prof.dr. Berim Ramosaj: Bazat e Menaxhmentit, Prishtinë, 2004

LIRIDONA GËRXHALIU – INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

LIRIDONA GËRXHALIU
Fakulteti Ekonomik, Kolegjin ILIRIA

Abstrakti

Si çdo vend tjetër edhe Kosova është një ndër vendet të cilat si qëllim kryesor kanë zhvillimin Ekonomik. Një ndër mundësitë apo rrugët të cilat duhet të ndjekë në arritjen e objektivave të veta janë edhe investimet e huaja direkte, të cilat kanë një rëndësi të veçantë, sidomos për vendet të cilat janë në tranzicion, siq është edhe vendi ynë.

Investimet e huaja direkte janë një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe të zhvillimit të ekonomisë. Poashtu investimet e huaja direkte përfshijnë prurjen e teknologjive e njohurive të reja në firmat vendase, rritje të konkurencës, si dhe rritjen e exporteve jashtë vendit. Gjithahstu mund të cekim se investimet e huaja direkte janë të një rëndësie të vecantë për vendët në tranzicion, sepse ndihmojnë financimin e deficitit në vend. Investimet e huaja direkte poashtu ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e pagave të punëtorëve, etj. Përveq anëve positive që kanë investimet e huaja direkte, kanë edhe anët negative, si p.sh kanë shpenzime të larta të komunikimit, udhëtimit, etj. Gjithashtu është një mundësi më e madhe e dështimit në pronësinë e një kompanie që ka kompani jashtë, etj. Pra, IHD-të kanë ndikimet e tyre në ekonomi, ndikime me efekte positive por edhe negative.

Fjalët kyqe: Motivet, investimet e huaja direkte, zhvillimi ekonomik, Kosova.

Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte luajnë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi, sidomos për vendet në tranzicion, duke u bazuar në rritje afatgjatë të kapitalit, ndryshim në strukturën ekonomike te vendit, poashtu ndikon në rritjen e aftësisë konkuruese të ekonisë së vendit ndërmjet transmetimit të teknologjisë, forcimin e infrastrukturës, rritjen e produktivitetit si dhe ndikon në gjenerim të vendëve të reja të punës. Njëkohësiahtë investimet e huaja direkte kanë një rol pozitiv në ekonominë e vendit, duke ndihumar vendin në ristrikturim të ekonomisë, njëashtu në uljen e deficitit si dhe rritjen e eksportit. Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuara në Kosovë në periudhën janar-qershor 2014 shënuan vlerën prej 38.9 milionë euro që është për 110.1 milionë euro më ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, investimet e rezidentëve të Kosovës në vende tjera ishin dukshëm më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 1.5 milionë euro253.
Vlera e ulët e investimeve të huaja direkte vie kryesisht nga shitja e aksioneve nga disa kompani të huaja të cilat operojnë në vendin tonë, të cilat iu shitën rezidentëve kosovar si dhe shpërndarjes së superdividendës nga disa prej kompanive të huaja.

Sipas Manualit të Bilancit të Pagesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Investimi Direkt është një kategori e investimeve ndërkombëtare, të cilat pasqyrojnë sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme nga një subjekt rezident i një ekonomie në një subjekt që është rezident në një ekonomi tjetër dhe ka një shkallë të konsiderueshme të ndikimit në menaxhimin e këtij të fundit".(FMN, 1993)

[253] Banka Qëndrore e Kosovës, (2015), "Raporti i Zhvillimeve Makroekonimike", Prishtinë, faqe 36

Investimet e huaja direkte kanë formën e investimeve kapitale të cilat ndahen në investime të huaja direkte si dhe në investime protofol.
Investimet e huaja direkte janë investime të cilat investitorit i japin kontrollin e kompanisë, nuk është e domosdoshme që kontrolli të jetë në formën 100% e as 50% mund të jetë edhe 49% e kontrollit ndërsa pjesa tjetër t'iu shpërndahet aksionarëve tjerë.

IHD-të janë shumë më komplekse për nga natyra sesa investimi portofol, pasi shpesh herë ato përfshijnë edhe transferimin e mjeteve bazë siç janë njohuritë teknologjike, dhe aftësitë menaxheriale dhe organizative.254 Investimet protofol jashtë vendit deri në qershor të vitit 2014, përbëjnë vlerën prej 53.4 milion euro. Ku pjesa më e madhe e këtye investimeve përbëhet nga fondet pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit.

Ekzistojnë tri mënyra për tërhjekjen e investimeve të huaja në një vend. Një nga mënyrat është që firmat e huaja të investojnë drejtëpërdrejtë në një vend. Mënyra e dytë është atëherë kur firmat investojnë nëpërmjetë huamarrjes në tregun botërorë të kapitaleve ose nëpërmjet institucioneve financiare siq është Banka Botërore. Atëherë kur vendi shfrytëzon ndihmë nga vendet e industrializuara, përdorë mënyrën e tretë për zhvillim të investimeve në ate vend. Kosova përballet me një numër të vogël të kursimeve të huaja për të ardhura për frymë (për capital)255, edhe se kursimet e huaja janë të një rëndësie të madh për një vend.

Disa nga mënyra të hyrjes së firmave në treg mund të jenë, nga ana e investimeve nga fillimi(Greenfield), nga bashkimet dhe nga ana e blerjes. Një investim nga fillimi ndodh kur një firmë, si e vetme ose së bashku me një firmë tjetër, (d.m.th., në një sipërmarrje të përbashkët) fillon aktivitet të ri në vendin pritës. Një blerje ndodh kur një firmë blen nga një pjesë (d.m.th., blerje e pjesshme) ose tërë kapitalin (d.m.th., blerje e plotë) e një firme të synuar në një vend pritës. Në përgjithësi, IHD-të mund të marrin një nga tri këto forma: investime nga fillimi (ose ndryshe në fushë të blertë), bashkime ose blerje shoqërish, si dhe krijime të shoqërive të përbashkëta256.

Motivet që i nxisin IHD-të

Duke pasur parasyshë faktin që investimet e huajaë direkte janë të një rëndësie të veçantë për një vend, njëashtu ndikojnë në zhvillim ekonomik të vendit, secili vend poashtu edhe vendi ynë bënë përpjekje që të tërhjek sa më shumë investitorë. Mirëpo, investitorët duhet të kenë motivë për të investuar në një vend. Siq e dimë secili investitorë inveson në një vend tjetër për të krijuar të ardhura më të mëdha, sesa të investonte në një vend tjetër. Çdo investirorë do të investonte në atë vend ku do ti krijonte kushte të mira për të bërë biznes.

Disa nga motivet që nxisin investitorët e huaj që të investojnë në vendin pritës, edhe pse mund të ndyshojnë nga vendi në vend, mund të jenë:
→ Madhësia e tregut dhe perspektivat e rritjes së tij;
→ Niveli i pagës dhe produktiviteti i punës;
→ Infrastruktura e mirë;
→ Stabiliteti politik dhe masat që merren për nxitjen e IHD-ve;
→ Mungesa e korrupsionit dhe nxitja e konkurrueshmërisë ndërmjet firmave;
→ Përmirësimi i mjedisit të investimeve, si: regjistrimi i biznesit, procedurat e licensimit, lehtësia e të bërit biznes, mjedisi i përshtatshëm për biznes etj. Edhe struktura e taksave mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në perspektivat e investimeve.

254 Sezer, H. (2006) "Foreign Direct Investment", in Piggott, J. and Cook, M. *International Business Economics: A European Perspective*, fq. 187
255 Badivuku-Pantina, M., (2008), "The importance of Foreing Direct Investiments on Economic Development of Kosova", Revista ndërkombëtare "Lex et Scientia", No.XV Vol.2/2008, Bucharest.
256 Zisi, A., (2014) "Ndikimi i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike dhe faktorët nxitës në përthithjen e tyre rasti i Shqipërisë", Universiteti "Aleksandër Mojsiu" Durrës.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore është një ndër alternativat e shumta që vendeve në tranzicion ndjekin për tërheqjen e kapitalit jashtë, njëashtu edhe për vendin tonë ka pasur një rëndësi të veqantë në tërheqjen e IHD-ve. Duke e ditur se ndërmarrjet kosovare nuk kanë fuqi të mjaftueshme ekonomike që do të kërkohen për shitjen e ndërmarrjeve të reja. Këta qdoher e më shumë janë duke u ballafaquar me mungesë të kapitalit të freskët, ku një nga alternativat është përdorimi i kredive nga bankat, mirpo kushtet të cilat i ofrojnë bankat janë të pavolitshme për ti shfrytëzuar. Dhe alternativë e vetme mbetet tërheqja e investimeve, jo vetem për tërheqje të kapitalit të freskët mirpo edhe për transferim të teknologjisë dhe të how-know.

Përcaktuesit e IHD-ve

Si përcaktues kryesorë të IHD-ve, përfshijnë potencialin dhe madhësinë e tregut pritës, qëndrueshmërinë ekonomike, shkallën e hapjes së vendit pritës, nivelin e të ardhurave, cilësinë e institucioneve dhe nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit pritës257.
Lipsey dhe Kravis theksojnë se infrasruktura e vendit pritës luan një rol të rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve258. Modeli i Easterlit parashikon se të ardhurat fillestare dhe inflacioni ndikojnë negativisht në rritjen reale të PBB-së, ndërsa kapitalit human, IHD-të, infrastruktura në telekomunikacion dhe zgjerimi i OECD259-së ndikojnë pozitivisht në rritjen reale të PBB-së260.

Mund të thuhet se qëndrueshmëria ekonomike e politike, madhësia e tregut, shkalla e hapjes së vendit, niveli i taksave, politikat tregtare, politikat qeveritare, aspekti institucional dhe cilësia e infrastukturës përbëjnë përcaktuesit kryesorë që duhet të kenë vendet pritëse për të tërhequr një numër sa më të madh të IHD-ve.

Vendi ynë paraqet një klimë jo edhe aq të favorshmë për tëheqjen e investitorëve të jashtëm. Investitorët e huaj ngurrojnë që të investojnë për shkak të preceptimeve të tyre lidhur me joefikasitetin në administratën publike. Disa nga pengesat tjera të cilat ndikojnë në tërheqjen e investitorëve janë:
Barrierat ligjore,
Korrupcioni,
Stabiliteti politik,
Tregu i kufizuar,
Telekomunikimet
Mungesa e energjisë elektrike,
Mungesa e garantimeve të investimeve.

Origjina e Investimet e Huaja Direkte – Kosovë

Ndër vite situata e Investimeve të Huaja Direkte sipas shtetit nga e kanë origjinën ndryshon. Në vitin 2007 dhe 2011 pjesa më e madhe e IHD-ve e kanë origjinën nga Britania e Madhe me një vlerë prej 116.16 dhe 80.1 milionë euro. Në vitin 2008 IHD-të më së shumti vijnë nga Austria me një vlerë prej 51.3 milionë euro.
Gjermania është shteti nga e kanë origjinën shumica e Investimeve të Huaja Direkte për vitet 2009 dhe 2010. Gjatë këtyre viteve ky shtet ka investuar në Kosovë përkatësisht 75.15 dhe 91.54 milionë euro. Për dy vitet e fundit nën analizë 2012-2013, konsiderohet se është Turqia e cila ka investuar më shumë në shtetin kosovar. Në vitin 2012 Investimet e Huaja Direkte nga ky vend shënonin vlerën e 65.55 milionë eurove dhe një vit më vonë 82.73 milionë euro.

257 Walsh dhe Yu. 2010. "Determinants of FDI: A Sectoral and Institutional Approach", IMF, Working Paper, WP/10/187.
258 Lipsey dhe Kravis. 1982. "Location of overseas production and production for exports by US multinational firms", Journal of International Economics, fq. 201-223.
259 Shënim: OECD – organization for Economic Co-operation and development
260 Easterly, W. 2001. "The Lost Decades: Developing Countries' Stagnation in Spite of Policy Reform 1980-1998", Journal of Economic groëth, vol. 6, fq. 135-157.



Ndërsa për vitin 2014, vendi prej nga kanë ardhë më së shumti investimet e huaja direkte është Zvicrra me 15.3 milon euro, duke pasuar nga Austria, Gjermania dhe Shqipëria të cilat investuan përafërsishtë 13 milion euro secila261. Krahasuar me periudhën e njetë të vitit të kaluar, investimet nga Austria dhe Shqipëria kanë shënuar rritje, ndërsa investimet në Kosovë nga Austria kanë shëuar rëni edhe pse prap mbetet një nga vendët me përqindje më të lartë të investimeve të huaja për periudhën qershor 2014.
Më 31 Mars 2014 gjendja e IHD-ve në Kosovë paraqitet: me vendet e Bashkimit Europian janë kryer 962.83 milionë euro Investime Hyrëse të Drejtpërdrejta dhe 53.81 milionë euro Investime të Drejtpërdrejta Dalëse; me shtetet e tjera Europiane janë kryer 534.32 milionë euro IHD Hyrëse dhe 75.4 Investime Dalëse- dhe me shtetet e tjera Joeuropiane janë kryer 111.31 milionë euro IHD Hyrëse dhe 11.41 IHD Dalëse.

Investimet e Huaja Direkte ne Kosove sipas shtetit te origjinës gjendja me 31 Mars 2014
Vlera ne milionë euro

Rajoni	IHD Hyrëse	IHD Dalëse
Bashkimi Europian	962.83	53.81
Shtetet e tjera Europiane	534.32	75.40
Shtete te tjera Joeuropiane	111.31	11.41
Te paspecifikuara	1,199.34	-
TOTALI	2,807.80	140.62

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Lidhja në mes IHD-ve dhe rritjes ekonomike

Duke u bazur në studime të mëherëshme vijmë në përfundim se IHD-të rrisin efiçencën e burimeve dhe faktorët e prodhimit në vendin pritës, njëashtu IHD-të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të një vendi. Përfitimet që vijnë nga IHD si rritja e potencialit konkurrues ndërmjet prodhimit bruto të kompanive, hyrjes së teknologjive të reja, eksperiencës në aftësitë menaxheriale, rritja e njohurive mbi prodhimin nga kontaktet me investitorët e huaj si dhe mundësitë për prodhim optimal të burimeve njerëzore dhe rritjen profesionale të tyre, kanë një ndikim të madh në rritjen ekonomike të vendit262.

[261] Banka Qëndrore e Kosovës, (2015), "Raporti i Zhvillimeve Makroekonimike", Prishtinë, faqe 39
[262] NakuçiV., Zizo K, (2005) "Foreign direct investment (FDI) – the promoter of groëth in the Albanian economy", South-East Europe Revieë 1/2006

IHD-të shfaqen në formë të kompanive shumëkombëshe në vendin pritës, duke ngritur operacionet lokale nëpërmjet bashkimeve të tyre për te mundësuar rritje në prodhim si dhe zvogëlim të papunësisë. Mirëpo jo vetëm investimet e huaja direkte ndikojnë në rrijten ekonomike. Edhe rritja ekonomike mund të ndikoj në rritjen e IHD-ve. Kompanitë e huaja të cilat vinë dhe investojnë në vendin tonë gjithësesi marrin parasyshë edhe rriskun e investimit, njëashtu edhe të dhënat e ekonomisë. Një vend me ekonomi të zhvilluar, rritje ekonomike të lartë do të ishte tërheqës për investitorë, duke marrë parasysh që produktiviteti në atë vend rritet çdo vit dhe në atë vend mund të krijon të ardhura.
Përvoja e zhvillimit ekonomik në dekadat e fundit e sidomos kur është fjala për vendet në zhvillim e ka vënë në pah faktin se investimet konsiderohen të rëndësishme për shkak të efekteve të tyre të shumëanshme pozitive e sidomos për shkak se:

- Është konstatuar një lidhje pozitive midis investimeve dhe rritjes së bruto produktit të vendit, në saje të rritjes së mundësive eksportuese dhe efekteve stimuluese në bizneset lokale dhe përmirësimit të konkurrencës,
- Investimet sigurojnë efekte më të mira për zhvillim të qëndrueshem sesa huazimet në formë të kredive, për shkak të involvimit direkt të investuesit në menaxhment, reduktimit të ngarkesës me borgje, dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe social të kapitalit human në saje të transferit teknologjik, dijeve të reja dhe trajnimit.

Efektet pozitive në buxhet: rritjes së të ardhurave buxhetore që vjen si rezultat i rritjes së taksave dhe zvoglimit të nevojës për subvencione në shërbimet publike.

Figura 1. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



Burim: ASK (2015)

Figura 2. Komponentat kryesore e PBB-së, vlera nominale, në milon euro



Burim ASK (2015)

Gjatë vitit 2014 Ekonomia e Kosovës është karakterizuar me një përformancë positive, rritje te PBB. Duke u bazuar në vlerësimet e BQK-së, norma reale e rritjes ekonomike për vitin 2014 është 3.0 përqind. Rritja ekonomike gjatë vitit 2014 vlerësohet të jetë gjeneruar nga konsumi privat dhe publik, ndërkohë që investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike. Vlera nominale e PBB-së, sipas vlerësimeve të BQK-së, ishte 5.5 miliard euro në vitin 2014. Krahasuar me vitin e kaluar vendi ynë ka treguar një zvogëlim të shumës së përgjithshëm të BPB-së, në të cilën e shohim nga vlerësimet e BQK-së se për vitin 2013 BPB-ja ka qenë 3.4% ndërsa për vitin 2014 po e shohim se kemi një rritje prej 3.0%.

Konsumi i përgjithshëm është komponenta kryesore e PBB-së në Kosovë me një pjesëmarrje prej 107.0 përqind, vlerësohet të jetë karakterizuar me rritje prej 5.8 përqind në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak (figura2). Kjo rritje e përshpejtuar e konsumit mbështetet kryesisht në rritjen e konsumit privat prej 5.8 përqind gjatë kësaj periudhe, kryesisht si rezultat i peshës më të madhe që ka (84.5 përqind) në gjithsej konsumin. Rritja e konsumit privat prej 5.8 përqind i atribuohet kryesisht

rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese, përderisa rritja e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë (konkretisht pagave dhe mëditjeve dhe subvencioneve e transfereve) vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e konsumit publik prej 6.2 përqind dhe rrjedhimisht, konsumit të përgjithshëm në vend. Duke u bazuar në vlerësimet e BQK-së shohim se investimet e huaja direkte, edhe pse janë një shtytës i zhvillimit ekonomik të vendi, gjatë kësaj periudhe nuk kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, pra përveq faktorëve pozitiv që IHD-të sjellin në rritjen ekonomike, ka gjasa që të kemi edhe impakt negativ. Ku shkaqet mund të jenë nga faktorët politikë e ato social.

Konkluzione dhe Rekomandime

Investimet e huaja direkte, janë një nga treguesit më të rëndësishëm i besimit të investitorëve të huaj në një vend. Nëse vendi përballet me kriza ekonomike dhe politike, eshtë shumë e qartë që investimet e huaja direkte do të ulen në atë vend, mirpo ato do rriten në kushtet e përmirësimit të ambientit ekonomik dhe politik. Vendi ynë përballet me një ekonomi në tranzicion e cila, sikurse cdo ekonomi në zhvillim dhe tranzicion, përballet me disa dukuri negative sic janë: niveli i lartë i papunësië, varfërisë, GDP e ulët si dhe rritje të importeve. Prandaj, terheqja e investimet të huaja direkte edhe për vendin tonë krijojnë njër rol të rëndësishëm në përmirësimin e këtyr dukurive negative.

Në shumicën e vendeve në tranzicion siç është Kosova depërtimi i kapitalit të huaj, kryesisht realizohët përmes procesit të privatizimit, ndërsa pjesmarrja e investimeve të reja,"GREENFIELD" është shumë e vogël. Kosova është duke bërë përpjekje për krijimin e kushteve të mira për investime të huaja direkte, për politika ekonomike, pmirërsimi i një klimë më të mirë në vend, ndërtim të infrastruktures rrugore etj. Të cilat padyshim ndikojnë në zhvillim ekonomik më të mirë të vendit. Institucionet e Kosovës duhet të bëjnë përpjekje në përmirësimin e disa prej pengesave që janë identifikuar nga ana e investitorëve të huaj, infrastruktura fizike, procedurat burokratike, mjedisi politik, korrupsioni, reforma ne administratën qeverisë dhe në sistemin arsimor.

Furnizimi jo i rregullt me energji elektrike, mbetet një ndër pengesat për tërheqjen e investimeve në Kosovë, edhe pse është punuar shumë në këtë drejtim mirpo prap mbetet një ndër pengesat për tërheqjen e investitorëve të huaj.

Në Kosovë duhet të bëhet një politikë aktive që do ta përmirësonte promovimin e mundësive për bashkëpunim me investitorët e jashtëm, rritjen e aftësive konkurruese në tregun e investimeve, njëashtu edhe për tërhjekjen e investimeve të përbashkëta.

Krahasuar me vendet në rajon, investimet e huaja direkte në Kosovë, momentalisht janë pothuajse më të voglat. Mirëpo, krijimi i kushteve të favorshme për investime, do të tërhiqte një numër më të madh të investitorëve te huaj, të cilët nuk do të hezitojnë të investojnë në vendin tonë.

Referencat

Badivuku-Pantina, M., (2008), “The importance of Foreing Direct Investiments on Economic Development of Kosova”, Revista ndërkombëtare ”Lex et Scientia”, No.XV Vol.2/2008, Bucharest.
Banka Botërore, (2010), “Raporti i Bankës Botërore për Kosovën”, Raporti nr. 53185-XK
Banka Qendrore e Kosovës, (2012), “Buletini mujor statistikor”, Prishtinë.
Banka Qëndrore e Kosovës, (2014), “Raporti i Stabilitetit Financiar”, Prishtinë.
Banka Qëndrore e Kosovës, (2015), “Raporti i Zhvillimeve Makroekonimike”, Prishtinë, faqe 36-39.
Easterly, W. 2001. "The Lost Decades: Developing Countries' Stagnation in Spite of Policy Reform 1980-1998", Journal of Economic groëth, vol. 6, fq. 135-157.
Fondi Monetar Ndërkombëtar, (1993)
KIPRED, (2013), “Kosova në kontekst rajonal”, Prishtinë
Lipsey dhe Kravis. 1982. "Location of overseas production and production for exports by US multinational firms", Journal of International Economics, fq. 201-223.
NakuçiV., Zizo K, (2005) “Foreign direct investment (FDI) – the promoter of groëth in the Albanian economy”, South- East Europe Revieë 1/2006
OSCE, Udhëzuesi i Praktikave më të Mira për një Klimë Pozitive për Biznesin dhe Investimet, 2006,
Sezer, H. (2006) “Foreign Direct Investment”, in Piggott, J. and Cook, M. International Business Economics: A European Perspective, fq. 187
Strategjia për Promovimin e Investimeve 2011-2013, APIK
Walsh dhe Yu. 2010. "Determinants of FDI: A Sectoral and Institutional Approach", IMF,Working Paper, WP/10/187.
Zisi, A., (2014) “Nndikimi i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike dhe faktorët nxitës në përthithjen e tyre rasti i Shqipërisë”, Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës.

PHD. (C) RAGIP GJOSHI – ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË KOSOVË-MODELI I MENAXHMENTIT BASHKËKOHOR DHE TË SUKSESSHËM

PHD. (C) RAGIP GJOSHI
Fakulteti Edukimit, Universiteti "Hasan Prishtina " ne Prishtine

Në këtë punim jam përpjekur të bëjë argumentimin shkencor për ta kuptuar organizimin e punës së shkollës dhe universitetit në kontekst të vlerave shoqëroro-ekonomike dhe të objektivave të paramenduar. Është fakt i pamohueshëm se zhvillimin e organizimit të mësimit dhe punës në shkollë e përcjellin të gjitha ndodhitë dhe ndryshimet të cilat bëhen në sferën ekonomike dhe politike të jetës shoqërore. Çështja e vizionit, qëllimeve, rritjes dhe zhvillimit të kurrikulës së shkollës, respektivisht universitetit dhe organizimi gjithëpërfshirës arsimor gjithnjë janë vazhdim i të njëjtave çështje në segmente të ndryshme të jetës shoqërore.

Ndoshta do të duhej megjithatë të vetëdijesohemi për faktin e pasigurisë së ardhmërisë së shek. XXI për çka shkolla dhe universiteti si organizata duhet të ndryshojnë konstruktin e vet, të bëhen më pak të varur për imponime, më shumë e orientuar kah hulumtimet, por vazhdimisht e hetuar për efektin moral- ndërsa e gjithë kjo në emër të çudisë së mësimit e cila quhet zbulim, pranim dhe e hetuar nga aspekti etik për ndryshimet e njeriut dhe botës.
Më poshtë do të përpiqemi të japim disa mendime lidhur me aspektet e menaxhimit dhe të tipareve të menaxhereve dhe të menaxhimit, me theks të veçantë në menaxhimin e institucionit arsimor në Kosovë.

Kultura e udhëheqjes së institucioneve edukativo-arsimore në Kosovë

Autorët amerikan Buchanan dhe Huczynski, mendojnë se kultura organizative, e një menaxheri, është diçka më shumë që një institucion "është" se sa që një institucion "ka".263 Në përgjithësi kultura organizative ka të bëjë kultivimin e qëndrimeve, përvojave, besimeve dhe vlerave të një institucioni arsimor. Prandaj mund të thuhet edhe se kultura e institucionit është një përmbledhje specifike e vlerave dhe normave që shkëmbehen ndërmjet njerëzve dhe grupeve në një institucion dhe kontrollin e mënyrës që ata ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe me kolegët e tyre jashtë institucionit. Pra gjithçka që është krijuar brenda dhe jashtë shkollës, institucionit arsimor e me të cilën dallohet nga institucionet tjera si motra. Autorë të ndryshëm prekin dimensione të ndryshme të kulturës organizative, ndërsa vlen të përmendet Stephen P. Robbins, që konsiderohet si baba i teorisë së sjelljes organizative, i cili konsideron se për kulturën organizative thelbësore janë shtatë karakteristika qenësore, siç janë:

Krijimi dhe pranimi i rrezikut, deri në çfarë shkalle të punësuarit janë të inkurajuar të jenë kreativë dhe pranues të rrezikut;

Prandaj është detyrë dhe përgjegjësi e menaxherit të institucionit arsimor që të ndikojë në përgatitjen edhe profesionale dhe sociologjike të stafit punues për ta përballuar çdo sfidë, por edhe për ta ndihmuar dhe motivuar për sukses personal si dhe kolektiv.

Orientimi në detale, deri në çfarë shkalle janë të priturat e të punësuarve të demonstrojnë precizitet, analizë dhe vëmendje në detale;

Kjo ka të bëjë me dieagnostifikimin që një menaxher duhat ta bëjë institucionit që drejton. Ky diagnostifikimi nuk ka të bëjë me caktimin e terapisë, por me identifikimin e anëve të forta dhe

[263] Sipas, S. P. Robbins, (2005) Essentials of Organiztional Behavior, Pearson Education International, New Jersey, fq.231.

dobësive që mund të ketë institucioni që merr në drejtim. Pastaj në bazë të një diagnostifkimi ai dhe do të ndërmarr, apo planifikojë e projektojë gjithë hapat e nevojshëm për avancim apo për përmirësim të të gjitha poreve organizative të atij institucioni. Pa pasjen e një pasqyre të këtillë asnjë menagjer nuk ka mundësi të dijë ta orientojë veprimtarinë, dhe veprimet për quarjen para të institucionit. Ndërsa synim i secilit është pikërisht kjo-quarja para, arritja e suksesit dhe raportimi te vartësit për të.

Orientimi në rezultate, deri në çfarë shkalle menaxherët janë të fokusuar në rezultate se sa në teknikat dhe proceset për arritjen e këtyre rezultateve;

Sipas autorit, menaxheri i mirë duhet të ketë njohuri solide edhe nga fusha e marketingut në ratet kur ai duhet ta orientojë institucionin, t'i jap kahe kah arritja e suskesit. Secili menaxher që në fillim duhet të vendosë disa pika kulmore të cilat synon që t'i arrijë. Cilat do të mund të ishin ato pika kulmore, ose thënë ndryshe objektiva të organizatës? E para, me Udhëzimin e 2014, për drejtor shkolle, kërkohet që kandidati i mundshëm para panelit intervistues, por edhe institucionit në të cilin konkurron për drejtor, duhet ta prezanojë një Plan zhvillimor. Konturat e këtij plani zhvillimor janë të dhëna në Udhëzimin administrativ264. Aty si pikë e parë është dhënë, si kërkesë për njjë plan zhvillimor të suksesshëm, formulimi i një vizioni për institucionin. Ky vizion duhet të jetë pika kryesore orientuese për të nga e cila pikë më vonë do të përcaktojë edhe objektivat, apo caqet se ku do të mbërrijë institucioni pas një periudhe të caktuar ose brenda një mandati. Këto pika orientuese të vendosura, objektiva apo rezultate të pritura duhet të bazohen në kushtet dhe potencialet reale të institucionit. Nëse këta objektiva, rezultate të synuara janë jo të studjuara mirë, dhe në shpërputhje me potencialet aktuale të institucionit, por edhe të vet menaxherit, atëherë kjo mund të kalojë në domenin e një ëndërre të bukur, e cila do të zgasë aq sa zgjatë gjumi letargjik i kandidatit.

Prandaj, menaxheri të cilin synojmë ta kemi, në shekullin e zhvilllimit të hovshëm të tekniks dhe të teknologjisë, por edhe të zhvillimit të shkencave të menachimit, të ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta në vet fushën e arsimit, sistemeve arsimore, kërkohet që me rastin e formulimit të vizionit të institucionit që menaxhon, ose e synon atë, ta studjojë mirë, të identifkojë rezultate të arritshme të matshme dhe reale. Të gjitha këto duhet zbërthyer në veprime konkrete të planifikuara dhe të orientuara kah rezultatet.

Orientimi kah njerëzit, deri në çfarë shkalle vendimet e menaxherëve dhe efektet e rezultateve ndikojnë në punonjësit e organizatës;

Asnjë menaxher nuk do të mund ta drejtonte një institucion pa pjesën tjetër të stafit. Dihet se në çdo institucion kemi njerëz që punojnë, të tjerë që presin urdhëra apo detyra nga lartë, por edhe të tillë që vazhdimisht bishtnojnë, ose mundohen t'u shmangen detyrave dhe përgjegjësive. Zakonisht kjo kaetgoria e fundit edhe janë më të zëshmit në kundërshtimin dhe rezistencën ndaj ndryshimit në organizatë265, sepse çdo ndryshim për ta është një 'çrregullim' i rehatisë prandaj edhe vjen deri te aktivizimi i mekanizmave rezistues ndaj ndyshimit.

Për arsye të mobilizimit të domosdoshëm të resurseve humane brenda institucionit, menaxheri duhet së pari ta studjojë mirë këtë resurs, të identifikojë mundësitë dhe potencialet e secilit, por edhe të gjej se ku mund të jenë pengesat kryesore, ose të mundshme për arritjen e objektivave të përcakuar në planin zhvillimor dhe menaxhues. Gjatë 'skanimit' të resurseve humane menaxheri duhet të ketë kujdes se për cilën pjesë të stafit mund të ketë ndonjë ndikim të mundshëm, pozitiv apo edhe negativ, mund ta cenojë ndonjë interes të dikujtë brenda institucionit, apo edhe interesin e përbashkët të tij.
Pas pasjes së një pasqyre të këtillë të resurseve njerëzore, menaxheri pastaj edhe mund të ndajë detyrat dhe përgjegjësitë individuale dhe grupore. Është me rëndësi që gjatë ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive të ofrojë sqarime adekuate dhe të mjaftueshme për secilin pranues –marrës të detyrës a përgjegjësisë. Sqarimi me kohë dhe i plotë i marrjes së detyrave dhe përgjegjësive të reja është me rëndësi për të dy palët, për menaxherin dhe për punëtorin/stafin, sepse paraprakisht njihen me

[264] Shih MAShT, (2011)Udhëzimi administrativ për PZHSH.
[265] Mikel Fullan, (2004), Fuqia e ndryshimit 3, Prishtinë.

përmbajtjen, vështirësitë, mundësitë dhe kahet e zhvillimit të procesit dhe të aktivitetit për arritjen e objektivit të përcaktuar në detyrë266, por edhe mobilizimi i forcave dhe mundësive intelektaule të tij. Pasja e një pasqyre të interesave dhe të motiveve punuese për secilin të punësuar në institucion ndihmon menaxherin në marrjen e hapave të mëtejshëm,por edhe në ndarjen e përgjegjësive dhe detyrave për personelin e instiucionit. Gjithashtu një hap i këtillë i shërben atij për kërkimin e rapotimit për punën bërë nga anëtarët t instiutcionit.

Orientimi në ekip, deri në çfarë shkalle punët janë të organizuara më shumë në grupe sesa në individë;

Organizimi i punës, ndarja e punëve dhe e përgjegjësive brenda një institucioni është njëra ndër shkathtësitë menaxheriale. Sot në teorinë e menaxhimit, organizimi i punës ekipore është një çështje e pakaparcyeshme, por edhe që ka dhënë sukses në arritjen e rezultateve të pakuntestueshme. Asnjëherë nuk mund të anashkalohet roli i individit, përkushtimi dhe profesionalizmi individual i secilit pjesëtarë të institucionit, por në shumë raste është i pamundur që individi ta luaj rolin e ekipit në kryerjen e detyrave punuese.
Shkathtësia e një menaxheri shihet në organizimin e ekipeve punuese, përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive për ekipin, ekipet punuese si dhe përcaktimi i detyrave dhe i përgjegësive për secilin anëtarë të ekipit. 267

Është e nohur se në punën ekpore shfaqen edhe probleme organizative, por edhe njëlloj i rezistencës nga ndonjëri nda anëtarët e ekipit. Në shumë raste jo të gjithë anëtarët e ekipit funksioniojnë si duhet. Pothuaj në të gjitha rastet gjenden individ që fshihen nën hijen e ekipit, përjetojnë suksesin e grupit, por akuzojnë në raste se puna e ekipit nuk del me sukses.

Agresiviteti, deri në çfarë shkalle njerëzit në punë janë agresivë dhe konkurrues sesa të shkujdesur;

Raportet sociale midis anëtaërve të një institucioni, njohja e atyre raporteve nga ana e menaxherit është me rëndësi të veçantë. Secili menaxher duhet ta bëjë të qartë sociogramin e organizatës së vet. Në kuadër të këtij sociogrami duhet të lexojë me saktësi se çfarë janë raportet sociale midis grupeve dhe nëngrupeve të mundshme në institucionin që menaxhon. Tek e fundit ai duhet të ketë njohuri për raportet midis tyre, të shfrytëzojë këtë njohuri për formimin e ekipeve punuese funksionale, por edhe të shmangë konfliktet apo mosmarrëveshjet e mundshme midis njerëzve për ta bërë më funksuonale punën, por edhe arritjen e suksesit të organizatës në përgjithësi. Ndoshë shpesh që, në emër të një konkurrence punuese, midis njerëzve të lindin edhe gjelozi, por edhe mosmarrëveshje të cilat dëmtojnë ore pengojnë arritjen e rezultateve të institucionit arsimor.
Menaxheri duhet të zhvillojë një konkurrencë të shëndosh midis punonjësve, duhet të gjej forma dhe mjete për stimulimin e punës dhe të konkurrencës së shëndosh midi tyre.
Çdo shprehje e agresisvietit duhet të ndërpritet dhe të mos anashkalohet nga ana e menaxherit, sepse ajo pastaj mund të adrsojë problme edhe më të mëdha të pa shërueshme dhe të dëmshme për institucionin arsimor.268

Stabiliteti, deri në çfarë shkalle veprimet organizative orientohen në ruajtjen e statuskuo-së sesa në rritjen e saj.269

MASHT nëpërmjet ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative ka normuar se cilat janë qëndrimet, përvojat, besimet dhe vlerat që duhet të përmbajë një institucion arsimor në Kosovë. Në këtë drejtim edhe drejtoritë komunale, vetë institucionet arsimore dhe asociacionet profesionale të arsimit i kanë kodifikuar këto vlera nëpërmjet rregulloreve apo të kodit të mirësjelljes. Kjo aq më tepër kur misioni i institucioneve arsimore është pikërisht krijimi, kultivimi dhe përparimi i këtyre vlerave shumë të rëndësishme për punonjësit, institucionin dhe shoqërinë në përgjithësi. Nuk mund të

[266] Po aty, fq. 76.
[267] Po aty, fq. 32.
[268] Po aty, fq.38.
[269] Po aty, fq. 139.

ankohemi se kemi dokumente të dobëta, por mund të ankohemi për gatishmërinë e ulët të zbatimit të tyre nga të gjitha nivelet. Besojmë se me kuptimin e rëndësisë së kulturës organizative në arritjen e rezultateve të punës dhe zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi, edhe zbatimi i këtyre vlerave të rëndësishme do të gjejnë zbatim dhe do të kultivohen nga të gjitha institucionet arsimore në Kosovë.

Atmosfera e udhëheqjes institucionale projektohet, është trajtuar në këtë kapitull në të cilin faktet dëshmojnë se si ndihet individi, si do ta ndiej veten të tjerët,etj. E gjithë kjo ka të bëjë me trajtimin dhe me shpjegimin e situatave qe dokumentojnë se kjo varet shumë nga kultura institucionale, modeli i formimit profesional dhe aftësitë komunikuese të individit. Ajo që zakonisht kuptohet si "kulturë institucionale" në literaturë te autorë të ndryshëm mund të gjendet edhe si modeli mental. Dallimet kulturore të disa institucioneve zakonisht janë të dukshme në kontaktin e parë me to. Kështu p.sh. burgu, manastiri, kazerma reflektojnë kultura të ndryshme. Të gjitha realitetet jetësore institucionale janë të ndërvarura, veprojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse në fëmijën dhe studentin dhe në pjesën më të madhe përcaktojnë kualitetet e përvojës së vet të përditshme. Boshtin e kësaj kaptine e paraqet argumentimi i sintagmës se Kulturën në shkollë e formojnë njerëzit dhe sjelljet e tyre. Kjo kulturë nuk mund të arrihet në rast se menaxheri është i mbyllur në dokumente zyrtare. Këtë kemi provuar ta shohim në hulumtim. Në pyetjen/kërkesë se sa është e vërtetë se U tregoj stafit se çfarë duhet të bëjnë, kemi marrë përgjigjet si në grafik.

Grafiku 1. Ndihma stafit se çfarë duhet të bëjnë



Pra shihet një përqindje e lartë e deklarimit se menaxherët u tregojnë stafit se çfarë duhet të bëjnë. Me këtë nuk nënkupton se ata edhe delegojnë detyrat dhe përgjegjësitë, por se atyre iu tregojnë se çfarë duhet të bëjnë.
Praktika edukativo-arsimore janë rezultat i kombinimeve të caktuara të vlerave orientuese të mësimdhënësve, dijes dhe aktiviteteve të tyre. Krijimi i vlerave të reja do të thotë ndryshimi i kulturës ekzistuese. Menaxherët që nuk janë të kënaqur me kulturën e institucionit edukativ, mund të planifikojmë që në mënyrë strategjike të planifikojmë dhe të bëjmë ndryshimin. Në institucionet edukativo-arsimore duhet vazhdimisht të kihet kujdes për të gjitha format e kulturës institucionale. Përjetimi i kuptimit të përgjegjësisë dhe suksesit të të punësuarve në vendin e punës është pjesë përbërëse e kulturës shkollore dhe mund të jetë burim i madh motivimi për punë dhe kontribuon në cilësinë e punës së shkollës.
Kultura e shkollës, apo e institucionit arsimor është bërë objekt i studimeve dhe trajtesave të ndryshme. Menaxheri i institucionit arsimor është pjesë e krijimit dhe e cilësisë së asaj kulture që ka institucioni. Kultura e institucionit nuk mund të krijohet brenda një periudhe të shkurtër e as nga një menaxher i vetëm, sepse ajo krijohet në faza të ndryshme dhe me rënie e ngritje të cilësisë, llojit dhe mjeteve të cilat ndihmojnë ndërtimin e asaj kulture. Kulturën e institucionit arsimor e përbën e gjithë pasuria materiale dhe shpirtërore e krijuar brez pas brezi në një institucion.

Po lidhur me grafikun dhe pyetjen paraprake kemi kërkuar me pyetësor që të shprehin vërtetësinë ose jo të sugjerimeve që ata kanë për punëtorët e vet. Shih grafikën.

Grafika 2. Dhënia e sugjerimeve për stafin



Roli dhe rëndësia e menaxherit në ndërtimin e kulturës së institucionit në përgjithësi dhe atë të menaxhimit në veçanti është e veçantë. Kultura e institucionit arsimor është një mozaik i aspekteve dhe dimensioneve që përbëjnë institucionin.
Kultura menaxheriale përbëhet, por edhe kushtëzohet, nga përmbushja e standardeve të praktikës profesionale të parapara për menaxher të institucionit arsimor.270
Roli i menaxherit në krijimin e kulturës qëndron në njohuritë po edhe shkathtësitë e tij menaxheriale si dhe të ndërtimit të vlerave të qëndrueshme të institucionit të cilat do të trashëgohen brez pas brezi. Kjo varet në masë të madhe nga niveli dhe cilësia e ndërtimit të raporteve ndër njerëzore brenda institucionit arsimor.271 Se si do të jenë këto raport varet shumë nga cilësia dhe kultura e komunikimit të menaxherit me aktorët që bëjnë institucionin arsimor. Ai mund të krijojë klimë pozitive, por edhe negative në institucion.
Sa i përket kulturës së udhëheqjes dhe ndikimit të menaxherit në procesin e bashkëpunimit me të tjerët në pyetësor kemi shtruar çështjen e bashkëpunimit të tyre me udhëheqësit kur ata nuk ishin në një pozitë të tillë, dhe kemi marrë përgjigjet si në vijimi.

Grafiku 3. Marrëdhënia juaj me udhëheqësin, karakteristikat themelore



Në këtë pyetje kemi marrë vetëm dy përgjigje, ku rreth 40% deklarojnë se këtë marrëdhënie e kanë mesatare ndërsa rreth 60% deklarojnë këtë e karakterizojnë mbi mesatare. Prandaj sipa kësaj del se ata vlerësojnë se kishin raport të mirë me udhëheqësin, çka presin që edhe të tjerët të ndihen njësoj në raport me të sa i përket marrëdhënies recipreoke me menaxherin e institucionit.

[270] Fullan, Michel, (2009), Forca e ndryshimit, Prishtinë, fq.75.
[271] Po aty, fq. 73.

Po në realcion me këtë dekklarim kemi parashtrua pyetjen në vijim: se "Unë shkoj përtej interesave të vetes, për të mirën e grupit" ku kemi marrë përgjigje interesante. Shih rezultatet në grafikun në vijim.

Grafiku 4. Gatsihmëria menaxherëve për të ofruar më shumëse për interes të grupit



Sipas këtij qëndrimi, afro 60% thonë se shkojnë përtej interesave individuale për të mirën e grupit, është diçka që mund të konsiderohet si ideale. Ndërsa afër kufirit të reales, sipas nesh, do të ishte qëndrimi/deklarimi i rreth 15% të anketuarve se këtë e bëjnë disa herë, por nuk e bëjnë gjithmonë dhe mjaft shpesh si deklarohen rreth 25% e menaxherëve të anketuar.
Megjithatë kjo bie më shumë në sferën e menaxherëve tepër entuziast dhe idealist, të cilët edhe mund të bien në gabime duke u munduar që me çdo kusht të realizojnë vizionin e organizatës, ose edhe synimin individual, por mund të hasin në rezistencë të fortë nga ana e grupit ose grupeve e individëve brenda institucionit arsimor.

Menaxhimi Financiar në Institucionet Edukativo-Arsimore Korniza Financiare dhe Prioritetet-Udhëheqja Financiare

Ky kapitull mbështetet mbështetur në bazë të analizave të bëra sipas përvojave të disa shteteve të zhvilluara është e pamohueshme se në kuadër të procesit të reformës në sektorin publik është e rëndësishme të kuptohen parimet e pranimit të transparencës, shkallë-shkallshmërisë, jetëgjatësisë dhe standardizimit, ndërsa si pasojë e kësaj edhe parimet e krahasueshmërisë ndërkombëtare. Është supozim i rëndësishëm suksesi i reformës financiare ndërtimi i kontabilitetit shembullor – sistemit informativ si sistem i menaxhimit përkrahje e menaxhimit publik. Është mjaft komplekse të përcjellësh dhe vlerësosh për kohë të shkurtër ndryshimet në nivel kombëtar. Shumica e vendeve i largohet praktikës së vlerësimit dhe ndryshimeve në raport me vendet të cilat u përmbahen ndryshimeve që përmendëm. Ngjashëm me këtë, te vlerësimi afatshkurtër i ndryshimeve në menaxhimin financiar, është e dëshirueshme që në praktikë të vlerësohen institucionet arsimore (shkollat, dhe universitetet) duke i krahasuar me profilet e ngjashme të institucioneve, ndërsa pastaj të vlerësohen ndryshimet në menaxhimin financiar në nivel kombëtar. 272

Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në shkollë dhe për shkollën janë aktivitete të koordinuara dhe në funksion të zhvillimit dhe avancimit të procesit kryesor të saj - arsimimin. Kuptohet që jo të gjitha ato aktivitete i përkasin kryekëput natyrës dhe fushës së edukimit, siç janë çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave të shkollës.
Kur jemi te planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave të shkollës, si në çdo aktivitet tjetër arsimor, është mjaft me rëndësi definimi i qëllimeve dhe objektivave të qarta, të qëndrueshme dhe në funksion të arritjes së rezultateve të matshme. Në nivelin strategjik të institucionit, këto objektiva mund të jenë të përgjithshme, qoftë sa i përket shtrirjes së përgjegjësive apo aspektit kohor, por në fund të fundit, janë në përgjegjësinë e menaxhmentit të shkollës planifikimi, menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i të arriturave edhe në aspektin financiar në shkolla.

[272] Zeneli, Isuf, (2013), Bazat e menaxhimit, Menaxhimi i institucioneve arsimore në Kosovë, fq 139.

Meqenëse planifikimi dhe menaxhimi i aspekteve financiare në shkolla është mjaft ngushtë i lidhur me çështje dhe disiplina të tjera në kuadër të shkollës dhe si i tillë në nivelin strategjik të shkollës nuk mund të trajtohet i veçuar nga hartimi i politikave arsimore, atëherë si proces nuk mund të ketë përkujdesje të veçantë nga ekspertë të fushës, mirëpo kërkohet që menaxhmenti i shkollës, në mbështetje të ekspertëve të fushës, të zhvillojë njohuri dhe aftësi për të bartur/përkthyer politikat strategjike në plane financiare dhe kjo arsyeton edhe nevojën për trajtimin e temës së planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe financave të shkollës.273

Në nivelin e arsimit parauniversitar, menaxhimi i sistemit merr parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin, të cilat janë të përfshira dhe të zbërthyera në dokumente ligjore, mbi të cilat gjejnë mbështetje funksionet dhe përgjegjësitë e ministrive, komunave dhe institucioneve arsimore. Në këtë frymë, edhe aspektet që kanë të bëjnë me çështje financiare në institucionet arsimore gjejnë zbatim mbi një bazë legjislative (të zbërthyera pastaj në akte të tjera nënligjore dhe udhëzime administrative përkatëse), por më të rëndësishmet për këtë proces po përmendim:

Ligji për arsimin në komunat e Republikës Kosovës274 - ka për qëllim bazë të rregullojë organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunat e Republikës së Kosovës.
S'do mend që transferimi i kompetencave për menaxhimin financiar të shkollave, realizimi me sukses i tyre në praktikë, shton edhe nevojën për përgatitjen e shkollave për t'i përballuar këto ndryshime. Sa i përket zhvillimit të njohurive dhe aftësive të udhëheqësve të institucioneve arsimore në Kosovë për menaxhimin e buxhetit dhe financave të institucionit, ligji në fjalë shtron nevojën që të gjithë drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore dhe cilido person tjetër me përgjegjësi për të administruar institucionet arsimore që mbajnë pozitat e tyre të kenë përfunduar me sukses, deri më 31 korrik 2013275, një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose fusha të ngjashme, i cili duhet të jetë i autorizuar nga Ministria sipas rekomandimeve nga KSHLM-ja. Gjithashtu, nga data 1 gusht 2013, të gjithë kandidatët për postet e cekura, para emërimit të tyre, duhet të kenë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose fushë.

Të gjitha standardet janë të ndërlidhura dhe plotësojnë reciprokisht njëri-tjetrin, megjithatë, standardi tre, Planifikimi dhe menaxhimi, thekson në mënyrë më specifike mundësinë e përdorimit të tij në cilësinë e instrumentit vetëvlerësues për praktikën profesionale të udhëheqësve të shkollës në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të financave të shkollës. Gjithashtu, ky standard mund të dhe duhet të shërbejë në të ardhmen si bazë për hartimin e programeve të trajnimit për fushën e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe financave të shkollës.

Për të mundësuar implementimin në praktikë të këtyre standardeve, MASHT në bashkëpunim ne donatorë të fushës, ka planifikuar që në vazhdimësi të realizojë programe të trajnimit me udhëheqësit e shkollave. Në proces është realizimi i projektit të Komisionit Evropian IPA – 2009276, gjegjësisht programi i trajnimit Ngritja e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave në Kosovë, i cili ndër të tjera ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve udhëheqëse të drejtorëve të shkollave dhe të autoriteteve në Kosovë.
Si çdo proces tjetër planifikues dhe administrativ, edhe planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave në kuadër të shkollës duhet të kalojë nëpër disa faza kryesore:

- Definimi i politikave strategjike të shkollës – vizioni dhe misioni
- Formulimi i politikave bazë- prioriteteve të shkollës
- Zbërthimi i buxhetit paushall në politikat financiare të shkollës
- Planifikimi i aktiviteteve përkatëse,

[273] Po aty, fq. 176.
[274] KK (2008), *Ligji për arsimin në komunat e Republikës Kosovës*
[275] Ligji për arsimin parauniveristar, 2011, fq.18.
[276] Programi IPA i KE për ngritjen e kapaciteteve arsimore në Kosovë.

- Dizajnimi i planit organizativ dhe menaxhues,
- Sigurimi i udhëheqjes dhe kontrollit /vlerësimit,
- Vlerësimi i vazhdueshëm i procesit. 277

Menaxhimi i buxhetit dhe financave brenda një institucioni bartë me vete edhe një varg përgjegjësish dhe llogaridhënie. Këtë e rregullon Ligji për buxhet dhe financa publike të cilit duhet t'i përmbahen të gjithë përfituesit dhe shfrytëzuesit e tij.

Shpenzimi dhe përdorimi i buxhetit, menaxhimi i mirë i tij, është detyrim ligjor, i cili duhet të mbështetet një planin e prokurimit për çdo vit kalendarik.

Për shpenzimin e buxheti secili menaxher është i detyruar që t'i përcaktojë objektivat dhe prioritetet afatshkurta, afatmesme dhe afatgjatë në bazë të të cilave edhe do ta bëjë shpërndarjen e buxhetit apo të zërave buxhetor.

Secili institucion arsimor, në bazë të Ligjit për arsim parauniversitar (MASHT 2011)278 duhet ta ketë një Këshill drejtues, i cili vendos për organizimin e punës, shpenzimin e buxhetit si dhe merr vendime të rëndësishme për procese të rëndësishme të funksionimit të institucionit. Ndërsa universitetet kanë Bordin drejtues, i cili gjithashtu merr vendime edhe sa i përket shpërndarjes dhe shpenzimit të buxhetit në bazë të prioriteteve të institucionit.

[277] Po aty.
[278] Ligjit për arsim parauniversitar (MASHT 2011), fq.18.

PROF. ASOC. DR. NAIM BAFTIU, PROF. ASOC. DR. ARTAN DERMAKU – PAJISJET ELEKTRONIKE DIGJITALE SI DHE SAKTËSIA E MATJEVE NË POMPAT E BENZINËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PROF. ASOC. DR. NAIM BAFTIU
PROF. ASOC. DR. ARTAN DERMAKU

Fakulteti Shkencave Kompjuterike, Universiteti Publik i Prizrenit "UKSHIN HOTI"

Abstrakt

Në Kosovë shumë organizata, Biznese, Kompani dhe Individë jane duke përdorur pajisjet matëse digjitale elektronike për matjen e parametrave teknik në lemi të ndryshme duke përfshir laboratoret gjeomekanik, laboratoret e ndotjes së ajrit, ujit, laboratore për matjen e parametrave metrologjisë siq jan parametrat e matjeve të Naftës dhe benzines nëtë gjitha pompat e republikës së Kosovës.

Pas një krize të gjatë, shoqëria Kosovare sot ballafaqohet me një sfidë të re për t'iu bashkangjitur rrjedhave aktuale të zhvillimit ndërkombëtar. Në sferën e pajisjeve elektronike digjitale për matjen e parametrave të sasisë se naftës si dhe furnizimit me arka fiskale. Nevojat e përhershme për matjen e sasis me pajisje digjitale elektronike së litrit në pompat e benzinës është më se e nevojshme dhe e demosdoshme sot në vendin ton.

Qëllimi kryesor i punimit shkencor është që pajisjet elektronike digjitale të cilat përdoren në nxjerrjen e sasis së sakt të litrit, të jen të kalibruara dhe matja e tyre të jetë e saktësi dhe të gjitha Instrumentet tjera tëjenë të sakta në mënyrë që të rrisin cilësinë e produkteve dhe shërbimeve me naftë në mënyrë që të jenë konkurrente në tregun vendor dhe ndërkombëtar për të gjithe qytetarët e Kosovës.

Sipas disa parametrave teknike të pajisjeve digjitale elektronike për laboratoret e Kosoves janeduke u zhvilluar disa funksione metrologjike, te cilat i parashihen themelimin e disa etaloneve kombëtare të matjes në mënyrë që të transmetojë njësi matëse për pajisjet dhe instrumentet matëse në përdorim në proceset e prodhimit, shërbimit dhe testimit dhe për të garantuar saktësinë matëse duke kontrolluar instrumentet matëse në shfrytëzim publik.

Sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi janë zhvillimi dhe kalibrimi i pasjisjeve digjitale për ndjenjën e vetëbesimit të biznesev të cilat mirren me ketë veprimtari.Qëllimi i shoqërisëKosovare është për t'u inkuadruar në një zhvillim të qëndueshëm njerëzor nëshoqëri demokratike duhet angazhuar me sukses në tregun e punësme qellim qe te gjitha punet te jen sipas standardeve te Bashkimit Evropian(BE).

Fjalet kyqe: pajisjet elektronike digjitale, instrumentet matëse, kalibrimi, matja dhe nafta.

Hyrje

Konsumatori ne Kosove prej disa kohësh po vuan nga nje cmimi real që i bëhet në pikat e shitjes së karburantëve, në Prishtine dhe disa qytete të tjera të Kosoves. Pas uljes dhe ngritjes se cmimeve ende nuk dihet ne menyr te sakte se sa eshte cmimi i naftes ne pikat e karburanteve, mund te themi se MTI -ja, pranoi, disa ditë më parë, se nga kontrollet e bëra janë konstatuar shkelje, pas disa aksioneve që jane bere pompave te benzines ne menyre sistematike, ky lloj kontrolli ka vazhduar dhe ka qen efektiv, dhe ka si objektiv primar sigurimin e qytetarëve vendas, por edhe qytetarëve të huaj, se për vlerën e paguar do marrin sasinë reale të produktit që blejnë.

Garantimi i kësaj mardhënieive të drejtë midis shitësit dhe blerësit të karburantit, nuk është thjesht një problem teknik dhe abuzim financiar ordiner, por është një përpjekje e qeverise për të ndalur këtë padrejtësi sociale që nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë.
Mund te themi se ndodhemi në një situatë të keq perdorimeve flagrante dhe të një vepre penale të dënueshme, ndodhemi në një pikë ku duhet të informojnë publikun se cilët janë këto karburante apo pika shitje që keqperdorin karburantet per qytetar te Kosoves.
Qytetarët në rolin e konsumatorit kanë të drejtën e pacenueshme dhe të mbrojtur nga ligjet në fuqi për t'u informuar, raste te keqperdoret çmimi e ngritur te naftes.

Çmimet e karburanteve në Ballkan

Çmimet e karburanteve në tregun botëror kanë arritur nivelin më të ulët në disa vite të fundit duke u reflektuar kështu drejtpërdrejt në çmimet e naftës në rajonin e Ballkanit, gjë të cilën e kanë mirëpritur qytetarët e zakonshëm të cilët ndodhen thellësisht të përfshirë nga problemet e përditshme ekonomike dhe sociale.

Çmimet e karburanteve më shumë do ti ndjejnë buxhetet e qytetarëve të Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë.

Ekspertët ekonomik besojnë se rënia e çmimeve të karburanteve, e cila është regjistruar gjatë disa javëve të fundit, në mënyrë pozitive mund të ndikojë si në konsum ashtu edhe në standardet jetësore të qytetarëve. Çmimet e karburanteve në Kosovë shënojnë rënie prej 10 deri 15 për qind.
Ulja e çmimeve në tregun botëror ka ndikuar edhe në uljen e çmimeve të karburanteve edhe në Kosovë, Para dy javësh 12.03.2015, çmimi i euro diezelit, në pompat e Kosoves ishte 1,15 euro. Javën e kaluar ka rënë në 1.10 euro, kurse së fundit, në këto shtatë ditët e kaluara ka shënuar edhe një rënie dhe aktualisht është 0.99 euro për litër.

Mund te theksojm se kjo rënie nuk është e njëjtë gjithkund për shkak se në Kosovë mungon rregullatori i çmimeve të naftës i cili do të ndikonte në formimin standard dhe transparent të karburanteve dhe jo vetëm kjo, por edhe do të kontrollohej cilësia gjatë importit të karburanteve, në kufi-Dogana dhe rezervat shtetërore të ndahen në mënyrë të barabartë.
Sa i përket çmimit të euro-benzinës prej 95 oktanëve, aktualisht një litër kushton 1.02 euro kurse, super-benzina pa plumb prej 98 oktanëve, kushton 1.05 euro.
Ndërkohë pompat e karburanteve të Kosoves, çmimet janë 1.03 euro për një litër euro-diezel, kurse çmimi i benzinës 95 oktan ishte 1.04 euro. Javë më parë. Evidente është se, çmimi i karburanteve në Kosovë, në këto dy javët e fundit ka shënuar rënie prej 10 deri 15%, por edhe çmimi i karburanteve dallon nga pompa në pompë dhe nuk ka një çmim të unisuar.

Çmimet e karburanteve në Federatën e BeH
Sipas nje llogarie shoferët në BeH për një rezervuar mund të kursejnë rreth 15 euro nese e mbushin ne territorin e Kosoves.
Çmimet e karburanteve në Federatën e BeH nga 25 dhjetori kan rene nën 2 KM, apo 1,02 euro, madje edhe deri 0,99 euro. Ndërkohë, ndërmarrja shoqërore "Auto-moto e BeH" (BIHAMK), që rregullisht përditëson informacione mbi çmimet e karburanteve në BeH dhe vendet e tjera të Evropës dhe botës, tregon se në tregun e BeH çmimi i benzinës 95 është 1,02 euro për litër, sa një litër benzinë.
Ndërkohë, çmimi mesatar i karburantit në Bosnje dhe Hercegovinë në fillim të dhjetorit të këtij viti ishte prej 1,17 - 1,25 euro. Sipas kësaj, çmimet e naftës në BeH për një muaj ka shënuar një rënie prej 0,15 - 0,23 euro. Pas rënies së çmimeve gjatë disa javëve të fundit, shoferët në BiH për një rezervua mund të kursejnë rreth 15 euro.

Çmimet e karburanteve në Serbi
Në Serbi, çmimet e karburanteve për një muaj bien për 0,10 euro, Sipas të dhënave të Shoqatës së kompanive të naftës në Serbi për muajin e kaluar, çmimi mesatar i benzinës në shumicën e pompave është më i ulët për 11,9 dinarë, apo 0,09 euro, i diezelit 0,06 euro, ndërsa i autogazit për 0,05 euro për

litër. Por, pas Vitit muajit mars pritet një rritje e çmimeve për 5 dinarë, apo 0,04 euro, për shkak të çmimeve në rritje të akcizës.
Që nga fillimi i dhjetorit vitit 2014 Industria e Naftës e Serbisë (NIS) për të shtatën herë ka ulur çmimin e karburantit, dhe në qoftë se shikohet periudha nga 1 nëntori, çmimet e benzinës në pompat e NIS-it janë më të ulëta për 0,13 euro, ndërsa të naftës për 0,08 euro për litër.
Aktualisht në pompat e NIS-it Euro-premium BMB 95 kushton 1,09 eur, për Euro BMB 98 duhet të ndahen 1,19 euro, për Premium Euro-disel 1,2 euro dhe për Euro dizelin 1,18 euro për litër.

Çmimet e karburanteve në Male te Zi
Ndër vendet e tjera të rajonit, çmimet e karburanteve në Malin e Zi nga e mërkura javën e fundit kanë rënë për 5-7 cent. Rënia konstante e naftës në bursat botërore ka shkaktuar uljen e çmimeve të derivateve të naftës edhe në Mal të Zi.
Kështu një litër të eurosuper BMB 98 do të kushtojë 1,18 euro, ndërsa eurosuper BMB 95 do të kushtojë 1,15 euro. Një litër naftë kushton 1,08 euro, që është gjashtë cent më pak nga llogaritja e fundit e çmimeve.
Çmimet e karburanteve në Malin e Zi prej kohësh kanë qenë më të lartat në rajon. Duke pasur parasysh se çmimi aktual i BMB 95 është 1,15 euro, për herë të fundit çmimet e ngjashme të naftës janë regjistruar në mars të vitit 2010.

Çmimet e karburanteve në Kroaci
Në Kroaci rënia e çmimeve të karburantit nën kufirin "psikologjik", Ngjashëm si në Malin e Zi çmimet e karburantit në Kroaci vazhdojnë të bien, ndërsa për herë të parë pas katër vitesh Eurosuper në pompat e INA-s ka rënë nën kufirin "psikologjik" prej nëntë kuna apo 1,17 euro. Kështu të qe ne javen e kaluar çmimi i benzinës më të shitur Eurosuper 95 ka rënë në krahasim me ditët tjera për 31 qind dhe arriti në 8,90 kuna apo 1,16 euro. Çmimi i naftës BS është 1,1 euro, ndërsa dizel BS Class është 10 lipa më i shtrenjtë për litër, ndërsa më i shtrenjtë në pompat e INA-s është Eurosuper 98 dhe çmimi i tij është 1,18 euro. Pas uljes së çmimeve në dy muajt e fundit, shoferët e makinave në Kroaci në një rezervuar mund të kursejnë rreth 10 euro. Në qoftë se çmimi krahasohet me atë të verës, diferenca është edhe më e madh dhe arrin deri në 15 euro.

Çmimet e karburanteve në Shqiperi
Në Shqipëri, gjithashtu, që në fillim të dhjetorit 2014, është regjistruar rënia e çmimeve të karburanteve. Pra, në javën e parë të dhjetorit një litër diezel ka kushtuar 177 lekë, apo 1,26 euro. Një javë më pas, përkatësisht deri 15 dhjetor, një litër diezel ka kushtuar 172 lekë, apo 1,23 euro. Çmimi i naftës ka vazhduar të bjerë edhe pas gjysmës së parë të dhjetorit, kështu që më 22 dhjetor çmimi i benzinës për litër ka qenë 167 lekë, apo 1,19 euro.



	SHKU	MARS	PRILL	MAJ	QERS	KORR	GUSH	SHTA	TETOR
Marzhi L/ltr (me TVSH)	20.5	25.7	29.4	30.7	30.0	27.0	25.9	28.0	30.2
Referenca L/ltr (me TVSH)	161.5	156.3	152.6	151.3	152.0	155.0	156.1	154.0	151.8

Levizja e cmimieve mujore ne Shqiperi

Çmimet e karburanteve në Maqedoni
Sipas të dhënave të fundit zyrtare për Maqedoninë, çmimi i benzinës 95 është 65,50 denarë, apo 1,06 euro, i benzinës 98/100 67,00 denarë apo 1,09 euro dhe çmimi i dizelit për litër 56,00 denarë, apo 0,91 euro.
Nga ana tjetër, në Evropë, karburant më të shtrenjtë paguajnë qytetarët e Norvegjisë, të cilët për një litër të eurosuper 95 duhet të ndajë 1,7 euro, ndërsa eurosuper 98 kushton 1,78 euro dhe eurodizel 1,57 euro. Çmimet më të ulëta të karburanteve janë në Rusi, ku qytetarët e këtij vendi për një litër të eurosuper 95 ndajnë 55 cent, ndërsa për eurodizel 53 cent.
A ka mundësi reale që tregu këtë herë të jetë neutral ndaj rritjes së taksës? Në rast se "lojtarët" që e dominojnë kërkojnë ndryshimin cilësor, një treg të maturuar konform standardeve europiane, mund të ketë gjasa që rritja të jetë e papërfillshme.

Autoriteti i Konkurrencës është në përfundim të një hetimi tremujor. "…në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës"; konkretisht dy nëntregjeve kryesore të shitjes me shumicë: diezelit 10 ppm e benzinës 95 RON, që në varësi të çmimeve të bursës, kursit të këmbimit e kërkesës vjetore të tregut tonë, nxjerrin jashtë vendit afër gjysmë miliardi USD në vit e u kushtojnë konsumatorëve 46% të çmimit fundor në pompë.
Mediat kanë informuar shifra e fakte shqetësuese lidhur me monopolizimin e deformimin e tejskajshëm të tregut; duket edhe institucioni "avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit" e konstatoi këtë të paktën për vitin 2013.

Treg i përqendruar

Një skanim i situatës do të jepte të dhëna të mjaftueshme për nivelin e përqendrimit në tregun e karburanteve. Procesi i ka fillesat në 2008-n me privatizimin e ARMO-s dhe mori rrugë në 2009 me dhënien asaj të monopolit për tregtimin e naftës D2 që kapte 80-85% të tregut të karburanteve automotive. AK e ka marrë më parë në hetim këtë periudhë; fakt është se asnjë penalitet i dhënë (nëse u pagua) nuk pengoi kompaninë e privilegjuar të vazhdonte ndoshta edhe në vitin 2010 e më tej me naftë D 1000 e 350 ppm, me "dokumente të rregullta"! Vitet 2009-2010 konsiderohen si të "standardeve të dyfishta në treg".
Aplikimi i parametrave cilësorë europianë u kthye armë në duart e shtetit e agjencive të tij për të goditur e favorizuar kompanitë sipas preferencave klienteliste: ku duhej, tregtohej me VKM edhe virgina, ku s'duhej, kontrollohej nëse diezeli e benzina ishin 10 apo 10.1 ppm.
Presioni me gjoba e penalitete të diferencuara, aplikimi i një barre fiskale të stërndryshueshme e penguese, vendosja e kasave fiskale si mjet përfitimi, tarifa të larta shërbimi etj., e dëmtuan klimën e besimit në këtë sipërmarrje fitimprurëse.

Një numër i madh kompanish, sidomos të huaja e mikse që nuk u integruan dot në modelin ton te dystandardeve, gradualisht humbën terren, shitën ose dhanë me qira aktivitetin, u tërhoqën ose falimentuan, ndërkohë përfituan e u faktorizuan 1-2 të reja.
Në tregun e shumicës mbetën 3-4 importues nga mbi 24 të tillë në vitin 2008; efektet e krizës përshpejtuan procesin. Viti 2012 thelloi karakteristikat oligopoliste sipas vargut Mackenzie të influencës 31+20.5+10.25+..nx0.125; tre "big-ët" OFN, me pjesë tregu rreth 85%, shfrytëzuan dominimin dhe nisën integrimin vertikal duke ndërtuar e marrë me qira stacione në pozicione të favorshme. Synimi ishte kontrolli i plotë i ciklit deri në pompë për maksimizimin e fitimeve e mbajtjen të pandryshueshme të çmimeve.

Ekspansioni dha rezultat jo vetëm për periudhën nga janari 2013 marrë në shqyrtim nga AK, por që nga marsi 2012 e deri tani, siç ilustrohet nga grafiku i trendit të ecurisë së kuotimeve Platts nga janari 2012 për ngarkesat HCIF Med Italy të benzinës e diezelit.
Çmimet e karburanteve për automjete si gazoil ULSD dhe benzinë Euro-Super 95 pësuan rënie në Bursën e Londrës pavarësisht kërkesës në rritje përgjatë sezonit veror. Sidomos rënia e benzinës u bë evidente pas mbylljes së shpejtë të sezonit herët në shtator. Sipas European Marketscan Platts, kuotimi më i lartë High FOB (CIF) Med Italy ishte pothuajse në ulje kostante me 15-20 USD/TON në

javë nga fundi i gushtit në tetor, ndërsa për gjithë periudhën: pas një maksimumi në qershor respektivisht Benzina 95 prej 1067 e Gazoili 10 ppm 968 USD/TON, çmimi ra në minimumin historik 746 dhe 737 USD/ TON në javën e dytë të nëntorit dhe në vlerë absolute 321 dhe 231 USD/TON.

Reagimi i Qeverise se Kosoves

Pas shkurtit 2013, gjithë rajoni e Europa ndryshoi çmimet progresivisht me rënie; në tabelat e stacioneve të lojtarëve tanë kryesorë, ato nuk ndryshuan?! Prej gushtit 2011, kur ishët aplikuan taksën e qarkullimit prej 5.5 euro/litër, rritën taksën mjedisore në 0.75 e 1.5 euro/litër e deri në gusht 2013 kur u shtua me 0.312 euro/litër (pa TVSH) për markimin, kostoja është varur gati krejtësisht nga çmimi në bursa. Sikur tendenca të ishte ndryshe, ku do të shkonin çmimet? Le të krahasojmë ecurinë e çmimeve në vendet fqinje, Italisë e Greqisë, nga sigurohen mbi 90% e importeve.
Sipas informacionit të publikuar prej ministrive të linjës dhe shoqatave hidrokarbure për vitin 2013, çmimet përfaqësuese në pompa janë sipas grafikëve. Nga rënia e kuotimeve në bursa, çmimi i benzinës në pompa ka rënë progresivisht rreth 5%, ndërsa i diezelit rreth 3.5%. Sikur kjo rënie të ishte aplikuar korrektësisht në pompat tona, aktualisht çmimet duhej të ishin për benzinën 7-10 euro më pak, për diezelin 4-6 euro më pak.

Në Kosove nuk ekziston akoma publikimi ligjor i strukturës së çmimeve në bazë të një metodologjie që kalkulon zyrtarisht kostot bazë e ndikimin e këmbimit, në marrëveshje me shoqatat hidrokarbure; tregjet rreth e rrotull e bëjnë këtë punë. APP ka publikuar referenca periodike për efekt prokurimi publik; pavarësisht objeksioneve mbi saktësinë e deklarimeve, ato kanë luajtur rol indikativ. Gjithsesi, pa strukturën e çmimeve në pompë, s'mund të sqarohet mekanizmi i luhatjes së çmimeve; fitimi i deklaruar nga operatorët mbetet i pabesuar.

Në skicimet e mëposhtme jepet struktura legale e çmimeve në pompat italiane e greke për javën e parë të dhjetorit 2013, ku pjesën dërrmuese të çmimit e përbëjnë taksat dhe blerja nga rafineria. Marzhet shkojnë deri 16.5%, por në të nuk është përfshirë kostoja e transportit detar, sepse APP llogarit referencën me 30 USD/ton mbi kuotimin HCIF Med Italy, pra e përfshin atë.
Rritja e taksës së qarkullimit mund dhe duhet të absorbohet nga kompanitë që dominojnë tregun duke ridimensionuar aktivitetin në funksion të një marrëdhënieje korrekte e bashkëpunuese me autoritetet. Ulja graduale e marzheve në funksion të lehtësimit të publikut në kushtet e krizës dhe gropës buxhetore, do të jetë hapi i parë për formalizimin real të tregut dhe investimi më i rëndësishëm që ky biznes do të bëjë për të ardhmen.

Aktet normative

Drejtoria e Metrologjisë bëri veprimin që pritej prej saj, ka hartuar Aktin Normativ, i cili qartëson pozicionin e kësaj Drejtorie për publikimin e këtyre subjekteve dhe është e gatshme ta zbatojë atë në momentit që do të miratohet. Por, një gjë e tillë është absurde në momentin që nuk ka Kuvend që ta miratojë Aktin.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vijuar kontrollet në zbatim të ligjit për respektimin e standardeve në fushën e importit dhe tregtimit të karburanteve, dizell dhe benzinë.
Trupat inspektuese të cilësisë dhe sasisë së karburanteve të lëngëta të naftës, kanë ndërmarr aktivitete shtesë në kontrollin e cilësisë së karburanteve që tregtohen brenda territorit të Republikës së Kosovës.
Nga kontrollet e ushtruara janë marrë gjithsej 22 mostra në pikat shitëse me pakicë. Aksioni është ndërmarrë edhe në bashkëpunim me Shoqatën e naftëtarëve të cilët kanë rekomanduar marrjen e disa mostrave në disa pika të dyshimta për ta.
Mostrat zakonisht dergohen ne testim. Ky veprim shtesë eshte, pa paralajmërim, dhe po ndërmerret për të qartësuar dyshimet e ngritura rreth cilësisë së karburanteve që tregtohen brenda vendit.

Marrja e mostrave per kontrollimin e cilesise se naftes dhe benzines ne Kosove

Saktesia e pajisjeve elektronike matese per nxjerrjen e naftes

Metrologjia është shkenca e matjes, metoda(t) për të përcaktuar matje të sakta dhe të besueshme të pajisjeve, makinerisë, dhe mallrave tjera. Metrologjia është shumë e rëndësishme për Kosovën për të siguruar që matjet e masës, peshës, vëllimit dhe parametrave tjerë të mallrave bëhen saktë në pajtim me matjet ndërkombëtare dhe të BE-së.
Testimi i produkteve përfshin analizën e karakteristikave, përbërësve, tipareve, kapaciteteve, specifikacioneve, komponentëve, etj. Është me rëndësi të keni siguri në besueshmërinë e testimit të produkteve në mënyrë që të përcaktohet përshtatja e një produkti me rregulloret teknike dhe/ose standardet e produktit. Këtu është vendi ku shërbimi metrologjik kompetent është jetësor për zhvillimin e ekonomik të Kosovës.

Pajisja elektronike digjitale per nxjerrjen e naftes nga tubat kryesore te furnizimit

Departamenti Metrologjik i Kosovës (DMK) organizohet dhe funksionon nën autoritetin e Ligjit për Metrologjinë nr. 03/L-203, dhe kryen aktivitetet e tij nën mandatin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. DMK është i vetmi institucion shtetëror në Kosovë që është përgjegjës për themelimin dhe

menaxhimin e sistemit metrologjik në Kosovë, duke përfshirë matjet e ndërlidhura me metalet e çmueshme
Te gjitha psjisje qe perdoren per nxjerrjen e nafes duhet te vendosen një sistem të qëndrueshëm e kompatibil të metrologjisë në Kosovë, keto pajisje duhet te Kalibrohen dhe do të mundësojë:
Matje në pajtim me sistemin e njësive matësi SI.
Matje të sakta dhe të besueshme me qëllim të mbrojtjes së jetës, shëndetit njerëzor, kafshëve, mjedisit, konsumatorëve dhe burimeve natyrore;
Instrumente të sakta matëse në mënyrë që të rris cilësinë e produkteve dhe shërbimeve vendore në mënyrë që të jenë konkurrente në tregun vendor dhe ndërkombëtar;
Të zhvillojë metrologjinë shkencore për të kontribuar në zhvillimin e kushteve të nevojshme që do t'i përgjigjen metrologjisë rajonale e ndërkombëtare, që ndikon në integrimin e ekonomisë sonë në ekonominë e tregut.

Laboratoret e Institucioneve te cilat sherbejn me naft dhe benzin jane në varësi të programeve të studimeve, disponojn kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale te gjitha keto pjisje duhet kalibruar dhe duhet te nxjerret saktsia e matjeve te tyre ne teren.
Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.
Sistemit të Transmisionit, mund të kryejë këto shërbime:
furnizimin me Pajisje Matëse;
instalimin, matjen, testimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e Pajisjeve Matëse;
shërbimet e mbledhjes së të dhënave;
transferin e të dhënave,
procedimin e të dhënave dhe
shërbimet e grumbullimit të të dhënave.

Metrologjia Legale të Kosovës, paraqet edhe një hap në forcimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Ky gurthemel është edhe më i rëndësishëm kur dihet fakti se që nga viti 1947 kur u themelua Shërbimi i metrologjisë në Prizren, ky është ndërtimi i parë në këtë lëmi. Rëndësia e këtij laboratori bëhet edhe më e madhe duke marrë parasysh nevojat e ekonomisë sonë e cila po zhvillohet me trende në rritje nga viti në vit duke patur si qëllim integrimin sa më të shpejtë të vendit tonë në ekonominë regjionale dhe evropiane.

Departamenti i Metrologjisë së Kosovës

DMK është organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit për Metrologji, ndërsa aktivitetin e vet e zhvillon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. DMK është Institucioni i vetëm nacional në Kosovë i cili është përgjegjës për vendosjen dhe udhëheqjen e sistemit të metrologjisë në Kosovë, përfshi edhe metalet e çmuara.
DMK përfaqëson një nga shtyllat kryesore të infrastrukturës teknike të cilësisë në Kosovë, qe së bashku edhe me shtyllat tjera të kësaj infrastrukture si Agjencine e Standardizimit te Kosoves, Njesine e Akreditimit, etj paraqet bazë të fortë për zhvillim të qëndrueshëm shkencor, teknologjik dhe ekonomik, si dhe mbështet përfshirjen e Kosovës në integrimet Evropiane dhe ndërkombëtare.
DMK është përgjegjës për implementimin e ligjeve në fushën e metrologjisë, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, si edhe akteve nënligjore në implementimin e këtyre ligjeve.
DMK është e strukturuar dhe funksionon me dy njësi te ndara fizikisht:

Divizioni i Metrologjise dhe Inspektimit ne Prishtinë dhe
Instituti i Metrologjisë Legale në Prizren.

Me qëllim të realizimit të misionit te saj dhe vendosjes se sitemit te metrologjise ne pajtim me praktikat e mira, DMK eshte angazhuar në zhvillimin e tri funksioneve të metrologjisë: shkencore, industriale dhe ligjore.

Pajisjet laboratorike, te cilat janë identifikuar do te mbulojnë fushat si: Gjatësi, mase, vëllim, rrjedhje, elektrike, force, presion dhe termometri.
Po ashtu me kërkesë te DMK-se, Qeveria e Kosoves ka miratuar një projekt investues prej 100.000 €, për renovimin e godinës se metrologjisë ne Prizren per kalibrimin e pajisjeve elektronike.
Ne drejtimin e metrologjisë ligjore, me kapacitetet ekzistuese te personelit dhe pajisjeve laboratorike, DMK aktualisht është duke mbuluar kontrollin metrologjik te këtyre mjeteve matëse:

Metra te tekstilit dhe thuprat metalike;
Gramarë te llojeve dhe kapaciteteve te ndryshme;
Peshore te llojeve dhe kapaciteteve te ndryshme;
Distributore te karburanteve;
Njehsor për matjen e energjisë elektrike, trefazor dhe monafazor (induktiv dhe elektronik);
Taksimetra dhe tahograf (këto dy fushave nëpërmjet subjekteve te autorizuara).

"Pa kupon tatimor nuk ka Karburant"

Sistemi fiskal tepër e avancuar për shërbimin e tregtimit të hirdrokarbureve, bën të mundur printimin e kuponave tatimorë nga Distributorët e Karburantit sipas parimit, "Pa kupon tatimor nuk ka Karburant". Kasa duhet të pajiset me Printer Seiko Easyloading vetëprerës, letër 58 mm dhe me QSHKE, sikurse është e aftë të printojë deri në 200.000 kupona tatimorë.
Gjithashtu mundëson lidhjen me Dispenserat të tipit, Gilbarco, Mepsan, Mekser, Dresser Wayner, Nuovo Pignone, Baransay, 2A dhe Nuova Migas me kokë elektronike.

Sistemi elektronik digjital-Kuponi

Veçojmë se, sistemi elektronik digjital krijon mundësinë e printimit të kuponëve me;
opsionet tollon,
faturë,
transferim
test.
Me opsionin Tollon i jepet mundësia operatori të fusë të dhena si numrin serial të tollonit/ targën e makines. Kuponi del në dy kopje, njëra është info tatimore, kurse tjetra info jo tatimore.
Sistemi mundëson, ndër të tjera edhe dërgimin e të dhënave online në fund të çdo Raporti zyrtar. Edhe në rastet kur pompa punon në mënyrë manuale, pas rilidhjes së saj me sistemin fiskal bëhet e mundur printimi i të gjitha shitjeve, keto sisteme elektronike digjitale duhet te perdoren ne Kosove dhe te jen te gjitha pompat nen kontroll nga Qeveria e Republikes se Kosoves.

Literatura

Ministria e Tregtise dhe Industrise –MTI-raportet vjetore 2012/2013/2014.
Bursat nderkombetare per karburante ne Amsterdam Holland.
www.dezell.com
GFI » Bloomberg<<
Udhëzim administrativ Nr. 2007/18
Ligji Nr.2004 / 5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë.
Departamenti Metrologjik i Kosovës -Kalibrimi i pajisjeve ne laboratoret e MTI-se ne Prizren.

PHD. ELONA PRROJ – NJË VËSHTRIM SOCIOLOGJIK MBI GJAKMARRJEN

PHD. ELONA PRROJ
Psikologji, Shkencat Sociale, Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakt

Moderniteti dhe gjakmarrja janë fenomene sociale kontradiktore dhe globalizimi hedh dritë mbi ekzistencën e gjakmarrjes në një botë të modernizuar. Në këtë punim, teoritë e modernizmit të Weber dhe Durkheim do të ritrajtohen në mënyrë që të kuptojmë se çfarë lidhje ka midis modernizmit dhe gjakmarrjes. Këta dy gjigandë të teorive klasike sociologjike e kanë integruar fenomenin në teoritë e tyre sociale në një mënyrë shumë të ndryshme nga njeri tjetri. Për Weber, gjakmarrja në fakt është shtylla qëndrore e teorisë së tij të organizimit politik, ndërsa Durkheim e shikon atë si një ndër shumë aspektet e shoqërizimit pasionant. Pasojat teorike të këtyre dy përqasjeve kaq të ndryshme do të mund t'i shikojmë dhe analizojmë në këtë punim. Para së gjithash do të përpiqem të jap një përmbledhje të teorive të gjakmarrjes në mënyrën se si ato renditen në kërkimet etnologjike, sociologjike dhe historike.
Sekreti i ekzistëncës së gjakmarrjes ndoshta nuk do të zbulohet në fund të këtij punimi, por ne mund të kemi ide më të qarta në atë se çfarë mund të ofrojnë teoritë sociale në mënyrë që të shpjegojnë këtë fenomen.

Fjalët kyce: Globalizimi, solidariteti organik, gjakmarrja, dhuna, kontrolli i pasionit.

Hyrje

Gjakmarrja është duke rifituar shumë interes në shkencat sociale pas një gjysmë shekulli të një konsiderate të vogël. Kriminologjia për shembull, është e interesuar në konkurencën e ligjit të shtetit modern dhe sistemit legal tradicional. Etnologjia ka qenë shumë aktive në kërkime mbi gjakmarrjen në Kosovë, Shqipëri dhe zona të tjera të Ballkanit. Teologjia ka rizbuluar gjakmarrjen si një problem të një drejtësie hyjnore që mbështetet në thënien; "Sy për sy dhe dhëmb për dhëmb". Vetë Bashkimi Europian po përballet me pasojat e këtij fenomeni ndërsa kërkon të gjejë zgjidhje për qindra emigrant azil-kërkues që deklarojnë se janë të kërcënuar me jetën për shkak të gjakmarrjes po të kthehen në vendin e tyre.

Të gjitha këto: emigrimi, internacionalizimi i konflikteve etnike, dhe konkurenca në rritje midis traditës dhe fesë – mund të përmblidhen si fenomeni i globalizimit. Për më tepër, mund të thuhet se globalizimi ka sjellë në dritë gjakmarrjen si një fenomen ekzistues ligjor dhe kulturor i cili nuk mund të anashkalohet.
Ka pasur një periudhë të interesit shkencor për gjakmarrjen kohë më parë. Shumica e artikujve për fenomenin datojnë ose në kohën tonë, ose ne fillimet e shek XX. Për këtë literaturë, fenomeni i gjakmarrjes ishte me interes si një fenomen etnologjik. Nga ana tjetër gjakmarrja shihej si një problem i hershëm, ligjor, europian dhe ishte interesante për shkencat sociale sepse ofronte një këndvështrim alternativ të sistemit ligjor modern dhe të zhvillimit të tyre të parashikuar. Gjakmarrja ka të bëjë më shumë me pasionin për të trazuar ndjenjat për hakmarrje dhe me vetë-gjyqësinë. Disa preferojnë ta lexojnë gjakmarrjen si një alternativë ndryshe ndaj modernitetit. Të tjerë e shohin atë si një apendiks qesharak të paramodernitetit. Honore de Balzak, novela e Gjakmarrjes u shkrua ne një kohë të një mungese të madhe të rregullit social dhe moral dhe pasqyronte dëshirat e tij për "kohët e mira të vjetra". Burime të tjera të literaturës nga ana tjetër kanë tendencë t'a banalizojnë këtë fenomen. Nga pikëpamja e këtyre autorëve gjakmarrja është një shenjë e një karakteri të papjekur kulturor.

Sado të tunduar të jemi për të gjykuar fenomenin e gjakmarrjes, ekzistenca e saj mbetet e pakuptueshme në një shoqëri moderne si kjo e sotmja, veçanërisht pasioni që përfshihet në të, që mund të admirohet ose të përqeshet, por vështirë të kuptohet.

Gjakmarrja Dhe Rregulli Social

Gjakmarrja është përshkruar ndoshta si një mekanizëm primitiv, por efektiv për kufizimin e dhunës. Nderi nuk është domosdoshmërisht një aspekt i gjakmarrjes edhe pse shpesh përfshihet ne dinamikat e saj. Nderi është pjesë e aleancë-bërjes që në shumë shoqëri është si rezultat i gjakmarrjes dhe i frikës ndaj saj. Prandaj fenomeni i gjakmarrjes ka vërtetuar të jetë shumë me i komplikuar sesa palët e përfshira në të do të dëshironin të ishte. Shpesh prek shumë më shumë njerëz sesa ishte paramenduar nga fillimi. Një drejtues heroik dhe sakrilegj mund të imponoj për një moment rregulla strikte mbi gjakmarrjen për të ndaluar rrethin vicioz të gjakderdhjes. Ky fenomen kështu prek një numër çështjesh që janë thelbësore për një shoqëri, siç janë: familja, skllaveria sociale, dhe pikëpyetjet për shtetërimin. Edhe pse gjakmarrja sjell shumë konfuzion për spektatorët modern, do të ishte gabim i madh t'i konsideronin të njëjta gjakmarrjen me çrregullin social. Madje mund të merret me mend një nocion i caktuar i rregullit social në gjakmarrje. Fjala 'Kanun' përshkruan dhe nënkupton një set tradicional idesh qe është rregullator i gjakmarrjes. Në ngjashmëri të dukshme me "kanunin" ligji Roman tregon që vetë shoqeritë e konfliktuara shohin një rregull pas kaosit të dukshëm. Në disa shoqëri madje ligji i gjakmarrjes është e kundërta e kaosit. Parë nga ky këndvështrim, gjakmarrja është një mekanizëm social që shërben si faktor parandalues i dhunës që të mos shpërndahet në të gjitha drejtimet. Në hyrjen e Enciklopedisë Italiane, etnologu Italian Raffaele Corso (1930) sygjeron që themeli universal i çdo gjakmarrje është ideja që vetëm gjaku mund të lahet me gjak dhe me asgjë tjetër. "kushdo që derdh gjakun e një njeriu, me anë të njeriut do të derdhet edhe gjaku i tij. Sepse Perëndia e krijoi njeriun në shëmbëlltyrën e Tij (Zanafilla 9:6)". Ky është shpjegimi biblik i këtij koncepti. Mund të thuhet ndryshe se ata që vrasin për të marrë gjakun, e bëjnë këtë për të vendosur në vend dhe për të rregulluar një situatë që më parë është prishur nga dikush tjetër. Nga ky këndvështrim gjakmarrja shfaqet si të jetë 'një detyrim i shenjtë' i një grupi ndaj një ose disa personave të dëmtuar ose edhe të vrarë nga anëtarë të një grupi tjetër. Sipas Corso (1930) vrasja për gjakmarrje kryesisht drejton në dy forma të kohëzionit shoqëror: solidaritet aktiv dhe pasiv. Rregulli që i atribuohet dhunës është natyrisht shumë i dobët, por duhet të kuptohet që baza dhe ideja parësore e marrjes së gjakut ka qenë për të vendosur rregull dhe jo për të krijuar kaos. Nëse ne e pranojmë gjakmarrjen si një mekanizëm ndoshta primitiv për frenimin social të dhunës, menjëherë duhet të perballemi me faktin që është provuar gjithashtu që ajo të jetë një faktor i vazhdueshmërisë së dhunës. Ideja e marrjes së gjakut është kaluar nga brezi në brez derisa është realizuar dhe përmbushur. Nëse gjakmarrja kombinohet me çështjen e nderit (ashtu siç ka ndodhur shpesh), atëherë jo vetëm dëmtimi fizik duhet të shpaguhet me gjak, por gjithashtu edhe dëmtimi i nderit të personit. Psh. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, nëse në një konflikt të ashpër, dikush vret dikë tjetër duke i dëmtuar fytyrën, personi vrasës i ka marrë viktimës jo vetëm jetën, por edhe nderin e tij, pasi fytyra është simbolikë e nderit. Vrasësi do ta bënte një gjë të tillë vetëm nëse viktima gjatë konfliktit do ta cënonte nderin e vrasësit. Përndryshe nëse viktima nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe është vrarë nga vrasësi duke iu dëmtuar fytyra, atëherë familja e dëmtuar ka të drejtën sipas kanunit që të marrë dy herë gjak ose të bëj një vrasje të ngjashme duke dëmtuar fytyrën tek personi që do të hakmerret. Kjo gjë mund ta bëj këtë ligj vërtet të komplikuar dhe të humbasë efektin e tij rregullues. Gjithashtu dhënia dhe marrja e 'Besës' mund të jetë një proçes lehtësues dhe ndihmues madje dhe sigurues për një farë kohe për disa anetarë të familjes së ngujuar, por kur nderi, që është si një rektor shpirtëror i grupeve dhe fiseve familjare, është nën kërcënim, gjakmarrja bëhet frikshmërisht e komplikuar.

Thyerja e Besës duket të jetë një burim i pashmangshëm i gjakmarrjes, sepse besa përfshin disa aktorë konfliktual, jo vetëm palët e konfliktuara në fillim. Keshtu psh, nëse një person vritet kur është mik në shtëpinë e dikujt tjetër, vrasësi e ka prerë në besë të zotin e shtepisë dhe ai do të kërkojë që të hakmerret për gjakun e personit të vrarë edhe nëse nuk ka asnjë lidhje gjaku apo farefisnore me viktimën. Gjithashtu është farefisi i personit të vrarë që mund të mbajë dy qëndrime ndaj një situate të tillë: Do të përpiqet vetë që të marrë gjakun e personit të tyre të afërt, ose do të detyrojë ose kërcënojë

të zotin e shtëpisë në të cilën u vra personi, që ai vetë të marrë hak për personin që u vra nën besën e tij.

Max Weber Mbi Gjakmarrjen

Teoria sociale e Maks Weber nuk e kupton shoqërinë si prodhim të një rrjedhje të parashikueshme të ngjarjeve. Dikush mund ta quajë teorinë e tij anti-marksiste pasi ajo refuzon idenë e historisë lineare dhe 'ligjeve' sociale. Ideja e Weber për zhvillimin historik mund të jetë shumë më mirë e krahasuar me një grup të komplikuar hekurudhash. Shoqëritë (ashtu si trenat) ndjekin gjurmët që ata mund të mos i kenë zgjedhur, por të cilat janë pasoja të zgjedhjeve të mëparshme. Weber argumenton se njerëzit dhe shoqëritë fillimisht nuk ishin aq të ndryshëm nga njëri-tjetri. Në fakt, edhe këto kultura gjeografikisht dhe filozofikisht të dallueshme, siç janë kinezët dhe evropianët ishin shumë të ngjashëm në fillim: "Sa më shumë që të kthehemi pas në histori aq më pranë janë kinezët dhe kultura e tyre me atë që mund të gjendet edhe në kulturën tonë.

Është përmes një proçesi që Weber e quan "racionalizim" që kulturat devijojnë gjithnjë e më shumë deri sa përfundojnë në "gjurmë" kulturore krejtësisht të ndryshme. Kuptimi i tezës së racionalizimit të Weber ka qenë shumë më i diskutuar. Problemi i lexuesit në përpjekjen për të kuptuar "racionalizimin" është se për Weber, "racionaliteti" ndonjëherë nënkupton edhe atribute të tjera si 'perëndimor', 'evropian' ose në rastin e ligjit racional edhe 'gjerman'. Nga njera anë racionalizimi është një proçes universal. Nga ana tjetër fjala racionalizim siç Weber e përdor, nënkupton zhvillim specifik të kulturës perëndimore. Nëse qëndrojmë në kuptimin e "racionalizimit" si një grup zgjedhjesh dhe degëzimesh kulturore që çojne në zhvillimin e zakoneve të caktuara kulturore, arrijmë të kuptojmë se pse Weber është kaq i interesuar në gjakmarrjen. Ne nuk do të të gjejmë ndonjë gjurmë të një historie Weberiane globale të gjakmarrjes. Por pavarsisht, gjakmarrja edhe sot dhe kësaj dite është me rëndësi qëndrore në argumentimin e Weber-it. Për të gjakmarrja është një institucion universal. I përket logjikës së çdo njeriu dhe çdo kulture. Politika nga ana tjetër, është më tepër një fenomen perëndimor. Përvec qyteteve, orienti kurrë nuk ka ditur mjaftueshëm rreth politikës sipas Weber. Qyteti oriental i cili ishte kryesisht i organizuar për qëllime administrative, mundet që teorikisht të ketë instaluar një entitet të politikes, por eficenca e tij zbehet shumë shpejt përtej mureve të qytetit. Banorët e fshatit mbështeteshin shumë në gjakmarrjen kur kishte të bënte me sigurinë personale dhe zbatimin e ligjit. Pra për Weber, kultura perëndimore është përshkruar edhe nga politika e forcës së saj publike. Eshtë një rrugë e drejtë nga gjakmarrja në politikë në shoqëritë perëndimore. Gjakmarrja dhe politika duhet të kuptohen si dy skajet e një linjë zhvillimi. Teoria e Weber për gjakmarrjen është një teori e forcës publike ose e dhunës politike.

Argumentohet se per Weber, i gjithë përdorimi i dhunës është politikë e qartë. Edhe pse mund të thuhet se dhuna dhe politika janë të lidhura ngushtë, një pamje e tillë duket të jetë pak dritëshkurtër. Janë të gjitha mënyrat e tranzicionit të vazhdueshem duke filluar nga lloji i përgjakshëm i konfliktit i cili, po të lëmë mënjanë të gjitha rregullat, synon shkatërrimin e kundërshtarit, me rastin e betejës së kalorësisë mesjetare, dhe te rregullat strikte të vendosura në sport nga rregullat e lojës. Do të ishte në këtë mënyrë një ekzagjerim po të supozohej se e gjithë dhuna për Weber është politike. Për ate e kundërta mund të aplikohet: "Të gjitha strukturat politike janë të bazuara në përdorimin e dhunës". Politika dhe dhuna mund të mos jenë të njëjta, por ato ndërlidhen shumë. Një 'komunitet politik' percaktohet si një komunitet veprimi shoqëror që ka për qëllim varësinë ndaj dominimit të rregullt nga pjesëmarrësit e një "territori" dhe sjelljen e personave brenda saj, përmes gatishmërisë së përdorimit të forcës fizike, duke përfshirë normalisht forcën e armëve". Pushteti politik në këtë kuptim mund të gjurmohet në të gjitha llojet e grupeve shoqërore, dhe madje edhe familja / klani në sytë Weber-it nuk është gjë tjetër veçse një formë shumë bazë e bashkësisë politike. Stabiliteti i strukturave klanore është e garantuar nga gjakmarrja. Ky koncept është universal dhe mund të gjenden në fazat e hershme të zhvillimit kulturor të të gjitha shoqërive. Gjakmarrja sipas Weber, mbetet burimi kryesor i sigurisë individuale në shoqëritë që nuk kanë një aparat të integruar për administrimin legjitim të forcës: Vetem kur grupi luftarak, i shoqëruar përtej rrjedhës së përditshme të jetës, është i përshtatur në një komunitet të përhershëm territorial dhe kur në këtë mënyrë një organizatë politike është formuar, që të

dy mbajnë një legjitimitet specifik për përdorimin e dhunës. I gjithë ky proçes ndodh në mënyrë graduale. Organizatat ushtarake mund të mbajnë mjetet e kontrollit të dhunës në duart e tyre, por kjo nuk është gjithmonë në interesin e tyre për të organizuar monopolin e forcës. Grupe të tjera shoqërore janë shumë më të interesuar në ndalimin e gjakmarrjes dhe organizimin e dënimit publik. Priftërinjtë janë ndër ata që kanë pasur një interes të gjallë në administrimin e 'denimeve', të cilat janë aplikuar gradualisht në vend te gjakmarrjes. Ndikimi i priftërinjve të krishterë dhe vendosmëria e tyre për t'i dhënë fund sistemeve të gjakmarrjes janë arsyet specifike për racionalizimin e forcës publike në Evropë. Dënimi - një term që përshkruan ndërhyrjen e një pale të tretë në një mosmarrëveshje, nuk është një shpikje e priftërinjve të krishterë, por ata janë përgjegjës për çështjet administrative dhe ligjore dhe ndërkaq të interesuar në zgjerimin e fushës së kompetencës. Gjakmarrja është një kërcënim serioz për kompetencën meshtare në shoqëritë perëndimore dhe kjo është një ndër arsyet pse ata janë të interesuar në nxjerrjen jashtë ligjit të saj. Priftëria orientale kurrë nuk ka pasur të njëjtin interes në luftimin ndaj gjakmarrjes, pasi interesi i saj primar qendronte në mbajtjen e rendit të caktuar. As priftërinjtë kinez apo indian nuk kishin ndonjë interes në rregullimin e dhunës. Për priftërinjtë indian, luftëtari përmbushte Besimin e tij dhe për rrjellojë nuk mund të bënte asnjë gabim. Për ata kinez, ruajtja e rendit ritual ishte shumë më i rëndësishëm se çdo rregullim i mosmarrëveshjeve. Në fakt lidhja me njerëzit e afërt ishte e një rëndësie të tillë fetare sa mbeti ritualisht e padiskutueshme gjatë tërë zhvillimit kulturor kinez. Zhvillimi i ndryshëm perëndimor ishte për shkak të disa degëzimeve kulturore specifike. Qyteti perëndimor ishte një vend i lirisë individuale më herët se ai oriental, së pari në kuptimin sipërmarrës dhe më vonë, edhe nga një këndvështrim politik dhe social. Ideja perëndimore e vëllazërisë së krishterë që vlerësonte vëllanë në besim më shumë se vëllanë në gjak dëmtoi fort etikat e gjakmarrjes. Më vonë, ideja e barazisë para Perëndisë (të paktën gjatë Kungimit të Shenjtë) ishte përgjegjëse për zhvillimin perëndimor të një etike që nuk i di kufijtë e klasës apo të klanit. Ky zhvillim specifik perendimor ishte paralel me një ndryshim gradual në kushtet ekonomike. Politika u bë një burim i rëndësishëm i sigurisë së tregut:

... zgjerimi i tregut në këtë mënyrë përbën një zhvillim i cili është i shoqëruar, përgjatë vijave paralele, nga (1) ai monopolizim i dhunës legjitime nga organizata politike e cila gjen kulmin e saj në konceptin modern të shtetit si burimi i fundit i çdo lloj legjitimiteti për përdorimin e forcës fizike; dhe (2) ai racionalizim i rregullave të zbatimit të saj e cila kulminohet në konceptin e rendit legjitim juridik.
Ky zhvillim është shumë perëndimor dhe i ndryshëm nga modelet universale të organizimit shoqëror për dy arsye themelore: së pari, karakteri i qytetit perëndimor dhe, së dyti, krishtërimi. Të dy kanë luajtur një rol të rëndësishëm në prishjen e rolit social të strukturave të klanit që mbeten përgjegjëse për vazhdimësinë e gjakmarrjes në shoqëritë orientale gjatë gjithë zhvillimit të tyre kulturor. Berserk me përshtatjet e tij të fiksuara të rendit dhe të kalorësisë, me dëshirën e tij për të matur veten me një kundërshtar nderi heroic, i cili është provuar në mënyrë që të fitojë nderim për veten e tij, janë që të dy të huaj për disiplinën [moderne];së pari për shkak të paarsyeshmërisë në të bërin e saj. Së dyti për shkak të qëndrimit të tij të papërshtatshëm të brendshem. Në sytë e Weber, gjakmarrja është një mjet universal i dhunës politike e cila, për shkak të disa degëzimeve kulturore, është eliminuar në shoqëritë perëndimore nga monopoli i dhunës nga ana e shtetit modern dhe perms përfaqësuesit të tij më të dukshëm, politokës. Ideja e politikës dhe për rrjedhojë edhe ndalimi i gjakmarrjes janë të huaja për shoqëritë orientale. Pasionet që janë të lidhura me gjakmarrjen janë të huaja për njeriun modern, sepse ai i gjen ato të paarsyeshme dhe shqetësuese.

Emile Durkheim Mbi Gjakmarrjen

Kur Weber flet për komunitetet politike, ai gjithashtu shkuran per dhunën. Emile Durkheim nga ana tjetër, është shumë më tepër i interesuar për kufijtë moralë që lidhin anëtarët e një shoqërie të caktuar. Për Weber i gjithë evoluimi social rrjedh nga fisi, i cili garanton sigurinë individuale përmes gjakmarrjes. Nëse një komunitet nuk është i aftë të garantojë sigurinë individuale përmes metodave të dhunës – ose të paktën kërcënimin përmes saj- nuk është një komunitet politik, sipas përkufizimit të Weber. Gjakmarrja është forca fillestare e gjithë skllavërisë shoqërore. Sociologjia e Durkheim është e interesuar kryesisht për fatin e "moralit" në shoqëri. Fjala 'moral' në frëngjisht siç është përdorur nga Durkheim, ka një kuptim mjaft të gjerë dhe është përkthyer drejt nga Anthony Giddens dhe

përfshin si "moralin" po ashtu edhe "etikën". Është ajo forcë që e kthen njeriun në një qenie shoqërore. Për Durkheim, njeriu është një qenie pasionante që vazhdimisht ka lakmi për më shumë. Morali është në gjendje të menaxhojë këto pasione individuale për t'i kthyer ato në vlera kolektive. Prandaj morali është forca kryesore e rendit shoqëror dhe madje edhe më shumë se kaq. Shoqëria për Durkheim, është 'atmosfera shoqërore e njeriut' pa të cilën ai nuk bën dot. Çdo shoqëri është një shoqëri morale ose nuk është fare shoqëri. Standartet e moralit janë te impostuara në njeriun nga trupi shoqëror i përbashkët ose morali përkeqësohet dhe njeriu rrjedh në pasionet e tij në një mënyrë patologjike vetë-shkatërruese. Në shikim të parë, kjo nuk duket se prek aspak problemin e gjakmarrjes. Standartet e moralit ndiqen jo për shkak të frikës individuale të ndëshkimit, por si rezultat i respektit. Kur ne e shfaqim veten ndaj impulseve kryesore të shoqërisë ne nuk e bëjmë këtë për shkak se ajo është më e fortë se ne. Normalisht është autoriteti moral që investon në gjithë rezultatin e aktivitetit social dhe që përcakton shpirtërat tanë dhe vullnetin tonë. Morali nuk mund të imponohet përmes mjeteve të dhunës. Përkundrazi; "Është përmes mjeteve mendore që ushtrohet presioni shoqëror. Por në fakt shoqëria e tillë është e dhunshme. Shoqëria për Durkheim është një trup i pavarur që është më tepër sesa totali i të gjithë anëtarëve të saj individualë. Është një entitet që e formon njeriun sipas vullnetit të saj. Shoqëria është e mundur vetem me këtë cmim.

Nga njera anë shoqëria nxit forcat njerëzore por nga ana tjetër është e vrazhdë me individin…dhe është vazhdimisht e dhunshme me ne dhe me urine tonë të natyrshme pikërisht sepse na lartëson ne përtej. Ndonjëherë morali imponohet përmes dhunës për të formuar njeriun social. Për këtë arësye sanksionet e dhunshme sociale na tregojnë shumë për vlerat morale dhe janë gjurmët që çojnë në interesin e Durkheim në gjakmarrjen. Durkheim është i interesuar në shoqëri për vetveten dhe kjo gjë sjell një sociologji në kuptimin e vërtetë të fjalës. Shoqëria për Durkheim, është "një send" ose "një objekt" që mund të analizohet shkencërisht siç ndodh me çdo objekt tjetër. Shoqëria thekson vlerat që janë të nevojshme për ndërgjegjen e përbashkët. Një shoqëri nuk ekziston pa anëtarët e saj. Edhe pse ajo është më e fortë se individi, shoqëria varet në idenë e përbashkësisë. Kjo është ajo ide me të cilën ka të bëjë ndërgjegjia e përbashkët. Shoqëria e bën njeriun moral dhe anasjelltas, njeriu moral e bën shoqërinë. Ndërgjegjia e përbashkët është shoqëria brenda secilit prej anëtarëve të saj. Njeriu është në të njëjtën kohë subjekt dhe objekt i shoqërisë në të cilën jeton. Eshtë një shoqëri e tillë ajo që mëson dallimin mes normalitet moral dhe patologjisë morale. Dhe shoqëria është gjithashtu përgjegjëse për përkufizimin e asaj që është profane dhe çfarë është e shenjtë. Në kufirin mes njerës dhe tjetrës, ajo ka vendosur sanksione për t'a treguar këtë kufi. Sanksioni kryesor që dallon normalitetin nga patologjia është ndëshkimi fizik. Kufiri mes të shenjtës dhe profanes shpesh shoqërohet me lëndim trupor. Fillimi (i cili për Durkheim është nga një status profan në një të shenjtë) në shumë shoqëri është i lidhur me dhimbjen. Dhuna për Durkheim, mund të mos jetë forca e rendit shoqëror siç është për Weber, por është një tregues që ndihmon në shqyrtimin e standarteve morale të shoqërive të ndryshme. Sanksioni i dhunës është një kufi i qartë mes asaj që është shoqërisht e pranueshme dhe asaj çfarë nuk është. Morali nuk imponohet nga sanksioni, por sanksioni është i përdorur për moral. Kështu sanksionet (të dhunshme ndonjëherë) na tregojnë ne se ku mund të gjenden kufijtë morale të një shoqërie të caktuar. Durkheim dallon dy lloje të skllavërisë shoqërore: solidariteti mekanik dhe organik. Ai e quan llojin e pare të solidaritetit "mekanik" sepse njerëzit në një shoqëri të tillë janë të gjithë të ndërlidhur me njeri-tjetrin si pjesët e një makine. Një lëvizje në një pjesë të shoqërisë do të çojë në një reagim të trupit social si një i tërë. Solidariteti 'Organik' (dikush mund të thotë edhe 'modern') nga ana tjetër, iu jep liri të mëdha personale anëtarëve të shoqërisë të cilët specializohen në aktivitete të ndryshme dhe bashkëpunojnë lirisht me njeri-tjetrin. Solidariteti mekanik është i lidhur me idealet fetare që fokusohen në vetë shoqërinë. Në të kundërt, solidariteti organik percepton individin si zot të idhujtarisë sociale. Sipas Durkheim, dikush mund të tregojë një progres botëror nga njera formë e solidaritetit shoqëror në tjetrën. Duke përdorur shembullin e dhunës në sport, Eric Dunning (198:135-138) ka dhënë një pamje mjaft të saktë të asaj çfarë diferencimi i Durkheim-it për solidaritetin mekanik dhe organik çon kur shoqërohet me idetë e tij mbi dhunën. Vëzhgohet në mënyrë rigoroze teksa anëtarët e solidaritetit mekanik janë të ekspozuar ndaj presionit të pakët social në lidhje me ndjenjat e tyre agresive, ndaj anëtarëve të solidaritetit organik dhe ndaj epshit të tyre për dhunë. Solidaritetet mekanike janë përdorur për shpërthime publike të dhunës pasionante; solidaritetet organike preferojnë ti mbajnë pasionet e tyre "prapa skenave". Dallimi më interesant është të gjendesh në pranimin shoqëror të dhunës. Solidaritetetet organike janë tolerantë vetëm në lidhje me përdorimin

racional të dhunës, ndërsa solidaritetet mekanike pranojnë përdorimin e tepruar të saj. Dunning ka zgjedhur futbollin si një shembull që të çon në pak lloje të dukshme të luajtjes së drejtë dhe të padrejtë në solidaritietin organik. Kockat e kundërshtarëve rrallë thyhen gjatë ndeshjes. Agresioni është përkundrazi verbal dhe e tërë loja është e vendosur nën një regjim të rreptë rregullash. Jo vetëm dhuna si e tillë, por edhe dhuna shoqërore qe përcakton kufinjtë mes sjelljeve të pranuara shoqërore dhe jo të pranuara ndryshojnë mes solidaritetit mekanik dhe organik. Solidariteti mekanik tenton drejt vendosjes së kufijëve drastik dhe shpesh dëshmon të jetë mizor dhe pasionant. Si janë të gjithë anëtarët të ndërlidhur si pjesë të një makine, reagimi ndaj një shkelje nga njeri prej anëtarëve të saj mund të jetë vetëm dëbimi nga shoqëria. Reagimi ndaj dëmit të jashtëm është po aq i ashpër dhe pasionant. Çdo dëm që është pasqyruar në trupin shoqëror konsiderohet si një kërcënim për të gjithë sistemin. Reagimi kundër dëmit është ndërkaq pasionant, kolektiv dhe i egër. Përderisa shoqëritë mekanike të solidaritetit varen fuqishëm nga emocionet e anëtarëve të tyre, një shpërthim periodik i këtyre ndjenjave nuk mund të shmanget. Në fakt dhuna e vazhdueshme pasionante që mund të konsiderohet si heroike ose thjesht shkatërruese. Ka periudha historike gjatë të cilave ndërlidhjet shoqërore bëhen shumë më tepër të shpeshta dhe aktive. Ndryshimet nuk janë vetëm me nuanca ose gradë. Njeriu bëhet ndryshe. Pasionet e acaruara janë aq intensive saqë ata nuk mund të jenë të kënaqur përvecse në akte të dhunshme të heroizmit mbinjerëzor apo barbarizmit të përgjakshëm. Solidaritetet organike nga ana tjetër, nuk dinë asgjë rreth pasioneve irracionale të solidaritetit mekanik primitiv. Edhe ata vendosin kufijtë mes moralit dhe imoralitetit, por ata nuk përdorin dhunë të papërshtatshme për të restauruar trupin shoqëror. Perdorimi modern i dhunës është drejtuar kundër individividit si një mjet për riintegrimin me vonesë në shoqëri. Shoqëria moderne ndëshkon "jo sepse ndëshkimi jep ndonjë kënaqësi kundrejt dikujt, por për shkak të bindjes së saj se një dënim paralizon dëshirat e këqija". Një kërcënim për shoqërinë nuk ndihet shumë gjallërisht siç është në solidaritetin mekanik. Energjia e përbashkët e cila në shoqërinë primitive çon në shpërthime të rregullta të pasionit, në shoqëritë moderne është e zhdukur. Ndarja e punës çon në multifunksionimin social dhe njeriu tani mund t'i zhvillojnë pasionet për punën e tij. Pasioni i përbashkët që dikur siguronte stabilitetin social në solidaritietet mekanike tani bëhet një pasion profesional i specialistëve. "Hulumtuesi, inxhinieri, mjeku... ata të gjithë kanë nevojë për vazhdueshmeri dhe energji po ashtu. Por kjo është një vazhdueshmeri më e heshtur dhe më pak energji e djegur. Gjithçka është më e qetë dhe e vazhdueshme" (Durkheim,1975b). Në këtë pikë mund të flasim për gjakmarrjen, e cila natyrisht nuk është aq themelore për Durkheim siç është për Weber. Argumenti i Weber që, zhvillimi i pushtetit politik për një kohë të gjatë mban përcaktimin ligjor të gjakmarrjes, është i huaj për idetë e vendosura të Durkheim. Për Durkheim, gjakmarrja është kryesisht një nga manifestimet e pasionuara të lidhjes personale mes pjesëtarëve të një grupi të solidaritetit mekanik. Në shoqëritë primitive të bazuara në klanizim, anëtarët e një grupi janë identikë me anëtarët e një shoqërie. Çdo njeri është i lidhur personalisht me të tjerët. Në këto solidaritete mekanike një lidhje e tillë është e manifestuar në disa mënyra të tilla si; "detyra e ndihmës së përbashkët, gjakmarrjes, pikëllimit". Anëtarët e një shoqërie të caktuar njohin njeri-tjetrin në kryerjen e këtyre detyrave të cilat përcaktojnë dallimin midis anëtarit të klanit të tyre dhe të klanit huaj. Ndjenjat e zemërimit dhe pasigurisë sociale nxisin pasion për hakmarrje, e cila është ndërkaq tipike e shoqërive që janë të themeluara në solidaritetin mekanik. Ajo shërben si një mjet i stabilitetit shoqëror, por në fakt është shumë primitive dhe nuk duhet krahasuar me ndëshkimin racional. Gjakmarrja është një sjellje mjaft e paarsyeshme dhe e çastit e cila gjen rrënjët në ndjenjat personale. Shoqëria e solidariteti mekanik kërkon të marrë hak në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e saj, por varet nga pasioni i anëtarëve të saj nëse hakmarrja do të ekzekutohet ose jo. Realisht stabiliteti social nuk varet nga ajo. Sipas Durkheim, gjakmarrja është një ndeshkim i cili është njohur si i ligjshëm nga shoqëria, edhe pse ekzekutimi i saj është i porositur nga anëtarë individual. Gjakmarrja nuk jep asnjë legjitimitet të rendit shoqëror siç e jep në teorinë e Weber. Shoqëria pranon gjakmarrjen si një nga masat e mundshme për të siguruar stabilitetin e saj. Megjithatë mjete të tilla janë shumë primitivë. Standardet morale mund të vendosen me anë të gjakmarrjes, por saktësia e masave të tilla është shumë e ulët në sytë e Durkheim. Gjakmarrja për Durkheim është një fenomen që mund të kuptohet vetëm në lidhje me solidaritetin mekanik. Solidariteti organik nuk i kupton pasionet që ushqejnë marrjen e gjakut. Gjakmarrja është një reagim shumë i pasionuar dhe i pamenduar ndaj kërcënimit të jashtëm dhe kjo ndihmon për të dalluar anëtarët e grupit dhe të huaj. Ky nuk është një sanksion i vërtetë social pasi ekzekutohet nga individët. Por

megjithatë shoqëria më shpesh pranon përdorimin e marrjes së gjakut si një zbatim të moralit në solidaritetin mekanik.

Perfundime

Që të dy, Weber dhe Durkheim shkojnë përtej pyetjes nëse gjakmarrja shkakton rend shoqëror ose çrregullim të këtij rendi. Të dy pretendojne se ajo ka të bëjë me rendin shoqëror në shoqëritë jo-moderne. Për Weberin, ajo është edhe mjeti më i nevojshëm i rendit shoqëror në shoqëritë që kanë tendencë të racionalizojnë lidhjet familjare më shumë sesa idenë e etikës të përgjithshme. Në të kundërt, një shoqëri e kontrolluar është në fakt shumë larg nga ideja e gjakmarrjes pasi ajo ka racionalizuar sferën publike më shumë sesa marrëdhëniet farefisnore përgjatë zhvillimit te saj. Politika për Weber është një fenomen perëndimor, sepse vetëm Perëndimi ka zhvilluar një shkallë të tillë të racionalitetit saqë ndjenja e pasionuar e nderit apo zemërimit është zëvendësuar nga disiplina dhe logjika. Durkheim është gjithashtu i bindur se shoqërisë moderne i mungojnë pasionet e egra që kulminojnë në gjakmarrje. Pasionet në shoqërinë moderne janë më shumë individuale se sa kolektive dhe përdoren për karrierën personale dhe jo për vendosjen e axhendave kolektive. Sipas Wolfgang SCHLUCHTER (1988), Max Weber paraqet një teori sociale antropocentrike ndërsa sociologjia e Durkheim dëshmon të jetë më sociocentrike. Në fakt Weber është i interesuar kryesisht në arsyet individuale për të rënë dakord me një sistem të gjakmarrjes, ndërsa Durkheim thekson efektet e saj të përgjithshme në shoqëri. Për Weber gjakmarrja është argumenti qendror për pushtetin politik në shoqëritë primitive. Individi i një shoqërie të tillë pajtohet me fuqinë detyruese të trupit politik, sepse ai mund të mbështetet në marrjen e gjakut nëse ai dëmtohet nga dikush jashtë grupit të tij. Shoqatat më të mëdha politike që kapërcejnë përmasat normale të klaneve e kanë ruajtur trillimin ligjor të gjakmarrjes edhe pse gjaku mund të mos merret në çdo rast dhe për çdo anëtar të shoqërisë. Janë vetëm format moderne të shoqërisë që shkojnë përtej idesë së gjakmarrjes dhe që e menaxhojnë dhunën dhe forcën përmes politikës dhe ushtrisë. Durkheim nga ana tjetër, argumenton se shoqëria është një trup moral që e mundëson njeriun të bëhet një qenie shoqërore. Shoqëria përkufizon vlerat morale dhe i zbaton ato me sanksione që dënojnë shkeljet e standardeve morale. Gjakmarrja në sytë e Durkheim, është për këtë arsye vetëm një nga sanksionet e shumta të mundshme që zbatojnë shoqërizimin në shoqëritë primitive.

Një tjetër dallim mes Weber dhe Durkheim është perspektiva e tyre mbi modernizmin. Për Durkheim modernizmi është një lëvizje universale i cili në disa shoqëri ka marshuar me një ritëm më të shpejtë se diku tjetër. Gjakmarrja është e lidhur ngushtë me solidaritetin mekanik dhe do të tejkalohet kur e gjithë bota të ketë arritur solidaritetin e plotë organik. Për Weber modernizmi është rezultat i zhvillimit kulturor perëndimor, i cili degëzohet nga tendencat universale diku gjatë evolucionit të tij social. Qytetërimi perëndimor dhe Krishterimi janë dy nga gurët më të rëndësishëm të qëndrueshëm të ftohtësisë perëndimore nga zhvillimi i tendencave normale universale. Gjakmarrja këtu bëhet më pak e rëndësishme, sepse afrimiteti e humb rëndësinë e tij. Në shoqëritë perëndimore farefisnia si një bashkësi politike është zëvendësuar gradualisht nga zbatimi i ligjit publik. Për Weber gjakmarrja është shtylla qëndrore e një komuniteti politik. Është një fenomen universal i ngjashëm me ‘stacionin hekurudhor’ historik prej të cilit janë nisur të gjithë ‘trenat’ kulturor drejt komuniteteve të ndryshme politike. Gjakmarrja është bërthama e historisë politike botërore për zhvillimin kulturor dhe madje moderniteti dhe politika moderne, nuk mund të kuptohen nëse nuk e marrim në konsideratë gjakmarrjen. Durkheim nga ana tjetër, nuk i jep këtë rëndësi gjakmarrjes. Për të morali social nuk ka nevojë për dhunë ose forcë për t’a imponuar veten tek anëtarët e saj. Kështu komunitetet pokitike janë morale ne vend që të jenë entitete të dhunës. Gjakmarrja del në skenë kur Durkheim flet për mjetet e vendosjes së moralit në solidaritetet mekanike. Nuk shikohet si një instrument qëndror, por si një zgjighje e pakëndëshme dhe shumë pasionante për problemet ligjore. Kur instalohet solidariteti organik, pasionet për hakmarrje humbasin dhe nuk kanë më përdorim ligjor. Për ta përmbledhur këtë ndryshim, dikush mund të analizojë se argumenti sociologjik i Weber është kulturor ndërsa sociologjia e Durkheim shqetësohet me shumë për moralin. Kjo e shpjegon tkurrjen e Durkheim për t’u marrë me gjakmarrjen sepse kufizon reflektimet e tij për moralin social në solidaritetet mekanike. Për Weber gjakmarrja është një fenomen social i këndshëm në dukje që e ndihmon atë të zhvillojë dhe

të shpjegojë idenë e tij për degëzimin kulturor të Orientit dhe të Perendimit. Durkheim bën ndryshim mes shoqërive modern (organike) dhe paramoderne (mekanike). Një zhvillim universal nga njera fazë në tjetrën është vetëm cështje kohe. Teoria e tij e modernizimit mund të quhet një teori kronologjike. Weber argumenton që zhvillimi oriental nuk do të drejtohet kurrë drejt modernitetit. Vetëm shoqëritë perëndimore kanë përjetuar evolucionin modern. Për të, ndryshimi universal nuk është kronologjik por gjeografik. Lindja do të jetë moderne vetëm përmes importit kulturor, ndërsa Perendimi është bartësi dhe zhvilluesi i modernitetit dhe kulturës së tij.
Çfarë mund të mësojmë ne prej Weber dhe Durkheim në lidhje me gjakmarrjen? Para së gjithash mësojmë se për t'iu përqasur fenomenit duhet një kornizë komplekse e teorisë sociale. Cila është alternativa e një shoqërie që mbështetet në gjakmarrjen? A është shoqëri moderne dhe çfarë është moderniteti? A është një fenomen kulturor apo moral, gjeografik apo kronologjik, individual apo social? Ne mund të ndjekim Durkheim duke shpresuar që shumë shpejt gjakmarrja do të zëvendësohet me solidaritetin organik. Por çfarë duhet të bëjmë ne ndërsa presim që kjo gjë të ndodhë. Ne gjithashtu mund të ndjekim Weber dhe të supozojmë që kulturat orientale nuk janë të ndërtuara që ta mposhtin vetë gjakmarrjen. A mundet që pasoja e një teorie të tillë te jetë dicka si një sistem global apartheid që ndan botën në dy gjysma, në atë orientale dhe perëndimore? Të dy rezultatet janë të përmasave gjigande për t'u përdorur praktikisht. Ndoshta zgjidhja mund të kërkohet në baza shumë më të vogla. Që të dy, Weber dhe Durkheim bien dakort që gjakmarrja ka të bëjë sa me pasionin po aq edhe me mendimet legale. Dhe gjithashtu është një fenomen i shoqërive jo-moderne. Gjakmarrja është më shumë se thjesht një veprim i nxehtë dhe i pamenduar. Është një problem ligjor që është i ndërlidhur me ndjenja të forta të drejtësisë dhe të rregullit moral. Prandaj nuk është dhe aq e huaj sa ç'duket në pamje të parë për vëzhguesin modern. Pothuajse çdo shoqëri ka bërë përpjekje për t'i qetësuar këto pasione për të parandaluar derdhjen e gjakut. Zakoni mesjetar legal i të pritjes për tri ditë ose edhe shtatë javë që të kalojnë para se të merret gjaku në mënyrë të dhunshme, është një ndër shumë përpjekje për të ndaluar pasionin që situata të mos bëhet edhe më keq. Kështu nëse jemi në dakortësi me Weber dhe Durkheim dhe përsa i përket gjakmarrjes si një fenomen pasioni, ne gjithashtu mund të biem dakord që zgjidhja e saj qëndron në proçesin e ngadalsimit dhe qetësimit të pasionit të ndarë vecmas nga kultura, feja dhe nga nuancat e modernitetit. Nuk kemi nevojë të shkojmë aq larg sa shkoi Georges Sorel, i cili u përpoq të rivendoste pasionin si një mjet ligjor. Ne thjesht duhet të pranojmë që pasioni ka të bëjë më shumë me mendime legale se ç'mund të duket nga fillimi. Autorët perendimor kanë shkruar për gjakmarrjen me ndjenja zemërimi dhe admirimi në të njëjtën kohë sepse pasionet për ta pasqyrojnë një parajsë të humbur të shfaqjes hapur të ndjenjave. Kështu gjakmarrja është përshkruar si burrërore ashtu edhe fëminore. Në raste të tjera nuk është asnjera prej këtyre përvecse një pasion legjitim që duhet të formohet në sens ligjor. Asnjë kulturë nuk pranon shfaqen e egër të ndjenjave të gjakmarrjes. Çdo kulturë njëh dhe përdor mekanizma që shërbejnë për t'i qetësuar këto ndjenja. Mësimi praktik që mësohet është që të globalizohen mekanizmat e kontrollit të pasionit dhe të përpiqemi të gjejmë marrëveshje transkulturore për këtë gjë për të arritur një modernitet organik ose perendimor.

Referenca

Barbiero, G. (1991) L'asino del nemico. Rinuncia alla vendetta e amore del nemico nella legislazione dell'Antico Testamento. Rome: Editrice Pontificio Istituto Biblico.
Bouglé, C. (1930) 'Émile Durkheim', pp. 291–ë Encyclopedia of the Social Sciences, Vol. 5, ed. Edwin Seligman. New York: Macmillan.
Corso, R. (1930) 'Vendetta', pp. 38–9 Enciclopedia Italiana di scienze, lettere e arti, Vol. 35, ed. Istituto Giovanni Trecciani. Milan: Istituto della Enciclopedia Italiana.
Cozzi, E. (1910) 'La vendetta del sangue nelle Montagne dell'Alta Albania', Anthropos 5: 654–72.
de Balzac, H. (1996) La Vendetta. Paris: Flammarion.
Dean, T. (1997) 'Marriage and Mutilation: Vendetta in Late Medieval Italy', Past and Present 157: 3–36.
Ducros, P. (1926) De la Vendetta à la loi de talion', Revue d'Histoire et de Philosophie Religieuses 6: 350–65.
Dunning, E. (1983) 'Social Bonding and Violence in Sport', pp. 129–46, Jefrey
H. Goldstein (ed.) Sports Violence. New York, Berlin, Heidelberg and Tokyo.
Durkheim, É. (1893) La Division du travail social. Paris:
E.Durkheim. Brenga e Ballkanit dhe vepra te tjera per Shqipërine dhe shqiptarët. Tiranë, 1991
Shtjefën Gjeçovi. "The Canon of Leke Dukagjini" Kanuni i Lek Dukagjinit. Tiranë, 1993 Tiranë, 1993
At Gjergj Fishta. "Forewords of Lek Dukagjini' Canon" Parathenie e Kanunit te Lek Dukagjinit. Shkoder, 1933.
Durkheim, É. (1970) 'Sur l'internationalisme', pp. 282–92 Jean-Claude Filloux
Durkheim, É. (1975c) 'La Sociologie et son domaine scientifique', pp. 13–36 Victor Karady (ed.) Textes 1. Eléments d'une théorie sociale. Paris: Minuit.
Giddens, A. (1971) Capitalism and Modern Social Theory: An Analysis of the Writings of Marx, Durkheim and Max Weber. London: Cambridge University Press.
Girard, R. (1972) La Violence et le sacrée. Paris: Grasset.
Godelier, M. (1999) 'Chefferies et États, une approche anthropologique', pp.
19–30 in Les Princes de la protohistoire et l'émergence de l'État. Naples and Rome: École Française de Rome.
Kuschel, R. (1988) Vengeance Is Their Reply: Blood Feuds and Homicides on Bellona Islands. Copenhagen:
Müller, H.-P. (1992) 'Durkheim's Vision einer "gerechten" Gesellschaft', Zeitschrift für Rechtssoziologie 13: 16–43.
Oakes, R.T. (1997) 'The Albanian Blood Feud', Journal of International Law and Practice 6: 177–98.
Rosenthal, J. (1966) 'Marriage and Blood Feud in "Heroic" Europe', The British Journal of Sociology 17: 133–44.
Schacht, J. (1993) An Introduction to Islamic Law. Oxford: Oxford University Press.
Schwandner-Sievers, S. (1995) 'Zur Logik der Blutrache in Nordalbanien. Ehre Symbolik und Gewaltlegitimation', Sociologus 45(2): 109-29.
Weber, M. (1947) 'Die rationalen und soziologischen Grundlagen der Musik', pp. 818–69 in Wirtschaft und Gesellschaft. Tübingen: Mohr.
Weber, M. (1978a) Agrarian Sociology of Ancient Civilisations, London: NLB.
Weber, M. (1978b) Economy and Society: An Outline of Interpretive Sociology, Los Angeles and London:
Weber, M. (1980) Wirtschaft und Gesellschaft. Tübingen: Mohr.

Shenim: Referencat jane vendosur me titullin e tyre te paperkthyer, pra ne versionin original.

PHD. (C) ALBERTA TAHIRI – ZHVILLIMI DHE RËNDESIA E TURIZMIT NË KOMUNEN E PEJËS

PHD. (C) ALBERTA TAHIRI
Kolegji Internacional Prizren

Abstrakti

Pozita gjeografike e Kosovës në qendër të Gadishullit Ballkanik. Zhvillimi i turizmit malor, me të gjitha specifikat që Kosova disponon në potenciale të mëdha, duhet të shfrytëzohet, si dhe burimet shumta termominerale. Disponon me begatitë e shumta kulturore dhe historike, por është i domosdoshmëm shfrytëzimi i kapaciteteve receptive dhe përmirësimi i kushteve, sipas standardeve turistike, si dhe vënia e tyre në funksion të ofertës turistike: turizmi afarist, transit, dimëror, i fundjavës, i gjuetisë dhe turizmi shëndetësor (balnear). Të gjitha parametrat tregojnë se Kosova disponon me potenciale të shumta turistike, të cilat premtojnë në perspektivë.

Me turizëm nënkuptojmë lëvizjen e njerëzëve me qëllim rekreacioni, argëtimi, shërimi dhe zgjerimi të njohurive kulturore. Edhe pse Kosova është hapësirë e vogël gjeografike, me motivet natyrore dhe njerëzore që ka, ofron mundësi të mira për zhvillimin e disa llojeve të turizmit vendas, rajonal, ndërkombëtar, stacionar dhe transit.

Zhvillimi i Turizmit në Komunën e Pejës

Historia e vjetër e qytetit, potencialet dhe pasuritë e shumta kulturore dhe ato natyrore me të cilat disponon komuna e Pejës si dhe pozita gjeografike dhe lidhjet rrugore që i ka me shtetet tjera, ka mundësuar që Peja të ketë një zhvillimin të hershëm të turizmit.
Në kohërat më të hershme, në Pejë flitet për një zhvillim të turizmit transit. Meqenëse Peja gjithmonë ka qenë rrugë lidhëse në mes të vendeve të ndryshme (Pejë – Qakor - bregdeti Adriatik) çka ka ndikuar që Peja të jetë pikë pritëse dhe pushimi të kalimtarëve, prandaj edhe zhvillimin i turizmit është parë një ndër alternativat më të mira për zhvillim ekonomik të vendit.

Turizmi në komunën e Pejës zë fill qysh në kohërat Iliro-Dardane, që në atë kohë burimet e ujërave termale në Ilixhe (banjën e Pejës) janë shfrytëzuar nga shumë njerëz për shërimin e sëmundjeve të ndryshme që kanë ardhur nga vendet e ndryshme, e këtë mund ta përkufizojmë edhe me një ngritje apo lulëzim të turizmit shëndetësor, e që edhe në ditët e sotme këto ujëra shfrytëzohen për të njëjtën çështje, ndërsa, tani ekziston një infrastrukturë mjaft e mirë turistike në këtë vend e cila është e njohur.279

Me paraqitjen e kërkesave të mëdha turistike dhe rendësin e turizmit, në Pejë filluan të ndërtohen "Konaqet dhe Hanet" të cilat kanë shërbyer si vende akomoduese për vizitorët të cilët kanë qëndruar në Pejë. Më vonë në komunën e Pejës u ndërtuan objekte të ndryshme hoteliere , në vitin 1929 Hotel "Korza", pastaj kampi "Karagaq" që shfrytëzohej nga turistët tranzit nga viset e ndryshme të Evropës, hotel "Metohija" (tani "Royal Ardarei"), motel "Karagaq" dhe "Nora" të cilat kapacitete shërbenin në ngritjen e ofertës turistike të komunës.280

Ekzistojnë shume publikime shqiptare dhe te huaja që ndihmojnë turistet të informohen mbi burimet turistike te të gjitha llojeve që disponohen aktualisht në Peja.

[279]Faqja zyrtare e Komunës së Pejës. Zbartur nga faqja e intrnetit me 16 shkurt 2015. Për më shumë : https://kk.rks-gov.net/peje/Assembly-5.aspx
[280] Faqja zyrtare e Ministrisë së Tregtise dhe Industrisë, Departamenti I Turizmit. Zbartur nga faqja e intrnetit me 16 shkurt 2015. Për më shumë : www.mti-ks.com

Zonat turistike lokale të Pejës : 281

Zona turistike e Pejës me rrethinë
Lokaliteti turistik i Karagaqit,
Lokaliteti turistik Lugina e Lumëbardhit,
Zona turistike e Rugovës:
Lokaliteti turistik i Grykës së Rugovës,
Lokaliteti turistik i Bjeshkës së Lumbardhit (Bjeshka e Lumbardhit dhe e Milishevcit),
Lokaliteti turistik i Leqenatit (Bjeshka e Leqenatit dhe Liqejt),
Lokaliteti turistik i Bogës (Kuqishtë, Stankaj, Haxhaj, Bogë, Shkreli),
Lokaliteti turistik i Drelajve (Drelaj, Shtupeq i Madh / Vogel, Dugaiv, Reka e Allagës, Rusolia, Lipa, Pepaj, Malaj).
Zona turistike e luginës së Drinit:
Lokaliteti turistik i Burimit të Drinit.
Zona turistike e Kopranikut (Bjeshka e Irzniqit):
Lokaliteti turistik Bjeshka e Irzniqit (Bjeshka e Irzniqit, Kopraniku, Çfërla)

Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik, komuna e Pejës ndahet në katër zona turistike. Zona turistike e qytetit të Pejës me rrethinë, Zona turistike e Rugovës, Zona turistike e Luginës së Drinit, Zona turistike e Kopranikut.

Pozita gjeografike e Pejës dhe bjeshkeve ka bërë të ndahet , klima, drejtimet e transitit turistik, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat, ofrojnë mundësi për zhvillimin e këtyre formave të turizmit, gjuetia etj.

Pasuria, shumëllojshmëria etnike dhe kulturore por edhe tërësitë e ruajtura kulturore historike dhe monumentet e veçanta, midis të cilëve ka të tillë që janë atraksione unike për një klientelë të caktuar. Oferta turistike e ekskursioneve ditore dhe të fundjavës, në bazë të elementeve ekzistuese natyrore, që ka si qëllim rekreacionin dhe pushimin e vazhdueshëm të banorëve.

Duke u nisur nga trendet aktuale dhe trendet e parashikuara të kërkesës ndërkombëtare turistike, ekzistojnë mundësi reale në plasimin e ofertës turistike në tregjet ndërkombëtare. Oferta kulminante turistike e Pejës, që përfshinë rrethin më të gjerë të kërkesës lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare bazohet në: peizazhet masive malore, që kanë potencial të madh pranimi, natyra e ruajtur, sidomos flora dhe fauna, lartësitë malore që arrijnë mbi 2500m, me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror e sidomos të atij dimëror; rrjeti i vendbanimeve me ofertën e organizuar të serviseve shërbyese që lidhen me korridoret kryesore të komunikacionit, si sistem hapësinor i zhvillimit të qarkullimit dinamik; atraksionet natyrore me bukuri të veçanta si: Kanioni i Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Shpellën e Radacit, shpellat ne Grykë të Rugovës etj.

Zona turistike e Pejës me rrethinë

Të dhëna statistikore për Pejën

Përshkrimi	Përshkrimi	Numri ose %
Popullsia	Gjithsej	125752
	Shqiptarë	90%
	Boshnjak	3.5%
	Të tjerë	6.5%
Gjeografia	Sipërfaqja (km2)	603
	Numri i fshatrave	

[281] Qeveria e Kosovës, Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare) Prishtinë 2008

Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	12.55%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	33.35%
	E mesme	40.22%
	Shkollë e lartë	13.14%
	Universitet	0.73%
	Nr. i nxënësve	23442
	Nr. i mësimdhënësve	1286
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	5
	Nr. i shkollave fillore(me paralele të ndara)	42
	Nr. i çerdheve	1
Shëndetësia	Spital	1
	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	24
	Nr. i mjekëve	105
Papunësia	Gjithsej	34.90%
	Meshkuj	27.60%
	Femra	49.06%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	76,709
	Të punësuar në sektorin publik komunal	2,322

Burimi : ASK

Peja antike dhe objektet relegjioze të saj

Peja e vjetër antike, shtrihej në anën lindore te rrjedhës së lumit Lumbardh, si dhe në anën e djathtë të stacionit hekurudhor, në Fushën e Pejës, për Pejën e lashtë flasin shumë edhe shenimet e Evansit dhe Çershkovit (si Siparant dardan), Peja permendet edhe në harten e "Gjeografisë"së Ptolomeut e cila u përgadit në gjysmen e shkekullittë dytë,në Aleksandri.

Me rastin e ndërtimit të fabrikes se baterive industriale, gjatë gjurmimeve arkeologjike në vitin 1978/79,u zbuluan objekte të lëvizhshme ; gurë mbivarror (stela,cipus), stoli, armë etj. Disa nga objektet e gjetura në këtë lokalitet gjënden në muzeun Etnografik të Pejës; një stele dhe një cipus qe i takojnë shek. I e, s. Stela është punuar nga mermeri i bardhë dhe ka këto dimenzione; 195x 65x25 cm, në pjesen ballore të sajë janë të paraqitura 3 figura me mbishkrime në gjuhen latine,po ashtu edhe cipusi është punuar nga mermeri i bardhe dhe lartësia e tijë arrin 90 cm.

Peja paraqet një thesar të pasur të monumenteve kulturore-historike të periudhave të ndryshme të cilat dallohen për llojllojshmerinë, kualitetët dhe rëndësinë historike të tyre, të gjeturat arkeologjike të përiudhave romake, por edhe të përiudhave ma të vonshmesi; reliktët e bazilikës së krishtërimitë hërshem në këtë anë, këto arte-fakte tregojnë se periudha paleokristiane haste në këtë hapsirë që nga itinerarët apostolike të Shën Palit dhe nxënseve të tij në Iliri.

Skllavet e ardhur në këto anë kanë hasur në popullatën e vjetër vëndase të krishter me kulture urbane që " ishin shumë më të afër më grekët dhe të romanizuarit dalmatinas se me serbët e posa krishtenzuar". Në veri dhe lindje të Pejës, dhe të vet Perandorisë Bizantine, me siguri kanë inicuar Koncentrimi i fiseve të ndryshme dhe definitivisht vëndosja e fiseve sllave në ndërtimin e tempujve fetar, dhe si pasoj e okupimit të Pejës nga feudalet serbë të Nemanjiqëve në shek.XIIIu ndërtua edhe manastiri në bregun e majtë të Lumbardhit në Pejë.282

Gjatë mesjetës qyteti i Pejës u pushtua nga Perandoria Osmane në vitin 1462 dhe më vendosjen e administrates osmane i tërë rajoni gradualishtë pësoj ndryshime në stilin e jetesës , kështu të gjitha vlerat kulturore popullore shqiptare (arkitektura, skulptura, doke dhe zakonet dardane) të trashëguara nga antika, bizanti, mesjeta që e gjetën Osmanë, kohë pas kohe e plotësuan me ndërtime te reja.

[282] Monumentet kulturo-historike – Pejë .

Ardhja e turqve solli një influencë shumë të fortë të kulturës osmane-islame në jetën shpirtrore dhe kulturen materiale të kësaj treve duke filluar të ndërtojnë shumë objekte si: xhamitë, mesxhidet, teqetë, hamamet, mederesatë etj. Këto vepra të karakterit publik e arsimor si objekte të kultures islamo-shqiptare pos të tjerash janë bazë e trashigimisë kulturore dhe paraqesin një frymë dhe ide të materializuar, ato shprehin nivelin krijues, aftësitë tekniko-teknologjike, arkitetktuale, rrethanave historike, kulturore, ekonomike, sociale, fetare, ndertimi tyre janë dëshmi e ngritjeve dhe rënieve historike dhe shprehin origjinalitetin e cilësive të artisteve vendas.

Veprat monumentale (Xhamiat) të ndërtuara në shek.XV-XIX, si:
Çarshi Xhamia shek.XV.
Bajrakli Xhamia 1471 nga Fatih Sulltan Mehmet Hanit.
Hamam Xhamia dhe Hamani I Hazhi Beut, shek.XV.
Kushumli Xhamia shek,XVI.
DeftedarXhamia, shek,XVI.
Xhamia e Kuqe shek,XVIII, e shumë xhamia tjera.

Shtëpitë e vjetra të qytetit të Pejës:
Shtëpia e Karamuqollve.
Shtëpia e Perollve.
Konaku i Tahir beut (posta kryesore) 1950.
Shtëpia e Adem Muhaxherit.
Shtëpia e Pilinghurkajve.
Shtëpia e Kurtesh kelmendit.
Konaku i Qehajve, Kasapollve,etj.

Kullat si ndërtim arkitekturor:
Kulla e Zenel Beut (1854).
Kulla e Sherametit(1956)
Kulla e Goskajve(1974)
Kulla e Kurtulve.
Kulla e Gegajve.
Kulla e Tal Brahimit.
Kulla e Shaban Mehmetit etj

Urat e hershme:
Ura e gurit.
Ura e Çakorrit.
Ura në grykë të Rugovës.

Çarshia e vjetër ; Peja, qytet i vjetër piktoresk në anën perendimore të Kosovës në shek.III-IV bëhet një nga qytetet kryesore të Dardanisë pas Ulpianes, "Çarshia e vjetër" në Pejë është bërthama e qytetit më një sipëfaqe prej 15 ha, planimetri funksionale, qendër zejtaro-tregtare e themeluar që nga shek.XIV, me evulucion si konglomerat urbanistik se bashku me xhamitë dhe asamblet e banimit, prezanton eksponata autentike me vlera dhe specifika arkitektonike nacionale. Karakteristikë e saj ishte: grupimi i dyqaneve me organizim gjenial unitet konstruktiv-stilistik duke krijuar hapsirë dhe elemente funksionalo-atraktive.

Çarshia e Pejës është qëndër ekonomike e qytetit, si pjesë më e vjetër e tij ku është përqendruar prodhimi zejtar dhe shitja e mallrave dhe prodhimeve bujqësore. Në vitin 1970 shpallet si monument nën mbrijtje dhe si i tillë edhe trajtohët.283

[283] Monumentet kulturo-historike-Pejë.

Zona gjeografike turistike malore e Rugovës

Sipas UNEP (Program i Mjedisit të Kombeve të Bashkuara) në një raport të vitit 2014 potencohet se "malet janë ekosisteme të cilat mbulojnë 24% të siperfaqës së tokës në botë". Ato shënojnë çdo kontinent dhe të gjitha llojet kryesore të ekosistemeve, nga shkretëtira tropikale deri të pjesa tjetër ndaj akullnajave polare".284

Malet paraqesin potencialin më të rëndesishëm për zhvillimin e turizmit në Rajonin e Pejës, dhe për atë të Dukagjinit dhe të Kosovës në përgjithësi. Malet e Bjeshkeve të Nemura (afër Pejës) bëjnë pjesë në vargmalin më të lartë të Kosovës, me një siperfaqe rreth 32.985.32 ha, një zonë me një potencial të madh turistik (Qëndra e Studimeve Turistike-Firence, 2007),285 me atrakcione turistike të rëndesishme për zhvillim me vargmale të që ofrojnë mundësi për zhvillim e ku lartësia mbidetare në këto Maja është Hajla (2403 m), Rusolia (2359 m), Shtedimi (2272 m) etj. "Vendndodhja në rrëzë të malit të Rugovës si dhe distanca e largët nga mjedisi industrial i Prishtinës, i ofron Pejës mundësi për turizëm. Mali u ofron vizitorëve mundësi për ecje, kapmpim ose peshkim. Nëpër fshatrat malore, objekte të vogla mund të ofrojnë strehim për turistët."286

ICIMOD-i, në vitin 2014 e ka identifikuar turizminsi një strategji premtuese duke siguruar njerëzit që jetojnë në vise malore do t'iu përshtaten jetës më të mirë, me opsionet alternative të jetesës, ndërtimi mbi pikat e forta të rajonit. 287

Numri i bizneseve që operojnë në bjeshkët e Rugovës sipas të dhënave zyrtare të Qendrës për Regjistrim të Bizneseve janë 46 biznese, ndërsa sipas ndarjes së veprimtarisë 22 biznese meren me veprimtari turistike, ku të dhënat paraqiten në vijim.

Grafikoni 1. Veprimtaritë turistike në zonën e Rugovës



Burimi: Zyra e Regjistrimit të Bizneseve Pejë, Dhjetor 2014

Pjesa me e madhe e ndërmarejve të regjistruara sipas grafikonit të mesipërm shihet qartë se pjesa me e madhe jane veprimtari hotelirele apo ndyshe në zhargonin ndërkombëtar njohet si HORECA (Hotel Restorant Caffe), disa merren me rekracion sidomos ne dhenien me qera.
Menaxhimi i udhëtimeve turistike në zonën e Rugovës

[284] **UNEP** - United Nations Environment Programme, Copyright © United Nations Environment Programme, 2007, Tourism and Mountains A Practical Guide to Managing the Environmental and Social Impacts of Mountain Tours: http://www.unep.org/
[285] QENDRA E STUDIMEVE TURISTIKE – Firence, Lugina e Rugovës, Draft per diskutimin e Planit Strategjik te Zhvillimit Turistik, Qershor 2007
[286] Studim për Planin e Zhvillimit Komunal - 2005
[287] **ICIMOD** - International Centre for Integrated Mountain Development: Nepal, 2008 http://www.icimod.org/?q=1252

Zhvillimi i turizmit duhet që të realizohet në atë mënyrë që të sigurojë shfrytezimin racional të resurseve të ambijentit jetësor, respektim të vlerave kulturore, afirmimit të vlerave autentike dhe specifike në fusha të caktuara, shpirtin dhe traditën të ndonjë vendi me vlerë për popullatën domicile, krahas kësaj duhet theksuar se faktorë qe ndikon dhe konrtibuon në proceset e zhvillimit te turizmit duhet përmendur janë :288
Cilësia jetësore,
Ekonomia e zhvilluar turistike,
Mbrojtja e ambientit jetësor dhe shfrytëzimi sa ma racional,
Bashkpunimi më organet lokale,
Minimizimi i efekteve negative, dhe
Plotesimi optimal i kërkesave turistike.

Roli kryesor për zhvillimin e turizmit, është organizimi i udhëtimeve turistike, që për synim kanë për të tërhequr konsumatorët, e sidomos ata të huaj. Para se gjithash së pari duhet mbojtur ambientin jetësor, gjegjsisht turistik, minimizimi i efekteve negative dhe plotësimin e ofërtes me lloj lloj produktesh dhe shërbimesh.

E, për të tërhequr konsumatorë/turist të rinjë, duhet bërë marketing, dhe marketignu duhet të përmbaje forma të ndryshme si: formën e çmimit për produkte të ndryshme, çmimi – për vendodhje, çmimi – për konsumatorë të ndryshëm, çmimi – për sezonë. 289

Teoria e marketingut në të kaluarën kryesisht e përqendruar në "në të shitur". Sot marketingu përqëndrohet në klientë, duke shtyrë kufijtë e veprimit, duke menduar në transaksione dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira me ta, të bëjnë të pa mundurën që broshurat, marketingu në mediume, faqet e internetit, tabelat udhëtreguese, etj, të kenë përshtypje më të mirë për destinacionin e caktuar dhe sa më shpesh që të jetë ë mundur të kënë vizitor. 290

Udhëtimi turistik është një produkt shumë kompleks (ofrohet në mënyra dhe me cilësi të ndryshme, mund të formohet në mënyra të ndryshme dhe për motive të ndryshme).

Faktorët përcaktues të udhëtimeve turistike : 291

- Distanca e udhëtimit,
- Kohëzgjatja e qëndrimit,
- Cilësia e udhëtimit (niveli i shërbimeve të udhëtimit dhe akomodimit),
- Koha e udhëtimit.

Udhëtimi turistik nëpër Bjeshkët e Nemura dhe maleve tjera që janë nëper Kosovë të ofron jo vetëm një klimë ideale, jo vetëm ajër të dëlirët, jo vetëm ujë të lehtë, të shëndetshëm dhe të ftohtë, por edhe gjithë lehtësirat e jetës. Me 8 deri 15 gjen njeriu në Rugovë një dhomë të mirë, të mobiluar bukur, me një ose dy shtretër. Ushqimi nuk është i shtrenjtë. Mishi i bagëtive shumë i shijshëm, vezë, pula dhe qumësht boll, gjalpi i parfumuar, djathi dhe zarzavate më mirë se kudo tjeter. Edhe dëfrimet nuk mungojnë.

Gjatë organizimit të udhëtimeve turistike nga organziata turistike kërkohet që t'i motivojë turistët, duhet të këtë motivim ta shpreh në ofertë, si motive tradicionale, kombëtare, dashurie, kulturore etj. E që me ndryshimin e kohes ka ndryshuar edhe forma e motivimit. Kështu që shihet nga kompania që vepron në Shqipëri, së pari në Kosovë edhe pastaj në tërë Ballkanin dhe Evropën aranzhon udhetime turistike.

[288] Vita Koja, Klodina Gorica, Marketingu i turizmt, Tiranë 2007, faqe. 7
[289] Evans, N. Campbell, D. & Stonehouse, G.(2003). Strategic Management for Travel and Tourism
[290] Kotler, Filip; Keler Lejn Kevin; (2013). Baza për marketing menaxhment,
[291] Revista shkencore Administrim Biznesi, Pejë 2010

Kjo veprimtari siç është turizmi, e cila ka një ndikim të madh në shumë sfera ekonomike qoftë në mënyrë direkte apo indirekte duhet të zhvillohet si proces i organizuar jashtëzakonisht mirë, të menaxhohet dhe koordinohet në mënyrë profesionale duke i shfrytëzuar reciprokisht burimet (resurset) që i posedon qofshin ato natyrore apo humane (njerëzore) në mënyrë që ti përballojmë trendeve të konkurences apo të paktën të jemi pjesë e tregut ndërkombëtar.

Për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit patjetër duhet të bazohet në funksionet kryesore të menaxhimit:
Organizimi,
Kuadri,
Planifikimi,
Udheheqja, dhe
Kontrolli.292

Menaxhimi i ofrimit dhe shitjes e shërbimeve turistike – kapaciteteve në disa lloje te objekteve hoteliere, për vendosje akomodim mund të jetë organizim i punës, meny e punës llojin dhe strukturën e shërbimit, kategorinë, kapacitetin, pozitën e objektit hotelier. Duhet të angazhohen të gjithë për të menaxhuar një gjë të tillë.

Organizimi i ndërmarrjeve turistike gjatë udhëtimeve turistike

Burimet njerëzore, paraqesin elementet bartës për ekzistencën dhe funksionimin normal të një biznesi. Aktiviteti i drejtimit të personelit është mjaft kompleks, ku implikohen operacionet me karakter administrativ, organizativ, ekonomik etj. për dallim nga sektorët e tjerë. Punësimi në sektorin e turizmit mund të jetë sezonal ose i përhershëm. 293

Te punësimi sezonal stafi i angazhuar mund të jetë më pak i kualifikuar krahas punës së përhershme. Në turizmin kosovar mungesa e të dhënave të statistikës turistike për të punësuarit, nivelin e përgatitjes profesionale pamundësojnë që të bëhet një analizë më e hollësishme e burimeve njerëzore në këtë sektor. Njëri nga faktorët më të rëndësishëm, për periudhën vijuese për zhvillimin e turizmit është përgatitja e kuadrit profesional turistik.

Veprimtaria e njësive punonjësve në hotele është ofrimi i shërbimeve të akomodimit, dhënien e dhomave dhe vendosjes së klientëve, në dhoma dhe apartamente shtretër ndihmës etj. Çdo organizatë punonjëse hoteliere apo njësi punonjëse qoftë edhe kapaciteti më i vogël duhet të bëjë sistematizimin e vendeve të punës, përkatësisht ndarjen e punëve nëpër njësi si dhe të përcaktosh çdo vende pune, detyrat e punës obligimet dhe përgjegjësit, kompetencat si dhe hierarkinë udhëheqëse dhe punë drejtuese me një organizim të punës profesionale e bashkëkohore me qëllim të rritjes së produktivitetit të punës cilësisë së shërbimit. Kjo ndarje e punëve siguron edhe specializimin e punëtorëve rritë rezultat e punës – profitin.

Hotelet janë objekte të cilat ofrojnë shërbimet e akomoditetit, shërbimit të ushqimit pijeve si dhe shërbime tjera plotësuese. Këto objekte ndërtohen në qendra urbane sidhe në zonat turistike. Hotelet duhet ti plotësojnë këto kritere për kategorizimin me yje.

Gjatë udhëtimeve turistike nëpër hotele të ndryshme, Menaxheri që menaxhojnë udhëtimet turistike duhet të këtë parasysh për të qenë një hotel me standarde të larta ai duhet ti plotësojë këto kritere:

[292] Armand Krasniqi, Fatos Ukaj. MENAXHIMI I ORGANIZATAVE DHE DESTINACIONEVE TURISTIKE, Pejë 2009, faqe, 60-70
[293] Armand Krasniqi, Fatos Ukaj. MENAXHIMI I ORGANIZATAVE DHE DESTINACIONEVE TURISTIKE, Pejë 2009, faqe, 60-70

Çdo hotel duhet të ketë recepsionin dhe hollin e pritjes. Varësisht nga madhësia e objektit hotelier. Të gjitha shërbimet e nevojshme në recepsion klientëve duhet tu ofrohet rezervimet, çlajmërimet pagesat dhe informatat shtesë që janë të nevojshme për ta.

Në recepsion duhet të gjendet lista e çmimeve dhe kasaforta për klientë. Holli i pritjes duhet të jetë i pajisur me mobilieri. Holli duhet të ketë arkitekturë dhe dekor të duhur i cili ofron shërbime të ndryshme për klientët. Holli duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme që duhet ti përgjigjet kategorisë së hotelit.

Rezervat shtazore në zonën e Rugovës

Peja është e pasur me kushte të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit të gjuetisë. Rezervat më të njohura të Fondit të shtazëve janë në Rezervatin e Rusolisë si: Gjahu i lartë dhe Gjahu i ultë.
- Në Gjahun e lartë bëjnë pjesë: Ariu,Kaprolli,Derri, Dhelpra, Cjapi i egër, Rrëqebulli, Kunalja e artë, Kunalja e bardhë etj.
- Gjahu i ultë : Lepuri , Thëllëza, Fazani, Pula e egër, Gjeli i pyjeve etj.

Kushtet atmosferike dhe hidrografia

Duke u bazuar në terrenin në të cilin shtrihet Peja ka resurse të mëdha tërheqëse dhe interesante turistike të cilat mund ti kënaqin edhe adhuruesit e natyrës së egër të paprekur, por edhe adhuruesit e bukurive idilike fshatare , si dhe hulumtuesit e interesuar për gjurmë të së kaluarës.

Duke u shtrirë në mes të rrjedhës së lumenjve Drini i bardhë dhe Lumëbardhi, Peja ofron një spektër mundësish për peshkatari të llojeve fisnike të peshqve të ujërave të ëmbla, ndërsa adhuruesve të aventurave të sporteve dimërore dhe verore do t'u ndalet fryma nga bukuritë e kanjonëve, ujëvarave dhe terreneve të përshtatshme për skijim. Familjet me fëmijë dhe të hareshmit të padurueshëm për shijimin e shëtisë në flladin natyror do të gjejnë pushim ideal në brigjet e freskëta të lumenjve në ditët e nxehta të verës.

Si do që të jetë regjioni i Rugovës mbetet një vend me klimë të përshtatshme për verime , në përgjithësi me verë të freskët ku temperaturat shkojnë deri në 17.2 gradë Celsius e ndonjëherë deri 20 e 25 gradë C që favorizon turizmin shtëpiak, të organizuar stacionar, shërues, dhe sportivo-rekreativ si, ngjitje dhe marshim, shëtitje, vizita monumenteve kulturo - historike lëshim me parashuta, notim në liqenin e Liqenatit dhe lundrim në lumë. Ndërsa dimri i ftohtë dhe i përshtatshëm favorizon zhvillimin e turizmit dimëror, ski, ngjitje dhe atë stacionar.

Para se të hysh në pikën që karakterizon këtë grykë si kanion tipik në kilometrin e 6-të ndodhet ujëvara e gjatë 25 m që buron në shkëmb nga ana jugore e derdhet në lumë. Ky kanjon i krijuar nga gërryerja e ujit dhe largimi i akullnajës së Pejës, është tipik dhe i thellë ku lumi diku edhe nuk shihet nga ngushtimi dhe ngritja e shkëmbinjve të lartë vertikal të pjerrët që të ngërthejnë brenda vetes aq sa mund të frikësohesh ose krekosesh sepse majat që ndërtojnë formacionet e shkëmbinjve gëlqeror e konglomerateve me ngjyrë hiri, në ngritje vertikale, radhë të mbuluar me bimë të ulta dhe Pishën e shkëmbit, duke u gjet i rrethuar prej tyre mund të shohësh vetëm qiellin e kaltër.

Kanjoni i Rugovës ose siç quhet "Gryka e Rugovës" duke filluar 3 km larg Pejës deri në kilometrin e 9-të ku ngadalë fillon të hapet, herë herë vije e ngushtohet , duke krijuar një lugajë , paksa më të butë në fundin e së cilës rrjedhë rrëmbyeshëm lumi Lumbardhë duke sjellë me vete rërën e gërryer, shushurimën dhe freskinë e për tu ngushtuar prapë në një grykë të ngushtë përgjatë rrugës në perëndim të regjionit që të shpie në Qafë të Çakorrit dhe në Plavë.

Në livadhet e maleve përreth në pranverë lulëzojnë lule me të llojllojshme të bjeshkës duke i dhënë pejsazhit bukuri të jashtëzakonshme atraktive, kurse hapësirës aromë të posaçme dhe freskinë e natyrës së pastër . Përjetim të jashtëzakonshëm vizuel të bukurisë natyrore këto male ofrojnë në kohën

e vjeshtës, në kohen e krijimit të pejsazhit kalimtar bjeshkatar kur tërë territori derdhet në spektrin e ngjyrave më të llojllojshme. Përjetim më të madh ofrojnë pamjet në pranverën e vonshme kur në viset e ulta gufon vegjetacioni bimor duke mbuluar tërë territorin më ngjyrë të gjelbër, kurse majet e larta të Bjeshkëve të Nemuna ende janë me mbulesë të trashë të borës.294.

PËRFUNDIMI

Për ta menaxhuar sa ma mirë dhe suksesshem turizmin atëherë patjetër se duhet të ju përmbahemi shtyllave kryesore të menaxhimit pa të cilat nuk ka mundësi të funksionoj as ndërmarrja ma e vogël familjare e lerë më një lëmi me karakter global si turizmi i cili në kohën moderne po merr përmasa globale ku po thyen çdo barrierë kufinjësh, race, gjinie dhe nacionaliteti, ku shumica e vendeve në mbarë globin po i mbush arkat e shtetit përmes vjeljes së tatimeve në saje të zhvillimit të hovshëm dhe të sukesesshem të turizmit.

Duke e ditur se zhvillimi i turizmit po merr hov me karakter global, mbetet tek qeveritë qendrore e ato komunale dhe menaxhmenti i ndërmarrjeve saj qe në të ardhmen të hartojnë programe profesionale të menaxhimit të udhëtimeve turistike dhe të qesin ne pah një marketing dinjitoz që terheq sa më shumë turistë.

Qarkullimet turistike lokale, individuale, familjare e grupore me qëllim pushimi e rekreacioni bëhen sidomos gjatë verës për t'u freskuar pranë bazeneve, lumenjëve, liqeneve, ose gjatë stinës së dimrit në qendrat e skijimit si në Brezovicë ashtu edhe në Rugovë etj. Në periudhën pas luftës në Kosovë është ndërtuar numër i madh i pishinave, të cilat tërheqin numër të madh të klientelës së re turistike.

Në këtë punim diplome mungesa e statistikës turistike pamundësojnë një pasqyrim më të hollësishëm të zhvillimeve në sektorin e turizmit e posaçerisht të udhetimeve turistike. Për të zbutur sadopak këtë zbrastirë të mungesës së të dhënave për statistikë turistike kemi pasqyruar të dhënat e për regjistrimin e bizneseve turistike të sektorit privat për periudhën kohore 2005-2011 gjithashtu të dhëna të përgjithshme të pasurisë së Kosovës, e posaçerisht e Komunës së Pejës.

[294] www.peja-komuna.org

Literatura

Agjensia Kosovare për Regjistrim e Bizneseve Zbartur nga faqja e intrnetit me 16 shkurt 2015. Për më shumë : : www.akrb-ks.org
Evans, N. Campbell, D. & Stonehouse, G.(2003). Strategic Management for Travel and Tourism
Faqe fansash në Facebook "Rugova Mountains", krijuar nga Fotografi i Pejës Driton Hysenaj. Për më shumë :
Faqja zyrtare e Komunës së Pejës. Zbartur nga faqja e intrnetit me 16 shkurt 2015. Për më shumë : https://kk.rks-gov.net/peje/Assembly-5.aspx
Faqja zyrtare e Ministrisë së Tregtise dhe Industrisë, Departamenti I Turizmit. Zbartur nga faqja e intrnetit me 16 shkurt 2015. Për më shumë : www.mti-ks.com
https://www.facebook.com/RugovaMountains2
ICIMOD - International Centre for Integrated Mountain Development: Nepal, 2008 http://www.icimod.org/?q=1252
Koja V & Gorica K., (2004). "Bazat e turizmit". Tiranë.
Komuna e Pejës, Studim për Planin e Zhvillimit Komunal, 2005
Kotler, Filip; Keler Lejn Kevin; (2013). Baza për marketing menaxhment,
Krasniqi, A. & Ukaj, F. (2009). "Menaxhimi i organizatave dhe destinacioneve turistike". Pejë. faqe, 60-70fq.
Mustafa, I. (1997). "Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor". Prishtinë.
QENDRA E STUDIMEVE TURISTIKE – Firence, Lugina e Rugovës, Draft per diskutimin e PLANIT STRATEGJIK TE ZHVILLIMIT TURISTIK, qershor 2007
Qeveria e Kosovës. (2008). Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare) Prishtinë
Revista shkencore Administrim Biznesi, Pejë 2010
UNEP - United Nations Environment Programme, Copyright © United Nations Environment Programme, 2007, Tourism and Mountains A Practical Guide to Managing the Environmental and Social Impacts of Mountain Tours: http://www.unep.org/

PHD (C) ARDIAN BERISHA – MJEDISI I BIZNESIT SI FAKTOR I ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË

PHD (C) ARDIAN BERISHA
Universiteti Europian i Tiranes

Abstrakti

Kujdesi për një infrastrukturë më cilësore kërkon edhe ndërtimin e një mjedisi që ofron mundësi për një nxitje më të madhe të ndërmarrësisë dhe nxjerrjen e masave mbështetëse që do të mundësojnë një zhvillim më të shpejtë të këtij procesi. Një faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në botë por edhe në Kosovë janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në të gjitha format e organizimit të saj. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë vë në pah nevojën për përkujdesje më të madhe jo vetëm nëpërmjet ndryshimit të legjislacionit por edhe me miratimin e një sërë masash nxitëse që do të krijonin një mjedis më të favorshëm për biznes.
Në kuadër të krijimit të mjedisit të favorshëm për zhvillimin e ekonomisë, është e nevojshme pjesëmarrja e administratës qendore dhe lokale, odave ekonomike, qendrave të biznesit dhe inkubatorëve, e asociacioneve ekonomike, ndërmarrësve etj., me qëllim që të analizohen mundësitë dhe kufizimet e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ekonomisë në përgjithësi.
Mjedisin e përshkruar që përbën tërësinë e faktorëve në të cilin veprojnë NVM-të të cilit duhet ti përshtaten ndërmarrësit do të paraqesim në vijim të punimit.

Fjalët Kyçe: Ndermarrje,Zhvillim,Mjedisi,Organizim,Faktorë

Hyrja

Nëse punëtorët në një organizatë janë të aftë dhe të përkushtuar, atëherë kjo mund të ngritë biznesin në shkallën më të lartë të mundshme, si dhe në qoftë se drejtorët e ndonjë biznesi kanë vizion të gjerë dhe të menduarit krijues, atëherë ata mund të parashikojnë ndryshimin i cili do të ndodhë në mjedis dhe mund të hartojnë politika të përshtatshme me kohë.
Nëse kompania është e mirë në hulumtim dhe në aktivitete e marketingut, atëherë ajo mund të ketë një avantazh ndaj konkurentëve dhe të ketë pjesëmarrje më të madhe në treg e poashtu nëse biznesi ka burime të mjaftushme financiare, ai do të ketë mundësi të shpenzojë më shumë në kërkimet (hulumtimet) e aktiviteteve promovues.
Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka aktiviteti afarist që zhvillojnë shoqëritë tregtare, mëndojmë se në krijimin e një ndërmarrje të suksesshme përveç niveleve menaxheriale kërkohet një lidership vizionar dhe i aftë për t'ju përshtatur nevojave të reja të ekonomisë tregute.

Mjedisi i brendshëm i biznesit

Mjedisi i brendshëm përfshin faktorët e brendshëm të biznesit të cilët mund të kontrollohen nga ta dhe i referohet mjedisit brenda organizatës. Ky mjedis përfshin: objektivat e biznesit, politikat menaxheriale, departamentet e ndryshme të organizatave, menaxhmentin dhe të punësuarit në organizatë, marrëdhëniet e menaxherit të punës, imazhet e korporatave, resurset fizike duke perfshirë infrastrukturen që kanë në dispozicion bizneset, vizionet dhe mendimet e top menaxhmentit, hulumtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të organizatës, kushtet e punës në organizatë, moralin dhe angazhimin e resurseve humane etj.Poashtu, për mjedisin e brendshëm të firmës, një element tjetër me rëndësi edhe Swot Analiza, e cila përfshinë: Forcat apo përparësitë (Strength), Dobësitë (Weaknesses) Mundësitë (Opportunities) dhe Kërcënimet (Threats). Një studim i mirë i kësaj analize nga ana e bizneseve do të jetë një përparësi krahas atyre kompanive të cilat nuk u kushtojnë aq rëndësi apo e neglizhojnë hartimin e një strategjie të tillë, gjë që mund të jetë një bumerang për to.Shumë studime,

qofshin ato teorike apo empirike, koncentrohen kryesisht në nivelin e zhvillimit menaxherial si dhe në resurset e kufizuara si pengesa të brendshme kryesore në aktivitetin e NVM-ve. Në mënyrë më specifike, ato koncentrohen në problemet që dalin nga struktura organizative, shkalla e edukimit dhe trajnimit të personelit, përcaktimi dhe qasja menaxheriale për eksport, përvoja menaxheriale, etj.(1 T.R.Jain, Mukesh Trehan, Ranju Trehan, "Business Environment" New Delhi 2009, fq. 182-188.
Hübner, W. "Zhvillimi i NVM-ve në vendet e Azisë Qendrore (Kazakistan, Kyrgistan dhe Uzbekistan): Pengesat, aspektet kulturore dhe roli i ndihmës ndërkombëtare", UNIDO, Vienë 2000)

Tabela 1: Pengesat specifike për firmën (shpërndarja e përgjigjeve në %)

Lloji i pengesës/Rangu	1	2	3	4	5
Aftësitë dhe përvojat e menaxherëve	1.8	6.4	11.0	14.7	66.1
Mungesa e informatave	17.3	17.3	21.8	10.0	33.6
Vështirësitë në gjetjen e partnerëve afaristë	9.1	11.8	30.9	9.1	39.1
Shpenzimet e prodhimit	10.9	13.6	20.0	10.0	45.5
Njohja e gjuhëve të huaja	10.0	10.0	10.9	9.1	60.0

Burimi: Anketa e "Riinvest" me 110 eksportues kosovarë.

Rezultatet nga anketa demonstrojnë se për NVM-të kosovarë njohuritë menaxheriale dhe eksperienca e tyre nuk paraqesin problem të rëndësishëm për zgjerimin e tyre në treg. Kjo pengesë është klasifikuar si pengesa më me pak ndikim në aktivitetet e kompanisë nga 14 pengesat e specifikuara. Mesatarisht kjo pengesë është ranguar më tepër se 4 me variancë dhe devijim standard relativisht të ulët. Andaj, në përgjithësi, sipas të gjithë indikatorëve statistikor, kjo pengesë konsiderohet si shumë e ulët apo pa kurrfarë ndikimi në eksport. Ngjashëm, në tabelën 1 shihet se pjesa më e madhe e përgjigjeve janë të grumbulluara në rangun 1 dhe 2.
Nga ajo që u tha më lart, siç shihet, çështja e sigurimit të informatave mund të konceptohet nga këndi i brendshëm i firmës si dhe nga aspekti eksternal. Ndërmarrjet bëjnë ç'është e mundur të sigurojnë sa më tepër informacione, meqenëse rëndësia e tyre, siç dihet, është kruciale. Në anën tjetër, nga aspekti institucional informata nuk iu ofrohet në sasi të mjaftueshme palëve të interesuara. Duke u nisur nga këto dy kënde, mund të konkludohet se informata është problem ekstern i kompanisë, janë institucionet qeveritare, OEK-u si dhe shoqatat afariste ato të cilat nuk e bëjnë punën e tyre si duhet. Studimet e bëra në vendet tjera kanë treguar se mungesa e informatave afariste është kritike për performansën e eksportit. Për shembull, Kostecki ka demonstruar se "njohja e tregjeve të huaja është problem kyç për ndërmarrjet polake". Edhe këta të fundit barrën më të madhe të problemit e vënë në institucionet të cilat duhet të ofrojnë informacione (posaçërisht në mosefikasitetin e tyre), që është pasojë e kufizimit të madh buxhetor si dhe burokracisë tejet të lartë. Andaj, edhe çështjen e informatave në rastin e Kosovës duhet trajtuar në kategorinë e problemeve të nxitura nga mosfunksionimi i mirë i institucioneve si dhe politikat joadekuate. Sipas hulumtimeve të bëra nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë rreth pengesave me të cilat ballafaqohen ndërmarrësit kosovar për rritjen e ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ka dalë se pikërisht problemet me menaxhimin e resurseve njerëzore dhe teknologjike janë pengesat kryesore në këtë drejtim.Si pengesa më të shpeshta që paraqiten si barrierë për përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve janë pamundësia e përcjelljes së risive teknologjike 38.5%, mungesa e personelit të kualifikuar 21.2%, dhe faktorët e tjerë 40.3%. Një radhitje përafërsisht të njëjtë të faktorëve që paraqiten si pengesë për rritjen e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve e hasim edhe sipas veprimtarive ekonomike.(MTI, "Strategjia e industrisë së Kosovës 2009-2013", Dhjetor 2009, fq. 23.Kostecki, M. M., Nowakowski, M. K. & Walkowicz, "Brengat e NVM-ve në Poloni sa i përket eksportit", Journal of East-West Business, Vol. 1, No. 4, 1996, fq. 95-115)

Tabela 2. Pengesat/barrierat në arritjen e kualitetit të produkteve apo shërbimeve

Pengesat në kualitetin e produktit/shërbimit	Nr. i NVM-ve	%	Prodhuese	%	Tregtare	%	Shërbyese	%
Mungesa e	22	21.2	4	14.3	6	17.6	12	28.6

personelit të kualifikuar								
Mospërcjellja e teknologjisë	40	38.5	10	35.7	16	47.1	14	33.3
Të tjera	42	40.3	14	50.0	12	35.3	16	38.1
Totali	104	100	28	100	34	100	42	100

Burimi: Të dhënat nga anketa e MTI-së, Departamenti i Zhvillimit të Sektorit Privat (2009)

Mjedisi i jashtëm

Zhvillimi i aktivitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe marrja e vendimeve menaxheriale realizohen nën trysninë e vazhdueshme të një spektri të gjërë forcash dhe faktorësh të mjedisit të jashtëm, të cilët kanë një influencë relativisht të madhe në mbijetesen dhe përspektivën e zhvillimit të ardhshëm të NVM-ve në. Faktorët e mjedisit të jashtëm janë ata faktorë që veprojnë jashtë kufijve të një ndërmarrjeje dhe që ndikojnë mbi operacionet e saj.Në spektrin e faktorëve të mjedisit dallohen dy grupe të mëdha, të cilat në mjaft raste veprojnë në mënyrë të ndërthurur midis tyre. Këto dy grupe janë: makrofaktorët e mjedisit dhe mikrofaktorët e mjedisit.
Makrofaktorët e mjedisit përfshijnë atë segment të mjedisit të jashtëm që pasqyron kushtet dhe tendencat e shoqërisë brenda së cilës operon ndërmarrja. Në këtë grup përfshihen një sërë faktorësh, ku më të rëndësishmit do ti përmendim në këtë punim dhe janë: faktorët politiko-ligjor, faktorët ekonomik, teknologjik, social dhe ndërkombëtar. Në mënyrë skematike veprimi i këtyre makrofaktorëve mbi ndërmarrjen do të paraqitej në këtë mënyrë: (Shyqyri Llaci, "Manaxhimi", Tiranë 2002, fq. 47 Shyqyri Llaci, "Menaxhimi", Tiranë 2006, fq. 35.)



Figura 1. Veprimi i makrofaktorëve mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Faktorët ekonomik
Faktorët ekonomikë zakonisht manifestohen përmes ndryshimeve në treg, rritjes reale ekonomike, normave të interesit, konkurrencës, papunësisë etj. Rritja reale ekonomike ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e madhësisë për mallra dhe shërbime. Zakonisht kur shënohet rritje ekonomike, rriten të gjitha aktivitetet ekonomike që përfshin edhe rritjen e fuqisë blerëse (njëra nga 5 forcat e Porterit) dhe në anën tjetër ndikon në rritjen e punësimit. Në rastet kur kemi recension ekonomik, atëherë kemi edhe rënie të kërkesës për mallra dhe shërbime, kështu që si rezultat i kësaj shumë biznese ballafaqohen me likuidim përkatësisht falimentim.
Sa i përket faktorëve ekonomik që determinojnë zhvillimin e NVM-ve, Kosova si një vend postkonfliktuoz dhe me një trashëgimi historike të pafavorshme në aspektin e zhvillimit, ka një ambient të pafavorshëm ekonomik i cili karakterizohet me shpërpjesëtime të ndjeshme në konfiguracionin e saj makroekonomik, GNP-ja tejkalon BPV-në për rreth 21%, eksporti mbulon importin vetëm rreth 4-5%, norma e papunësisë arrin midis 39-49%, ndërsa Buxheti i Kosovës (rreth 40% të BPV-së), është i servisuar tërësisht nga taksapaguesit kosovarë. Profili i strukturës ekonomike karakterizohet me pjesëmarrjen e lartë të sektorit të shërbimeve (60%) dhe bujqësisë (25%) në BPV,

për shkak të procesit të dezindustrializuar në vitet e nëntëdhjeta. Tashti, pjesëmarrja e industrisë në BPV është vetëm 15%.
Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2011 vazhdoi të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike përkundër sfidave të shkaktuara nga luhatjet në ekonominë globale dhe sidomos në atë evropiane. Aktiviteti ekonomik në vend karakterizohet me stabilitet kur merren parasysh burimet kryesore të financimit shumica e të cilave kanë treguar performancë të mirë. Sidoqoftë, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në disa prej vendeve të eurozonës rezultoi në ngadalësim të eksporteve të mallrave, rritja e të cilave gjatë vitit 2011 ishte vetëm 6.3 përqind.(Isa Mustafa, "Udhëheqja, efiqenca dhe efektiviteti", Prishtinë 2007, fq. 42.
RIINVEST "Profili socio – ekonomik i Kosovës dhe sfidat e zhvillimit", Prishtinë, Prill 2005).

Faktorët politiko-ligjor
Veprimet dhe politikat e institucioneve politike kanë një ndikim të madh në mënyrën në të cilën operojnë bizneset. Të gjitha bizneset duhet të veprojnë brenda kushteve ligjore dhe rregullative të cilat janë të përcaktuara nga shteti në të cilin ndërmarrja zhvillon aktivitetin.Institucionet e Kosovës që nga shpallja e Pavarësisë në 2008 kanë bërë një reformë e madhe tatimore dhe është bërë riorganizimi i arkëtimit të TVSH-së përmes arkave fiskale, me qëllim të uljes së shkallës së informalitetit në sektorin e NVM-ve dhe luftimit të konkurrencës jolojale dhe për të provuar përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit të biznesit dhe shtetit. Janë bërë disa përmirësime në çështjet ligjore dhe administrative dhe tani NVM-të mund tëregjistrohen përmes pilot Qendrave Komunale të Biznesit (QKB) të themeluara me përkrahjen e Bankës Botërore. Mbetet të shihet nëse një përpjekje e përbashkët ndërmjet QK-së dhe partnerëve ndërkombëtar do të rezultojë me përmirësim të qasjes së mallrave dhe shërbimeve të Kosovës në tregjet ndërkombëtare dhe drejtë anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Në Memorandumin Ekonomik të Bankës Botërore për Vendin, janë propozuar pesë rekomandime kyçe të politikave për Kosovën. Vazhdimi i përpjekjeve për përforcimin e sundimit të ligjit dhe posaçërisht për luftimin e korrupsionit dhe krimit; Implementimi i masave për shkurtimin e kohës dhe kostove për fillimin e biznesit, posaçërisht në nivel komunal; Përvijimi i procedurave dhe përforcimi i kapacitetit administrativ që ka të bëj me regjimin rregullativ të të bërit biznes, posaçërisht sa i përket licencimit të bizneseve dhe lejeve të ndërtimit; Përforcimi i sistemit gjyqësor për përmirësimin e përmbarimit të kontratave; dhe, Implementimi i shtyllave kyçe të strategjisë për energji. Të gjitha këto kontribuojnë përmirësimin e mjedisit të biznesit.

Faktorët social-kulturor
Mjedisi social-kulturor përbëhet nga normat, zakonet, qëndrimet dhe sjellja që janë karakteristika e një grupi njerëzish apo e një shoqërie të caktuar. Këta elementë variojnë për njerëz që jetojnë në vende apo zona të ndryshme gjeografike, për njerëz të varfër dhe të pasur, për punëtorët e punëdhënësit, për të arsimuarit dhe për ata me arsSim të ulët etj. (1 Qeveria e Kosovës, "Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion 2020", Prishtinë, Korrik 2011.
Campbell Daivid dhe Craig, Tom; " Organisations and the Business Environment", Oksford 2005, fq. 123.
Qeveria e Kosovës, "Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion 2020", Prishtinë, Korrik 2011.
BB, "Kosova: Zhbllokimi i Potencialit të Rritjes: Strategjitë, Politikat, Veprimet", Prishtinë 2010).
Shyqyri Llaci, "Manaxhimi", Alb Paper, Tiranë 2002, fq. 49).
Gjithashtu, secili ndërmarrës i mirë, duhet të di ti përshtaten faktorëve kulturorë, në mënyrë mënyrë që të realizoj afarizmin në mënyrën më të mirë. Qëndrimet jokorrekte ndaj një kulture mund të bëhen pengesë e madhe në realizimin e procesit të punës dhe arritjen e objektivave të biznesit.

Faktorët teknologjik
Ne jetojmë në një epokë tepër konkurruese. Vetëm nëpërmjet novacioneve teknologjike, NVM-të mund të krijojnë produkte dhe shërbime të reja dhe të përmirësojnë ato ekzistuese, që të mbeten konkurruese. Gjithashtu teknologjia siguron një bazë, që ndërmarrja të arrij produktivitetin dhe cilësinë që i duhet asaj për të fituar një avantazh konkurrues. Avancimet në teknologjinë e kompjuterëve i kanë ndihmuar NVM-të për të nxjerr avantazhe nga shfrytëzimi i informacionit.Problemi me aplikimin e inovacioneve në NVM është me rëndësi të madhe për

Kosovën. Sipas të dhënave të fondacioneve të ndryshme, vendi ynë zë vendin e fundit në Evropë për nga numri i ndërmarrjeve inovative dhe për nga niveli i bashkëpunimit të firmave të ngjashme me kolegë të tyre evropian. Vetëm ekonomia, bazuar mbi dijet, pohojnë ekspertët, do të garantojë rritjen ekonomike dhe do të përmirësojë standardin e jetesës së kosovarëve. Inovacionet janë në qendrën e politikës së BE dhe të të gjitha shteteve të mëdha dhe organizatave ekonomike në botë.

Faktorët ndërkombëtar

Zhvillimet ndërkombëtare kanë ndikim jo të vogël mbi mundësitë e NVM-ve kosovare për të zhvilluar biznes jashtë vendit. Për firmat kosovare integrimet kërkojnë vështrime nga afër të zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare qoftë përmes pjesëmarrjes nëpër panaire, seminare, përmes themelimit të sektorëve të vecantë enkas për kërkime të tilla apo duke bashkëpunuar me organizata të specializuara për marrëdhënie ekonomike ndërkombëtare, si dhe gjetja e mundësive për të penetruar në to. Ndryshimet në rregullativat ligjore ofrojnë mundësi për biznes. (Shyqyri Llaci, "Manaxhimi", Alb Paper, Tiranë 2002, fq. 51).

Konkluzione

Niveli i ekonomisë kosovare, që shpreson për krah më të lirë të punës, po sos mundësitë e veta, prandaj është i nevojshëm bashkëveprim midis institucioneve, organizatave shkencore dhe biznesit, për të gjetur mekanizma për rritje, të bazuar mbi inovacionet. Krijimi i mundësive të reja për zhvillimin teknologjik është rruga drejt prosperitetit, dhe kushtet e nevojshme, të cilët do t'u japin shtytje zhvillimit të inovacioneve dhe depërtimit të tyre në ekonomi janë sigurimi i resurseve financiare dhe njerëzore. Ne në Kosovë duhet të fillojmë të punojmë për zgjidhjen e këtij problemi. Më e rëndësishme, është të ndërtojmë një klimë të tillë, e cila të favorizojë zhvillimin e inovacioneve.
Nga ana tjetër, ato duhet të jenë në dijeni të gjendjes reale të konkurrentëve me qëllim që të zbatojnë strategji të veprimit në fusha si: ofertë e produkteve ose e shërbimeve me çmim më të lirë, ofrim i produkteve diferencuese, ofrim i shërbimeve me efiçencë (p.sh. shitja përmes internetit), lojërat shpërblyese etj.

Literatura

T.R.Jain, Mukesh Trehan, Ranju Trehan, “Business Environment” New Delhi 2009, fq. 182-188.
Hübner, W. “Zhvillimi i NVM-ve në vendet e Azisë Qendrore (Kazakistan, Kyrgistan dhe Uzbekistan): Pengesat, aspektet kulturore dhe roli i ndihmës ndërkombëtare”, UNIDO, Vienë 2000.
MTI, “Strategjia e industrisë së Kosovës 2009-2013”, Dhjetor 2009, fq. 23.
Kostecki, M. M., Nowakowski, M. K. & Walkowicz, “Brengat e NVM-ve në Poloni sa i përket eksporti
Shyqyri Llaci, “Manaxhimi”, Tiranë 2002, fq. 47
Shyqyri Llaci, “Menaxhimi”, Tiranë 2006, fq. 35.1 Isa Mustafa, “Udhëheqja, efiqenca dhe efektiviteti”, Prishtinë 2007, fq. 42.
RIINVEST “Profili socio – ekonomik i Kosovës dhe sfidat e zhvillimit”, Prishtinë, Prill 2005.
Qeveria e Kosovës, “Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion 2020”, Prishtinë, Korrik 2011.
Campbell Daivid dhe Craig, Tom; ” Organisations and the Business Environment”, Oksford 2005, fq. 123
Qeveria e Kosovës, “Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion 2020”, Prishtinë, Korrik 2011.
Campbell Daivid dhe Craig, Tom; ” Organisations and the Business Environment”, Oksford 2005, fq. 123.
Qeveria e Kosovës, “Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion 2020”, Prishtinë, Korrik 2011.
BB, “Kosova: Zhbllokimi i Potencialit të Rritjes: Strategjitë, Politikat, Veprimet”, Prishtinë 2010.
Shyqyri Llaci, “Manaxhimi”, Alb Paper, Tiranë 2002, fq. 49
Shyqyri Llaci, “Manaxhimi”, Alb Paper, Tiranë 2002, fq. 51

PHD. (C) BESARTA VLADI, PHD. (C) ILIR REXHEPI, DORINA PLAKU – MENAXHIMI I TALENTEVE SI KUSHT PËR SUKSESIN AFATGJATË TË ORGANIZATËS

PhD. (c) BESARTA VLADI
Departamenti i Menaxhimit & Ekonomiksit, Universiteti Europian i Tiranës

PhD. (c) ILIR REXHEPI
Instituti Kosovar për Menaxhim

DORINA PLAKU
Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakti

Sfidat e sotme të menaxhimit të talenteve janë shumë të ndryshme nga sfidat me të cilat janë përballur bizneset vite më parë. Bizneset po përballen në mënyrë të ndjeshme me konkurrencen për të mbajtur një pjesë të konsiderueshme të tregut. Shumë kompani kanë arritur të kuptojnë se për të realizuar këtë qellim, ju duhet të investojnë shumë dukshëm në burimet njerëzore të organizatës së tyre. Pjesa më e madhe e menaxherëve tashme e kanë kuptuar se investimi tek punonjësit e tyre arrin ta bëjnë kompaninë të suksesshme. Menaxhimi i talenteve është bërë një komponent qendror i strategjive të Burimeve Njerëzore në një organizatë. Talentet padyshim që duhet të zhvillohen dhe të përvetësohen brenda një organizate. "Rëndësia e talenteve dhe menaxhimi i talenteve ka qënë prioritet në ciklin e jetës së aktivitetëve të Burimeve Njerëzore (Dhanabhankyam & Kokilambal, 2014).
Menaxhimi i mirë i talenteve ofron një siguri dhe vetëbesim për organizatën. Duke patur punonjës të talentuar, organizata krijon avantazh konkurruesë (Lawler, 2009). Strategjitë e talentetve janë të rëndësishme për çdo organizatë, pavarësisht sa fitimprurëse janë ato. Në këtë kontekst, pyetja që synojmë t'i japim përgjigje në këtë punim është: Cilat janë strategjitë më të suksshme të menaxhimit të talenteve në kompanitë e ndryshme ndërkombëtare dhe sa të rëndësishme janë këto strategji për tu implementuar në kompanitë shqiptare? Rezultatet e kësaj analize do të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë rëndësinë që ka menaxhimit i talentëve brenda një organizate dhe përfitimet që sjell në përformancën e organizatës në epoken e globalizmit.

Fjalë kyçe: ekonomia e dijes, menaxhimi i talenteve, zhvillimi i qendrueshëm

Hyrje

Menaxhimi i talenteve 'është proçesi i rekrutimit, vlerësimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjës së njerëzve më të rëndësishëm në organizatë' (Khatri, 2010). Procesi i menaxhimit të talenteve është bërë një nga çështjet më thelbësore të HR në një organizatë dhe të trajnimit të tyre (Bersin, 2006). Rëndësia e menaxhimit të talenteve duket qartë që nga mënyra se si kanë evoluar Burimet Njerëzore brenda një organizate. Në vitet 1970-1980 ekzistonte grupi i ashtuaquajtur "Departamenti i Personelit", i cili merrej me punësimin, pagat, sigurimin e personelit etj. Më pas në vitet 1980-1990 organizatat kuptuan se roli i Burimeve Njerëzore ishtë shumë herë më i rëndësishëm dhe mori emërtimin "Burimet Njerëzore Strategjike" dhe roli i këtij grupi përfshinte: rekrutimin e njerëzve të duhur, trajnimin e tyre, organizimin e strukturave, ekzekutimin e urdhërave dhe motivimn e punonjësve. Në këtë pjesë departamenti i Burimeve Njerëzore u kthye nga një funksion biznesi në një partner biznesi. Në vitet e fundit jemi duke hyrë në një epokë të re "Menaxhimi i Talenteve", ku Burimet Njerëzore janë fokusuar në një strategji më të kompletuar: në bërjën e gjërave në mënyrë efikase dhe efektive, në krijimin e vlerave dhe kredibilitetit brenda organizatës, në përshtatshmërinë e trajnimeve në mënyrë relevante dhe fleksibël (Bersin, 2006).

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Qellimi kryesor i këtij punimi është të analizojë rëndësinë që ka në ditët e sotme menaxhimi i talenteve për ecurinë e organizatës. Në mënyrë më konkrete ne do të analizojmë se cilat janë strategjitë më të suksshme të menaxhimit të talenteve në kompanitë e ndryshme ndërkombëtare dhe sa të rëndësishme janë këto strategji për tu implementuar në kompanitë shqiptare? Hipoteza bazë e këtij punimi është 'sa më mirë të menaxhohen talentët në një organizatë, aq më mirë realizohen objektivat dhe synimet afatgjata të organizatës'. Duke qënë se 'menaxhimi i talenteve' nuk përbën një koncept dhe teknikë shumë të njohur në kontekstin shqiptar, ky punim do të bazohet kryesisht në diskutimin e të dhënave dytësore. Në studime të mëtejshme, synohet testimi konkret i strategjive të aplikuara dhe masave të ndërmarra nga kompanitë shqiptare në drejtim të menaxhimit të talenteve në organizatë.
Pjesa e parë e punimit është përqëndruar në strategjitë dhe pratikat e menaxhmit të talenteve dhe përfitimet që sjellin talentët në një organizatë. Në pjesen e dytë do të bëhët një analogji e rezultateve të arritura në pjesen e parë të punimit me kontekstin shqiptar të biznesit, më synim ndërgjegjesimin e sipërmarrësve shqiptarë për rëndësinë që ka në ditët e sotme investimi në menaxhimin e talenteve në organizatë. Konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse do të përbëjnë pjesen përmbyllëse të këtij punimi.

Menaxhimi i talenteve si objektiv strategjik i biznesit

Sot punëdhënësit përballem me një treg të ndryshëm nga vitet e kaluara dhe është e vështirë për të mbajtur punonjës potencial me nivel interpretuesë relativisht të lartë. Organizatat po përballen me një konkurrencë shumë të lartë dhe është gjithnjë e më e vështirë të mbahet në nivele të larta zgjerimi i aktivitetit (Oracle, 2014). Nw nivel global, mw shumw se gjysma e punëdhënësve tregojnë se punësimi është rritur në raport me vitin e kaluar. "Ky studim tregon se është e vështirë për të gjetur dhe mbajtur talentët brenda një organizate" (Towers Watson, 2014). Punonjësit e sotëm, më shumë se asnjëherë tjetër kanë mundësinë e transferimit, lëvizjes dhe të punësimit në thuajse çdo skaj të botës. Në këtë këndvështrim, koncepti i stabilitetit në punë po zëvëndësohet gradualist me konceptin e stabilitetit të punonjësit. Kjo pasi, punonjësit e talentuar, në çdo moment janë të mundshëm për tu larguar nga organizata, gjë e cila përbën kosto shumëdimensionale për organizaten në fjalë.
Sondazhi vjetor global PwC's i CEOs ka treguar se 63% e të anketuarve janë të shqetësuar në lidhje me disponueshmërinë e ardhshme të aftësive kyçe të punonjësve të tyre. Ky rezultat na bën të kuptojmë më mirë arsyen se pse bizneset e vogla dhe të mesme perqëndrohen gjithnjë e më teper në menaxhimin e talenteve. Sondazhi i nëntë vjetor i Manspower Group mbi mungesen e talenteve ka treguar 'se 54% e punëdhënësve që raportojnë një mungesë talenti, thone se ajo ka një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tyre për të përmbushur nevojat e klientit. Rritja e qarkullimit të stafit është në vetvete pasojë e mungesës së talenteve nw organizatw. Megjithatë, lëvizja e shpeshtë e punonjësve të talentuar nga një organizatë në tjetren, rezulton të jetë negative për shkak të mos-angazhimit të tyre afatgjatë në një organizatë, nivelit të risisë dhe krijimtarisë në të' (Manpower Group , 2014). Nga ana tjetër, largimi i talenteve nga organizata e detyron këtë të fundit të punësojë njerëz më pak të talentuar, gjë e cila sjell dëmtime në performancën e organizatës dhe nuk mund ta çojë atë në nivelët e deshiruara të performancës.

Shumë drejtues biznesesh pohojnë se ekziston një problem në menaxhimin e talenteve dhe bien dakord se programet e menaxhimit të talenteve duhet të përmirësohen. Nga ana tjetër, zgjidhja e këtij problemi ka qënë i ngadalshëm, në raport me nevojat e bizneseve për shkak se një sistem i tillë (që realizon atë çfarë kanë nevojë burimet njerëzore dhe menaxherët) është i kushtueshëm për tu ruajtur dhe zbatuar (Oracle Corporation, 2014). Gjërat po ndryshojnë në mënyrë pozitive, duke filluar nga strategjitë e gjëra të biznesëve në drejtim të asaj çfarë talentët kërkojnë për të arritur suksesin. Kompanitë e suksesshme janë duke u fokusuar në menaxhimin e talenteve në mënyrë efektive dhe efikase (Oracle, 2014). Menaxhimi i talenteve kërkon integrimin dhe komunikmin mes kompanive ekzistuese për funksionet kryesore të burimeve njerëzore (Bersin, 2006).

Gjithashtu drejtuesit e lartë pohojnë se punonjësit përçojnë vlerën e biznesit. Çdo biznes mbështetet në talentët kyçe në mënyrë që të realizojë strategjitë e tij. Punonjësit e talentuar kanë vlerë për klientët dhe aksionerët e biznesit. Ata janë të mirë kualifikuar dhe kanë njohuri jo vetëm rreth punës së tyre por janë në gjendje të zgjidhin çdo situatë të mundshme që mund të ndodhë në biznes. Aftësi dhe njohuri të tilla janë një kërkesë e madhe për çdo organizatë, sepse 'nësë punonjësit nuk kanë aftësi për të përmbushur kërkesat e klienteve, atëhere organizata dështon'. Nësë punonjësit arrijnë të kuptojnë se ku janë më dobiprurësë në organizatë dhe menaxherët shprehin qartë çfarë duan nga punonjësit, atëhere bashkëpunimi i tyrë është një pasqyrim i realizimit të synimeve dhe objektivave të organizatës (The Economist Intelligence, 2007)

Biznesët përfitojnë kur qëllimet individuale të punonjësve janë në përputhje me qëllimet e biznesit. Në këtë këndvështrim burimet njerëzore ndihmojnë biznesin duke u siguruar se qëllimet e të dy palëve janë pothuajse të njejta dhe mund të ekzistojë bashkëpunimi. "Drejtimi i vërtetë i talenteve është një çelës për të qënë konkurrues" (Oracle, 2014, fq.5). Prandaj, më shumë se asnjëherë tjeter, menaxherët e burimeve njerëzore duhet t'i kushtojnë shumë vëmendje dhe rëndësi zgjedhjës së punonjësve të duhur për arritjën e qellimeve të organizatës. Lëvizshmëria e talenteve krijon tërheqje dhe sfidë njëkohësisht.

Menaxhimi i Talenteve & praktikat e Burimeve Njerëzore

Menaxhimi i talenteve është një proçes i vazhdueshën dhe i integruar për rekrutimin, trajnimin, menaxhimin, mbeshtetjen dhe kompesimin e ketyre individeve. Proçesi i menaxhimit të talenteve përfshin fuqinë punëtore, rekrutimin, vendosjën e talenteve në bord drejtimi, menaxhimin e përformancës, planifikimin e vazhdimësisë, kompesimin, aftësitë kritke etj., (Bersin, 2006). Talentet në organizatë kanë disa karakteristika të përbashkëta:

Talenti kërkon aftësi specifike & të përgjithshme
Talenti kërkon aftësi individuale & në grup
Talenti kërkon vlerësim & ndërgjegjshmëri
Talenti kërkon kompetenca, përkushtim & gadishmëri (Khatri Preeti, 2010)

Praktikat e mirëfillta të menaxhimit të talenteve kanë qëllim të rrisin performancën e organizatës, forcën e punës dhe zhvillimin profesional të punojësve (Dhanabhankyam & Kokilambal, 2014).
Menaxhimi i talenteve lidhet me çdo fazë të aktiviteteve të Burimeve Njerëzore:

Menaxhimi i talenteve dhe Fuqia punëtore: ky proçes krijon fuqinë punëtore, planet e punësimit, buxhetin e punësimit për vitin vijues.
Menaxhimi i talenteve dhe Rekrutimi: nëpërmjet ketij proçesi bëhet vlerësmi i duhur për zgjedhjën e duhur të punonjesve.
Menaxhimi i talenteve dhe Trajnime: kjo praktikë ka një rëndësi të madhe, siguron mënyrën e të mësuarit dhe të zhvilluarit të programeve për nivelët e organizatës. Mbi të gjitha, talentet menaxhohen sipas kategorive dhe në përputhje me objektivat strategjike të organizatës.
Menaxhimi i talenteve dhe Shpërblimet: në këtë fuksion organizatat përpiqën të përputhin planin e kompesimit në mënyrë direkte me menaxhimin e përformancës në mënyrë që përfitimet , stimujt, shpërblimet të lidhën me objektivate biznesit.
Menaxhimi i talenteve dhe përfshirja e talenteve ne bordin drejtimi: organizata duhet të trajnojë punojnësit që të jenë më produktive dhe të integruar në kompani, sidomos kur bëhet fjalë për përfshirjen e tyre në vendimmarrje të rëndësishme organizative.
Menaxhimi i talenteve dhe Menaxhimi i performancës: duke përdorur planin e biznesit, organizata përcakton proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e punonjësve.
Menaxhimi i talenteve dhe Planifikimi i vazhdimësisë: ky funksion ju mundëson menaxherëve të Burimeve Njerëzore indetifikimin e kanditatëve të duhur për një pozitë të caktuar në të ardhmen. Gjithashtu planifikimi i vazhdimësisë duhet të jetë në përputhje me planin e biznesit në mënyrë që të kuptohen dhe të përmbushen kërkesat për postet kyçe (3-5 vjet).

Menaxhimi i talenteve dhe aftësitë kritike: analizohen mangësitë dhe bëhet përmirësimi i tyre. Shumë organizata po shkojnë drejt menaxhimit kritik të talenteve në ditët e sotme (Bersin, 2006).
Organiztat duhet të kënë të qarta strategjitë aktuale dhe strategjitë e ardhshme që do të ndjekin. Ato duhet të identifikojnë mangësitë e talenteve ekzistuese dhe të dijnë çfarë talentesh të tjera ju nevojiten për të ardhmen (Wellins, Smith & Scott).

Grafiku Nr. 1: Përdorimi i strategjive të talenteve sipas industrive



	Pa strategji	Fillestar	Mesatarë	Avancuar
Qeveria	27%	48%	21%	4%
Prodhimi	13%	38%	42%	8%
Teknologjia	8%	31%	50%	11%
Bankat	9%	31%	52%	9%
Bizneset Konsultuese	9%	41%	41%	8%

Burimi: Bersin & Associates, 2010

Teknologjia & Menaxhimi i Talenteve

Kompanitë vazhdojnë duke investuar në talente, duke sakrifikuar produktivitetin. Të kesh njerëz të talentuar në një organizatë është padyshim një arritje e madhe. Nga ana tjetër të dish t'i menaxhosh ata është çelësi i suksesit (Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, 2001) Kompanitë gjithjnë e më shumë tentojnë të investojnë në talente, pasi nëpërmjet talenteve arrin të realizojnë qëllimet e tyre. Format më të zakonshme të investimit në talente përfshijnë:

Angzhimi i individëve për të përmbushur synimet dhe objektivat e organizatës
Zhvillimi profesional i ekipeve & individëve
Menaxhimi i përformancës me efektivitet
Përzgjedhja e talenteve më të mirë për promovimet
Reduktimi i sfidave të komunikimit
Komunikimi në të gjitha disiplinat & grupmoshat
Vleresimi i talentit për më të mirët për tu bashkuar në organizatë
Gjetja e talenteve jashtë organizatës
Suksesi me kontraktorët (Project Management, 2013)

Megjithatë, investimi me koston më të lartë në drejtim të menaxhimit të talenteve ka të bëjë me investimin teknologjik. Zhvillimet teknologjike janë drejtpërdrejtë të lidhura me burimet njerëzore, dhe në mënyrë specifike me menaxhimin e talenteve në organizatë. Përmes implementimit të teknologjise së informacionit në funksion të departamentit të Burimeve Njerëzore, është një arsye më shumë që e bën këtë departament më strategjikë dhe i jep mundësinë që të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin e biznesit (Road, 2014). Dekadat e fundit e kanë transformuar departamentin e Burimeve Njerëzore në një sistem të mirëfilltë teknologjik që siguron menaxhimin e talenteve, që ofron një strategje të sofistikuar të rekrutimit dhe që mbulon në mënyrë efektive fazat e ciklit të jetës së punonjësve. Teknologjia ka ndihmuar në menaxhimin e talenteve në mënyrë efikase,

ka thjeshtësuar punën e Burimeve Njerëzore, ka ndryshuar mënyrën se si Burimet Njerëzore realizojnë procesin e menaxhimit të talenteve etj., (Oracle, 2014).

Konteksti shqiptar i Biznesit dhe Menaxhimi i Talenteve në organizatë

Si pjesë e ekonomive në zhvillim, tregu i punës në Shqipëri akoma nuk pretendohet të jetë në fazën ku punonjësit lëvizin në mënyrë sistematike nga një kompani në tjetren. Përkundrazi, niveli i lartë i papunësisë është një tregues domethënës për të kuptuar deri diku kontekstin e biznesit në vend. Ajo çfarë duket shqetësimi kryesor tek shumë punonjës është garantimi i një vendi punë dhe qendrimi sa më afatgjatë në tregun e punës. Kjo ndoshta lidhet edhe me numrin e lartë të të diplomuarve çdo vit nga auditoret e universiteteve nga njëra anë dhe me numrin e vogël të hapsirave të punësimit nga ana tjetër. Në këtë situatë, menaxherët e lartë organizativ duket se nuk e ndjejnë mjaftueshëm "presionin" e largimit të talenteve nga organizata e tyre. Për rrjedhojë edhe investimi i tyre në drejtim të menaxhimit të talenteve është relativisht i ulët.
Megjithatë, hapja e tregut të punës në kuadër të globalizimit dhe lëvizjes së lirë të punonjësve, mendoj së duhet parë si kërcënim serioz nga ana e kompanive shqiptare. Kjo për faktin e thjeshtë se punonjësit e talentuar kanë më shumë se asnjëherë mundësi për tu punësuar jashtë kufijve të Shqipërisë, në organizata dhe kompani të ndryshme në thuajse çdo vend të botës. Për këtë arsye, menaxherët e lartë në Shqipëri duhet të ndërgjegjësohen mbi rëndësinë që investimi në drejtim të menaxhimit të talenteve, në mënyrë që këta të fundit ta shohin veten si pjesë të organizatës dhe si pjesë e planeve të tyre afatgjata.
Kompanitë e huaja që operojnë në Shqipëri, si për shembull Vodafonë, sjellin frymën pozitive të investimit në talented brenda organizatës përmes pagave të diferencuara të tyre, investimit në trajnimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të punonjësve të talentuar, dhënien e mundësisë për karrierë, përfshirjen në vendimmarrjet më të rëndësishme organizave etj. Ndoshta ky është një shembull i mirë që sipërmarrësit shqiptarë duhet të ndjekin në mënyrë që të garantojnë suksesin e tyre afatgjatë në treg.

Konkluzione

Në ditët e sotme thuajse çdo organizatat është në kërkim të talenteve të cilat do të punojnë sa më gjatë për të. Punonjësit janë ndërgjegjësuar për rëndësinë që kanë si aset themelorë i çdo organizate ndaj dhe pretendimet e tyre sa vijnë e shtohen. Për rrjedhoje mbajtja e talenteve brenda organizatës është bërë shumë e vështirë. Tashmë menaxhimi i talenteve fillon që nga proçesi i intervistës për të parë nësë punonjësi është i përshtatshëm për organizatën, e deri tek mënyra e ndarjës së punonjësve sipas ekspertizës dhe aftësive të tyre brenda organizatës. Me rritjen e konkurrencës, mungesa e talenteve dhe efektet e globalizimit do të sjellin nevojë më të madhe për menaxhimin e talenteve në drejtimin e duhur në një organizate. Kompanitë po levizin në drejtimin e menaxhimit të talenteve në mënyrë të integruar dhe sistematike.
Nëse i referohemi kontekstit shqiptar të biznesit, në pamje të parë duket se menaxhimi i talenteve nuk është akoma një domosdoshmëri pasi punonjësit kanë tendencen të jenë sa më afatgjatë në një vend pune dhe nuk preferojnë lëvizjen e vazhdueshme nga një kompani në tjetren. Megjithatë, globalizmi ju ka krijuar tashmë mundësinë punonjësve (përfshirë edhe atyre shqiptarë) të lëvizin jo vetem breda kufijve kombëtar, por në çdo skaj të globit. Ky fenomen, i nxitur edhe nga pasiguria dhe destabiliteti politik, mund të kthehet në një risk kërcënues për biznesin në Shqipëri. Për këtë arsye, sipërmarrësit në vendin tonë duhet të trajtojnë me prioritet strategjitë bashkëkohore të menaxhimit të talenteve, në mënyrë që të parandalojnë (dhe jo thjesht të korrigjojnë) pasojat që mund të shkaktoje fenomeni i lëvizjes sistematike të punonjësve në të ardhmen.

Referencat

Bersin & Associates, (2010), 'Talent Management: Benchmarks, Treds, & Best Practices', marrë nga http://www.hreonline.com/pdfs/TalentMgmtBenchmarks06162010.pdf (Parë për herë të fundit 15-03-2015)
Josh Bersin, Principal, (2006), 'Talent Managemnt What is it? Why not?', marrë nga http://www.bf.umich.edu/docs/KeyReferenceArticles.pdf (Parë për herë të fundit 09-03-2015)
Khatri Preeti, (2010), 'Talent Management in HR', marrë nga http://www.sciedu.ca/journal/index.php/jms/article/viewFile/64/22 (Parë për herë të fundit 15-03-2015)
Laywer E. (2009), 'Make Human Capital A Source of competitive Advantage, Organizational Dynamics-38(1), 1–7 marrë nga file:///C:/Users/Flori/Downloads/materiali%204-%20Manage-A%20Study%20on%20existing%20talent%20management%20practice-K.%20Kokillambal%20(3).pdf (Parë për herë të fundit 14-03-2015)
Manpower Group (2014) 'The Talent Shortage Continues'
Oracle Corporation, (2014), 'An Innovative Approach to Strategic Talent Management in the Cloud' marrw nga http://www.oracle.com/us/products/applications/human-capital-management/talent-management-2315742.pdf, (Parë për herë të fundit 08-03-2015)
Project Management Institute-Headquarters, (2013), ' The competitive advantage of effective organizational talent management', marrë nga http://www.pmi.org/~/media/PDF/Business-Solutions/PMExecutiveSummaryTalentMgmt.ashx (Parë për herë të fundit 14-03-2015)

Richards S.Wellins, Audrey B.Smith, Scott Erker,'White Paper' marrë nga https://www.ddiworld.com/DDIWorld/media/white-papers/ninebestpracticetalentmanagement_wp_ddi.pdf (Parë për herë të fundit 15-03-2015)
Silk Road Talent Talk, (2014), 'The State of TalentManagement 2014', marrë nga http://www.nasrecruitment.com/uploads/files/2014-state-of-talent-management-101.pdf (Parë për herë të fundit 15-03-2015)
Towers Watson, (2014), 'Global Talent Management and Rewards Study' marrë nga file:///C:/Users/Flori/Downloads/materiali%202-%202014-global-talent-management-and-rewards-study-towers-watson%20(1).pdf (parë për herë të fundit 14-03-2015)
The Economist Intelligence Unit, (2013), 'Building an integrated talent management strategy' marrë nga http://www.zanett.com/assets/pdf/wp_datasheets/Economist-White-Paper-building-an-integrated-talent-management-strategy.pdf (Parë për herë të fundit 15-03-5-2015)
Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, (Korrik,2001),'Menaxhimi Modern i Burimeve Njerëzore', Përgatitur nga projekti KOMPAS, Tiranë f-q 7

BRIKENË DIONIZI – PLANIFIKIMI STRATEGJIK, SPECIFIKA PËR SME-TË

BRIKENË DIONIZI
Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Abstract

Planning is a very important function that accompanies the performance of each manager. This function has specific characteristics to the small business, depending on their nature. Given the structure of the Albanian business, small business predominates, so it's pertinent to study the specifics of planning in this category. "What are the characteristics of planning?", "Do the managers of SMEs realize strategic planning?" – these are some of questions to be made. Here will be addressed also a very efficient tools as it's the balanced scorecard, which can help managers in the strategic planning process. It'll also be analyzed in the perspective of SMEs. Albania is looking for entering the common European market, but the business environment must be ready and operate on the European standards. This is why it's important to study the environment, to evaluate the problematics in order to formulate effective strategies for improving the business climate

Key words: SMEs, strategic planning, balanced scorecard.

Hyrje

Vizioni i çdo qeverie duhet të jetë krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që biznesi të lindë e të lulëzojë. Por që të realizohet kjo, duhet të kuptojmë karakteristikat e biznesit në vend, si dhe elementët përcaktues të suksesit apo dështimit të tyre. Biznesi në çdo vend ka karakteristikat e veta, prandaj del e domosdoshme për akademikët të studjojnë biznesin vendas dhe të paraqesin strategji që mund të përdoren nga politikëbërësit. Të gjithë duhet të kuptojnë që ndërvarësia e të gjithë bizneseve është një realitet bazë i sistemit ekonomik. Asnjë biznes sot nuk është një entitet më vete, aktiviteti i tij ka varësi nga bizneset e tjera. Pikërisht në këtë ndërvarësi gjendet roli i SME-ve pavarësisht nga struktura e biznesit në një vend të caktuar. Duke iu referuar vendit tonë, kategorizimi i biznesit ndryshon nga ai i Bashkimit Europian. Kështu sipas standarteve të BE-së kategorizimi është si më poshtë.

Tabela 1. Kategorizimi i Biznesit sipas BE-së

Kategorizimi biznesit	Nr.punonjësve	Xhiroja	ose	Totali i bilancit
Biznes i mesëm	< 250	≤ € 50 m		≤ € 43 m
Biznes i vogël	< 50	≤ € 10 m		≤ € 10 m
Mikrobiznes	< 10	≤ € 2 m		≤ € 2 m

Burimi: http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/facts-figures-analysis/sme-definition/index_en.htm

Duke iu referuar kategorizimit të mësipërm, në Shqipëri për vitin 2012 ishin 77 000 biznese në kategorinë SME, të cilët mbulojnë 70% të punësimit295. Duke iu referuar të njëjtit burim, Shqipëria në pesë vitet e fundit ka përjetuar një rritje të qëndrueshme. Por Shqipëria është një vend kandidat që inspiron hyrjen në tregun e përbashkët europian ku SME-të konsiderohen si një element kryesor për novacion, punësim, si dhe integrim social e lokal në Europe296. Kjo është një arsye më shumë për t'u kujdesur për legjislacionin, lehtësinë për fillimin e një biznesi të ri dhe elemente të tjerë që janë të rëndësishëm për krijimin e klimës së përshtatshme për nxitjen e zhvillimin e SME-ve. Nga ana tjetër, SME-të duhet të bëjnë përpjekje për zhvillimin e biznesit të tyre e planifikimi konsiderohet shumë i rëndësishëm pasi shumë elemente lidhen me efektivitetin e tij. Planifikimi ka të bëjë më përcaktimin e

[295] Muller et al., 2014, Annual Report on European SMEs 2013/2014, A partial and fragile recovery, pp. 51
[296] http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/files/charter/docs/charter_en.pdf

objektivave të biznesit dhe përcaktimin e strategjive për t'i arritur ato297. Zakonisht te SME-të është pronari/menaxher që merret me planifikimin, i cili është kryesisht informal (Scarborough, 2014). Mund të jetë me vlerë të studjohet proçesi i planifikimit te SME-të në vendin tonë dhe efektiviteti i këtij proçesi në produktivitetin e biznesit. Njohja është e vlefshme për të mirëpërcaktuar, në vazhdimësi, nevojat që ka kjo kategori biznesi dhe strategjitë e përshtatshme për nxitjen e tyre, të nevojshme këto për institucionet e edukimit, ato rregullatore, por edhe për politikëbërësit.

Planifikimi, specifika për SME-të

Disiplina e menaxhimit strategjik u shfaq në vitet 1980, bazuar në arritjet në fushën e planifikimit strategjik. Përgjithësisht menaxhimi strategjik shihet me orientim afatgjatë, i orientuar nga mundësitë për rritje në të ardhmen, i lidhur me nivelin më të lartë menaxherial që përcakton misionin, vizionin dhe kulturën e biznesit.

Planifikimi strategjik është një përpjekje për t'u përgatitur për të papriturat në të ardhmen, duke marrë parasysh dinamikën dhe kompleksitetin e mjedisit. Megjithëse e ardhmja nuk mund të parashikohet, është e mundur që organizata të përgatitet për të ardhmen dhe të marrë vendimet e veprime e duhura. Ndryshe nga menaxhimi strategjik, planifikimi nuk është i lidhur me zhvillimin e vizionit e objektivave strategjike, por siguron udhëzimet dhe programon për arritjen e vizionit e objektivave strategjike.

Pavarësisht nga fuqia relativisht e vogël e tregut, madhësia dhe fleksibiliteti i SME-ve i lejon atyre të specializohen për tregje të vogla që zakonisht nuk i interesojnë kompanive të mëdha për shkak të shitjeve relativisht të vogla dhe kostove fikse të mëdha. Për më tepër burimet e kufizuara të SME-ve rezultojnë në përqendrim në produkte, ku mund të sigurohen avantazhe të mëdha konkurruese dhe aftësi të veçanta për zgjidhje problemesh. Gjithashtu dhe fleksibiliteti ne vendim-marrje dhe kontaktet direkte me konsumatorin ndihmojnë në konvertimin e rezultateve të kërkim&zhvillimit në novacione të tregtueshme megjithëse mbetet risku i mbështetjes vetëm në një numër të vogël produktesh dhe mungesa e kompensimit të humbjeve (Kropfberger, 1986).

Duke qenë një vend ku mbizotërojnë SME-të (me mbi 90% të numrit total të bizneseve), është e rëndësishme që këto biznese të shihen si një burim të ardhurash (nëpërmjet taksave), inicativave sociale (nëpërmjet përfshirjes në komunitet), por edhe të vendeve të punës. Elementet që mundësojnë suksesin e biznesit mund të kategorizohen në tre grupe: kapacitetet dhe mundësitë e brendshme, mjedisi i jashtëm dhe vizioni i pronarit298. Është e rëndësishme që të kemi biznese të suksesshme prandaj dhe duhet të analizojmë këta elemente, ndër të cilët planifikimi strategjik zë një vend kyç. Gjithashtu biznesi nuk mund të mendohet pa novacionin, i cili duhet të merret parasysh në momentin e planifikimit strategjik. Studime të ndryshme tregojnë një marrëdhënie të drejtë ndërmjet planifikimit strategjik dhe suksesit. Bizneset që realizojnë planifikim strategjik sigurojnë rezultate më të mira, gjë që nënkupton që shpenzimet që lidhen me aktivitetet e planifikimit janë të kompensueshëm financiarisht (Kraus et al, 2008). Pearce&Robinson (2010) paraqesin tre modele të planifikimit formal strategjik: lloji sipërmarrës, planifikues e përshtatës. Vazhdimisht janë diskutuar ndryshimet ndërmjet SME-ve dhe bizneseve të mëdha, ndryshime që rrjedhin nga madhësia, lloji i biznesit apo faktorë të tjerë. Nganjëherë SME-të nuk i kanë burimet (financiare apo njerëzorë) për të siguruar vazhdueshmëri në zbatim të planifikimit srategjik. Në krahasim me kompanitë e mëdha, SME-të përgjithësisht kanë një nivel më të ulët burimesh, duke filluar nga kapitali financiar e njerëzor, si dhe mungesë të formimit akademik profesional (sidomos të menaxherit/pronar). Lidhur me planifikimin zakonisht SME-të angazhohen në forma intuitive, jo formale e të pastrukturuar të planifikimit të biznesit (Ponelis, 2014), të cilat mund të jenë pasqyrim i llojit sipërmarrës të planifikimit (Pearce&Robinson, 2010). Sipas këtij lloji bizneset praktikisht janë nën kontrollin e vetë pronarëve, ku vlerësimi strategjik është informal, intuitiv dhe i kufizuar.

[297] Daft R., 2006, The New Era of Management, pp 238
[298] Durham Business School, 2013, "Understanding growth in Microbusiness", BIS Research Paper no.114

Karta e balancuar tek SME-të

Menaxherët duhet të ndërgjegjësohen për elementët që sigurojnë sukses dhe të kuptuarit e marrëdhënieve ndërmjet faktorëve kyç të suksesit ndihmon në përcaktimin e strategjisë. Në mënyrë që të kordinojnë iniciativat strategjike me sjelljen e punonjësve, shumë firma përdorin kartën e balancuar299, e cila ndër të tjera është një mjet për pasqyrimin e marrëdhënieve mes faktorëve të ndryshëm (Antola et al, 2006) dhe vë theksin mbi balancën mes matësave financiarë e jofinanciarë për arritjen e drejtimit strategjik. Ajo u prezantua së pari nga Kaplan&Norton në 1992 në përpjekje për të përqendruar bizneset e mëdha në përmirësimin e matësave të tyre financiarë. Karta e balancuar siguron një mjet të fuqishëm për vizualizimin e strategjisë si një zinxhir i marrëdhënieve shkak/pasojë ndërmjet objektivave strategjikë dhe matjeve që mund t'iu komunikohen lehtësisht të gjithë punonjësve300. Ajo gjithashtu mund të ndihmojë për përmirësim në vendim-marrje e performancë.
Biznesi i vogël, i cili mund të përpiqet të përshtasë një proçes formal planifikimi, do të vendosë më tepër theks në cilësinë e vendimeve strategjike pasi menaxherët mund të kenë mungesë vizioni afatgjatë për ku është orientuar kompania, meqë orientohen më tepër nga proçese operacionale sesa strategjike (Lyles et al, 1993). Fillimisht e përdorur si një mjet për matjen e performancës, karta e balancuar sot mund të përdoret në kuadrin e komunikimit strategjik, si dhe të matjes së performancës. Ajo duhet të pasqyrojë rëndësinë e komunikimit të qartë të objektivave dhe prioriteteve, por edhe përfitimet e të mësuarit të vazhdueshëm dhe punës së integruar. Për të maksimizuar efektin e saj, karta e balancuar mund të përdoret në qendër të sistemit të menaxhimit strategjik pasi krijon një kordinim ndërmjet objektivave, iniciativave, njerëzve, proçeseve e sistemeve në gjithë organizatën. Monk (2000) rekomandon përdorimin e kartës së balancuar në sektorin e SME-vë për parandalinim, uljen apo menaxhimin e vështirësive, duke treguar vëmendje ndaj treguesve kyç, të tillë si kënaqësia e konsumatorit dhe cilësia. Ajo mund të përdoret edhe për përmirësimin e vazhdueshëm, një element i rëndësishëm ky për rritjen e SME-ve (Gumbus&Lussier, 2006). Megjithëse studimet empirike mbi zbatimin e kartës së balancuar janë shumë të pakta, përdorimi i saj duhet të stimulohet, sidomos për menaxherët-pronarë vizionarë që kërkojnë gjithnjë përmirësimin dhe i japin rëndësi të veçantë planeve afatgjata. Nga ana tjetër duhet të mbajmë parasysh që efektiviteti i një mjeti do maksimizohet, atëherë kur personat që e zbatojnë e njohin dhe dinë vlerat e tij. Prandaj mbetet gjithnjë i rëndësishëm mbajtja dhe trajnimi i punonjësve më të mire pasi mungesa e burimeve njerëzore m tepër sesa e atyre financiare është një nga barierat më të mëdha në zbatimin e karës së balancuar tek SME-të (Fernandes et al, 2006). Po ashtu kushtet e përgjithshme dhe kënaqësia e punonjësve mund të jenë barrier në implementim (Fernades et al, 2006, Ulf et al, 2006).

SME-të dhe terreni shqiptar

Ekonomia shqiptare përfshihet në ato ekonomi që udhëhiqen nga efiçenca me nje indeks global të konkurrencës të përkeqësuar (nga vendi i 78-të në 2011 në atë të 97-të në 2014), me një koefiçent të edukimit e trajnimit 4.5 (vlerësimi 1-7), por koefiçent të novacionit 2.7 (vlerësimi 1-7)301. Kjo mund të interpretohet si një mungesë efiçence dhe efektiviteti në përdorimin e kapacitetit intelektual prandaj del e domosdoshme për studjuesit që të orientohen nga tregu dhe të vendosin në zbatim teoritë e tyre. Një iniciativë e tillë mund të merret edhe tek SME-të, duke pasur parasysh që Shqipëria hyn në vendet ku dominon biznesi i vogël, siç shihet dhe nga grafiku i mëposhtëm.

[299] Smeal College of Business, The Pennsylvania State University, 2006, Innovation and Change Management in Small and Medium-Sized Manufacturing Companies, pp 35
[300] Kaplan&Norton, 2008, Mastering the Management System, available at https://hbr.org/2008/01/mastering-the-management-system
[301] Raporti i konkurrencës globale 2014-2015, pp 104-105, I disponueshëm në http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf



Burimi: INSTAT, Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik madhësisë, 2013

Zakonisht bizneset e vogla drejtohen nga pronarët/menaxherë, të cilët mund të jenë strategjikisht miopë pasi atyre iu mungon vizioni afatgjatë për ku është orientuar biznesi dhe më tepër orientohen nga cështje operacionale sesa strategjike (Mazaarol, 2004). Supozohet se ata përdorin burimin e kufizuar kohor më tepër për aktivitetet operacionalë apo të shitjes (Kraus et al, 2007). Disa nga problematikat që lidhen me zhvillimin e strategjisë te SME-të rrjedh nga vetë karakteristikat e tyre (Flueglistaller et al, 2003; Kraus et al, 2007), të tilla si:

- Burimet, koha e mjetet e kufizuara
- Njohuritë e kufizuara
- Përqendrimi kryesisht vetëm në një treg/produkt
- Mbingarkesë e mundshme për menaxhimin

Qëllimi i studimit është për të vlerësuar nëse

- kompanitë realizojnë planifikim strategjik
- sa është efektiv planifikimi i tyre
- a e njohin kartën e balancuar si një mjet që ndihmon në planifikim

Për këtë u morën në studim 127 biznese në rrethin e Shkodrës. Zgjedhja u bë e rastësishme, por duke patur parasysh edhe zhvillimin e biznesit në rreth, të gjithë bizneset janë biznese në kategorinë SME. Për realizimin e studimit u përdor pyetsori, i cili u plotësua nga pronari i biznesit nëpërmjet kontaktit direkt. Nga përgjigjet rezulton që vetëm 76% e bizneseve kanë një plan të shkruar (97), nga të cilët 61% (51 biznese) kanë bërë një plan të tillë vetëm sepse i është kërkuar nga institucionet financiare në momentin që kanë kërkuar të marrin kredi në bankë. Kështu rezulton që vetëm 38 biznese (nga ata që janë marrë në studim) e shohin si të domosdoshëm planifikimin strategjik dhe planet e tyre i shkruajnë e i realizojnë. Përsa i përket njohjes së kartës së balancuar, asnjë nga këta biznese nuk e njeh këtë mjet.

Diskutime

Menaxhimi i një biznesi të vogël përfshin një sjellje strategjike më shumë sesa zakonisht pranohet. Kështu psh vendim-marrja e pronarit/menaxher nuk është sistematike dhe formale në këndvështrimin e planifikimit, megjithatë ka ndikim strategjik tek firma302. Mund të themi që sipërmarrësit shqetësohen për qëndrimin afatgjatë në treg pasi ata kanë një vision në mendjen e tyre (mund të shohin dhe fëmijët e tyre duke drejtuar biznesin në një të ardhme). Ata janë kaq shumë të lidhur emocionalisht me biznesin, por duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka planifikimi në të

[302] Reboud&Mazzarol, 2008, Strategic planning in SMEs, a Revieë of the English and French Literature, Paper presented at the ANZAM Annual Conference, pp 2

ardhmen e biznesit. Ata mund të përdorin afërsinë që kanë me konsumatorin për të siguruar njohuri për tregun, të bëjnë planin e tyre strategjik dhe të zbatojnë ndryshimin (ata janë më fleksibël sesa bizneset e mëdha).

Proçesi i planifikimit te SME-të shpesh mund të kërkojë një përmirësim rrënjësor dhe një sistem i kuptueshëm për planifikim mund të jetë një parakusht për menaxhimin e riskut, me të cilin çdo sipërmarrës ndeshet (Henschel, 2006). Rezultatet e mësipërme japin një pasqyre të realitetit të biznesit, një realitet jo shumë pozitiv. Kjo është edhe në mbështetje të Scarborough, 2014; Daft, 2006; Ponelis, 2014, të cilët pranojnë që planifikimi në bizneset e vogla është më tepër informal. Megjithatë prezantimi me kartën e balancuar, si një mjet që ndihmon në planifikim e kontroll, do ishte një strategji e përshtatshme për të rritur ndërgjegjësimin e biznesit për rëndësinë e planifikimit në rritjen e efiçencës e efektivitetit të veprimeve të tyre të përditshme e afatgjata. Prandaj për të ardhmen do ishte me vlerë të sugjerohej trajnimi e orientimi i bizneseve nga elemente konkrete që ndihmojnë në planifikim dhe realizimi i studimit me një mostër shumë më të madhe se mostra e marrë aktualisht. Kjo do ndihmonte më shumë në objektivitetin e studimit.

Referenca

Antola J., Lonnqvist A., Uusi-Rauva E., Designing a strategy map in order to facilitate strategy implementation, LTA 1/06, pp 11-29

Daft R., 2006, The New Era of Management

Durham Business School, 2013, "Understanding growth in Microbusiness", BIS Research Paper no.114

Fernandes K.J., Raja V., Whally A., 2006, Lessons from implementing the balanced scorecards in small and medium size manufacturing organizations, Technovation, vol.26, pp 623-634

Flueglistaller U., Frey U, Halter F, 2003, Strategisches Management fuer KMU- Eine praxisorientierte Anleitung, St. Galle: KMU HSG
Gumbus, A., & Lussier, R. N. (2006). Entrepreneurs Use a Balanced Scorecard to Translate Strategy into Performance Measures, Journal of Small Business management, (44)3, 407-425. http://dx.doi.org/10.1111/j.1540-627X.2006.00179.x
Henschel T., 2006, Risk Management Practices in German SMEs: An empirical investigation, International Journal of Entrepreneurship and Small Business, vol.3, no. 5, pp 554-571
Kaplan R.S., Norton D.P., 2008, Mastering the Management System, Harvard Business Review, available at https://hbr.org/2008/01/mastering-the-management-system
Krauss S, Reiche B.S., Reschke C.H., 2008, Implications of strategic planning in SMEs for international entrepreneurship research and practice, In M. Terziovski (Ed.), Energizing Management through Innovation and Entrepreneurship: European Research and Practice, pp. 110-127. London: Routledge
Lyles M.A., Baird I.S., Orris J.B., Kuratko D.F., 1993, "Formalized planning in small business: Increasing strategic choices", Journal of Small Business Management, April, pp 38-52
Mazzarol T., 2004, "Strategic management of small firms: A proposed framework for entrepreneurial ventures", Proceedings for the 17th Annual SEAANZ Conference, Entrepreneurship as the way of Future
Monk, R. (2000). Why Small Businesses Fail, CMA Management, (74) 6, 12-13.
Muller et al, 2014, Annual Report on European SMEs 2013/2014, A partial and fragile recovery
Pearce J.A., Robinson R.B., 2010, Strategic management: Analysis, Implementation and Control (13th ed.)
Ponelis Sh. R., 2014, Information and IT in SMEs, Encyclopedia of Information, Science and Technology, 3rd ed., IGI Global, pp 6688-6695
Reboud S., Mazzarol T, 2008, Strategic Planning in SMEs, a Review of the English and French Literature, Paper presented at the ANZAM Annual Conference, Auckland New Zealand
Scarborough N.M., 2014, Essentials of Entrepreneurship and Small Business Management, Bot VII
Smeal College of Business, The Pennsylvania State University, Sponsored research prepared for US Dept. of Commerce, 2006, Innovation and Change Management in Small and Medium-Sized Manufacturing Companies
Ulf J, Matti S., Andreas B., Roland A., 2006, Balancing dilemmas of the balanced scorecard, Accounting, Auditing & Accountability Journal, vol.19, no.6, pp 842-857
http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/files/charter/docs/charter_en.pdf
http://www.instat.gov.al/al/themes/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABrmarrjeve.aspx?tab=tabs-5
Global Competiveness Report 2014-15
http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf

DORUNTINA MUSTAFA – STRUKTURA DHE ROLI I NVM-VE NË EKONOMINË E KOSOVËS

DORUNTINA MUSTAFA
Univeristeti i Prizrenit "Ushkin Hoti"

Abstrakti

Duke pasur parasysh ndikimin dhe rolin që po e nxënë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në ekonominë vendore vendosa që objekt shqyrtimi për këtë punim të merren pikërisht ky lloj i subjekteve ekonomike.
Studimi i kësaj problematike mund të themi se ka mjaft rëndësi për shumë arsye, një nga arsyet e shumta është se numri i tyre dekadën e fundit ka shënuar rritje të konsiderueshme, ndonëse një rritje e tillë viteve të fundit nuk po vërehet.
Një arsye tjetër për punimin e kësaj teme, është domosdoshmëria e njoftimit të qytetarëve me dinamikën dhe ndikimin e këtyre bizneseve në ekonominë vendore si dhe mundësitë e tyre për të pasur qasje edhe në ekonominë ndërkombëtare.
Për shkak të krijimit të këtyre rrethanave të reja politike, ekonomike dhe juridike NVM janë të prirura që të shfrytëzojnë rrethanat e krijuara dhe për t'i shfrytëzuar ato drejt një ndikimi pozitiv për ekonominë vendore.
Për arritjen e rezultatëve të dëshiruara gjatë studimit dhe hulumtimit të këtij punimi me qëllim që ky punim të jetë sa më serioz, i qartë dhe i punuar në mënyrë sa më profesionale janë përdorur metodologji dhe metoda të caktuara empirike , si rrugë për të arritur deri te një studim sa më objektiv i NVM-ve në Kosovë.
Ky punim është bazuar në literaturë teorike, shkencore dhe dispozitat e aplikueshme, po ashtu nuk ka munguar edhe konsultimi me punime shkencore të autorëve të ndryshëm. Të dhënat e siguruara janë të sistemuara dhe të klasifikuara në aspektin kronologjik dhe përmbajtësor, me qëllim të paraqitjes së tyre në mënyrë sa më racionale dhe të kuptueshme.

Qasjet dhe specifikat e ndryshme në përkufizimin e BVM

Në literaurën e sotme, por edhe në jetën e përditshme ka një trajtim të gjerë lidhur me termin ndërmarrje, përkatësisht biznese të vogla dhe të mesme (NVM / BVM). Megjithatë nuk ka pajtueshmëri rreth asaj se cilat janë kriteret që e përcaktojnë një ndërmarrje apo biznes për të qenë i vogël apo i mesëm.

Një nga përkufizimet për biznesin e vogël është dhënë nga "Committee for Econimic Development", sipas të cilit duhen të plotësohen dy ose më shumë nga karakteristikat vijuese:
Menaxhmenti i firmës është i pavarur dhe zakonisht menaxherët janë njëkohësisht pronarë
Kapitali është një pronësi të një individi ose një grupi të vogël;
Regjioni i shtirjes kryesisht është i vogël, ndërsa të punësuarit dhe pronarët janë nga i njëjti rajon. Mirëpo tregu nuk do të thotë të jetë lokal.
Madhësia relative e firmës në korniza të industrisë patjetër duhet të jetë e vogël kur krahasohet me ndërmarrjet më të mëdha në atë rajon.
Kjo mund të jetë e paraqitur në termine si madhësia e shitjes, numri i të punësuarve ose një numër i madh i krahasimeve të rëndësishme.
Është e qartë se gjatë përkufizimit të biznesit të vogël dhe të mesëm duhet të merren parasysh më shumë kritere, të cilat mund të ndihmojnë. 303
Ekzistojnë dallime themelore në mes të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, të cilat duhet pasur parasysh, kur bisedohet për zbatimin e menaxhmentit. Thënë thjeshtë, ndërmarrjet e vogla kanë disa

[303] M.Mustafa, E. Kutllovci, P.Gashi, B. Krasniqi., Biznesi i vogël dhe i mesëm,Instituti Riinvest,Prishtinë 2006 fq. 19

karakteristika imanente, të cilat dalin nga madhësia. Kështu, p.sh. ndërmarrjet e vogla kanë numër të vogël të punësuarish, madhësi të vogël të punës, numër të vogël shfrytëzuesish dhe kryesisht veprojnë në tregje lokale. Për të sqaruar dallimet në aplikimin e menaxhmentit në ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, është e nevojshme që të sqarohen disa karakteristika plotësuese të ndërmarrjeve të vogla të cilat i dallojnë nga ndërmarrjet e mëdha.

Ato janë:
Marrja më e shpejtë e vendimeve
Fleksibilitet më i madh
Centralizim më i madh gjatë marrjes së vendimeve, strukturë organizative e thjeshtë
Ndikim i madh i pronarit, komunikim i drejtëpërdrejtë prej lartë poshtë, planifikim formal i thjeshtë
Participim i kufizuar të punsuarëve në vendimmarrje, më pak nivele të menaxhmentit.304

NVM-të gjenerator kryesor i zhvillimit ekonomik në Kosovë

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë një histori shumë të gjatë, ndërsa zhvillimi i tyre është i shënuar me zgjerimin dhe stagnimin e tyre të kohëpaskohshëm.
Ndonëse një pjesë e vogël e tyre përdor teknikë tradicionale pjesa më e madhe aplikon një teknologji të re dhe të lartë si dhe një organizim modern. Primare është se NVM-të simbolizojnë një shkallë të lartë të inovacionit, fleksibilitetit dhe adaptim ndaj ndryshimeve, të cilat ndodhin në rrethinë. Edhe pse janë të orientuara nga tregu lokal NVM-të kanë ndikim edhe në këmbimet ndërkombëtare, pjesëmarrja e tyre është shumë më e madhe sesa e ndërmarrjeve të mëdha. Rastet kur ekonomitë e ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha po gjejnë një gjuhë të përbashkët po bëhen çdo ditë e më të mëdha. Zhvillimi i NVM-ve kontribuon edhe në vendet në tranzicion në ringjalljen e iniciativës ndërmarrëse në ndryshimin e stukturës ekonomike dhe funksionimin e ekonomisë në përgjithësi në Kosovë dhe vende tjera të botës.

Sfidat kryesore janë rritja ekonomike, zhvillimi i NVM-ve, gjetja e tregjeve nga prodhuesit, përmirësimi i legjislacionit për NVM-të, luftimi informalitetit e korrupsionit, reforma në administratën publike, mbyllja e bizneseve e shumë sfida tjera që po pengojnë zhvillimin e NVM-ve. Pa rritjen e fuqisë blerëse nuk ka edhe zhvillim të NVM-ve. Sidomos në këto vite në Kosovë, zhvillimi i NVM-ve kontribuon në përballimin e çështjeve të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, me efektet e pabarazisë sociale, me nivelin e lartë të papunësisë, me rritjen më të shpejtë demografike dhe me nevojën shumë të madhe për ndryshime strukturale në përgjithësi. Zhvillimi i NVM-ve ofron mundësi të mëdha punësimi, të cilat do të ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë, dhe në përballimin e problemeve demografike të popullatës, të cilat janë në rritje mjaft të shpejtë.

Zhvillimi do të promovojë edhe transformimin e përgjithshëm të sektorit të NVM, për shkak të lidhjes me inovimin dhe zhvillimin teknologjik të këtyre ndërmarrjeve. Prandaj, zhvillimi i sektorit të NVM-ve është i rëndësishëm për Kosovën, sidomos nëse merren parasysh problemet sociale në vendit, të cilat janë në masë të madhe pasojë e rritjes së pabarabartë ekonomike. Zhvillimi i qëndrueshëm i rajonit kërkon shpërndarjen e kulturës së promovimit të investimeve dhe të territoreve ndërvepruesit lokalë, duke mundësuar ndarjen më të mirë të investimeve, vendeve të punës, pasurive dhe përballimin e konkurrencës, e cila intensifikohet vazhdimisht kohëve të fundit në Kosovë.
Në Kosovë mbi 99% të numrit të përgjithshëm të firmave janë karakterizuar si ndërmarrje të vogla dhe të mesme, prandaj roli i tyre në zgjidhjen e papunësisë dhe rritjen ekonomike, zvogëlimin e varfërisë është tejet i madh.

Problemet e menaxhmit financiar

Sikurse edhe në fushat e tjera edhe tek fusha e menaxhimit të financave në BVM paraqiten probleme specifike që kanë të bëjnë me efiçiencën në sigurimin e burimeve të nevojshme si dhe për mundësitë

[304] M.Mustafa, E. Kutllovci, P.Gashi, B. Krasniqi., Biznesi i vogël dhe i mesëm,Instituti Riinvest,Prishtinë 2006 fq. 22

për të shfrytëzuar mirë asetet, me të cilat disponojnë bizneset dhe duke krijuar nga ato si afësinë paguese (likuidetin) dhe aftësinë për të investuar. Lidhur me këtë paraqiten probleme të shumta.
Menaxhimi dhe evidenca e varfër, e cila ka burimin në nënçmimin e rëndësisë së ndërtimit të një evidence të mirë financiare, sistemi cilësor informativ, nga ana e pronarit dhe ndërmarrësit. Kjo ka për pasojë që menaxhmi i financave nuk bëhet në mënyrë efektive, nuk ka kontroll efikas financiar dhe vendimet për shfrytëzimin e mjeteve në disponim, apo për sigurimin e mjeteve plotësuese nuk janë cilësore dhe nuk merren në kohën e duhur.
Kontrolli jo cilësor ndikon në shfrytëzimin joracional të aseteve ekzistuese kështu që mund të paraqiten situata kur hyet në borxhe pa nevojë dhe nuk i kushtohet mjaft kujdes shfrytëzimit të aseteve me të cilat disponon biznesi.
Stoqet e tepërta, të cilat shkatojnë mungesë financimesh të kapitalit punues dhe vonesa në arkëtimin e pagesave janë pasojë logjike e një gjendjeje kur evidenca nuk shikohet me kujdes nga pronari apo menaxheri.

Bizneset e Regjistruara në Kosovë

Sipas ARBK-së në MTI, numri i NVM-ve të regjistruara më 31 dhjetor 2010 ishte më i madh se 100.000, të cilat punësojnë 216.799 punëtorë, ose 79.59% të totalit të të punësuarve në sektorin privat dhe 62.24% të totalit të punësuarve në Kosovë.
Madhësia e NVM-ve në Kosovë është e definuar me Ligjin nr. 2005/02-L5 dhe me Ligjin nr. 03/L-031 për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Numri i të punësuarve është
kriteri i vetëm që përdoret për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas madhësisë në Kosovë. Kjo paraqet dallimin me vendet e BE-së, ku përveç numrit të punëtorëve, merret parasysh edhe qarkullimi vjetor.
Në tabelë është dhënë spektri i ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë në
bazë të numrit të punëtorëve.[305]
Aktivitetet ekonomike më të preferuara edhe gjatë këtij tremujori ishin me 793 ndërmarrje (31.7%), pasuritë e patundshme dhe rënia me qira me 322(12.9%), industria përpunuese me 278(11.01%), hotelet dhe restorantet me 245 (8.9%), transporti, depot dhe telekomunikacioni me 175 ndërmarrje (7.0%), bujqësia, gjuetia dhe pylltaria 149 (6.0%). Ndërsa akivitetet tjera marrin pjesë në shkallë më të vogël.[306]

Kategoria e numrit të punësuarve nga 1-4 (të punësuar) përbën rreth 2428 ndërmarrje apo 97.0% të ndërmarrjeve të reja, kategoria me 5-9 me 58(2.3%), kategoria me 10- 19 me 13 (0.5%), kategoria me 20-49 me 3 ndërmarrje (0.1%), kategoria me 50-49 me vetëm 2 ndërmarrje, ndërsa në kategorinë e fundit me 250 e më shumë të punësuar nuk është asnjë ndërmarrje e re e rëgjistruar në këtë tremujorë.
Sa i përket shtrirjes së ndërmarrjeve të reja nëpër komuna të reja edhe në këtë tremujorë mbizotëron Prishtina me 681 sosh, Prizreni dhe Ferizaj kanë numër të njëjtë me nga 196, Gjilani me 147, Peja me 131 sosh, Mitrovica me 119, Gjakova me 109, ndërsa komunat tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të reja gjatë këtij tremujori.
Sigurisht që lloji i pronësisë i paraqitur më lartë paraqet mangësitë e NVM-ve në Kosovë, sepse
tregon hezitim të pronarëve të NVM-ve për bashkimin e kapitalit financiar dhe njerëzor në forma më të avancuara të biznesit.

Analiza SWOT për Sektorin e NVM-ve

Përparësitë u referohen mundësive apo aftësive të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të NVM-ve. Si të tilla, ato janë shumë të rëndësishme sepse përparësia mund të përdoret për shfrytëzimin e të gjitha mundësive, për zbutjen dhe zvogëlimin e dobësive si dhe po ashtu edhe për reduktimin e kërcënimeve. Në kuptimin e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë, gjer më tani janë identifikuar 18 përparësi të ndryshme. Pjesa dërmuese e këtyre përparësive kanë të bëjnë me rritjen e

[305] http://www.scribd.com/doc/137422883/Strategjia-e-zhvillimit-te-NVM-ve-ne-Kosove
[306] http://www.kosovapress.com/sq/ekonomi/bie-numri-i-ndermarrjeve-dhe-bizneseve-te-reja-1065/

vazhdueshme të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), kostos së ulët të fuqisë punëtore të shkolluar dhe me moshë të re, miratimin e Aktit për Biznese të Vogla (ABV) si dhe rritjen e shkallës së harmonizimit të politikave kosovare për NVM-të me NVM-të e Bashkimit Evropian (BE).

Dobësitë janë mungesa apo deficite substanciale të cilat e pengojnë rritjen, zhvillimin dhe mbijetesën e NVM-ve. Janë identifikuar një numër i tërësishëm prej 33 dobësish të ndryshme dhe më kryesoret prej tyre janë mungesa e një kornize të qartë strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të NVM-ve si dhe korniza e pafavorshme legjislative për fillimin e bizneseve të reja siç është vënë re edhe në raportin e BB-së për zhvillimin e biznesit.

Mundësitë janë shanse dhe raste të mira të cilat janë në dispozicionin e NVM-ve në funksion të zhvillimit dhe të rritjes së tyre të mëtejshme. Gjatë zhvillimit të analizave SWOT gjithsej janë identifikuar 35 mundësi të ndryshme. Këto mundësi kryesisht lidhen me mundësinë e Kosovës për t'iu bashkëngjitur Bashkimit Evropian – BE-së, Organizatës Botërore të Tregtisë – OBT-së si dhe përmirësimit të shkallës së implementimit të CEFTA-s. Për më tepër, ngritja e shkallës së eksporteve, zhvillimi tepër i shpejtë i sektorit të komunikimeve elektronike dhe prokurimi i
mallrave dhe i shërbimeve në procesin e biznesit, janë vetëm disa prej mundësive të cilat do të mund të shfrytëzoheshin nga ana e NVM-ve në Kosovë.

Kërcënimet paraqesin sfida të jashtëzakonshme, të cilat do të mund të pengonin apo linin prapa një përparësi të identifikuar apo do të mund të përshpejtonin një dobësi të caktuar duke penguar në këtë mënyrë shfrytëzimin e mëtejshëm të mundësive të llojllojshme. Situata e paqëndrueshme politike, shkalla në rritje e korrupsionit si dhe legjislacioni i dobët për përmbarimin e kontratave, pastaj niveli i lartë i varfërisë janë vetëm disa nga numri i tërësishëm prej 14 kërcënimesh në fushën e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë.

Faktorët kryesorë të falimentimit të NVM-ve

Kohëve të fundit menxherët e bizneseve të vogla shpesh përballen me një sërë problemesh të cilat janë unike, por rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen ata është falimentimi i biznesit. Është fakt që aktualisht niveli i falimentimit të bizneseve të vogla është i lartë.
Janë me qindra biznese të reja që stratojnë çdo vit në botë, por fatkeqësisht më pak se gjysma e tyre janë të suksesshme. Përgjithësisht, më shumë se 50% e bizneseve të reja falimentojnë Brenda pesë viteve të para të aktivitetit të tyre , ndërsa në Europë nga të gjitha bizneset e ngritura rishtazi mbijetojnë 87% e bizneseve në vitin e parë të jetës së tyre, 68% për rreth tre vjet, dhe 55% mbijetojnë deri në fund të vitit të pestë.307

Dy nga shkaqet kryesore të dështimit të bizneseve janë:

Mungesa e ekspertizës në fushën manaxheriale. Rëndësia e veçantë e menaxhimit dhe e menaxherëve të aftë është provuar me dhjetëra e qindra herë nga praktika e biznesit botëror. Shpesh faktori vendimtar për suksesin apo dështimin e biznesit ka qenë roli dhe kompetenca profesionale e ekipit menaxherial. Në Kosovë, ashtu sikurse në vendet tjera, kalimi drejt një ekonomie të mbështetur në principet e ekonomisë së tregut, shtroi si domosdoshmëri edhe një rikonceptim të përmbajtjes dhe rolit të menaxherit, të cilit do t'i duhej të orientohej e të ishte i suksesshëm në një fushë ku loja luhej sipas një tërësie rregullash pothuajse të panjohura prej tyre. Në këtë këndvështrim , mund të themi se menaxhimi ishte një shkencë e profesion i ri, të cilën për të qenë efektiv në punën e tyre, menaxherët kosovarë duhet ta mësonin nga e para.

Aftësitë e kufizuara financiare. Jo rrallë, shumë nga problemet me të cilat ballafaqohen firmat e vogla e që çojnë deri në falimentim është aftësia e kufizuar financiare. Sipas literaturës së kësaj fushe, gati 60% e financimeve të bizneseve të vogla vjen nga burimet vetjake të sipërmarrëseve. Në jo pak raste të tjera, burim financimi janë kursimet e të afërmve dhe të njohurve të tyre. Madje, në disa vende,

[307] Prof.Dr Shyqri Llaci,Manaxhimi,Tiranë 2010,Fq 31

duke përfshirë edhe vendin tonë, të ardhurat e këtyre njerëzve që punojnë si emigrant në vendet tjera kanë përbërë një nga burimet kryesore të financimit të bizneseve të tilla. Pra, është e qartë se firmat e vogla kanë më pak mundësi për të kompensuar investimet e këqia sesa bizneset e mëdha, për rrjedhojë investimet e bëra prej tyre janë më të riskuara. Kjo ndikon negativisht edhe në aneksin e tyre ndaj kredive bankare. Në fakt, problemet financiare me të cilat ballafaqohen bizneset e vogla janë më të mprehta sidomos për ato lloj biznesesh që janë shumë të vogla. Edhe bankat në përgjithësi e shohin si një investim me risk dhënien e kredive për këto biznese.

Konkluzione dhe rekomandime

Kosova gradualisht po përgatitet për sfidat që zakonisht janë përballur vendet që janë apo kanë kaluar periudhën e tranzicionit si, transferi i dijes dhe teknologjisë, absorbimi i fondeve dhe distribuimi i tyre, thithja e investimeve të huaja, anëtarësimi në mekanizmat dhe institucionet kryesore ndërkombëtare. Në këtë rrugëtim mbështetja e komunitetit ndërkombëtar edhe më tej do jetë shumë e mirëseardhur po edhe institucionet e Kosovës, Kuvendi, Presidenca, Qeveria dhe gjithë mekanizmat brenda shoqërisë kosovare do të punojnë me përkushtim dhe profesionalizëm për t'i krijuar popullit të Kosovës një perspektivë evropiane, ku qytetarët e saj do të ndjehen të lirë dhe të barabartë.
Zhvillimi i Sektorit të NVM-ve në Kosovë ka bërë një progres të padiskutueshëm. Ambienti që rrethohet dhe vepron jo gjithherë ka qenë miqësor dhe i favorshëm për këtë sektor. Pesë vite pas lufte mund të themi se sektori i NVM-ve ka një prirje kah stabilizimi dhe veprimi normal. Shumë indikatorë që menjëherë pas lufte frynë të arriturat e këtij sektori tani po vijnë dhe po stabilizohen. Prirjet e ndërmarrësve për përfitime të lehta dhe të shpejta gradualisht po zëvendësohen me qëndrime përmbajtjesore dhe pritje reale të mbështetura kryesisht mbi zhvillimet e tregut, ku dominon raporti mes ofertës dhe kërkesës.
Në literaturën e sotme analizohet dhe debatohet shumë mbi shkaqet e dështimit të bizneseve në përgjithësi e sidomos të biznesit të vogël dhe të mesëm për shkak të rëndësisë dhe vendit që zënë në kuadrin e ekonomisë kombëtare të një vendi. Shpesh trajtohet një diapazon i gjerë faktorësh, sikurse janë shitjet e pamjaftueshme, fitimi i vogël, shpenzime të larta të akiviteteve ekonomike, mashtrimet, etj.
Rol të rëndësishëm të zhvillimit të tyre kanë asociacionet e ndryshme ekonomike, si odat ekonomike, shoqatat afariste, format e kooperimit ndërmjet NVM-ve dhe korporatave, zhvillimi i franqizës, joint-venture, dhe inkubatorëve.
Vlerësohet se efikasiteti ekonomik do të arrihet përmes përmirësimit të udhëheqjes dhe aftësisë për përshtatshmëri ndaj kushteve të reja të afarizmit, përmes motivimit të punëtorëve, rritjes së prodhimit, aftësisë vetëfinancuese dhe zhvillimit. Për realizimin e këtij modeli nevojitet ndërtimi i sitemit ekonomik, krijimi i klimës së përgjithshme dhe kushteve makroekonomike, si dhe krijimi i infastrukturës institucionale.

Literatura

Mustafa M, Kutllovci E,Gashi P, Krasniqi B: “Biznesi i vogël dhe i mesëm”, Prishtinë 2006
Llaci Shyqyri: “Manaxhimi”, Tiranë 2010
Mustafa Isa Dr.: “Udhëheqja efiçienca dhe efektiviteti”,Prishtinë 2008
Bombek Kliford M: “Basic Small Business Management,Libër Universitar, Tiranë 1994
Ramosaj Berim Dr: “Management-Menaxhmenti kreativ&Lidershipi”,2006
Republika e Kosovës: “Ligji për mbështjetjen e NVM”
HOTI, Hamdi: “Ndikimi i NVM në ekonomi”, The 1 st International Conference on Research and Educatıon– Challenges Toward the Future (ICRAE 2013), 24-25 May 2013, University of Shkodra “Luigj Gurakuqi” Albania
Gazeta ditore “Kosovapress”,16 nëntor 2012
http://www.scribd.com/doc/137422883/Strategjia-e-zhvillimit-te-NVM-ve-ne-Kosove

http://www.kosovapress.com/sq/ekonomi/bie-numri-i-ndermarrjeve-dhe-bizneseve-te-reja-1065/

PROF. ASOC. DR. BRILANDA BUSHATI, PROF.AS.DR. ELEZ OSMANI – RENDESIA E PERDORIMIT TE SISTEMEVE TE INFORMACIONIT NE BANKA. (RASTI BANKA E SHQIPERISE)

PROF. ASOC. DR. BRILANDA BUSHATI
Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

PROF.AS.DR.ELEZ OSMANI

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Abstrakti

Në këtë punim paraqitet roli dhe rëndësia ë përdorimit të TI dhë kryesisht të sistemeve të informacionit në sistemin bankar. Shekulli i ri do të sjellë një konvergjencë gjithëpërfshirëse të kompjuterit, komunikimit, të informacionit, informatikës, dhe njohurive. Kjo do të ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si jetojmë, punojmë, dhe mendojmë. Rritja e rrjeteve me shpejtësi të lartë, shoqëruar me kosto në rënie të pushtetit te kompjuterit, është duke bërë të mundshme aplikime te pa ëndërruara në të kaluarën. Zëri, të dhënat, imazhet, dhe videot tani mund të transferohen rreth botës në mikro- sekonda. Ky shpërthim i teknologjisë po ndryshon industrinë bankare prej letres dhe degëve të bankave në " shërbimeve të digjitalizuar" dhe rrjete sherbimi bankare. Ajo ka ndryshuar tashmë dhe kontabilitetin e brendëshëm dhe sistemet e menaxhimit të bankave. Ajo tani është duke ndryshuar rrënjësisht sistemet qe bankat përdorin për të bashkëvepruar me klientët e tyre. Në të gjithë botën, bankat janë ende duke luftuar për të gjetur një zgjidhje teknologjike për të përmbushur sfidat e një mjedisi qe eshte në ndryshim të shpejtë. Është e qartë se kjo teknologji e re po ndryshon industrinë bankare përgjithmonë. Bankat me aftësinë për të investuar dhe integruar teknologjinë e informacionit do të dominojë mjaft në tregun konkurrues global. Bankieret janë të bindur se duke investuar në IT është e rendesishme. Potenciali i TI dhe pasojat për të ardhmen e industrisë bankare është i madh.

Teknologjia dhe Transformimi i Bankave

Kompjuterat janë duke u bere më shumë të sofistikuar. Ata i kanë dhënë bankave një potencial qe ata vetëm mund të ëndërronin dhe u kanë dhënë shpresa të mëdha klientëve te bankës. Ndryshimet që teknologjitë e reja kanë nxjerrë në sektorin bankar janë enorme në ndikimin e tyre mbi zyrtarët, punonjësit dhe klientët e bankave. Përparimet në teknologji kanë lejuar për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare më të përshtatshme dhe efikase se kurrë më parë - duke krijuar kështu bazat e reja të konkurrencës. Qasje të shpejtë në informacione kritike dhe aftësia për të vepruar shpejt dhe në mënyrë efektive do të dallojë bankat e suksesshme ne të ardhmen. Banka fiton një avantazh konkurrues jetik nga të paturit e një marketingu të drejtpërdrejtë dhe të përgjegjshëm ne nje mjedis të shërbimit të klientit dhe proçeseve të reja të njësuara te biznesit. Menaxhimi i qëndrueshëm dhe sistemet e mbështetjes vendimit i sigurojnë bankave një avantazh konkurrues për të ecur përpara në tregun bankar.

Ndikimi i SI në efiçencën e bankave

Interneti na jep një kanal për bizneset për të mundësuar produkte dhe shërbime te konsumatorët. Për kompanitë që japin shërbime, duket natyrale që adaptimi i kësaj teknologjie do të jetë më e mirë për të arritur klientët, si edhe për ti dhënë një shërbim më të mirë, dhe kjo duhet të rezultojë në një performancë më të mirë. Por nga ana tjetër konsumatorët thjesht mund të hyjnë dhe të mbledhin informacione rreth produkteve, dhe më pas të bëjnë një krahasim çmimesh midis tyre. Kjo do të çonte në një konkurrencë me veten,edhe nëse e ka një treg të gatshëm. Në këtë rast kjo lloj metode mund të rezultojë në drejtimtë kundërt me qëllimin e kompanisë.Vendi ku vendosja e teknologjisë do të kishte

më tepër ndikim do të ishte industria e bankave. Nga vëzhgime të shumta është parë se bankat rajonale me mundësi transaksionesh me internet duket se janë më efektive. Teorikisht kjo mund të shpjegohet si shkak i ekonomive të shkallëve që vijnë nga një kanal i "internet banking".
Sistemet e informacionit në Shqipëri[308]

Historik

Po bëjmë një renditje kronologjike të ecurisë së zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të informacionit në Shqipëri:

•Periudha e parë (1986)
-Themelimi i INIMA / INSTAT, institucionet e vetme që merreshin me mbledhjen e informacioneve nga e gjithë Shqipëria (hidroçentralet, nafta, etj..)si edhe perpunimin dhe studimin e tyre

•Periudha e dytë (1990)
-Krijimi i linjave të para të komunikimit të të dhënave me jashtë, kjo përsëri njëiniciativë e INIMA, duke krijuar edhe sistemin e parë email në Shqipëri.

• Periudha e tretë (1992 – 1996)
-Shtimi i përdorimit të kompjuterave në administratën shtetërore
-Mungesa e tyre në bizneset shqiptare

•Periudha e katërt(1998 – 2000)
-Fillimi i përdorimit të kompjuterave nga bizneset shqiptare
-Themelimi i kompanive si IMB, Infosoft, Datech, CCS etj, gjenerata e parë ekompanive në sektorin e teknologjisë së informacionit

• Periudha aktuale(2000 – aktualisht)
-Zgjerimi i përdorimit të sistemeve të informacionit nga bizneset shqiptare
-Shtimi i numrit të firmave që krijojnë e tregëtojnë software dhe i atyre që ofrojnë hardware
-Gjithashtu në këtë kohë shihet një bum i softwarëve të importuar nga jashtë,dhe që tashmë përdoren në të gjitha kompjuterat që ndodhen në bizneset e ndryshme dhe në përdoruesit e thjeshtë.

Zhvillimet e mësiperme kanë ardhur edhe si rezultat i zhvillimeve socio-ekonomike të mëposhtme:
•Rritja e numrit të bizneseve dhe e konkurrencës
•Rritja e bashkëpunimit dhe e konkurrencës me firmat e huaja
•Fokusimi i bizneseve tek cilësia e produkteve apo shërbimeve që ofrojnë
•Rritja e numrit te specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencavekompjuterike, elektronikës etj.
•Ndryshimi i strukturës organizative të bizneseve duke patur tashmë një departament të vecantë për teknologjinë e informacionit (IT) Aktualisht më pak se 25% e bizneseve shqiptare përdorin sisteme informacioni të bazuara në kompjuter. Bizneset e mëdha janë pothuaj të vetmet që e perdorin teknologjinë e informacionit në menyrë eficiente.

Pse ndodh kështu?
•Mungesa e njohurive të përgjithshme dhe të sakta rreth fushës së teknologjisë sëinformacionit
•Mospërshtatja e stafit me zhvillimet e reja të teknologjisë së informacionit
•Kostot fillestare të larta të aplikimit të saj
•Mosbesimi në teknologjinë e informacionit
• Kushtet që ekzistojnë në Shqipëri. Këto e kanë bërë më të vështire mbijetesën e bizneseve në një treg që gjithmonë e më tepër bëhet më konkurrues. Kjo i ka ndërlikuar të gjitha proceset e biznesit që mund të jenë: prodhimi, shitja, menaxhimi dhe sidomos mbajtja e regjistrimit të ecurisë se biznesit, pra kontabilitetit. Për këtë arsye është e nevojshme që drejtuesit e kompanive të marrin njohuritë e

[308] Igli Hakrama, Erjon Zoto Ekonomiksi_i_shoqërisë_së_informacionit, 31 Maj 2009

nevojshme rreth zhvillimeve të fundit dhe mundësine e aplikimeve të teknologjisë së informacionit në kompanitë e tyre. Ekziston vërtet vështirësia fillestare e aplikimit të saj,sidomos për bizneset e vogla e të mesme, që lidhet me kostot e larta fillestare, përshtatja optimale me aktivitetet e biznesit, përshtatja e stafit me menyrën e re të kryerjes së punës dhe përshtatja me zhvillimet e vrullshme në teknologjinë e informacionit.Nje faktor tjetër i rëndësishëm janë edhe kushtet në të cilat do të përdoren pajisjet teknologjike, si p.sh. energjia elektrike që, në gjendjen aktuale ku ndodhet Shqipëria, nuk lejojnë shfrytëzimin maksimal dhe zhvillimin e teknologjisë së informacionit.

Ndikimi i Teknologjise së Informacionit në Sistemin Bankar në Shqipëri

Zhvillimet e fundit teknologjike në botë, kanë ndikuar edhe në Shqipëri duke prekur padyshim edhe Sistemin Bankar309. Aplikimet e kësaj teknologjie i ndien edhe një klient i zakonshëm, i cili kryen një veprim fare të thjeshtë pranë çdo sporteli të cilësdo prej bankave që veprojnë në tregun shqiptar. Aplikimi i Teknologjisë së Informacionit në bankë ka një ndikim dhe përparësi të padiskutueshme në të gjitha proceset si në vendimmarrje, në prodhim, në vjelje dhe në kontroll të informacionit, në rritjen e efektivitetit të operacioneve, në rritjen e cilësisë së shërbimit te klientët e saj si dhe në rritjen e kontrollit mbi të gjitha aktivitetet. Roli i Tekonologjisë së Informacionit është një pozicion qendror për institucionin, aktiviteti i të cilit është përgjithësisht i orientuar rreth informacionit. Teknologjia e Informacionit po shndërrohet në mënyrë të shpejtë në një mjet komunikimi dhe integrimi midis funksioneve të brendshme të institucionit, ndërkohë që burimet e brendshme po përshtaten për të mundësuar rritje të infrastrukturës teknologjike.

Përdorimi IT-së (Information Technology-Teknologjia e Informacionit), përgjithësisht referuar kompjuterave dhe pajisjeve periferike infokomunikuese, është sot mëse i domosdoshëm dhe mjaft efektiv në ofrimin e produkteve të reja bankare. Interneti (internet banking), pagesat elektronike, shkëmbimet në tregjet financiare, falë IT-së janë ndër produktet 'hi-tech' që një bankë ofron sot në mbarë botën.

Në përgjithësi studimet e kryera nxjerrin përfundimin në dy efekte pozitive për marrëdhënien ndërmjet produktivitetit bankar dhe IT-së. E para është se IT redukton kostot operacionale të një banke (faturat e paguara 'online') duke krijuar transaksione standarde me vlerë të ulët. Kjo bën që bankat të përqendrohen në transaksione të specializuara me vlerë më të lartë në shërbim të një ndryshimi të ndjeshëm në ekonomi (investment banking). E dyta, falë IT-së thjeshtohen shërbimet e transaksioneve ndaj klientëve kudo që të jenë. Për të kuptuar këtë mjafton të përmendim shërbimin e ATM-ve (automated teller machines). ATM-të janë të shpërndara gjeografikisht në hapësira të mëdha, madje kudo në botë gjendet një rrjet ATM që u mundëson klientëve aksesin në llogarinë e tyre. Por jo vetëm kaq, shërbimi ATM-ve ofron mundësi të ndryshme pagesash dhe transaksionesh, megjithëse për bankat në Shqipëri mbetet vetëm tërheqja 'cash' e parave.310

IT në sistemin bankar në Shqipëri

IT në sistemin bankar në Shqipëri u mundëson bankave të kryejnë një shërbim në një nivel deri diku të pëlqyeshëm. Mbetet shumë për të bërë sidomos lidhur me trajnimin dhe kualifikimin që duhet t'i bëjnë bankat personelit të tyre në përdorimin e teknologjive të reja që zbatojnë. Ndërmjarrja e këtyre kualifikimeve duhet të bëhet nga departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Është e rëndësishme të theksohet se në Shqipëri, departamente të tilla në sektorin bankar jo gjithmonë e mundësojnë këtë. Si rezultat kjo sjell shpeshherë ulje të produktivitetit dhe shërbime jocilësore ndaj klientëve, duke hasur thuajse gjithmonë në vonesa apo radhë të gjata për veprime fare të thjeshta në sportelet e një banke.
Industria bankare, krahasuar me industri si ajo agrikulturore apo të tjera, ofron një diversitet të lartë në fushën e shërbimeve ndaj klientëve. është e rëndësishme të kuptohet së çfarë arritje ka përdorimi sa më i mirë i teknologjive të reja dhe se si ndikon IT në reduktimin e kostove të një banke.

[309] http://www.monitor.al/teknologjia-e-informacionit-banka-me-nje-te-klikuar-4558/#
[310] http://www.monitor.al/teknologjia-e-informacionit-banka-me-nje-te-klikuar-4558/#

Për bankat, individualisht, përshtatja e IT-së ka dy efekte, reduktimi i kostove operacionale dhe krijimi i efektit të rrjetit në shërbimin ndaj klientit. Dhe është e sigurtë që efektet janë pozitive. Por nëse të gjitha bankat në industri kanë të njëjtin akses në teknologjinë e ruajtjes dhe menaxhimit sa më të mirë të kostove, a do të zhdukë kjo kostot operacionale, në veçanti konkurrencën e çmimeve në industrinë bankarer A do të sjellë prania e një rrjeti të gjerë përfitime për secilën bankë? Përdorimi i IT-së i drejton bankat në një ulje të kostove, por efekti në përfitim mbetet jovendimtar për shkak të efektit të mundësive të zhvillimit të rrjetit që varet nga konkurrenca në shërbimet financiare. Shpikjet në fushën e teknologjisë së informacionit, globalizimi dhe tregu i lirë në industrinë bankare mund të ulin rrjedhën e të ardhurave të bankave dhe në këtë mënyrë ndikon në dinamikën e industrisë bankare.

Sistemi i Informacionit ne Banken e Shqipërisë311

Në përpjekje për të ndërtuar portretin e një banke qendrore moderne, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, ka realizuar një zhvillim të dukshëm në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Ky zhvillim konsiston në zgjerimin e sistemeve të informacionit, rikonceptimin e sistemit të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, zgjerimin e burimeve njerëzore si dhe zhvillimin profesional të tyre.

Departamenti i teknologjisë së informacionit është përgjegjës për mirëmbajtjen e infrastrukturës informatike të Bankës së Shqipërisë, për organizimin, drejtimin, realizimin dhe zhvillimin e projekteve informatike si dhe për përmirësimin e aplikimeve informatike bankare, në bashkëpunim me departamentet e tjera. Gjatë kësaj periudhe, ky departament ka realizuar me sukses një sërë projektesh si dhe ka përmirësuar më tej shumë sisteme informatike dhe aplikime bankare. Disa nga këto arritje kanë të bëjnë me:

1) vënien në funksionim të një numri të madh sistemesh specifike;
2) krijimin e një infrastrukture të brendshme, të mbështetur nga fjala e fundit e teknologjisë;
3) krijimin dhe zgjerimin, në mënyrë të vazhdueshme, të komunikimit elektronik bazuar në teknologjinë e postës elektronike (e-mail), "internet" si dhe krijimin dhe zhvillimin e faqes WEB të Bankës;
4) implementimin e sistemit të menaxhimit të tregtimit dhe kontabilitetit – ATM;
5) implementimin e sistemit ndërbankar të shlyerjes së pagesave bruto në kohë reale – AIPS;
6) implementimin e sistemit ndërbankar të kryqëzimit të pagesave të vogla – AECH;
7) zgjerimin dhe shtimin e sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes së brendshme të informacionit;
8) implementimin e sistemit të sigurisë fizike dhe elektronike të ambienteve të teknologjisë së informacionit.

Sot, teknologjia e informacionit nuk konsiderohet më vetëm si mjet ndihmës në automatizimin e proceseve, por si ofrues shërbimesh dhe instrumentesh të reja, manualisht të pazëvendësueshme. Në këtë fokus, disa nga zhvillimet e teknologjisë në Bankën e Shqipërisë, për një periudhë afatshkurtër deri afatmesme, do të synojnë në:
• aplikimin gjerësisht, të standardeve ndërkombëtare të sigurisë së informacionit;
• zgjerimin dhe shtrirjen e infrastrukturës së komunikimit në degët e Bankës në rrethe, në ambientet e reja dhe lidhjen me ministrinë e financave;
• automatizimin e operacioneve, të cilat janë pjesërisht apo totalisht manuale.
Gjatë viteve të fundit, Banka e Shqipërisë ka realizuar një shndërrim të madh lidhur me çështjet e teknologjisë së informacionit. Ky shndërrim konsiston si në zgjerimin e sistemeve të informacionit, rikonceptimin e sistemit të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, zgjerimin e burimeve njerëzore si dhe në zhvillimin e organizimit të tyre. Gjatë kësaj periudhe janë: (1) futur në funksionim një numër i mash sistemesh specifike (2) është krijuar një infrastrukturë e brendshme e mbështetur nga fjala e fundit e teknologjisë, (3) është krijuar dhe zgjeruar në mënyrë të vazhdueshme komunikimi elektronik bazuar në teknologjinë e postës elektronike (e- mail), "Internet" si dhe është krijuar dhe

311 Banka e Shqiperise: Sistemi I informacionit ne Banken e Shqiperise

zhvillluar faqja WEB e Bankës se Shqipërisë; (4) është implementuar sistemi ATM dhe janë; (5) zgjeruar dhe rritur sistemet e sigurisë dhe të mbrojtjes së brendshme të informacionit.
Aktualisht, numri i kompjuterave personalë dhe përdoruesve të tyre, në vitet e fundit është rritur me 3 herë, numri punonjësve dhe i specialistëve të Teknologjisë së Informacionit është rritur 2.5 herë, numri i sistemeve është rritur me 10 herë, ndërkohë që investime të ngjashme janë kryer në infrastrukturën teknike.
Për të përballuar ritmet e rritjes dhe për të garantuar uljen dhe minimizimin e rreziqeve që lidhen me të, janë ndërmarrë një sërë masash. Si të tilla mund të përmendim: (1) miratimin e "Politikës së sigurisë së informacionit", (2) krijimin e Komitetit të Strategjisë së TI, (3) krijimin, brenda strukturës organizative të departamentit të pozicionit të "Administratorit të Projekteve", (4) krijimin e "Zyrës së Kontrollit dhe Sigurisë".

Konkluzione

⇨ Banka e Shqipërisë është një institucion qendror dhe pa qëllim fitimi, me detyrat e saj kryesore të përcaktuara në ligj.
⇨ Pozicioni qendror e vendos atë larg konkurrencës direkte, por megjithatë, nevojat e saj të zhvillimit kanë në bazë realizimin me eficiencë e efektivitet të detyrave ligjore, mbështetjen dhe mundësimin e vazhdueshëm të rritjes së sistemit bankar në Shqipëri.
⇨ Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë kërkon të mbërrijë vizionin e mëposhtëm në fushën e Tekonologjisë së Informacionit:
⇨ "Tekonologjia e Informacionit do të mundësojë komunikimin e personelit, të klientëve dhe të publikut të Bankës së Shqipërisë, në çdo kohë, me mjetet dhe me informacionet e brendshme në mënyrë eficiente, të besueshme, të sigurtë."
⇨ Për të kryer si duhet funksionet e saj, ajo mbështetet në informacionin statistikor.
⇨ Lidhjet e ngushta të bankës qendrore me sistemin financiar si dhe futja e saj në detajet e agregatëve të parasë dhe të kredisë, e bëjnë atë të ketë përparësi në drejtimin e përpilimit dhe të botimit të këtyre të dhënave.
⇨ Banka qendrore mund të dërgojë të dhëna të nevojshme për llogaritë kombëtare ose statistika të tjera, në zyrat kombëtare të statistikave.
⇨ Në Bankën e Shqipërisë, bazuar në funksionet e saj si bankë qendrore, funksionojnë disa njësi që realizojnë përcaktimin e metodologjive si dhe punën konkrete për grumbullimin, kompilimin dhe shpërndarjen.

Bibliografia

Igli Hakrama, Erjon Zoto Ekonomiksi_i_shoqërisë_së_informacionit, 31 Maj 2009
Sistemi I informacionit ne Banken e Shqiperise
http://www.academia.edu/
http://www.monitor.al/teknologjia-e-informacionit-banka-me-nje-te-klikuar

YLVIJE BORIÇI – FONDET E INVESTIMEVE NE TREGUN FINANCIAR

YLVIJE BORIÇI
Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Abstrakti

Fondet e investimeve jane fonde qe institucionet financiare te specializuara grumbullojne nga investitoret e vegjel individuale, te cilet u besojne kursimet e tyre me shprese te nje rentabiliteti me te larte se format e tjera te investimit.
Fondi i pare i mirefillte u krijua ne vitin 1822 ne Belgjike pastaj ne SHBA rreth fundit te shek XIX. Te gjitha kompanite investuese te fillii ishin me fund te mbyllur. Me tu shitur aksionet e tyre njehere, nuk kishin ndonje fond te parashikuar si provizion per compensi, qe njihen ndryshe si fonde reciproke.

Fondet e investimeve drejtohen nga kompani professionale, drejtimi te cilat rregullon sherbimin e sistemit te regjistrimit te nevojshem per fondet dhe mbikqyr vendimet e drejtimit te portofolit.
Keto kompani drejtimi marrin nje kuote per sherbimet e drejtimit te portofolit te tyre. Fondet moderne u krijuan ne Massachusetts SHBA ne vitin 1928, vit ne te cilin keto fonde u bene publike (me fund te hapur). Keto investime arrijne te konkurrojne llojet e tjera te investimit sepse per te njejtin nivel risku ofrojne kthime me te larta. Investimet individuale jane me pak te pelqyeshme sepse kostoja e informacionit dhe komisionet qe ata duhet te paguajne jane relativisht te larta ndersa, ndersa investimi ne fond ofron nje ekspertize me te gjere dhe kosto me te ulet dhe eshte likuid. Cdo fond investimesh ne nje numer njesish te barabarta qe mund te quhet edhe numri i njesive ose numri i aksioneve te fondit te investimeve. Cmimi i seciles prej ketyre njesive varet nga cmimi i letrave me vlere ku eshte investuar fondi.

Kuptimi i fondit te investimeve

Fondet e investimit jane shume te rendesishem per zhvillimin e ekonomise dhe shoqerise sepse individe apo institucione te ndryshem investojne ne fond duke filluar nga te gjitha lehtesirat qe ofron ky fond qe lidhen me informacionin e bollshem, ekspertizen financiare dhe mund te investohet edhe me nje shume relativisht te vogel.

-Ato investojne ne portofole te mirediversifikuara, ne portofole asetesh
-Ato emetojne letra me vlere te vlerave nominale te shumellojshme dhe njekohesisht te tregtueshme.

Nga pikepamja e afatit te investimit te mjeteve, fondet e investimeve ndahen ne fonde te investimeve afatshkurter, te cilat kryejne investime ne letrat me vlere me afat me te vogel se nje vit, qe tregtohen ne tregun monetar dhe ne fonde te investimeve afatgjate qe kryejne investime ne letrat me vlere me afat me te gjate mbi nje vit ne tregun e kapitaleve. Dy investimet kryesore qe behen ne nje fond te tille jane zakonisht, investimi ne aksione dhe obligacione.

Fondet e investimeve kane marre nje zhvillim shume te gjere, ne vendet ish-socialiste keto fonde u zhvilluan per te privatizuar sektore te ndryshem te ekonomise.
Ne Shqiperi pas viteve 90 u krijua fondi Anglo-Adriatica i cili mblodhi bono privatizimi dhe synoi te merrte pjese ne privatizimin e sektoreve strategjike. Ky institucion eshte i specializuar per huadhenie afatgjate.

Fondet e investimeve jane institucione financiare, qe i sigurojne fondet nga nje numer i madh invetitoresh te cileve ne kembim u jepen aksionet e fondit. Nga ana tjeter kompania i investon keto

fonde te grumbulluara me qellim qe te arrije nivele te larta fitimi qe tu japе fitime invesitoreve dhe te siguroje fitimin e saj. Por edhe investimi ne fond nuk eshte pa risk sepse ne baze te ecurise se letres me vlere te cilen je posedues i saj nepermjet fondit, do te varet edhe fitimi nga kjo leter me vlere. Kjo varet edhe nga risku qe eshte i gatshem te marre persiper investitori. Risku leviz ne menyre te drejte me fitimin.

Çdo investitor mund te fitoje nga investimi ne fond ne tre menyra:

Fondi i investimeve mund te siguroje te ardhura ne formen e dividenteve dhe interesave nga letrat me vlere qe zoteron. Keto te ardhura u shperndahen investitoreve ne menyre te vazhdueshme, ne formen e dividenteve per kuotat qe ata zoterojne.
Cmimet e letrave me vlere qe zoterohen nga fondi mund te rriten. Kur nje fond shet nje leter me vlere, cmimi i se ciles eshte rritur, ai siguron nje te ardhur kapitali. Shumica e fondeve shperndajne kete te ardhur per investitoret ne fund te vitit.
Ne qofte se fondi nuk i shet, por i mban letrat me vlere, cmimi i te cilave eshte rritur, vlera e kuotave te fondit rritet. Rritja e vleres se kuotave do te thote nje vlere me e larte e investimit te investitoreve. Ne qofte se dikush shet kuotat, ai do te siguroje nje vlere me te larte ne krahasim me investimin e tij fillestar.

Fondi i investimeve i jep investitorit mundesi te zgjedhe: ose te marre dividentet dhe te ardhurat e tjera, ose t'i riinvestoje ato perseri ne fond duke blere kuota shtese.

Vlera e fondit varet nga llojshmeria e letrave me vlere qe ka fondi ne posedim dhe huaja e akumuluar:
Vlera e tregut te letrave me vlere ku eshte investuar – borxhet e fondit
Numri i pergjithshem i njesive te fondit.

Llojet e fondeve te investimeve

Fondet me fund te hapur, njihen edhe si fonde reciproke. Jane tipi me I perhapur I fondeve te investimeve. Keto fonde rrine te gatshme ne cdo kohe qe e blejne ose te shesin arsione e veta ne treg me cmimin e tregut ne cdo moment.
Fondet me fund te mbyllur, formohen me nje numer fiks aksionesh. Kapitali I krijuar ne fillim nuk mund te rritet pa marre me pare mirarimin e Asamblese se Pergjitshme te aksionereve. Pra investitoret e ketyre fondeve nuk mund ti shesin lehtesisht aksionet e tyre.
Fonde me ritme te shpejta rritjeje, keto jane fonde investimesh te cilat investohen zakonisht ne aksione qe mund te sigurojne norma te larta fitimi por qe mbartin dhe rreziqe te medha.
Fonde investimesh te ekuilibruara, ne keto fonde ekziston nje strukture e ekuilibruar e investimeve ne letrat me vlerete perbera nga aksione, obligacione dhe lloje te tjera letrash me vlere
Fonde investimesh te tregut monetar, keto fonde investohen vetem ne letra me vlere te tregut monetar te cilat nuk kane ndonje risk te larte, jene me afat te shkurter dhe kane rentabilitet relativisht te vogel.
Fonde investimesh te obligacioneve, keto fonde investohen ne lloje te ndryshme te obligacioneve, jane investime afatgjata, me rentabilitet me te larte por me nje nivel me te larte risku. Keto ndryshojne edhe sipas tipit te obligacioneve.
Fonde investimesh te specializuara, te cilat investohen ne aksione dhe obligacione te njesive ekonomike te nje dege te caktuar ekonomike ose te nje rajoni te caktuar te botes.
Fonde investimesh te indeksit, keto fonde nuk investohen ne ndonje leter me vlere por investohen ne vleren e indeksit te nje burse te caktuar, luhatja e te cilit varet nga luhatja e cmimeve te te gjitha letrave me vlere qe kuotohen ne kete burse.
Fonde investimesh ombrelle, keto fonde investohen ne fonde te tjera investimesh shume me te medha se vetja e tyre dhe prandaj u sherbejne si ombrelle mbrojtjeje.

Struktura e fondeve te investimeve

Zakonisht, nje fond investimi nuk eshte nje shoqeri aksionere, pra korporate. Por, si dhe ne rastin e cdo korporate, pasuria e fondit i perket investitoreve, te cilet gezojne te gjitha perfitimet. Ne ndryshim

nga shoqerite aksionere, te gjitha fondet e investimeve administrohen ne emer e per llogari te tyre nga shoqerite administruese.

Themeluesi.
Fondi i investimeve krijohet si shoqeri anonime. Keto shoqeri anonime (aksionere) mund te krijohen ne baze te nismes se lire te personave te ndryshem juridike, ose me nismen e shtetit. Ne rastin e pare fondi i investimeve krijohet nga grumbullimi i kontributeve ne para te personave te ndryshem me nje kapital themelimi mbi 20000$. Sot ligji nuk ka kufizime persa i perket numrit minimal te themeluesve te fondit te investimeve.

Kompania udheheqese.
Cdo fond investimi duhet te kete si udheheqes ne drejtimin e tij nje firme te licensuar, e cila shperblehet nga nje komision vjetor e bazuar kjo ne marreveshjen kontraktore. Ne ligj parashikohet se cdo fond investimi duhet te emeroje nje administrator I cili eshte nje subjekt jo I punesuar ne fond.

Depozituesi.
Kapitali i fondit te investimit duhet te jete i depozituar ne nje banke te nivelit te dyte ose ne nje institucion te ngjashem me te i cili ruan mjetet monetare dhe kryen te gjitha transaksionet monetare duke zvogeluar mundesine per abuzim.

Referenca

Elez Osmani “Tregje dhe Institucione Financiare”
Andreas Hess, Dr Arne Holzhausen,” The structure of European mortgage markets”2008, page 13-15
European Central Bank: Statistical Data Warehouse, http://sdw.ecb.europa.eu/
European Mortgage Federation: Website, http://www.hypo.org
Buletini i Bankës së Shqipërisë, www.bankofalbania.org
http://www.investopedia.com/articles/bonds/12/introduction-asset-backed-securities.asp
http://www.hypo.org/Content/Default.asp?PageID=524

FATBARDHA MOLLA, PETER SARACI, ELIDIANA BASHI – ANALIZA E RISKUT TE ASETEVE DHE DETYRIMEVE NE BIZNESET SHQIPTARE

FATBARDHA MOLLA
PETER SARACI
ELIDIANA BASHI

Departamenti Financë-Kontabilitet, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Abstrakti

Menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve (Asset Liabilities Management) mund të përkufizohet si një mekanizëm për të menaxhuar riskun me të cilin përballet një organizatë fitimprurëse për shkak të mospërputhjes midis aseteve dhe detyrimeve, për shkak të likuiditetit ose ndryshimeve në normat e interesit. ALM u përdor fillimisht nga institucionet financiare në vitet 1970, kur normat e interesit u bënë gjithnjë e më të paqëndrueshme. Kjo paqëndrueshmëri shfaqi efekte negative tek institucionet financiare.

Roli dhe veprimi i ALM-së mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një institucion financiar në tjetrin në varësi të modelit të biznesit të miratuar dhe mund të përfshijnë një zonë të gjerë të rreziqeve. Programet tradicionale ALM përqëndrohet në rrezikun e normës së interesit dhe të likuiditetit sepse ato paraqesin rrezikun më të madh që ndikojnë në bilancin e organizatës dhe kërkon koordinim midis aktiveve dhe pasiveve.
Por ALM e ka zgjeruar spektrin e saj të menaxhimit të riskut edhe përsa i përket menaxhimit të riskut të kapitalit dhe të riskut të këmbimit valutor.

Janë marrë për studim 10 kompani të ndryshme në mënyrë rastësore të Qarkut të Lezhës ku, kompanitë kanë tendencën që të financohen më shumë me detyrime sesa me kapital aksioner. Kthimet nga aktivet për kompanitë e marra në studim është relativisht i ulët. Sic shikohet edhe nga të dhënat kompanitë e marra për studim nuk i kanë problemet tek kthimet nga shitjet por problemet mund të qëndrojnë tek struktura e kapitalit dhe analiza paguese e kompanive. Nuk ekziston në fakt një strukturë financiare gjithmonë e vlefshme ashtu sic nuk ekziston nje strukture financiare e vlefshme për periudha të gjata. Një nga gabimet që bëjnë kompanitë është të financosh mjetet afatgjata me detyrime afatshkurtra. Ky gabim sjell rëndim të situatës në strukturën e kapitalit dhe sjell një ulje të aftësisë paguese të firmës.

Pra risqet duhen studiuar dhe manaxhuar dhe një nga metodat bashkëkohore që e bën një gjë të tillë është metoda e manaxhimit të aktiveve dhe detyrimeve ALM. Risqet kryesore që në mënyrë tipike menaxhohen nga ALM janë risku i likuiditetit, risku i normave të interesit dhe risku i monedhës.

Fjalet Kyce: Kthimi, Risku Financiar, Struktura E Kapitalit

Procesi i ALM-së

Proçesi i ALM kalon në nivele të caktuara dhe finalizohet me përcaktimin e parametrave të riskut. Ato janë:
1. Politikat e riskut që ndjek organizata dhe niveli i tolerancës ndaj riskut.
2. Menaxhimi i riskut
3. Matja e riskut
4. Identifikimi i riskut ose risqeve kryesore që ndikojnë mbi organizatën
5. Përcaktimi i parametrave të riskut

Nga ana konceptuale, politikat e ALM fokusohen në përfitueshmërine dhe qëndrueshmërinë afatgjatë dhe lidhet me tre kritere kyesore: marzhin neto të interesit (Net Interes Margin), të ardhurat neto nga interesi (Net Interes Income) dhe vlerën neto ekonomike (Net Economic Value), si kritere që kufizojnë pasqyrën financiare të bilancit.
E parë në një këndvështrim më të thellë, ALM është një teknikë e koordinimit të pjesëve përbërëse të pasqyrës së bilancit dhe menaxhimi i portofolit dhe jo menaxhim pjesë-pjesë i zërave të bilancit.
Përgjegjësia për ALM është e ndarë shpesh në mes të thesarit dhe CFO (Chief Financial Officer). Në organizatat më të vogla, procesi ALM mund të trajtohen nga një ose dy persona kyç (Shefit Ekzekutiv CEO, CFO ose thesarit).

Shumica dërrmuese e bankave vepron me një model të centralizuar ALM i cili mundëson mbikëqyrjen e konsoliduar të bilancit me njësi të nivelit më të ulët duke u përqëndruar në njësitë e biznesit ose personave juridik.
Ajo ka për qëllim kryesor arritjen e qëllimeve të përcaktuara në planet afatshkurtra dhe afatgjata strategjike si psh:
• Të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm dhe koordinimin e të ardhurave nga interesi me shpenzimet e interesit
• Të hartojë dhe miratojë një plan emergjence
• Të shqyrtojë dhe miratojë politikën e likuiditetit dhe fondet e menaxhimit
• Përshtatja e politikave të fondeve me nevojat dhe burimet psh, miksi i detyrimeve kundrejt miksit të aseteve (ose shitjes së aseteve), fondet me norma fikse kundrejt fondeve me norma të ndryshueshme, financimi në tregun e parasë kundrejt financimit në tregun e kapitalit, fonde në valutë vendase kundrejt fondeve në valutë të huaj, etj.
Përsa i përket anës legjislative në lidhje me ALM, shumica e bankave globale kanë benchmark-et e tyre në bazë të udhezimeve të Komitetit të Bazelit për Mbikqyrjen Bankare “Parimet për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut të normës së interesit "(BCBS).
Risqet tipike të cilat menaxhohen nëpërmjet mekanizmit të ALM-së janë risku i likuiditetit, risku i normave të interesit dhe risku i monedhës. Megjithatë, ALM e ka shtrirë funksionin e saj edhe në fusha të tjera.

1. Risku i likuiditetit: risku aktual dhe risku i ardhshëm që rrjedh nga paaftësia e bankës për të shlyer detyrimet e saj kur ato maturohen duke cënuar kushtet financiare te bankës. Në prespektivën e AML – së, fokusi është në minimizimin e riskut të likuiditetit të bankës që do të thotë në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e saj aktuale dhe të ardhshme të rrjedhave të mjeteve monetare dhe të nevojave për kolateral, te dyja si të pritura dhe të papritura. Ky mision kështu përfshin përcaktimin e një benchmark-u të likuiditetit të bankës në treg.

2. Risku i normave te interesit: risku i humbjes që vjen si rezultat i lëvizjeve në normat e interesit dhe impakti i tyre në flukset e ardhshme të parave. Në përgjithësi kjo mund të ndodh për shkak se një bankë mund të ketë një sasi disproporcionale të normave fikse ose të ndryshueshme në të dyja anët e bilancit. Një nga shkaqet kryesore janë mospërputhjet në drejtim të depozitave bankare dhe kredive.

3. Menaxhimi i rrezikut të monedhës: rreziku i humbjeve që rrjedhin nga lëvizjet në normat e shkëmbimeve në rastet kur zërat në aktiv dhe pasiv janë të shprehura në monedha të ndryshme ose kur flukset e pritshme të parave janë të shprehura në monedha të ndryshme.

4. Financimi dhe menaxhimi i kapitalit: për të siguruar ruajtjen e kapitalit të mjaftueshëm në mënyrë të vazhdueshme. Eshtë një proces dinamik dhe në vazhdim duke pasur parasysh nevojat në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë të kapitalit dhe është i koordinuar me strategjinë dhe ciklin e planifikimit të përgjithshëm të bankës (zakonisht një prespektivë kohore 2 vjet) dhe planifikimet për rritje.

5. Menaxhimi i riskut të kredisë: menaxhimi i gjithë portofolit të kredisë (duke përfshirë para të gatshme, investimet dhe kreditë) në bilanc.

6. Si përfundim, funksionimi i ALM-së mbulon komponentë që kanë të bëjnë me realizimin dhe monitorimin rregullave të brendshme në përputhje më kushtet dhe rregulloret e jashtme duke synuar optimizimin e pozitës së bilancit të organizatës dhe duke ndërhyrë kështu në aktivite aktuale të saj.

Sot, teknikat ALM janë zgjeruar dhe adoptuar nga korporatat dhe nga institucionet financiare të tjera përvec bankave dhe kompanive të sigurimit.

Teknikat e ALM-së

ALM si një mekanizëm i mbrojtjes nga risku, ofron mundësi për rritjen e vlerës neto. Tre janë konceptet kyesore që janë bazë për ushtrimin e teknikave të saj:
Të ardhurat neto nga interesi (NII)
Marzhi neto i interesit (NIM)
Vlera ekonomike

Net Interes Margin = (Të ardhurat nga interesi – Shpenzimet e Interesit) / Asete fitimprurëse

Prespektiva e vlerës ekonomike:

Ndryshueshmëria në treg e normave të interest ndikon edhe vlerën e tregut të aseteve, detyrimeve dhe pozicionit jashtë bilancit (Off Balance Sheet) të një banke. Prekpektiva e vlerës ekonomike konsideron efektin potencial të ndryshimit të normave të interest në vlerën prezente të të gjitha flukseve të ardhme të pritura.

Modeli GAP dhe ndjeshmëria e normave të interesit

Ky model mat shtrirjen e aseteve afatshkurtër dhe pasiveve afatshkurtër për shkak të mospërputhjes në maturim (ose metoda GAP). Aktivet dhe detyrimet janë të grupuara në klasa të caktura për sa i përket maturimit. Sipas metodës GAP për cdo klasë përcaktohet ndjeshmëria e normës së interesit për asetet (Rate Sensitive Assets) dhe ndjeshmëria e normës së interest për detyrimet (Rate Sensitive Liabilities) Nga ana matematikore ky model paraqitet:

GAP = RSAs – RSLs

Një GAP zero tregon se banka është e mbrojtur plotësisht nga rritjet dhe uljet në normat e interesit dhe NII nuk do të ndryshojë në të dy rastet. Dhe për rrjedhojë kjo do të ishte edhe zgjidhja më e mirë për një bankë.
Analiza baze e GAP-it kalon në një analizë më të thelluar ose në analizën e standartizuar të GAP-it e cila konsiston në analizën e shkallëve të ndryshmë të ndjeshmërisë ndaj normës së interesit për aktivë dhe pasivë me ndjeshmëri të ndryshme ndaj normës së interesit.

Cila janë alternativat e mundshme për të minimizuar riskun e normave të interesit (IRR)?Vlersërimi i riskut ka karakter subjektiv dhe varet edhe nga parashikimi që mund të bëjme duke ndikuar kështu edhe në marrjen e vendimit. Nëse sipas parashikimeve normat e interesit në të ardhmen do të ulen, nuk është e nevojshme për të ndërmarrë ndonjë veprim sepse rënia e normave të interesit është në favor të bankës. Në të kundërt duhen gjetur mënyra për të minimizuar riskun dhe efektet negative të ngjarjes.Parimisht dy janë alternativat:

1. Ulja e kohëzgjatjes së aktivit bankar (DUR asset duke rritur të ardhurat nga interesi dhe aktivi banker në këtë rast është më i ndjeshëm ndaj luhatjeve të normave të interesit.
2. Rritja e kohëzgjatjes së pasivit bankar (DUR liabilities) duke shtyrë kështu pagesën e interesave të detyrimeve.
VaR është një analizë e simulimit e cila i referohet humbjeve maksimale që një bankë ose institucion financiar mund të ketë në vlerë tregu ose në fitime:

Në një periudhë të caktuar kohe të dhënë
Mbi disa kushte tregu të dhëna
Në një nivel sigurie të caktuar

Pra analiza VaR bën të mundur llogaritjen e vlerës neto të organizatës në një kohë të caktuar dhe mundëson menaxherët të fokusohen në implikimin e vendimeve afatgjata në lidhje me riskun që janë marrë ose mendohet të merren në të ardhmen.
Përvec këtyre teknikave bazë përdoren edhe instrumentet derivative që ofrojnë tregjet financiare të cilat kombinohen me procesin dhe fazat e ndryshme të ALM-së.

Aftesia Paguese

Ndërmjet nivelit të përfitueshmërisë së aktivitetit të njësisë ekomomike dhe aftësisë së saj paguese ekziston një lidhje dhe ndërvarësi e rëndësishme, por ato nuk janë nocione identike. Për periudha afatgjata, aftësia paguese varet shumë nga niveli i përfitueshmërisë së aktivitetit të zhvilluar, sepse pa një aktivitet rentable asnjë njësi ekonomike nuk mund të sigurojë shumën e duhur të arketimeve per mbulimin e shpenzimeve të bëra dhe shlyerjen e huadhënësve ndaj njësisë ekonomike huamarrëse.
Nëqoftëse huadhënësit shohin se njësia ekonomike huamarrëse nuk ka madhësine e kënaqshme të kapitalit të vet për të siguruar në të gjitha rastet kthimin e kapitaleve te marra hua, atëherë ata nuk do të pranojnë që ti japin njësisë ekonomike hua të reja.Por, nëqoftëse kjo njësi nuk do të garantoje shlyerjen në kohë të interesave dhe të kësteve të huase, atëherë do të ndërpresin huadhënien ndaj kësaj njësie ekonomike.

Aftësia paguese e njësisë ekonomike,shkalla e likuiditetit të aktiveve të saj dhe niveli i përfitueshmërisë së aktivitetit që ajo zhvillon përcaktojnë në një masë të gjerë mbijetesën dhe ecurinë e njësisë ekonomike. Aftësia paguese e një njësie ekonomike përfaqëson aftësinë e saj për të përballuar shlyerjen në kohë të detyrimeve të veta afatshkurtra.
Në këtë rast duhet theksuar se përballimi i detyrimeve afatshkurtra të njësisë ekonomike konsiderohet se është bërë normalisht, nëqoftëse të gjtha aktivet e nevojshme për këtë qëllim janë siguruar nëpërmjet gjendjes së lëvizjes normale të aktiveve qarkulluese dhe të aktiveve të tjera që mund të kthehen me lehtësi në likuiditete, ose nëpërmjet burimeve suplementare afatshkurtra, pa marrjen e huave të paleverdishme e pa përmbysjen e programit të saj afatgjatë të zhvillimit.
Risku bazë para të cilit ndodhet njësia me një levë të konsiderueshme financiare, apo me strukturë të kombinuartë kapitalit në favor të buriimeve të huajtura është risku I gjendjes së pamjaftueshme të likuiditeteve.

Borxhi përfaqëson një angazhim për të paguar shpenzimet fikse në formën e interesave dhe të pagimit të principalit.Ndërsa, disa shpenzime fikse mund të shtyhen në kohë kur ka mungesë likuiditetesh, shpenzimet fikse lidhur me borxhin nuk mund të shtyhen pa patur kundërshtim me aksionerët dhe kreditorët e njësisë ekonomike.
Një njësi e tillë me shumë burime të huajtura përballet me riskun e humbjes së fleksibilitetit të financimit. Aftësia e njësisë ekonomike për të gjeturfondet e nevojshme dëmtohet kur ajo ka një levë financiare të lartë në favor të fondeve të huajtura, veçanarisht në periudha kur kushtet e tregut nuk janë të përshtatshme.

Gjendja e parasë për të përballuar bor ekonomike që ka përdorur levën financiare xhin është me rëndësi për një njësi duke marrë borxh. Risku bazë para të cilit ndodhet njësia me një levë të konsiderueshme financiare, apo me strukturë të kombinuartë kapitalit në favor të buriimeve të huajtura është risku I gjendjes së pamjaftueshme të likuiditeteve.
Borxhi përfaqëson një angazhim për të paguar shpenzimet fikse në formën e interesave dhe të pagimit të principalit.Ndërsa, disa shpenzime fikse mund të shtyhen në kohë kur ka mungesë likuiditetesh, shpenzimet fikse lidhur me borxhin nuk mund të shtyhen pa patur kundërshtim me aksionerët dhe kreditorët e njësisë ekonomike.
Një njësi e tillë me shumë burime të huajtura përballet me riskun e humbjes së fleksibilitetit të financimit. Aftësia e njësisë ekonomike për të gjeturfondet e nevojshme dëmtohet kur ajo ka një levë

financiare të lartë në favor të fondeve të huajtura, veçanarisht në periudha kur kushtet e tregut nuk janë të përshtatshme.
Gjendja e parasë për të përballuar bor ekonomike që ka përdorur levën financiare xhin është me rëndësi për një njësi duke marrë borxh. Njësia ekonomike mund të vazhdojë që të punojë me kapital hua vetëm nëqoftëse arrin kombinim optimal të kapitalit të vet me kapitalin e huajtur. Problemi I kombinimeve të llojeve të burimeve nga ana e njësisë ekonomike është ndër më të ndjekurit nga ana e studiuesve të fushes.

Konkretisht janë marrë me munësitë e financimit për zgjerimin e aktivitetit të shoqërisë apo me studimin koeficientëve të kombinimit të kapitalevetë vëta me kapitalet e huaja. Me kombinimin optimal të kapitaleve nënkuptohet ruajtja e një strukture të tillë të kapitaleve të veta dhe të huajtura që siguron nga njëra anë rritje të përfitueshmërisë së kapitaleve të njësisë ekonomike huamarrëse dhe nga ana tjetër shlyerjen e garantuar të kapitaleve dhe të interesave që u takojnë huamarrësve.
Studiuesit e këtij problem I janë referuar studimit të raporteve faktike ndërmjet kapitaleve të veta dhe kapitaleve të huajtura. Në kushte normale njësia ekonomike duhet të perballojë nevojat për active të qëndrueshme të trupëzuara afatgjata me anë të kapitaleve të përhershme, dhe nevojat për active afatshkurtëra duhet ti përballojë me anë të detyrimeve afatshkurtra,të cilat kërkohen të shlyhen më shpejt.

Raportet kryesore të strukturës së kapitalit

Raportet e strukturës së kapitalit janë një mjet tjetër shumë I rëndësishëm I analizës së aftësisë paguese. Raporti që mat strukturën e kapitalit lidh përbërësit e strukturës së kapitalit me njëri tjetrin apo me totalin. Para se të llogarisim raportet duhet të jemi të kujdesshëm të kuptojmë secilin element të raportit.

Raportet e strukturës së kapitalit janë:
- Raporti i detyrimeve totale mbi kapitalin aksioner, i cili tregon peshën specifike të dëtyrimeve totale ndaj kapitalit të vet.
- Raporti totali i detyrimeve me totalin e kapitalit plus detyrimet, (i cili quhet raporti i borxhit total) shpreh peshën specifike të detyrimeve ndaj totalit të pasiveve.
- Raporti i kapitalit aksioner ndaj detyrimeve totale, i cili tregon garantimin ose jo të madhësisë së kapitaleve të huajtura me madhësinë e kapitaleve të veta.
- Raporti i EAN mbi shitjet i cili tregon fitimin neto që përfitohet për çdo lek shitje.
- Kthimi mbi aktivet gjithsej (ROI) i cili shpreh kthimin që përfitohet mbi aktivet gjithsej.
- Kthimi mbi kapitali aksioner (ROE) i cili shpreh fitimin neto që marrin aksionrët për kapitalin e investuar.

Raporti i detyrimeve totale mbi kapitalin aksioner = Detyrime totale / Kapital aksioner
Raporti i borxhit total = Detyrime totale / Pasive totale
Raporti i kapitalit aksioner ndaj detyrimeve totale = Kapital aksioner / Detyrime totale
Raporti i EAN mbi shitjet = EAN / Shitje
Kthimi mbi aktivet gjithsej (ROI) = EAN / Pasive totale
Kthimi mbi kapitali aksioner (ROE) = EAN / Kapital aksioner

Konkluzione

Nga studimi i 10 kompanive të ndryshme në mënyrë rastësore të Qarkut të Lezhës ku janë marrë perfundimet e punimit.

1. Me zhvillimin e tregjeve financiare dhe me rritjen e paqëndrueshmërisë së tyre, është rritur edhe ekspozimi i organizatave dhe institucioneve financiare ndaj risqeve të ndryshme. ALM ka lindur si nevojë e kohës për të menaxhuar riskun dhe për të minimizuar efektet negative të tij në përfitueshmërine dhe vlerë ekonomike të organizatës. ALM është një kornizë gjithëpërfshirëse dhe

dinamike për matjen, monitorimin dhe administrimin e rrezikut të tregut të një banke ose kompanie sigurime.

2. Risqet kryesore që në mënyrë tipike menaxhohen nga ALM janë risku i likuiditetit, risku i normave të interesit dhe risku i monedhës. Por ALM e ka shtrirë funksionin e saj edhe në fusha të tjera. Teknikat e menaxhimit të aseteve-detyrimeve kanë evoluar dhe është shoqëruar edhe me rritjen e përdorimit të derivateve në tregjeve të ndryshme financiare.

3. Aftësia paguese e njësisë ekonomike,shkalla e likuiditetit të aktiveve të saj dhe niveli i përfitueshmërisë së aktivitetit që ajo zhvillon përcaktojnë në një masë të gjerë mbijetesën dhe ecurinë e njësisë ekonomike. Aftësia paguese e një njësie ekonomike përfaqëson aftësinë e saj për të përballuar shlyerjen në kohë të detyrimeve të veta afatshkurtra

4. Kompanitë kanë tendencën që të financohen më shumë me detyrime sesa me kapital aksioner. Kthimet nga aktivet për kompanitë e marra në studim është relativisht i ulët. Sic shikohet edhe nga të dhënat kompanitë e marra për studim nuk i kanë problemet tek kthimet nga shitjet por problemet mund të qëndrojnë tek struktura e kapitalit dhe analiza paguese e kompanive.

Rekomandime

1. Mbajtja e riskut, është e pershtatshme për risqe me impakt te vogël dhe me mundësi të paktë ndodhjeje. Është e pashmangshme në ato raste kur është e pamundur të reduktohet apo te eleminohet risku. Shembull: çdo biznes ka riskun e zgjedhjes së përsonelit të gabuar, por kosto që vjen nga kjo mund të jetë më e ulët se kosto e ngritjes së një sistemi rekrutimi dhe shtesës në pagë/përfitime që mund të kërkojë një punonjës i mbikualifikuar

2. Shmangia, ndodh për ato raste kur mund ti shmangemi ndërmarrjes së një aktiviteti të caktuar duke mos marrë vendimin për mosinvestim. Shembull: Nëse risku i tregut (konkurencës) në një sektor të caktuar vlerësohet tepër i lartë, atëherë vendimi për të mos investuar (mos u futur) në atë sektor është ti shmangesh riskut.

3. Një nga detyrat e analistit është, studimi nëse veprimtaria e ndërrmarjes karakterizohet nga struktura financiare më e mirë e mundshme. Problemi nuk është i lehtë për tu zgjidhur, sepse, si te gjitha problemet e ndërmarrjes, është një problem dinamik.Nuk ekziston në fakt një strukturë financiare gjithmonë e vlefshme ashtu sic nuk ekziston nje strukture financiare e vlefshme për periudha të gjata.

4. Një nga gabimet që bëjnë kompanitë është të financosh mjetet afatgjata me detyrime afatshkurtra. Ky gabim sjell rëndim të situatës në strukturën e kapitalit dhe sjell një ulje të aftësisë paguese të firmës. Financimet për mjetet afatgjata duhet të bëhen ose me kapital aksioner ose me detyrime afatgjata, sipas niveli të interesit të huamarrjes dhe atij të fituar nda pronaret.

Bibliografia

Acounting for Menagers Bill Webster
SKK 01 Kuadri I pwrgjithshwm pwr pwrgatitjen e pasqyrave financiare
Financial Accounting, John J.Wild, Chapter 10 Liabilities
Kontabiliteti Financiar, S.Dhamo, 2010
Halit Xhafa,Beshir Ciceri,Drejtim Financiar 1,Tirane 2004
Financial Accounting - Paul Danos,Eugene A. Imhoff,JR
Kontabiliteti – Prof.As.Dr Agim Binaj, Prof.As.Dr Flutura Kalemi
Ingrid Shuli,Rezarta Perri Analiza e Pasqyrave Financiare 2008
www.aicpa.org

The American Institute of Certified Public Accountants is “the CPA mother ship”
www.gasb.org
www.rmahq.org
http://www.oracle.com/us/industries/financial-services/045581.pdf
http://www.riskencyclopedia.com/articles/asset-liability-management/
http://www.rbidocs.rbi.org.in/rdocs/PressRelease/PDFs/3204.pdf
http://www.investopedia.com/articles/investing/041213/examples-assetliability-management.asp

PHD. (C) FATMIR HALILI – LEGISLATIVE PROCEDURE IN THE EUROPEAN UNION PROCEDURA LEGJISLATIVE NË UNIONIN EVROPIAN

PHD. (C) FATMIR HALILI
Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Prizren

Abstract

As each organization have its own institutions and rules governing which works, so the European Union since its creation has created organs and operating rules. These rules and institutions have consistently changed by adapting to the changes that have occurred over time in the European Union. Undoubtedly, special roles in every organization have bodies that emit legal acts (laws) and decide on important issues of the organization. Thus, whenever talking about bodies that issue legal acts and decide on important issues primarily thought Parliament. This results from the fact, that in almost all countries of the world function of extracting the most important legal acts is attributed to Parliament as a representative body of the people. However, the European Union has not been given the legislative function only parliament, but there are three institutions that interact to legislate in the European Union: the European Parliament, the Council and the European Commission. This is one of the characteristics of the European Union, and this is due to supranacionalitetit and special organization that has the European Union, as well as changes that have occurred in continuity throughout the history of the European Union since 1951, when it signed the first fundamental treaty in Paris, known as the Treaty of the Economic Community for Coal and Steel (ECCS). In this paper are initially treated, in short way, institutions in general, and in particular in order to expand, legislative procedures, types of procedures, the European Union uses to extract acts. The paper aims at explaining the European Union's legislative procedure and inter-institutional cooperation in this procedure.

Keywords: Institution, Legislation, Procedure, Treaty, Regulation, Directive, etc.

Abstrakt

Si çdo organizatë që ka institucionet e veta qeverisëse dhe rregullat mbi të cilat funksionon, edhe Unioni Evropian që nga krijimi i tij ka krijuar organet dhe rregullat e funksionimit. Këto rregulla dhe institucione në vazhdimësi kanë pësuar ndryshime duke ju përshtatur ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë kohës në Unionin Evropian. Pa dyshim, një rol të veçantë në çdo organizatë e kanë organet të cilat nxjerrin akte juridike (ligje) dhe vendosin për çështje të rëndësishme të organizatës. Kështu, sa herë që flitet për organet që nxjerrin akte juridike dhe vendosin për çështje të rëndësishme kryesisht mendohet Parlamenti. Kjo, rrjedh nga fakti, se gati në të gjitha shtetet e botës funksioni i nxjerrjes së akteve më të rëndësishme juridike i është atribuuar Parlamentit si organ përfaqësues i popullit. Në këtë kontekst, kur flitet edhe për organin më të rëndësishëm vendosës të Unionit Evropian, fillimisht do të mendohet për Parlamentin. Mirëpo, në Unionin Evropian, nuk i është dhënë funksioni ligjdhënës vetëm parlamentit, por janë tri institucione që bashkëveprojnë në nxjerrjen e ligjeve në Unionin Evropian: Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni Evropian. Kjo është një nga karakteristikat e Unionit Evropian, dhe është e tillë për shkak të supranacionalitetit dhe organizimit të veçantë që ka Unioni Evropian, si dhe ndryshimeve që kanë ndodhur në vazhdimësi gjatë historisë së krijimit të Unionit Evropian, që nga viti 1951 kur është nënshkruar Traktati i parë themeltar në Paris, i njohur si Traktati për Bashkësinë Ekonomike për Thëngjill dhe Çelik (BETHÇ). Në këtë punim janë trajtuar fillimisht, në mënyrë të shkurtër, institucionet në përgjithësi, dhe në veçanti në mënyrë të zgjeruar, procedura legjislative, llojet e procedurave që Unioni Evropian përdorë në nxjerrjen e akteve juridike. Punimi ka për qëllim shpjegimin e procedurës legjislative të Unionit Evropian dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në këtë procedurë.

Fjalë kyçe: Institucion, Legjislacion, Procedurë, Traktat, Rregullore, Direktivë, etj.

Mbi Institucionet e Unionit Evropian në përgjithësi

Ndryshimet institucionale kanë qenë të vazhdueshme si rezultat i zgjerimit dhe unifikimit të Unionit Evropian. "Debati që ka angazhuar shoqërinë evropiane rreth reformës institucionale është sa i rëndësishëm aq edhe i vështirë. Sado gjeniale të kenë qenë baballarët e Evropës së bashkuar, ata nuk kanë pasur mundësi të parashikonin të gjithë ecurinë e së ardhmes evropiane dhe të institucioneve që do ta ndërtojnë atë"312. Nuk ka dyshim se institucione me një funksionim të mirëfilltë janë një motor i fuqishëm i qëndrueshmërisë së Unionit Evropian, për këtë arsye edhe traktatet që nga ai i Parisit për Bashkësinë Ekonomike për Thëngjill dhe Çelik, në një formë ose në një tjetër kanë përmbajtur dispozita mbi institucionet. Duhet të kemi parasysh që "në tokën Evropiane ekzistojnë kultura dhe tradita të ndryshme, megjithatë edhe vlera të përbashkëta për popujt evropian. Shtetet e bashkuara demokratike Evropiane, përmes bashkëpunimit ekonomik dhe politik synojnë kah sigurimi i prosperitetit dhe paqes së përhershme. Dëshirat për sigurim dhe paqe, për liri dhe lëvizje të lirë, si dhe begatia ekonomike janë thellë të rrënjëzuara në arsyet e ekzistimit të Unionit Evropian"313. Në këtë kontekst institucionet paraqesin shtyllën themelore të ombrellës së quajtur Union Evropian. Sipas nenit 13 të traktatit të Lisabonës "Unioni ka një kuadër institucional që ka si qëllim të promovojë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, t'u shërbejë interesave të tij, të qytetarëve të tij dhe të Shteteve Anëtare dhe të sigurojë njëtrajtshmërinë, efektshmërinë dhe vijimësinë e politikave dhe masave të tij"314. Sipas këtij neni, Institucionet e Unionit Evropian janë:

- Parlamenti Evropian,
- Këshilli Evropian,
- Këshilli,
- Komisioni Evropian,
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian,
- Banka Qendrore Evropiane dhe
- Gjykata e Auditorëve.

Përveç Institucioneve të përmendura më lartë, Unioni Evropian ka edhe organe të tjera të cilat njihen si organe dytësore ose ndihmëse të Unionit Evropian, e që janë:

☑ Komiteti Ekonomik dhe Social,
☑ Komiteti i Rajoneve,
☑ Banka Evropiane e Investimeve dhe
☑ Agjencitë"315

Nga këto institucione asnjëra prej tyre nuk ka ndonjë relevantë të caktuar në aspektin legjislativ.

Institucionet Ligjvënëse të Unionit Evropian
Duke u bazuar në Traktatin e Lisabonës dhe në Traktatin për Funksionimin e Unionit Evropian, organet e Unionit Evropian mund t'i ndajmë në organet kryesore dhe në organet ndihmëse apo dytësore. Kjo ndarje vjen nga roli i tyre që kanë në ushtrimin e funksioneve brenda Unionit Evropian. Institucionet e përmendura në nenin 13 të traktatit të Lisabonës paraqesin institucionet (organet) kryesore të Unionit Evropian. "Secili institucion vepron brenda kufijve të kompetencave që u japin Traktatet dhe në përputhje me procedurat, kushtet dhe objektivat që përcaktohen në to"316.
Nga institucionet kryesore dallojmë tri institucione që në Unionin Evropian paraqesin institucione që kanë rol të veçantë në nxjerrjen e akteve juridike (ligjeve), dhe nga kjo del se në nxjerrjen e ligjeve në Unionin Evropian nuk kemi vetëm një organ, siç ekziston në shtetet nacionale ku një institucion

[312] Paskal Milo, Bashkimi Evropian, alb PAPER, Tirana, 2002, pg. 332
[313] Qendra maqedonase për arsimim evropian, Unioni evropian – Mësojmë drejtësi, Shkup, Maqedoni, 2009, fq. 8
[314] Neni 13 i Traktati të Lisabonës, miratuar më 2007 dhe hyrë në fuqi më 2009
[315] Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe Politika e Unionit Evropian, Tetovë, 2010, fq. 23
[316] Neni 13 paragrafi 2 i Traktati të Lisabonës, miratuar më 2007 dhe hyrë në fuqi më 2009

(Parlamenti) ka rolin qendror në nxjerrjen e ligjeve. Në Traktatin për Funksionimin e Unionit Evropian, në nenin 289 paragrafi 1 është paraparë se Procedura e zakonshme legjislative konsiston në miratimin e përbashkët nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, me propozim të Komisionit.

Procedura Legjislative
Në Unionin Evropian nuk kemi një hierarki ligjore ashtu siç është në shtetet nacionale. Nuk ekziston një kushtetutë Evropian dhe ligje ashtu siç janë në shtetet nacionale. Në Unionin Evropian ekzistojnë Traktatet të cilat e kanë fuqinë më të lartë ligjore dhe të gjitha aktet e tjera duhet të jenë në përputhje me Traktatet.

Traktatet janë produkt i ujdisë së shteteve anëtare të Unionit Evropian, pra, nxjerrën nga shtetet anëtare të UE-së317, ndërsa aktet e tjera, janë produkt i organeve të Unionit Evropian. Me Traktatin për Funksionimin e Unionit Evropian (TFUE) është përcaktuar se Institucionet e Unionit Evropian, për të ushtruar kompetencat e Unionit mund të miratojnë rregullore, direktiva, vendime, rekomandime dhe opinione318. Në Traktat është përcaktuar edhe fuqia vepruese e tyre, tri të parat: rregulloret, direktivat dhe vendimet kanë fuqi detyruese, ndërsa dy të fundit, rekomandimet dhe opinionet nuk kanë fuqinë detyruese319.

Parlamenti Evropian nuk kishte asnjë rol legjislativ në Traktatet e para, atë të Parisit 1951 dhe atë të Romës 1957. Procedura "injoruese" ndaj Parlamentit Evropian u ndryshua me Aktin Unik Evropian duke e ngritur rolin e PE-së në procedurën legjislative dhe duke vendosur sistemin e shumicës së kualifikuar të votave, si mekanizëm vendimmarrës në Këshill320.
Roli i parlamentit në procesin legjislativ ka shkuar në vazhdimësi drejt rritjes me Traktatet e më vonshme, atë të Mastrihtit, të Amsterdamit duke u zgjeruar edhe më shumë me Traktatin e Nicës.
Bazuar në nenin 289 të Traktatin për Funksionimin e Unionit Evropian (TFUE) dallojmë tri lloje të procedurave të nxjerrjes së akteve juridike në Unionin Evropian, dhe atë:

☑ Procedura e zakonshme (e rregullt) legjislative
☑ Procedura e posaçme legjislative si dhe
☑ Procedurat e tjera legjislative

Procedura e zakonshme (e rregullt) legjislative
Procedura e zakonshme apo e rregullt legjislative është paraparë në nenin 294 të Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian. Kjo është procedurë e cila në thelb është procedurë e vendimmarrjes së përbashkët (të vendosur më parë në nenin 251) ndërsa Traktati i Lisbonës thjesht ka ndryshuar formulimin për të theksuar barazinë ndërmjet Parlamentit Evropian (PE) dhe Këshillit gjatë gjithë kësaj procedure321. Është e rëndësishme të theksohet se "ndryshimi kryesor që rezultojnë nga Traktati i Lisbonës është aplikimi i kësaj procedure në një numër të 'bazave ligjore' të tjera. Tani ka rreth 70 baza ligjore që ofrohen për procedurën e zakonshme legjislative. Natyrisht një përqindje më e madhe e legjislacionit se më parë do të jetë subjekt i kësaj procedure"322.
Rol të rëndësishëm në procedurën legjislative ka Komisioni Evropian, ai është institucioni i vetëm i UE-së i cili ka të drejtë të iniciojë legjislacionin. Por në bazë të nenit 289 paragrafi 4, në rastet e caktuara të parashikuara nga Traktatet, aktet legjislative mund të miratohen me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare ose të Parlamentit Evropian, me rekomandim të Bankës Qendrore Evropiane ose me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë ose të Bankës Evropiane të Investimeve. Rrjedhimisht, Komisioni është përgjegjës për hartimin e propozimeve të duhura legjislative. Përpara miratimit të propozimeve

[317] Deri më sot Unioni Evropian ka nxjerrë (miratuar) disa Traktate. Traktati i fundit është ai i Lisabonës i cili u nënshkrua më 13dhjetor 2007, dhe ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009
[318] Neni 288 i Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian
[319] Neni 288 i Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian
[320] Blerim Reka & Arta Ibrahimi, Studime Evropiane, Identiteti, Historia, Integrimet Evropiane, Institucionet, Politika, E Drejta e Unionit Evropian, Tetovë, 2004, fq. 212
[321] Steve Peers, Guide to EU decision-making and justice and home affairs after the Treaty of Lisbon, A Statewatch publication, December 2010, fq. 3
[322] IBID, fq. 3

formale, Komisioni do të konsultohet me grupet përkatëse të interesit. Projekt propozimi legjislativ i Komisionit i paraqitet si Parlamentit Evropian dhe Këshillit, dhe gjithashtu për të gjithë 28 vendet anëtare të Parlamentit, dhe kur është e përshtatshme Komitetit të Rajoneve dhe Komitetit Ekonomik dhe Social323.

Fillimisht pas propozimit nga Komisioni sipas nenit 294 paragrafi 3 të Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian pasi bënë leximin e parë Parlamenti Evropian miraton një qëndrim, të cilin ja komunikon Këshillit. Traktati për Funksionimin e Unionit Evropian (neni 294, par. 4 dhe 5) me këtë rast Këshillit i ka dhënë dy mundësi, të aprovojë qëndrimin e Parlamentit ose të mos e aprovoj atë. Nëse e aprovon akti i korrespondon qëndrimit të Parlamentit Evropian, nëse nuk e aprovon, Këshilli e miraton qëndrimin e vet në leximin e parë dhe ia komunikon atë Parlamentit Evropian.
Në shqyrtimin e dytë, pas këtij komunikimi, Parlamenti Evropian brenda tre muajve pas marrjes së qëndrimit nga Këshilli ka tri mundësi të veprimit:

a. të aprovoj qëndrimin e Këshillit
b. të hedhë poshtë ose
c. të ndryshojë qëndrimin e Këshillit324.

Në rastin e tretë kur Parlamenti Evropian ndryshon qëndrimin e Këshillit, brenda tre muajve pas marrjes së shtesave dhe ndryshimeve nga Parlamenti Evropian, Këshilli, me shumicë të cilësuar mund:

(a) të aprovoj të gjitha shtesat dhe ndryshimet, dhe akti në fjalë konsiderohet si i miratuar;
(b) të mos aprovoj të gjitha shtesat dhe ndryshimet, Presidenti i Këshilli, në marrëveshje me Presidentin e Parlamenti Evropian, brenda gjashtë javëve thërret një mbledhje të Komitetit të Pajtimit (Nenin 294 paragrafi 8 i TFUE). Ky Komiteti i Pajtimit, përbëhet nga anëtarët e Këshillit ose përfaqësuesit e tyre dhe nga një numër i barabartë deputetësh të Parlamentit Evropian, dhe ka për detyrë të arrijë një marrëveshje për një tekst të përbashkët, me shumicën e cilësuar të anëtarëve të Këshillit ose përfaqësuesve të tyre dhe me shumicën e deputetëve që përfaqësojnë Parlamentin Evropian, brenda gjashtë javëve pasi thirret mbledhja e tij, mbështetur në qëndrimet e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në leximin e dytë (Nenin 294 paragrafi 10 i TFUE). Nëse, brenda gjashtë javëve pasi thirret mbledhja e tij, Komiteti i Pajtimit nuk e aprovon tekstin e përbashkët, atëherë akti i propozuar konsiderohet i pa miratuar (Nenin 294 paragrafi 12 i TFUE).

Në leximin e tretë, nëse brenda kësaj periudhe, periudhës gjashtë javore, Komiteti i Pajtimit aprovon një tekst të përbashkët, Parlamenti Evropian me shumicën e votave të hedhura, dhe Këshilli me shumicë të cilësuar, ka secili një periudhë gjashtë javore nga data e aprovimit, brenda së cilës mund ta miratojnë aktin në fjalë në përputhje me tekstin e përbashkët. Nëse nuk e arrijnë këtë, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar (Nenin 294 paragrafi 13 i TFUE).
Nga kjo që u tha rrjedh se "rëndësia e procedurës së rregullt legjislative qëndron në vetë faktin që Parlamentit Evropian i njihet një e drejtë e denjë e bashkërendimit në nxjerrjen e akteve juridike të Unionit Evropian. Parlamenti Evropian dhe Këshilli (i Unionit Evropian) bashkëveprojnë në mënyrë të barabartë në nxjerrjen e akteve juridike të Unionit Evropian325.

Procedura e posaçme (e veçantë) legjislative
Karakteristik e kësaj procedure legjislative është se njëri nga dy organet, Parlamenti Evropian ose Këshilli (i Unionit Evropian), nxjerr një akt juridik, ndërsa organi tjetër megjithëse merr pjesë në nxjerrjen e tij ai nuk i ka kompetencat e barabarta në vendimmarrje. Procedura e posaçme legjislative ngërthen në vete ish-procedurat e dëgjimit dhe të bashkëvendimit326. Kjo procedurë aplikohet në

[323] Iain McIver, SPICe Briefing, The European Union – The Legislative Process, This subject profile provides a brief introduction to the European Union's legislative process. It looks at the different forms of legislation available to the EU and the way in which that legislation is agreed at EU level.11/46, 20 June 2011, pg. 4
[324] Shih: Nenin 294 paragrafi 7 i Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian
[325] Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, Prishtinë, OLYMP, 2013, fq. 150
[326] IBID, fq. 152

rastet e caktuara kur është paraparë nga Traktatet. Objektivi i këtyre procedurave është që të lehtësoj procesin e vendim-marrjes së UE-së duke e bërë atë më të qartë dhe më efektiv. Siç tregon edhe emri i tyre, këto procedura derogojnë nga procedurat e zakonshme legjislative dhe prandaj përbëjnë përjashtime.

Procedurat e tjera legjislative
Procedurat e tjera legjislative kanë të bëjnë me çështjet e veçanta që kanë të bëjnë me Unionin Evropian, si për shembull amandamentimi i Traktatit themeltar të UE-së, miratimi i buxhetit të Unionit Evropian, miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Unionit etj.

Nënshkrimi dhe shpallja e akteve juridike të Unionit Evropian
Varësisht se a kemi nxjerrjen e një akti juridik në procedurë të rregullt legjislative apo në procedurë të posaçme, dallon edhe subjekti që i nënshkruan ato. Kjo është përcaktuar nga Traktati për Funksionimin e Unionit Evropian në të cilin thuhet: "Aktet legjislative të miratuara sipas procedurës së zakonshme legjislative nënshkruhen nga Kryetari i Parlamentit Evropian dhe nga Presidenti i Këshillit. Aktet legjislative të miratuara sipas një procedure të posaçme legjislative nënshkruhen nga Titullari i institucionit që i miraton"327. Po ashtu edhe "Aktet jo legjislative të miratuara në formën e rregulloreve, direktivave ose vendimeve, kur nuk e përcaktojnë se cilit i drejtohen, nënshkruhen nga Titullari i institucionit që i miraton"328.
TFUE ka përcaktuar se aktet legjislative botohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe hyrja në fuqi bëhet me datën e përcaktuar në tekstin e tyre ose, në mungesë të këtij parashikimi, njëzet ditë pas botimit të tyre.

Konkluzione

Sikurse çdo Shtet dhe Organizatë që posedon institucione e veta dhe rregullat e veta për funksionimin e saj, në këtë mënyrë edhe Unioni Evropian si një Organizatë supranacionale e llojit sui generis posedon institucionet e veta dhe rregullat e veta mbi bazën e të cilave funksionon. Në këtë kontekst, sikurse organizatat dhe shtetet që kanë organet legjislative edhe Unioni Evropian ka organet e veta legjislative.

Mirëpo, në Unionin Evropian siç e pamë nuk ekziston një institucion i vetëm legjislativ ashtu siç është në shtetet nacionale. Parlamenti Evropian në fillim nuk kishte ndonjë rol legjislativ, roli i tij në nxjerrjen e akteve legjislative është fuqizuar gradualisht ndërsa me Aktin Unik Evropian është ngritur roli i PE-së në procedurën legjislative.

Rolin e legjislativit në Unionin Evropian e luajnë tri institucione Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni. Procedura legjislative është rregulluar me Traktatin për Funksionimin e Unionit Evropian në nenin 294 në bazë të së cilit Komisioni është propozues i ligjeve në Unionin Evropian, ndërsa dy institucionet e tjera Këshilli dhe Parlamenti Evropian janë bashkëpunues në procedurën legjislative.

Në Traktatin për Funksionimin e Unionit Evropian – TFUE dallojmë tre lloje të procedurave legjislative, procedurën e zakonshme apo të rregullt legjislative, procedurën e posaçme legjislative dhe procedurat e tjera legjislative. Prej tyre procedura e zakonshme legjislative është kryesore dhe më e rëndësishme.

Të gjitha aktet legjislative të nxjerra në procedurë të rregullt legjislative nënshkruhen nga Kryetari i Parlamentit Evropian dhe nga Presidenti i Këshillit, ndërsa Aktet legjislative të miratuara sipas një procedure të posaçme legjislative nënshkruhen nga Titullari i institucionit që i miraton. Sipas TFUE aktet legjislative botohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe hyrja në fuqi bëhet me datën e përcaktuar në tekstin e tyre ose, në mungesë të këtij parashikimi, njëzet ditë pas botimit të tyre.

[327] Nenin 297 paragrafi 1 i Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian
[328] IBID, Nenin 297 paragrafi 2

Referencat

Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, Prishtinë, OLYMP, 2013
Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe Politika e Unionit Evropian, Tetovë, 2010
Blerim Reka & Arta Ibrahimi, Studime Evropiane, Identiteti, Historia, Integrimet Evropiane, Institucionet, Politika, E Drejta e Unionit Evropian, Tetovë, 2004
Paskal Milo, Bashkimi Evropian, alb PAPER, Tirana, 2002
Steve Peers, Guide to EU decision-making and justice and home affairs after the Treaty of Lisbon, A Statewatch publication, December 2010
Iain McIver, SPICe Briefing, The European Union – The Legislative Process, This subject profile provides a brief introduction to the European Union's legislative process. It looks at the different forms of legislation available to the EU and the way in which that legislation is agreed at EU level.11/46, 20 June 2011
Qendra maqedonase për arsimim evropian, Unioni evropian – Mësojmë drejtësi, Shkup, Maqedoni, 2009
Traktati të Lisabonës, miratuar më 13dhjetor 2007dhe hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009
Traktatit për Funksionimin e Unionit Evropian 2007

IRIS KRUJA – TREGU I FONDEVE DHE SKEMAVE TË PENSIONEVE NË SHQIPËRI.

ZHVILLIMET DHE PROBLEMATIKAT E TIJ

IRIS KRUJA
Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakt

Mbrojtja shoqërore është një veprimtari e rëndësishme e jetës shoqërore, e cila synon të përmbushë nevojat bazë dhe ti japë siguri anëtarëve të saj ndaj humbjes apo reduktimit të burimeve të jetës. Fondet e pensionit përbëjnë një nga çështjet më të rëndësishme që prekin jo vetëm brezin e moshuar, por i përkasin edhe brezave më të rinj. Sistemi shtetëror i pensioneve në Shqipëri njohu një periudhë të vështirë tranzicioni dhe tashmë ai nuk është i mjaftueshëm për kënaqjen e nevojave financiare për pjesën e popullsisë së moshës së tretë, duke u bërë kështu domosdoshmëri zhvillimi i sistemit privat të pensioneve.
Pensionet janë një element i rëndësishëm i mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Aktualisht 18 % e popullsisë marrin pension ndërkohë që fondet private të pensioneve janë të kufizuara. Akoma nuk ka hyrë fryma dhe kultura pasi operohet akoma me rrjetat tradicionale ku të moshuarit janë në kujdesin e fëmijëve të tyre. Megjithatë për shkak të emigracionit dhe të kushteve të vështira sociale këto rrjeta tradicionale do të vijnë duke u ulur.
Qëllimi i këtij punimi është të japë një pamje të qartë të fondeve të pensioneve në Shqipëri duke përfshirë problematikat dhe të ndergjegjësojë për rëndësinë e këtyre fondeve dhe risitë që ato sjellin.

Fjalët kyce: Tregu i fondeve, skema e pensioneve, zhvillimet, Shqipëri.

Hyrje

Sigurimet Private si një formë efikase e ndërthurur me Sigurimet Shoqërore janë krijuar me synimin për të financuar të ardhurat në moshën e pensionit. Ato janë burim parësor i produkteve të tyre, pikërisht i sigurimit të të ardhurave suplementare për pension me qëllim që të sigurojë një nivel jetik më të lartë të individit kur ai arrin moshën e pensionit. Niveli i të ardhurave të individit pas daljes në pension do të përbëhet nga të ardhurat që ai siguron si rezultat i përfshirjes në Skemën e Sigurimeve Shoqërore të detyrueshme plus kontributin dhe përfitimet e nxjerra nga pjesëmarrja në Fondet private të pensionit.329
Fondi i pensionit është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, i përbërë nga kontributet dhe investimi i tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifat. Fondi i pensionit zotërohet bashkërisht nga disa persona, në pronësi të ndarë dhe ku pjesët e pronësisë përfaqësohen nga kuota në fondin e pensionit.
Çdo kuotë përfaqëson pronësinë e pjesës përpjesëtimore të aseteve, të cilat ndodhen në fondin e pensionit.330

Fondet e pensionit privat kundrejt atyre publik.

Një hap i hedhur më tej në zhvillimin e këtij tregu në Shqipëri ishte ligji i ri "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" i miratuar në dhjetor të vitit 2009, i cili ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensionit vullnetar.Ky ligj sjell ndikime pozitive në tregun e

[329] http://www.sicred-pensions.com.al/Web/Rreth_Nesh.php
[330] http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Aktet_ligjorenenligjore/Projektudhezimi_i_tatimit_mbi_te_ardhurat_dhjetor_2014_(1).docx.

pensioneve private duke bërë një ndryshim rrënjësor në fushën e organizimit, administrimit dhe funksionimit të këtyre fondeve dhe si rrjedhim duke rritur interesin ndaj tyre.
Klasifimi kryesor i fondeve të pensionit është ndarja e tyre në fonde pensioni publik e privat.
Fondet e pensioneve publike u nënshtrohen më shumë rregullimeve dhe kontrolleve të hollësishme nga shteti. Këto fonde nuk janë aktivë në tregun financiar. Në këto fonde, përfitimi nuk lidhet ngushtë me kontributin e kaluar të pjesëmarrësit në plan, sepse ai paguhet nga kontributet aktuale, prandaj ky quhet edhe sistemi "pay-as-you-go". Kjo mënyrë pagese mund të çojë, siç ka ndodhur në fakt, në vështirësi financiare të këtyre fondeve për një varg arsyesh, ku një prej tyre është plakja e popullsisë. (Hadëri, 2007)

Fondet e pensioneve private kanë një trysni më të madhe nga përfituesit për të ardhura të larta. Karakteristikë e këtyre fondeve është investimi i burimeve të tyre në dy lloje letrash me vlerë të tregut të kapitalit: obligacione dhe aksione të korporatave. Fondet private të pensioneve janë institucione financiare me efekte të rëndësishme në dy drejtime kryesore: së pari në atë shoqëror, si një instrument me anë të të cilit individët mund të kursejnë para për kohën e pensionit të tyre dhe së dyti si faktor shumë i rëndësishëm në tregjet e kapitalit.
Në këto plane, shpërblimi bëhet mbi bazën e kontributit. Për të shmangur mosdrejtimin e mirë dhe abuzimet e ndryshme është vendosur rregullimi i tyre nga agjensitë përkatëse. (Sulo Hadëri)

Situata aktuale e fondeve të pensionit në Shqipëri dhe evoluimi i tyre.

Ligji i ri per "Fondet e Pensioneve Vullnetare" ka për qëllim:
- Stimulimin e shtetasve të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- Shtimin e nivelit të kursimit të popullsisë dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.331

Fondi i Pensionit përbëhet nga një grup asetesh , pronarët e të cilëve janë anëtarët e fondit. Është e krijuar mbi bazë kontratash, ku secili anëtar ka pjesën e tij. Në këto asete përfshihen kontributet e derdhura dhe fitimi neto i realizuar nga investimi i tyre. Kemi dy lloje fondesh pensioni:332

Fondi i Pensionit Vullnetar, që përfaqëson dëshirën e individëve për të marrë pjesë në një plan pensioni. Në këtë rast midis individit dhe Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit lidhet një kontratë ku përcaktohen kushtet dhe detyrimet që kanë palët.

Fondi i Pensionit Profesional përfaqëson dëshirën e punëdhënësit privat ose shtetëror të sigurojë te një Fond Pensioni punonjësit e tij me një plan pensioni profesional. Në këtë rast lidhet një kontratë midis punëdhënësit dhe Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit, ku specifikohen kushtet dhe emrat e personave që do te perfitojnë nga kjo marrëveshje. Pjesëmarrja në planin e pensionit mund të jetë tre llojesh: kolektive, individuale dhe e kombinuar. Në një plan pensioni kolektiv, punëdhënësi duhet të paguajë tërësisht kontributet për pension vullnetar në emër të punonjësve të tij, në një plan pensioni individual punëmarrësit marrin përsipër të paguajnë gjithë kuotën e kontributit për pension vullnetar nga të ardhurat personale, kurse në një plan pensioni të kombinuar kontributet për pension vullnetar paguhen pjesërisht nga punëdhënësi e pjesërisht nga punëmarrësi.333

Sipas Naim Hasës, drejtor i përgjithshëm i pensioneve Sigal, ligji i ri i pensioneve private me lehtësirat fiskale që parashikon do ta bëjë investimin në fondet private të pensioneve edhe më tërheqës për individët edhe për punëdhënësit. (Revista Monitor, 2012,fq 40)

1-Ky ligj i ofron konsumatorit sigurinë e munguar në treg, pasi fondet e pensioneve private do të administrohen nga Shoqëria Administruese, e cila është një Institucion Financiar, bankë apo kompani sigurimi, përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve dhe pagesën e përfitimeve.

[331] Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, 2010
[332] Ligji nr.10 197, date 10.12.2009, Per fondet e pensionit vullnetar.
[333] Fabozzi, F. J. & Modigliani, F.(2013). *Tregu I kapitaleve; Institucionet dhe instrumentet* (Vol. 4), Mediaprint.

2-Ky ligj ofron gjithashtu dhe garanci sepse asetet e fondit të pensionit334 që përbëhen nga kontributet e derdhura dhe fitimi i realizuar do të mbahen nga Depozitari, që është një bankë e liçencuar nga Banka e Shqipërisë dhe e miratuar nga autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili mbikëqyr gjithë veprimtarinë e Fondit.
3-Kështu një nga lehtësirat tatimore që bëhet e mundur është se kontributet e derdhura në një fond pensioni privat, si ato të punëmarrësit edhe ato të punëdhënësit, zbriten nga të ardhurat personale për efekt tatimi. Fitimi i realizuar nga investimi i aseteve të fondit, nuk i nënshtrohet tatimit as për fondin e pensioneve dhe as për shoqërinë administruese.
4-Gjithashtu pjesëmarrja në një Fond Pensioni është shërbim financiar dhe si rrjedhojë është i përjashtuar nga TVSH-ja. Kontributet e derdhura nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një fond pensioni konsiderohen si shpenzim i zbritshëm për qëllime të tatimit mbi fitimin.

Si paraqitet situata aktuale e skemave te pensioneve në Shqipëri?

Aktualisht në Shqipëri veprojnë sistemi shtetëror i sigurimeve shoqërore dhe tre fonde pensioni private vullnetare.

Skema e pensionit të detyrueshëm.
Sistemi shtetëror i pensioneve funksionon sipas modelit PAYG (pay-as-you-go), pra bazohet në solidaritetin e brezave, ku gjenerata e sotme e të punësuarve, paguajnë për pensionistët e sotëm.
Pensionet ndahen në tre kategori kryesore: të pleqërisë, që zënë 81% të numrit të përgjithshëm, familjare që zënë 13% dhe të invaliditetit me 6%. Në vendin tonë ka mesatarisht një pensionist për çdo familje Fondet e sigurimeve shoqërore në shkallë vendi zënë rreth një të pestën e Buxhetit të Shtetit. (Kepi, 2007)
Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore për të punësuarin janë 27.9% e pagës bruto mujore, ku pjesa e punëdhënësit është 16.7% (15% për sigurime shoqërore dhe 1.7% për sigurime shëndetësore), kurse pjesa e punëmarrësit është 11.2% (9.5% për sigurime shoqërore dhe 1.7% për sigurime shëndetësore).335
Financimi i buxhetit të shtetit në drejtim të skemës së sigurimeve shoqërore është i ndarë në dy kategori: në financim të programeve të veçanta të qeverisë si dhe në subvencionim të fondit të pensioneve.

Disavantazhet e skemës së pensionit të detyrueshëm.
Siç mund të vihet re nga sa u trajtua më sipër, raporti kontribues/përfitues është i vogël dhe skema paraqet një sërë problemesh, të tilla si336:
-Niveli i ulët i pensioneve;
-Normë e zëvendësimit e ulët;
-Ndryshimet demografike që çojnë në rritjen e numrit të pensionistëve.
-Kontributet nuk akumulojnë të ardhura pasi ato nuk investohen.

Skema private (vullnetare) e pensioneve
Për vetë kompleksitetin dhe problematikën që paraqet skema e sigurimeve shoqërore, u bë domosdoshmëri shfaqja e pensioneve private. Sot numërohen kater kompani të pensioneve private suplementare : Raiffeisen Invest337(Raiffeisen Pensions), Sigal, Sicred sh.a, Sigma.

Avantazhet e skemës private te pensioneve
Arsyeja që ky sistem sot po bëhet gjithnjë e më shumë dominues janë edhe avantazhet që ka në raport me sistemin e vjetër shtetëror të pensioneve.

[334] http://news.al/lajme/artikull/iden/390281/titulli/Pensionet-private-dhe-ligji-i-ri
[335] Vendim nr. 1114, datë 30.07.2008, i Këshillit të Ministrave
[336]http://www.minfin.gov.al/minfin/Reformimi_i_sistemit_te_pensioneve_kerkon_nje_pakt_te_gjere_politik_e_social_978_
[337] Më 26.03.2009 është miratuar ndryshimi i emrit nga IAPPSH (Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare) në Raiffeisen Pensions.

Së pari për mënyrën se si funksionon. Sistemi shtetëror funksionon mbi bazën e solidaritetit, ku çdo i punësuar duhet të kontribuojë për të mbajtur brezin në rritje të pensionistëve dhe do të përfitojë aq sa shoqëria ka mundësi t'i ofrojë në kohën kur do dalë në pension. Ndërsa sistemi privat mbështetet në parimin e vetëkapitalizimit, i cili i garanton individit kontributet që ka derdhur në vite, si dhe fitimin që është realizuar gjatë investimit të tyre.
Së dyti për kushtet favorizuese që ofron sistemi për të përfituar një pension në pleqëri. Sistemi shtetëror për të ofruar një pension, qoftë edhe të pjesshëm pleqërie, kërkon një moshë të caktuar si dhe një vjetërsi në punë jo më pak se 15 vjet. Ndërsa në sistemin privat mund të dalësh në pension 5 vjet më parë se në sistemin shtetëror dhe nuk ka kufizime në vjetërsinë e punës.
Së treti, sistemi privat ofron përfitime shumë më të larta se sistemi shtetëror, që për kohën e sigurimit dhe për masën e kontributit shkon nga 3-5 herë më shumë.
Së katërti sistemi privat i pensioneve njeh edhe tërheqje të menjëhershme, duke ju dhënë mundësinë anëtarëve që të tërheqin në çdo kohë asetet që kanë në fond ose t'i transferojnë ato në një fond tjetër pensionesh.
Së pesti nëse anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjitha aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.338

Në etapën aktuale të zhvillimit që ka arritur jeta sociale dhe ekonomike në Shqipëri është bërë e domosdoshme prania e skemave private vullnetare, të cilat arrijnë t'i japin zgjidhje disa problemeve që karakterizojnë skemën PAYG. Në skemat private është pak i përfillshëm ndikimi i plakjes së popullsisë, i cili redukton fuqinë punëtore dhe jep shumë efekte negative në skemën shtetërore meqënëse zvogëlon bazën e kontributeve. Gjithashtu kontribuesit në skemat private arrijnë të bëjnë një lidhje më të qartë ndërmjet kontributeve aktuale dhe përfitimeve të ardhshme gjë që tregon se skemat private ofrojnë stimuj më të fuqishëm në tregun e punës dhe minimizojnë shtrembërimet në këtë treg meqënëse interesimi i individëve është më i lartë. Një karakteristikë themelore e fondeve private është diversifikimi i riskut, por që kjo të rezultojë me sukses duhet që fondi të jetë i menaxhuar mirë dhe në mënyrë kompetente.

Konkluzione

- Tablloja e sistemit aktual të pensioneve në Shqipëri e trajtuar në kapitujt paraardhës tregon se ky sistem ka shumë mangësi e probleme.
- Problematika e skemës së Sigurimeve Shoqërore është mjaft e gjerë dhe komplekse dhe prek në mënyrë direkte dhe indirekte gjithë popullsinë. Kjo skemë paraqet një varg problemesh si: raport të ulët përfitues/kontribues, nivel të ulët të pensioneve si dhe ndikohet nga plakja e popullsisë. Kështu që reformimi i sistemit të pensioneve është i paevitueshëm.
- Tregu i pensioneve private është një treg në zhvillim e sipër në Shqipëri, por me miratimin e ligjit të ri mbi fondet vullnetare private pritet të ketë një zhvillim akoma më të madh.
- Avantazhi i skemës së sigurimit vullnetar është mbështetja tek parimi i vetëkapitalizimit, i cili i garanton individit marrjen e kontributeve të derdhura dhe fitimin e ardhur nga investimi i tyre. Në këtë skemë nuk ka mbushje moshe dhe as vitesh pune, por çdo individ mund të marrë kontributin e vet në çdo kohë apo ta transferojë në një fond tjetër pensionesh. Krijon mundësinë e lehtësira fiskale dhe të ardhurave më të larta në periudhën e pleqërisë.
- Fondet private të pensionit përbëjnë një alternativë të mirë për përmirësimin e sistemit të pensioneve në Shqipëri dhe janë një fenomen më se i zakonshëm në vendet e zhvilluara, madje po zhvillohen mjaft dhe në vendet e rajonit. Efektet pozitive që sjellin janë të shumta si dhe kanë një sërë përparësish në raport me skemën shtetërore.
- Fondet private të pensionit ndikojnë në rritjen e kursimeve të popullsisë dhe sigurojnë një kanal të kalimit të fondeve nga subjektet që kursejnë tek ata që kanë nevojë për fonde, duke rritur kështu investimet.
- Gjithashtu fondet e pensionit mbështesin zhvillimin e tregjeve kapitale. Ata zvogëlojnë kostot e transaksioneve, përmirësojnë alokimin e fondeve, rrisin kursimet, duke sjellur efekte pozitive në

[338] http://www.sicred-pensions.com.al/Web/Terheqja_e_Parakohshme.php

rritjen dhe mirëqënien ekonomike, por gjithsesi këto efekte pozitive reduktohen në qoftë se nuk ka një situatë të kënaqshme makroekonomike të vendit. (Walker& Lefort, 2002)

- Gjithmonë duhet patur parasysh se qëllimi primar i një sistemi pensioni është të sigurojë të ardhura të qëndrueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të moshuarit, ndërkohë që implementohen në mënyrën e duhur dhe në përputhje me kushtet konkrete të vendit skemat që optimizojnë mirëqënien.

Rekomandime

- Një zhvillim tepër i rëndësishëm për tregun privat vullnetar të pensioneve do të ishte përfshirja në këto fonde i emigrantëve dhe për të nxitur pjesëmarrjen e tyre është i nevojshëm krijimi i lehtësirave për të komunikuar e afruar ndërmjetësit financiarë nëpërmjet lidhjeve të marrëveshjeve bilaterale me vendet ku është ky emigracion.
- Kontributet e anëtarëve mund të investohen nga fondi në mënyra të ndryshme, brenda vendit apo edhe në tregjet kapitale të huaja, në aksione e obligacione të firmave, ose mund të depozitohen në banka apo të investohen në asete të tjera. Por është esenciale që të diversifikohet portofoli i investimeve dhe të bëhet një vlerësim korrekt i riskut të instrumenteve e alternativave të ndryshme të investimit.
- Zhvillimi i mëtejshëm i tregut të pensioneve private është shumë i rëndësishëm për vendin, dhe duhet të shoqërohet dhe me hapa të tjerë. Nuk duhet harruar se një nga rolet e tyre është të sigurojnë një kanal të kalimit të fondeve nga ata që i kursejnë te ata që kanë nevojë për fonde, duke pasur kështu një impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

Bibliografia

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Raporte Statistikore mbi Tregun e Pensioneve Vullnetare, 2010.
Fabozzi, F. J. & Modigliani, F.(2013). Tregu I kapitaleve; Institucionet dhe instrumentet (Vol. 4), Mediaprint.
Hadëri, S. (2007). Paraja bankat dhe tregjet financiare. Shoqata e kerkimeve shkencore sociale-ekonomike (AGAFER) botimi, 3.
http://news.al/lajme/artikull/iden/390281/titulli/Pensionet-private-dhe-ligji-i-ri
http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/06/Doktoratura-Valbona-Gjini-Fakulteti-Ekonomik-Departamenti-i-Finances.pdf
http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Aktet_ligjorenenligjore/Projektudhezimi_i_tatimit_mbi_te_ardhurat_dhjetor_2014_(1).docx.
http://www.issh.gov.al/publikime/Broshura.pdf
http://www.minfin.gov.al/minfin/Reformimi_i_sistemit_te_pensioneve_kerkon_nje_pakt_te_gjere_politik_e_social_978_
http://www.sicred-pensions.com.al/
Kepi, F. (2007) Ja çduhet të dini për pensionet, Tiranë, Shtëpia Botuese ILAR, 2007, faqe 5-17
Ligji nr.10 197, date 10.12.2009. Për fondet e pensionit vullnetar.
Ligji nr. 7703, date 11.05.1993, ndryshuar me ligjin Nr. 9600, date 27.07.2006 për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë
Ligji nr.7961 datë 12.07 .1995, ndryshuar me ligjin nr.9125 datë 29.07 .2003.Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë.
Revista Ekonomike Monitor. (2010) Fondet e Pensioneve Private, në pritje të rritjes. Nr 422, fq 40.
Udhëzimi I Ministrave të Financave, nr.26, date 16.04.2009, I ndryshuar
Vendim nr. 1114, datë 30.07.2008, i Këshillit të Ministrave
VKM nr 415 ,datë 27.06.2012
VKM nr.445, datë 11.07.2012
Walker, E. & Lefort, F. (2002) Pension Reform and Capital Markets: Are there any links? Banka Botërore
www.issh.gov.al

DR. JULEJDA GËRXHI – STATUSI I NËPUNËSIT CIVIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, KONFORM STANDARTEVE EVROPIANE TË SHËRBIMIT CIVIL.

DR. JULEJDA GËRXHI
Fakulteti i Shkencave Politike–Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ALBANIA

Abstrakt

Ligji i ri "Për nëpunësin civil" në Republikën e Shqipërisë, në zbatim rigoroz të standarteve evropiane të funksionimit të shërbimit civil, ka sanksionuar statusin e nëpunësit civil, si nje korpus të drejtash dhe detyrimesh.
Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i statusit të nëpunësit civil në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pasi ato përbëjnë një balancim pushtetesh mes nëpunësit dhe institucionit të administratës publike. Mjeshtria e ligjvënsit në krijimin e kësaj barazpeshe normative ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësve civilë, qëndron pikërisht në garantimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit, por nga ana tjetër edhe garancinë e ruajtjes së figurës së nëpunësit civil gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
Në këto kushte të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë, përbëjnë elementet e një raporti kontraktual të punës, të lidhur mes nëpunësit civil, si punëmarrës, dhe institucionit të administratës publike, si punëdhënës. Por që një marrëdhënie pune të funksionojë më së miri, duhet që palët kontraktore, pra, punëdhënësi dhe punëmarrësi, t'i respektojnë me përpikëri të drejtat dhe detyrat e tyre, të cilat janë reciprocikisht të ndërsjella: të drejtës së njërës palë i përgjigjet detyrimi i palës tjetër dhe e kundërta.
Ashtu si marrëdhëniet e punës në përgjithësi, edhe nëpunësi civil gëzon të drejta dhe mbart detyrime, të cilët në momentin e nënshkrimit të aktit të emërimit të nëpunësit, e vendosin atë përballë sfidës së ruajtjes së raportit të qëndrueshëm të punës në administratën publike.

Fjalët Çelës: legjislacion, status, nëpunës civil, standart, administratë publike.

Hyrje

Tradita administrative ndryshon në varësi të kulturës së një vendi, por ekzistojnë dhe pikëpamje të përbashkëta për mënyrën se si nëpunësit civilë duhet t'i përmbushin detyrat e tyre në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe efikase. Megjithatë këto vlera mund të bien në kundërshtim me atë çka pritet. Për shembull, mbi shpinën e anëtarit të familjes, që është i punësuar në administratën publike, ushtrohet një presion i madh, sepse pritet që ai të kujdeset për familjarët e tjerë, edhe në rastet kur niveli i pagave me vështirësi arrin t'i përmbushë nevojat personale më të ngutshme të nëpunësit civil. Në kuadër të këtyre trysnive shfaqen disa situate, ku bëhet e vështirë marrja e vendimit të duhur, prandaj nëpunësit civil i duhet të zbatojë standartet që ai i njeh dhe i kupton e, mbi bazën e tyre, mund të realizojë vendimmarrjen e duhur.
Pjesa më e madhe e publikut, do të donte që nëpunësi civil të ishte i ndershëm dhe i respektuar për integritetin e tij personal (Hooligan, 2009). Ky pohim është i saktë dhe ofron pikënisje për një sistem menaxhimi të konsoliduar të shërbimit në administratën publike.
Në pamje të parë duket sikur ky pohim është garantues i gëzimit të statusit të nëpunësit civil, por përtej tij, ka shumë elementë që vendosin mirëfunksionimin e këtij statusi.
Sot në vendet e zhvilluara, por edhe në vendet në zhvillim, trysnitë mbi shërbimin civil vijnë për arsye të ndryshme, siç janë:

- ☑ delegimi i përgjegjësive, duke përfshirë përgjegjësitë financiare brenda organizmave të shërbimit publik;
- ☑ ndikimi që ushtron media ndaj nëpunësve civilë, duke i detyruar ata të shfaqin anën e tyre më negative, si rezultat i provokimeve që u janë bërë;

☑ gatishmëria në rritje e publikut për t'u ankuar, kur cilësia e shërbimit të ofruar është e ulët.

Të gjitha këto arsye kanë kontribuar për rritjen e ndërgjegjshmërisë në lidhje me nevojën për të ndërmarrë hapa në konsolidimin e të drejtave dhe detyrimeve, mbi të cilët do të funksionojë marrëdhënia e punës së nëpunësit civil në administratën publike.

Shumë vendeve në tranzicion u është dashur të përballen me skeletin e trashëguar të një shërbimi civil të demoralizuar dhe keqfunksional, shpesh të keqpaguar apo të mospaguar, duke realizuar një mbijetesë me çfarëdo që mund të zhvatë nga populli për shërbimet që ofron. (Ongaro, 2010)
Por sot reformat në fushën e administratës publike, po synojnë gjithmonë e më tepër, përfshirjen e një delegimi më të madh të përgjegjësive, dhe liri veprimi më të madhe për nëpunësit civilë, trysni buxhetore dhe forma të reja të shpërndarjes së shërbimeve publike, të cilat po i sfidojnë vlerat tradicionale të shërbimit publik.
Proçesi i menaxhimit të shërbimit modern civil ka zgjeruar hapësirën e lirisë së veprimit në shumë fusha. (Report of Center for European Reform, 2013)

Bazuar në rekomandimet e Avokatit të Popullit Evropian (Ombudsman, 2012), 5 parimet që duhet të udhëheqin statusin e nëpunësit civil, parashikuar në legjislacionin e shërbimit civil të vendeve të BE-së, por edhe të shteteve që aspirojnë të jenë pjesë e saj, janë:
1→Angazhimi ndaj BE-së dhe shtetasve të tij
2→Integriteti
3→Objektiviteti
4→Respekti për të tjerët
5→Transparenca.

Në fushën e rregullimit ligjor të marrdhënieve të punës në shërbimin civil, debati zhvillohet në gjetjen e balancës së duhur mes sigurisë juridike të imponuar nga e drejta administrative dhe nevojës për fleksibilitet menaxherial, për të shmangur fragmentimin e rregullimit të marrëdhënieve të punës në favor të detyrimeve, dhe anashkalimit të të drejtave të nëpunësit civil.

Të drejtat e nëpunësit civil sipas legjislacionit shqiptar.

Shqipëria është një shtet, me një administratë të vogël publike dhe një numër të kufizuar të nëpunësve civilë, (pavarësisht se ligji i ri "Për nëpunësin civil", e zgjeroi fushën e veprimit të tij), dhe kjo parashikohet të jetë fizionomia e saj edhe për të ardhmen.
Gjithësesi administrata publike shqiptare është duke kaluar nëpër reforma dinamike në rrugën drejt integrimit evropian.

Një ndër zhvillimet më pozitive në reformat e kërkuara nga BE që ka patur Shqipëria këto vitet e fundit në kuadër të shërbimit civil, ishte miratimi me konsensus të gjerë politik i Ligjit Nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", implemetimi i të cilët duket se është në rrugë të mbarë, pavarësisht kohës së shkurtër të vënies së tij në zbatim.
Në kreun e shtatë të ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil"(i ndryshuar), janë parashikuar të drejtat e nëpunësit civil, të cilat garantojnë statusin e tij gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Neni 33 i ligjit ka garantuar të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës dhe mbrojtjen nga shteti në kryerjen e detyrave. Nëpunësi civil ka të drejtën për kushte pune të përshtatshme, që sigurojnë mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe dinjitetit të tij. (neni 33 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"). Autoriteti publik ka detyrimin ligjor të vendos në dispozicion të nëpunësit të gjithë bazën infrastrukturore të posaçme, në funksion të kryerjes së një shërbimi efiçient. Ofrimi i shërbimit nga ana e nëpunësit lidhet me veprimtarinë intelektuale të punës së tij, prandaj paraqet domosdoshmëri baza logjistike e nevojshme, për një rezultat sa më cilësor dhe të pranueshëm nga konsumatori i shërbimit. Gjithashtu nëpunësi civil mbrohet nga shteti në ushtrimin e detyrave të tij në shërbimin civil, duke kërkuar edhe mbështetjen e institucioneve të specializuara, nëse është e nevojshme. Nëpunësi civil gëzon të drejtën e mbrojtjes, në qoftë se atij drejtpërsëdrejti i janë bërë kërcënime,

sulme apo edhe veprime të tjera të ngjashme me to lidhur me kryerjen e detyrave zyrtare. Në raste të tilla, me qëllim ruajtjen e personalitetit të tyre dhe vazhdimësinë në kryerjen e detyrës, shteti është i detyruar që t'u siguroje këtyre nëpunësve një mbrojtje të veçantë.

Marrëdhëniet juridike të punës përgjithësisht, por edhe në veçanti në shërbimin civil, bazohen në binomin shërbim-shpërblim. Është e drejta e përfitimit të pagës së punës dhe e shpërblimeve të tjera, ajo që garanton mirëqënien financiare të nëpunësit civil. Por gjithashtu është edhe motivimi për të kryer me korrektesë shërbimin për të cilin ai është kontraktuar.
Neni 34 i ligjit, sanksionon se nëpunësi civil ka të drejtën e pagës për ushtrimin e detyrës në shërbimin civil.

Figura 1. Paga e punës së nëpunësit civil është e organizuar sipas kësaj strukture



E drejta e antarësimit në sindikata dhe shoqatat profesionale, përveçse një e drejtë kushtetuese, është edhe e drejtë e garantuar nga neni 36 i ligjit. Neni 50 i Kushtetutës së RSH, përcakton organizimin e lirë sindikal, duke garantuar një mbrojtje kolektive të marrëdhënieve juridike të punës së nëpunësit civil. Çdo nëpunës ka të drejtën të marrë inisiativën e themelimit të organizatës sindikaliste ose të aderojë në sindikata, që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tyre në shërbimin civil (neni 36 ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil").

Organizatat sindikale luajnë një rol të rëndësishëm dhe janë pjesë aktive në vendimarrjen në lidhje me kushtet e punës, të realizuara në çdo institucion të përfshirë në shërbimin civil, çka do të thotë, që bashkëpunimi produktiv institucional nuk provokon inisiativa antiligjore të cilat sjellin destabilitet.
Sipas kësaj logjike askush nuk ka të drejtë të kushtëzojë lirinë e nëpunësit për të qënë ose jo anatar i një sindikatë të krijuar në bazë të ligjit, por nga ana tjetër askush nuk mund të cënoje apo dëmtojë nëpunësin për shkak të antarësimit të tij, ose jo në një sindikatë ose pjesëmarrjes së tij në një veprimtari sindikale në respektim të legjislacionit në fuqi. Organizimi në sindikata i jep nëpunësit civil mundësinë e përmbushjes së kërkesave në lidhje me marrëdhënien juridike të punës. Nëpunësi civil ka të drejtën të konsultohet nëpërmjet sindikatave apo shoqatave profesionale të nëpunësve civilë të institucionit, në vendimmarrjen për aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me marrëdhënien e punës në shërbimin civil. (neni 39 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"). Çdo nëpunës civil ka të drejtë të zgjidhet në organet drejtuese të sindikatës dhe të ushtrojë komptencat jashtë orarit zyrtar, por këtë të drejtë nuk e kanë antarët e trupës së nivelit të lartë drejtues (TND).
Pjesëmarrja në organet drejtuese sindikale nuk është e detyrueshme për nëpunësin civil.
Përderisa kjo është një e drejtë e parashikuar në ligjin material, është zgjedhja e lirë e çdo nëpunësi, nëse do të bëhet pjesë e organizmit sindikalist apo jo.

E drejta e grevës është parashikuar në nenin 51 të Kushtetutës, dhe i lejohet të gjithë të punësuarve, në lidhje me pretendimet që ata kanë nga marrëdhënia juridike e punës. Pjesëmarrja nëpërmjet sindikatave ose përfaqësuesve të tyre, në proçesin e marrjes së vendimeve lidhur me kushtet e punës, apo edhe pretendime që lidhen me kontratën e punës, mundëson të drejtën për të bërë grevë. Ligji i ri

nuk i privon nëpunësit civilë nga e drejta e tyre për të kërkuar kushte më të mira pune dhe për t'i realizuar pretendimet e tyre nëpërmjet të drejtës së grevës. Por kjo e drejtë është e ndaluar në disa fusha, (neni 35 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"), që përfshijnë shërbimet emergjente si transporti, furnizimi me ujë dhe energji elektrike, administrata e burgjeve, e sistemit të drejtësisë, shërbimet kombëtare, të mbrojtjes, shërbimet shëndetësore urgjente, shërbimet për furnizime me ushqime, shërbimet e kontrollit të trafikut ajror dhe detar. Kufizimi i kësaj të drejte konform ligjit "Për nëpunësin civil"është bërë në respektim të nenit 17 të Kushtetutës, i cili përcakton kufizimin e të drejtave të sanksionuara me ligj për interes publik, ose për mbrojtjen e interesave të të tjerëve.
Qëllimi i ndalimit për të bërë grevë për nëpunësit civil të punësuar në shërbimet emergjente, lidhet me rëndësinë e pozicionit të punës që ata kanë dhe me mirëfunksionimin total të strukturave të administratës publike. Detyrimi për të mos bërë grevë nuk i mohon të drejtën këtyre nëpunësve për të kërkuar zgjidhje për problematikat që ata kanë në lidhje me marrëdhënien juridike të punës.

Të drejtat politike
Kjo e drejtë bazohet në Kushtetutë (neni 46), ku parashikohet se kushdo ka të drejtë që të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllim të ligjshëm, dhe për asnjë arsye një e drejtë e tillë nuk mund të kufizohet dhe si rrjedhim as për faktin e të qënurit nëpunës civil.
Por edhe pse antarësimi në parti politike përbën një të drejtë kushtetuese nuk mund të përdoret edhe për të justifikuar pjesëmarrjen e nëpunësit në strukturat drejtuese të tyre, (Anastasi, 2008) pasi do të sillte disa pasoja negative gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar, për shkak të detyrimeve politike. Angazhimi në strukturat drejtuese të një partie politike do të kërkonte një angazhim mendor dhe fizik nga ana e nëpunësit duke penguar ushtrimin e funksioneve zyrtare, e duke sjellë kështu shkeljen e detyrimeve të marra përsipër në momentin e nënshkrimit të vendimit për fitimin e statusit të nëpunësit civil. Në pikëpamje konceptuale interpretimi kushtetues i përpunuar në ligjin "Për nëpunësin civil", (neni 37), përcakton së nëpunësi ka të drejtë të jetë anëtar i një partie politike, të jetë aktiv politikisht si individ, por me kushtin që të mos jetë i zgjedhur në organet qendrore ekzekutive të partisë, dhe këto veprimtari politike t'i zhvillojë pa i përzjerë me ushtrimin e detyrave zyrtare në shërbimin ndaj publikut. Këtë të drejtë nuk e kanë antarët e TND.

Pra teorikisht ekziston parimi i asnjanësisë politike në kryerjen e punëve zyrtare të nëpunësit civil. Asnjanësia politike gjatë ushtrimit të funksionit të nëpunësit në një kuptim ideal, do të ishte depolitizimi i nëpunësit, duke bërë që ky i fundit t'i kryejë detyrat e veta pa pasion politik dhe pa urrejtje. Por sipas legjislacionit tonë ky idealizëm nuk mund të realizohet pasi vetë norma juridike lejon antarësimin e nëpunësit në parti politike, apo pjesëmarrjen në veprimtari politike.
Por gjithësesi zbatimi i saj në praktikë shfaq edhe kufizime të tilla:
⌦ duke qënë anëtar i një partie politike nëpunësi civil nuk duhet të vërë në dyshim statusin e tij dhe as kryerjen e detyrave zyrtare që rezultojnë nga ky status;
⌦ duke qënë anëtar i partisë politike nëpunësi nuk mund të marrë pjesë në fushatat elektorale gjatë kohës së tij të punës;
⌦ nëpunësi civil nuk mund të propogandojë simbolet e partisë ku aderon në ambientet e tij të punës, si dhe të shprehë bindjet dhe preferencat e tij politike publikisht.
Në kuadër të të drejtave politike, krahas të drejtës aktive për të zgjedhur, nëpunësi civil gëzon dhe të drejtën pasive për t'u zgjedhur në zgjedhjet e përgjithshme apo ato vendore. Në këtë rast nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra.

E drejta e formimit profesional.
Nëpunësit civil kanë të drejtë të trajnohen në lidhje me punën, në mënyrë periodike dhe të paguar nga fondet publike, donatorë të huaj apo të ardhura vetjake. Formimi profesional i nëpunësit civil, përfshin programin e formimit të thelluar të kandidatëve për kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), anëtarë të trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, dhe programin e formimit të vazhdueshëm të nëpunësve civilë. Formimi i vazhdueshëm profesional është një ndër pikat më të rëndësishme të politikave të punësimit, pasi nëpunësi që e ka fituar këtë status, profesionalizohet në ecurinë e funksionit që ai kryhen duke përdorur metodat më të mira në realizimin e produktit. Institucionet e administratës publike janë të detyruara që t'u ofrojnë nëpunësve trajnime të përgjithëshme dhe të veçanta, në përputhje me pozicionin e punës.

Detyrimi i ofrimit të trajnimeve i është ngarkuar Shkollës së Administratës Publike (ASPA), por me amendimin e fundit të ligjit "Për nëpunësin civil", (Ligji nr.178/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin rr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil") përgjegjësia i është ngarkuar edhe Departamentit të Administratës Publike (DAP), në hartimin e politikave të trajnimit, duke mbajtur parasysh zhvillimet e legjislacionit dhe politikat shtetërore. Parashikohet që në përcaktimin e politikave të përzgjedhjes dhe të formimit, ASPA detyrohet të bashkëpunojë me DAP-in, duke marrë në konsideratë rekomandimet e miratuara prej tij, si njësia e ngarkuar për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil.

E Drejta e Informimit dhe Ankimit.
Nëpunësi civil ka të drejtë të informohet për fillimin e çdo proçedimi administrativ dhe për çdo vendim që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij në shërbimin civil.
Proçedimi administrativ duhet të kryhet në përputhje të plotë me parimin kushtetues të një proçesi të rregullt ligjor, sipas të cilit nëpunësi i proçeduar duhet të informohet mbi çështjet objekt proçedimi, por gjithashtu mbi bazën e parimit të verbalitetit dhe kontraditoritetit, ai ka të drejtën e "dyluftimit", për të pasqyruar kështu edhe realitetin objektiv sipas pretendimeve të tij.
Gjithashtu nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative ndaj çdo veprimi ose mosveprimi që i cënon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme gjatë ushtrimit të detyrave në shërbimin civil.
Në kuadrin e kësaj te drejte, nëpunësi civil lejohet të kontrollojë dosjen e tij personale pranë drejtorisë së burimeve njërëzore dhe në çdo kohë mund të kërkojë rinovimin e të dhënave të saj, pas ndryshimeve të ndodhura në jetën profesionale të nëpunësit.

Punësimi dhe ushtrimi i veprimtarive të tjera të ligjshme (veprimari të jashtme), jashtë detyrës dhe kohës së punës, në qoftë se një gjë e tillë nuk paraqet konflikt interesi me detyrën e tyre zyrtare dhe nuk i pengon ato në ushtrimin e saj.

Veprimtaria e jashtme (dytësore) e nëpunësit nënkupton të gjitha rastet e kryerjes së një veprimtarie të dytë nga ana e tij, e cila i sjell të ardhura. (Gérxhi, 2009)
Veprimtaritë e jashtme ose dypunësimi janë përgjithësisht të lejuara, por duke respektuar këto kufizime:
- ⌦ nëpunësi civil nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, e cila e pengon në kryrjen e detyrës zyrtare, ose që kërkon një agazhim mendor apo fizik nga ana e tij;
- ⌦ nëpunësi nuk mund të angazhohet në veprimtari të jashtme, qëllimi i aktivitetit të të cilave bie ndesh me detyrën e tij zyrtare apo me qëllimin e saj;
- ⌦ nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues nuk duhet që të zotërojnë aksione apo të jenë antarë të organeve drejtuese në një shoqëri tregtare ose OJF. Gjthashtu ata e kanë të ndaluar të ushtrojnë veprimtari private, që krijojnë të ardhura në formën e personave fizikë tregtare, apo çdo formë ortakerie.

Përveç këtyre kufizimeve nëpunësit civil kanë të drejtë të punësohen ose të vetëpunësohen, por pa prekur kohën e punës në shërbimin civil, si dhe pa patur konflikt interesi me pozicionin që ata kanë në shërbimin civil.

Detyrimet e nëpunësit civil sipas legjislacionit shqiptar.

Integriteti publik i qeverisjes është një premisë themelore, e cila reflektohet në shumë Kushtetuta në mbarë globin. Rëndësia e kësaj premise është shtjelluar në mënyrë të shkëlqyer në Kodin e Sjelljes Zyrtare të Senatit të SHBA:"Koncepti ideal i detyrës publike, i shprehur me fjalët 'Një detyrë publike është një besim publik', do të thotë që zyrtarit i është dhënë një besim publik nga populli; zyrtari duhet t'a ushtrojë këtë pushtet vetëm në të mirë të popullit dhe asnjëherë për përfitimin e tij ose të disa personave të tjerë dhe, zyrtari nuk duhet të drejtojë asnjëherë punët e tij në mënyrë të tillë që të dëmtojë besimin publik".

Një nëpunës pa integritet nuk mund të përmbushë detyrën e tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. i nisur nga interesa të tij personale, apo duke qenë nën presionin e individëve apo grupeve të tjerë, si

rrjedhojë e mungesës së integritetit, ai nuk do të jetë në gjëndje që të kryejë detyrën e tij në interes të të gjithë shoqërisë. Veprime të tilla të individëve të veshur me pushtetin e të qeverisurit, do të çojnë në humbjen e integritetit publik të të gjithë qeverisjes dhe, si rrjedhim, në shkeljen e besimit publik.
Në këtë kuadër vendosja e detyrimeve për nëpunësin civil është një rekuizitë, e cila e vendos nëpunësin nën presionin e vazhdueshëm të përgjegjshmërisë, korrektesës dhe efiçensës, në ushtrimin e detyrave publike. Detyrimet e nëpunësit civil janë të sanksionuara në ligjin "Për nëpunësit civil". Sipas këtij ligji nëpunësi civil ka këto detyra:

Detyrimi i respektimit të ligjit.
Nëpunësi civil detyrohet të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën, me Kodin e Proçedurave Administrative dhe me akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Parimi i ligjshmërisë ka të bëjë me realizimin e kompetencave në përputhje me ligjin, gjë që kërkon në rradhë të parë njohjen e tij të plotë nga ana e nëpunësit, dhe zbatimit të tij sipas situatave që i paraqiten për zgjidhje. (neni 42 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil")
Për këtë qëllim kandidatët për hyrjen në shërbimin civil, testohen për njohuritë e tyre në fushën e të drejtës kushtetuese, administrative dhe të nëpunësit civil. (Dobiani.E, 2003)

Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe refuzimit të urdhrave të paligjshëm.
Ligji "Për nëpunësin civil", ka parashikuar situatën kur realisht paraqitet konflikti ndërmjet parimit të organizimit dhe funksionimit të shërbimit, dhe parimit universal të ligjshmërisë që duhet të respektohet dhe të zbatohet nga të gjithë nëpunësit civil, prej nivelit më të ulët, deri në trupën e nivelit më të lartë drejtues të shërbimit civil. Nëpunësi civil detyrohet të mbajë përgjegjësi të plotë për paligjshmërinë e veprimeve të tij gjatë kryerjes së detyrës. (neni 43 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil")

Ai ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marra nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të institucionit. Nëse nëpunësi civil nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe vendimeve të marra nga eprorët, ai nuk i zbaton, por njofton eprorin që ka nxjerrë urdhrin ose vendimin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.

Ligji me zgjidhjen që jep për të vepruar në rast urdhërash të paligjshëm nga eprorët, në thelb e konfirmon përparësinë e parimit të ligjshmërisë dhe domethënien ekskluzive të saj për funksionimin e sistemit të shërbimit civil, duke i garantuar mbrojtje nëpunësit "të pabindur" ndaj urdhrave të paligjshëm. Ky moment është shumë i rëndësishëm po të kemi parasysh presionet në të cilat është i detyruar të punojë një nëpunës në raste të caktuara.
Qëllimi i ligjvënësit ka qënë që këtë detyrim të mos e vendosë tek të drejtat e nëpunësit, por tek detyrat e tij, me qëllim që ky i fundit të jetë i detyruar të kundërshtojë zbatimin e një urdhëri i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Detyrimi i transparencës dhe konfidencialitetit.
Nëpunësi civil detyrohet të sigurojë për publikun e gjerë, për palët e interesuara dhe institucionet publike, informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur ky informacion është sekret shtetëror, konfidencial ose për përdorim të brendshëm në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore. (neni 44 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil")

Kjo detyrë rrjedh nga zbatimi i parimit të transparencës me publikun.dhe ka të bëjë me faktin që nëpunësi civil ka për detyrë që në përputhje me ligjin në bazë të kërkesave të qytetarëve të japë informata për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre, kuptohet përvec informacionit të rezervuar që përbën sekret shtetëror. Përcaktimi i këtij detyrimi ka të bëjë me shmangien e konceptit burokratik tradicional të mbyllur, i cili pas perdes së sekretit zyrtar dhe shtetëror, fshihte mbrojtjen e burokracisë nga përgjegjësia për veprimet dhe vendimet e saj. (Butcher, 2011)
Transparenca e administratës ndaj publikut tregon në të njëjtën kohë edhe marrjen përsipër të një doze të madhe të përgjegjësisë, dhe mundësinë më të madhe të mbikqyrjes së punës së shërbimit civil nga shoqëria. Për shkak të këtij detyrimi, nëpunësi civil duhet të respektojë kërkesat e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në bazë të të cilit përcaktohet detyrueshmëria e krijimit të lehtësirave

strukturore dhe praktike, për marrjen nga ana e publikut në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme dhe të shpejtë të informacionit të kërkuar. Ai ka detyrimin e mbrojtjes dhe të mospërhapjes së të dhënave vetjake, që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të cilëve u ofrohet shërbimi.

Konflikti i interesit dhe deklarimi i interesave dhe pasurisë.
Konflikti i interesave është i përkufizuar si situata, në të cilën një nëpunës i administratës publike ka një interes personal, të tillë që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë apo objektivitetin e kryerjes së detyrës së tij zyrtare. Por përkufizimi për konfliktin e interesave është një çështje problematike.

Një vështirësi e tillë është e paevitueshme për vetë natyrën e konfliktit të interesit. Në këtë pikë, Kernaghan dhe Langford kanë patur plotësisht të drejtë kur pohonin se:"Është e rëndësishme që të njihen edhe konfliktet në dukje dhe konfliktet potencialë të interesit, të cilët e bëjnë përkufizimin e konfliktit të interesit shumë të gjërë (të papërcaktuar), dhe ndoshta edhe të padrejtë". (Langford)
Ndonëse përkufizimi i konfliktit të interesit mund të jetë shumë i gjerë, dhe deri diku edhe i padrejtë (gjatë zbatimit në praktikë të rregullave të shmangies dhe zgjidhjes së konflikteve të interesit, mund të ketë edhe raste të shkeljeve të të drejtave individuale të nëpunësve civilë), pasojat e konflikteve të tilla janë shumë të rënda, dhe ndikojnë direkt në besimin dhe konfidencën e publikut në integritetin e nëpunësve civilë dhe në qeverisjen e vendit.
Janë pikërisht pasoja të tilla të cilat e bëjnë të domosdoshëm përkufizimin edhe të konflikteve në dukje, dhe atyre potenciale të interesit, me qëllim shmangien ose minimizimin e situatave të tilla në veprimtarinë e nëpunësve civilë në administratën publike. (Young, 19.12.2003)

Konflikti i interesave, (Conflict of interest and public sector interests. British Columbia Cases, comparative perspectives, June 1991), përveç faktit që ndikon në një proçedurë vendimarrëse të caktuar, duke cënuar të drejtat e të tretëve, ka një efekt shumë negativ në besueshmërinë e institucionit dhe të procedurave që ai është i ngarkuar të kryejë. Është shumë e vështirë që të fitosh besimin e publikut, por është shumë e lehtë ta humbasësh shpejt atë. Humbja e besimit të publikut mund të shkaktojë pakënaqësi sociale dhe një reaksion zinxhir në institucione të tjera ku punojnë njërëzit e zhgënjyer. Konflikti i interesit nuk duhet parë dhe as duhet kërkuar vetëm tek TND, por edhe tek nëpunësit e thjeshtë, të cilët janë të angazhuar çdo ditë në pozicionet e tyre të punës. Qëllimi i këtij rregullimi është garantimi i një vendimarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta. (neni 46 dhe 47 i ligjit nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil")



Përfundime dhe rekomandime

Shërbimi civil që të funksionojë me sukses, duhet të ketë mbështetjen e publikut. Të gjithë nëpunësit civilë kanë një përgjegjësi të vazhdueshme të promovojnë një kuptim më të mirë të objektivave dhe të punojnë me përkushtim. Kjo kërkon që ata të jenë të informuar mirë për arritjet jo vetëm të institucionit ku punojnë, por edhe shërbimin civil në tërësi, për ti dhënë informacion publikut në çdo kohë.
Koncepti i integritetit i mishëruar në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe adoptuar nga legjislacioni shqiptar, përfshin të gjitha aspektet e sjelljes së një nëpunësi civil, duke përfshirë edhe cilësi të tilla si ndershmëria, sinqeriteti, paanshmëria dhe moskorruptimi.
Toleranca dhe mirëkuptimi janë vlera themelore, por edhe thelbësore për nëpunësit civilë, të cilët duhet të respektojnë të gjithë individët në mënyrë të barabartë, pa asnjë lloj diskriminimi. Ky respekt nxit një klimë dhe një mjedis pune të ndjeshëm për nevojat e të gjithëve.
Paanësia në përmbajtjen e shërbimit, veçanërisht në trajtimin politik, është një ndër vlerat e shërbimit civil. Kjo cilësi nuk cënon pikëpamjet personale politike ose perspektivat kombëtare, të nëpunësve civilë, të cilat mbeten të paprekura. Gjithësesi ata nuk e kanë lirinë e personave privatë për të shprehur pikëpamjet e tyre publikisht në ambientet e punës, për çështje të debatueshme, qoftë individualisht ose si anëtarë të një grupi. Kjo do të thotë se, në situata të caktuara, pikëpamjet personale duhet të shprehen vetëm me takt dhe maturi, jashtë kontekstit të shërbimit civil.
Liria nga diskriminimi është një e drejtë themelore e shërbimit civil. Nëpunësit civil duhet të priren drejt respektimit të barazisë pa asnjë dallim. Supozimet në bazë të stereotipeve duhet të shmangen me këmbëngulje.
Një nga parimet kryesore të Kartës së OKB-s është barazia e burrave dhe grave, në funksion të promovimit të barazisë gjinore. Liria nga diskriminimi nënkupton edhe respektin ndaj modeleve të ndryshme kulturore. Kjo kërkon një vullnet për të punuar pa paragjykime me persona të të gjitha kombësive, feve dhe kulturave, çka do të thotë, shmangie skurupuloze të çdo shprehje që mund të interpretohet si e njëanshme apo intolerante. Metodat e punës mund të jenë të ndryshme në kultura të ndryshme, por ato nuk mund të jenë të paragjykuara, përsa kohë respektojnë rregullat e përgjithshme dhe specifike.
Besnikëria ndaj shërbimit civil siguron integritet dhe opinion pozitiv, se nëpunësit civilë do të vendosin interesat e përgjithshme ndaj interesave personale, pavarësisht tundimeve të çastit. Kjo do të thotë gjithashtu përdorim i burimeve të shërbimit civil në mënyrë të përgjegjshme.
Respektimi i modeleve më të mira të meritokracisë nxit respektimin e standarteve më të larta të sjelljes. Nëse nuk funksionon ky parim, do të shfaqen sjellje të pahijshme për të kërkuar favore, dhurata apo kredi nga stafet e tyre, të cilët do të jenë nën presionin e humbjes së vëndit të punës, çka do të cënojë edhe cilësinë e shërbimit civil. Proçedurat e vendimarrjes nga ana e menaxherëve apo mbikqyrësve të shërbimit civil, duhet të jenë transparente, pasi kështu ata vendosin ura komunikimi efektive me stafet e tyre. Vetëm në këto kushte, nëpunësit civilë ndjejnë një përgjegjësi reciproke për të siguruar të gjitha faktet dhe informacionet për mbikëqyrësit e tyre, në mbrojtje të vendimeve të marra, madje edhe kur këto nuk përputhen me bindjet e tyre personale profesionale.
Nëpunësit civilë duhet të mbeten të pavarur nga çdo autoritet jashtë institucionit të tyre, dhe vetë sjellja e tyre duhet të pasqyrojë atë pavarësi. Në përputhje me besnikërinë e detyrës së tyre, ata nuk duhet të pranojnë udhëzime nga asnjë subjekt jashtë organizatës së tyre të punësimit. Nëpunësit civilë duhet të ndjekin udhëzimet që ata marrin në lidhje me funksionet e tyre zyrtare, dhe në qoftë se ata kanë dyshime nëse një udhëzim bie ndesh me ligjin ose rregullin, së pari duhet të konsultohen me mbikëqyrësit e tyre. Nëse nuk gjejnë konsensus, mund të kërkojnë me shkrim udhëzimet, të cilat mund të kundërshtohen me anë të mekanizmave të duhur institucionalë. Kjo mënyrë funksionon për udhëzimet që janë qartazi në kundërshtim me funksionet e tyre zyrtare apo që kërcënojnë sigurinë e tyre ose të të tjerëve. Ata duhet të raportojnë çdo shkelje të rregullave nga një zyrtar i nivelit të lartë, përgjegjësia e të cilit është për të marrë masat e duhura. Një nëpunës civil, i cili bën një raport të tillë në të mirë të institucionit dhe publikut, ka të drejtë të jetë i mbrojtur kundër hakmarrjeve apo sanksioneve subjektive të zyrtarit të lartë, shkelës të rregullave.
Konflikti i interesave përbën një sfidë në standartet e sjelljes së nëpunësve civilë. Konflikti i interesit përfshin rrethanat në të cilat nëpunësi civil, direkt ose indirekt, krijon për të përfituar vetë në mënyrë të paligjshme, ose të lejojë një palë të tretë për të përfituar në mënyrë të paligjshme. Nëpunësit civil

duhet të shmangin ndihmën e organeve private ose personave privatë në marrëdhëniet mes tyre, kur kjo mund të çojë në trajtime preferenciale të perceptuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e prokurimit publik, ose në negociatat për punësim të ardhshëm. Për të parandaluar raste konfliktesh, nëpunësit civilë vullnetarisht duhet të bëjnë të ditur paraprakisht konfliktet e mundshme të interesit që lindin gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ata duhet ti kryejnë detyrat e tyre zyrtare dhe punët e tyre private në një mënyrë që të mos cënohet besimi i publikut në integritetin e tyre personal dhe institucional.

Liria e organizimit është një e drejtë themelore e njeriut, dhe nëpunësit civilë kanë të drejtë të formojnë sindikata apo grupime të tjera profesionale që promovojnë dhe mbrojnë interesat e tyre. Marrëdhëniet mes eprorit të drejtëpërdrejtë dhe stafit duhet të udhëhiqen nga respekti reciprok. Përfaqësuesit e zgjedhur të nëpunësve civilë, kanë një rol kardinal në mbrojtjen e të drejtës për kushte të mira pune, si dhe në të gjitha çështjet e mirëqenies së stafit.

Përfaqësuesit e zgjedhur të nëpunësve civilë, gëzojnë të drejtat që burojnë nga statusi i tyre, dhe kjo mund të përfshijë mundësinë për të adresuar organet legjislative të organizatës së tyre. Këto të drejta duhet të ushtrohet në një mënyrë që është në përputhje me legjislacionin e brendshëm si dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Konfidencialiteti është një ndër parimet e rëndësishme në shërbimin civil. Zbulimi i informatave konfidenciale mund të rrezikojë seriozisht efikasitetin dhe besueshmërinë e një institucioni. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për ushtrimin e diskrecionit në të gjitha çështjet zyrtare. Ata nuk duhet të zbulojnë informacione konfidenciale pa autorizim, madje nuk duhet të përdorin informacione që nuk janë bërë publike, dhe pse janë njohur me të për shkak të pozitës së tyre zyrtare.

Obligimi kryesor i nëpunësve civilë është që të përkushtohen me të gjitha energjitë profesionale brënda institucionit të tyre, dhe çdo angazhim në veprimtari të jashtme, me ose pa shpërblim, pa autorizim paraprak të institucionit përgjegjës përbën shkelje disiplinore.

Në rast se institucioni e shikon të arsyeshëm angazhimin jashtë tij, në aktivitetet profesionale që shërbejnë per të ruajtur dhe për të përmirësuar kompetencat teknike të nëpunësit civil, i lejon dhe i inkurajon ata për rritje profesionale.

Nëpunësit civilë që të quhen pjesë e këtij sistemi duhet të jenë të angazhuar për vlerat, parimet dhe standartet e përcaktuara ndërkombtarisht. Ata duhet të kenë një qasje pozitive dhe aktive në respektimin e tyre, dhe duhet të ndjehen përgjegjës për të kontribuar ndaj idealeve, në të cilët ata duhet të përfshihen me përkushtim. Që këto standarte të zbatohen në mënyrë efektive, është thelbësore që ata të jenë gjerësisht të njohur, dhe të merren masa për të siguruar se fushëveprimi dhe rëndësia e tyre janë kuptuar si duhet për aplikim.

Respektimi i këtyre standarteve siguron se shërbimi civil do të vazhdojë të jetë një instrument efektiv në përmbushjen e përgjegjësive të veta, dhe në përmbushjen e aspiratave të publikut në mbarë botën.

Bibliography

Anastasi, A. (2008). ”E Drejta Kushtetuese”. Tiranë.

Butcher, T. a. (2011). ‘Modernising civil services’, Public Policy and Administration, 16(3), 1–3.

(June 1991). Conflict of interest and public sector interests. British Columbia Cases, comparative perspectives. Publikim i British Columbia Civil Association, http://www.bccla.org/positions/political/91conflictinterest.html.

Dobiani, E. (2003). "E Drejta Administrative“. Tiranë: SHBLU.

Gérxhi, J. (2009). "Marrédhéniet juridike té punés pér népunésin civil". Tirané: SHBLU.

Hooligan, J. (2009). ‘Models of public administration and neë roles of the state: exploring contradictions and patterns of change’, paper for the panel Theoretical Perspectives on Government Organizations, European Consortium for Political Research, General Conference, 0-12 September, Potsdam.

Langford, K. &. “The Responsible Public Servant”, fq 138.

Ligji nr 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”. tetor 2013.

Ligji nr.178/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin rr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

Ombudsman, E. (2012). Public service principles for the EU civil service,. European Ombudsman.

Ongaro, E. a. (2010). ‘Réforme de la fonction publique et introduction de la rémunération liée aux performances en Italie: évidence empirique, interprétations et en seignements’. Revue Française d’Administration Publique, 132, 817–39.
(2013). Report of Center for European Reform.
Young, M. (19.12.2003). “Conflict of interest rules for federal legislators” . Parliamentary Information and Research Service, Canada; http://www.parl.gc.ca/information/library/PRBpubs/bp793-e.htm.

Prof.Dr.FATMIRE LUMANI – UNIVERSITETI SHTETËROR I TETOVËS

MBIKQYRJA, ORGANET KOMPETENTE PËR KRYERJEN E MBIKQYRJES (KONTROLLIT) DHE AKTET E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Prof.Dr.FATMIRE LUMANI – FQ 434

Universiteti Shtetëror i Tetovës

ABSTRACT

The paper "Monitoring, competent authorities for carrying out surveillance (control) and acts of state administration bodies" includes a scientific research becomes legal regulations, in particular acts of state administration bodies, as well as the competent bodies that carry out supervision over the work of the state administration bodies.

Supervision is an activity which consists of: monitoring, control, evaluation of compatibility of acts, activities, behavior rules and regulations adopted. The main purpose of supervision (control) is the protection and realization of the principle of legality.

In the paper the methodology used specific legal (normative) research.

In the legislative field surveillance, the competent authorities to conduct surveillance and acts of state administration bodies, there is an administrative unique code, so the status and activity of organs administarive regulated by different laws. As a result, it is known to have legislation, but not codified. As a result, there is a need for legislation to codify in a unique code, which would be obvious and would be offered to entities in need.

Keywords: Surveillance; authorities to conduct surveillance; administrative acts;

ABSTRAKT

Punimi “Mbikqyrja, organet kompetente për kryerjen e mbikqyrjes (kontrollit) dhe aktet e organeve të administratës shtetërore” përfshin një hulumtim shkencor që i bëhet rregullativës ligjore, në veçanti akteve të organeve të administratës shtetërore, si dhe organeve kompetente që kryejnë mbikqyrje mbi punën e organeve të administratës shtetërore.

Mbikqyrja është veprimtari e cila përbëhet nga: përcjellja, kontrolli, vlerësimi i pajtueshmërise së akteve, veprimtaria, sjellja me rregullat dhe dispozitat e miratuara. Qëllimi kryesor i mbikqyrjes (kontrollit) është mbrojtja dhe realizimi i parimit të ligjshmërisë.

Në punim përdoret metodologjia e posaçme juridike (normative) e kërkimit shkencor.

Në fushën legjislative të mbikqyrjes, organeve kompetente për kryerjen e mbikqyrjes dhe aktet e organeve të administratës shtetërore, nuk ka një kod unik administrativ, andaj statusi dhe veprimtaria e organeve administarive, rregullohet me ligje të ndryshme. Si rezultat i kësaj, ajo shquhet me një legjislacion të pasur, por të pa kodifikuar. Si rezultat i kësaj, ndihet nevoja për një legjislacion të kodifikuar në një kod unik, i cili do të ishte i qartë dhe do t’u ofrohej subjekteve në nevojë.

Fjalë kyçe: Mbikqyrja; organet kompetente për kryerjen e mbikqyrjes; aktet administrative;

I.MBIKQYRJA MBI PUNËN E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë nga ish federata Jugosllave në v.1991, Republika e Maqedonisë (shkurt RM) iu rrek reformimit të legjislacionit për mbikqyrje, për organet kompetente për kryerjen e mbikqyrjes (kontrollit) dhe akteve të organeve të administratës shtetërore. Ajo hasi në një proces të vështirë, sepse u përball me një numër të madh të ligjeve të cilat nuk i përshtateshin rendit të ri shtetëror, hasi me një administratë joefikase, byrokratike, të koruptuar, të stërngarkuar, etj. Republika e Maqedonisë, ndonëse jo në tempon dhe në nivelin e duhur, vazhdoi me reformat edhe pas miratimit të Marrveshjes Kornizë të Ohrit të vitit 2001, shkaku i përmbushjes së disa kritereve që dolën nga kjo marrëveshje, si dhe me qëllim për anëtarësim në UE. Republika e Maqedonisë me anë të kësaj marrëveshje Kornizë vendos qytetarin në qendër të sistemit kushtetues dhe politik.339

Edhe pse janë bërë mjaft lëvizje në këtë drejtim, nevoitet edhe shumë punë, me qëllim të plotësimit të kritereve të duhura për funksionimin e organeve të administratës shtetërore si një administratë efikase, demokratike, transparente, etj. Sipas të dhënave statistikore në RM, në organet administrative janë punësuar mbi 160 mijë persona, numër ky shumë i madh, në krahasim me popullatën e vendit. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, vetëm parimisht e përcakton organizimin e administratës.340

Administrata shtetërore, përbëhet nga ministritë dhe organet e tjera të administratës dhe organizatat e caktuara me ligj. Do të thot, organet e administratës shtetërore janë pjesë e pushtetit ekzekutiv. Ato krijohen në njësitë dhe fushat të cilat janë të rëndësishme për funksionimin e shtetit dhe realizimin efikas të të drejtave dhe detyrimeve të qytetareve dhe personave juridike. Qeveria si bartëse e pushtetit ekzekutiv, e drejton veprimtarinë e organeve shtetërore dhe bën mbikqyrjen e veprimtarisë së tyre.341

Sipas Ligjit342 administra shtetërore e Republikës së Maqedonisë përbëhet nga:

1)Ministritë;

2)Organet e tjera të administratës shtetërore;

3)Organizatat administrative;

Mbikqyrja e administratës në sistemet juridike bashkëkohore, por edhe në Republikën e Maqedonisë paraqet: mbikqyrja e administratës nga organi përfaqësues; mbikqyrja e administratës nga avokati i popullit; mbikqyrja e cila kryhet brënda vet administratës; mbikqyrja e administratës nga ana e gjykatave dhe format e ndryshme të iniciativës qytetare.343

Qëllimi kryesor i mbikqyrjes (kontrollit) është mbrojtja dhe realizimi i parimit të ligjshmërisë. Sipas ksaj, mbikqyrja që bëhet në punën e organeve të administratës shtetërore, përfshin mbikqyrjen mbi ligjshmërinë dhe efikasitietin e punës së tyre.

339 Mersim Maksuti, E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, faq.124

340 Neni 95, 96, 97 i Kushtetutës RM 1991

341 Fatmire Lumani, E drejta kushtetuese, Tetovë, 2014, faq.258

342 Ligji për organizimin dhe veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore, neni 5, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.58/2000)

343 Bajram Pollozhani, Esat Stavileci, Emir Dobjani, Lazim Salihu, *E drejta administrative aspekte krahasuese*, Shkup, 2010, fq.185

Mbikqyrja është veprimtari e cila përbëhet nga: përcjellja, kontrolli, vlerësimi i pajtueshmërise së akteve, veprimtaria, sjellja me rregullat dhe dispozitat e miratuara.

Mbikqyrja në organet e administratës shtetërore, para së gjithash bëhet nga ana e qeverisë, e cila është bartëse e pushtetit ekzekutiv.

Poashtu mbikqyrja bëhet edhe në: ndërmarrjet publike, shërbimet dhe institucionet publike, mbi personat fizik dhe juridik, të cilëve me ligj u është besuar të kryejnë autorizime publike.

Nëse Qeveria, vlerëson se një dispozitë e caktuar, të cilën e ka sjellur një Ministër, nuk është në pajtueshmëri me kushtetutën, ligjin ose me ndonjë dispozitë tjetër, mundet që për këtë, ta udhëzojë ministrin që ta ndalojë ekzekutimin e dispozitës dhe ministrit t'i propozojë që në afat të caktuar ta ndryshojë ose ta tërheq dispozitën.

Poashtu Qeveria ka të drejte dhe obligim të anulojë dhe shfuqizojë dispozitën ose ndonjë akt tjetër të ministrive, organeve të administratës shtetërore dheorganizatave administrative.

Sipas ligit, organet e administratës shtetërore janë edhe vet subjekte të kontrollit, respektivisht bartës të kontrollit, në rastet kur kryen kontrollin mbi ligjshmërinë dhe efikasitetin e punës së: organeve më të ulta të administratës shtetërore; ndërmarrjeve publike; shërbimeve publike; enteve; personave fizik e juridik, që me ligj u është besuar kryerja e autorizimeve publike.

Qeveria e kryen mbikqyrjen (kontrollin) ndaj punës së ministrive, ndërsa ministritë, e kryejnë kontrollin mbi punën e organizatave në përbërjen e tyre, ndaj organeve të pavarura të administratës shtetërore dhe organizatave administrative, në fushat administrative, për të cilat janë kompetente.

Poashtu, organet e administratës shtetërore kryejnë kontrollin mbi ligjshmërin e punës së organeve të njësive të vetqeverisjes lokale dhe qytetit te Shkupit.

Nëse bëhet fjalë për kontrollin e punës në kompetencë të vetqeverisjes lokale, Qeveria ka të drejtë: të anulojë ose prish dispozitën apo aktin e Këshillit, ose të ndonjë organi të vetqeverisjes lokale, apo të qytetit të Shkupit.

Zhvillimi i kapaciteteve të përgjithshme të administratës publike është një çështje me një rëndësi shumë të madhe jo vetëm për nevojat e brendshme të Republikës së Maqedonisë, por edhe për aderimin në strukturat evropiane.344

II.KONTROLLI INSPEKTUES (REPRESIV)

Sipas ligjit me kontroll inspektues (represiv) nënkuptojmë kontrollin mbi zbatimin e ligjit dhe dispozitave të tjera nga ana e organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike, shoqatave tregtare, enteve si dhe personave fizik e juridik.

Kontrollin inspektues, mund ta bëjnë, ekskluzivisht, organet e qeverisjes edhe ate nëpërmjet inspektorëve.

Kontrolli inspektues, quhet represiv për shkak të karakterit të mjeteve dhe sanksioneve që mund të zbatohen, për t'u mënjanuar shkeljet e ligjeve dhe dispozitave të tjera.

[344] Nacionalna strategija za integracija na Republika Makedonija vo Evropskata Unija, 207

Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, përcakton se, në përbërje të ministrive, mund të themelohen Inspektoratet, si organe të cilët janë të specializuara për kryerjen e kontrollit në fusha të caktuara.

Në përbërje të Ministrive në Republikën e Maqedonisë, ekzistojnë këto inspektorate:

-Në Ministrinë e Drejtësisë: Inspektorati shtetëror administrativ;

-Në Ministrinë e Financave: Inspektorati shtetëror revizor;

-Në Ministrinë e Ekonomisë: Inspektorati Shtetëror i tregut; si dhe Inspektorati shtetëror për inspektim teknik;

-Në Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi: Inspektorati shtetëror i bujqësisë; si dhe Inspektorati shtetëror i pylltarisë dhe gjuetisë;

-Në Ministrinë për Shëndetësi: Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor;

-Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës: Inspektorati shtetëror i arsimit;

-Në Ministrinë për punë dhe politikë sociale: Inspektorati shtetëror i punës;

-Në Ministrinë e vetqeverisjes lokale: Inspektorati shtetëror për vetqeverisje lokale;

-Në Ministrinë e transportit dhe lidhjeve: Inspektorati shtetëror për transport; Inspektorati shtetëror për ndërtimari dhe urbanizëm; Inspektorati shtetëror komunal;

-Në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe Planifikimit hapsinor: Inspektorati shtetëror për ambientin jetësor.

III. UDHËHEQJA ME ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Sistemi shtetëror në Maqedoni paraqitet në dy segmente dhe atë në segmentin politik ekzekutiv dhe pushtetin administrativ.345 Në botë njihen dy sisteme dhe atë sistemi i karrierës dhe sistemi i vendit të punës.346 Me Ligjin për nëpunës shtetëror, të vitit 2000, në RM njihet sistemi i vendit të punës.

Sipas Kushtetutës së RM (n.95), administrata shtetërore, përbëhet nga ministritë dhe organet të tjera të përcaktuara me ligj.347

Me punën e ministrive udhëheqin ministrat.348 Ministrat zgjidhen nga Parlamenti i RM. Kompetetncat e ministrit janë: ai e përfaqëson ministrinë, organizon dhe siguron punë të ligjshme dhe efikase, sjell dispozita dhe akte të tjera për të cilat është i autorizuar me ligj dhe ndërmerr masa të tjera në kompetencë të ministrisë. Ai vendos për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve shtetërorë dhe të punësuarve tjerë në ministri, për statusin e nëpunësve shtetërore, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Ligji përcakton se, me propozim të Kryetarit të qeverisë (Kryeministrit), Kuvendi i RM, emëron dhe shkarkon zëvendës të ministrave, nëpër ministritë përkatëse, i cili e zëvendëson ministrin, me tërë autorizimet dhe përgjegjësitë në udhëheqjen, kur nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij.

---

[345] Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë*, fq.239,
[346] http://www.ads.gov.mk/WBStorage/Files/poglavje18_Al.pdf
[347] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, v.1991,
[348] Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, n.47, Gazeta zyrtare e RM, 58/2000,

Qeveria, emëron dhe shkarkon edhe drejtorët, të cilët udhëheqin me punën e organit të pavarur të administratës shtetërore, organizimin e administratës dhe me organin në përbërje të ministrisë, si edhe zëvendës drejtorët, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Nëpër ministri, qeveria emëron një sekretar shtetëtëror, si nëpunës shtetëror më i lartë.

IV.AKTET E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Në Republikën e Maqedonisë, janë bërë edhe reforma në sjelljen e akteve të organeve të administratës shtetërore. Reforma, kërkon ristrukturim organizativ brenda organeve të ndryshme të administratës të njësive ose nëpunësit shtetëror që kryen shërbime apo që janë të punësuar në organe kyçe të institucioneve të administratës si për shembull në përgaditjen e akteve, në menaxhimin financiar, në teknologjinë e informacionit ose komunikimit institucional në burime njerëzore, etj.349

Sipas Ligjit për kontestet administrative, me akt administrativ kuptojmë aktin mbi të cilin organi shtetëror apo organizata e cila përmban autorizime publike vendos për një të drejtë, obligim apo interes për persona të caktuar apo të personave juridik për çështhje të caktuara administrative.350

E drejta administrative, përcakton se çfarë akte kanë të drejtë të sjellin organet e administratës shtetërore. Kur për këtë janë të autorizuara me ligj351 ato, mund të sjellin:

1.Akte administrative të përgjithshme;

2.Akte administrative konkrete (individuale);

3.Akte administrative materiale.352

1.AKTET E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

1.Aktet e përgjithshme administrative, janë norma të përgjithshme juridike, gjegjësisht rregullat të përgjithshme abstrakte juridike, të cilat u dedikohen rasteve të shumta. Me to përcaktohet mënyra e zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera.

Kompetente për sjelljen e ligjeve është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, si organ me i lartë legjislativ. Ndërsa sjellja e akteve të përgjithshme administrative, paraqet veprimtarinë normative të organeve të administratës shtetërore. Pra, organet e administratës shtetërore, sjellin lloje të ndryshme të akteve të përgjithshme administrative, si në vijim: 1) rregullore; 2) urdhëresa; 3) udhëzime; 4) plane dhe programe; 5) këshilla profesionale (instrukcione të obligueshme) me karakter intern;

Duhet cekur se veprimtaria normative e organeve të administratës shtetërore është e kufizuar në sjelljen e akteve nënligjore (legjislatura sekondare), pasi në të përpunohen dispozitat e veçanta të ligjeve dhe e dispozitave, për shkak të realizimit më të shpejt dhe më efikas.

Me aktet e përgjithshme administrative nënligjore: nuk mundet në mënyre origjinere dhe burimore, të përcaktohen të drejtat dhe obligimet për qytetarët dhe personat e tjerë juridik dhe as të përcaktohen kompetencat e organeve të tjera. Me to, mundet vetëm të përpunohet dhe precizohet, mënyra e realizimit të të drejtave dhe obligimeve, të përcaktuara me ligj.

[349] Strategija za reformata na javnata administracija vo Republika Makedonija (2010-2015) 21 dekemvri 2010 godina, str.24
[350] Ligji për kontestet administrative, (Gazeta zyrtare nr.62/2006)
[351] Ligji për kontestet administrative (Gazeta zyrtare nr.62/2006),
[352] Organet e administratës shtetërore, fq.129, *http://aa.mk/WBStorage?Files/poglavje09-Al.pdf*

1)Rregullorja:

Cekëm se rregullorja është akt i përgjithshëm administrativ. Rregullorja është akti më i rëndësishëm i organeve të administratës shtetërore.

Me rregullore përcaktohen dhe përpunohen pjesë të caktuara të ligjit dhe të dispozitave të tjera për ekzekutimin e tyre. Me rregullore mund të rregullohet edhe organizimi i brendshëm i punës në organet e administratës shtetërore.

2)Urdhëresa

Urdhëresa, është akt i pergjithshëm administrativ dhe nuk u dedikohet personave të caktuar, por të gjithë personave të territorit të caktuar, të cilët gjenden në situatë konkrete të caktuar. Me urdhëresë urdhërohet apo ndalohet veprimi në situatë të caktuar, e cila ka karakter të përgjithshëm për ekzekutimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera, (n.56).

3)Udhëzimi

Me udhëzim, parashihet mënyra e veprimit, në zbatimin e dispozitave të veçanta të ligjeve dhe të akteve të tjera. Udhëzimi parasheh mënyrën e punës të organeve administrative dhe subjekteve të tjera që u dedikohet ligji.

4)Plani dhe programi

Me plan dhe program, përcaktohen dhe përpunohen çështje të veçanta për zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera për të cilat është e nevojshme përcaktimi i afateve dhe dinamika për zbatimin e tyre.

5)Këshillat profesionale (instruksionet e obligueshme)

Organet e administratës shtetërore mund të sjellin edhe këshilla profesionale (instrukcione të obligueshme) me karakter intern, të dedikuara për organizimin profesional dhe punën profesionale të punëtoreve dhe mënyrën e ekzekutimit të punëve të caktuara administrative. Kompetent për sjelljen e tyre është Ministri.

2.AKTET ADMINISTRATIVE KONKRETE (INDIVIDUALE)

Aktet konkrete administrative të organeve të administratës shtetërore janë vendimet, të cilat sillen në procedurë administrative dhe vendosin për çështje të veçanta, si dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj dhe dispozitë tjetër.

Me aktet konkrete, vendoset për të drejtat, obligimet, interesat e qytetarëve dhe të personave juridik. Me to drejtpërdrejtë ekzekutohen ligjet dhe dispozitat e tjera, respektivisht, normat ligjore të përgjithshme materiale zbatohen në raste konkrete individuale, në raste konkrete konstatohet, a ekziston ose a janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, për njohjen e ndonjë të drejte, interesi ose për detyrimin e ndonjë obligimi të qytetarit dhe personit juridik.

Sipas ndarjes standarde, aktet konkrete administrative ndahen në: 1) pozitive, 2) negative, 3) konstituive, 4) deklarative, 5) diskrete, 6) aktevete të lidhura me ligj, 7) akteve kolektive administrative.

1)Aktet konkrete pozitive, janë ato akte me të cilat krijohet, ndryshohet apo ndërpritet ndonjë situatë e caktuar juridike apo marrëdhënie juridike.

2)Aktet negative juridike, janë ato akte konkrete administrative, me të cilat nuk kryhet asnjë ndryshim në marrëdhënjet administrative - juridike ekzistuese.

3)Aktet administrative konstituive dhe deklarative, bëjnë pjesë në grupin e akteve pozitive për arsye se edhe me njërën edhe me tjetrën krijohen, ndryshohen apo ndërpriten marëdhëniet administrativo të caktuara juridike.

Aktet administrative konstituive, janë ato akte, me të cilat krijohen, ndryshohen apo ndërpriten marrëdhëniet apo situatat administrativo juridike.

4)Me aktet administrativo juridike deklarative, deklarohet se janë paraqitur kushte të caktuara juridike, në bazë të të cilave me fuqi të ligjit, krijohen, ndryshohen apo ndërpriten marrëdhënie të caktuara administrativo juridike.

5)Aktet administrativo juridike diskrete, sillen, kur me ligj, lejohet një shkallë më e lartë e lirisë gjatë zgjidhjes së punëve administrative, gjegjësisht jepet zgjidhje, në mes më shumë alternativave apo varianteve, gjatë zgjidhjes së rasteve konkrete.

6)Aktet e lidhura me ligj, janë ato akte, të cilat sillen në bazë të kushteve reptësisht të caktuara me ligj dhe janë me përmbajtje të përcaktuar. Gjatë sjelljes së tyre, liria në zgjedhjen dhe vendosjen për rastin konkret, është plotësisht restriktive.

7)Aktet administrative të përmbledhura apo kolektive janë ato akte, në sjelljen e të cilëve, marrin pjesë dy ose më shumë organe. Ato mund të jenë vendime për të cilin vendosin dy ose më shumë organe. Në këto raste, secili nga organet vendos veçmas për lëndën, por jepet vetëm një vendim në bazë të marrëveshjes së këtyre dy organeve.

3.AKTET MATERIALE TË ORGANIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Aktet materiale administrative, i sjellin organet e administratës shtetërore. Ato janë veprime administrative, që ndërmarrin organet gjatë kryerjes së punëve nga kompetenca e tyre. Gjatë kryerjes së punëve administrative nuk krijojnë pasoja juridike, por shërbejnë si bazë për realizimin e situatave juridike. 353

Aktet administrative materiale ndahen në:

Aktet materiale të dokumentimit, me të cilat shënohen dukuri të ndryshme, veti personale, fakte të tjera, si dhe jepen të dhëna për ato fakte dhe cilësi.

Aktet e dokumentimit mund të jenë:

-Aktet materiale të evidentimit, me të cilat shënohen dukuritë, vetitë dhe faktet (regjistrat, kartotekat, listat, listat zgjedhore, etj);

-Aktet materiale për njoftim, me të cilat organet e administratës shtetërore bëjnë njoftimin e personave të interesuar për gjendjet, faktet dhe dukuritë e ndyshme dhe shpallin akte juridike.

-Aktet materiale për marrjen e deklaratave, me të cilat organet e administratës shtetërore pranojnë parashtresa dhe kërkesa të tjera, deklarata doganore, fletparaqitje tatimore, dëgjimi i dëshmitarëve, i ekspertëve, paraqitja e vdekjes, kurorëzimit, lindjes së fëmijës, etj.

Aktet e tjera materiale, ku bëjnë pjesë të gjitha veprimet administrative tjera të lidhura me punë të tjera profesionale, teknike dhe lloji tjetër të punëve të organeve të administratës shtetërore.

5. SJELLESIT E AKTEVE NË ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

[353] Organet e administrates shtetërore, faq.131, shih: http://aa.mk/WBStorage/Files/poglavje09_Al.pdf

Aktet e organeve të administratës shtetërore, i sjellin ministrat të cilët udhëheqin me ministritë si dhe drejtorët e organeve të pavarura të administratës shtetërore (organe të tjera të administratës shtetërore dhe organizatave administrative).

Ministri i cili udhëheq me ministrinë, i sjell edhe aktet e organeve të cilat janë në përbërje të asaj ministrie, me propozim të drejtorit i cili udhëheq me organin në përbërje të asaj ministrie.

PËRFUNDIM

RM, pas pavarësimit, hasi në një proces të vështirë, pasi u përball me një numër të madh të ligjeve të cilat nuk i përshtateshin rendit të ri shtetëror, hasi me një administratë joefikase, byrokratike, të koruptuar, të stërngarkuar, etj. Në fushën përkatëse legjislative të mbikqyrjes, organeve kompetente për kryerjen e mbikqyrjes dhe aktet e organeve të administratës shtetërore, mungon një kod unik administrativ, andaj statusi dhe veprimtaria e organeve administarive, rregullohet me ligje të ndryshme.

Republika e Maqedonisë, ndonëse jo në tempon dhe në nivelin e duhur, vazhdoi me reformat edhe pas miratimit të Marrveshjes Kornizë të Ohrit të vitit 2001, shkaku i përmbushjes së disa kritereve që dolën nga kjo marrëveshje, si dhe me qëllim për anëtarësim në UE. Edhe pse janë bërë mjaft lëvizje në këtë drejtim, nevoitet edhe shumë punë, me qëllim të plotësimit të kritereve të duhura për funksionimin e organeve të administratës shtetërore si një administratë efikase, demokratike, transparente, e pa koruptuar, etj.

Rekomandime

- Mbikqyrje efektive, transparente, joselektive nga organet kompetente për kryerjen e mbikqyrjes (kontrollit);

-Unifikimi i legjislacionit të sferës administrative në një kod unik administrativ, i cili do të ishte i qartë dhe do t'u ofrohej subjekteve në nevojë;

-Harmonizimi i legjislacionit të RM me legjislacionin e UE në numrin e ministrive dhe realizimi i reformave. Reduktimi i numrit të Ministrive, në numër më të vogël dhe më efikas;

-Zbatimi i plotë i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, si kusht për garantimin dhe realizimin e të drejtave të barabarta të bashkësive etnike;

-Zvogëlimi i të punësuarve në organet e administratës shtetërore;

-Të bëhet depolitizimi dhe departizimi i administratës shtetërore;

Bibliografia:

-Bajram Pollozhani, Esat Stavileci, Emir Dobjani, Lazim Salihu, E drejta administrative aspekte krahasuese, Shkup, 2010;

-Etem Aziri, Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë;

- Fatmire Lumani, E drejta kushtetuese, Tetovë, 2014;

- Mersim Maksuti, E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë;

-Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, v.1991;

-Ligji për organizimin dhe veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore, neni 5, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.58/2000);

- Nacionalna strategija za integracija na Republika Makedonija vo Evropskata Unija;

-Strategija za reformata na javnata administracija vo Republika Makedonija (2010-2015) 21 dekemvri 2010 g.

-Ligji për kontestet administrative, (Gazeta zyrtare nr.62/2006);

-Organet e administratës shtetërore, fq.129, http://aa.mk/WBStorage?Files/poglavje09-Al.pd

f-http://www.ads.gov.mk/WBStorage/Files/poglavje18_Al.pdf

MSC. OSMAN CUCOVIĆ, DR.SC. ANITA CUCOVIĆ – GARANTIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT SIPAS KUSHTETUTËS SË KOSOVËS

MSC. OSMAN CUCOVIĆ
Oda e Avokatëve të Kosovës, Pejë

DR.SC. ANITA CUCOVIĆ
Kolegji Fama-Prizren

Abstrakt

Lirite dhe të drejtat e njeriut kanë qenë për diskutim dhe janë edhe sot aktuale në tërë botën . Pas shpalljes së Pavarësie nga institucionet e Kosovës, është hartuar Kushtetuta e Republikës e cila mbron liritë dhe të drejtat e njeriut. Është e një standardeje të larte, me qensë sipas disa sondazheve në disa çeshtje politike nuk është e specifikuar si duhet, apo ndoshta është nga qarqet e ndryshme per interesa të tyre po e interpretojnë në një menyre. Megjithëse në kete punim fokusi do të jetë paraqitja e Lirive dhe të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës, e që ne Kushtetun e Republikës së Kosovës gjinden në kapitullin e dyte.
Cili është roli i mbrojtjes se gjinise, pastaj te drejtat e pakicave kombetare, etj. Komentimi modest i neneve sipas mundesise dhe njohurive të deri tanishme të autorit.

Fjalët kyçe: Te drejtat e njeriut, Kushtetuta, Shkelje, Nenet, Republika e Kosovës

Hyrje

Kushtetuta e Kosovës, e 15 Qershorit, 2008, ashtu sikurse edhe kushtetutat e tjera të vendeve demokratike, përbën aktin më të lartë dhe më sublim të shtetit. Kjo Kushtetutë është mbështetur në standardet më të larta të shteteve moderne dhe demokratike për të drejtat dhe liritë themelore . Në kontekstin e saj, të drejtat e njeriut janë të përfshira në Kapitullin II, respektivisht nga neni 21 deri në nenin 56.
Transformimet e mëdha social-politike të ndodhura në vendin tone shtruan si një kërkesë imperative, të domosdoshme rritjen e rolit të individit në shoqërinë e re demokratike, në pjesëmarrjen e tij në qeverisjen e vendit. Për realizimin me sukses të këtij roli të individit, të shtetasit shqiptar në jetën politike dhe administrative të vendit, në radhë të parë kërkohej vendosja e garancive ligjore dhe institucionale edhe për të drejtën e informimit, si një e drejtë themelore e njeriut.
Garantimi sa më i mirë dhe sa më i plotë i parimeve të demokracisë, i parimeve të shtetit të së drejtës dhe i të drejtave dhe lirive themelore të individit, përbëjnë sot ndër problemet më të mprehta dhe sfidat më të rëndësishme jo vetëm për shtetet që janë në rrugën e demokracisë, por edhe për vetë shtetet me demokraci të konsoliduar. Dhe kjo, veçanërisht në demokracitë e reja, bëhet jo thjesht për të garantuar formalisht paqen dhe sigurinë sociale mes shtresave të ndryshme të popullsisë, e aq më pak, thjesht për shkak të integrimit. Realisht, kjo ndodh për faktin se normalisht, në demokracinë si formë të qeverisjes, individi, të drejtat, interesat, siguria dhe mirëqenia e tij, janë dhe duhet të jenë në mënyrë të vazhdueshme në qendër të vëmendjes së të gjithë pushtetit shtetëror në tërësi.

Kuptimi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vendos qenien njerëzore në qendër të interest. Kjo aspiratë është e bazuar në sistemin e përbashkët universal të vlerave të përkushtuara të të drejtës për jetë, si një e drejtë e paprekshme, dhe ofron një kornizë për ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, të mbrojtur nga normat dhe standardet e pranuara ndërkombëtarisht.
Garantimi dhe promovimi i të drejtave të njeriut kërkon standarde më të larta të mbrojtjes, duke qenë se në shumë raste janë vetë autoritetet shtetërore që shkelin të drejta e njeriut. Ato u zhvilluan pas

ngritjes së Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Karta e OKB-së dhe miratimi i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut, shënuan shkëndijat e para në kuadër të mbrojtjes dhe garantimit të këtyre të drejtave. Të drejtat e njeriut filluan të trajtohen me më shumë seriozitet dhe të përkufizohen në aspektin ndërkombëtar. Ky trend vazhdoi edhe me miratimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të konkretizuar më tej edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), të miratuar nga Kombeve të Bashkuara në vitin 1948, u referohet shtyllave kryesore të sistemit të të drejtave të njeriut, të cilat janë liria, barazia dhe solidariteti. Liritë, siç janë liria e mendimit, ndërgjegjes, besimit, sikurse edhe ajo e opinionit dhe shprehjes, janë të mbrojtura nga të drejtat e njeriut. Në mënyrë të ngjashme, të drejtat e njeriut garantojnë barazi, siç është mbrojtja e barabartë kundër të gjitha formave të diskriminimit për të gëzuar të gjitha të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe barazinë e plotë ndërmjet grave dhe burrave, e të tjerë. Sigurisht "të drejtat e njeriut" nuk janë një fenomen i shfaqur kohëve të fundit. Koncepti i të drejtave të njeriut është po aq i vjetër sa edhe vete nocioni i shtetit dhe i së drejtës. Me fjalë të tjera, të drejtat e njeriut si koncept e kanë origjinën e tyre që me fillimin e qytetërimit njerëzor. Me kalimin e kohës, ky nocion është përpunuar, saktësuar e zgjeruar në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, përgjithësisht, me termin "të drejtat e njeriut" janë konsideruar përgjithësisht të drejtat themelore dhe të patjetërsueshme që janë të domosdoshme për jetën. Sidoqoftë, edhe sot nuk ka një perkufizim shterues mbi përmbajtjen e të drejtave të njeriut.
Në fakt, përpjekje për përkufizimin e termit "Të Drejta të Njeriut" ka pasur në vazhdimësi. Një nga shumë përkufizimet e tilla që mendoj se paraqet interes, është ai i autorit të mirënjohur Umozurike, i cili thekson ndër të tjera se të drejtat e njeriut janë ato të drejta ".... që komuniteti ndërkombëtar i njeh se i përkasin të gjithë individëve, thjesht nga fakti i të qenit njeri/qënie njerëzore".354
Spinoza flet për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duke u përqendruar sidomos në njohjen e lirisë së mendimit dhe të fjalës, të cilat i lartëson si vlera të pazëvendësueshme në jetën shoqërore dhe politike, dhe se shprehja e lirë e mendimit dhe fjalës nuk duhet të ishte në kundërshtim me sistemin demokratik, pavarësisht se është rezultat i drejtpërdrejtë i këtij sistemi. Këtë të drejtë ai e konsideronte si jo të rrezikshme për paqen sociale të shtetit, aspak armiqësore për ata që mbanin pushtetin, përkundrazi, shumë të dobishme, sepse në shprehjen e lirë të mendimit dhe fjalës manifestohet liria e njerëzve dhe qytetarëve si qëllim i shtetit demokratik. 355
Sipas Hugo Grocit, e drejta natyrore, duke qenë urdhër ose rregull epror, është njëkohësisht e pandryshueshme, pasi as vetë Perëndia nuk mund ta ndryshojë. Po sipas tij, autoriteti moral i së drejtës natyrore sigurohet për shkak se ajo ka prejardhje hyjnore. Perëndia vetë ka vendosur kufijtë e aktivitetit të njeriut politik. 356
Autorë të shumtë theksojnë sot se një formë e njohur e interpretimit të të drejtës natyrore është një qasje klasike, është një tregues se e drejta natyrore ekziston në kuptimin absolut dhe të pandryshueshëm.

Garancitë Kushtetuese për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës

Kushtetuta e Kosovës në kapitullin e dytë i inkorporon të drejtat civile dhe politike (neni 23-48)357. Ndalimet kundër heqjes së lirisë , skllavësinë, torturës, burgosjet arbitrare, dhe diskriminimit racor janë të përfshira në mënyrë eksplicite në Deklaratën Universale131, si dhe në instrumente të tjera ndërkombëtare. Ndërsa parimet e ndalimit të genocidit dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut janë nënkuptuar në dispozitat e Deklaratës. Nenet 1, 2, 6, dhe 7 shprehin të drejtën themelore të trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues në lidhje me të drejtat e garantuara "pa dallim të çfarëdo

[354] U.O. Umozurike, Introduction to International Law (Ibadan: Spectrum Law Publishing 1993), p.141.
[355] Gruda, Zejnullah, Mbrojta ndërkombëtare e te drejtave te njeriut, Prishtinë, 2010, f. 5.2.
[356] Cary, J. Nederman, Natural Law, An introduction to Legal Philosophy , (Transaction Publishers, New Brunswick, 2009) p. 71-71. http://books.google.com/books?id=fftZM_scbu4C&pg=PA53&lpg=PA53&dq=Chroust,+A.+(1943)+%22Hugo+Grotius+and+the+Scholastic+Natural+Law+Tradition,%22+The+New+Scholasticism,+XVII.&source=bl&ots=soUaki3KAY&sig=Xa18H-OfyuHW_tTFh-spzS1ngC4&hl=en&sa=X&ei=LpAoUZCoPMvMsgbygoDoBA&ved=0CEIQ6AEwAw#v=onepage&q=Chroust%2C%20A.%20(1943)%20%22Hugo%20Grotius%20and%20the%20Scholastic%20Natural%20Law%20Tradition%2C%22%20The%20New%20Scholasticism%2C%20XVII.&f=false . Accessed on February 10 , 2015.
[357] KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Kapitulli II (NENI 21 – 56)

lloji" diskriminimi. Pranimi i drejtës për trajtim të barabartë sipas ligjit tashmë është fakt që mund të konstatohet në legjislacionin e çdo vendi. Sigurisht, edhe në lidhje me të drejtat e mbrojtura, shumë praktika shtetërore nuk mbështesin konkluzionin se ka pajtueshmëri ose zbatim të plotë me parimin e barazisë.358
Mbrojta e lirive dhe të drejtave të njeriut janë shtyllë kryesore në funksionimin normal të shteteve demokratike sepse nga respektimi i të drejtave dhe lirive varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti demokratik. Këtë e kanë dëshmuar shtetet euro - perëndimore (skandinave) ku respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut ka arritur në zenit dhe janë shtetet më të fuqishme ekonomike, sociale dhe demokratike.359

Kosova trajtohet si një rast unik në lidhje me procedurat e hartimit të kushtetutës, sepse në të janë inkorporuar pjesë nga kushtetuta dhe konventa të ndryshme ndërkombëtare. Mbi bazën e kësaj analize, mund të arrijmë në konkluzionin se Deklarata Universale, ICCPR dhe ECHR janë pika referimi të hartuesve të Kushtetutës se Kosovës. Kjo mund të konstatohet nga përmbajtja e dispozitave të saj, veçanërisht në nenet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore, përkatësisht nenet 21 – 56 të Kushtetutës së Kosovës.
Në nenin 21, ku parashikohen Parimet e Përgjithshme, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përkufizohen: "të pandashme, të patjetërsueshme, të pacënueshme dhe bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës", ndërsa në nenin 22 ku parashikohen Instrumentet Ndërkombëtare, garantohet zbatim i tyre i drejtpërdrejtë në Kosovë, me prioritet të zbatimit në rast konflikti me normat e brendshme ligjore apo nënligjore, dhe ku përfshihen:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet;
(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Ç'njerëzore dhe Poshtëruese.

Nga ky përkufizim normativo - kushtetues dhe nga kjo përfshirje e instrumenteve ndërkombëtare, nënkuptohet qartë fakti se ato duhen respektuar, promovuar dhe mbrojtur nga çdo autoritet publik që ushtron funksionet e tij në Kosovë, pavarësisht faktit se mbrojta e tyre realizohet edhe në sistemin gjyqësor, si dhe nga Gjykata Kushtetuese.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 23 ka parashikuar Dinjitetin e Njeriut si të pacënueshëm dhe bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
Pavarësisht situatave të ndryshme, shmangia nga këto të drejta dhe liri themelore nuk është e lejuar në asnjë rrethanë, e në të cilat përshihen:

- Barazia para Ligjit, neni 24, sepse të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë para ligjit, pa diskriminim;
- E Drejta për Jetën, neni 25, ku sanksionohet ndalimi i dënimit me vdekje;
- Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Ç'njerëzor ose Poshtërues, neni 27;
- Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar, neni 28; (punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë) ku përshihet edhe ndalimi i trafikimit qenieve njerëzore;

358 Hurst Hannum, "The Status of the Universal Declaration..." vep e cit. f/p. 343.
359 http://www.telegrafi.com/lajme/mbrojtja-e-lirive-dhe-te-drejtave-te-njeriut-element-themelor-ne-funksionimin-e-shtetit-modern-26-4474.html Zbartur me 1 mars ,2015.

- E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë, neni 29; (Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, në rastet e përcaktuara në mënyrë taksative dhe sipas procedurave të përcaktura me dispozita kushtetuese e ligjore);
- E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, neni 31; (garantimi i mbrotjes së barabartë i të drejtave gjatë procedurave para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe mbartësve të kompetencave publike).
- Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në çështjet Penale, neni 33; (respektimi I parimit "nullum crimen, nulla poena sine lege" me përjashtim të veprave të cilat në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin genocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit);
- E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër, neni 34;.
- E Drejta e Martesës dhe Familjes, neni 37;.
- Liria e Besimit, Ndërgjegjes dhe e Fesë, neni 38;

Në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga të cilat, gjatë shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, mund të bëhet shmagia deri në masën sa është e domosdoshme, nën rrethanat e parashikuara, përfshihen:

- E Drejta për Mjete Juridike, neni 32;
- E Drejta e Integritetit Personal, neni 26; (e drejta e kontrollit trupor, e drejta që të mos I nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj, e drejta që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij).
- Të Drejtat e të Akuzuarit, neni 30;
- Liria e Lëvizjes, neni 35;
- E Drejta e Privatësisë, neni 36;
- Bashkësitë fetare, neni 39; (themelimi i shkollave fetare, institucioneve bamirëse).
- Liria e Shprehjes, neni 40; (e drejta për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera).
- E Drejta e informimit në Dokumente Publike, neni 41;
- Liria e Mediave, neni 42;
- Liria e Tubimit, neni 43, e drejta për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to.
- Liria e organizimit, neni 44, (të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar).
- Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes, Neni 45, vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
- Mbrojtja e Pronës, neni 46;
- E Drejta për Arsimin, neni 47;
- Liria e Artit dhe e Shkencës, neni 48;
- E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit, neni 49;
- Të Drejtat e Fëmijës, neni 50;
- Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale, neni 51. (Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e tretë, rregullohet me ligj.
- Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor, neni 52; dhe
- Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave, neni 54.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban 33 dispozita që parashikojnë të drejta dhe liri themelore të njeriut, duke përfshirë si kategori të veçantë edhe të drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre. Duhet theksuar fakti se dispozitat kushtetuse i grupojnë ato në dy kategori: në dispozita nga të cilat nuk mund tëi shangemi në asnjë rrethanë dhe dispozita nga të cilat mund t'i shmangemi përkohësisht në rrethana të caktuara, deri sa të zgjasin këto rrethana.

Garancitë kushtetuese të barazisë gjinore - korniza e përgjithshme

Dispozitat themelore të kushtetutës dhe dispozitat hyrëse në kapitujt për të drejtat dhe liritë e njeriut, përmbajnë shumë garanci që nuk kanë të bëjnë vetëm me barazinë gjinore por me të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me kushtetutë. Kështu që, vetëm në kuadër të këtyre garancive kushtetuese mund të vërehen edhe ato garanci të cilat më për së afërmi sigurojnë barazinë gjinore.

Përfundimi

Pas luftës së dytë botërore u nxjerrën këto akte shumë të rëndësishme: Karta e OKB-ës, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e shumë akte të tjera të cilat i garantojnë dhe i mbrojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.360

Sa i përket zbatimit të këtyre akteve, një standard të përfshirjes së tyre në legjislacionin e saj e ka arritur edhe Republika e Kosovës përmes Kushtetutës (2008), kapitulli i dytë që i referohet të drejtave dhe lirive themelore ku janë të përfshira aktet kryesore ndërkombëtare që i mbrojnë dhe garantojnë të drejtat dhe liritë themelore (shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 22, Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare).

Perspektiva e Kushtetutës së Kosovës, konstitucionalizmi reflektohet edhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Ndërkohë që disa organeve përkatëse iu njihet kompetenca për të ushtruar autoritetet, njëkohësisht atyre iu kufizohet pushteti sepse në rend të parë kanë për detyrë respektimin e të drejtave të njeriut.

Si rezultat i kësaj, në sistemin juridik të Kosovës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore interpretohen në harmoni me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë nga Marrëveshjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare. Kjo lind nga nevoja e domosdoshme për të siguruar edhe mbrojtur efektivisht të drejtat e njeriut, të cilat janë kërkesa dhe standarde të zhvillimeve progresive ndërkombëtare.

Kushtetuta e Kosovës ka parashikuar si vlerë të shtetit respektimin e të drejtave të njeriut, duke i përkufizuar ato si të pandashme, të pacënueshme dhe të patjetërsueshme në themelet e rendit juridik, duke detyruar organet shtetërore, në veçanti organet e drejtësisë, që t'i përmbahen Kushtetutës dhe ligjit.

Njëkohësisht ka përcaktuar Gjykatën Kushtetuese si autoritetin përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, ndërsa individëve iu është njohur e drejta që të paraqesin para kësaj Gjykate çështje që lidhen me shkeljet e të drejtave të tyre nga autoritet publike, pra të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

360 http://www.telegrafi.com/lajme/mbrojtja-e-lirive-dhe-te-drejtave-te-njeriut-element-themelor-ne-funksionimin-e-shtetit-modern-26-4474.html

Në këto raste, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk është në pozicionion e gjykatës më të lartë të sistemit të drejtësisë, por ajo jep drejtësinë kushtetuese, dhe se funksioni i saj është që konstatimi i faktit të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore nga organet që kanë miratuar vendime apo kanë ndërmarrë akte konkrete. Duke ditur faktin se ajo është gardiani i Kushtetutës, si dhe bën gjykimin kushtetues të shkeljes së të drejtave e njeriut, duket qartë se boshti i këtij punimi është konkretisht mbrojtja kushtetuese e të drejtave të njeriut.

Literatura

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II (Nenet 21 – 56)
Hurst Hannum, "The Status of the Universal Declaration..." vep e cit. f/p. 343.
U.O. Umozurike, Introduction to International Law (Ibadan: Spectrum Law Publishing 1993), p.141.
Gruda, Zejnullah, Mbrojta ndërkombëtare e te drejtave te njeriut, Prishtinë, 2010, f. 5.2.
Cary, J. Nederman, Natural Law, An introduction to Legal Philosophy, (Transaction Publishers, New Brunswick, 2009) p. 71-71.
Mr.sc. Flamur Hyseni & Mr.sc. Burim Haliti, "Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut - element themelor në funksionimin e shtetit modern", TELEGRAFI.COM, për më shumë: http://www.telegrafi.com/lajme/mbrojtja-e-lirive-dhe-te-drejtave-te-njeriut-element-themelor-ne-funksionimin-e-shtetit-modern-26-4474.html

PHD. (C) PRANVERA HYSENAJ - ANALIZA E NGARKESAVE ELEKTRIKE NË RRJETIN ELEKTRIK SIPAS METODËS SË DITËVE TË NGJASHME DHE NËPËRMJET VLERSIMIT TË DEVIJIMIT STANDART TË NGARKESËS. (ANALYSIS OF THE ELECTRICAL CHARGES IN THE ELECTRICAL NETWORK UNDER SIMILAR METHOD DAYS AND THROUGH EVALUATION OF LOAD STANDARD DEVIATION)

PHD. (C) PRANVERA HYSENAJ
Dega Elektrike, Albanian University, Tiranë

Abstrakti

Qëllimi i këtij studimi është të propozojmë një trajtim ndryshe të analizimit të ngarkesave elektrike për konsumatorët urban dhe ata industrial si dhe paraqitjen grafike të tyre për një periudhë një mujore.
Materialet dhe metodat: Në n/stacionin Tec–Ballsh ku funizohen me energji konsumatorë urban dhe konsumatore industrial janë marrë parametrat e energjisë orare të 24 orëve për periudhën Janar 2014. Duke përdorur metodën e e ditëve të ngjashme dhe vleresimin e devijimit standart të ngarkesës kemi krahasuar rezultatet e dy rasteve (fideri 2 urban dhe fideri 3 industrial).
Rezultatet: Për konsumatorin industrial (fideri 3)devijimi standart ishte i rendit më të lartë (14-20%) kurse për konsumatorin urban dejvijimi standart ishte I rendit më të ulët (10%).
Gjatë orëve të natës kur ngarkesa është minimale devijimi standart është I rendit më të madh krahasuar me orët e mbrëmjes kur ngarkesa është maksimale ku devijimi standart është I rendit më të ulët.
Përfundimet: Metoda e mësiperme është e vlefshme për parashikimin e ngarkesave elektrike në rastin e konsumatorit industrial. Metoda e mësipërme për parashimikimin e ngarkesave elektrike në rastin e konsumatorit urban duhet të korigjohet sepse duhet të jetë më e madhe dhe me koeficientin e kushteve meteorologjike. Kur ngarkesa është minimale (23.00-05.00) nga rezultatet, shkalla e gabimit sipas metodës së ditëve të ngjashme është e lartë. Kur ngarkesa është maksimale (18.00-23.00) nga rezultatet, shkalla e gabimit sipas metodës së ditëve të ngjashme është e ulët

Fjalët kyçe: ngarkesat elektrike, konsumator urban, konsumator industrial, parametrat e energjisë, metoda e ditëve të ngjashme, devijimi standart.

Abstract

The aim of this study is to propose a different approach to analyzing electrical loads for urban and industrial consumers and their graphical representation for a period of one month.
Materials and methods: In the electrical stationTEC-Ballsh where consumer power feed urban and industrial consumer of energy parameters are taken all 24 hours for the period January 2014. Using similar days method and evaluation of load standard deviation compared the results of two cases (feeder 2 urban and industrial feeder 3).
Results: For industrial consumers (feeder 3). The order standard deviation was higher (14-20%) while for urban consumers Order standard deviation was lower (10%).
During the night hours when the load was minimal standard deviation is greater order compared with evening hours when the load is maximum where the standard deviation is lower ranks.
Conclusions: The method above is useful for predicting the electrical charges in the case of industrial consumer. The above method for forecast of electrical charges in the case of urban consumers need to be reviewed because they have to be bigger and coefficient of meteorological conditions.
When the load is minimal (23:00 to 05:00) the results, the error rate according to the method similar days is high. When the load is maximum (18:00 to 11:00 p.m.) from the results, the error rate according to the method similar days is low.

Keywords: electrical loads, urban consumer, industrial customers, power settings, the method similar days, standard deviation.

Hyrje

Përafrimet statistikore zakonisht kërkojnë një model matematik që paraqet ngarkesën si funksion te faktorëve të ndryshëm të tilla si koha, moti dhe konsumatorë. Parashikimi afatshkurter i ngarkesës duhet të marrë parasysh shume faktorë, si faktorët e kohës, të dhënat e motit dhe kategoritë e mundshme te konsumatorëve. Parashikimi afatmesëm dhe afatgjatë marrin parasysh ngarkesën historike dhe të dhënat atmosferike, numrin e konsumatorëve në kategori te ndryshme, të dhënat ekonomike, demografike dhe parashikimet e tyre, të dhënat nga shitja dhe nga faktorë të tjerë.
Ndryshimet e ngarkesës paraqesin interes të vecantë për pika te caktuara të rrjetit shpërndarës nga të cilat më kryesoret janë : Pika e lidhjes së përdoruesit, kabina e transformimit, nën/ stacionet elektrike
Me anë të ndryshimit ditor të ngarkesës (grafikut ditor) për përdoruesit e te njëjtes kategori (psh te përdoruesëve shtëpiake, tregëtarë etj) paraqesin ngjashmëri te madhe vençanërisht nëse ato i takojne se njëjtës stine ose llojit të njëjtë të ditës (ditë pune apo ditë pushimi) jepet mundësia e analizës së ngarkesës si madhësi statistikore, e cila për një ditë dhe për orë të caktuar, paraqitet me një vlerë mesatare dhe me një përhapje (dispersion) rreth saj.
Kur njihen ngarkesat e vecanta, vlerësimi i "grafikut shumar të ngarkesës ",(1,2,3) ose i vlerave ekstremale të tij (maksimum, minimum) mund të përcaktohen madhesitë e elementëve të rrjetit (psh transformatorët,seksionet e percjellësave etj.) dhe bëhen llogaritjet përkatëse. Ky problem, që në vitet e para të zhvillimit të rrjetëve elektrike e deri më sot, është përballuar me përdorimin e koeficientëve të nxjerrë nga përvoja. Por, në vitet e fundit përdorimi i M.LL.E(4) i lidhur ngushtë me metodat bashkohore të matjeve dhe të depozitimit te informacioneve, jep mundësinë e analizave më të plota të ndryshimit të ngarkesave.



Figura 1. Skema elektrike e nënstacionit Tec Ballsh

Materiali dhe metoda

Parametrat e energjisë elektrike në N/st TEC Ballsh për periudhen Janar 2014.Nisur nga të dhënat orare të enegjisë sipas konsumatorëve shpërndarës dhe pajisjeve kryesore në n/stacionin elektrike ne morëm në studim të gjithe muajt e vitit 2014.Nga krahasimi I vlerave të matura pamë që në muajin janar 2014 janë ngarkesat më të mëdha të rrjetit shpërndarës Ballsh.

Mbledhja e të dhënave

Të dhënat janë organizuar për fiderin 2 I cili ushqen rrjetin shperndarës të Ballshit.dhe fiderin 3 që ushqen rrjetin industrial.
Temperatura dhe lagështia janë parashikuesit më të përdorëshem të ngarkesës(5). Një vrojtim mbi parashikimin e ngarkesës elektrike ka vene re se nga 22 kërkime të marra në konsideratë, 13 prej tyre perdornin vetëm temperaturën, 3 përdornin temperaturën dhe lagështinë, 3 përdornin parametra të ndryshëm atmosferik dhe vetëm 3 prej tyre përdornin parametrat e ngarkesës.

Analiza e të dhënave

Nga të dhënat janë përcaktuar ligjshmëria e ndryshimit te fuqive minimale,maksimale dhe mesatare për fiderin 2 ,3 dhe për transformatorin ushqyes (TR1, 35/6Kv) për periudhën në shqyrtim. Ngarkesa industriale ushqehet nëpermjet fiderit 3 përben rreth 30% te ngarkesës totale, kurse ngarkesa urbane që ushqehet nëpërmjet fiderit 2 përbën 70% te ngarkesës totale Ngarkesa industriale lidhet me procesin teknologjik dhe më pak me kushtet meteorologjike ,kurse ngarkesa urbane lidhet më shumë me kushtet meterologjike. Në analizë janë përdorur devijimi mesatar AVEDEV dhe devijimi standart STDEV.

STDEV llogaritet nga formula:

$$\sqrt{\frac{\sum (x-\bar{x})^2}{(n-1)}}$$

AVEDEV llogaritet nga formula:

$$\frac{1}{n}\sum |x-\bar{x}|$$

AVEDEV ndikohet nga njësia matëse e të dhënave.

Rezultatet

Në grafikë (figura 1) janë paraqitur fuqia minimale,maksimale dhe mesatare për transformatorin e fuqisë gjatë muajit Janar 2014.
Në grafikë (figure 2-3) janë parqitur ngarkesa maksimale ,minimale ,mesatare për fideri 2 dhe fiderin 3 gjatë muajit Janar 2014.
Në grafikë (figure 4-5) janë paraqitur devijimet standarte për fiderin 2 dhe fiderin 3gjate muajit Janar 2014.



Figura 1. Grafiku i fuqisë minimale, maksimale dhe mesatare e TR1 për muajin Janar

Transformatori 35/6kv vlerat më të ulëta të fuqisë i ka në orët e para te mëngjesit (4:00-7:00) dhe vlerat më të larta të fuqise i ka në orët e mbrëmjes (18:00-21:00).



Figura 2. Grafiku i ngarkesës maksimale, minimale dhe mesatare per Fiderin 2 gjatë muajit Janar



Figura 3. Grafiku i ngarkesës maksimale,minimale dhe mesatare per Fiderin 3 gjatë muajit Janar

Nga grafiku ngarkesa mban një ritem pothuajse konstant. Kjo për faktin se fideri 3 është fider që ushqen ngarkesë industriale.
Në vazhdim jepen grafikët e mesatares së ngarkesave të fiderit 2, fiderit 3 dhe devijimet e tyre gjatë muajit Janar.



Figura 4. Grafiket e ngarkesës për fiderin 2 dhe devijimet gjatë muajit Janar

Devijimi i ngarkesës përben rreth 10 % te vleftës pik të mesatares



Figura 5. Grafikët e ngarkesës mesatare për fiderin 3 dhe devijimet gjatë muajit Janar

Devijimi i ngarkesës përbën rreth 14 % te vleftës pik te mesatares.

Diskutim

Të dhënat e studimit tonë tregojnë qartë që metoda e ditëve të ngjashme dhe devijimi standart I ngarkesës është përcakues I rëndësishëm për vlerësimin e ndryshimit të ngarkesës.
Në studimin tonë nuk janë përdorur algoritmet e inteligjencës artificiale të tilla si regresioni,rrjetat neutrale,dhe sistemet eksperte. Një shumëllojshmëri metodash të cilat përfshijnë të ashtuquajturat përafrimet ditore, modelet e ndryshme të regresionit, serite e kohës, algoritmet statistikor dhe sistemet eksperte janë zhvilluar për parashikimet afatshkurtra.
Në studimin tonë nuk janë përdorur dy prej metodave, të ashtuquajtura (end-use) dhe (econometric approach) janë gjerësisht të përdorura për parashikimet afatmesme dhe afatgjata.
Me anë të metodës së ditëve të ngjashme dhe devijimit standart për parashikimin e ngarkesës(marren vendime të rëndësishme për blerjen dhe gjenerimin e fuqisë elektrike, stakimit të ngarkesës dhe zhvillimit te infrastrukturës. Parashikimet e ngarkesës janë shumë të rëndësishme për furnizuesit e energjisë, ISO-t, institucionet financiare dhe për pjesmarrësit e tjerë në gjenerimin e energjisë elektrike, transmetim, shpërndarje dhe tregëti.
Zhvillimi, përmirësimet, dhe hulumtimi i mjeteve të përshtatshme matematikore do të çojë në zhvillimin e teknikave të sakta për parashikimin e ngarkesës.

Konkluzione

Rrjeti shperndarës i Ballshit është i natyrës industrial dhe urbane.
Vlerësimi i ndryshimit te ngarkesës është bërë sipas metodikës së ditëve te ngjashme dhe nëpërmjet vlerësimit të devijimit standart të ngarkesës. Per fiderin që ushqen ngarkesën industriale metoda e mësipërme është e vlefshme për parashikimin e ngarkesës elektrike.
Per fiderin që ushqen ngarkesën urbane metoda e mësipërme duhet të korigjohet, metoda e mësipërme nuk është e vlefshme për parashikimin e ngarkesës elektrike.
Gjatë orëve kur ngarkesa eshte minimale, devijimi standart eshte e ulet dhe shkalla e gabimit sipas metodës së ditëve të ngjashme është më e lartë.
Gjatë orëve kur ngarkesa eshte maksimale, devijimi standart eshte i vogël,shkalla e gabimit sipas metodës së ditëve të ngjashme është më e ulët.

Referenca

T.V. Uspensky. McGraw-Hill Book Company, Inc., * Introduction to Mathematical Probability *
York, N.Y. 1964, page 214-218
F. P. Benner. General Electric *The Use of the Theory of Probability to Determine Spare Capacity*, (Schenectady, N.Y.), 1934, page1-20
L.T. Anstine, R.E. Burke, J.R. Casey, R. Holgate, R.S. John, H.G. Stewart, "Application of Probability Methods...,"
York, N.Y, 1963, page 726-735.
A. Papoulis, "Probability, Random Variables, and Stochastic Processes", McGraw-Hill Book Co., New York, 1965, page 279-292.
B.E. Biggerstaff, T. M. Jackson, "The Markov Process as a Means of Determining Generating Unit States*
York, N.Y 1968, page 28-219.
A. Papoulis, "Probability, Random Variables, and Stochastic Processes", McGraw-Hill Book Co., New York, 1965, vol 3 page 101-123.
R. Billinton, R. Ringlee, A. Wood, "Power System Reliability Calculations", The MIT Press, Cambridge, Mass.1973 ,page1-220.
Edison Electric Institute-Prime Movers Committee "Equipment Availability Data Reporting Instructions", 1973.
S.A. Smith, Jr. Bulletin * Probability Theory and Spare Equipment * (New York, N.Y.), 1934, page3-5
A. Papoulis, "Probability, Random Variables, and Stochastic Processes", McGraw-Hill Book Co., New York, page1-20, 1965.
L.T. Anstine, R.E.Burke, J.E.Casey, R. Holgate,R.S. John,H.G.Stewart *Application of Probability Methods to the Determination of Spinning Reserve Requirements *. Pennsylvania-New, 1963, page. 726-735.

ALLMEDINA LIKA - KONFERENCA E RAMBUJES - ASPEKTI JURIDIK DHE NDERKOMBETAR

ALLMEDINA LIKA

Fakulteti Juridik, "Universiteti Hasan Prishtina", Prishtinë

Abstrakti

Masakra e Recakut dhe gjykimi i drejte i saj nga ambasadori i OSBE-se ne Kosove, Uoker, ishte nje ngjarje kyce qe ndikoi ne thirrjen e nje Konference Paqesore Nderkombetare per Kosoven ne Rambuje te Frances.
Konferenca nderkombetare paqesore per Kosoven u mbajt ne Rambuje dhe Paris prej 6 deri me 23 shkurt dhe prej 15 deri me 18 mars 1999 ne kohen kur kriza ne Kosove kishte pershkallezuar ne nje lufte te pergjakshme me rrezik shtrirjeje edhe jashte kufinjve te territorit te Republikes se Kosoves.
Konferenca paraqiste perpjekjen e fundit politike per ndaljen e luftes dhe gjenocidit serb kunder shqiptareve, vendosjen e Kosoves nen protektoratin e NATO-s, krijimin e nje statusi kalimtar per Kosoven dhe evitimin e rrezikut potencial qe kercenonte paqen dhe sigurine nderkombetare.
Konferenca ishte organizuar nga i ashtuquajturi Grup i Kontaktit dhe ne konference mori pjese delegacioni shqiptar, ai serbo-jugosllav dhe pala nderkombetare, ku benin pjese anetaret Grupit te Kontaktit dhe te shume shteteve. Delegacioni shqiptar perfaqsohej nga subjektet e atehershme politike dhe perfaqsuesit e UCK-se si dhe nga eksperte te pavarur. Konferenca kryesohej nga tre bashkekryesues Kristofer Hill nga SHBA, Volfgang Petric nga Keshilli I Evropes dhe Boris Majorski nga Federata Ruse.

Procesi negociator ne Rambuje zhvillohej mbi bazen e Projekt Marreveshjes se Rambujese, respektivisht project marreveshjes se perkohshme per Paqe dhe Veteqeverisje ne Kosove, te cilen e kishte pergaditur Grupi I Kontaktit.
Konferenca e Rambujes synonte arritjen e nje marreveshjeje juridike dhe politike per zgjidhjen politike te krizes ne Kosove, duke percakutar nje zgjidhje kalimtare qe parashihte vendosjen e Kosoves nen mbrojtjen e NATO-s, te mundesonte nje vetadministrim te perkohshem per Kosoven ne periudhne trevjecaredhe te hapte mundesine e zhvillimit ten je procesi politik per percaktimin final per Kosoven.

Ne pjesen e pare te punes se kesaj Konference, delegacioni kosovar perkrahu ne parim tekstin e marreveshjes se propozuar nga negociatoret nderkombetare dhe kerkoi qe nenshkrimin e saj ta beje pas nje konsulltimi te serishem me popullin ne Kosove. Nderkaq pala serbe, e refuzoi ne teresi marreveshjen, duke mos treguar seriozitet ne negociata dhe duke refuzuar cdo zgjidhje politike te krizes.

Ne pjesen e dyte te Konferences ne Paris, delegacioni kosovar beri nenshkrimin solemn te Marreveshjes, kurse ai serb serish e refuzoi nenshkrimin e saj.
Nenshkrimi i Marreveshjes se Rambujes nga delegacioni kosovar ka qene nje akt pragmatik, i cili mundesoi nderhyrjen ushtarake te NATO-s ne Kosove dhe clirimin e territorit te saj. Veshtruar nga aspekti i legalitetit, kjo marreveshje e eshte e paqendrueshme sepse nuk eshte nenshkruar dhe pranuar nga pala serbe.kjo eshte me rendesi te theksohet sepse Rezoluta 1244 I referohet kesaj marreveshjeje dhe parimeve te saj, si baze per statusin politik te Kosoves. Nje referim i tille, eshte plotesisht i paqendrueshem, jo vetem nga aspekti juridik por edhe ai politik.

Rambuje – momente historike dhe politike

Duke lexuar dhe studiuar ne lidhje me kete teme, duke vendosur argumentet dhe kunder-argumentet ne lidhje me Konferencen e Rambujese, na ka rastisur qe edhe te ndalemi e te mendojme edhe per kuadrot pjesemarrese ne Konference (gjithmone duke pasur parasysh anen shqiptare). Ne epoken e pas luftes kane dalur ne pah shume filiza te rinj te cilet e mbajne veten per heroj dhe te atille qe historine e shkruajne sipas interesave partiake apo thjesht sic e kerkon populli ta degjoje (theksoj duke marre parasysh shpirtin romantik te popullit shqiptar, gjegj shqiptareve te Kosoves).
Mirepo cfare ndodhi me te vertete ne Rambujes ?

A ishte Konferenca e Rambujes me te vertete zgjidhja e duhur per fatin e Kosoves dhe gjithe popullsise?
Marreveshja e Rambujese sipas Veton Surroit shperblente Kosoven e jo individet e caktuar qe ishin pjesemarres ne ate Konference. “Ajo vendoste rrugen e re revolucionare, te shtetndertimit dhe te pavaresimit... revolucionin tash do ta bente NATO-ja.”
Mirepo ish ministri I arsimit Rame Buja (gjithmone me ka habitur emri dhe mbiemri I tij qe asocon me Rambujen mirepo kjo s’eshte ceshtje per shtjellim), shfaq edhe anen tjeter te medaljes gjate nje fjalimi te mbajtur gjate aktivitetit te “Javes se Albanologjise”; “Konferenca e Rambujesë është çështja që ngjalli më së shumti debate, dyshime kundërshtime, dilema e refleksion. Konferenca e Rambujesë si mekanizëm i fundit politik për ndaljen e luftës në Kosovë solli intervenimin e NATO-s në Kosovë dhe mbi caqet e koncentrimit të Ushtrisë serbe edhe në Serbi”. Dmth nuk ka frike te pranoje se edhe vete Grupi I Kontaktit, me ne krye bashkekryesuesit dhe perfaquesit nderkombetar e kishin ate dyshimin ne funksionimin apo mosfuksionimin e Konferences se Rambujese. Duhet theksuar se siguria ishte ne nje nivel atebote te padegjuar, me qellim qe shqiptaret e delagacionit perfaqsues ne asnje moment mos te ballafaqoheshin me te deleguarit e qeverise se atehershme serbe.

"Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së vendosi shpejt për anëtarët e saj, na u shty për një ditë shkuarja, sepse Serbia nuk ka lejoi të hynim në Aeroportin e Prishtinës në ditën e parë. Problem tjetër paraqiste edhe fakti se ishim në rroba ushtarake. Të nesërmen shkuam, dikush nga Aeroporti i Prishtinës, të tjerët nga Tirana. Për shkaqe sigurie dhe nga nevoja e domosdoshme për të mos u dorëzuar të gjallë,

në rast se do të binim në ndonjë pritë, kërkuam nga miqtë tanë ndërkombëtarë që të na mundësohej për të shkuar të armatosur në konferencë dhe kjo na u lejua", tha ministri Buja, i cili shprehu bindjen e tij se Konferenca e Rambujesë ishte e vetmja në të cilën faktori ndërkombëtarë për herë të parë ishte në krah të kërkesave shqiptare.

Pse nuk dyshoi dikush mbi kete dashamiresi te nderkombetareve kur gjate historise jemi deshmitare te shume padrejtesive ne disfavor te shqiptareve?
A eshte me te vertete Konferenca e Rambujese, asi ne doren e shqiptareve apo thjesht nje e keqe e domosdoshme? (them e keqe e domosdoshme sepse perseri Kosoves i duhej te degjonte me te medhenjte ne fushe te mejdanit).

Vete statusi i padefinuar i Kosoves ishte ajo cka veshtiresonte cdo proces. Sepse ne Keshillin e Sigurimit e gjithe kjo situate shihej sin je konflikt mbrenda shtetit e jo nje konflikt midis dy shteteve. Leja per nderhyrje ushtarake ne asnje menyre nuk duhej te kerkohej tek Keshilli I Sigurimit sepse dihej qe Rusia do te perdorte veton dhe procesi jo vetem qe dongadalesohej por edhe do deshtonte. Mirepo ajo qe shtyu nderkombetaret te reagonin ne lidhje me statusin e Kosoves dhe gjendjen e saj alarmante sidomos pas Masakres se Recakut ishte gabimi I pare qe kishin bere me Srebrenicen e cila ishte shpallur si nje "Safe Zone" kurse gjate nates u masakruan mbi 10.000 civil nga militaret serb. Keshtu u hodh nje skepticizem mbi forcat nderkombetare dhe sa sa atom und ti dilnin ne krah Kosoves, ne menyre qe te mos perseritej nje Srebrenice e dyte.
Nese Konferenca e Rambollouie do kishte nje figure identifikuese, sipas mendimit tim do ishte Madeline Albright (edhe kesaj sikur zonjes Thatcher, do ia jepja epitetin "the iron lady – zonja e hekurt"). Po e shtjelloj pse.

Ne nje inteviste te dhene per "The Frontline" ajo theksoi shqetesimin e saj ne lidhje me brutalitetin e Millosheviqit qe nga viti 1989 me marrjen me force te autonomise se Kosoves dhe fillimin e trazirave ballkanike. Pse ishte e nevojshme te perdorej forca ? A nuk ishte Millosheviqi nje lider I nje shteti qe mund te zgjidhte dicka nepermjet diplomacise sikurse edhe homologet e tij ?
"Ne te gjithe e dinim se ai me se miri ka kuptuar perdorimin e forces dhe dhunes. Ai nuk e pa driten e diellit ne Bosne deri pas boimbardimeve te NATO-s e pastaj ra dakord per Marreveshjen e Dejtonit. Mirepo ne perjashtim te rastit kur kemi vendosur qe te marrim ne konsiderate perdorimin e forces, per ne ishte me e veshtire te dialogonim me nje njeri qe di vetem te perdore dhunen e njo fjalen. Ne kishim hartuar nje udhe te qendrueshme diplomatike dhe nje zgjidhje diplomatike gjate kesaj periudhe"

"Ne disa nga takimet e realizuara argumentonim nevojen per te nderhyre me force nese Millosheviqi refuzon marreveshjet politike. Mirepo ajo cka na bente pershtypje ishte mos bindja e ketij te fundit se sa te gatshem jemi ne per te perdorur forcen vetem e vetem qe ta ndalim ate per te mos shkaktuar nje tjeter katastrofe njerezore. Ai mori pjese ne nje Marreveshje qe Hollbruku kishte ndermjetesuar mirepo serbet manipuluan cdo gje dhe kjo solli radikalizimin e shqiptareve. Ne ato moment e kuptova se kishte ardhur koha te ndermerrnim masa me te rrepta kunder ketij njeriu. Une shkova edhe ne Senat ku mund te them se nuk gjeta perkrahjen e plote te te gjithe senatoreve. Disa theksonin se Ballkani nuk eshte problematike e tyrja dhe se ata mund ti zgjidhin ceshtjet mes veti. Justifikoheshin me ate se "ne kemi bere cfare kemi mundur ne Bosne, pse te merremi edhe me Kosoven ?"kurse anteret e tjere e kuptuan rendesine e nderhyrjes dhe ndihmes qe duhej dhene Kosoves drejt pavaresise se plote dhe u pajtuan se regjimi I Millosheviqit duhej luftuar. Degjuam lajmet ne radio duke thene se forcat serbe po merrnin nje ofensive pranverore, duke debuar te gjithe kosovaret. Ne morem per baze faktin se Shtetet e Bashkuara do te jene pjese e forces se zbatimit ne terren, e keshtu filluam te hartojme edhe planin per fushaten ajrore ushtarake. Isha e bindur se pot e punonim intenzivisht paqja do ishte e jona. Presidenti na autorizoi qe te perdorim forcen nese do ishte e nevojshme. Per te ishte shume e qarte se Kosova eshte shume ndryshe nga Bosna. Na u desh te bashkpunonim edhe me aleatet, duke mos dhene pershtypjen e njeanesise. Kjo ishte e rendesishme per NATO-n dhe Ballkanin. Ai erdhi deri tek ky vendim duke pelqyer idene e te pasurit nje plan se si do dukej Ballkani ne te ardhmen.

Ne kerkonim nga Serbia qe ta mbante Kosoven nen Jugosllavi por ne do dergonim nje force per ta siguruar ate. Pata pershtypjen se nuk po kerkonim shume. Kosovaret ishin te gatshem te bashkpunonin me aleatet kurse serbet kishin vendosur ti thonin JO bahskpunimit. Kjo na e beri me te lehte dhe pasqyroi nje vendim te qarte nese ne do pordornim forcen dhe pse do e perdornim. Ne te dyja Konferencat si ne Rambuje ashtu edhe ne Paris, presidenti serb ishte shume I qete ne bisedime dhe te jepte pershtypjen se ishte I gatshem per bashkpunim mirepo per nje dictator eshte shume e lehte kur ne nje grup e ka te vecuar nje individ qe te flase ne emer te te gjithe grupit negociator serb. Ne anen tjeter ishin pala kosovare, disa luftetare dhe disa qe merreshin me shume me politike. Ata kishin nje enderr ; ne perpjekje per te zhvilluar formen politike ne menyre demokratike duke e beret e ditur se kush po perfaqsohej nga kush. E ndjeja se do ishte e veshtire per te marre nje pergjigje dhe ata kerkuan qe te largoheshin ne menyre qe te konsultoheshin ne Kosove me komandantet lokale dhe njerezit e tyre. Ne te gjithe shpresonim se Millosheviqi do te ishte nje qenie njerezore e kuptueshme dhe qe nuk do te lejonte qe ti bombardohej populli vet, por ai anashkaloi cdo marreveshje duke mos I lene vend zgjidhjes diplomatike pa cka mundimit tone per ta bindur. Ne shpresonim se ai do ta kuptionte se ne kete konflikt do triumfonte SHBA-ja dhe NATO-ja"361

Eshte interesant fakti se si te gjithe pjesemarresit shqiptare ne Konference kane secili nje version te vetin, kunder njeri tjetrit, ne menyre qe figura e tyre individuale te dale triumfuese.

Po citoi "Duke u larguar prej salles, Hashim Thaci, tha me gjithe ofendim paralajmerimin per gjemen qe e priste Kosoven se "femijet tuaj do te mesojne anglisht" … Gjate Konferences me tub ere ora gjashte e mbremjes, anetaret e delegacionit nga UCK-ja, nderprisnin punimet e Delegacionit, nxirrnin nje radiotransistor dhe ne valet e shkurtra kerkonin Zerin e Amerikes shqip. Te mbledhur rreth transistorit degjonin per ngjarjen ku ata ishin protagonist. Radioja shpjegonte se ata ishin ne sallen e Keshtjelles se Rambouilletse, se ate sale po zhvilloheshin negociatat, se ne te kishte ardhur sekretarja e shtetit Madeline Albright dhe se ishte kercenuar se dota humbnin perkrahjen amerikane nese nuk e nenshkruanin Marreveshjen.
Radioja shpjegonte ate qe ata vete kishin perjetuar nje moment me pare. Ajo qe qe perjetuar ndonje moment me pare u ndodhte protagonisteve te histories, atyre qe ishin mbrenda. ndersa, tash, rreth transistorit, ishin publiku, ishin duke shikuar nga tribunat se cka po ndodhte, dhe si po ndodhte… dhe kishin nevoje qe realitetin ta kuptonin prej vendit te mirebesuar. Nuk do te besonin se dicka po ndodhte nese kete nuk e thoshte Zeri I Amerikes. Vetem atehere beheshin protagoniste te historise.
Diten, kur ne emer te Delegacionit te Kosoves nenshkrova kompromisin me te cilen Delegacioni e pranonte Marreveshjen e Rambouilletse, por kerkonke kohe shtese per konsultime dhe nenshkrim formal, Hashim Thaci, duhej te shperblehej me nje rol ardhmerie. Ishte nje gje problematike. Ai ishte terhequr nje dite me heret nga Kryesia, kishte refuzuar edhe idene per themelimin e nje Qeverie te perkohshme ku do te ishin se bashku LDK-ja dhe UCK-ja. Zgjidhjen e gjeti James Rubin, zedhenesi I Departamentit te Shtetit, I cili, nxori, me insistim te diplomatit amerikan Jim O'Brien, Hashim Thacin, nga salla e konferencave qe te mos pengonte procedimin e metejme.
Ne nje bisede gjysemoreshe pasi deshtuan te gjitha bindjet per rolin historic qe kishte Marreveshja, per rolin historic qe kishte moment ku ne mbrojtje te Kosoves viheshin Shtetet e Bashkuara te Amerikes, James Rubin I tregoi Hashim Thacit se kishte nje shok qe shkruante skenare filmash ne Hollywood dhe se ndoshta do te ishte mire qe te shkruante nje skenar per te. per nje film. Per ne Hollywood.
Dhe ne ate moment, Hashim Thaci e nderpreu oponencen e tij ndaj Marreveshjes se Rambouilletse, duke kuptuar se tashme historia po I gjente rruget e veta te avancimit dhe se ai ishte protagonist ne te. Ne histori, e mbase edhe ne filma.
Pse jane te rendesishme keto pershkrime qe duken teknike dhe, si te tilla, te bezdisshme ?
Sepse definojne politiken mbrendashqiptare ne moment te vitit 1999, ne mase te madhe, si nje revolucion te mbrendshem. Nje ne te cilin perfaqsuesve kushtimisht elitare (ne forme jo gjithpershirese qe qene zgjedhur) te shqiptareve te Kosoves, profesori I Kimise, Azem Syla, do t'u jepte urdher qe te respektohet vonesa (vonesat) e Hashim Thacit, per hi rte ruajtjes se unitetit te "faktorit politik dhe ushtarak", sic quhej atehere.

[361] Madeline Albright – Frontline Interview

Te nesermen, kur tashme kishte arritur anetari I munguar, debate nuk ishte me per ate se si do te merreshin vendimet (profesori nuk e kishte fjalen per konsensus), por se si do te zgjidhej Hashim Thaci, ne krye te Kryesise se Delagacionit te Kosoves. Nga ky kendveshtrim, ai moment I Konferences nuk ishte I luftes se UCK-se per clirim nga Serbia, por clirim nga lidershipi I Rugoves, clirim nga Rugova."362

"Kishte thirrur ne drake ne Keshtjelle, ne kater anetaret e Kryesise se Delegacionit te Kosoves, sekretarja e shtetit, Madeline Albright. Kishte vendosur qe ne ate drake te merrte pelqimin tone per marreveshjen. Ishte duke filluar te lodhej seriozisht me sjelljen tone dhe ne nje moment filloi te na qortonte me nje fjalor jo shume te zgjedhur. "Krejte kete po iu them se jam mike e juaja, se ju dua dhe ju respektoj. Ja, edhe mineralin e bukur qe ma ka dhuruar dr.Rugova ne viziten tuaj te fundit, po e mbaj ne zyren time, qe ne hyrje dhe kushdo qe vjen e me pyet per te I them se e kam nga dr.Rugova, nga Kosova."
Kur dolem, nga dreka, pa ndonje rezultat evident, fytyrat e te gjithe anetareve te Kryesise ishin te ngrysura. Para deres na priste percjellesi I dr.Rugoves, Adnan Merovci dhe kur I pa fytyrat, u brengos dhe menjeher iu drejtua shefit te tij, me pyetjen "si ia kaluat ?".
"shume mire Adnan – I tha Rugova, a mban mend ate gurin qe is dhashe sekretares Albright. Tha qe po e mban ne zyre, dhe se kush hyn e del prej aty merr vesh se ia kam dhene une, se eshte nga Kosova."
Fytyra e Adnanit u kthye ne kenaqesi. Kete e kishte reflektuar nga humori I mire I shefit, I cili ne vazhde te ketij humori iu kthye Hashim Thacit: A mos don,me ta dhan edhe ty nje gur, djale?
Hashim Thaci, dukshem nervozuar, u pergjigj: "Jo, se e cliroj une Trepcen e I marr vete."363

Mos me te vertete ishte nje qasje anti-rugoviste e ish-Kryministrit apo thjesht elita politike shqiptare nuk arrin asnjehere te jete realiste dhe te thote te verteten e te bashkpunoje ne mes vete duke I lene menjane mllefet dhe inatet ! ?

Nje personazh tjeter interesant I kesaj Konference ishte edhe Adnan Merovci I cili kujtimet e tij I pershkruan ne kete menyre: " Ne hollin e Aeroportit te Klagenfurtit ku po pritnim I tere delegacioni I Rambujeseper te vazhduar fluturimin per ne Paris, duke bere shaka me Thacin ndodhi dicka qe nuk e prisja. I thashe Thacit: "Valla edhe ti shume paqesor u bere, leshove frontin dhe tani po merresh dhe me paqe. Ja ke kalue edhe Rugoves".

Ky ishte nje humor I stilit tim cdohere me qellimin me te mire per te mbajtur nje atmosfere te kendeshme te delegacionit. Pa nje, pa dy, Thaci, futi dy duart ne xhepat e setres se vet dhe me te dyja duart nxori dy granata dore (kashikarka) dhe mi leshoi ne dore, duke dashur te me pergjigjej se cfare paqesori ishte aid he ma ktheu shpinen. U stepa, mora fryme thelle, u habita. Per te mbetur ne frymen e humorit me te dyja granatat e bllokuara qe m'i leshoi Thaci ne ted y duart, u drejtova nga Rugova dhe prof. Agani, duke dashur te kerkoj keshilla nga ata per nje situateqe as vete nuk ia dija fundin. Ata me refuzuan me fjale: "ik nga ne, dhe lej shakate!".
Mbeta si huti me dy granata ne duar. E kerkoja Thacin per t'ia dorezuar tani duke dashur ti them OK, se nuk te ngacmoj me, vetem hiqmi nga duart keto dy metale qe mu bene barre. Kur u bind Thaci qe e mora pergjigjen, m'u afua dhe mi mori te dyja granatat dhe I futi ne xhepat e setres se vet.
Nga ky moment sa komik, sa psikologjik ne mendje me preokupuan dy gjera. E para kishte te beje me nje veprim ultra naiv te Thacin per vete faktin se me vete kishte arme te tilla, dhe e dyta vete domethenia dhe arsyeja e Thacit per te qene I armatosur edhe ne keso rrethanash. Pa dashje dhe pa vetedije ne koke mu zbethye esenca e ketyre armeve.
Thaci kishte nje fletearrestim nga Serbia, po ashtu ishte nje njeri me te cilin identofikohej lufta e UCK-se, qe se bashku me perpjekjet e te gjitheve kishim ardhur deri te nje Konference nderkombetare per Kosoven. Mendja me tha, ky njeri,I gjalle, nuk do dorezohej ne duar te serbeve. M'u rrotullua

[362] Veton Surroi – "Kembet e Gjarprit" fq.17, 18, 21, 23, 24, 37
[363] Veton Surroi – "Kembet e Gjarprit" fq 118, 119

historia dhe m'u kujtua koha e Isa Boletinit. Kjo ishte ndjenja qe e mbyti paragjykimin tim per te cilesuar kete fakt si naivitet te Thacit"364

"Pas nenshkrimit te Marreveshjes delegacioni shqiptar pati nje takim me z. Uncinger rreth kthimit tone ne Kosove. Percaktim dhe perkushtim I padiskutueshem I te gjithe te pranishmeve ne delegacionin tone ishte kthimi ne Kosove, edhe pse flitej per alternativat e qendrimit te delegacionit jashte Kosoves, per shkak te rrezikut nga serbet te cilet do te bombardoheshin mbrenda ca ditesh. Ne kete kohe pothuaj te gjitha zyrat, organizatat e ndryshme, gazetaret etj. Filluan te leshojne Kosoven per shkaqe sigurie. Ne kete takim pak me rreptesi kerkova nga Z.Uncinger garanci dhe transport te delegacionit deri ne Prishtine, duke u thene se ne aspektin logjistik Konferenca perfundon me transportin tone deri ne Prishtine e jo vetem me nenshkrimin e Marreveshjes, sepse kishte tendenca qe te lihemi aty dhe cdokush sit e doje ne menyre te paorganizuar, te kthehej apo te mos kthehej. Per kete pata perkrahjen e Qosjes, Surroit dhe Rugoves"365

[364] Adnan Merovci – "Ne hap me Rugoven" fq. 278
[365] Adnan Merovci – "Ne hap me Rugoven", fq. 279

DR.SC.SHUKRI MAXHUNI, DR.SC. HALIL KUKAJ THE FACTORS IMPORTANCE TO ECONOMIZATION PRODUCED CHEESE MOZZARELLA FROM COW'S

Dr.Sc.Shurki Maxhuni, Prof.Assis.,

Dr.Sc.Halil Kukaj, Prof.Assis.

Economic Faculty, University of Prizren "Ukshin Hoti"

Summary

Milk used for cheese making is normally standardized and heat treated. In some case, milk is homogenized. An acid – producing starter culture is then added.
The standardization of milk has become necessary to ensure that the milk obtained from several producers or dairies is of a "standard" composition and condition throughout the year. This is critical in cheese making because the legal standards of various cheeses specify certain fat-to-protein rations. Though there are numerous cheese varieties, the manufacturing processes of most of them share several common steps. Variations at one or more steps during manufacture produce cheese of different textures and flavors.
Neil Schneiderman, Gail Ironson, and Scott D. Siegel Annu Rev Clin Psychol. 2005; 1: 607–628. STRESS AND HEALTH: Psychological, Behavioral, and Biological Determinants PMC2568977
Ongaro Basaglia F. (1982), Salute/Malattia: le parole della medicina, Einaudi, Torino.
Oxman, T. E., Dietrich, A. J., & Schulberg, H. C. (2005). Evidence-based models of integrated management of depression in primary care. Psychiatric Clinics of North America, 28, 1061-1077.
Plante G. Contemporary clinical psychology. New York: John Wiley, & Sons; 1999.
P. Soons and J. Denollet, "Medical Psychology Services in Dutch General Hospitals: State of the Art Developments and Recommendations for the Future," Journal of Clinical Psychology in Medical Settings, Vol. 16, No. 2, 2009, pp. 161-168. doi:10.1007/s10880-009-9158-7
Rowan Bayne, Ian Horton, Applied Psychology: Current Issues and New Directions, 2003 - 264 pagine, capter 6, James J Ëalsh, and Mark R McDermott, Health Psychology, page 79- 93 ISBN1848608586, 9781848608580
Resnick R, Rozensky R. Health psychology through the life span. Washington: APA; 1996.
Rosenstock, I. M. (1974) Historical origins of the health belief model. Health Education Monographs, 2, 328–335
Sternberg, Robert J. (Ed), Career paths in psychology: Ëhere your degree can take you.
Washington, DC, US: American Psychological Association. (1997). vii 297 pp.
Sunil Dath, Christine Yang Dong, Malcolm Ë Steëart, Eileen Sables 28th March 2014, Volume 127 Number 1391
Todd M Edwards, Anthony Stern, David D Clarke, Gabriel Ivbijaro, Mbbs frcgpfwacpsych MMedSci DFFP MA, and L Michelle Kansney, BA The treatment of patients with medically unexplained symptoms in primary care: a revieë of the literature Ment Health Fam Med. 2010 Dec; 7(4): 209–221.
The World health report. Geneva: WHO; 2002. The World Health Organization.
UK: 1995. Management Advisory Services.
World Health Organization. (2009). WHO report on the global tobacco epidemic: Implementing smoke-free environments. Geneva: World Health Organization.
Zeiss, A. M., & Karlin, B. E. (2008). Integrating mental health and primary care services in the Department of Veterans Affairs Health Care System. Journal of Clinical Psychology in Medical Settings, 15, 73-78.

PHD (C) DRITAN CEKA, PROF. ASOC. DR. FATMIR VADAHI, MSC. ANILA JAKU – ROLI I FAMILJES NË FORMIMIN E SJELLJEVE KULTURORE TË FËMIJVE

PHD (C) DRITAN CEKA
Department Education-Psychology European University of Tirana, Tirana, Albania

PROF. ASOC. DR. FATMIR VADAHI
Faculty of Education, University of Shkodra "LuigjGurakuqi", Albania

MSC. ANILA JAKU
University of Shkodra "LuigjGurakuqi", Albania

Abstrakti

Që në fillim të ekzistencës së vet shoqërore, njerëzimi ndjeu nevojën e përcaktimit të disa rregullave që duhej të respektoheshin nga të gjithë anëtarët e një bashkësie, në mënyrë që jetesa e përbashkët të ishte sa më e pranushme. Format e shfaqes së mirësjelljes mund të ndryshojnë jo vetëm nga njëri vend tek tjetri, por nga një epokë tek tjetra, duke pasur parasysh mjedisin shoqëror dhe rrethanat e ndryshme. Njeriu i ndershëm e respekton kurdoherë premtimin e dhënë, ka parime morale të shëndoshta, fisnikëri shpirëtërore, nderim ndaj vetës dhe ndaj të tjerëve. Qëllimi i çdo njeriu është të bëjë një jetë të këndëshme, të bukur edhe kur individi që është më pak konformist, mund të arrijë në këtë përfundim. Qëllimi dhe detyra edukative të familjes te na janë në pajtim me qëllimin dhe detyrat e përgjithshme edukative në shoqërinë tonë. Familja tuj vepruar në mënyrë unike me të gjithë faktorët tjerë edukativ jep një kontribut të rëndësishëm në edukatën e fëmijëve të zhvilluar të gjithanshëm i cili është shtylla krysore në edukimin e fëmijëve në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve.

Fjalët Çelësa: Familja, fëmijët, sjelljet, kultura

Hyrja

Familja është bashkësi parësore njerëzore, ku individi së pari takohet me kushtet e jetës shoqërore,të cilat ia përcaktojnë atij kornizën, në të cilën ai mund të zhvillohet si individ,kështu që mund të themi se personaliteti njerëzor formohet në procesin e ndërveprimit të të gjithë fakëtorve shoqëror.
Formimi i personalitetit "është proces kompleks i cili përfshin: 1.Kultivimin dhe zhvillimin e aftësive të konsiderushme fundamentale njerëzore, e që arrihet me bartjen e elementeve thelbësore të kulturës tek fëmija. Me anë të të mësuarit merren përvoja të ndryshme të një kulture të dhënë dhe bëhët aftësimi për vetëveprim dhe pjesëmarrje në procesin krijues të zhvillimit kulturor. 2.Socializimin si proces në të cilin fëmija inkorporohet brenda rregullativave shoqërore,përmes roleve dhe normave me të cilat njoftohet ai,krijon njëkohësishtë masa dhe kritere personale të sjelljes. 3. Individualizimin,si proces me ndihmën e të cilit zhvillohet sistemi i brendshëm i motivimit dhe kuadrit orientues në përputhje me cilësitë personale të individit.

Fëmija nuk lind i formuar,por ai lind me predispozita që të bëhet njeri i formuar në konteksin e ndërveprimit të fakëtorve shoqëror. Ai së pari e njeh familjen e vet dhe gradualisht bëhet personalitet gjatë interaksionit të ndërlikuar kulturor të jetës shoqërore. Duke qenë në kontakt direkt me prindërit dhe antarër tjerë të familjes fëmija gradualisht socializohet. Në familje ai mëson se si duhet të sillet brenda dhe jashtë saj. E gjithë kjo ndodh në fëmijërinë e hershme,pastaj në periudhën e pubertetit-adoleshencës,duke vazhduar me periudhën kur individi bëhet person i rritur dhe kalon nëpër procese komplekse të pjekurisë gjatë formësimit të përsonalitetit të tij."

Familja është një koncept i gjerë i cili,përfshinë tërë procesin me anë të të cilit ne zhvillohemi,përmes interaksionit me njerëz të tjerë,mënyra e të menduarit,ndijimit dhe veprimit që janë thelbësore për një pjesmarrje efektive brenda shoqërisë.

Familja është proces i gjatë nga i cili individi në interaksion me antarët e mjedisit social përvetëson shkathtësi,shprehi,qëndrime,norma,vlera dhe njohuri të reja të nevojshme për t'u inkuadruar në grupin shoqëror dhe në jetë.Individi socializohet gjatë gjithë jetës së tij. Socailizimi parësor zhvillohet në familje, në entet parashkollore dhe në shkollën fillore dhe vazhdon gjatë gjithë jetës.
Edukata te fëmijët zë fill nga prirjet natyrore të tij,nevojat dhe zhvillimi spontan. Edukimi merr një domethënie sociale. Ai është një aksion i socializimit dhe moralizimit.
Që familja të plotësojnë detyrën e vet të ndërlikuar për formimin e përsonalitetit,të rëndësishme janë edhe ndryshimet shoqërore. Për ndërtimin e personalitetit është e nevojshme që si familja ashtu edhe shoqëria në tërësi të plotësojnë detyrën përkatëse,ngase ndërtimi komplet mund të formohet vetëm në ndërveprim reciprok të grupit familjar dhe shoqërisë në tërsi.

Qëllimi i hulumtimit dhe objektivat e studimit

Me këtë hulumtim synojmë t'i nxjerrim disa rezultate dhe të konstatohet se sa ndikon roli i familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijëve, po ashtu jemi përpjekur të tregojme se sa ndikon roli i familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijëve. Ky studim synon të na shërbejë si ndihmesë në ndikimin e familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijëve. Kemi pas një komunikim shumë të afërt më nxënsit po ashtu edhe me mësimdhënsit,edhe nga ana e tyre është pritur mirë anketimi jonë në klasën e tyre si dhe bashkëbisedimi jonë më ta ka qenë shumë korrekt i afërt në formë bashkëbisedimi. Para se ta bëjmë anketimin së pari kemi biseduar me to,ju kemi treguar arsyet e hulutimit si dhe ju kemi shpjeguar rëndësin e këtij hulumtimi. Tek ato kemi gjetur një mirëkuptim të mirë dhe hulumtimi është realizuar me sukses.

Objekti i Hulumtimit

Për ta përmbledhë në një mënyrë më përmbledhse objekti i hulumtimit është: Roli i familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve. Meqë problemi i sjelljeve kulturore të fëmijve dhe roli i familjes në formimin e sjelljeve kulturore kohëve të fundit është mjaf aktual, kërkon një qasje bukur afatëgjate të një ekipi profesionistësh, disiplinave të ndryshme, dhe nga pamundësia që ta bëjmë këtë,u përcaktuam që këtë problem ta hulumtojmë dhe ta studiojmë në komunën e Ulqinit pikërishtë në shkollat e qytetit dhe të rrethinës së Ulqinit.
Problemin e rolit të familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve e trajtuam nga të gjitha aspektet, pra edhe në aspektin historik, duke vështruar problemin që nga kohërat më të vjetra e deri më sot. Kështu shfletuam dhe e analizuam tërë materjalin që arritëm ta siguronim, për të parë se ç'është menduar, ç'është shkruar në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror, pastaj sesi e kanë trajtuar shkencetarët e profileve të ndryshme këtë problem etj.

Pyetja kërkimore, hipotesa dhe metodologjia e punimit

Pyetja kërkimore e këtij hulumtimi është sa ndikon familja në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve?
Hipoteza-Supozojmë se familja si faktorë i parë edukativë, ndikon dukshëm në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve, si dhe në arsimimin, edukimin dhe formimin e personalitetit shoqëror, me fjalë tjera është shtylla kryesore e formimit të sjelljeve kulturore të fëmijëve.

1.Rëndësia e hulumtimit nisur nga faktet që tema është aktuale dhe e pa hulumtuar deri më sot jemi përcaktuar ta hulumtojmë rrolin e familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve.
2.Instrumentet e hulumtimit
Për ta hulumtuar problemin, kam pregaditur instrumentet për hulumtim. Prej instrumenteve për hulumtim kam përdorur pyetësorë të cilët kanë përmbajtur 6 pyetje, secila pyetje ka pasur 3 e më

shumë përgjigje alternative.Me anë të këtyre pyetësorve kam marrë mendimet e nxënësve dhe mësimdhënsve lidhur me rrolin e familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve. Para se të bëhej hulumtimi ne kemi shkuar, kemi biseduar së pari me to, ju kemi shpjeguar arsyet e këtij hulumtimi, nga ana e tyre kemi pasë një bashkëpunim shumë të mirë dhe frytdhënës. Metoda përmes pyetësorve ishte menduar si metoda më e mirë për të nxjerrë të dhënat e nevojshme për këtë studim.

Detyrat e Hulumtimit

Për ta kryer me sukses hulumtimin dhe për t'ia arritur qëllimit në këtë studim,i kam parashturuar disa detyra.Më poshtë do t'i paraqes disa prej detyrave që është dashur t'i krye gjatë punës hulumtuse:
-Për sa na lejojnë mundësitë objektive, të konsultojmë literaturën e drejtëpërdejtë dhe tërthortë, lidhur me problemin.
-Kemi studiuar aspektin teorik të këtijë problemi.
-Kam bërë anketimin e nxënësve, dhe mësimdhënsve.
-Kam bërë analizën e rezultateve të instrumenteve të hulumtimit.
-Kam krahasuar ato rezultate në mes veti,dmth materiali i nxjerë nga dokumaentacioni pedagogjik është nënshtruar përpunimi statestikor.
-Kam bërë sistematizimin e rezultateve të mbledhura.
-Gjithashtu kam bërë paraqitjen tabelore dhe grafike të rezultateve.
-Më në fund kam bërë interpretimin e rezultateve dhe nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimeve.
-Nga të gjitha materjalet e grumbulluara do të përpiqemi ti nxjerrim përfundimet e nevojshme.

Popullacioni dhe mostrat

Popullacioni i këtij problemi është i madh dhe heterogjen.Me që këtë problem nuk ka mundësi ta studiojmë në popullacion, por jam përcaktuar ta bëj në një mostër të zgjedhur,posaçarisht me qëllim të hulumtimit të problemit.
Popullacionin e këtij problemi e përbëjnë nxënësit e shkollave në Komunën e Ulqinit. Meqë numri i rasteve individuale të popullacionit është shumë i madhë jam orjentuar që këtë problem ta studiojë vetëm në disa klasë të shkollës dhe me disa mësimdhënës. Numri i nxënësve që ka marrë pjesë në hulumtim ka qenë 270 nxënës ndërsa mësimdhënës kanë qenë 130.

Trajtimi teorik i problemit

Rroli i familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve është një problematikë me të cilën janë marrë e merren teoricientë të fushave të ndryshme. Andaj, që të trajtohet ky problem në nivelin që e meriton,duhet studiuar literaturë nga fusha e edukimit, e drejtësisë, e psikologjisë, pedagogjisë dhe e sociologjisë.
"Mësimi si aktivitet njerëzor,është i lashtë,sa edhe vetë njeriu,si qenie shoqërore. Ai, si veprimtari e organizuar dhe specifike e me rëndësi të madhe shoqërore u paraqit në kohën e formacionit ekonomiko-shoqëror skllavopronar"366.Këtë problematikë fillimisht do ta trajtojm në aspektin teorik. Kjo nënkupton që të ndalemi në pika të shkurta rreth rrolit të familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve. Në kuadër të kësaj, në mënyrë retrospektive dhe të shkurtër do t'i paraqes disa prej periudhave të zhvillimit të edukatës dhe qasjes ndaj rrolit të familjes ne formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve. Jo çdo herë fëmija është i trajnuar mirë ashtu si e meriton. Ka pasur periudha kur fëmija, përveç që është privuar nga shumë të drejta që i kanë takuar,ai shumë herë është ndëshkuar edhe fizikisht. Pas kësaj do të ndalem në mënyrë më konkret e rreth temës, ku do te përpiqem t'i paraqes rrolin e familjes në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijve. Në kuadër të po të këtij kapitulli do të përpiqem të bëj fjalë edhe për të drejtat e fëmijve në edukim dhe arsim. Në vazhdim do të bëj fjalë për sjelljet e kulturuara të individit (sjelljet e pëlqyera), kodin e sjelljeve të pelqyera, mirësjelljen, marrëdhënjet midis edukatës familjare dhe asaj shoqërore etj.

[366]Dr.Januz, H.Dërvodeli, Dallimet në suksesin e nxënsve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe, Prishtinë, 2010, fq.13.

Familja është vatër e çdo njeriut në formimin e sjelljeve kulturore si tek fëmijët ashtu edhe tek të moshuarit, është bartëse e proceseve të pandërpreshme shoqërore, në mirësjelljen e njerëzve si në shoqëri po ashtu edhe në rrethin familjarë dhe gjithkund ku ato gjinden dhe veprojnë. Në doktrinat sociologjike familja merret ndër agjendët më të rëndësishëm të formimit të personalitetit, në të ndikon gjithçka vepruse në formë direkte dhe indirekte. Familja është faktori ku fëmija kalonë pjesën më të madhe të jetës, ku formon, rritë dhe edukon personalitetin. Rasti i parë i mirësjelljes, duhet të ketë qenë atëherë kur individi primitiv që jetonte në shpellë, nuk thirri si i çmendur kur gjeti ushqim,sepse vuri re se aty pranë flinte një grua me një fëmijë në krah. Nuk mundë të dimë mesiguri, sado imagjinatë që të kemi,nëse i kërkoi edhe falje.

Formimi i sjelljeve kulturore

Sjelljet kulturore apo të pëlqyeshme u krijuan në oborret mbretërore dhe u përshtaten nga aristokracia, e vetmja klasë asokohe që mund të vendoste nëse një zakon, normë a rregull duhej përvetësuar detyrimisht nga njerëzit. Me daljen në skenë të Borgjezisë, ato (sjellje kulturore) filluan të përgjithësohen, duke u bërë pastaj në ditët tona, të pranuara. Sjellja kulturore prandaj, parapraktisht nënkupton formimin e bindjes së individit për ta nderuar dhe rrespektuar personalitetin tjetër, dhe se ky gjest është në të vërtetë një gjest human i tij. Zhvillimin dhe formimin e shprehisë së individit për sjellje kulturore ndaj prindërve,ndaj mësimdhënësve, ndaj të moshuarëve,ndaj shokëve dhe të rinjëve, pastaj mirësjellja në familje, në shkollë, në fakultet, në vende publike (në teater, kino, etj) gjatë kohës së punës dhe argëtimit-duhet formuar në vazhdimësi përmes ndikimit të faktorëve edukativ. "Askush nuk është kaq i parëndësishëm sa të mos meritojë një përshendetje. Ludvigu i XIV përshendeste edhe gjellëbërsen me dashamirësi"367.

Sjelljet kulturore duhet të aplikohen edhe në Kuzhinë, pastaj për të kërkuar leje nga familja, shkolla, pastaj duhet formohet shprehia për trokitje në derë para se të hyhet brenda, pastaj nuk duhet të hapen letrat postare dhe dokumentacionet e tjerëve. Gjithashtu duhet të formohet shprehia për ecje kulturore, të mos bëhemi zhurmaxhi, të mos përdoren fjalë të ndyta, të mos shfrytëzohen gjuha e rrugës,të mos ofendohen dhe fyhen të tjeret, etj. Ka rëndësi edhe formimi i shprehisë për pedantëri në veshmbathje dhe kudo tjetër. Gjithashtu ka rëndësi formimi i shprehisë kulturore për të folur bukur, rrjedhshëm, drejt e pa gabime, pastaj biseda nuk duhet të zhvillohen me një tonë tepër të lartë apo shumë të ultë. Ka rëndësi gjithashtu prezantimi (paraqitja) e individit në mënyrë kultuorore, mandej përshendetja duhet të jetë vërtetë përshendetje, e jo njëfarë përshëndetje sa për sy e faqe, që nuk përkon apo që bie ndesh me normat morale të sjelljes njërzore. Kështu aspak nuk i ka hije njeriut (nxënësit, studentit, profesorit, etj.) të përshendes me duar në xhepa, me cigare në gojë, të përshendes me kokë të këthyer anash, etj. Kuptohet mirësjelljet kulturore nuk duhet të ushtërohen vetëm në familje, po edhe në rrugë, në kumunikacion e kudo tjetër. Po ashtu duhet krijuar shprehinë për sjellje kulturore tek të rit sidomos, po edhe te të tjeret, që të mos e pengojnë palen tjetër gjatë bisedës, sepse edhe biseda e ka një rend. Të përdoren në përditshmëri shprehitë: Ju lutem, urdhëroni, na falni, iu bëftë mirë dreka, iu dëshiroi punë të suksesshme, kalim të këndëshëm, gjitha të mirat etj.

Kodi i sjelljeve të pëlqyera sot

Nuk është psikologjia e para që trajton problemin e rëndësishëm veçanarishtë për një shoqëri në tranzicion,të sjelljes së kulturuar. Nga pikëpamja e sjelljes së kulturuar,përqafimi dhe puthja nuk janë të lejushme në publik. Një film i famshëm titullohej "Në këtë botë, të dashuruarit janë vetëm". Fatkeqsisht, kjo gjë nuk është e vertetë. Megjithëse ndodh që ata të ndihen vetëm, bota është e pranishme përreth tyre, kurreshtare, ironike, me thashetheme. Them "fatkeqsisht" sepse një botë vetëm me të dashuruar do të kishte qenë shumë e bukur! "Intriga të zëshë në gojë për keq ata që nuk janë të pranishëm tregojnë se je njeri pa karakter. Dhe është një lojë mjaftë e rrezikshme, pa informata arrin shumë në veshin e personit të përgojuar. Nëse e njeh këtë vertetë dhe përgojon,tregon edhe se nuk je aspak i zgjuar... Të mos e shqetësojmë kurrë tjetrin duke i treguar gjëra të papëlqyeshme"368.

[367]Prof. Dr. Kozma Grillo, Kodi i sjelljeve të pelqyera sot, Tiranë, 2004, fq.161
[368]Dr. Veljo Korac, Historia e doktrinaveshoqërore e politike, Sarajevë,1967, fq. 171

Problemet vetjake... Edhe sikur t'ju luten, mos u përzini në grindjet e prindërve me fëmijët e tyre, të një çifti të të dashuruarve ose të miqve. Ata do të pajtohen, kurse ju do të mbeteni fajtor. Secili për hesapin e vet të drejtë dhe këto janë problemet e tyre. Anonimati dhe sjelljet e kulturuara... As në familje e as në rrethin e të afërmve tanë gabimet nuk na i fal kush. Thënë troç, shoqëria i mënjanon njërzit e paedukuar."369

Moshat e reja,edukata dhe sjellja e kulturuar

Në shoqërinë shqiptare rritet dhe edukohet një rini e shëndetëshme në të gjitha rrafshet.Jo vetëm politikisht e ideologjikisht,por edhe etnikisht, për nga shija,edukata sjellja.
Mirëpo ende vërehen sjellje të pahijshme të fëmijve e të të rinjve.Kuptohet,ato janë një pasqyrim i drejtpërdrejtë i edukatës qytetare të të rriturve,jo vetëm i karakteristikave pozitive,por edhe i mangësive të saj.Disa herë,sidomos në biseda të lira,midis prindërve,mësuesve,përgjithësisht të rriturve,madje edhe të atyre që mendojnë se flasin e gjykojnë me përgjegjësi ka çarje e ankime veçanërisht për sjelljen dhe edukatën e rinisë.

"Është tepër e qartë se ka një rëndësi të dorës së parë që të gjitha normat e edukatës sonë qytetare të spikatin në sjelljen e kulturuar të fëmijve e të të rinjve,që ata të dinë të sillen bukur,të rrespektojnë rendin publik,rregullat e bashkëjetesës me të mëdhenjtë në moshë etj.Por në këtë mes luajnë rrol edhe karakateristikat moshore psikologjike,njohja e tyre nga të rriturit,zhvillimi i punës edukative në përshtatje me këto karakterisitika.Vjen një ditë dhe ikën fëmijëria,me bukurinë dhe gjallërinë e saj,me dinamizmin dhe karakteristikat.Shfaqen paraadoleshenca dhe adoleshenca,siç u thojnë ndryshe,mituria,mosha e parë kalimtare në jëtë,që konsiderohet edhe një farë moshë kritike,kur problemi që sapo shtruam,bëhet edhe më i mprehtë.Si rregull,ajo kap fëmijët 11-12 vjeçarë gjer në 15-16 vjeçarë"370. Prandaj quhet edhe mosha e mesme shkollore dhe zakonisht,përkon me ciklin e shkollimit të mesëm të lartë. Fëmijët e kësaj moshe ruajnë shumë karakteristika të moshës paraardhëse,fëmijërore,por tek ata shfaqen edhe dukuri të reja.Në rradhë të parë, ata fillojnë të mos e ndienë veten fëmijë dhe në mënyrë të veçantë,nuk duan që të rriturit,sidomos të afërmit,e veçanarishtë prindërit e mësuesit t'i trajtojnë si të tillë.Fillon t'u duket vetja "të rriturr".Shfaqet prirja e hershme për një afirmim sa më të plotë të personalitetit të tyre,për më shumë pavarësi.

Si u shfaqen sjelljet e mira, të pëlqyera

Që në fillim të ekzistencës së vet shoqërore,njerëzimi ndjeu nevojën e përcaktimit të disa rregullave që duhej të rrespektoheshin nga të gjithë anëtarët e një bashkësie,në mënytë që jetesa e përbashkët të ishte sa më e pranushme.Në mënyrë paradoksale,këto rregulla të kodifikuara dhe të përvetsishme nuk kufizonin lirinë e individit,por përkundrazi e zgjeronin.Duke ditur me saktësi se si duhej të sillej në të gjitha rastet,në jetën e përditshme,njeriu i edukuar e ndjeu veten më të sigurt,shpëtonte nga komplekset,pranohej dhe respektohej nga të gjithë me një fjalë e ndien vetën më të lirë."Sjelljet e pëlqyshme u krijuan në oborret mbretërore dhe u përshtaten nga aristokracia,e vetmja klasë asokohe që mund të vendoste nëse një zakon i caktuar duhej përvetësuar detyrimisht nga njerëzit.Për këtë arsye,gjatë shekujve XV dhe XVI sjelljet e pëlqyshme ose të mira përfaqësonin një stil të veçantë jetese.Krahas me daljen në skenë të borgjezisë,ato filluan të përgjithësoheshin,duke u bërë në ditët tona të pranuara"371.Por ndërsa shoqëria zhvillohet,disa prej tyre mbeten anakronike,ashtu siç ndodhë që disa të tjera ndryshojnë nga një shtet në tjetrin.Sikundër dihet,për të hyrë në kodin e sjelljeve të pëlqyshme,një zakon duhet të përballojë provën e kohës,dhe kjo ndodhë për arsye se jeta shoqërore pëson ndryshime. Mjaft zakone,prej shumë vjetësh,nuk kanë më asnjë lidhje me ngjarje që i kanë krijuar. Vallë,kush mendon sot se heqia e kapelës për të përshendetur dikë e ka zanafillën në zakonin e kalorësve,të cilët,pas mbarimit të një gare e zbulonin fytyrën që të njiheshin nga publiku. Psh.në Francë,sallata në mënyrë tradiconale shërbehet pas pijatës kryesore dhe hahet vetëm me pirun dhe me thikë. Në Itali pihet "kapuçino"vetëm në mengjes.Në Gjermani psh nuk puthet dora e grave

[369]Prof. Dr. Kozma Grillo „Kodi i sjelljeve të pëlqyera sot", Tiranë, 2004, fq.162
[370]Dr.HamitBeqaj,Rrjedhat e historisësëedukatësdhetëkulturës,Tiranë ,1983,fq,55.
[371]AurelaMarinesku,Kodi i sjelljevetëpëlqyera sot,Tiranë,2002.

por është forcuar zakoni që njerëzit të jenë të përpiktë,zakon ky që duhet zbatuar me çdo kusht. Në Kanada si edhe në shtete të tjera ekziston zakoni për të dhuruar lule në numër çift.

Arti i bashkëbisedimit dhe sjellja në shoqëri

Rreziku më i madhë që kërcënon çdo tubim,si rreth tryezës familjare,ashtu edhe në takimin ose pritjen më solemne,është mërzija.Mjeti më i sigurt kundër saj është bashkëbisedimi.Nuk mund të zotroshë mënjëherë sekretin me të cilin zhduk mërzitjen,dhe të del përpara një tjetër pengesë,duke u përpjekur që të zhdukësh mërzitjen,ka rrezik që të bëhesh i padashur,qesharak.Prandaj në këto raste duhet të kesh takt,të jesh i vëmendshëm,të jesh një tip i gjallë,të kesh humor,kulturë,sjellje të pëlqyeshme dhe mbi të gjitha të jesh i sinqertë.Shpeshherë në jetën e përditshme edhe në këtë fushë paraqiten dy qëndrime të gabuara.”Disa janë shumë të sigurt në vetvete,fillojnë të flasin pa pushim,këpusin të njoma dhe të thata,duke mos i lejuar të tjerët të flasin edhe ata,të marrin pjesë,pra në atë diskutim.Disa të tjerë qëndërojnë në skajin tjetër,këta nuk flasin,pasi kanë frikë të tmerrshme se mos gabojnë,ndaj nuk shfaqin asnjë mendim,por belbëzojnë vazhdimisht vetëm.”372.
Arti i bashkëbisedimit nuk mësohet si formulat matematikore,ai fitohet,pak a shumë,si një gjuhë e huaj,duke respektuar disa rregulla dhe duke u ushtruar vazhdimisht.Asnjë bisedë e përgjithshme ndërmjet dhjetë a dymbëdhjet personash nuk mund të zgjatet pa mbarim.Prandaj një zot shtëpie duhet t’i grupojë të ftuarit sipas disa kritereve të caktuar.Por rreth kësaj çështje duhet të mendohemi që në çastin kur i ftojmë miqët.Duhet të kemi parasyshë se takimet në grup do të kenë më shumë suksese,do të jenë ato kur të ftuarit janë të një profesioni ose kanë të njëjtat dëshira dhe pasione.Në rast se kemi mjekë të ftuar ata do të bisedonin rreth problemeve me interes të përbashkët dmth.mjekësore.Gjithashtu,po të ftojmë vetëm pedagogë biseda e tyre do të vërehet vetëm rreth problemeve didaktike etj.

Sjellja e fëmijve dhe rroli i mësuesit,qëndrime të ndryshme për këtë problem

Çdo fëmijë ka një mënyrë sjellje që përmban në vetvete elementë pozitivë dhe negativë. Çdo fëmijë dëshiron dhe ka nevojë për një mënyrë të sjellur pozitive,pa të cilën ata ndjehen të pasigurt dhe të pafatë të krijojnë lidhje të drejta me të tjerët,bëjnë interpretime jo të qarta për mënyrën e sjelljes së tyre,etj.
Po t’i lesh në dorë fëmijës të flasë për kuptimin e jetës,të vendosë për punën në grup,të vendosë për pavarsinë e tij në zhvillimin e aftësive për bashkëpunim më të tjerët,fëmijët bëjnë gabime dhe shpesh arrijnë në përfundim se janë të pafatë dhe të lënë mënjëanë nga të rriturit.
Mësueset kanë detyrën dhe përgjegjësinë të udhëheqin sjelljen e fëmijve,ta pasurojnë atë me elementë pozitivë dhe ta lehtësojë nga elementët negativë,t’i aftësojë ata të kontrrollojnë vetveten dhe të vlersojnë mënyrën e sjelljes së tyre373.Mësueset duhet të qartësohen dhe të aftësohen në përdorimin e teknikave të ndryshme për të realizuar një mënyrë sjellje efikase të fëmijve.

Modifikimi i sjelljes

Nga literatura pedagogjike dimë që çdo sjellje ka qenë rezultative,e pranushme nga shoqëria ndërsa,sjelljet të cilat shoqërohen nga një pasojë e pakëndëshme ka të ngjarë të mos përseritet.Në këtë parim të vjetër të edukimit të sjelljes gjenden rrënjët e teknikës së modifikimit të sjelljes.Ndjekja e këtij parimi do të thotë se mësusja mund të shpërblejë ata fëmijë që kryejnë porositë e saj.P.sh. ata të cilët rrinë urtë dhe bashkëpunojnë me mësusen mund të marrin ndonjë shpërblim të veçantë,të tjerët të cilët ngrejnë dorën përpara se të flasin shpërblejnë me diçka tjetër,etj.Teoria e modifikimit të sjelljes shërben për të udhëhequr edukimin e sjelljeve të fëmijve dhe funksionon mirë kur dihen të përdoren teknikat e saj.Është mënyrë efikase për të modifikuar sjellejn e fëmijeve,por është me rëndësi të kuptohen parimet e saj.Nëse nuk kuptohen parimet dhe nuk përvetsohen tërësisht teknikat e përdorimit të teorisë së modifikimit të sjelljes së fëmijve mund të gabohet duke përforcuar sjellje të cilat nuk janë të dëshirushme.

[372] Aurelia Marinesku,Kodi i sjelljevetëpëlqyshme sot,Omsca,Tiranë,2002,fq 68.
[373]FatmirVadahi,Pedagogjia Parashkollore,fq.60.

Analizë, interpretimi të dhënash

Hulumtimi është organizuar dhe kryer në shkollat ”në komunën e Ulqinit. Këtu kam marrë opinionet nga mësimëdhënsit dhe nga nxënësit lidhur me rrolin që ka familja në formimin e sjelljeve kulturore të fëmijëve.
Për të qenë rezultatet sa më të qarta,ato i kemi paraqitur në mënyrë grafike. Rezultatet e fituara i kemi paraqitur dhe sqaruar përmes skemave grafike të shtyllave,duke dhënë sqarime plotësuse për secilën skemë grafike.Për hulumtim kemi anketuar 270 nxënës dhe 130 mësimdhënës të shkollave fillore (nga klasa e parë deri në klasë të nëntë). Gjatë këtij hulumtimi kam pasë nji përkrahje shumë të madhe nga ana e mësimdhënësve po ashtu edhe nga stafi administrativ i shkollës ku më kanë dhënë një përkrahje jashtëzakonisht të madhe,dhe prandaj unë jam shumë falenderues për ndihmën që më kanë dhënë. Pytjet në pyetësor janë të tipit të mbyllur dmth secila pyetje ka pasur minimum 3 a ma shumë përgjegje alternative gjë që është kërkuar të rrumbullaksohet një a ma shume përgjegje. Pyetjet kanë qenë shumë të qarta dhe në formë rrumbullaksuese. Nxënëist janë përgjigjur në mënyrë individuale po ashtu edhe mësimdhënsit janë përgjigjur individualisht dhe kanë dhënë mendimin e tyre personal.
Me anë të ngjyrës së kaltërt kam paraqitur rezultatet e nxënsves ndërsa me ngjyrë të kyqe janë të paraqitur rezultatet e mësimdhënësve.

Grafiku nr. 1: Sipas mendimit tuaj,çka ndikon më së shumti familja në fëmijë:



a) në zhvillimin psiko-shëndetësor
b) në veshmbathje dhe edukim
c) në shprehi për punë
d) në sjellje dhe mirësjelljen e tyre

Në pyetjen e pare ka pasur 4 përgjegje alternative pytja ka qenë: Sipas mendimit tuaj, çka ndikon më së shumti familja në fëmijët?

Nga 270 nxënës të anketuar 24% shprehen se familja ndikon në zhvillimin psiko-shëndetësor, përkundër tek mësimdhësit janë nga 130 të anketuar del që 40% e tyre mendojnë në zhvillimin psiko-shëndetësor, në përgjegjen e dytë 7,5% e nxënësve deklarohen se familja ndikon në veshmbathje dhe edukim ndërsa mësimdhënsit 3,5%,kurse në përgjegjen e tretë, në shprehi dhe punë janë përgjegjur 7,5% ndërsa mësimdhënsit 6,5%,në pyetjen e katërt,në sjellje dhe mirësjelljen e tyre 61% e nxënsve kanë dhënë këtë përgjegje kurse 50% e mësimdhënsve kanë dhënë këtë përgjegje.Siç tek nxënësit poashtu edhe tek mësimdhënsit del se familja ndikon më së shumti në sjelljen dhe mirësjelljen e tyre.

Grafiku nr. 2:Cilat familje ndikon më së shumti në formimin e sjelljeve ndaj fëmijës:



a) ajo që ka një arsimim pedagogjik
b) ajo që mbretëron një atmosfere autoritare
c) ajo që i mungon kujdesi ndaj fëmijëve

Në pyetjen e dytë të parashturar secila familje ndikon më së shumti në forcimin e sjelljeve ndaj fëmijës, nga nxënësit e anketuar del se 70% e tyre mendojnë në përgjegjen e parë,16% mendojnë në përgjegjen e dytë, ndërsa 14% deklarohen për përgjegjen e tretë. Ngjajshëm kemi pothuaj edhe rezultatin tek mësimdhënsit ato në përgjegjen e pare deklarohen 60% e tyre në përgjegjen e dytë 23% ndërsa në përgjegjen e tretë deklarohen rreth 17% e tyre.Nga kjo pytje mund të themi se në formimin e sjelljeve ndaj fëmijve ndikon ajo familje që ka një arsimim pedagogjik dhe që ndërton një edukate të mirëfillët intelektuale.

Grafiku nr. 3:.Ku tregojnë më së shumti mirësjellje fëmijët:



a) në familje
b) në shkollë
c) në rrethin ku jetojnë ata

Në pytjen e tretë me rradhe se ku tregojnë fëmijët më së shumti mirësjellje kemi këto rezultate ku tregojnë se 14% e fëmijëve mendojnë në familje,67% mendojnë në shkollë dhe 19% mendojnë në rrethin ku jetojnë,ndërsa mësimdhënsit tregojnë këtë rezultat në pytjen e parë deklarohen 14% në pytjen e dytë 63% ndërsa në të tretën 23%.Si nxënësit po ashtu edhe mësimdhënsit mendojnë se fëmija më së shumti mirësjellje tregon në shkollë.

Grafiku nr. 4: Sipas mendimit tuaj,cilët faktorë edukativ i çmojnë dhe vlerësoj në sjelljet dhe mirësjelljet kulturore:



a) mësimdhënësit
b) prindërit
c) rrethi shoqëror
d) mjetet e informimit

Në pytjen e katërt,sipas mendimit tuaj,cilët faktorë edukativë i çmojnë dhe vlerësojnë sjelljet dhe mirësjelljet kulturore:Në përgjegjen e pare deklarohen 53% në të dytën 19% dhe në të tretën 21% ndërsa në të katërtën 7%.Tek mësimdhënësit kemi këto rezultate në përgjegjen e parë janë deklaruar 73% në të dytën 10% po ashtu edhe në të tretën 10% ndërsa në përgjegjen e katërt 7%.Nga ky rezultat mund të konkludojmë se mësimdhënësit janë faktorë edukativ të cilët i çmojnë dhe vlersojnë sjelljet dhe mirësjelljet kulturore.

Grafiku nr.5: Çka përfitojnë fëmijët nga përdorimi i sjelljeve kulturore:

a) rrespektin
b) dashurinë
c) falënderimin
d) buzëqeshjen
e) mirësjelljen
f) gëzimin
g) motivimin



Në pytjen se çka përfitojnë fëmijët nga përdorimi i sjelljeve kulturore kemi këto rezultate: në përgjegjen e pare janë deklaruar 56% në të dytën 10% në të tretën 3% në të katërtën 2% në të pestën 5% në të gjashtën 11% dhe në të shtatën 13%.Tek mësimdhënësit kemi këto rezultate përgjegjen e parë 43%, të dytën 7%, të tretën 3%, të katërtën 7%, të pestën 10%, të gjashtën 23%, dhe të shtatën 7%. Nga rezultatet që kemi nxjerrë del se fëmijët më së shumti përfitojnë respektin.

Grafiku nr.6: Çfarë është mendimi juaj,se ku i formon më së shumti fëmija sjelljet kulturore:



a) në familje
b) në shkollë
c) në rrethin shoqëror
d) në familje dhe shkollë

Në pytjen e gjashtë kemi këto rezultate.Në përgjegjen e parë janë deklaruar 13% në të dytën 7% në të tretën po ashtu 7% dhe në të katërtën 73%. Tek mësimdhënësit kemi këto rezultate në përgjegjen e parë 34% në të dytën 13% në të tretën 3% dhe në të katërtën 50%.Nga rezultatet që kemi nxjerre del se fëmija i formonë më së shumti sjelljet kulturore në shkollë dhe në famlije.

Përfundime dhe Rekomandime

Familja është shtylla kryesore ku fëmia formon,përvetëson,aftëson sjelljet e qytetëruara në jetën e përditshme.Familja është ajo që në të mëson sjellje të pëlqyera,psh.të dishë dhe të rrespektosh ma të vjetërin,të vishësh në mënyrë korrekte në çdo rrethanë të bisedosh lirshëm me një rreth të caktuar shoqëror që frekuenton,të jeshë në gjendje të përballosh situata nga më të ndërlikuarat në takimin më të sofistikuar ose psh,në restorane si të sillesh në bare në kafene etj. Rroli i familjes është shumë shumë i madhë në formimin e sjelljeve kulturore.Lirisht mund të themi që familja ndikon shumë në sjelljet dhe mirësjelljet e fëmijëve,ndikon shumë në arsimimin pedagogjik,fëmija tregonë mirësjellje të mirë në procesin arsimor në shkollë. Po ashtu edhe fëmijët me sjelle kulturore përfitojnë shumë në respekt,në dashuri,në falenderim,në buzëqeshje,në mirësjellje,në gëzim,në motivim etj.Por vlen të theksohet që një grup i fëmijëve nuk i përdorin sjelljet kulturore të tyre fatkeqësisht sa duhet. Dihet mirë se fëmijët më së lehti i fitojnë sjelljet e kulturuara në moshën e fëmirisë pra dmth sa është në gjirin familjarë. Familja është ajo ku fëmija fiton sjelljet e kulturuar,është faktori vendimtarë që fëmija ndikon tek përvetësimi i sjelljeve kulturore personale dhe shoqërore të individit,është faktori i parë i edukimit të fëmijës. Institucioni familje nuk mund ta kufizojë veprimtarinë tij vetëm në formulimin e identitetit të fëmijës, ai duhet të bashkëpunojë ngusht me pedagogun dhe psikologun e shkollës për marvajtjen e edukimit gjatë procesit shkollorë.

Biblografia

Aurelia, Marinesku, Kodi i sjelljeve të pëlqyera sot, Omsca, Tiranë, 2002.
Beqaj, Dr. Hamit,Rrjedhat e histories së edukates dhe të kulturës,Tiranë ,1983.
Deva-Zuna, dr. Aferdita, Edukimi i parashkollorit në familje, Prishtinë, 2003.
Deva-Zuna, dr. Aferdita, Partneriteti, Shkollë-Familje-Komunitet, Prishtinë, 2009.
Dërvodeli, dr. Januz, Dallimi në suksesin e nxënësve të shkollës fillore , Prishtinë, 2010.
Kerneta, Ljubomir dhe Potkonjak, Nikolla, Pedagogjia, Pristinë, 1965.
Korac, Dr.Veljo, Historia e doktrinave shoqërore e politike,Sarajevë,1967.
Mailaaret, Gastron, Pedagogjia e Përgjithshme, Koha, Prishtinë, 1997.
Montesori, Maria, Zbulimi i fëmijës, Plejad, Tiranë,2009.
Vadahi, dr. Fatmir ,Pedagogjia Parashkollore, 2002, Shkodër.
Trnavac, Nedeljko dhe Dordevic Jovan, Pedagogija, Beograd, 2010.
Tamo,dr.Adem, Pedagogjia (për shkollat e mesme pedagogjike), ISP,Tiranë,1995.

MARSELA SAKO - DIMENSIONE TË METODËS SË ZGJIDHJES SË PROBLEMIT

MARSELA SAKO

Universiteti i Tiranës-Fakulteti i swhkencave politike

Abstrakt

Në bibliografinë botërore rreth teorisë së zgjidhjes së konflikteve dominojnë dy tendenca kryesore, përkatësisht ajo që thekson dimensionin objektiv dhe ajo që përqëndrohet kryesisht në anën subjektive të konflikteve. Ndryshimi midis qasjes që i mëshon më shumë natyrës objektive të konflikteve, shprehje e së cilës është Realizmi (Morgenthau, Bull, Scharzenberg) dhe qasjes që i mëshon më shumë natyrës subjektive të konflikteve, që përfaqësohet nga Pluralizmi (Burton, Kelman), konsiderohet gjithashtu edhe një ndryshim shkencor në hapësirën e shkencave sociale. Në funksion të sa më sipër, vlen të theksohet se qëllimi i këtij punimi është eksplorimi i "metodës së zgjidhjes së problemit", shprehje e dimensionit subjektiv, që konsiderohet si një ndër metodat më të rëndësishme në funksion të menaxhimit dhe zgjidhjes së situatave të ndryshme konfliktuale.

Fjalë kyçe: perceptim, dimension subjektiv, zgjidhje konflikti, ndërmjetësim, bashkëbisedim

Hyrje

Disiplina e "Zgjidhjes së Konflikteve" i ka fillesat e saj në vitet 1950-1960, në një periudhë që shënon edhe kulminacionin e Luftës së Ftohtë. Rreziku që po i kanosej njerëzimit pikërisht në periudhën e zhvillimit të armëve bërthamore dhe konflikteve të vazhdueshme midis superfuqive, shërbeu si nxitje për studiues nga disiplina të ndryshme, të cilët arritën të perceptonin si të një rëndësie të veçantë studimin e konflikteve, duke e konsideruar atë si një fenomen të përgjithshëm.
Fundi i Luftës së Ftohtë i gjeti një numër të madh studiuesish, të paqartë për të kuptuar, pse realiteti i ri ndërkombëtar nuk ishte një vend i paqshëm. "Rendi i Ri Botëror" nuk paraqitej sikundër ishte parashikuar. Përveç kësaj studimet e konflikteve filluan të merreshin me analizimin e një kategorie të re konfliktesh që ishin "konfliktet e brendshme etnike", të njohura ndryshe si luftra të llojit të tretë. Kur filloi të bëhej e qartë se këto konflikte që ishin në thelb identitare nuk lidheshin në mënyrë rigoroze me etnicitetin, atëherë filluan të bëheshin edhe klasifikime të tjera të tilla si: konflikte "etnopolitike", "konflikte sociale të zgjatura në kohë", dhe së fundmi emërtimi më përdorur "konflikte me bazë identiteti" (Rotham, J., Olson, Marie L 2001: 290).
Vlen të nënvizohet fakti se, disiplina e "Zgjidhjes së Konflikteve" kishte si veçori të sajën kundërshtimin e disiplinave të tjera në lidhje me qëndrimet e tyre kundrejt konflikteve.
Në këtë kontekst duhet theksuar se, studimet për zgjidhjen e konflikteve më tepër kanë evoluar si një formë kritike, veçanërisht ndaj qasjes realiste dhe konkretisht ndaj mënyrës sesi analizohej prej saj realiteti ndërkomëtar. Sipas këndvështimit realist,"Zgjidhja e Konflikteve" konsideroohej jo reale dhe një trajtim i butë i një realiteti në të cilin "dëshira për të dominuar… përbën një element thelbësor të bashkësisë njerëzore" dhe ku, "aspiratat e njeriut për pushtet nuk janë kurresesi një aksident i historisë, apo një devijim i përkohshëm nga një shtet i lire, por përkundrazi janë karakteristikat kryesore të natyrës njerëzore" (Donnelly, J, 2000: 47-48). Hobbes ishte ndër të parët që arriti në konkluzionin se gjendja natyrore e njeriut konsiderohet situata e luftës. Në këtë kontekts vlen të theksohet se, sipas realistëve konfliktet shkaktohen si rezultat i antagonizmit të vazhdueshëm të shteteve për të vendosur kontrollin mbi burimet të caktuara natyrore (A.B.Fetherson, 2000: 7).
Sipas kësaj perspektive, konfliktet konsiderohen totalisht të një natyre objektive, duke përjashtuar në këtë mënyrë rolin e dimensionit subjektiv. Arsyet objektive sipas të cilave i konsideron realizmi konfliktet janë në përputhshmëri të plotë dhe me strategjitë e zgjidhjes që aplikohen prej tij, të cilat

synojnë gjithmonë drejt zgjidhjeve të shumës zero (zero-sum, njeri fiton-tjetri humbet), duke u fokusuar në mënyrë eksluzive në papajtueshmërinë e interesave. Në këtë pikë të trajtimit vlen të nënvizohet fakti se disiplina e "Zgjidhjes së Konflikteve" e sfidon realizmin në shumë plane.

Metoda e "Zgjidhjes së Problemit"

John Burton mbetet një ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të teorisë së zgjidhjes së konflikteve si dhe një ndër oponentët kryesorë të realizmit dhe të "Power Politics" në përgjithësi (Griffiths, M., 2001: 90). Metodat jo tradicionale të zgjidhjes së konflikteve - jo tradicionale si për nga natyra apo roli i palës së tretë, ashtu edhe për nga mënyra e zhvillimit të bashkëbisedimeve ndërmjet palëve konfliktuale - u zhvilluan teorikisht nga John Burton në Universitetin e Londës, i cili konsiderohet edhe pionieri i themelimit të saj, si edhe nga Herbert Kelman profesor në Universitetin e Harvardit. Ndër autorët më të vonshëm, por po aq të rëndësishëm, të kësaj teorie, mund të përmendim midis të tjerëve edhe Edëard Azar nga Universiteti i Maryland, C.R. Mitchell dhe Dennis J.D. Sandole (në bashkëpunim me John Ë. Burton) nga Universiteti i George Mason, nga A.J.R. Groom në Universitetin Kent dhe nga Roland J.Fisher nga Universiteti i Harvardit (Ηρακλειδις, Α., Κωστακος, Γ., Φραχκολοπουλος, Χ 1994: 97).

E njohur ndryshe si qasja e "konflikteve subjektive", kjo metodë është e lidhur ngushtësisht me John Burton, që me të drejtë mund të konsiderohet edhe si themeluesi i dimensionit psikologjik të politikës së jashtme (teoria e perceptimeve, ikonave-stereotipeve) (Ηρακλειδις, Α., Κωστακος, Γ., Φραχκολοπουλος, Χ 1994: 98).

Zgjidhja e problemit (problem – solving), është një metodw që synon të transformojë çdo lloj situate konfliktuale të shumës zero, në një situatë të shumës jo zero (positive – sum).

Përsa kohë që shtetet vënë në përdorim mjete që shpesh i përjetësojnë konfliktet, Burton argumenton se zgjidhja e konflikteve si në nivele ndërshtetërore, ashtu edhe në nivele të brendshme shtetërore, nuk duhet të lihet vetëm në dorën e palëve të përfshira në konflikt.

Ai përkrah idenë e ndërmjetësimit të palëve të treta që mund ta asistojnë procesin. Karakteristikat kryesore te kesaj metode janë dy. Së pari pala e trete nuk ndërhyn energjikisht duke ofruar zgjidhje si ndërhyrësi klasik, por thjesht lehteson zhvillimin e dialogut duke ofruar sqarime të ndryshme, ose duke dhënë shpjegime shkencore dhe teknike në lidhje me mosmarreveshjet në përgjithësi, apo duke u bazuar në ngjarje të vërtetuara. Pala e tretë nuk paraqet ndonje zgjidhje konkrete, roli i saj është të ndihmojë për fillimin e bisedimeve dhe të nxisi palet për arritjen e një marrëveshjeje të suksesshme midis tyre.

Megjithëse mbetet pak e praktikuar nga dipllomatët, kjo metodë ka pasur një shtrirje të gjerë tek studiuesit të cilët janë angazhuar drejpërsëdrejti me ndërmjetësimin e palëve të përfshira në konflikte. Situatat konfliktuale, që kanë pasur edhe aplikimet më të shpeshta të kësaj metode lidhen me çështjen Qipriote, Irlandën e Veriut, Lindjen e Mesme, Indi- Pakistan, Afrikë, Sri Lanka, SHBA, në ish Bashkimin Sovjetik etj. (Rotham, J., Marie L. Olson, 2001: 299).

Sipas Burton dhe autorëve të tjerë, që konfliktet e dhunshme të zgjidhen duhet të përmbushen të paktën 3 nevojat më të rëndësishme që lidhen me: identitetin, sigurinë dhe mundësinë e zhvillimit (A.B.Fetherson, 2000: 7). Studiuesi Burton i qëndron fort idesë se "mospërmbushja e nevojave" mbetet arsyeja kryesore për ekzistencën e konflikteve të dhunshme në shoqërinë njerëzore (Griffiths., M, 2001: 92). Ai argumenton se kur institucionet dhe normat shoqërore janë të papajtueshme me nevojat e qënësishme njerëzore, atëherë rezultati do të jetë shfaqja e agresivitetit dhe konflikteve. Argumenti lidhet me faktin se agresiviteti dhe sjelljet anti – sociale, stimulohen nga kushte të caktuara shoqërore.

Burton argumenton se qeveritë duhet të reflektojnë vlerat dhe të përmbushin nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të tyre, në mënyrë që të jenë sa më legjitime. Përsa kohë që ekzistojnë dallime midis interesave sistemike nga njëra anë dhe qëllimeve dhe vlerave që përfaqësojnë autoritetet nga ana tjetër atëherë flasim për një .."nivel të reduktuar të legjitimitetit social" (Griffiths., M, 2001: 111).

Nevojat njerëzore të cilat janë frustuar nga institucionet do të duhet që në një mënyrë apo tjetër të përmbushen. Individët duhet të jenë të pregatitur që të shkojnë deri aty, sa të mund të sfidojnë sistemet në mënyrë që të përmbushin kërkesat e tyre që lidhen me nevoja thelbësore (Dennis J.D Sandole, 2006: 560).

Nga pikëpamja teorike ekziston një propozim i thjeshtë, se në rastet kur nevoja të caktuara nuk janë përmbushur në nivele të kënaqshme, atëherë do të ketë konflikt. Konflikti do të jetë i një natyre të tillë që çdo përpjekje për ta shtypur konfliktin në fakt, do të shërbejë për përshkallëzimin e mëtejshëm të tij (Dennis J.D Sandole,2006: 560).
Shumë studiues të Zgjidhjes së Konflikteve, argumentojnë se konfliktet në vetvete përbëhen nga një anë ondologjike të bazuar në nevojat njerëzore, mohimi apo refuzimi i të cilave shkakton konfliktet e dhunshme. Kjo mënyrë e të perceptuarit konsideron si burime objektive të konflikteve nevojat dhe jo interesat (A.B.Fetherson, 2000: 2).
Për sa kohë që konfiktet e dhunshme kanë gjithmonë arsye objektive ato kanë gjithmonë edhe arsye subjektive. Konfliktet ashtu si çdo lloj veprimtarie apo nisme në fushën politike, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, përcaktohen në pjesën më të madhe nga mënyra sesi ne i kuptojmë ato. Realiteti kombëtar dhe ai ndërkombëtar perceptohet në mënyra të ndryshme nga aktorë të ndryshëm edhe pse tipikisht të gjithë mund të shohin të njëjtin fenomen. Tema merr dimensione të vecanta nëqoftëse do duhet të merren vendime konkrete, në mënyrë që aktori 'A" të reagojë ndaj aktit të aktorit "B". Në këtë mënyrë ana psikologjike e konflikteve që është shprehje e dimensionit subjektiv, bëhet shoqërues i pandashëm i dimensionit objektiv (Ηρακλειδις, A, 2000).
E quajtur ndryshe edhe "komunikimi i monitoruar ", qasja e përfaqësuar nga Burton mbledh sëbashku përfaqësues nga nivele të larta të shtetit apo grupeve të përfshira në konfliktet e dhunshme, me qëllim zhvillimin e bisedimeve joformale të asistuara nga studiues të shkencave sociale (Lisa J. Freeman., Ronald J. Fisher, 2012: 68).
Ndërsa përfaqësuesi tjetër, po aq i njohur i kësaj qasjeje Herbert Kelman, ka preferuar që në grupet e vogla jonformale pjesëmarrësit të mos jenë njerëz të niveleve të larta me pozita vendimmarrëse (policy makers), por individë që gëzojnë autoritet.

Veçoritë e metodës

Krahasuar me metodat e tjera tradicionale të dipllomacisë zyrtare "metoda e zgjidhjes së problemit", synon eksplorimin në thellësi të shkaqeve që kanë çuar në përshkallëzimin e marrëdhënieve konfliktuale. Veçantitë kryesore të saj lidhen me krijimin e një terreni të duhur për zhvillimin e komunikimit të drejpërdrejtë midis palëve apo zhvillimin e konsultimeve, të cilat kanë si qëllim të ndryshojnë në mënyrë graduale qëndrimet e palëve ndaj mosmarrëveshjes, pra nga një konflikt në një problem, i cili të mund të zgjidhet lehtë nëse palët vendosin të bashkëpunojnë. Zgjidhja mund të arrihet – nqs arrihet – nëpërmjet analizës që i bëhet në thellësi mosmarrëveshjes, duke marrë në konsideratë vazhdimisht nevojat themelore të njeriut, dhe promovimin e paqes, drejtësisë dhe barazisë (Rotham, J., Olson, Marie L., 2001: 291).

Argumentohet se aplikimi i qasjeve tradicionale, të cilat përqëndrohen më tepër në përdorimin e fuqisë dhe pushtetit në zgjidhjen e konflikteve, shpesh kanë pasur efektin e acarimit apo përshkallëzimit të konfliktit. Është e qartë psh. se: konfliktet që lidhen me çështjet e identitetit, në vetvete përmbajnë edhe shumë elementë, që lidhen me interesa të tjera të prekshme. Megjithatë, duke iu referuar në këtë pikë të trajtesës teoricienit (njëkohësisht profesor në Universitetin e Harvardit) Kelman, i cili është marrë eksluzivisht me çështjen Izrael- Palestinë, i mëshohet idesë se konflikti në fjalë, apo dhe konflikte të tjera të ngjashme me të, nuk mund të zgjidhen në mënyrë përfundimtare, nëse nuk punohet për rritjen e besueshmërisë që palët duhet të kenë tek njëra-tjetra. E rëndësishme në situata të tilla është vendosja e komunikimit të vërtetë midis palëve të përfshira në konflikt, që mund të arrihet si rezultat i heqjes së pengesave psikologjike (të tilla si: frika, mosbesimi, keqinterpretimet, konceptet e gabuara, stereotipet e ndryshme për armikun etj), dhe me krijimin e një klime të fortë besimi (Rotham, J.,. Olson, Marie L., 2001: 29).

Kelman argumenton se konflikti Izrael - Palestinë, nuk mund të zgjidhet nëpërmjet përdorimit të forcës, që nënkupton se një zgjidhje e imponuar në këtë rast nuk do të ishte veçse afatshkurtër, për shkak se thelbi i konfliktit konsiderohet i pazgjidhur. Konflikti për të njëjtën vlerë (psh, për të njëjtën hapësirë territoriale) konsiderohet vetëm sipërfaqësor për shkak se sikundër argumenton Kelman, pas tij fshihen të tjera vlera më të rëndësishme të tilla si: siguria, mbijetesa, zhvillimi etj. që në thelb

përbëjnë vlera jo sasiore dhe si të tilla bëhet domosdoshmëri keshillimi i paleve të përfshira në konflikt, që të mund të behen realitet.
Mënyra që do mund të çojë në një zgjidhje afatgjatë të konfliktit Izrael –Palestinë sipas Kelman, është krijimi i marrëdhënieve të reja që do duhet të bazohen në respektin e ndërsjelltë të palëve, dhe veçanërisht për çështjet që lidhen me identitetin kombëtar reciprokisht. Ajo që sugjerohet se duhet të ndodhë me qëllim instalimin e një paqeje afatgjatë , sipas autorit, është "negociimi i identiteteve". Çdo lloj përpjekjeje tjetër sipas tij, që anashkalon këtë element do të ketë efektin e polarizimit të mëtejshëm në qëndrimet e palëve të përfshira në konflikt (Rotham, J., Olson, Marie L., 2001: 291).

Sipas Kelman tre duhet të jenë rregullat bazë në procedurën e "zgjidhjes së problemit": privatësia dhe konfidencialiteti i procedurave, duhet të ekzistojë besim paraprak për arritjen e një marrëveshjeje si dhe barazia e palëve gjatë bashkëbisedimeve (Lisa J. Freeman., Ronald J. Fisher 2012: 69). Pala e tretë e cila është pjesë e procesit, në të gjitha rastet përfaqësohet nga studiues të shkencave sociale, të cilët zotërojnë njohuri të mjaftueshme rreth dinamikave të konfliktit dhe proceseve sociale në përgjithësi. Pala e tretë në këtë rast nuk ndërhyn energjikisht duke ofruar zgjidhje si ndërhyrësi klasik, por thjesht lehtëson zhvillimin e dialogut duke ofruar sqarime të ndryshme ose duke asistuar me shpjegime shkencore e teknike në lidhje me mosmarrëveshjet në përgjithësi apo duke u bazuar në ngjarje të vërtetuara, mbajnë shënim çdo gjë që thuhet gjatë diskutimit dhe së fundmi bëjnë të njohur vërejtjet ndaj procesit në lidhje me mënyrën e ndërveprimit midis palëve. Vënia e theksit mbi elementët subjektivë - perceptime, qëndrime, besim, përkushtim, komunikim, orientim – dallon rolin konsultues të palës së tretë, nga roli i ndërmjetësuesit klasik. Kjo metodë bazohet në supozimin se, përmirësimi i elementëve subjektivë të konfliktit do të mundësojë arritjen e një bashkëpunimi midis palëve (Lisa J. Freeman., Ronald J. Fisher 2012: 69).
Sipas metodës së "zgjidhjes së problemit", konflikti perceptohet si subjektiv dhe kjo jo sepse ekziston ne "mendjet e njerezve", por sepse ekziston mundesia e ndryshimit te politikes midis palëve qe kane mosmarreveshje, pa qene nevoja qe te ndryshoj realiteti i jashtem objektiv, i cili ka sherbyer si shtyse per formimin e qendrimeve konfliktuale fillestare, prej te cilave lindi me pas edhe konflikti (Ηρακλειδις, Α., Κωστακος, Γ., Φραχκολοπουλος, Χ 1994: 99).
Bashkebisedimet ne kuadrin e kësaj metode mund te ndahen ne dy faza. Më konkretisht, në fazën e parë theksi vihet në arritjen e një komunikimi të vërtetë midis paleve, që mund të realizohet si rezultat i heqjes së pengesave psikologjike që ndojnë palët konfliktuale (të tilla si: frika, mosbesimi, keqinterpretimet, konceptet e gabuara, stereotipet e ndryshme per armikun etj) dhe në krijimin e një klime besimi.
Në fazën e dytë të bisedimeve fillon hierarkia e qëllimeve dhe vlerave: së pari kërkimi i vlerave reale të cilat nuk janë materiale apo sasior, por që në të njëjtën kohë përbëjnë rrënjët e vërteta të konfliktit, dhe së dyti analizimi në mënyrë të arsyeshme të kostos së konfliktit në lidhje kjo me vlerat që synohen. Me shtimin e të tjera vlerave dhe me rishqyrtimin që i behet mosmarreveshjes, konflikti pushon së qeni i shumes zero, dhe palët arrijnë me kalimin e kohës në përfundimin se zgjidhja mund të jetë e dobishme për to (Ηρακλειδις, Α., Κωστακος, Γ., Φραχκολοπουλος, Χ 1994: 100).
Metoda e "zgjidhjes së problemit" i mëshon idesë se asnjë zgjidhje konflikti (përfshirë si konfliktet ndërshtetërore, ashtu edhe konfliktet e brendshme, ndryshe luftrat e llojit të tretë) nuk duhet konsideruar e "shumës 0", pra si zgjidhje në të cilën njëra palë i fiton të gjitha dhe pala tjetër i humbet të gjitha . Të gjitha konfliktet mund të shndërrohen në konflikte të "shumës jo- zero", dhe ku asnjërës palë nuk do t'i duhet të tërhiqet, apo të bëjë koncesione të imponuara.

Në vënd të përfundimit...
"Zgjidhja e problemit" është konsideruar nga Burton, Kelman dhe të tjerë studiues më shumë sesa një metodë për zgjidhjen e konflikteve. Që në gjenezë është perceptuar si një koncept qëndror i idesë së paradigmës së ndryshuar rreth sjelljes dhe konflikteve në përgjithësi, të cilat janë konsideronte esenciale nëse njerëzimi dëshironte të shmangte situatat katastrofike.
Sipas kësaj metode të aplikuar gjerësisht në funksion të zgjidhjes, si të konflikteve me natyrë ndërkombëtare, ashtu edhe të konflikteve të brendshme (luftrat e llojit të tretë), argumentohet se situatat e konflikteve do duhen të menaxhohen duke marrë në konsideratë, më tepër sesa arsyet

objektive (qëndrimet realiste), nevojat ondologjike të natyrës njerëzore, mohimi i të cilave shkakton lindjen e konflikteve.
Në thelb kjo metodë nuk përbën thjesht dhe vetëm një koncept të ri radikal mbi situatat konfliktuale dhe procesin drejt arritjes së paqes. Më tepër sesa kaq, parakupton një pozicionim të gjerë filozofik, që mund të kontribuojë në mënyrë vendimtare në mbijetesën e shoqërive si në nivel kombëtar, ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Bibliografia

Griffiths., M : Fifty Key Thinkers in International Relation, Routledge, 2001.
Ηρακλειδις, Α., Κωστακος, Γ., Φραχκολοπουλος, Χ : Διεθνεις διενεζσεις, Αντιμετοπιση και Επιληση, Σιδερης, 1994.
Miall, H., Ramsbotham, O, Woodhouse, T. Contemporary conflict resolution, Polity Press & Blackëell Publishers, 1999.
Rotham, J., Marie L. Olson : From Interests to Identities:Toward a New Emphasis to Interactive Conflict Resolution, Journal of Peace Research, 2001.
A.B.Fetherson : From Conflict resolution to Transformative Peacebuilding: Reflections from Croatia, University of Bradford: Centre for Conflict Resolution, 2000.
Dennis J.D Sandole : Tradicional "Realism" versus the "New" Realism: John Burton, Conflict Provention, and the Elusive "Paradigm Shift", Global Society, 2006.
Ηρακλειδις, Α: Αναλυση και επιλυση συνγρουσεων Συμειωσεις, Παντειο Πανεπιστιμιο , Αθηνα 2000.
Lisa J. Freeman., Ronald J. Fisher : Comparing a Problem-Solving Workshop to a Conflict Assessment Framework: Conflict Analysis Versus Conflict Assessment in Practice, Journal of Peacebuilding & Development, 2012.
Rotham, J., Olson, Marie L: From Interests to Identities:Toward a New Emphasis to Interactive Conflict Resolution, Journal of Peace Research, 2001.
Donnelly, J : Realism and International Relations, Cambridge University Press, 2000.

PHD. (C) DRITA KRYEZIU – NDËRLIDHJA E EDUKIMIT MUZIKOR ME LËNDËT TJERA MËSIMORE

PhD. (C) DRITA KRYEZIU
European University of Tirana, Albania

Abstrakti

Ndërlidhja dhe vazhdimësia në mësimdhënien është e një rëndësie të veçantë pasi që nxënia e përmbajtjes mësimore realizohet më e plotë dhe më me sukses.
Ndërlidhja e edukimit muzikor me lëndët tjera është shumë e nevojshme duke u nisur nga vetë fakti që këto ndërlidhje sjellin kreativitet dhe atmosferë në procesin mësimor.
Në ketë punim kemi realizuar disa ndërlidhje duke u nisur nga: ndërlidhja e edukimit muzikor me letërsinë – poezinë; ndërlidhja e edukimit muzikor me vallëzimin; ndërlidhja e edukimit muzikor me artin figurative; ndërlidhja e edukimit muzikor me lëndën e historisë; ndërlidhja e edukimit muzikor me njohjen e kulturës së popujve të ndryshëm si dhe ndërlidhje mjaftë e ngushtë është lidhja në mes të cilësive muzikore dhe shtrirjes gjeografike.
Lidhjet e muzikës me artet tjera janë të pakontestueshme, meqë për t'i ndarë artet nga njëri – tjetri është pretendim i pamundur për qëllimin e trajtimit të mirëfilltë dhe të kompletuar (çdo njëri prej arteve të bën për vete dhe të ndihmon në shpjegimin e fenomeneve dhe dukurive të ndryshme).
Në këtë punim janë paraqitur shembuj të ndryshëm për secilën ndërlidhje për të parë se si reflektohet kur ndërlidhen lëndët mes veti.

Fjalët kyçe: ndërlidhja, edukimi muzikor, mësimdhënia, nxënësit.

Hyrje

Ky punim përqëndrohet në ndërlidhjen e edukimit muzikor me lëndët tjera mësimore sidomos me ato që bazohen në arte. Në mënyrë të veçantë theksohet simbioza muzikë – poezi si ndërlidhje e natyrshme e formave të punës në kuadër të lëndëve edukatë muzikore – gjuhë amtare, edukatë muzikore, gjuhë e huaj.

Ndërlidhja muzikë – lëvizje është argument i fuqishëm i raportit të pashkëputshëm mes tyre gjë që transmetohet gati në të gjitha format e mësimit të muzikës. Në punim veçanërisht theksohet vallja si tërësi estetike që ndërlidhet edhe me edukimin fizik.

Paraqitja vizuale e dukurive muzikore përmes simboleve të ndryshme është formë e shkëlqyeshme e gërshetimit asociativ audio – vizual.

Në vazhdim paraqitet ndërlidhja muzikë – shprehje figurative duke u ndalur në hulumtimet nga literatura por dhe në një shembull nga praktika jonë shkollore ku dëgjimi i një kompozimi bëhet inspirim për krijimin e një vizatimi që përkon me shprehjen e kompozimit.

Po ashtu në vazhdim të këtij punimi duke reflektuar në ndërlidhje theksohet fakti se nxënësit përmes këngës përjetojnë më thellë ngjarjet dhe personazhet historike se sa kur jepen vetëm fakte historike poashtu në kontekstin e njohjes së kombeve dhe vendeve të ndryshme ndërlidhja e folklorit muzikor të tyre mundëson përjetimin edhe të vlerave shpirtërore të tyre.

Ndërlidhja e edukimit muzikor me letërsinë – poezinë

Edhe pse muzika, letërsia – poezia janë të pavarura kanë një fushë të gjerë të analogjive formale dhe esenciale. Gjatë zhvillimit të tyre historik, këto arte kanë qenë bazë e bashkëveprimit në fushën e muzikës vokale, formave vokalo- instrumentale dhe të artit skenik si opera, opereta, melodrama, pjesë me këndim etj.

Në të kaluarën dhe tash muzika është shfaqur me lloje të tjera artesh, posaçërisht me poezinë me ç'rast janë bërë përpjekje për të paraqitur diçka, për të shprehur apo edhe për të kërkuar diçka.
Kështu që muzika edhe mund të ndihmoj por edhe të jetë e ndihmuar nga poezia.
Kjo lidhje e muzikës dhe poezisë ka qenë praktikisht më e frytshme në lëmin e
muzikës vokale dhe formave tjera muzikore, në të cilat merr pjesë zëri i njeriut.
Lidhjet e muzikës dhe të poezisë janë të pashkëputshme. Ndërlidhja e vijës melodike në unitet me poezinë është më afër nxënësit. Ato së bashku(ushtrimet melodike me tekste poetike), zhvillojnë veshin muzikor te nxënësit.

Muzika është pjesë e marrëdhënieve të letërsisë edhe me artet e tjera. Marëdhëniet e para të muzikës me letërsin kanë qenë të ndërsjellta më pas ato u shëndërruan në forma të ndryshme komunikimi.
Fjala ka domethënie të caktuar, ajo ngërthen në vete '' idenë'', krahasuar me tingullin i cili është fenomen akustik por njëkohësisht estetik, mirëpo si i tillë nuk ka domethënie krejtësisht të përcaktuar si fjala. Fjala në letërsi sajon një vepër, që më vonë mund të quhet roman apo edhe ndonjë gjini tjetër letrare, ashtu edhe tingulli si element themelor i muzikës, është atom në formimin e një përmbajtjeje specifike të re muzikore.

Si mund të ndërlidhen këto shprehje artistike në procesin mësimor?
Muzika e dëgjuar mund t'i nxitë nxënësit me prirje letrare të hartojnë ndonjë përmbajtje letrare, në formë tregimi apo poezie.
Shkrimtarët dhe kompozitorët gjithmonë e kanë gjetur një gjuhë të përbashkët dhe kanë ndërlidhur veprimtarinë e tyre me njëra - tjetrën.
Në historinë e muzikës ka të dhëna se njeriu ka kënduar mu atëherë kur filloi të flasë.
Përveç ndërlidhjes së edukimit muzikor me gjuhën amtare ajo poashtu ka të bëjë edhe me gjuhët e huaja dhe është e një rëndësie të veçantë në procesin edukativ arsimor.
Pedagogët e gjuhëve të huaja aplikojnë këngë, të cilat ndihmojnë mësimin e gjuhëve të ndryshme ngase fjalët e huaja përmes këngës mbahen mend më lehtë.
Me këtë rast bashkëveprohet në dy sfera njëkohësisht: në sferën njohëse: kuptimore dhe emocionale.

Ndërlidhja e edukimit muzikor me lëvizjen:

Raportin e ngushtë në mes të muzikës dhe lëvizjes si tërësi estetike do ta ndjejnë nxënësit në vallet popullore dhe fëmijërore, të cilat mund të realizohen të ndërlidhura si në edukatën muzikore ashtu edhe të lëndës edukatë fizike.

Shumë forma të hershme të muzikës dhe valles u krijuan dhe u interpretuan së bashku. Ky zhvillim i përbashkët ka vazhduar gjatë kohëve me format e valles - muzikës të tilla si : valle e shpejtë, e ngadalëshme, e gëzueshme e deri në vallet aktuale si: vals, tango, elektronike, hip – hop etj.
Gjithashtu disa zhanre muzikore kane një formë paralele valleje të tilla si muzikë barok dhe valle barok ndërsa të tjerat zhvillohen të ndara : muzikë klasike dhe balet klasik.

"Lëvizjen nuk duhet ta konsiderojmë vetëm si funksion muskulor, por si rrjedhim të një mendimi që zgjatë, kurse muzikën nuk e konsiderojmë vetëm lojë tingujsh, por si forcë të brendshme, e cila të lëvizë. Kështu fillon loja e pashtershme, e pasur dhe e njëpasnjëshme e raporteve në mes njërës dhe tjetrës, me kohën, hapësirën, forcën dhe formën".374 – thotë Josip Kramershek në librin e tij "Estetska gimnastika".

[374] Krameršek, Josip. Estetska Gimnastika - Osnovi. Zagreb 1952, fq. 69

Varësisht nga karakteri i veprës, nxënësit do t'i realizojnë edhe lëvizjet: me temp të shpejtë, karakter të gëzueshëm - lëvizje të gjalla, marshi – me lëvizje të mprehta, kompozimi lirik – lëvizjet e gjëra dhe të buta.

Frymëmarrja, intonimi i saktë, cilësia e zërit, këndimi pa shtrëngime dhe diksioni me një edukim të mirëfilltë, ndërlidhin kulturën vokale dhe kulturën e lëvizjes.
Aftësitë e nxënësëve zhvillohen dhe formohen në mënyrë graduale, por nxënësi në çdo etapë të zhvillimit është krijesë e tërësishme. Të tërësishëm janë edhe karakteri, të shprehurit dhe përjetimet e tij.

Kur loja është e përcjellur me muzikë i bënë nxënësit më të gjallë, më të hareshëm, më atraktiv.
Çdo vepër e re e dëgjuar nxënësit e përcjellin në forma të ndryshme, në mënyrë sponatne pasi që muzika nxitë emocione dhe ndjenjat thellohen te ata.
Gjithashtu duhet patur kujdes në përzgjedhjen e materialit që do t'ju ofrojmë nxënësve pasi që në rend të parë ai duhet t'ju përshtatet moshës së tyre, në mënyrë që ata të kenë mundësi përjetimi sa më të thellë.

Këngët me karakter vallëzues janë më të afërta për ta ngase në të njejtën kohë këndojnë dhe vallezojnë. Ja një këngë e cila mund t'i nxitë nxënësit më të vegjël që të këndojnë e të vallëzojnë njekohësisht.

Shembulli: F.Beqiri

Zilja jone



375

Kjo këngë është e realizuar në praktikë ku së pari është bërë demonstrimi i këngës duke vazhduar kështu me një bisedë të shkurtër.

Ndëridhja e edukimit muzikor me artin figurativ:

Në aktivitetet e ndryshme muzikore – krijuese nxënësi mund të paraqitet si krijues, interpret dhe vlerësues i punës apo lojës së vet dhe kjo mund të merret si një ndërlidhje më vete të aktivitetit. Mbresat emocionale që i përjetojnë nxënësit duke dëgjuar një vepër muzikore, sidomos me karakter programor, mund të nxisin kreativitetin e tyre për të vizatuar dhe anasjelltas, tablotë figurative mund të zgjojnë imagjinatën për krijimtarinë e tyre muzikore.
Në procesin edukativ muzikor nxënësëve nuk duhet t'ua ndërpresim lojën kreative, përkundrazi ajo duhet të gërshetohet me të gjitha komponentet e edukimit. "Ne dëshirojmë që fëmijët ti zhvillojmë emocionalisht, ti sensibilizojmë ata, t'ua zgjojmë fantazinë, ti nxisim shprehjet e tyre kreative dhe ndjenjat ndaj të bukurës".376
Ndërlidhja e suksesshme arrihet me planifikimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve mësimore në lëndët e ndryshme me shfrytëzimin e përvojës së nxënësve, me qëndrimin e drejtë të mësimdhënësit

375 Rudi Drita – Rafet Rudi, Edukata 3. Dukagjini, Pejë, 2006, fq.8
376 Casopis "Muzicka kultura", broj 5, Zagreb. 1982, fq. 189

ndaj lëndëve tjera mësimore, me hartimin dhe shfrytëzimin e teksteve shkollore dhe aktiviteteve të lira.

Nxënësit, duke dëgjuar një vepër muzikore, përshtypjet emocionale mund t'i nxisin ata për shprehje kreative për vizatim dhe anasjelltas. Tejtrajtime të tilla asociative të përshtypjeve, janë të njohura në krijimtarinë dhe pedagogjinë muzikore. Prirjet kreative në shkallë të ndryshme nuk duhet të jenë pengesë e punës së përbashkët dhe individuale te nxënësve, përkundrazi, këto mund të jenë motivim dhe nxitje për punë më të frytshme.

Mësimdhënësi duhet të jetë ai i cili orën e vizatimit do ta bëjë edhe më inspiruese duke e ndërlidhur dëgjimin e ndonjë vepre muzikore që për nga shprehja përkon me karakterin e temës nga edukimi figurativ në mënyrë që ata të shprehin sa më mire potencialin e tyre krijues.

Ndërlidhja e edukimit muzikor me lëndën e historisë:

Arti dhe vlerat artistike edhe kanë karakter shoqëror – historik ngase kushtëzohen nga niveli i zhvillimit të mardhënieve shoqërore, nga niveli i qytetërimit njerëzor.
Nëpërmjet këngës nxënësit përjetojnë më thellë ngjarjet e ndryshme që kanë ndodhur gjatë historisë.
Veprat që paraqesin figurat e heronjve dhe ngjarjet historike, shërbejnë si mjet motivues emocional në orët e historisë dhe mund të bëhen shkas për krijimtari muzikore me karakter heroik.
Nxënësit më thellë e ndjejnë heroizmin e popullit përmes veprave muzikore dhe shprehjeve tjera artistike.
Pra, për ta fuqizuar përjetimin dhe të kuptuarit e përmbajtjeve muzikore, në mësimin e edukimit muzikor aplikohen në mënyrë të ndërsjellë njohuritë nga lëndët tjera, si domosdoshmëri e vazhdimësisë së ndërlidhjes në edukimin dhe arsimimin muzikor.
Ja një shembull ku përmes këngës arrihet përjetimi i (muzikës-melodisë), këngës dhe përvetësimi i përmbëjtjes tekstuale për dëshmorët e pavarësisë.

Këto këngë rrëfejnë të kaluarën dhe të sotmen historike, ato janë nxitje për për liri, pavarësi e drejtësi shoqërore.

Ndërlidhja e edukimit muzikor me njohjen e kulturave të ndryshme

Ndërlidhja me folklorin muzikor në kontekstin e njohjes së kombeve dhe vendeve të ndryshme, do ti njohë nxënësit për së afërmi edhe me vlerat shpirtërore muzikore, të këtyre vendeve.
Ngjarjet historike e aktuale të një kombi,përshkrimi i natyrës së një vendi, personalitetet e njohura, kompozitorët mund t'i shprehin përmes gjinive të ndryshme muzikore: me muzikë orkestrale, programore, në formën e poemës simfonike si tërësi të pandashme etj. P.sh. është e njohur poema simfonike "Vëlltava", e kompozitorit çek, Bedzhih Smetana, i cili përmes tingujve muzikor përshkuan

rrjedhën e lumit Vëlltava që nga burimi i tij. Kompozitori edhe përmes simboleve muzikore shpreh forcën, guximin dhe trimërinë, me tinguj të fuqishëm, ritëm të theksuar, melodi të karakterit dramatik(përmes frymorëve të tunxhit), pastaj krenarinë, entuziazmin, gëzimin dhe mallëngjimin e bashkëvendësve të tij.

"Vëlltava" shtratin e saj e fillon me dy burime në një hije mali (dy flauta),

të cilat pastaj shkrihen në një përrua. Ajo duke rrjedhë nëpër Çeki krijon shtratin e një lumi të madh. Duke kaluar nëpër male, dëgjohet zëri i bririt (kornës), e cila paralajmëron kohën për gjueti, ndërsa duke kaluar nëpër fushat e bujshme me lule dëgjohen vallet e ahengut dasmor.

"Pra, gjeografia muzikore mund të pasurojë njohuritë e përgjithshme të nxënësve për vendet dhe popujt e ndryshëm".377 Temën e poemës simfonike "Vëlltava", nxënësit mund ta këndojnë para dëgjimit të veprës.

Si ndërlidhje mjaft e ngushtë është lidhja në mes të cilësive muzikore dhe shtrirjes gjeografike ku mund të dallohet se cilit komb i takon, kështu që do të vërehet më lehtë muzika autoktone e një populli.
''Shpjegimet dhe përshkrimet lidhur me një vend të caktuar do të jenë më piktoreske po të shoqërohen edhe me ilustrime muzikore të popullit të këtij vendi''.378
Edukimi muzikor mund të ndërlidhet me lëndë të ndryshme duke i plotësuar ato me elementin muzikor që ndihmon arritjen e përjetimeve më të thella gjatë përfitimit të njohurive në lëndët respektive.

Nga ana tjetër për ta lehtësuar përjetimin dhe të kuptuarit e përmbajtjeve muzikore, në mësimin e edukimit muzikor aplikohen në mënyrë të ndërsjellë njohuritë nga lëndët tjera, si domosdoshmëri e vazhdimësisë së ndërlidhjes në edukimin dhe arsimimin muzikor.

377 Spahiu, mr.Seniha Metodika e muzikës. Prishtinë, 2009 fq.269
378 Spahiu, mr.Seniha Metodika e muzikës. Prishtinë, 2009 fq.269

LITERATURA

Literatura bazë

Antoni, Lorenc. Folklori muzikor shqiptar. bleni VI. Prishtinë, 1974.
Borota, Olga. "My first ABC book" (Libri im i parë i alfabetit anglez). Beograd, 1985.
Dali Emërllahu. Edukata estetike. Prishtinë, 2001.
Požgaj, Jože. Metodika glazbenog odgoja u osnovnoj školi. Zagreb, 1975.
Radosh Mirkoviq, Ksenija. Psihologija muzičkih sposobnosti. Beograd, 1983.
Rudi Drita – Rafet. Edukata 3. Pejë, 2006.
Rudi Drita – Rafet. Edukata 6. Pejë, 2004.
Spahiu, mr. Seniha. Metodika e mësimit të muzikës. Prishtinë, 2009.
Spahiu, mr. Seniha. Doracak metodik për arsimtarë të edukatës muzikore. Prishtinë, 1976.
Spahiu, mr. Seniha. Edukata muzikore 7, Prishtinë, 2009.
Spahiu, Seniha; Jashari, Baki; Luzha, Besa. Edukata muzikore 9, Prishtinë, 2006,

Literatura ndihmëse

Abraham, Gerald. Oksfordska istoria muzike 1. Beograd, 2002.
Ballata, Zeqirja. Gjurmave të muzikës. Prishtinë, 1987.
Časopis (revista) "Muzička kultura" br.5 Zagreb, 1982.
Grillo, prof. dr. Kozma. Fjalor edukimi. Tiranë, 2002.
Grup autorësh. Fjalor serbokroatisht - shqip. Prishtinë, 1974.
Grup autorësh. Fjalor derjtshkrimor i gjuhës shipe. Tiranë, 1976.
Kramarshek, Josip. Estetska gimnastika - osnovi. Zagreb 1952.
Mailaret, Gaston. Pedagogjia e përgjithshme. Prishtinë, 1997.
Nishku, Majlinda. Si te shkruajmë - procesi dhe shkrimet funksionlale .Tiranë, 2004.
Oscar Wilde. Aforizma të pa shkruara ndonjëherë, Tiranë, 2001.
Sopi, Balliu, Albana, Fjalor muzikorë enciklopedik. Tiranë, 2003.
Shupo, Sokol. Fjalor i termave muzikore. Tiranë, 1999.
C. Burime nga interneti:
http://en.wikipedia.org/wiki/Claude_Debussy
http://en.wikipedia.org/wiki/Seneca
http://en.wikipedia.org/wiki/Verdi
http://www.google.com

ON THE WAY TO MOURNING IN *HAMLET*

Prof. Dr. Sonia Vitanova-Strezova,
Ss Cyril and Methodius University of Skopje,
Republic of Macedonia

On the Way to Mourning in *Hamlet*

‘Tis not alone my inky cloak, good mother,
Nor customary suits of solemn black,
Nor windy suspiration of forced breath,
No, nor the fruitful river in the eye,
Nor the dejected haviour of the visage,
Together with all forms, modes, shows of grief,
That can denote me truly; these indeed “seem,”
For they are actions that a man might play;
But I have that within which passeth show;
These but the trappings and the suits of woe.

(Act I, Sc. II)

This is how Shakespeare gushes forth Hamlet’s sorrow through the lines of the play, sorrow - immense and immeasurable, going beyond tears “suits of solemn black” or any other way of its outward manifestation. These lines are also Hamlet’s response to his mother when she endeavours to persuade him to accept the transience of life as something “common”, for “all that lives must die, / Passing through nature to eternity.”

Hamlet, however, cannot reconcile himself to his father's death. His soul is overwhelmed by "the trappings and the suits of woe". This scene displays the first point in the play where Hamlet himself talks about the overwhelming grief entrapping his soul in response to the reproaches of his stepfather and mother for his sadness that he does not manage to hide. This is how the topic of mourning is introduced in the play through the typical situation in which the loss or death of someone brings grief to another person.

In his essay "Mourning and Melancholia", Freud defines mourning as: ''regularly the reaction to the loss of a loved person, or to the loss of some abstraction which has taken the place of one, such as one's country, liberty or ideal, and so on". The meaning of the English word "mourning" comprises both the effects of grief and its outward manifestation.[1]

According to these definitions, the beginning of the play unfolds the typical background for mourning with all the circumstances that should invoke it. However, in spite of the presence of death and Hamlet's immeasurable grief, it only seems that he is mourning for the loss of his father, but things are never what they "seem" to be in the play. The main character sets off on the way to mourning; however, it turns out that the winding path to mourning in the play is somehow aborted or obstructed. Not only Hamlet, but all the characters trying to mourn, at some point, are deflected from their objective or prevented from attaining it. Ophelia's way to mourning leads her to madness. Laertes' mourning is only a tool used by Claudius who guides his destiny. Thus, failure in mourning on the large scale in the play is reflected through the failure

[1] See Freud, "Mourning and Melancholia" (1915), SE 14, p. 243.

of the main character. Being dispossessed of the throne and power and forced to live in the kingdom ruled by his father's murderer, Hamlet's grief seems to be buried in his soul for ever, crushing him inwardly for he is unable to manifest it in the open. The way to mourning of the main character is paved by his attempts and failures until the final hour, the hour of his destruction, which brings about renewal of life, but only after Hamlet's death.

There is something "unnatural" in the whole play, pervaded by failures to mourn, abbreviated and maimed funeral rituals, transpositions from sanity to madness, appearances of ghosts, excess of grief and emotions, something surpassing the boundaries of normality and stepping over the inner psychic world of the play. This unnatural, abnormal or peculiar thing, which lies at the core of the enigma of mourning and its accomplishment, is especially centred on the main character. Hamlet's inability to undergo the normal state of mourning, his "antic disposition", and the labyrinth of his outrageous puns, innuendoes and conceits indicate that his peculiarity is deeply rooted in his inner psychic nature and, therefore, can only be accounted for through analysis of the same.

Making a distinction between mourning and melancholia, Freud says: "although mourning involves great departures from the normal attitude to life, it never occurs to us to regard it as a pathological condition and to refer it to medical treatment".[2] According to Freud, in mourning the libido's attachment withdraws from the loved object after the reality testing has proved that the loved object does not exist any more. This is performed gradually, by bringing up each one of the memories and expectations in which the libido is bound to the object so that the detachment of the libido can be

[2] See Freud, "Mourning and Melancholia", pp. 243-244.

realised. Eventually, after the work of mourning, the libido remains uninhibited and free again. What is crucial, however, for the character of Hamlet is the correlation of mourning and melancholia both manifested through the profoundly painful dejection, cessation of interest in the outside world, loss of the ability to love and inhibition of activity. However, Hamlet's behaviour goes beyond that, surpassing the pure state of mourning.

Throughout the whole play Hamlet is embittered, because he is unable to act despite his great "cause". Thus, in the second act, comparing his inhibition to the passion of actors, Hamlet says:

> Yeti,
>
> A dull and muddy-mettled rascal, peak,
>
> Like John-a-dreams, unpregnant of my cause,
>
> And can say nothing; no, not for a king,
>
> Upon whose property and most dear life
>
> A damn'd defeat was made. Am I a coward?
>
> Who calls me villain?
>
> (Act II, Sc. II)

As the lines progress he plunges in such a cascade of abuses and reproaches, calling himself "pigeon-liver'd and lack gall", "ass", "whore", "drab", "scullion" and what not, that ultimately he ends with complete denigration of his personality and his selfesteem.[3] In this scene as in many others where he uses each occasion to describe himself as petty,

[3] The sexual allusion in the words "unpregnant" and "whore" implies the absence of phallus and, therefore, castration. I will be referring to the phallus and castration later in the essay.

